

BIBLËN MUND TA KUPTOSH EDHE TI!

***Ungjilli sipas Palit:
Romakëve***

Nga Dr. Bob Utley, profesor në pension i Hermeneutikës
(Interpretimit Biblik)

*SERIA E KOMENTARËVE STUDIMORË UDHËZUES
DHIATA E RE, VËLLIMI 5*

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEKSAS
2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime të përdorura në këtë komentari	i
Një fjalë nga autori: Si mund të të ndihmojë ky komentari?iii
Udhëzues për leximin e mirë biblik: Kërkim personal për të vërtetën e verifikueshme	v

Komentari:

Hyrje për Romakëve	1
Romakëve 1	5
Romakëve 2	41
Romakëve 3	55
Romakëve 4	73
Romakëve 5	84
Romakëve 6	102
Romakëve 7	114
Romakëve 8	127
Romakëve 9	154
Romakëve 10	178
Romakëve 11	189
Romakëve 12	202
Romakëve 13	218
Romakëve 14	235
Romakëve 15	247
Romakëve 16	261
Shtojca një: Përcaktime të termave gramatikore greqisht	275
Shtojca dy: Kritika e tekstit	284
Shtojca tre: Fjalorth	287
Shtojca katër: Deklaratë doktrinare	294

TABELA E PËRMBAJTJES PËR TEMAT E VEÇANTA TE ROMAKËVE

Dërgoj (<i>Apostellō</i>), 1:1	7
<i>Kerygma</i> e kishës së hershme, 1:2	9
Biri i Perëndisë, 1:3.	9
Mishi (<i>Sarx</i>), 1:3.	11
Mesia, 1:4	12
Emrat për Hyjninë, 1:4	13
Besoj, zë besë, besim dhe besnikëri në DHV, 1:5	16
Anësitë ungjillore të Bobit, 1:5	19
Të thirrur. 1:6	19
Shenjtore, 1:7.	20
Atëroriteti i Perëndisë, 1:7	21
Fryma (<i>pneuma</i>) në DHR, 1:8.	23
Shpëtimi (term i DHV), 1:16	25
Drejtësia, 1:17	27
Perëndia i përshkruar si njerëzor (gjuha antropomorfike), 1:18	30
“E vërteta” në shkrimet e Palit, 1:18	31
Njoh, 1:19.	32
Shkatërroj, Shkretoj, Korruptoj (<i>Phtheirē</i>), 1:23.	34
Zemra, 1:24	35
Përgjithmonë (Idioma greke), 1:25.	35
Amen, 1:25.	36
Homoseksualiteti, 1:26,27.	37
Veset dhe Virtytet në Dhiatën e Re, 1:29-31	38
Përdorimi nga ana e Palit e fjalëve të përbëra me <i>Huper</i> , 1:30.	39
Pendimi, 2:4	44
Racizmi, 2:11	46
Mburrja, 2:17	50

Termet greqisht për “Vënien në provë” dhe ngjyrimet e tyre kuptimore, 2:18	51
Anuloj dhe shfuqizoj (<i>Katargeō</i>), 3:3.	57
Lavdia, 3:23	63
Prova të DHR për shpëtimin personal, 3:24	64
Shpërblej/Shpengoj, 3:24	64
Literatura lindore, 3:27	69
Monoteizmi, 3:30.	70
Besoj/Besim, 4:5.	76
Vula, 4:11	79
Garanci, 4:16	81
Paqe, 5:1.	86
Qëndroj (<i>Histēmi</i>), 5:2	87
Siguria, 5:2	88
Pse vuajnë të krishterët?, 5:3.	90
Mundimi, 5:3	90
Rritja e krishterë, 5:4	91
Mbretërimi në Mbretërinë e Perëndisë, 5:17,18	99
Pagëzimi, 6:3-4	104
Shenjtërimi, 6:4	105
Forma (<i>Tupos</i>), 6:17	111
Lavdërimi, Lutja dhe falenderimi i Palit ndaj Perëndisë, 7:25.	125
Jezusi dhe Fryma, 8:9	133
Trinia, 8:11	134
Trashëgimia e besimtarëve, 8:17	138
Burimet natyrore, 8:19	140
Shpresa, 8:25	143
Nevoja për të këmbëngulur, 8:25	144
Personaliteti i Frymës, 8:27	146

I parëlindur, 8:29	148
Zgjedhja/Paracaktimi dhe nevoja për një drejtpeshim teologjik, 8:33.	149
<i>Archē</i> , 8:38.	152
Ndërgjegjia, 9:1	157
Lutja ndërmjetësuese, 9:3	158
Mallkimi (<i>Anathema</i>), 9:3	160
Izraeli, 9:4	161
Besëlidhja, 9:4	162
Terminologjia antropomorlike për Perëndinë, 9:13.	165
Dashmirësia (<i>Hesed</i>), 9:15	167
Mbetja, tre kuptimet, 9:27-28	171
Emrat për Perëndinë, 9:29	172
Guri i qoshes, 9:33.	176
Njoh/di, 10:2.	180
Nënshtrimi, 10:3	180
Kohë foljesh në greqisht të përdorura për shpëtimin, 10:4.	182
Rrëfimi, 10:9	183
Emri i Zotit, 10:9.	184
Përndritja/Ndriçimi, 10:18.	187
Femohimi, 11:21	196
Misteri, 11:25	198
I Shenjtë, 12:1	204
Kjo epokë dhe epoka e ardhshme, 12:2.	205
Përtërij (<i>Anakainōsis</i>), 12:2	206
Vullneti (<i>Thelēma</i>) i Perëndisë, 12:2	206
Profecia në Dhiatën e Re, 12:6	209
Bujar, i sinqertë (<i>Haplotes</i>), 12:8	211
<i>Koinōnia</i> , 12:13	215

Autoriteti, 13:1	220
Qeveria njerëzore, 13:1	220
Pikëpamja e Palit për Ligjin e Moisiut, 13:9	225
Shënime mbi Eksodin 20,13:15,17.	226
Dobësia, 14:1	237
A duhet ta gjykojnë të krishterët njëri-tjetrin?, 14:13	241
Mbretëria e Perëndisë, 14:17	243
Ndërtoj, 15:2	249
Teprojt (<i>Perissevō</i>), 15:13	252
I krishteri dhe uria, 15:26.	257
Gratë në Bibël, 16:1	263
Kisha (<i>Ekklesia</i>), 16:1	265
Ligësia si person, 16:20.	269
I përjetshëm, 16:26.	273

SHKURTIME TË PËRDORURA NË KËTË KOMENTAR

- AB Anchor Bible Commentaries, ed. William Foxwell Albright and David Noel Freedman (*Komentarët e Biblës Ankor*, red. Uilliam Foksuell Ollbrajt dhe Dejvid Noel Fridman)
- ABD Anchor Bible Dictionary (6 vols.), ed. David Noel Freedman (*Fjalori i Biblës Ankor* (6 vëll.) red. Dejvid Noel Fridman)
- AKOT Analytical Key to the Old Testament by John Joseph Owens (*Çelësi analitik i Dhiatës së Vjetër* nga Xhon Xhozef Ouens)
- ANET Ancient Near Eastern Texts, James B. Pritchard (*Tekste të lashta të Lindjes së Afërme*, Xhejms B. Priçard)
- BAGD A Greek-English Lexicon of the New Testament and Early Christian Literature, Walter Bauer, 2nd edition by F. W. Gingrich and Fredrick Danker (*Leksik greqisht-anglisht i Dhiatës së Re dhe Literaturës së hershme të krishterë*, Uollter Bauer, botimi i 2-të nga F. U. Gingriç dhe Fredrik Danker)
- BDB A Hebrew and English Lexicon of the Old Testament by F. Brown, S. R. Driver and C. A. Briggs (*Leksik hebraisht dhe anglisht i Dhiatës së Vjetër* nga F. Braun, S. R. Drajver and Ç. A. Brigs)
- BHS Biblia Hebraica Stuttgartensia, GBS, 1997 (*Bibla hebraike e Shtutgartit*)
- IDB The Interpreter's Dictionary of the Bible (4 vols.), ed. George A. Buttrick (*Fjalori i Biblës i Interpretuesit* (4 vëll.), red. Xhorxh A. Butrik)
- ISBE International Standard Bible Encyclopedia (5 vols.), ed. James Orr (*Enciklopedia Ndërkombëtare Standarde e Biblës* (5 vëll.), red. Xhejms Orr)
- JB Jerusalem Bible (*Bibla e Jerusalemit*)
- JPSOA The Holy Scriptures According to the Masoretic Text: A New Translation (The Jewish Publication Society of America) – *Shkrimet e Shenjta sipas Tekstit Masoretik: Një përkthim i ri* (Shoqëria hebreje e botimeve e Amerikës)
- KB The Hebrew and Aramaic Lexicon of the Old Testament by Ludwig Koehler and Walter Baumgartner (*Leksiku hebraisht dhe aramaisht i Dhiatës së Vjetër* nga Ludvig Kohler dhe Uolltër Baumgartner)
- LAM The Holy Bible From Ancient Eastern Manuscripts (the Peshitta) by George M. Lamsa – *Bibla e Shenjtë nga dorëshkrime të lashta lindore (Peshita)* nga Xhorxh M. Lamsa
- LXX Septuaginta (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
- MOF A New Translation of the Bible by James Moffatt (*Një përkthim i ri i Biblës* nga Xhejms Mofat)

MT	Masoretic Hebrew Text (<i>Teksti Hebre Masoretik</i>)
NAB	New American Bible Text (<i>Teksti i Biblës së Re Amerikane</i>)
NASB	New American Standard Bible (<i>Bibla e Re Standarde Amerikane</i>)
NEB	New English Bible (<i>Bibla e Re Anglisht</i>)
NET	NET Bible: New English Translation, Second Beta Edition ii (<i>Bibla NET: Përkthimi i Ri Anglisht, Botimi i Dytë Beta ii</i>)
NIDNTT	New International Dictionary of New Testament Theology and Exegesis (5 vols.), ed. Willem A. VanGemeren (<i>Fjalori i ri ndërkombëtar i teologjisë dhe eksegjzës së Dhiatës së Re</i> (5 vëll.), red, Vilem A. VanGemeren)
NRSV	New Revised Standard Bible (<i>Bibla e Re Standarde e Rishikuar</i>)
NIV	New International Version (<i>Versioni i Ri Ndërkombëtar</i>)
NJB	New Jerusalem Bible (<i>Bibla e Re e Jerusalemit</i>)
OTPG	Old Testament Parsing Guide by Todd S.Beall, William A. Banks and Colin Smith (<i>Udhëzues i analizës gramatikore për Dhiatën e Vjetër nga Tod S.Bioll, Uilliam A. Benks dhe Kolin Smith</i>)
REB	Revised English Bible (<i>Bibla e Rishikuar Anglisht</i>)
RSV	Revised Standard Version (<i>Versioni i Rishikuar Standard</i>)
SEPT	Septuaginta (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
TCNT	The Twentieth Century New Testament (<i>Dhiata e Re e Shekullit të Njëzetë</i>)
TEV	Today's English Version from United Bible Societies (<i>Versioni i Sotëm Anglisht nga Shoqëritë e Bashkuara Biblike</i>)
YLT	Young's Literal Translation of the Holy Bible by Robert Young (<i>Përkthimi i Fjalëpërfjalshëm i Jang i Biblës së Shenjtë nga Robert Jang</i>)
ZPBE	Zondervan Pictorial Bible Encyclopedia (5 vols.), ed. Merrill C. Tenney (<i>Enciklopedia Biblike Zondervan me Figura</i> (5 vëll.), red. Merill Ç. Teni

NJË FJALË NGA AUTORI

SI MUND TË TË NDIHMOJË KY KOMENTAR?

Interpretimi biblik është një proces arsytues dhe shpirtëror që përpiqet të kuptojë një shkrimtar të lashtë të frymëzuar, në mënyrë të tillë që mesazhi i dhënë nga Perëndia të mund të kuptohet dhe të zbatohet në kohën tonë.

Procesi shpirtëror është kyç, por i vështirë për t'u përcaktuar. Ai kërkon qëndrim të dorëzuar dhe të hapur ndaj Perëndisë. Duhet të kesh uri (1) për Perëndinë, (2) për ta njohur atë dhe (3) për t'i shërbyer. Ky proces përfshin lutjen, rrëfimin dhe gatishmërinë për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Fryma është kyç në procesin interpretues, por mbetet mister pse të krishterët e sinqertë dhe të perëndishëm e kuptojnë Biblën ndryshe nga njëri-tjetri.

Procesi arsytues është më i lehtë për t'u shpjeguar. Duhet të jemi konsekuentë dhe të ndershëm me tekstin, dhe të mos ndikohemi nga anësitë tona personale apo denominacionale. Të gjithë jemi të kushtëzuar historikisht. Askush prej nesh s'është interpretues objektiv dhe asnjans. Ky komentuar ofron një proces të kujdesshëm arsytues që përmban tri parime interpretuese, që janë strukturuar për të na ndihmuar të tejkalojmë anësitë tona.

Parimi i parë

Parimi i parë është të vërejmë sfondin historik ku u shkrua libri biblik, si dhe shkasit e veçantë historik për autorësinë e tij. Autori fillestar donte të përçonte një synim, një mesazh. Teksti nuk mund të ketë për ne një kuptim që nuk e pati kurrë për autorin fillestar, të lashtë e të frymëzuar. Çelësi është synimi i autorit, jo nevoja jonë historike, emocionale, kulturore, personale, apo denominacionale. Zbatimi është partner i pandashëm i interpretimit, por interpretimi i drejtë duhet t'i paraprijë gjithmonë zbatimit. Duhet ritheksuar se çdo tekst biblik ka një kuptim të vetëm dhe jo më tepër. Ky kuptim është ai që synonte t'i përçonte kohës së vet autori biblik fillestar përmes udhëheqjes së Frymës. Ky kuptim i vetëm mund të ketë shumë zbatime të mundshme për kultura dhe situata të ndryshme. Këto zbatime duhen lidhur me të vërtetën qendrore të autorit fillestar. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon që të sigurojë një hyrje për secilin libër të Biblës.

Parimi i dytë

Parimi i dytë është të identifikojmë njësitë letrare. Secili libër biblik përbën një dokument të unifikuar. Interpretuesit nuk kanë të drejtë të izolojnë njërin aspekt të së vërtetës duke përjashtuar të tjerët. Prandaj, duhet të rrekemi të kuptojmë synimin e gjithë librit biblik përpara se të interpretojmë njësitë e veçanta letrare të tij. Pjesët e veçanta (kapitujt, paragrafët, apo vargjet) nuk mund të kenë një kuptim ndryshe nga ai i gjithë njësisë në tërësi. Interpretimi duhet të zhvendoset nga qasja deduktive ndaj tërësisë drejt qasjes induktive ndaj pjesëve. Për këtë arsye, ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që të analizojë strukturën e secilës njësi letrare sipas paragrafëve. Ndarjet sipas paragrafëve apo kapitujve nuk janë të frymëzuara, por na ndihmojnë që të identifikojmë njësitë e mendimit.

Interpretimi në nivelin e paragrafit (jo në nivelin e periudhës, fjalisë, frazës apo fjalës) është çelësi për të ndjekur kuptimin e synuar të autorit biblik. Paragrafët bazohen në një tematikë të unifikuar, shpesh e quajtur tema, ose fjalia temë. Çdo fjalë, frazë, fjali dhe periudhë e paragrafit lidhet në njëfarë mënyre me këtë temë të unifikuar. Ato e kufizojnë, zgjerojnë, shpjegojnë dhe/ose e vënë në pikëpyetje. Një çelës i vërtetë për interpretimin e saktë është të ndjekim mendimin e autorit fillestar paragraf për paragraf përmes njësive të veçanta letrare që përbëjnë librin biblik. Ky komentuar studimi udhëzues synon të ndihmojë studiuesin që ta bëjë këtë duke krahasuar përkthimet e sotme në gjuhën angleze. Këto përkthime janë përzgjedhur për shkak se përdorin teori të ndryshme përkthimi:

1. Teksti greqisht i United Bible Society (Shoqëria e Bashkuar Biblike) është botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴). Ky tekst është ndarë në paragrafë nga studiues të sotëm teksti.
2. Versioni New King James (NKJV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm i bazuar në traditën e dorëshkrimeve greqisht të njohur si *Textus Receptus*. Ndarjet e paragrafëve të tij janë më të gjata se në përkthimet e tjera. Këto njësi më të gjata e ndihmojnë studiuesin që të shohë temat e unifikuara.

[Kur autori i komentarit citon nga NKJV, përkthyesit në shqip citojnë nga versioni LIM, i cili i përket të njëjtës familje tekstuale si NKJV. Shënim i përkthyesit.]

3. Versioni New Revised Standard (NRSV) është një përkthim i fjalëpërfjalshëm, por i modifikuar. Ai përbën një pikë të ndërmjetme mes dy versioneve të mëposhtme moderne. Ndarjet e tij të paragrafëve janë tejet të dobishme për identifikimin e temave.
4. Versioni Today's English (TEV) është një përkthim ekuivalent dinamik i botuar nga Shoqëria e Bashkuar Biblike. Ai përpiket ta përkthejë Biblën në mënyrë të tillë që çdo lexues ose folës modern i anglishtes të mund të rrokë kuptimin e tekstit greqisht. Shpesh, sidomos në ungjijtë, ai i ndan paragrafët sipas folësve, jo sipas temës, në të njëjtën mënyrë si NIV. Për synimet e interpretuesit, kjo nuk është e dobishme. Është interesante të vërejmë se, si UBS⁴, ashtu dhe TEV, janë botuar nga e njëjta organizatë, e megjithatë ndarja e paragrafëve të tyre ndryshon.
5. Bibla e New Jerusalem (NJB) është një përkthim ekuivalent dinamik i bazuar në përkthimin katolik francez. Është shumë i dobishëm për krahasimin e ndarjes së paragrafëve nga pikëvështrimi evropian.
6. Teksti i shtypur është ai i New American Standard Bible (NASB), i përditësuar në vitin 1995, i cili është një përkthim i fjalëpërfjalshëm. Paragrafët e tij ndiqen nga komentet e mia varg për varg. [Në shqip, përkthyesi ka përkthyer drejtpërdrejt NASB-në sa herë që përdoret në komentar. Shënim i përkthyesit.]

Parimi i tretë

Parimi i tretë është ta lexojmë Biblën në përkthime të ndryshme me qëllim që të kapim gamën më të gjerë të mundshme kuptimore (fusha semantike) që mund të kenë fjalët ose frazat biblike. Shpesh, fraza ose fjala greqisht mund të kuptohet në një sërë mënyrash. Këto përkthime të ndryshme i nxjerrin në pah këto alternativa dhe ndihmojnë në identifikimin dhe shpjegimin e varianteve në dorëshkrimet greqisht. Këto nuk ndikojnë në doktrinë, por, gjithsesi, na ndihmojnë në përpjekjen për t'u kthyer te teksti origjinal i shkruar nga shkrimtari i frymëzuar në lashtësi.

Ky komentar ofron një mënyrë të shpejtë që studiuesi të kontrollojë interpretimet e veta. Ai nuk synon që të thotë fjalën e fundit, por të jetë informues dhe të nxisë mendimin. Shpesh, interpretimet e tjera të mundshme na ndihmojnë që të mos bëhemi tepër të provincialë, dogmatikë dhe denominacionalë. Interpretuesve u nevojitet një gamë më e gjerë alternativash interpretuese për të kuptuar sesa i vagullt mund të jetë teksti i lashtë. Është tronditëse sesa pak konsensus ekziston mes të krishterëve që pretendojnë se burimi i tyre i së vërtetës është Bibla.

Këto parime më kanë ndihmuar të tejkaloj një pjesë të mirë të kushtëzimit tim historik, pasi më kanë detyruar të "përleshem" me tekstin e lashtë. Shpresoj se kjo gjë do të jetë bekim edhe për ty.

Bob Utley
East Texas Baptist University
27 qershor 1996

UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIK: KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet? E verifikojmë dot logjikisht? A ekziston autoriteti absolut? A ka vlera absolute që mund të na udhëheqin jetën dhe botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë? Këto pyetje (pyetje që përsiasin të gjithë njerëzit e logjikshëm) e kanë përndjekur mendjen njerëzore që nga agu i kohës (Pred. 1:13-18; 3:9-11). Më kujtohet kërkimi im vetjak për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në moshë të re, kryesisht në bazë të dëshmisë së disa personave të rëndësishëm në familjen time. Me rritjen drejt pjekurisë, m'u rritën edhe pyetjet për veten dhe botën time. Klishtë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk u jepnin kuptim përjetimeve për të cilat lexoja dhe me të cilat ndeshesha. Ishte një kohë pësjtjellimi, kërkimi, përmallimi dhe, shpesh, e një mungese shprese përballë botës së pandjeshme dhe të ashpër ku jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje për këto pyetje absolute, por, pas hulumtimeve dhe përsiatjeve, vërejtja se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite të lashta, (3) përjetime personale, ose (4) projeksione psikologjike. Kisha nevojë për njëfarë mase verifikimi, njëfarëlloj prove, një logjikë mbi të cilën të bazoja botëkuptimin tim, qendrën time integruese, arsyen për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin e Biblës. Fillova të shqyrtoja për prova për vërtetësinë e saj, të cilat i gjeta në (1) besueshmërinë historike të Biblës, e vërtetuar nga arkeologjia, (2) saktësinë e profecive të Dhiatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës gjatë një mijë e gjashtëqind viteve të prodhimit të saj, dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve të cilëve iu ndryshoi jeta një herë e përgjithmonë nga kontakti me Biblën. Krishterimi, si sistem i unifikuar besimi dhe bindjesh, ka aftësinë që të trajtojë pyetjet e koklavitura të jetës njerëzore. Kjo jo vetëm që më siguroi një kornizë logjike, por aspekti përjetues i besimit biblik më solli edhe gëzim e qëndrueshmëri emocionale.

Mendova se e gjeta qendrën integruese për jetën time: Krishtin, siç kuptohet përmes Shkrimeve. Ishte një përjetim ngazëllues, një çlirim emocional. Megjithatë, ende më kujtohet tronditja dhe dhimbja që pata kur fillova të kuptoja se sa shumë interpretime të ndryshme të këtij libri propagandoheshin, nganjëherë edhe brenda të njëjtave kisha dhe shkolla mendimi. Pohimi i frymëzimit dhe vërtetësisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i vërtetoj ose mohoj interpretimet e larmishme dhe të kundërta të pasazheve të shumta e të vështira në Bibël, që ofroheshin nga ata që besonin në autoritetin dhe vërtetësinë e saj?

Kjo detyrë u bë synimi i jetës sime dhe shtegtimi i besimit tim. E dija se besimi në Krishtin (1) më kishte sjellë paqe dhe gëzim të madh. Mendja ime kërkonte me ngulm disa vlera absolute në mes të relativitetit të kulturës sime (postmodernizmit); (2) dogmatizmi i sistemeve të kundërta fetare (fëve botërore); dhe (3) arroganca denominacionale. Në kërkimin tim për qasje të vlefshme për interpretimin e literaturës së lashtë, u habita kur zbulova dhe vetë anësitë e mia historike, kulturore, denominacionale dhe përjetuese. Shpesh, Biblën e kisha lexuar për të përforcuar pikëpamjet e mia. E përdorja si burim dogme për të sulmuar të tjerët dhe për të ripërkrahur vetë pasiguritë dhe mangësitë e mia. Sa të dhimbshëm e pata këtë ndërgjegjësim!

Ndonëse nuk mund të jem kurrë plotësisht objektiv, mund të bëhem lexues më i mirë i Biblës. Mund t'i kufizoj anësitë e mia duke i identifikuar dhe duke pranuar praninë e tyre. Ende nuk jam i çliruar prej tyre, por jam përballur me dobësitë e mia. Shpesh, interpretuesi është armiku më i keq i leximit të mirë biblik!

Më lejo të rendis disa nga presupozimet që sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ti, si lexues, t'i shqyrtosh bashkë me mua:

I. Presupozime

- A. Unë besoj se Bibla është e vetmja vetëzbulesë e frymëzuar e të vetmit Perëndi të vërtetë. Si rrjedhojë, duhet interpretuar në dritën e synimit të autorit fillestar hyjnor (Frymës) përmes shkrimtarit njerëzor në një sfond të veçantë historik.
- B. Unë besoj se Bibla është shkruar për njeriun e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia na u përshtat për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk e fsheh të vërtetën – ai dëshiron të kuptojmë! Si rrjedhojë, Bibla duhet interpretuar në dritën e kohës së vet, jo sonës. Për ne, Bibla nuk duhet të ketë kurrë një kuptim të ndryshëm nga ajo që kuptuan ata që e lexuan dhe dëgjuan për herë të parë. Ajo është e kuptueshme nga mendja e zakonshme njerëzore dhe përdor forma e teknika normale të komunikimit njerëzor.


- C. Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe synim të unifikuar. Ajo nuk bie në kundërshti me veten, ndonëse vërtet përmban pasazhe të vështira dhe paradoksale. Kështu, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.
- D. Unë besoj se çdo pasazh (përjashtoj profecitë) ka vetëm një kuptim, i bazuar në synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Ndonëse s'mund të jemi kurrë absolutisht të sigurt se e njohim synimin e autorit fillestar, shumë tregues na dëftojnë në drejtimin e tij:
1. Gjinia (lloji letrar) e zgjedhur për të shprehur mesazhin
 2. Sfondi historik dhe/ose shkasi i veçantë që solli në ekzistencë shkrimin
 3. Konteksti letrar i gjithë librit, si dhe i çdo njësie letrare
 4. Modeli (përvijimi) tekstual i njësisë letrare në mënyrën si lidhen me gjithë mesazhin
 5. Tiparet e veçanta gramatikore që janë përdorur për të komunikuar mesazhin
 6. Fjalët e zgjedhura për të paraqitur mesazhin
 7. Pasazhet paralele

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të pasazhit. Përpara se të shpjegoj metodologjinë time për leximin e mirë të Biblës, më lejoni të përvijoj disa nga metodat e papërshtatshme që po përdoren sot, të cilat kanë shkaktuar kaq shumë larmi interpretimesh dhe që, si rrjedhojë, duhen shmangur:

II. Metoda të papërshtatshme

- A. Anashkalimi i kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo periudhe, fjalie, madje dhe fjalësh të veçanta si pohime të së vërtetës pa lidhje me synimin e autorit ose kontekstin më të gjerë. Shpesh, ky quhet “përdorim i teksteve si provë”.
- B. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke e zëvendësuar me një sfond të hamendësuar historik që ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
- C. Anashkalimi i sfondit historik të librave dhe leximi i tyre si gazetën lokale të mëngjesit, të shkruar kryesisht për të krishterët e sotëm si individë.
- D. Anashkalimi i sfondit historik të librave duke alegorizuar tekstin në një mesazh teologjiko-filozofik tërësisht pa lidhje me dëgjuesit e parë apo me synimin e autorit fillestar.
- E. Anashkalimi i mesazhit fillestar duke e zëvendësuar me sistemin tonë të teologjisë, ndonjë doktrinë që e kemi për zemër, apo me ndonjë çështje bashkëkohore pa lidhje me synimin dhe mesazhin e shprehur të autorit fillestar. Shpesh, ky fenomen vijon pas leximit fillestar të Biblës si mënyrë për të mbështetur autoritetin e folësit. Rëndom, ky quhet “reagim i lexuesit” (interpretim i llojit “çfarë më thotë teksti mua?”).

Në çdo komunikim njerëzor me shkrim mund të gjenden tre përbërës të lidhur me njëri-tjetrin:



Në të shkuarën, teknikat e ndryshme të leximit janë fokusuar në njërin nga këta tre përbërës. Por, për të pohuar vërtet frymëzimin unik të Biblës, do të ishte më i përshtatshëm një diagram i ndryshuar:



Në të vërtetë, në procesin interpretues duhen përfshirë të tre këta përbërës. Për qëllime vërtetimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori fillestar dhe teksti. Ndoshta, po reagoj ndaj keqpërdorimeve që kam përmendur: (1) alegorizimi ose shpirtërizimi i teksteve dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (ç’kuptim ka teksti për mua). Keqpërdorimi mund të ndodhë në secilën fazë. Duhet t’i kontrollojmë gjithmonë motivet, anësitë, teknikat dhe zbatimet tona. Por si t’i kontrollojmë nëse nuk ka asnjë kufi, cak, apo kritere për interpretimet? Pikërisht këtu, synimi autorial dhe struktura e tekstit më sigurojnë disa kritere për t’ua kufizuar gamën interpretimeve të vlefshme të mundshme.

Në dritën e këtyre teknikave të përshtatshme leximore, cilat janë disa qasje të mundshme për leximin dhe interpretimin e mirë të Biblës, të cilat na ofrojnë një shkallë vërtetimi dhe konsistence?

III. Qasje të mundshme për leximin e mirë të Biblës

Në këtë pikë, nuk po diskutoj për teknikat unike të interpretimit të gjinive të veçanta, por për parimet e përgjithshme hermeneutike që janë të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për qasjet sipas gjinive të ndryshme është *How To Read the Bible For All Its Worth (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, botuar nga Zondervan.

Metodologjia ime fokusohet fillimisht te fakti se lexuesi duhet t’i lejojë Frymës së Shenjtë që të hedhë dritë mbi Biblën përmes katër ciklesh personale leximi. Kjo i jep Frymës, tekstit dhe lexuesit vend parësor, jo dytësor. Po kështu, kjo e mbron lexuesin që të mos ndikohet në mënyrë të panevojshme nga komentuesit. Kam dëgjuar se dikush ka thënë: “Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret”. Ky nuk synohet si koment zhvlerësues për ndihmat studimore, por si thirrje për përdorimin e tyre në kohën e duhur.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimet t’i mbështesim me vetë tekstin. Tri zona sigurojnë të paktën një vërtetim të kufizuar:

1. Autori fillestar
 - a. sfondi i tij historik
 - b. konteksti letrar
2. Zgjedhja nga ana e autorit fillestar e
 - a. strukturave gramatikore (sintaksës)
 - b. përdorimit të fjalëve të kohës
 - c. gjinisë letrare
3. Të kuptuarit nga ana jonë e
 - a. pasazheve të përshtatshme paralele
 - b. marrëdhënies mes doktrinaeve (paradoksi)

Duhet të jemi në gjendje të japim arsyet dhe logjikën e interpretimeve tona. Bibla është burimi ynë i vetëm për besimin dhe praktikën. Mjerisht, shpesh, të krishterët nuk bien dakord për ato që mëson ose pohon ajo. Është vetëkundërshtuese që ne besimtarët të pohojmë frymëzimin e Biblës dhe, pastaj, të mos jemi në gjendje të biem dakord se çfarë na mëson dhe kërkon ajo!

Katër ciklet e leximit synojnë të na sigurojnë të dhënat interpretuese të mëposhtme:

A. Cikli i parë i leximit

1. Lexo gjithë librin njëherësh. Lexoje sërish me një përkthim tjetër, ndoshta me një teori të ndryshme përkthimi
 - a. fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
2. Kërko qëllimin qendror të gjithë shkrimit. Identifiko idenë e tij kryesore.
3. Izolo (nëse është e mundur) një njësi letrare, kapitull, paragraf, apo fjali që shpreh qartë qëllimin ose idenë e tij qendrore.
4. Identifiko gjininë mbizotëruese letrare
 - a. Dhiata e Vjetër
 - (1) Narrativa hebraike
 - (2) Poezia hebraike (letërsi urtësie, psalm)
 - (3) Profecia hebraike (prozë, poezi)
 - (4) Kodet e ligjit

- b. Dhiata e Re
 - (1) Narrativa (ungjijtë, Veprat)
 - (2) Shëmbëlltyra (ungjijtë)
 - (3) Letra
 - (4) Letërsia apokaliptike
- B. Cikli i dytë i leximit
 - 1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh temat ose subjektet kryesore.
 - 2. Përvijoj temat madhore dhe shpreh shkurtimisht përmbajtjen e tyre me një pohim të thjeshtë.
 - 3. Kontrolllo pohimin e synimit dhe përvijimin tënd të përgjithshëm me anë të ndihmave studimore.
- C. Cikli i tretë i leximit
 - 1. Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh sfondin historik dhe shkasit e veçantë për shkrimin e tij, duke u bazuar në të dhënat e vetë këtij libri biblik.
 - 2. Rendit elementet historike që përmenden në librin biblik
 - a. Autori
 - b. Data
 - c. Marrësit
 - d. Arsyeja e veçantë për shkrimin e tij
 - e. Aspekte të sfondit kulturor që lidhen me qëllimin e shkrimit
 - f. Përmendje të njerëzve dhe ngjarjeve historike
 - 3. Zgjeroje përvijimin tënd në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpreton. Gjithmonë identifikoj dhe përvijoj njësinë letrare. Kjo mund të përbëhet nga një sërë kapitujsh ose paragrafesh. Kjo gjë të mundëson të ndjekësh logjikën dhe modelin tekstual të autorit fillestar.
 - 4. Kontrolllo sfondin historik duke përdorur ndihma studimore.
- D. Cikli i katërt i leximit
 - 1. Lexo sërish njësinë e veçantë letrare në disa përkthime
 - a. Fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - b. Ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - c. Parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 - 2. Gjej strukturat letrare ose gramatikore
 - a. Fraza të përsëritura, Efe. 1:6, 12, 14
 - b. Struktura të përsëritura gramatikore, Rom. 8:31
 - c. Koncepte të kundërta
 - 3. Rendit elementet e mëposhtme
 - a. Terma të rëndësishëm
 - b. Terma të pazakontë
 - c. Struktura të rëndësishme gramatikore
 - d. Fjalë, fjali dhe periudha tejet të vështira
 - 4. Gjej pasazhet e duhura paralele
 - a. Gjej pasazhin më të qartë mësimor për temën tënde duke përdorur
 - (1) Libra “të teologjisë sistematike”
 - (2) Bibla me referenca
 - (3) Përkues biblikë
 - b. Gjej një çift të mundshëm paradoksal brenda temës tënde. Shumë të vërteta biblike paraqiten në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale vijnë nga mbështetja e njëanshme te gjysma e një tensioni biblik. Gjithë Bibla është e frymëzuar, ndaj duhet të përpiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që t’i sigurojmë një drejtpeshim biblik interpretimit tonë.
 - c. Kërko për paralele brenda të njëjtit libër, të njëjtit autor, ose të njëjtës gjini letrare; Bibla është interpretuesja më e mirë e vetes, pasi ajo ka një autor të vetëm, Frymën.
 - 5. Përdor ndihmat studimore për të kontrolluar vëzhgimet e tua për sfondin dhe shkasit historik
 - a. Bibla studimore
 - b. Enciklopedi, manualë dhe fjalorë biblikë
 - c. Hyrje biblike
 - d. Komentare biblikë (në këtë pikë në studimin tënd, lejo komunitetin besimtar, të kaluar dhe të tashëm, që të të ndihmojë në studimin tënd personal dhe të ta korrigjojë).

IV. Zbatimi i interpretimit të Biblës

Në këtë pikë, i kthehemi zbatimit. Ke kaluar kohë për të kuptuar tekstin në sfondin e vet fillestar; tani, duhet ta zbatosh në jetën dhe kulturën tënde. Unë e përcaktoj autoritetin biblik si “të kuptuarit e asaj që po i thoshte autori fillestar biblik kohës së vet dhe zbatimin e asaj të vërtete në kohën tonë”.

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e synimit të autorit fillestar si nga ana kohore, ashtu dhe ajo logjike. Nuk mund ta zbatojmë pasazhin biblik në kohën tonë pa kuptuar se çfarë po thoshte ai në kohën e vet! Pasazhi biblik nuk duhet të ketë një kuptim që nuk e pati kurrë vetë!

Si udhërrëfyes do të kesh përvijimin tënd të detajuar në nivelin e paragrafit (cikli i tretë i leximit). Zbatimi duhet bërë në nivelin e paragrafit, jo fjalës. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst; periudhat kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar, që është i përfshirë në procesin interpretues, është autori fillestar. Ne ndjekim vetëm udhëheqjen e tij me anë të përndritjes së Frymës së Shenjtë. Por përndritja nuk është frymëzim. Për të thënë, “kështu thotë Zoti”, duhet t’i qëndrojmë besnikë synimit të autorit fillestar. Zbatimi duhet të ketë lidhje të veçantë me synimin e përgjithshëm të gjithë shkrimit, me njësinë e veçantë letrare dhe me zhvillimin e mendimit në nivelin e paragrafit.

Mos lejo që problematikën e kohës sonë të interpretojnë Biblën; lër Biblën të flasë vetë! Kjo mund të na kërkojë që t’i nxjerrim parimet nga teksti. Kjo është e vlefshme nëse teksti mbështet një parim të caktuar. Fatkeqësisht, shumë herë, parimet tona janë thjesht të tilla, parime “tonat” – jo parime të tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të kujtojmë se (përveçse në rastin e profecisë) vetëm një kuptim i vetëm është i vlefshëm për një tekst të caktuar biblik. Ai kuptim lidhet me synimin e autorit fillestar teksa trajtonte një krizë apo nevojës të kohës. Nga ky kuptim i vetëm mund të nxirren shumë zbatime të mundshme. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve, por duhet të ketë lidhje me kuptimin e autorit fillestar.

V. Aspekti shpirtëror i interpretimit

Deri tani, kam diskutuar për procesin logjik dhe tekstual që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin. Tani, më lejoni të diskutoj shkurtimisht për aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme më ka rezultuar e dobishme:

- A. Lutu për ndihmën e Frymës (shih 1 Kor. 1:26-2:16).
- B. Lutu për falje dhe pastrim personal nga mëkatet e njohura (shih 1 Gjonit 1:9).
- C. Lutu për një dëshirë më të madhe për të njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e më tej; 119:1 e më tej).
- D. Çdo mësim të ri zbatohet menjëherë në jetë.
- E. Vazhdo të jesh i përlulur dhe i mësueshëm.

Është shumë e vështirë të ruash ekuilibrin mes procesit logjik dhe udhëheqjes shpirtërore të Frymës së Shenjtë. Citimet e mëposhtme më kanë ndihmuar t’i ekuilibroj këto të dyja:

- A. nga James W. Sire, *Scripture Twisting (Shtrembërimi i Shkrimit)*, f. 17-18:

“Përndritja i vjen në mendje popullit të Perëndisë – jo vetëm elitës shpirtërore. Nuk ka asnjë klasë *guru*-sh në krishterimin biblik, asnjë *iluminati*, as njerëz përmes të cilëve duhet të vijë çdo interpretim i saktë. Prandaj, ndonëse Fryma e Shenjtë jep dhuntitë të veçanta urtësie, njohurie dhe mprehtësie shpirtërore, ai nuk i cakton këta të krishterë të dhuntishëm që të jenë të vetmit interpretues të autoritetshëm të Fjalës së tij. Është në dorën e secilit individ të popullit të tij që të mësojë, të gjykojë dhe të dallojë në lidhje me Biblën, e cila qëndron si autoritet edhe mbi ata të cilëve Perëndia u ka dhënë aftësi të veçanta. Si përmbledhje, supozimi që shpreh në gjithë këtë libër është se Bibla është zbulesa e vërtetë e Perëndisë për gjithë njerëzimin, se ajo është autoriteti ynë absolut për të gjitha çështjet për të cilat flet, dhe se ajo nuk është mister i plotë, por mund të kuptohet mjaftueshëm nga njerëzit e zakonshëm në çdo kulturë”.

- B. për Kirkegardin, gjetur në Bernard Ramm, *Protestant Biblical Interpretation (Interpretimi biblik protestant)*, f. 75:

Sipas Kirkegardit, studimi gramatikor, leksikor dhe historik i Biblës është hap i nevojshëm, por paraprak, drejt leximit të vërtetë të Biblës. “Për ta lexuar Biblën *si fjalë të Perëndisë*, njeriu duhet ta lexojë me emocion të madh, në majtë gishtave, me pritshmëri të madhe, në kuvendim me Perëndinë. Nëse Biblën e lexon shkel e shko, pa kujdes, apo në mënyrë akademike, apo profesionale, nuk po e lexon si Fjalë të Perëndisë. Kur njeriu e lexon Biblën siç lexon një letër dashurie, atëherë po e lexon si Fjalë të Perëndisë”.

- C. H. H. Rowley në *The Relevance of the Bible (Natyra aktuale e Biblës)*, f. 19:
 “Asnjë kuptim thjesht mendor i Biblës, sado i plotë, s’ mund t’ia zotërojë dot të gjitha thesaret asaj. Ajo nuk e përçmon këtë lloj kuptimi, sepse ai është thelbësor për të shkuar drejt të kuptuarit të plotë. Por kjo duhet të të çojë në një të kuptuar shpirtëror të thesareve shpirtërore të këtij libri, në mënyrë që të plotësohet. Dhe, për këtë të kuptuar shpirtëror, është e nevojshme diçka më tepër sesa vigjilenca mendore. Gjërat shpirtërore dallohen shpirtërisht, ndaj studiuesit të Biblës i nevojitet një qëndrim shpirtëror pranues, një zell për të gjetur Perëndinë që t’i dorëzohet atij, në mënyrë që të kalojë, përtej studimit të tij shkencor, në trashëgiminë më të pasur të librit më madhështor në botë”.

VI. Metoda e këtij komentuari

Komentari studimor udhëzues synon të të ndihmojë në procedurat interpretuese në mënyrat vijuese

- A. Një përvijim i shkurtër historik shërben si hyrje e çdo libri. Pasi të kesh kryer “ciklin tre të leximit”, kontrollo këtë informacion.
- B. Mësimet kontekstuale gjenden në fillim të secilit kapitull. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh sesi është strukturuar njësia letrare.
- C. Në fillim të çdo kapitulli ose njësie letrare kryesore, kam dhënë ndarjet e paragrafëve dhe titujt e tyre përshkruar nga një sërë përkthimesh moderne:
1. Teksti greqisht i United Bible Society, botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴)
 2. The New American Standard Bible, përditësimi i vitit 1995 (NASB)
 3. The New King James Version (NKJV)
 4. The New Revised Standard Version (NRSV)
 5. Today’s English Version (TEV)
 6. The Jerusalem Bible (JB)
- Ndarjet sipas paragrafëve nuk janë të frymëzuara. Ato duhen vërtetuar nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime moderne që nisen nga teori të ndryshme përkthimi dhe pikëvështrime të ndryshme teologjike, jemi në gjendje të analizojmë strukturën e hamendësuar të mendimit të autorit fillestar. Secili paragraf përmban nga një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalë temë”, ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretimin e duhur historik dhe gramatikor. S’ duhet kurrë të interpretojmë, të predikojmë, ose të japim mësim nga më pak se një paragraf! Gjithmonë kujto se çdo paragraf ka lidhje me paragrafët rrethues. Ja pse është kaq e rëndësishme të bësh një përvijim të të gjithë librit në nivelin e paragrafëve. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim rrjedhën logjike të temës që po trajtohet nga autori i frymëzuar fillestar.
- D. Shënimet e Bobit ndjekin një qasje interpretimi “varg për varg”. Kjo na shtrëngon të ndjekim mendimin e autorit fillestar. Shënimet sigurojnë informacion për pikat e mëposhtme:
1. kontekstin letrar
 2. të dhënat historike dhe kulturore
 3. informacione gramatikore
 4. studime fjalësh
 5. pasazhe paralele të rëndësishme
- E. Në pika të ndryshme gjatë këtij komentari, tekstit të shtypur të New American Standard Version (përditësimi i vitit 1995) do t’i shtojmë edhe përkthimet e një sërë versionesh të tjera moderne:
1. The New King James Version (NKJV), i cili ndjek dorëshkrimet tekstuale të “Textus Receptus”.
 2. The New Revised Standard Version (NRSV), i cili është një rishikim “fjalë për fjalë” i Revised Standard Version, i kryer nga Këshilli Kombëtar i Kishave (National Council of Churches).
 3. The Today’s English Version (TEV), i cili është një përkthim ekuivalent dinamik i Shoqërisë Biblike Amerikane.
 4. The Jerusalem Bible (JB), i cili është një përkthim anglisht i bazuar në një përkthim ekuivalent dinamik nga ana e katolikëve francezë.
- F. Për ata që s’lexojnë greqisht, krahasimi i përkthimeve anglisht mund t’i ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
1. variantet në dorëshkrime
 2. kuptimet e ndryshme të fjalëve
 3. tekstet dhe strukturat që janë të vështira nga ana gramatikore
 4. tekstet e paqarta

Ndonëse përkthimet anglisht nuk i zgjidhin dot këto probleme, gjithsesi i shigjetojnë si pjesë që kanë nevojë për një studim më të thellë dhe më tërësor.

- G. Në përmbyllje të çdo kapitulli, jepen pyetje të vlefshme diskutimi, të cilat përpiqen të shigjetojnë çështjet kryesore interpretuese të atij kapitulli.

HYRJE PËR LETRËN DREJTUAR ROMAKËVE

DEKLARATA HYRËSE

- A. Romakëve është libri doktrinar më sistematik dhe logjik i Apostullit Pal. Ai u ndikua nga rrethanat në Romë, prandaj është një dokument “sipas rastit.” Diçka ndodhi që e shtyu Palin ta shkruante letrën. Megjithatë, është më neutrali i shkrimeve të Palit, në atë që mënyra e Palit për t’u marrë me problemin (ka të ngjarë xhelozia midis udhëheqësve besimtarë hebrej dhe johebrej, krh. 14:1-15:13) ishte një prezantim i qartë i ungjillit dhe rrjedhëve të tij për jetën e përditshme.
- B. Romakëve është zhvillimi teologjik i të vërtetave të Galatasve. Efesianëve është zhvillimi i Romakëve në një letër përmbledhëse qarkore. Ungjilli i Palit nuk ndryshonte, por mënyra si ai e prezantonte atë, po!
- C. Prezantimi nga Pali i ungjillit të Romakëve e ka ndikuar jetën e Kishës në çdo epokë.
1. Agustini u bë besimtar në vitin 386 pas Krishtit duke lexuar Romakëve 13:13-14.
 2. Të kuptuarit e Martin Luterit për shpëtimin ndryshoi rrënjësisht në vitin 1513 pas Krishtit kur krahasoi Ps 31:1 me Rom 1:17 (krh. Hab. 2:4).
 3. Xhon Uesli, duke kaluar pranë një takimi Menonit në Londër, në vitin 1738, u kthye në besim pasi dëgjoji predikimin e Luterit mbi hyrjen e Romakëve që po lexohej, sepse predikuesi i caktuar nuk kishte ardhur!
- D. Të njohësh letrën e Romakëve është të njohësh krishtërimin! Ajo e paraqet jetën dhe mësimet e Jezusit në formën e të vërtetave themeltare për Kishën për të gjitha kohërat. Martin Luteri tha për të, “Libri kryesor në DHR dhe ungjilli më i pastër!”
- E. Unë gjithmonë i inkurajoj besimtarët e rinj të fillojnë ta lexojnë Biblën çdo ditë. Unë u rekomandoj të fillojnë me tre libra të DHR.
1. ungjillin e Gjonit, për të kuptuar Jezusin,
 2. librin e Romakëve për të kuptuar mësimet e Jezusit të zbatuara ndaj kishave,
 3. 1 Gjonit për të kuptuar si ta jetojnë ungjillin në jetën e përditshme

AUTORI

Pali është pa dyshim autori. Përshëndetja e tij tipike gjendet në 1:1. Në përgjithësi mendohet se “gjemb i në mish” i Palit ishte shikimi i kufizuar, prandaj ai nuk e shkroi letrën vetë fizikisht, por përdori një shkruar, Tercin (krh. 16:22).

DATA

- A. Një datë e mundshme për autorësinë e Romakëve është viti 56-58 pas Krishtit. Ky është një nga librat e paktë të Dhiatës së Re që mund të datohet me mjaft saktësi. Kjo bëhet duke krahasuar Veprat 20:2 e më tej me Romakëve 15:17 e më tej. Romakëve ka mundësi të jetë shkruar në Korint nga fundi i udhëtimit të tretë misionar të Palit, pak para se të nisej për në Jerusalem.
- B. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit sipas F. F. Bruce dhe Murry Harris me përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Marrëdhënia me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3

7.-10. Letrat e burgut			
Kolosianëve	fillimi i 60		
Efesianëve	fillimi i 60	Roma	
Filemoni	fillimi i 60		
Filipianëve	fundi i 62-63		28:30-31
11.-13. Udhëtimi i katërt misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë,	Maqedoni	
Titit	63 por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	63 v.64 pas Kr)	Romë	

MARRËSIT

Letra përmend si destinacion Romën. Nuk e dimë kush e themeloi kishën në Romë.

- A. Mund të kenë qenë disa nga njerëzit që ishin në Jerusalem Ditën e Rrëshajëve, të cilët besuan dhe kur u kthyen në vendin e tyre filluan një kishë (krh. Veprat 2:20).
- B. Mund të kenë qenë dishepuj që u larguan për shkak të përndjekjes në Jerusalem pas vdekjes së Stefanit (krh. Veprat 8:4).
- C. Mund të kenë qenë të kthyer në besim nga udhëtimet misionare të Palit që shkuan në Romë. Pali nuk e kishte vizituar asnjëherë këtë kishë, por kishte shumë dëshirë ta vizitonte (krh. Veprat 19:21). Ai kishte shumë miq atje (krh. Romakëve 16).

Me sa duket, plani i tij ishte të vizitonte Romën rrugës për në Spanjë (krh. Rom. 15:28) pas udhëtimit në Jerusalem me “dhuratën e dashurisë.” Pali e konsideronte të përfunduar shërbesën e tij në Mesdheun lindor. Ai kërkonte fusha të reja (krh. Rom. 15:20-23, 28). Ajo që e çoi letrën nga Pali në Korint për në Romë ishte Feba, një dhjake e cila po udhëtonte për atje (krh. Rom 16:1).

Pse është kaq e çmuar kjo letër, e shkruar në rrugët e parëndësishme të Korintit në shekullin e parë nga një çadrabërës hebre? Martin Luteri e quajti “libri kryesor në Dhiatën e Re dhe ungjilli më i pastër.” Vlera e këtij libri gjendet në faktin që ai është një shpjegim i thellë i ungjillit nga rabini i bërë i krishterë, Sauli i Tarsit, i thirrur për të qenë apostull i johebrenjve. Pjesa më e madhe e letrave të Palit kanë një ngjyrim të fortë nga një situatë lokale, por jo Romakëve. Ajo është një paraqitje sistematike e besimit të një Apostulli.

A e kuptove, mik i dashur i krishterë, që pjesa më e madhe e termave teknike që ne përdorim sot për të përshkruar “besimin” (“shfajësimi,” “veshja e drejtësisë,” “birësimi” dhe “shenjtërimi”) vijnë nga Romakëve? Ajo është zhvillimi teologjik i të vërtetave të Galatasve. Lutju Perëndisë të të ndihmojë ta kuptosh këtë letër të mrekullueshme ndërsa kërkohet së bashku vullnetin e Tij për jetët tona sot!

QËLLIMI

- A. Një kërkesë për ndihmë ndaj kishës në Romë për udhëtimin e tij misionar në Spanjë. Pali e konsideronte të përfunduar punën e tij apostolike në Mesdheun lindor (krh. 15:20-23, 28).
- B. Për t’iu adresuar problemit në kishën e Romës midis besimtarëve hebrenj dhe atyre johebrenj. Ky ishte ndoshta rezultati i dëbimit të hebrenjve nga Roma dhe rikthimit të tyre të mëvonshëm. Deri atëherë udhëheqësit e krishterë hebrenj ishin zëvendësuar me udhëheqës të krishterë johebrenj.
- C. Për ta prezantuar veten me kishën e Romës. Kishte shumë kundërshtim ndaj Palit nga hebrenj të sinqertë të bërë të krishterë që ishin në Jerusalem (krh. Këshillin e Jerusalemit tek Veprat 15), nga hebrenj jo të sinqertë (judenjtë tek Galatasve dhe 2 Korintasve 3, 10-13), dhe nga johebrenj (Kolosianëve, Efesianëve) që përpiqeshin ta përziënin ungjillin me teoritë dhe filozofitë e tyre të dashura (p.sh. Gnosticizmin).

- D. Pali u akuzua si dikush që po sillte risi të rrezikshme, që po u shtonte mësimëve të Jezusit pa përfillur pasojat. Libri i Romakëve ishte mënyra e tij për të mbrojtur veten në mënyrë sistematike duke treguar se si unguilli i tij ishte i vërtetë, duke përdorur Dhiatën e Vjetër dhe mësimet e Jezusit (ungujtë).

PËRVIJIM I SHKURTËR

- 1) Hyrja (1:1-17)
 - a) Përshëndetja (1:1-7)
 - i) Autori (1-5)
 - ii) Destinacioni (6-7a)
 - iii) Përshëndetja (7b)
 - b) Rasti (1:8-15)
 - c) Tema (1:16-17)

- 2) Nevoja për Drejtësi Hyjnore (1:18-3:20)
 - a) Rënia e botës johebreje (1:18-32)
 - b) Hipokrizia e judenjve ose moralistëve paganë (2:1-16)
 - c) Gjykimi i hebrenjve (2:17-3:8)
 - d) Dënimi universal (3:9-20)

- 3) Çfarë është Drejtësia Hyjnore (3:21-8:39)
 - a) Drejtësi vetëm me anë të besimit (3:21-31)
 - b) Baza e drejtësisë: Premtimi i Perëndisë (4:1-25)
 - i) Pozita e drejtë e Abrahamit (4:1-5)
 - ii) Davidi (4:6-8)
 - iii) Marrëdhënia e Abrahamit me Rrethprerjen (4:9-12)
 - iv) Premtimi i Perëndisë ndaj Abrahamit (4:13-25)
 - c) Arritja e Drejtësisë (5:1-21)
 - i) Aspekti subjektiv: dashuri e pamerituar, gëzim i pakrahasueshëm (5:1-5)
 - ii) Baza objektive: dashuria mahnitëse e Perëndisë (5:6-11)
 - iii) Tipologjia Adam/Krisht: shkelja e Adamit, sigurimi i Perëndisë (5:12-21)
 - d) Drejtësia hyjnore duhet të rezultojë në drejtësi personale (6:1-7:25)
 - i) Të çliruar nga mëkati (6:1-14)
 - (1) Një kundërshtim i supozuar (6:1-2)
 - (2) Kuptimi i pagëzimit (6:3-14)
 - ii) Skllav i Satanit apo skllav i Perëndisë: zgjedhja jote (6:15-23)
 - iii) Martesa e Njeriut me Ligjin (7:1-6)
 - iv) Ligji është i mirë, por mëkati e pengon të mirën (7:7-14)
 - v) Beteja e përjetshme e së mirës dhe së keqes në besimtarin (7:15-25)
 - e) Rezultatet e vëzhgueshme të drejtësisë hyjnore (8:1-39)
 - i) Jetë në Frymën (8:1-17)
 - ii) Shpengimi i krijimit (8:18-25)
 - iii) Ndihma e vazhdueshme e Frymës (8:26-30)
 - iv) Triumfi gjyqësor i shfajësimit me anë të besimit (8:31-39)

- 4) Qëllimi hyjnor për gjithë njerëzimin (9:1-11:32)
 - a) Zgjedhja e Izraelit (9:1-33)
 - i) Trashëgimtarë të vërtetë të besimit (9:1-13)
 - ii) Sovraniteti i Perëndisë (9:14-26)
 - iii) Plani universal i Perëndisë përfshin paganët (9:27-33)
 - b) Shpëtimi i Izraelit (10:1-21)
 - i) Drejtësia e Perëndisë përkundër drejtësisë së njerëzimit (10:1-13)
 - ii) Mëshira e Perëndisë bën të nevojshëm lajmëtarët, një thirrje për mision botëror (10:14-18)
 - iii) Vazhdimi i mosbesimit të Izraelit në Krishtin (10:19-21)

- c) Dështimi i Izraelit (11:1-36)
 - i) Mbetja e hebrenjve (11:1-10)
 - ii) Xhelozia e hebrenjve (11:11-24)
 - iii) Verbëria e përkohshme e Izraelit (11:25-32)
 - iv) Shpërthimi i Palit në lavdërim (11:33-36)
- 5) Rezultati i Dhuratës së Drejtësisë Hyjnore (12:1-15:130)
 - a) Thirrja për shenjtërim (12:1-2)
 - b) Përdorimi i dhuntive (12:3-8)
 - c) Marrëdhënia e besimtarëve me besimtarë të tjerë (12:9-21)
 - d) Marrëdhëniet me shtetin (13:1-7)
 - e) Marrëdhëniet me fqinjët (13:8-10)
 - f) Marrëdhënia me Zotin (13:11-14)
 - g) Marrëdhëniet me anëtarët e të njëjtës kishë (14:1-12)
 - h) Efekti ynë mbi të tjerët (14:13-23)
 - i) Marrëdhëniet në ngjashmëri me Krishtin (15:1-13)
- 6) Mbyllja (15:14-33)
 - a) Planet personale të Palit (15:14-29)
 - b) Kërkesë për lutje (15:30-33)
- 7) Poshtë shënim (16:1-27)
 - a) Përshëndetje (16:1-24)
 - b) Bekim (16:25-27)

CIKLI NJË I LEXIMIT (shih f. viii)

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje të gjithë librin e Biblës njëherësh. Shprehe idenë qendrore të librit me fjalët e tua.

1. Ideja e gjithë librit
2. Lloji i letërsisë (gjinia letrare)

CIKLI DY I LEXIMIT (shih f. viii)

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit

Lexoje të gjithë librin e Biblës njëherësh për herë të dytë. Përvijoj temat kryesore dhe shprehe temën me një fjali.

1. Tema e njësisë së parë letrare
2. Tema e njësisë së dytë letrare
3. Tema e njësisë së tretë letrare
4. Tema e njësisë së katërt letrare
5. Etj.

ROMAKËVE 1

NDARJET E PARAGRAFËVE TË PËRKTHEMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje 1:1-7	Përshëndetjet 1:1-7	Përshëndetje 1:1-6 1:7a 1:7b	Përshëndetje 1:1 1:2-6 1:7a 1:7b	Adresimi 1:1-2 1:3-7
Dëshira e Palit për të vizituar Romën 1:8-15	Dëshira për të vizituar Romën 1:8-15	Falenderime 1:8-15	Lutje falenderimi 1:8-12 1:13-15	Falenderim dhe lutje 1:8-15
Fuqia e Ungjillit 1:16-17	Të drejtët jetojnë me anë të besimit 1:16-17	Ideja e letrës 1:16-17	Fuqia e Ungjillit 1:16-17	Deklarimi i idesë 1:16-17
Faji i njerëzimit 1:18-23 1:24-32	Zemërimi i Perëndisë mbi padrejtësinë 1:18-32	Gjykimi i Perëndisë mbi mëkatin 1:18-23 1:24-25 1:26-27 1:28-32	Faji i njerëzimit 1:18-23 1:24-25 1:26-27 1:28-32	Hakmarrja e Perëndisë ndaj johebrenjeve 1:18-25 1:24-25 1:26-27 1:28-32

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ju jeni vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë të drejtë komentuesit.

Lexojeni kapitullin njëherësh. Identifikoni temat. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë

Megjithëse nuk janë të frymëzuara, ndarjet e paragrafëve janë kyçe në të kuptuarit e synimit të autorit origjinal. Çdo përkthim i sotëm e ka ndarë dhe përmbledhur kapitullin një. Çdo paragraf ka një temë, të vërtetë apo mendim qëndror. Secili version e përmbledh atë temë në mënyrën e vet të dallueshme. Ndërsa lexoni tekstin, bëjini vetes pyetjen cili përkthim përputhet me të kuptuarit tuaj të temës dhe ndarjes së vargjeve.

Në çdo kapitull, ju duhet të lexoni Biblën në fillim dhe të përpiqeni të identifikoni temat (paragrafët) e tij. Pastaj krahasoni të kuptuarit tuaj me përkthimet e sotme. Vetëm pasi një person kupton synimin e autorit origjinal duke ndjekur logjikën dhe prezantimin e tij, ai mund ta kuptojë vërtet Biblën. Vetëm autori origjinal është i frymëzuar – lexuesit nuk kanë të drejtë ta ndryshojnë apo modifikojnë mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë përgjegjësinë të zbatojnë të vërtetën e frymëzuar në kohën dhe jetën e tyre.

Vini re që të gjithë termat teknikë dhe shkurtime shpjegohen plotësisht në Shtojcat Një, Dy dhe Tre.

2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Vargjet 1-7 formojnë hyrjen e letrës. Është hyrja më e gjatë nga të gjitha letrat e Palit. Ai po përpiquej t'i prezantonte veten dhe teologjinë e tij një kishe që nuk e njihte atë personalisht dhe mund të kishte dëgjuar gjëra negative për të.
- B. Vargjet 8-12 janë një lutje hyrëse falenderimi. Kjo ishte karakteristikë e letrave greke në përgjithësi dhe e letrave të Palit në veçanti.
- C. Vargjet 16-17 deklarojnë temën e librit.
- D. Vargjet 18 deri në 3:20 formojnë njësinë e parë letrare dhe pikën e parë të ungjillit të Palit; të gjithë njerëzit (3 grupet) janë të humbur dhe kanë nevojë të shpëtohen (krh. Zanafilla 3).
 1. paganët imoralë
 2. paganët moralë
 3. judenjtë
- E. Romakëve 1:18-3:20 reflekton Zanafillën 3 (për çudi rabinët nuk fokusohen në këtë tekst, por tek Zanafilla 6 për origjinën e mëkatit). Njerëzimi u krijua për bashkësi me Perëndinë, në vetë shëmbëlltërinë e Tij (krh. Zan. 1:26-27). Megjithatë, njerëzimi zgjodhi ndriçimin dhe premtimin e pushtetit dhe pavarësisë. Në të vërtetë njerëzit e këmbyen lartësimin e Perëndisë me lartësimin e vetes (humanizmi ateist)!
 Perëndia e lejoi këtë krizë. Të jesh në shëmbëlltërinë e Perëndisë do të thotë të jesh i përgjegjshëm, moralisht llogaridhënës, të jesh i lirë nga ana e vullnetit, me pasoja. Perëndia i ndan njerëzit në bazë të zgjedhjes së Tij edhe zgjedhjes së tyre (një marrëdhënie besëlidhjeje)! Ai i lejon ata të zgjedhin veten me të gjitha pasojat e saj. Perëndia trishtohet (krh. Zan. 6:5-7), por njerëzit janë agjentë të lirë nga ana morale me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që kjo sjell. Faza e përsëritur “Perëndia i dorëzoi” (krh. 1:24, 26, 28) është një njohje e asaj lirie, jo një hedhje poshtë me dashje nga Perëndia. Kjo nuk ishte zgjedhja e Perëndisë. Kjo nuk është bota që kishte ndërmend Perëndia (krh. Zan. 3:22; 6:5-7, 11-13)!
- F. Përmbledhja teologjike e 1:18-3:20 gjendet në 3:21-31. Kjo është pika e parë teologjike e “lajmit të mirë” të ungjillit – të gjithë njerëzit kanë mëkatuar dhe kanë nevojë për faljen e Perëndisë. Perëndia në mënyrë të hirshme siguron një mënyrë për të rikthyer bashkësinë intime (d.m.th. përjetimin në Eden, krahaso Zanafilla 1-2 me Zbulesa 21-22).
- G. Në këtë njësi të parë letrare të prezantimit të ungjillit nga ana e Palit është interesant të vëmë re se njerëzimi i rënë mbahet përgjegjës për rebelimin dhe mëkatin pa ndonjë referencë ndaj Satanit ose demonikes (krh. Rom. 1:18-3:20). Ky seksion sigurisht reflekton teologjinë e Zanafillës 3, por pa një tundues personal. Perëndia nuk do ta lejojë njerëzimin e rënë të fajësojë përsëri Satanin (krh. Zan. 3:13) apo Vetë Perëndinë (krh. Zan. 3:12). Njerëzit janë bërë në shëmbëlltërinë e Perëndisë (krh. Zan. 1:26; 5:1,3; 9:6). Ata kanë të drejtën, fuqinë dhe detyrimin për të zgjedhur. Ata janë përgjegjës për zgjedhjet e tyre edhe bashkarisht në Adamin, edhe individualisht në mëkatin personal (krh. 3:23).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:1-6

¹Pali, skllav i Krishtit Jezus, i thirrur *si* apostull, i ndarë mënjanë për ungjillin e Perëndisë, ² të cilin e premtoi që më përpara përmes profetëve të Tij në Shkrimet e Shenjta, ³ në lidhje me Birin e Tij, që u lind pasardhës i Davidit sipas mishit, ⁴ që u deklarua Biri i Perëndisë me fuqi nëpërmjet ringjalljes nga të vdekurit, sipas Frymës së shenjtërisë, Jezu Krishti, Zoti ynë, ⁵ përmes të cilit kemi marrë hir dhe apostullim për të sjellë bindjen e besimit midis gjithë johebrenjve për hir të emrit të Tij, ⁶ midis të cilëve edhe ju jeni të thirrurit e Jezu Krishtit;

1:1 “Pali” shumica e hebrenjve në kohën e Palit kishin dy emra, një hebre dhe një romak (krh. Veprat 13:9). Emri hebre i Palit ishte Saul. Ai, ashtu si mbreti i lashtë i Izraelit, ishte nga fisi i Beniaminit (krh. Rom 11:1; Fil. 3:5). Emri i tij romak në formën greke, Pal (Paulos), do të thoshte “i vogël.” Kjo i referohej

1. trupit të tij fizik, gjë për të cilën aludohet në një libër jo-kanonik të shekullit të dytë, *Veprat e Palit*, në një kapitull të titulluar “Pali dhe Thekla”
2. ndjesisë së tij personale se ishte më i vogli i shenjtorëve, sepse ai në fillim e përndiqte Kishën (krh. 1 Kor. 15:9; Efe. 3:8; 1 Tim. 1:15)
3. thjesht emrit që i kishin vënë prindërit në lindje

Opsioni #3 duket më i mirë.

▣ **“skllav”** përkthimet NKJV, NRSV, TEV dhe NJB e kanë “shërbëtor.” Ky koncept ishte ose

1. antitetik ndaj Jezusit si Zot, ose
2. një titull nderues i DHV (krh. Moisiun tek Num. 12:7 dhe Joz. 1:1; Jozueu në Joz. 24:29; dhe Davidi në Psalmet (titulli) dhe Isaia 42:1, 19; 52:13).

▣

NASB, TEV,

NJB, REB “Krishtit Jezus”

NKJV, NRSV “Jezu Krishtit”

“Krishtit Jezus” është më e pazakontë, dhe prandaj, ndoshta origjinale (krh. MSS P¹⁰, B). UBS⁴ i jep një notë “B” (pothuaj e sigurt).

Megjithatë, forma tjetër ka prova vërtet të mira (krh. MSS P²⁶, ⋈, A, D, G, dhe shumica e Etërve të kishës së hershme).

Shih Shtojcën Dy mbi supozimet e Kritikës tekstuale. Shumica e varianteve tekstuale janë si ky, në kuptimin që nuk e ndikojnë kuptimin themelor të tekstit në greqisht.

▣ **“i thirrur si apostull”** Kjo ishte zgjedhja e Perëndisë, jo e tija (krh. Veprat 9:15; Gal. 1:15; Efe. 3:7). Me këtë frazë Pali po i pohon kualifikimet dhe autoritetin e tij shpirtëror, (siç bën te 1 Kor. 1:11; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; Titit 1:1) kësaj kishe që nuk e kishte takuar më parë. Shih Temën e Veçantë “I thirrur” në 1:6.

Termi Koine “apostull” në qarqet e hebrenjve të Palestinës të shekullit të parë do të thoshte “një i dërguar si përfaqësues zyrtar” (krh. 2 Kron. 17:7-9). Në DHR ky term përdorej në dy kuptime: (1) në kuptimin e të Dymbëdhjetë dishepujve të veçantë dhe Palit dhe (2) në kuptimin e dhuntisë frymërore që vazhdon në kishë (krh. 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11).

TEMË E VEÇANTË: DËRGOJ (APOSTELLŌ)

Kjo është fjalë e zakonshme greqisht që do të thotë “dërgoj” (pra, *apostellō*). Ky term ka një sërë përdorimesh teologjike.

1. rabinët e përdornin në kuptimin e dikujt që thirret dhe dërgohet si përfaqësues zyrtar i një tjetri, pak a shumë si fjala jonë “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20)

2. shpesh, ungjijtë e përdorin këtë term për dërgimin e Jezusit nga Ati. Te Gjoni, ky term merr ngjyrimë mesianike (Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48 dhe veçanërisht Gjoni 5:36,38; 6:29,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3, 8, 18, 21, 23, 25; 20:21). Përdoret për dërgimin e besimtarëve nga Jezusi (shih Gjoni 17:18; 20:21 [në v. 21 përmendet, si *apostellō*, ashtu dhe sinonimi i tij *pempō*).
3. Dhr e përdori për dishepujt
 - a. rrethi i brendshëm fillestar i dymbëdhjetë dishepujve (p.sh., Marku 6:30; Luka 6:13; Veprat 1:2, 26)
 - b. një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkëpunëtorësh apostolikë
 - (1) Barnaba (shih Veprat 14:4, 14)
 - (2) Androniku dhe Juniasi (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)
 - (3) Apollo (shih 1 Kor. 4:6-9)
 - (4) Jakobi, vëllai i Zotit (Gal. 1:19)
 - (5) Silvani dhe Timoteu (1 Thes. 2:6)
 - (6) ndoshta Titi (2 Kor. 8:23)
 - (7) ndoshta Epafroditi (Fil. 2:25)
 - c. një dhunti e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
4. Pali e përdor këtë titull për vete në shumicën e letrave të tij si mënyrë për të pohuar autoritetin hyjnor të tij si përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titi 1:1).

▣ **“i ndarë mënjanë”** Kjo është një PJESORE E KRYER PËSORE, që nënkuptonte se ai ishte ndarë mënjanë nga Perëndia në të shkuarën (krh. Jer. 1:5 dhe Gal. 1:15) dhe kjo vazhdonte si një gjendje. Kjo ishte ndoshta një lojë e mundshme me fjalën aramaike për “Farise.” Ata ishin të ndarë mënjanë për legalizmin hebre (edhe Pali gjithashtu [Fil. 3:5] përpara se të takohej me Jezusin në Rrugën e Damaskut), por tani ai ishte ndarë mënjanë për ungjillin.

Ajo lidhet me fjalën hebraisht për “i shenjtë” (BDB 872), që ka kuptimin “i ndarë mënjanë për përdorim nga Perëndia (krh. Eks. 19:6; 1 Pjet. 2:5). Termat “shenjtor,” “shenjtëroj” dhe “ndaj mënjanë” të gjithë kanë të njëjtën rrënjë greke, “i shenjtë” (*hagios*).

▣ **“për ungjillin e Perëndisë”** PARAFJALA *eis* në këtë kontekst (dhe në v.5) tregon qëllimin e “thirrjes” së Palit (v. 1n) dhe të “ndarjes mënjanë” të tij (v. 1c).

Ungjill është një fjalë e përbërë nga “i mirë” (*eu*) dhe “mesazh” (*angellos*). Ai u bë termi që përshkruante doktrinat e zbuluara në Besëlidhjen e Re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-32) të lidhura me Mesian e premtuar të Perëndisë (krh. Vv. 3-4). Ai është “ungjilli i Birit të Tij” (v. 2).

Ky është ungjilli i Perëndisë, jo i Palit (krh. 15:16; Marku 1:14; 2 Kor. 11:7; 1 Thes. 2:2,8,9; 1 Pjet. 4:17). Pali nuk ishte shpikës i një gjëje të re, por shpallës i së vërtetës që mori (krh. Veprat 9; 1 Kor. 1:18-25).

1:2 “të cilin e premtoi që më përpara përmes profetëve të Tij në Shkrimet e Shenjta” Kjo folje është AORISTE JOVEPRORE DËFTORE. Përdoret vetëm në shkrimet e Palit (këtu dhe në 2 Kor. 9:5). Ungjilli nuk ishte një mendim i mëvonshëm i Perëndisë, por plani i Tij i përjetshëm dhe i qëllimshëm (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5; Isa. 53; Ps. 118; Marku 10:45; Luka 2:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; Titit 1:2). Predikimet e hershme tek Veprat (*kerygma*) e paraqesin Jezusin si përmbushjen e premtimeve dhe profecive të DHV.

DHV përmendet në DHR në dy mënyra të zakonshme.

1. “është shkruar” (ose “shkrimet,” p.sh. 2 Tim. 3:16; 2 Pjet. 3:16)
2. Shkrimi(et)

Gjithashtu përmendet në lidhje me profetët. Në mendjen hebreje profetët e shkruan Shkrimin.

1. “Ligji ose Profetët,” Mat. 5:17-18; gjithashtu vini re Luka 24:44
2. “profecia,” Luka 24:27
3. “shkrimet e profetëve,” Mat. 26:56
4. “shkrimet profetike,” Rom. 16:26 (dhe Rom. 1:2 i përmend “profetët”)
5. “Profecia e Shkrimit,” 2 Pjet. 1:20

Ka dy raste kur është bashkangjitur mbiemri “i shenjtë.”

1. “Shkrimet e shenjta” (fjalja e plotë përmend edhe “profetët”), Rom. 1:2
2. “shkrimet e shenjta,” 2 tim. 3:15

TEMË E VEÇANTË: *KERYGMA* E KISHËS SË HERSHME

- A. Premtimet që Perëndia kishte bërë në Dhiatën e Vjetër tani janë përmbushur me ardhjen e Jezus Mesisë (Veprat 2:30-31; 3:19,24; 10:43; 26:6-7,22; Rom. 1:2-4; 1 Tim. 3:16; Heb. 1:1-2; 1 Pjet. 1:10-12; 2 Pjet. 1:18-19).
- B. Jezusi u vajos si Mesi nga Perëndia kur u pagëzua (Veprat 10:38).
- C. Jezusi e filloi shërbesën e vet në Galile pas pagëzimit (Veprat 10:37).
- D. Shërbesa e tij karakterizohej nga veprat e mira dhe nga kryerja e veprave të fuqishme me anë të fuqisë së Perëndisë (Marku 10:45; Veprat 2:22; 10:38).
- E. Mesia u kryqëzua sipas synimit të përjetshëm të Perëndisë (Marku 10:45; Gjoni 3:16; Veprat 2:23; 3:13-15,18; 4:11; 10:39; 26:23; Rom. 8:34; 1 Kor. 1:17-18; 15:3; Gal. 1:4; Heb. 1:3; 1 Pjet. 1:2,19; 3:18; 1 Gjonit 4:10).
- F. Ai u ringjall nga vdekja dhe iu shfaq dishepujve (Veprat 2:24,31-32; 3:15,26; 10:40-41; 17:31; 26:23; Rom. 8:34; 10:9; 1 Kor. 15:4-7,12ff; 1 Thes. 1:10; 1 Tim. 3:16; 1 Pjet. 1:2; 3:18,21).
- G. Jezusi u lartësua nga Perëndia, i cili i dha emrin “Zot” (Veprat 2:25-29,33-36; 3:13; 10:36; Rom. 8:34; 10:9; 1 Tim. 3:16; Heb. 1:3; 1 Pjet. 3:22).
- H. Ai dha Frymën e Shenjtë për të formuar komunitetin e ri të Perëndisë (Veprat 1:8; 2:14-18,38-39; 10:44-47; 1 Pjet. 1:12).
- I. Ai do të kthehet sërish për gjykimin dhe ripërtëritjen e të gjitha gjërave (Veprat 3:20-21; 10:42; 17:31; 1 Kor. 15:20-28; 1 Thes. 1:10).
- J. Të gjithë ata që dëgjojnë mesazhin duhet të pendohen dhe të pagëzohen (Veprat 2:21,38; 3:19; 10:43,47-48; 17:30; 26:20; Rom. 1:17; 10:9; 1 Pjet. 3:21).

Kjo skemë shërbente si thelbi i shpalljes së kishës së hershme, ndonëse autorë të ndryshëm të Dhiatës së Re mund të lënë pa përmendur një pjesë të saj, ose theksojnë disa veçori të tjera në predikimin e tyre. Gjithë ungjilli i Markut ndjek ngushtë aspektin pjetrin të *kerigmës*. Tradicionalisht, mendohet se Marku strukturoi predikimet e Pjetrit, të bëra në Romë, në një ungjill të shkruar. Si Mateu, ashtu dhe Luka, ndjekin strukturën bazë të Markut.

1:3 “në lidhje me Birin e Tij” Mesazhi qendror i Lajmit të Mirë është një person, Jezusi i Nazaretit, biri i lindur në virgjëri nga Maria. Në kombin e DHV, mbreti dhe Mesia quheshin “bir” (krh. 2 Sam. 7:14; Osea 11:1; Ps. 2:7; Mat. 2:15).

Në DHV Perëndia foli përmes shërbëtorëve dhe profetëve. Jezusi nuk ishte shërbëtor i Perëndisë. Ai ishte një pjesëtar i familjes (krh. Heb. 1:1-2; 3:6; 5:8; 7:28). Për çudi, ky është i vetmi vend në libër ku Pali fokusohet në kristologji. Romakëve nuk është një teologji e plotë sistematike.

TEMË E VEÇANTË: BIRI I PERËNDISË

Ky është një nga titujt kryesorë në DhR për Jezusin. Pa dyshim që ka ngjyrimë hyjnore. Ajo e përfshinte Jezusin si “Biri”, ose si “Biri im”, dhe Perëndisë i drejtohet me termin “Atë”. Në DhR shfaqet mbi 124 herë. Edhe vetëpërcaktimi si “Bir i Njeriut” ka ngjyrim hyjnor nga Dan. 7:13-14.

Në DhV, termi “bir” mund t’u referohet katër grupeve të veçanta.

1. engjëjve (zakonisht, në SHUMËS, shih Zan. 6:2; Jobi 1:6; 2:1)
2. Mbreti i Izraelit (shih 2 Sam. 7:14; Psa. 2:7; 89:26-27)
3. kombi i Izraelit në tërësi (shih Eks. 4:22-23; LiP. 14:1; Os. 11:1; Mal. 2:10)
4. gjykatësit e Izraelit (shih Psa. 82:6)

Ajo që lidhet me Jezusin është faza e dytë. Në këtë mënyrë, “biri i Davidit” dhe “biri i Perëndisë” lidhen me 2 Samuelin 7; Psalmi 2 dhe 89. Në DhV, “biri i Perëndisë” nuk përdoret kurrë në mënyrë të veçantë për Mesinë, përveç si mbreti eskatologjik, si një nga “ofiqet e vajosura” të Izraelit. Sidoqoftë, në Pergamenat e Detit të Vdekur, ky titull me ngjyrimë mesianike është i zakonshëm (shih referencat e veçanta në *Dictionary of Jesus and the Gospels* [Fjalori i Jezusit dhe i ungjijve], f. 770). Po kështu, “Biri i Perëndisë” është titull mesianik në dy vepra judaike apokaliptike në periudhën ndërthi (shih 2 Esdra 7:28; 13:32, 37, 52; 14:9 dhe 1 Enokut 105:2).

Sfondi i saj në DhR, kur përdoret për Jezusin, përmbledhet më së miri nga një sërë kategorish.

1. paraekzistenca e tij (shih Gjoni 1:1-18)
2. lindja e tij unike (e virgjër) (shih Mat. 1:23; Luka 1:31-35)

3. pagëzimi i tij (shih Mat. 3:17; Marku 1:11; Luka 3:22. Zëri i Perëndisë nga qielli bashkon mbretin mbretëror të Psalmi 2 me shërbëtorin e përvuajtur të Isaisë 53).
4. tundimi i tij mesianik (shih Mat. 4:1-11; Marku 1:12, 13; Luka 4:1-13). Ai tundohet për të vënë në dyshim natyrën e tij birnore, ose të paktën, që ta arrinte synimin e saj me mjete të ndryshme nga kryqi).
5. pranimi i tij nga rrëfyetë të papranueshëm
 - a. demonët (shih Marku 1:23-25; Luka 4:31-37, 41; Marku 3:11-12, 5:7)
 - b. jobesimtarët (shih Mat. 27:43; Marku 14:61; Gjoni 19:7)
6. pranimi i tij nga dishepujt
 - a. Mat. 14:33; 16:16
 - b. Gjoni 1:34, 49; 6:69; 11:27
7. rrëfimi që ai dha për veten
 - a. Mateu 11:25-27
 - b. Gjoni 10:36
8. përdorimi nga ana e tij e metaforës familjare të Perëndisë si Atë
 - a. përdorimi i fjalës “abba” për Perëndinë
 - 1) Marku 14:36
 - 2) Romakëve 8:15
 - 3) Galatasve 4:6
 - b. përdorimi i përsëritur i fjalës Atë (*patēr*) për të përshkruar marrëdhënien e tij me Perëndinë

Si përmbledhje, titulli “Bir i Perëndisë” kishte kuptim të madh teologjik për ata që e njihnin DhV dhe premtimet e kategoritë e saj, por shkruesit e DhR ishin nervozë për ta përdorur këtë term me johebrejtë, për shkak të sfondit të tyre pagan ku “perënditë” merrnin gra dhe fëmijet që lindnin prej tyre quheshin “titanë” ose “gjigantë”.

■ **“që u lind pasardhës i Davidit”** Kjo lidhet me profecinë e 2 Samuelit 7. Mesia ishte i linjës mbretërore të Davidit (krh. Isa. 9:7; 11:1,10; Jer. 23:5; 30:9; 33:15) nga fisi i Judës (krh. Zan 49:4-12; Isa. 65:9). Në Ungjillin e Mateut Jezusi përmendet si pasardhës i Davidit disa herë (krh. 1:6;9:27; 12:23; 15:22; 20:30,31; 21:9,15; 22:42), gjë që reflektonte shpresën e hebrenjve për ardhjen e një shpëtimtari davidik.

Është e habitshme që Pali nuk e thekson këtë aspekt të Jezusit. Ai e përmend atë vetëm këtu dhe në 2 Tim. 2:8; të dy pasazhet mund të kenë qenë citime nga një formulë besoreje e kishës së hershme. NIDNTT, vol. 3, fq. 61, rreshton disa tekste të DHR që mund të reflektojnë besore/himne/liturgji të hershme Kristologjike (p.sh.,Rom. 1:3-4; 8:34; 1 Kor. 15:3-4; Fil. 2:6-11; 1 Tim. 3:16; 2 Tim. 2:8; 1 Pjet. 3:18-20).

■

NASB, NKJV,

NRSV “sipas mishit”

TEV “nga ana njerëzore”

NJB “sipas natyrës njerëzore”

Kjo ishte përmbushje profecie dhe një pohim i natyrës njerëzore të Jezusit, e cila shpesh mohohej në botën fetare përzgjedhëse¹ të shekullit të parë (krh. 1 Gjonit 1:1-4; 4:1-3). Ky varg tregon qartë që Pali nuk e përdor gjithmonë termin “mish” (*sarx*) në një kuptim negativ (krh. 2:28; 9:3). Megjithatë, Pali e përdor zakonisht “mish” në kontrast me “frymë” (krh. 6:19; 7:5,18,25; 8:3-9,12,13; 1 Kor. 5:5; 2 Kor. 1:17; 11:18; Gal. 3:3; 5:13,16,17-19,24; 6:8; Efe. 2:3; Kol. 2:11,13,18,23).

Ky konstruksion gramatikor *kata* (sipas) plus një DHANORE ka një paralel në v. 4. Jezusi është edhe njerëzor (sipas mishit, v. 3), edhe hyjnor (sipas Frymës, v. 4). Kjo doktrinë e mishërimit është thelbësore (krh. 1 Gjonit 4:1-3). Mund të jetë edhe rrjedhojë e emërimit të vetë-zgjedhur të Jezusit, “Biri i Njeriut” (krh. Ps. 8:4; Ezek. 2:1 [njerëzor] dhe Danieli 7:13 [hyjnor]).

TEMË E VEÇANTË: MISH (*sarx*)

Kjo i referohet urtësisë njerëzore, ose standardeve të botës (shih 1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:180. Pali e përdor termin “mish” (pra, *sarx*) në disa mënyra në shkrimet e veta.

¹ Shën i përkth. Në anglisht *eclectic*, që përshkruan dikë që nuk aderon në ndonjë rrymë të caktuar filozofike apo fetare, por përzgjedh nga disa prej tyre, ose nga të gjitha vetëm ato që i pëlqejnë.

1. trupi njerëzor (shih Rom. 2:28; 1 Kor. 5:5; 7:28)
 2. prejardhja njerëzore (pra, atë-bir, shih Rom. 1:3; 4:1; 1 Kor. 10:18)
 3. njerëzimi në tërësi (shih 1 Kor. 1:26, 29)
- dobësia njerëzore për shkak të rënies së njerëzimit në Zanafilla 3 (shih Rom. 6:19; 7:18)

1:4

NASB, NKJV,
NRSV, NIV “deklaruar”
TEV “treguar”
NJB, RSV “zgjedhur”
NET “caktuar”
REB “shpallur”

Kjo është një PJESORE PËSORE AORISTE. Perëndia e caktoi Jezusin “Bir të Perëndisë” në mënyrë përfundimtare. Kjo nuk nënkupton që Betlehemi ishte fillimi i Jezusit apo që Ai është inferior ndaj Atit. Shih Temën e Veçantë: Trinia në 8:11. Shih paragrafin e tretë më poshtë.

▣ **“Biri i Perëndisë me fuqi”** Autorët e DHR nuk iu referuan shpesh Jezusit me titullin “Biri i Perëndisë” (krh. Mat. 4:3) për shkak të nënkuptimeve të rreme nga mitologjia greke (e njëjta gjë është e vërtetë për lindjen e virgjër). Ky koncept shpesh cilësohet nga “unik, i vetëm i atij lloji” (*monogenes*) (krh. Gjonit 1:18; 3:16,18; 1 Gjonit 4:9). Prandaj kuptimi është “Jezusi, i vetmi Bir i vërtetë i Perëndisë.”

DHR ka dy pole teologjike lidhur me Perëndinë Atë dhe Jezusin Bir.

1. Ata janë të barabartë (krh. Gjonit 1:1; 5:18; 10:30; 14:9; 20:28; II Kor. 4:4; Fil. 2:6; Kol. 1:15; Heb. 1:3), por
2. Ata janë personalitete të ndara (krh. Marku 10:18; 14:36; 15:34)

Është e mundur që Pali po citonte një kredo/besore të hershme kristologjike, ose po aludonte për Mbretin Mesianik të YHWH tek Psalmi 2:6,7 ose 110:1 (krh. Vep. 2:34-36). Duke bërë këtë, ai po theksonte të gjithë frazën “Biri i Perëndisë me fuqi” (NIDNTT, vol. 2, fq. 79) që fokusohet jo në lindjen apo pagëzimin e Tij, por në ngjitjen e Tij në qiell. Megjithatë, Kristologjia e Adoptimit (shih Fjalorin) e morën vargun dhe e cituan për arsye të tyre. Me këtë metodë të gabuar² të interpretimit të Biblës, mund ta bësh Biblën të thotë çdo gjë (shih seminarin tim mbi Interpretimin Biblik falas online në www.freebiblecommentary.org).

▣ **“nëpërmjet ringjalljes”** Perëndia Atë e miratoi jetën dhe mesazhin e Jezusit duke e ngjallur atë nga të vdekurit (krh. 4:24; 6:4,9; 8:11; Vep. 2:31-33). Hyjnia e Jezusit (krh. Gjonit 1:1-14; Kol. 1:15-19; Fil. 2:6-11; Heb. 1:2-3) dhe ringjallja e Tij (krh. 4:25; 10:9-13; I Kor. 15) janë shtylla binjake të Krishtëritimit.

▣ Ky varg u përdor shpesh për të mbrojtur herezinë e “adoptimizmit” që thoshte se Jezusi u shpërblye dhe u lartësua nga Perëndia për jetën dhe bindjen e Tij shembullore. Heretikët pohonin se Ai nuk qe gjithmonë (ontologjikisht) hyjni, por u bë hyjni kur Perëndia e ngjalli nga të vdekurit. Megjithëse kjo është qartësisht e pavërtetë, gjë që është e qartë nga shumë tekste si Gjoni 1 dhe 17, (përsëri duhet thënë se) në ringjalljen e Tij, Jezusit iu përçua diçka e mrekullueshme. Është e vështirë të shprehësh se si mund të shpërblehet hyjnia, e megjithatë kjo ishte ajo që ndodhi. Megjithëse Jezusi kishte lavdi të përjetshme bashkë me Atin, statusi i Tij u pasurua në njëfarë mënyre nga përmbushja e përsosur e detyrës shpenguese që i ishte caktuar. Ringjallja ishte miratimi nga ana e Atit për jetën, shembullin, mësimet dhe vdekjen sakrifikuuese të Jezusit të Nazaretit: Birit unik përjetësisht hynor, plotësisht njerëzor, shpëtimtar i përsosur, i rikthyer dhe i shpërblyer! Shih Shtojcën Tre – Adoptimizmi.

▣
NASB, NKJV “sipas Frymës së shenjtërisë”

² Shën i përkth. Në anglisht kjo metodë quhet *proof-texting* dhe i referohet praktikës së përdorimit të citimeve të izoluara dhe jashtë kontekstit nga një tekst i caktuar për të krijuar një teori.

NRSV	“sipas frymës së shenjtërisë”
TEV	“sa për shenjtërinë e tij hyjnore”
NJB	“në rendin e frymës, frymës së shenjtërisë”

Disa përkthime e kapitalizojnë “F”-në tek Fryma, duke nënkuptuar Frymën e Shenjtë, ndërsa “f”-ja e vogël i referohet frymës njerëzore të Jezusit. Ashtu si Ati Perëndi është Frymë, ashtu është edhe Jezusi. Tekstet e lashta në hebraisht dhe greqisht nuk kishin shkronja kapitale, nuk kishin pikësim dhe as ndarje të kapitujve dhe vargjeve, prandaj të gjitha këto janë çështje të traditës ose të interpretimit nga përkthyesit.

Ka tre mënyra për t’i parë vargjet 3 dhe 4.

1. si një referencë ndaj dy natyrave të Jezusit, asaj njerëzore dhe asaj hyjnore
2. si një referencë ndaj dy fazave në jetën e tij tokësore, Zot njerëzor dhe i ringjallur
3. si paralele me “Jezu Krishti, Zoti ynë”

■ **“Jezu(s)”** Emri aramaik *Jezus* është i njëjtë me emrin hebraik *Joshua*. Ishte emër i përbërë nga dy fjalë hebraike “YHWH” dhe “shpëtim.” Kuptimi i tij mund të jetë “YHWH shpëton,” “YHWH çliron,” ose “YHWH është shpëtim.” Pika kryesore e kuptimit mund të shihet tek Mat. 1:21,25.

■ **“Krishti”** Ky ishte përkthimi në greqisht i termit hebraik *messiah* (BDB 603), që do të thoshte “i vajosur.” Në DHV disa grupe udhëheqësish (profetët, priftërinjtë dhe mbretërit) vajoseshin si shenjë e zgjedhjes dhe pajisjes nga Perëndia. Jezusi i përmbushi të tre këta funksione të vajosurish (krh. Heb. 1:2-3).

DHV parashikoi që Perëndia do të dërgonte një “të vajosur” të veçantë për të inauguruar Epokën e Re të Drejtësisë. Jezusi ishte “shërbëtori,” “biri” dhe “Mesia” i Tij i veçantë.

TEMË E VEÇANTË: MESIA

Kjo është marrë nga shënimet e komentarit tim për Danielin 9:6. Vështirësia në interpretimin e këtij vargu vjen për shkak të kuptimeve të mundshme që shoqërohen me termin Mesia, ose i vajosuri (BDB 603).

1. Përdorej për mbretërit judenj (p.sh., 1 Sam. 2:10; 12:3)
2. Përdorej për priftërinjtë judenj (p.sh., Lev. 4:3, 5)
3. Përdorej për Kirin (shih Isa. 45:1)
4. # 1 dhe # 2 kombinohen me njëri-tjetrin në Psalmi 110 dhe Zakaria 4
5. Përdorej për Mbretin e ardhshëm e të veçantë Davidik të Perëndisë, i cili do të sillte epokën e re të drejtësisë
 - a. Pasardhja e Judës (shih Zan. 49:10)
 - b. Familja e Jeseut (shih 2 Samuelit 7)
 - c. Mbretërim universal (shih Psalmi 2; Isa. 9:6; 11:1-5; Mik. 5:1-4 e më tej)

Personalisht, mua më tërheq identifikimi i “të vajosurit” me Jezusin e Nazaretit për këto arsye:

1. Prezantimi i një Mbretërie të përjetshme në kapitullin 2 gjatë perandorisë së katërt
2. Prezantimi i “një biri njeriu” në 7:13, të cilit i jepet një mbretëri e përjetshme
3. Fjalitë shpenguese të 9:24, të cilat dëftojnë drejt pikës kulmore të historisë së botës së rënë
4. Përdorimi që i bën Jezusi librit të Danielit në DHR (shih Mat. 24:15; Marku 13:14)

■ **“Zoti”** Në judaizëm emri Besëlidhor i Perëndisë, YHWH, u bë kaq i shenjtë, saqë rabinët e zëvendësuan me titullin “Zot,” (*Adon*) kur lexonin Shkrimet, sepse kishin frikë se mund ta përdornin emrin e Zotit kot (krh. Eksodi 20:7; LiP 5:11) dhe kështu të thyenin njërin nga Dhjetë Urdhërimet. Kur autorët e DHR e quajtën Jezusin “Zot” (“Kurios”) në kontekstet teologjike, ata po pohonin hyjninë e Tij (krh. Vep. 2:36; Rom. 10:9-13; Fil. 2:6-11).

TEMË E VEÇANTË: EMRAT PËR HYJNINË

A. *EI* (BDB 42, KB 48)

1. Kuptimi fillestar i këtij termi të përgjithshëm e të lashtë për Perëndinë është i paqartë, ndonëse shumë studiues besojnë se vjen nga rrënja akadiane “jam i fortë”, ose “jam i fuqishëm” (shih Zan. 17:1; Num. 23:19; LiP. 7:21; Psa. 50:1).

2. Në panteonin kanaanit, perëndia i lartë është *El* (tekstet e Ras Shamras).
 3. Në Bibël, zakonisht, *El* shoqërohet me terma të tjerë. Këto kombinime bëhen një mënyrë për të karakterizuar Perëndinë.
 - a. *El-Elyon* (Perëndia Shumë i Lartë, BDB 42 & 751 II), Zan. 14:18-22; LiP. 32:8; Isa. 14:14
 - b. *El-Roi* (“Perëndia që sheh”, ose “Perëndia që zbulon veten”, BDB 42 & 909), Zan. 16:13
 - c. *El-Shaddai* (“Perëndia i Gjithëfuqishëm”, ose “Perëndia i Gjithëmëshirshëm”, ose “Perëndia i malit”, BDB 42 & 994), Zan. 17:1; 35:11; 43:14; 49:25; Eks. 6:3
 - d. *El-Olam* (Perëndia i Përjetshëm, BDB 42 & 761), Zan. 21:33. Ky term lidhet nga ana teologjike me premtimin e Perëndisë për Davidin, 2 Sam. 7:13, 16
 - e. *El-Berit* (“Perëndia i Besëlidhjes”, BDB 42 & 136), Gjyq. 9:46
 4. *El* barazohet me
 - a. YHWH, në Psa. 85:8; Isa. 42:5
 - b. *Elohim* në Zan. 46:3; Jobi 5:8, “Unë jam *El*, *Elohim* i atit tuaj”
 - c. *Shaddai*, në Zan. 49:25
 - d. “xhelozinë”, në Eks. 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15
 - e. “mëshirën” në LiP. 4:31; Neh. 9:31;
 - f. “i madh dhe i mahnitshëm” në LiP. 7:21; 10:17; Neh. 1:5; 9:31; Dan. 9:4
 - g. “njohurinë”, në 1 Sam. 2:3
 - h. “streha ime e fuqishme”, në 2 Sam. 22:33
 - i. “hakmarrësi im”, në 2 Sam. 22:49
 - j. “i shenjti”, në Isa. 5:16
 - k. “fuqi”, në Isa. 10:21
 - l. “shpëtimi im”, në Isa. 12:2
 - m. “i madh dhe i fuqishëm”, në Jer. 32:19
 - n. “shpagim”, në Jer. 51:56
 5. Një kombinim i të gjithë emrave kryesore të Perëndisë në DhV gjendet në Jozueu 22:22 (*El*, *Elohim*, *YHWH*, të përsëritur)
- B. *Elyon* (BDB 751, KB 832)
1. Kuptimi bazë i kësaj fjale është “i lartë”, “i lartësuar”, ose “i ngritur lart” (shih Zan. 40:17; 1 Mbret. 9:8; 2 Mbret. 18:17; Neh. 3:25; Jer. 20:2; 36:10; Psa. 18:13).
 2. Përdoret në kuptim paralel me disa emra/tituj të tjerë të Perëndisë.
 - a. *Elohim* - Ps. 47:1-2; 73:11; 107:11
 - b. *YHWH* – Zan. 14:22; 2 Sam. 22:14
 - c. *El-Shaddai* – Psa. 91:1, 9
 - d. *El* – Num. 24:16
 - e. *Elah* – përdoret shpesh te Danieli 2-6 dhe Esdra 4-7, lidhet me *illair* (aramaisht, “Perëndia i Lartë”), te Dan. 3:26; 4:2; 5:18, 21
 3. Përdoret shpesh nga johebrenjtë.
 - a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:16
 - c. Moisiu, që u flet kombeve te LiP. 32:8
 - d. Ungjilli i Lukës në DhR, që u shkruhet johebrenjve, përdor ekuivalentin grek *Hupsistos* (shih 1:32, 35, 76; 6:35; 8:28; Veprat 7:48; 16:17)
- C. *Elohim* (SHUMËS), *Eloah* (NJËJËS), që përdoren kryesisht në poezi (BDB 43, KB 52)
1. Ky term nuk gjendet jashtë Dhiatës së Vjetër.
 2. Kjo fjalë mund të nënkuptojë Perëndinë e Izraelit ose perënditë e kombeve (shih Eks. 12. 12; 20:3). Familja e Abrahamit ishte politeiste (shih Joz. 242).
 3. Mund t’u referohet gjyqtarëve të Izraelit (shih Eks. 216; Psa. 82:6).
 4. Termi *elohim* përdoret edhe për qenie të tjera shpirtërore (engjëjt, demonët), si te LiP. 32:8 (LXX) Psa. 8:5; Jobi 1:6; 38:7.
 5. Në Bibël, ky është emri/titulli i parë i Hyjnisë (shih Zan. 1:1). Është i vetmi që përdoret deri te Zan. 2:4, ku kombinohet me YHWH. Në thelb, nga ana teologjike, nënkupton Perëndinë si krijues, ruajtës dhe sigurues i gjithë jetës në këtë planet (shih Psalmi 104).
- Është sinonim me *El* (shih LiP. 32:15-19). Mund të jetë edhe term paralel me YHWH, pasi

Psalmi 14 (*Elohim*) është plotësisht njësoj si Psalmi 53 (YHWH), me përjashtim të ndryshimit të emrave hyjonrë.

6. Ndonëse SHUMËSI mund të përdoret edhe për perënditë e tjera, shpesh, ky term nënkupton Perëndinë e Izraelit, por zakonisht ajo që tregon kuptimin monoteist është FOLJA në NJËJËS.
7. Ky term gjendet në gojën e joizraelitëve si emri i hyjnisë.
 - a. Melkisedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:2
 - c. Moisiu, kur flet për kombet, LiP. 32:8
8. Është e çuditshme që një emër i zakonshëm i Perëndisë monoteiste të Izraelit është në SHUMËS!
Ndonëse nuk ka siguri, këto janë teoritë.
 - a. Hebraishtja ka shumë SHUMËSA, që shpesh përdoren për theksim. E lidhur ngushtë me këtë është një veçori e mëvonshme gramatikore e hebraishtes, që quhet “shumësi i madhështisë”, ku SHUMËSI përdoret për të përforcuar një koncept.
 - b. Kjo mund t’i referohet këshillit të engjëjve, me të cilët Perëndia takohet në qiell dhe të cilët bëjnë vullnetin e tij (shih 1 Mbret. 22:19-23; Jobi 1:6; Psa. 82:1; 89:5, 7).
 - c. Madje, është e mundur që kjo të reflektojë zbuluesën në DhR e të një Perëndie në tre persona. Te Zan. 1:1, Perëndia krijon; Zan. 1:2, Fryma rri mbi ujërat, dhe, nga DhR, Jezusi është vepruesi i krijimit të Atit Perëndi (shih Gjoni 1:3, 1 Rom. 11:36; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15; Heb. 1:2; 2:10).

D. YHWH (BDB 217, KB 394)

1. Ky është emri që reflekton Hyjninë si Perëndia që bën besëlidhje; Perëndia si shpëtimtar, shpengues! Njerëzit i thyejnë besëlidhjet, kurse Perëndia është besnik ndaj fjalës, premtimit, besëlidhjes së vet (shih Psalmi 103).

Ky emër përmendet për herë të parë në kombinim me *Elohim* në Zan. 2:4. Te Zan. 1-2 nuk gjenden dy rrëfime të krijimit, por dy theksime të tij: (1) Perëndia si krijuesi i universit (fizik) dhe (2) Perëndia si krijuesi i veçantë i njerëzimit. Zanafilla 2:4-3:24 nis zbuluesën e veçantë për pozicionin dhe synimin e privilegjuar të njerëzimit, si dhe për problemin e mëkatit dhe rebelimit që shoqërojnë këtë pozitë unike.
2. Në Zan. 4:26, thuhet se “njerëzit filluan t’i bënin thirrje emrit të ZOTIT” (YHWH). Mirëpo Eks. 6:3 nënkupton se populli i hershëm i besëlidhjes (patriarkët dhe familjet e tyre) e njihnin Perëndinë vetëm si *El-Shaddai*. Emri YHWH shpjegohet vetëm një herë në Eks. 3:13-16, sidomos në v. 14. Megjithatë, shkrimet e Moisiut shpesh i interpretojnë fjalët me lojëra të njohura fjalësh, jo me etimologji (shih Zan. 17:5; 27:36; 29:13-35). Ka patur disa teori për kuptimin e këtij emri (marrë nga IDB, vëll. 2 f. 409-11).
 - a. nga një rrënjë fjale arabisht, “tregoj dashuri të zjarrtë”
 - b. nga një rrënjë fjale arabisht, “fryj” (YHWH si Perëndia i furtunës)
 - c. nga një rrënjë fjale ugarite (kanaanite), “flas”
 - d. nga një mbishkrim fenikas, një PJESORE SHKAKORE që do të thotë “Ai që mban”, ose “Ai që themelon”
 - e. nga forma *Qal* në hebraisht, “Ai që është”, ose “Ai që është i pranishëm” (në kuptimin e ardhshëm, “Ai që do të jetë”)
 - f. nga forma *Hiphil* në hebraisht, “Ai që bën të jetë”
 - g. nga rrënja e fjalës hebraisht “jetoj” (p.sh. Zan. 3:20), që do të thotë “Ai që është i vetmi që jeton dhe që jeton gjithmonë”
 - h. nga konteksti i Eks. 3:13-16, një lojë fjalësh me formën E PAKRYER të përdorur në një kuptim TË KRYER, “Unë do të vazhdoj të jem ai që isha”, ose “do të vazhdoj të jem ai që kam qenë gjithmonë” (shih J. Wash Watts, *A Survey of Syntax in the Old Testament*, f. 67). Emri i plotë YHWH shpesh shprehet në formë të shkurtuar, ose, mundësisht, në një formë fillestare.
 - (1) *Yah* (p.sh. Halelu – jah, BDB 219, shih Eks. 15:2; 17:16; Psa. 89:8; 104:35)
 - (2) *Yahu* (fundi i emrave me “iah”, p.sh., Isaiah)
 - (3) *Yo* (emrat që fillojnë me “Jo”, p.sh., Jozueu ose Joeli)
3. Në judaizmin e mëvonshëm, ky emër i besëlidhjes u bë kaq i shenjtë (tetragramtoni), saqë judenjtë druheshin ta përdornin se mos shkelnin urdhrin e Eks. 20:7; LiP. 5:11; 6:13. Kështu, ata e zëvendësuan me termin hebraisht “pronar”, “zotëri”, “bashkëshort”, “zot” – *adon* ose *adonai* (zoti im). Kur vinin te fjala YHWH në leximin e pasazheve të DhV, ata shqiptonin “zot”. Ja pse YHWH shkruhet me të mëdha ZOT në përkthimet në anglisht.

4. Si në rastin e *El-it*, edhe YHWH shpesh kombinohet me terma të tjerë për të theksuar disa karakteristika të Perëndisë së Besëlidhjes me Izraelin. Ndonëse ka shumë terma të mundshëm për këto kombinime, ja disa prej tyre.
- a. *YHWH – Yireh* (YHWH do të sigurojë, BDB 217 & 906), Zan. 22:14
 - b. *YHWH – Rophekha* (YHWH është shëruesi yt, BDB 217 & 950, PJESORJA *Qal*), Eks. 15:26
 - c. *YHWH – Nissi* (YHWH është flamuri im, BDB 217 & 651), Eks. 17:15
 - d. *YHWH – Meqaddishkem* (YHWH, Ai që të shenjtëron, BDB 217 & 872, PJESORE *Piel*), Eks. 31:13
 - e. *YHWH – Shalom* (YHWH është Paqe, BDB 217 & 1022), Gjyq. 6:24
 - f. *YHWH – Sabaoth* (YHWH i ushtrive, BDB 217 & 878), 1 Sam. 1:3, 11; 4:4; 15:2, shpesh në Profetët
 - g. *YHWH – Ro’I* (YHWH është bariu im, BDB 217 & 944, PJESORE *Qal*), Psa. 23:1
 - h. *YHWH – Sidqenu* (YHWH është drejtësia jonë, BDB 217 & 841), Jer. 23:6
 - a. *YHWH – Shammah* (YHWH është aty, BDB 217 & 1027), Ezek. 48:35

1:5 “ne” Pali nuk përmend njeri tjetër në hyrjen e tij, siç bën shpesh në letrat e tij të tjera. Kjo frazë e parë i referohet takimit dhe kthimit në besim të Palit në Rrugën për në Damask (krh. Vep. 9), gjë që nënkupton fuqishëm përdorimin editorial të “ne.”

▣ **“kemi marrë hir dhe apostullim”** Pali po pohon jo vetëm dhuratën e shpëtimit përmes Krishtit, por gjithashtu dhe lidhur me të edhe thirrjen për të qenë apostull i Johebrenjve. E gjithë kjo ndodhi njëkohësisht rrugës për në Damask (AORISTE VEPRORE DËFTORE, krh. Vep. 9:1-22; 22:3-16; 26:9-18). Nuk ishte nga merita, por nga hiri i qëllimshëm!

Është e mundur që “hir” dhe “apostullim” duhen marrë si një njësi, “dhurata apo dhuntia e apostullimit” (NET shënimi #13). Të gjithë përkthimet e ndryshme të listuara në *Dhiata e Re në 26 përkthime* (fq. 646) e shohin këtë në të njëjtën mënyrë, si një hendiadis³.

▣ **“për të sjellë”** Ky është një përdorim i dytë i *eis* në një kontekst qëllimi (krh. v.1). Ungjilli e restauron shëmbëlltyrën e Perëndisë në njerëzimin përmes besimit në Jezusin. Kjo lejon të manifestohet qëllimi original i Perëndisë, i cili është një popull në bashkësi intime me Të që reflekton karakterin e Tij (krh. v. 7).

▣

NASB, NJB	“bindjen e besimit”
NKJV	“për bindje ndaj besimit”
NRSV	“për të sjellë bindjen e besimit”
TEV	“për të besuar dhe për t’u bindur”

Ky është përdorimi i parë i termit kyç “besim” te Romakëve (shih Temën e Veçantë në 4:5). Ai përdoret në tre mënyra të dallueshme në këtë kapitull dhe libër.

1. Vargu 5. Përdoret për një grup të vërtetash apo doktrinash të lidhura me Jezusin dhe jetën e krishterë (krh. Vep. 6:7; 13:8; 14:22; 16:5; Rom. 14:1; 16:26; Gal. 1:23; 6:10; Juda 3, 20).
2. Vargu 8. Përdoret në kuptimin e besimit personal në Jezusin. Termat “besoj,” “besim” dhe “zënie besë” përkthejnë të gjitha një term në greqisht (*pistis/pisteuō*). Ungjilli është edhe konceptual (doktrinë), edhe personal (krh. v. 16; Gjoni 1:12; 3:16). Shih Temën e Veçantë në 4:5.
3. Vargu 17. Përdoret në kuptimin e tij të DHV të besueshmërisë, besnikërisë apo sigurisë. Ky është kuptimi i Hab. 2:4. Në DHV nuk kishte një doktrinë besimi të zhvilluar, por kishte shembull pas shembulli të jetëve me besim (krh. Abrahamin në Zan. 15:6), jo besim i përsosur, por besim që përpiqej (krh. Hebrenjve 11). Shpresa e njerëzimit nuk është në aftësinë e tyre për të vepruar apo

³ Shën i përkth. -*Hendiadys*, nga greqishtja, një figurë letrare që përdor dy fjalë të lidhura me lidhëzën *dhe* për të nënkuptuar një njësi të vetme, ku njëra fjalë përcakton tjetrën. Në rastin tonë, *hir dhe apostullim* është përdorur në kuptimin *hir apostullor*.

besuar siç duhet, por në karakterin e Perëndisë (krh. 3:24; 6:23; Efe. 2:8-9). Vetëm Perëndia është besnik (krh. Mal. 3:6)!

Ka një seri veprimesh që mund të quhen ngjarja e shpëtimit.

- a. pendimi (krh. 2:4; Marku 1:15; Luka 13:3,5; Vep. 3:16,19; 20:21)
- b. besimi (krh. 1:16; Gjoni 1:12; 3:16; Vep. 16:31, pagëzimi është shpallja publike e besimit personal)
- c. bindja (krh. 2:13; II Kor. 9:13; 10:5; I Pjet. 1:2,22)
- d. këmbëngulja (krh. 2:7; Luka. 18:1; II Kor. 4:1,16; Gal. 6:9; II Thes. 3:13).

Këto janë kushtet e Besëlidhjes së Re. Ne duhet të marrim/besojmë dhe të vazhdojmë të marrim/besojmë ofertën e Perëndisë në Krishtin (krh. v. 16; Gjoni 1:12).

TEMË E VEÇANTË: BESOJ, ZË BESË, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHIATËN E VJETËR (𐤀𐤎𐤁)

I. Shënim hyrës

Duhet pohuar se përdorimi i këtij koncepti teologjik, kaq jetik për DhR, nuk është përcaktuar dhe aq qartë në DhV. Pa dyshim që ekziston aty, por demonstron në pasazhe dhe persona kyç e të përzgjedhur.

DhV shkrin

1. individin me komunitetin
2. takimin personal dhe bindjen e besëlidhjes

Besimi është edhe takim personal, edhe stil i përditshëm jetese! Është më e lehtë ta përshkruash në një person, sesa në formë leksikore (pra, me studime fjale). Ky aspekt personal ilustron më së miri në

1. Abrahamin dhe farën e tij
2. Davidin dhe Izraelin

Këta burra u takuan/u poqën me Perëndinë dhe jeta e tyre ndryshoi një herë e përgjithmonë (jo jetë të përsosura, por besim i vazhdueshëm). Sprovimi zbuloi dobësitë dhe pikat e forta të takimit të besimit të tyre me Perëndinë, por marrëdhënia e ngushtë dhe plot besim vazhdoi gjatë gjithë kohës! Ajo u provua dhe u përpunua, por vazhdoi të dëshmohej në përkushtimin dhe stilin e tyre të jetesës.

II. Rrënja kryesore që përdoret

A. 𐤀𐤎𐤁 (BDB 52)

1. FOLJA

- a. Rrënja *Qal* – mbështes, ushqej (p.sh., 2 Mbret. 10:1, 5; Ester 2:7, përdorimi joteologjik)
- b. Rrënja *Niphal* – bëj të sigurt ose të patundur, themeloj, pohoj, jam besnik ose i besueshëm
 - (1) për njerëzit, Isa. 8:2; 53:1; Jer. 40:14
 - (2) për gjërat, Isa. 22:23
 - (3) për Perëndinë, LiP. 7:9; Isa. 49:7; Jer. 42:5
- c. Rrënja *Hiphil* – qëndroj i patundur, besoj, kam besim
 - (1) Abrahami besoi në Perëndinë, Zan. 15:6
 - (2) Izraelitët në Egjipt besuan, Eks. 4:31; 14:31 (mohuar në LiP. 1:32)
 - (3) Izraelitët besonin se YHWH fliste përmes Moisiut (Eks. 19:9; Ps. 106:12, 24)
 - (4) Ahazi nuk i besoi Perëndisë, Isa. 7:9
 - (5) Kushdo që beso në të, Isa. 28:16
 - (6) Besoni të vërtetat për Perëndinë Isa. 43:10-12

2. EMRI (MASHKULLOR) – besnikëri (shih LiP. 32:20; Isa. 25:1; 26:2)

3. NDAJFOLJA – me të vërtetë, ashtu është, jam dakord, ashtu qoftë (shih LiP. 27:15-26; 1 Mbret. 1:36; 1 Kro. 16:36; Isa. 65:16; Jer. 11:5; 28:6). Ky është përdorimi liturgjik i “amen” në DhV dhe DhR.

B. 𐤀𐤎𐤁𐤁 (BDB 54) EMRI FËMEROR, patundshmëri, besnikëri, e vërtetë

1. për njerëzit, Isa. 10:20; 42:3; 48:1
2. për Perëndinë, Eks. 34:6; Psa. 117:2; Isa. 38:18-19; 61:8
3. për të vërtetën, LiP. 32:4; 1 Mbret. 22:16; Psa. 33:4; 98:3; 100:5; 119:30; Jer. 9:5; Zak. 8:16

C. 𐤀𐤎𐤁𐤁𐤁 (BDB 53), patundshmëri, qëndresë, besnikëri

1. për duart, Eks. 17:12
2. për kohët, Isa. 33:6
3. për njerëzit, Jer. 5:3; 7:28; 9:2

4. për Perëndinë, Psa. 40:11; 88:11; 89:1, 2, 5, 8; 119:138

III. Përdorimi i këtij koncepti të DhV nga Pali

A. Pali e bazon kuptimin e tij të ri të YHWH-së dhe DhV në takimin e vet personal me Jezusin në rrugën për në Damask (shih Veprat 9; 22; 26).

B. Ai gjeti mbështetje në DhV për botëkuptimin e tij të ri në dy pasazhe kyçe të DhV, të cilat përdorin rrënjën $\gamma\alpha$.

1. Zan. 15:6 – takimi personal i Abrahamit, i nisur nga Perëndia (Zanafilla 12) rezultoi në një jetë bindjeje dhe besimi (Zan. 12-22). Pali aludon për këtë në Romakëve 4 dhe Galatasve 5.

2. Isa. 28:16 – ata që besojnë në të (pra, në gurin e sprovuar të qoshes të Perëndisë, i cili është vendosur në mënyrë të patundur), kurrë

a. Rom. 9:33, “nuk do të turpërohen” apo “zhgënjehen”

b. Rom. 10:11, njësoj si më lart

3. Hab. 2:4 – ata që njohin Perëndinë besnik do të bëjnë jetë besnike (shih Jer. 7:28). Pali e përdor këtë pasazh në Rom. 1:17 dhe Gal. 3:11 (vini re dhe Heb. 10:38).

IV. Përdorimi i këtij koncepti të DhV nga Pjetri

A. Pjetri kombinon

1. Isa. 8:14 – 1 Pjet. 2:8 (guri i pengesës)

2. Isa. 28:16 – 1 Pjet. 2:6 (guri i qoshes)

3. Psa. 118:22 – 1 Pjet. 2:7 (guri i refuzuar)

B. Ai i kthehet gjuhës unike që përshkruan Izraelin, “racë e zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë, popull për zotërimin e Perëndisë” nga

1. LiP. 10:15; Isa. 43:21

2. Isa. 61:6; 66:21

3. Eks. 19:6; LiP. 7:6

dhe tani e përdor për besimin e kishës në Krishtin

V. Përdorimi i këtij koncepti nga Gjoni

A. Përdorimi në DhR

Termi “besoi” vjen nga termi greqisht (*pisteuō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “bindje”. Për shembull, EMRI nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në Gjoni 2:23-25, ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termit “besoj” gjenden në Gjoni 8:31-59 dhe Veprat 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa një reagim fillestar. Ai duhet vijuar nga një proces dishepullizimi (shih Mat. 13:20-22, 31-32).

B. Përdorimi i tij me PARAFJALË

1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vendosin besimin në Jezusin

a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjonit 5:13)

b. në të (Gjoni 2:11; 3:15, 18; 4:39; 6:40; 7:5, 31, 39, 48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45, 48; 12:37, 42; Mat. 18:6; Veprat 10:43; Fil. 1:29; 1 Pje. 1:8)

c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25-26; 12:44, 46; 14:1, 12; 16:9; 17:20)

d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjonit 5:10)

e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat 19:4; Gal. 2:16)

f. në Dritën (Gjoni 12:36)

g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)

2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat 5:14

3. *epi* do të thotë “në” ose “mbi”, si te Mat. 27:42; Veprat 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5, 24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pje. 2:6

4. RASA DHANORE pa PARAFJALË, si te Gal. 3:6; Veprat 18:8; 27:25; 1 Gjonit 3:23; 5:10

5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, i jep përmbajtje asaj që besohet

a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)

b. Jezusi është Unë Jam-i (Gjoni 8:24)

c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në të (Gjoni 10:38)

d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)

e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)

- f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
- g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
- h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)
- i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
- j. Ne do të jetojmë me të (Rom. 6:8)
- k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)

VI. Përmbyllje

Besimi biblik është reagimi njerëzor ndaj një fjale/premtimi Hyjnor. Perëndia është gjithmonë nismëtari (p.sh., Gjoni 6:44-45), por pjesë e këtij komunikimi hyjnor është nevoja që njerëzit t'i përgjigjen.

A.besimi

B.bindja ndaj besëlidhjes

Besimi biblik është

1. marrëdhënie personale (besimi fillestar)
2. pohim i së vërtetës biblike (besim në zbulesën e Perëndisë)
3. reagim i duhur dhe plot bindje ndaj tij (besimi i përditshëm)

Besimi biblik nuk është biletë për në qiell, apo policë sigurimi. Ai është marrëdhënie personale. Ky është synimi i krijimit dhe bërjes së njerëzve në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë me Perëndinë (shih Zan. 1:26-27). Çështja qëndron te “ngushtësia e marrëdhënies”. Perëndia dëshiron bashkësi, jo një qëndrim të caktuar teologjik! Por bashkësia me Perëndinë e shenjtë kërkon që fëmijët e tij të shfaqin karakteristikat e “familjes” (pra, shenjtërinë, shih Lev. 19:2; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:15-16). Rënia (Zanafilla 3) na preku aftësinë për t'u përgjigjur në mënyrën e duhur. Si rrjedhojë, Perëndia veprroi në emrin tonë (shih Ezek. 36:27-38), duke na dhënë një “zemër të re” dhe një “frymë të re”, që na mundëson, përmes besimit dhe pendimit, që të kemi bashkësi me të dhe t'i bindemi!

Të tria këto janë kyçe. Të tria duhen ruajtur. Synimi është të njohim Perëndinë (si në kuptimin hebraisht, ashtu dhe atë greqisht) dhe të reflektojmë karakterin e tij në jetë. Synimi i besimit nuk është qielli një ditë, por ngjashmëria me Krishtin përditë!

Besnikëria njerëzore është rezultati (DhR), jo baza (DhV), për një marrëdhënie me Perëndinë: besimi i njeriut në besnikërinë e tij; besimi i njeriut në besueshmërinë e tij. Thelbi i pikëpamjes së DhR për shpëtimin është se njerëzit duhet t'i përgjigjen fillimisht dhe vazhdimisht hirit dhe mëshirës së Perëndisë, të demonstruar në Krishtin. Ai ka dashur, ai ka dërguar, ai ka siguruar; ne duhet t'i përgjigjemi me besim dhe besnikëri (shih Efe. 2:8-9 dhe 10)!

Perëndia besnik do njerëz besnikë për t'iu zbuluar kësaj bote pa besim dhe për t'i sjellë ata në një besim personal në të.



NASB “për hir të emrit të Tij”

NKJV “për emrin e Tij”

NRSV “për hirin e emrit të tij”

TEV “për hir të Krishtit”

NJB “për nder të emrit të tij”

Shih TEMË E VEÇANTË në 10:9.

■ **“bindjen e besimit”** Fraza greke e fjalëpërfjalshme është “për (*eis*) bindje.” Ungjilli ka një

1. bindje të menjëhershme të pendimit dhe besimit
2. bindje si mënyrë jetese të ngjashmërisë me Krishtin dhe të këmbënguljes

Ungjilli është një dhuratë e hirit, por kërkon rezultate! DHR është një besëlidhje ashtu si DHV. Të dyja kërkojnë një përgjigje besimi/bindjeje. Ato të dyja kanë përfitime, përgjegjësi dhe pritshmëri/kërkesa (p.sh. Efe. 1:4; 2:10). Kjo nuk është një drejtësi me anë të veprave, por një konfirmim me anë të veprave (krh. Jakobi, 1 Gjonit)! Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme!



NASB, NRSV “midis të gjithë johebrenjve”

NKJV	“midis të gjithë kombeve”
TEV	“njerëz të të gjithë kombeve”
NJB	“ndaj gjithë kombeve pagane”

Ky është ungjilli universal. Premtimi i Perëndisë për shpengim tek Zan. 3:15 përfshinte të gjithë njerëzimin. Vdekja zëvendësuese e Jezusit përfshiu të gjithë fëmijët e rënë të Adamit (krh. Gjonit 1:29; 3:16; 4:42; 6:33,51; I Kor. 15:22; II Kor. 5:19; Efe. 2:11-3:13; I Tim. 2:4;4:10; Titit 2:11; Heb. 2:9; II Pjet. 3:9; I Gjonit 2:2; 4:14). Pali e sheh thirtjen e tij të veçantë si predikimi i ungjillit të Perëndisë ndaj johebrenjve (krh. Vep. 9:15; 22:21; 26:17; Rom. 11:13; 15:16; Gal. 1:16; 2:29; Efe. 3:2,8; I Tim. 2:7; II Tim. 4:17).

TEMË E VEÇANTË: ANËSITË UNGJILLORE TË BOBIT

Duhet të të rrëfej, o lexues, se, në këtë pikë, unë kam anësinë time. Teologjia ime sistematike nuk është as kalvinizmi, as dispensacionalizmi, por është ungjillizimi që ndjek Porosinë e Madhe (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat 1:8). Unë besoj se Perëndia kishte një plan të përrjetshëm për shpengimin e gjithë njerëzimit (p.sh., Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Jer. 31:31-34; Eze. 18; 36:22-38; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Rom. 3:9-18, 19-20, 21-31), të gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e tij (shih Zan. 1:26-27). Besëlidhjet janë bashkuar në Krishtin (shih Gal. 3:28-29; Kol. 3:11). Jezusi është misteri i Perëndisë, i fshehur, por tani i zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13)! Çelësi i Shkrimit nuk është Izraeli, por ungjilli i DhR.

Ky botëkuptim paraprak ngjyros gjithë interpretimet e mia të Shkrimit. Unë i lexoj të gjitha pasazhet përmes tij! Pa dyshim që kjo është anësi (të gjithë interpretuesit i kanë!), por është bazuar në Shkrimet.

1:6 “edhe ju” Pali ishte një shembull ekstrem (d.m.th. përndjekës i kishës) i hirit të Perëndisë, por edhe lexuesit e tij ishin shembuj të hiri të pamerituar të Perëndisë.

☐	
NASB, NKJV	“të thirrurit e Jezu Krishtit”
NRSV	“që jeni thirrur t’i përkisni Jezu Krishtit”
TEV	“që Perëndia ka thirrur që t’i përkasin Jezu Krishtit”
NJB	“me anë të thirrjes së tij i përkisni Jezu Krishtit”

Kjo mund të jetë

1. një lojë fjalësh me termin “kishë,” që do të thoshte “të thirrurit jashtë” ose “të mbledhurit”
2. një referencë ndaj zgjedhjes hyjnore (krh. Rom. 8:29-30; 9:1 e më tej; Efe.1:4, 11; 3:21; 4:1,4)
3. përkthimi i Revised English Bible për këtë frazë “ju që keni dëgjuar thirrjen dhe i përkisni Jezu Krishtit”.

Kjo gjithashtu reflekton të kuptuarit e kësaj fraze siç është përkthyer në NRSV, TEV dhe JB. Shih TEMË E VEÇANTË më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: TË THIRRUR

Perëndia gjithmonë e merr iniciativën në thirrjen, zgjedhjen dhe tërheqjen e besimtarëve tek Vetja (krh. Gjoni 6:44, 65; 15:16; I Kor. 1:12; Efe. 1:4-5,11). Termi “thirrje” përdoret në disa kuptime teologjike.

- A. Mëkatarët thirren në shpëtim me anë të hirit të Perëndisë, përmes punës së përfunduar të Krishtit dhe bindjes së Frymës (p.sh., *klētos*, krh. Rom. 1:6-7; 9:24, që është i ngjashëm nga ana teologjike me I Kor. 1:1-2 dhe II Tim. 1:9; II Pjet. 1:10).
- B. Mëkatarët thërrasin emrin e Zotit për t’u shpëtuar (p.sh., *epikaleō*, krh. Vep. 2:21; 22:16; Rom. 10:9-13). Kjo deklaratë është një idiomë adhurimi hebreje.
- C. Besimtarët janë thirrur për të jetuar jetë si të Krishtit (p.sh., *klēsis*, krh. I Kor. 1:26; 7:20; Efe. 4:1; Fil. 3:14; II Thes. 1:11; II Tim. 1:9)
- D. Besimtarët janë thirrur në detyra të shërbesës (krh. Vep. 13:2; I Kor. 12:4-7; Efe. 4:1).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:7

⁷të gjithë juve që jeni të dashur nga Perëndia në Romë, të thirrur si shenjtorë: Hir mbi ju dhe paqe nga Perëndia Ati ynë dhe Zoti Jezu Krisht.

1:7 “të dashur nga Perëndia” Kjo frazë shpesh përdorej për Jezusin (krh. Mat. 3:17; 17:5). Tani është përdorur për kishën në Romë! Kjo tregon thellësinë e dashurisë së Perëndisë për ata që besojnë në Birin e Tij. Ky lloj transferimi mund të shihet edhe tek Efe. 1:20 (veprimet e Perëndisë në favor të Jezusit) dhe Efe 2:5-6 (veprimet e Jezusit në favor të besimtarëve).

■ **“në Romë”** Këtë kishë nuk e mbolli Pali. Askush nuk e di kush e mbolli. Romakëve ishte një letër që e prezantonte atë me një kishë tashmë të themeluar. Libri i Romakëve është prezantimi më i plotë nga ana e Palit e ungjillit që ai predikonte. Ajo është më pak e ndikuara nga ndonjë situatë lokale, megjithëse kishte tensione midis besimtarëve hebrenj dhe johebrenj për të cilat ai komenton gjatë gjithë letrës (sid. kap. 9-11).

■

NASB	“të thirrur si shenjtorë”
NKJV, NRSV, NJB	“të thirrur për të qenë shenjtorë”
TEV	“të thirrur për të qenë populli i tij”

Termi “shenjtorë” i referohet pozicionit të besimtarëve në Krishtin (shih Temë e Veçantë në 6:4), jo pamëkatshmërisë së tyre. Ai gjithashtu duhet të përshkruajë ngjashmërinë gjithmonë e më të madhe të tyre me Krishtin. Termi është gjithmonë në SHUMËS, përveç te Fil. 4:21. Megjithatë, edhe në atë kontekst ka kuptim të përgjithshëm trupor. Të jesh i krishterë është të jesh pjesë e një komuniteti, një familjeje, një trupi.

Vargu 1 tregon që Pali ishte thirrur për të qenë apostull. Besimtarët janë “të thirrurit e Jezu Krishtit” në vargun 6. Besimtarët gjithashtu quhen “shenjtorë” në vargun 7. Kjo “thirrje” ishte një mënyrë e DHR për të pohuar të vërtetën e përparësisë së Perëndisë në marrjen e iniciativës (shih Temën e Veçantë në 1:6). Asnjë qenie njerëzore e rënë nuk e thirri ndonjëherë veten (krh. 3:9-13; Isa. 53:6; I Pjet. 2:25). Perëndia gjithnjë e merr iniciativën (krh. Gjonit 6:44,65; 15:16). Ai gjithmonë na e sjell besëlidhjen neve (shih Temë e Veçantë në 9:4). Kjo është e vërtetë për shpëtimin (drejtësinë që na është veshur/llogaritur apo për pozitën tonë ligjore), por edhe për pajisjen tonë me dhunti për shërbim efektiv (krh. I Kor. 12:7,11) dhe për jetën tonë të krishterë. Shih TEMËN E VEÇANTË që vijon.

TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË

Ky është barazvlerësi grek i fjalës hebraike *kadash*, e cila ka kuptimin themelor të ndarjes së dikujt, diçkaje ose ndonjë vendi mënjane për përdorimin ekskluziv të YHWH (BDB 871). Shpreh konceptin e diçkaje të shenjtë. YHWH është i ndarë mënjane nga njerëzimi nga natyra e Tij (Frymë i përgjeshëm, i pakrijuar) dhe nga karakteri i Tij (përsosmëria morale). Ai është standardi me anë të të Cilit matet dhe gjykohet gjithçka tjetër. Ai është i Shenjti i Ndryshëm, i Shenjti i Përtejkesibotshëm.

Perëndia i krijoi njerëzit për bashkësi me Të, por Rënia (Zan. 3) shkaktoi një barrierë marrëdhënore dhe morale midis një Perëndie të Shenjtë dhe njerëzimit mëkatar. Perëndia zgjodhi ta rimëkëmbte/restauronte krijimin e Tij të ndërgjegjshëm; prandaj, Ai e thërret popullin e Tij të jetë “i shenjtë” (krh. Lev. 11:44; 19:2; 20:7,26; 21:8). Me anë të një marrëdhënieje besimi me YHWH populli i Tij u bë i shenjtë me anë të pozicionit të tij besëlidhor në Të, por gjithashtu është thirrur të jetojë jetë të shenjtë (krh. Mat. 5:48).

Kjo jetesë e shenjtë është e mundur sepse besimtarët janë plotësisht të pranuar dhe të falur përmes jetës dhe punës së Jezusit dhe përmes pranisë së Frymës së Shenjtë në mendjet dhe zemrat e tyre. Kjo vendos situatën paradoksale të:

1. të qenit të shenjtë për shkak të veshjes së drejtësisë së Krishtit
2. thirrjes për të jetuar si të shenjtë për shkak të pranisë së Frymës

Besimtarët janë “shenjtorë” (*hagioi*) për shkak të (1) vullnetit të të Shenjtit (Atit); (2) punës së Birit të Shenjtë (Jezusit); dhe (3) pranisë së Frymës së Shenjtë.

DHR gjithmonë u referohet shenjtorëve si SHUMËS (përveç një herë te Fil 4:21, por edhe atje konteksti e bën atë SHUMËS). Të jesh i shpëtuar është të jesh pjesë e një familjeje, një trupi, një ndërtese! Besimi biblik fillon me një

pranim personal, por rezulton në një bashkësi trupore. Ne të gjithëve na janë dhënë dhunti (krh. I Kor. 12:7) për shëndetin, rritjen dhe mirëqenien e trupit të Krishtit – kishës (krh. I Kor. 12:11). Ne jemi shpëtuar për të shërbyer! Shenjtëria është një karakteristikë familjare!

■ **“Hir mbi ju dhe paqe nga Perëndia”** Ky është bekimi karakteristik hyrës i Palit. Është një lojë fjalësh me termin tradicional grek “përshëndetje (*charein*) dhe termin vetëm të krishterë “hir” (*charis*). Pali mund të ketë qenë duke e kombinuar këtë hyrje greke me përshëndetjen tradicionale hebraike *shalom* ose “paqe.” Megjithatë, ky është vetëm një hamendësim. Vini re se nga ana teologjike hiri gjithmonë i paraprin paqes.

■ **“nga Perëndia Ati ynë dhe Zoti Jezu Krisht”** Pali rregullisht përdor vetëm një PARAFJALË për të dy emrat (krh. I Kor. 1:3; Gal. 1:3; Efe. 1:2; Fil. 1:2; II Thes. 1:2; I Tim. 1:1; II Tim. 1:2; Titit 1:4). Kjo ishte mënyra e tij për t’i lidhur në mënyrë gramatikore këta dy Persona të Trinisë. Kjo do të theksonte hyjninë e Jezusit dhe barazinë e Tij me Atin.

TEMË E VEÇANTË: ATËRORITETI I PERËNDISË

I. Dhiata e Vjetër

A. Në një kuptim Perëndia është atë nëpërmjet krijimit.

1. Zan. 1:26-27
2. Mal. 2:10
3. Vep. 17:28

B. Atë është një analogji e përdorur në disa kuptime.

1. atë i Izraelit (me anë të zgjedhjes)
 - a. “Bir” – Eks. 4:22; LiP. 14:1; 39:5; Isa. 1:2; 63:16; 64:8; Jer. 3:19; 31:20; Osea 1:10; 11:1; Mal. 1:6
 - b. “i parëlinduri” – Eks. 4:32; Jer. 31:9
2. atë i mbretit të Izraelit (Mesianik)
 - a. 2 Sam. 7:11-16
 - b. Ps. 2:7; Vep. 13:33; Heb. 1:5; 5:5
 - c. Osea 11:1; Mat. 2:15
3. analogjia e një prindi të dashur
 - a. atë (metaforë)
 - 1) mbart birin e tij – LiP 1:31
 - 2) e disiplinon - LiP. 8:5; Fja. 3:12
 - 3) siguron (p.sh. Eksodi) – LiP 32:1
 - 4) nuk do ta braktisë kurrë – Ps. 27:10
 - 5) e do – Ps. 103:13
 - 6) mik/udhërrëfyes – Jer. 3:4
 - 7) shërues/falës – Jer. 3:22
 - 8) dhënës i mëshirës – Jer. 31:20
 - 9) stërvitës – Osea 11:1-4
 - 10) bir i veçantë – Mal. 3:17
 - b. nënë (metaforë)
 - 1) nuk do ta braktisë kurrë – Ps. 27:10
 - 2) dashuria e një mëndeshe – Isa. 49:15; 66:9-13 dhe Osea 11:4 (duke propozuar ndreqjen e tekstit nga “zgjedhë” në “foshnjë”)

II. Dhiata e Re

A. Trinia (tekstet ku përmenden të tre)

1. Ungjijtë
 - a. Mat. 3:16-17; 28:19
 - b. Gjoni 14:26
2. Pali
 - a. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10

- b. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
 - c. 2 Kor. 1:21; 13:14
 - d. Gal. 4:4-6
 - e. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4-
 - f. 1 Thes. 1:2-5
 - g. 2 Thes. 2:13
 - h. Titit 3:4-6
3. Pjetri – 1 Pjet. 1:2
4. Juda – vv. 20-21
- B. Jezusi
- 1. Jezusi si “i vetëmlinduri” - Gjoni 1:18; 3:16,18; 1 Gjoni 4:9
 - 2. Jezusi si “Biri i Perëndisë” - Mat. 4:3; 14:33;16:16; Luka 1:32,35; Gjoni 1:34,49; 6:69; 11:27
 - 3. Jezusi si Biri i Dashur - Mat. 3:17; 17:5
 - 4. Përdorimi nga ana e Jezusit e *abba* për Perëndinë – Marku 14:36
 - 5. Përdorimi nga ana e Jezusit e PËREMRAVE për të treguar marrëdhënien e Tij dhe tonën me Perëndinë
 - a. “Ati im,” p.sh., Gjoni 5:18; 10:30,33; 19:7; 20:17
 - b. “ati juaj,” p.sh., Mat. 17:24-27
 - c. “ati ynë,” p.sh., Mat. 6:9,14,26
- C. Një nga metaforat e shumta familjare për të përshkruar marrëdhënien intime midis Perëndisë dhe njerëzimit:
- 1. Perëndia si Atë
 - 2. Besimtarët si
 - a. Bij të Perëndisë
 - b. Fëmijë
 - c. Të lindur nga Perëndia
 - d. Të lindur sërish
 - e. Të adoptuar
 - f. Të nxjerrë
 - g. Familje e Perëndisë

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:8-15

⁸Së pari, e falenderoj Perëndinë tim përmes Jezu Krishtit për ju të gjithë, sepse besimi juaj po shpallet në të gjithë botën. ⁹Sepse Perëndia, të Cilit i shërbej në frymën tim në *predikimin e ungjillit të Birit të Tij*, është dëshmitari im *se sa pa pushim iu kujtoj* ¹⁰gjithmonë në lutjet e mia duke bërë kërkesë, nëse ndoshta tani më së fundi me vullnetin e Perëndisë mund të arrij të vij te ju. ¹¹Sepse kam mall t’ju shoh që të mund t’ju përçoj ndonjë dhunti frymërore, që të themeloheni; ¹²domethënë, që unë të mund të inkurajohem bashkë me ju *ndërkohë që jam* në mes tuaj, secili nga ne me anë të besimit të tjetrit, tuajit dhe timit. ¹³Nuk dua që të mos e dini vëllezër, që shpesh kam planifikuar të vij tek ju (dhe nuk jam lejuar deri tani) që të mund të fitoj disa fryte edhe midis jush, si edhe midis johebrenjve të tjerë. ¹⁴Unë u detyrohem si grekëve, ashtu edhe barbarëve, të urtëve dhe të marrëve. ¹⁵Kështu, për sa më takon mua, jam i paduruar t’ju a predikoj ungjillin edhe juve që jeni në Romë.

1:8 “Së pari” Në këtë kontekst “së pari” do të thotë “nga fillimi” ose “duhet të filloj” (J. B. Phillips).

▣ “e falenderoj Perëndinë tim përmes Jezu Krishtit.” Pali normalisht ia drejton lutjet e tij Perëndisë përmes Jezu Krishtit. Jezusi është rruga jonë e vetme për t’iu afruar Perëndisë! Shih TEMË E VEÇANTË: Lutjet e Palit të lavdërimit dhe falenderimit tek 7:25.

■ **“për ju të gjithë”** Ky përdorim i “të gjithë,” si v. 7, mund të reflektojë xhelozinë dhe konfliktin midis udhëheqësve besimtarë hebrenj që u larguan nga Roma me dekretin e Neronit dhe udhëheqësve besimtarë johebrenj që i kishin zëvendësuar ata për disa vjet. Romakëve 9-11 i adresohet pikërisht kësaj çështjeje.

Është gjithashtu e mundur që përfshirja iu adresohet “të dobtëve” dhe “të fortëve” të Rom. 14:1-15:13. Perëndia i do të gjithë në kishën e Romës dhe i do në mënyrë të barabartë!

■ **“sepse besimi juaj po shpallet në të gjithë botën.”** Romakëve 16:19 bën aluzion për të njëjtën të vërtetë. Kjo ishte pa dyshim një hiperbolë orientale dhe i referohej botës romake (krh. I Thes. 1:8).

1:9 “Perëndia...është dëshmitari im” Pali po bënte një betim në emrin e Perëndisë (krh. 9:1; II Kor. 1:23; 11:10-11,31; 12:19; Gal. 1:20; I Thes. 2:5). Kjo ishte mënyra e tij hebreje e pohimit të vërtetësisë së tij.

■	
NASB	“sa papushim”
NKJV, NRSV	“pa pushuar”
NJB	“përmend vazhdimisht”
NIV	“sa vazhdimisht”

Ky lajtmotiv i lutjeve të vazhdueshme dhe urgjente të Palit (krh. I Thes. 1:2; 2:13; II Tim. 1:3) duhet të jetë një shembull që udhëheqësit e kishës duhet ta ndjekin me zell (krh. I Thes.5:17). Lutja hap një derë të fuqishme frymërore. Ne nuk kemi, sepse nuk kërkojmë (Jakobi 4:2).

■ **“në frymën tim”** Ky është një shembull i mirë i përdorimit të *pneuma* për frymën njerëzore (krh. 8:5,10,16; 12:11) (d.m.th., frymë (që merr), hebraisht *ruach*, BDB 924, krh. Zan. 2:7).

TEMË E VEÇANTË: FRYMË (*PNEUMA*) NË DHR

Termi greqisht “frymë” përdoret në mënyra të ndryshme në DHR. Ja disa klasifikime dhe shembuj përfaqësues.

- A. për Perëndinë Triun
 1. për Atin (shih Gjoni 4:24)
 2. për Birin (shih Rom. 8:9-10; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11)
 3. për Frymën e Shenjtë (shih Marku 1:11; Mat. 3:16; 10:20; Gjoni 3:5,6,8; 7:39; 14:17; Veprat 2:4; 5:9; 8:29,35; Rom. 1:4; 8:11,16; 1 Kor. 2:4,10,11,13,14; 12:7)
- B. për forcën e jetës njerëzore
 1. për Jezusin (shih Marku 8:12; Gjoni 11:33,38; 13:21)
 2. për njerëzimin (shih Mat. 22:43; Veprat 7:59; 17:16; 20:22; Rom. 1:9; 8:16; 1 Kor. 2:11; 5:3-5; 7:34; 15:45; 16:18; 2 Kor. 2:13; 7:13; Fil. 4:23; Kol. 2:5)
- C. për botën shpirtërore
 1. qeniet shpirtërore
 - a. të mira (pra, engjëjt, shih Veprat 23:8-9; Heb. 1:14)
 - b. të këqija (pra, demonët, shih Mat. 8:16; 10:1; 12:43,45; Veprat 5:16; 8:7; 16:16; 19:12-21; Efe. 6:12)
 - c. fantazmat (shih Luka 24:37)
 2. dallueshmëria shpirtërore (shih Mat. 5:3; 26:41; Gjoni 3:6; 4:23; Veprat 18:25; 19:21; Rom. 2:29; 7:6; 8:4,10; 12:11; 1 Kor. 14:37)
 3. gjërat shpirtërore (shih Gjoni 6:63; Rom. 2:29; 8:2,5,9,15; 15:27; 1 Kor. 9:11; 14:12)
 4. dhuntitë shpirtërore (shih 1 Kor. 12:1; 14:1)
 5. frymëzimi i Frymës (shih Mat. 22:43; Luka 2:27; Efe. 1:17)
 6. trupi shpirtëror (shih 1 Kor. 15:44-45)
- D. Karakterizon
 1. qëndrimin e botës (shih Rom. 8:15; 11:8; 1 Kor. 2:12)
 2. procesin e mendimit të njerëzve (shih Veprat 6:10; Rom. 8:6; 1 Kor. 4:2)
- E. për sferën fizike
 1. era (shih Mat. 7:25, 27; Gjoni 3:8; Veprat 2:2)

2. hukatja (shih Veprat 17:25; 2 Thes. 2:8)

Është e qartë se ky term duhet interpretuar në bazë të kontekstit të atypëratyshëm. Ka ngjyrimë të ndryshme kuptimore që mund t'i referohen (1) botës fizike; (2) botës së padukshme; (3) si dhe personave të kësaj bote fizike, ose të sferës shpirtërore.

Fryma e Shenjtë është ai person i Perëndisë triun që është më së tepërmi veprues në këtë fazë të historisë. Epoka e re e Frymës ka mbërritur. Gjithçka që është e mirë, e shenjtë, e drejtë dhe e vërtetë lidhet me Frymën. Prania, dhuntitë dhe shërbesa e tij janë kyçe për përhapjen e ungjillit dhe për suksesin e mbretërisë së Perëndisë (shih Gjoni 14 dhe 16). Ai dënon, bind, josh, pagëzon dhe pjek gjithë besimtarët (shih Gjoni 16:8-11).

1:10 “gjithmonë në lutjet e mia duke bërë kërkesë” Pali nuk e mbolli vetë këtë kishë, e megjithatë ai vazhdimisht lutej për ta (krh. II Kor. 11:28), siç bënte për të gjitha kishat e tij! Shih TEMË E VEÇANTË: Lutja ndërhyrëse në 9:3. Megjithatë, Pali kishte shumë miq dhe bashkëpunëtorë në kishën romane, siç e tregon qartë kapitulli 16.

■ **“nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË e cila merret e mirëqenë që është e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Pali planifikonte ta vizitonte Romën rrugës për në Spanjë (krh. 15:22-24). Ai ndoshta nuk planifikonte të qëndronte atje për një kohë të gjatë. Pali gjithmonë donte të shërbente në një fushë të re ku nuk kishte punuar tjetër njeri më parë (krh. 15:20; II Kor. 10:15,16). Është e mundur që një nga qëllimet e letrës drejtuar romakëve ishte për të kërkuar fonde për udhëtimin e tij misionar në Spanjë (krh. 15:24).

■ **“me vullnetin e Perëndisë mund të arrij të vij tek ju”** Kjo ka një paralel në v.13 dhe 15:32. Pali nuk mendonte se jeta dhe planet e tij të udhëtimit i përkisnin atij, por Perëndisë (krh. Vep. 18:21; I Kor. 4:19; 16:7). Shih TEMË E VEÇANTË te 12:2.

Gjithashtu vini re që vullneti i Perëndisë mund të ndikohet nga lutjet e besimtarëve!

1:11 “sepse kam mall t’ju shoh” Kjo është paralele me 15:23. Për një kohë të gjatë Pali dëshironte t’i takonte besimtarët në Romë. (krh. Vep. 19:21).

■ **“që të mund t’ju përçoj ndonjë dhunti frymërore”** Frazja “dhunti frymërore” përdorej në kuptimin e të kuptuarit ose bekimit frymëror (krh. 11:29; 15:27). Pali e shikonte veten si të thirrur në mënyrë unike për të qenë Apostulli i Johebrenjve (krh. v. 15).

■ **“që të mund të themeloheni”** Kjo është një AORISTE PËSORE INFINITIVE e *histēmi*. Shih TEMË E VEÇANTË te 5:2. Kjo fjalë ka tre kuptime.

1. themeloj, Rom. 1:11; 16:25; I Thes. 3:13; II Pjet. 1:12
2. forcoj, Luka 22:32; I Thes. 3:2; II Thes. 2:17; 3:3; Jakobi 5:8; Zbu. 3:2
3. një shprehje semitike për marrjen e një vendimi të prerë, Luka 9:51

Shih Temën e Veçantë në 5:2.

1:12 Ky është qëllimi i bashkësisë të krishterë. Dhuntitë kanë qëllim t’i bashkojnë besimtarët në një komunitet shërbyes. Besimtarëve iu janë dhënë dhunti për të mirën e përbashkët (krh. I Kor. 12:7). Të gjitha dhuntitë kanë përdorim. (krh. I Kor. 12:11). Të gjithë besimtarët janë shërbyes me kohë të plotë të thirrur e të pajisur me dhunti. (krh. Efe. 4:11-12). Pali e deklaroi qartë kuptimin e tij të autoritetit Apostolik, por edhe një reciprocitet mbarë-komunitar. Besimtarët kanë nevojë për njëri-tjetrin! Besimtarët janë Trupi i Krishtit.

1:13 “Nuk dua që të mos e dini vëllezër” Kjo është një idiomë/shprehje që Pali e përdor shpesh si hyrje për deklarime të rëndësishme (krh. 11:25; I Kor. 10:1; 12:1; II Kor. 1:8; I Thes. 4:13). Është e ngjashme në qëllimin letrar me shprehjen e Jezusit, “Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them.”

■ **“dhe jam penguar deri tani”** Kjo është një FOLJE PËSORE. E njëjta frazë gjendet edhe te I Thes. 2:18 ku agjenti veprues është Satani. Pali besonte se jeta e tij drejtohej nga Perëndia, por pengohej nga Satani. Në njëfarë mënyre të dyja janë të vërteta (krh. Jobi 1-2; Danieli 10). Përdorimi i këtij termi në 15:22 nënkupton se pengesa

ishite puna misionare e Palit në zonën e Mesdheut lindor, e cila nuk kishte përfunduar ende (por ishte afër përfundimit).

■ **“që të mund të fitoj disa fryte edhe midis jush”** Në këtë kontekst “fryte” mund t’iu referohet të kthyerve të rinj në besim, por tek Gjoni 15:1-8 dhe Gal. 5:22 ajo i referohet pjekurisë së krishterë. Mateu 7 thotë, “do të njiheni nga frytet tuaja,” por nuk e përkufizon termin fryt. Paraleli më i mirë është ndoshta Fil. 1:22, ku Pali e përdor po këtë metaforë bujqësore.

1:14 “unë u detyrohem” Pali e përdor këtë term disa herë te Romakëve.

1. Pali është i detyruar t’ua predikojë ungjillin të gjithë johebrenjve (këtu).
2. Pali nuk i detyrohet “mishit” (8:12).
3. Kisha johebreje është e detyruar të ndihmojë kishën mëmë në Jerusalem (15:27).

■ **“grekëve”** Kjo u referohet njerëzve të qytetëruar e të kulturuar rrethëqark Detit Mesdhe. Aleksandri i Madh dhe pasuesit e tij e kishin helenizuar botën e njohur. Romakët që erdhën më pas asimiluan kulturën greke.

■ **“barbarëve”** Ky term (*onomatopei*) kishte kuptimin e popujve të paarsimuar apo të pakulturuar, zakonisht në veri. Ai përdorej për popuj që nuk flisnin greqisht. Gjuha e tyre grekëve dhe romakëve u tingëllonte si “bar bar bar.”

■ **“të diturve dhe të paditurve”** Është e mundur që kjo të jetë paralele në tekstin në greqisht me “barbarëve,” por jo patjetër kështu. Kjo mund të jetë një mënyrë tjetër për t’iu referuar të gjithë popujve dhe individëve.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:16-17

¹⁶Sepse unë nuk kam turp për ungjillin, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e kujtdo që beson, hebreat më parë dhe gjithashtu edhe grekut. ¹⁷Sepse në të drejtësia e Perëndisë është zbuluar nga besimi në besim; siç është shkruar, "POR I DREJTI DO TË JETOJË ME ANË TË BESIMIT."

1:16-17 Vargjet 16-17 janë lajtmotivi i të gjithë librit. Ky lajtmotiv amplifikohet dhe përmbledhet në 3:21-31.

1:16

NASB, NRSV	“Unë nuk kam turp për ungjillin”
NKJV	“Unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit”
TEV	“Unë kam siguri të plotë në ungjillin”
NJB	“Unë nuk kam turp për Lajmin e Mirë:”

Pali mund të jetë duke aluduar për fjalët e Jezusit te Marku 8:38 dhe Luka 9:26. Ai nuk ka turp për përmbajtjen e ungjillit ose për përndjekjen që rezulton prej tij (krh. II Tim. 1:12,16,18).

Te I Kor. 1:23 hebrenjtë kishin turp për ungjillin, sepse ai pohonte një Mesi vuajtës, dhe grekët sepse ai pohonte ringjalljen e trupit.

■ **“shpëtimin”** NË DHV, termi hebraik (*yasho*) së pari i referohej çlirimit fizik (krh. Jakobi 5:15), por në DHR termi grek (*sōzō*) i referohet së pari çlirimit shpirtëror (krh. I Kor. 1:18, 21). Shih Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, faqet 124-126.

TEMË E VEÇANTË: SHPËTIMI (Termi i DHV)

Ky term (BDB 447) ka disa kuptime.

1. mirëqenie, prosperitet, Jobi 30:15
2. shpëtim hyjnor që përfshin edhe aspektin fizik, edhe atë frymëror
 - a. Zan. 49:18
 - b. LiP. 32:15
 - c. Ps. 3:2,8; 22:1; 35:3; 62:2; 69:29; 70:5; 78:22; 80:3; 89:26;91:16; 106:4; 140:7
 - d. Isa. 12:2; 33:2; 51:6,8; 52:7,10; 56:1; 59:11; 60:18; 62:1
3. ideja e çlirimit fizik dhe frymëror është qartësisht e pranishme te Jona 2:9-10

4. shpesh “gëzimi” është i lidhur me shpëtimin e YHWH, I Sam. 2:1; Isa.25:9; 26:1; Ps. 9:14; 13:5; 35:9 Shpëtimi përfshin vendosjen e bashkësisë dhe shoqërisë së synuar që nga fillimi të YHWH me krijesat e Tij njerëzore. Ai përfshin tërësi/shëndet/mirëqenie individuale dhe shoqërore!



NASB “ndaj kujtdo që beson”
NKJV “për këdo që beson”
NRSV “ndaj kujtdo që ka besim”
TEV “të gjithë që besojnë”
NJB “të gjithë që kanë besim”

Ungjilli është për të gjithë njerëzit (oh, sa më pëlqejnë fjalët “kujtdo,” “kushdo,” “të gjithë,” shih shënimin në 1:5, i 6-ti në rradhë), por besimi është njëri nga kushtet për pranim (krh. Vep. 16:30-31). Tjetri është pendimi (krh. Marku 1:15; Vep. 3:16,19; 20:21). Perëndia merret me njerëzimin me anë të besëlidhjes (shih Temë e Veçantë te 9:4). Ai gjithmonë e merr iniciativën dhe cakton axhendën (krh. Gjonit 6:44, 65). Por ka disa kushte reciproke (Shih shënimin në 1:5, i katërti në rradhë).

Termi grek që këtu është përkthyer “besoj,” mund të përkthehet edhe me termat “besim” ose “besë.” Fjala greke ka një spektër kuptimor më të gjerë sesa ndonjë fjalë në anglisht (apo në shqip, shën. i përkth.). Vini re që është një PËRCJELLORE. Besimi shpëtues është një besim i vazhdueshëm (krh. I Kor. 1:18; 15:2; II Kor. 2:15; I Thes. 4:14)! Shih Temën e Veçantë në 10:4.

Fillimisht termat hebreje mbrapa këtij termi grek për “besim” kishin kuptimin e një pozicioni të qëndrueshëm, një njeri me këmbët e hapura që të mos lëvizet lehtë. Metafora e kundërt e DHV do të ishte “këmbët e mia ishin në argjilë të rrëshqitshme” (Ps. 40:2), “këmbët e mia për pak më rrëshqitën” (Ps. 73:2). Rrënjët hebraike të lidhura me të *emun*, *emunah*, *aman*, përdorshin në mënyrë metaforike për dikë që ishte i besueshëm, besnik ose i besës. Besimi shpëtues nuk reflekton aftësinë e njerëzimit të rënë për të qenë besnik, por të Perëndisë! Shpresat e besimtarëve nuk qëndrojnë në aftësitë e tyre, por në karakterin dhe premtimet e Perëndisë. Është besueshmëria e Tij, besnikëria e Tij, premtimet e Tij! Shih Temën e Veçantë në 1:5.

■ “**hebreut më parë**” Arsyeja për këtë parashtrrohet shkurtimisht në 2:9-10 dhe 3:1-20 dhe zhvillohet plotësisht në kapitujt 9-11. Ajo ndjek thëniet e Jezusit te Mateu 10:6; 15:24; Marku 7:27; Gjoni 4:22.

Kjo mund të ketë lidhje me xhelozinë midis udhëheqësve besimtarë hebrenj dhe johebrenj në kishën romane.

1:17 “drejtësia e Perëndisë” Kjo frazë në këtë kontekst i referohet (1) karakterit të Perëndisë dhe (2) mënyrës se si Ai ia jep atë karakter njerëzimit mëkatar. Bibla e Jerusalemit (JB) e përkthen “kjo është ajo që zbulon drejtësinë⁴ e Perëndisë.” Megjithëse kjo i referohet edhe mënyrës morale të jetesës së besimtarit, në rradhë të parë ajo ka të bëjë me pozicionin e tij ligjor përpara Gjykatësit të Drejtë. Kjo veshje e drejtësisë së Perëndisë njerëzimit mëkatar e të rënë, që nga koha e Reformacionit është karakterizuar si “shfajësim me anë të hirit nëpërmjet besimit” (krh. II Kor. 5:21; Fil. 3:9). Ky është vetë vargu që ndryshoi jetën dhe teologjinë e Martin Luterit!

Megjithatë, synimi i shfajësimit është shenjtërimi, ngjashmëria me Krishtin, ose karakteri i drejtë i Perëndisë (krh. Rom. 8:28-29; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 2:10; 4:13; I Thes. 3:13; 4:3; I Pjet. 1:15). Drejtësia nuk është vetëm një deklaram ligjor, është një thirrje për një jetë të shenjtë; imazhi i Perëndisë në njerëzimin duhet restauruar në mënyrë funksionale (krh. II Kor. 5:21).

TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA

“Drejtësia” është temë kaq kyçe sa studiuesi i Biblës duhet të bëjë një studim të hollësishëm personal të këtij koncepti.

⁴ 1 (Shën i përkth. - Në shqip ne kemi vetëm një fjalë “drejtësi” me dy kuptime. Në anglisht ka dy: *righteousness* që tregon karakterin e drejtë të dikujt dhe *justice* që tregon drejtësinë ligjore. JB e ka përkthyer *justice*.

Në DhV, karakteri i Perëndisë përshkruhet si “i drejtë” (BDB 841). Vetë kjo fjalë mesopotamase vjen nga një kallam lumi, që përdorej si vegël ndërtimi për të gjykuar drejtësinë horizontale të mureve dhe gardheve. Perëndia e zgjodhi këtë term për ta përdorur në mënyrë metaforike për natyrën e vet. Ai është shkopi i drejtë (vizorja) me të cilin maten të gjitha gjërat. Ky koncept pohon edhe drejtësinë e Perëndisë, edhe të drejtën e tij për të gjykuar.

Njeriu u krijua në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; 5:1, 3; 9:6). Njerëzimi u krijua për miqësi me Perëndinë. Gjithë krijimi është skenë ose sfond për ndërveprimin e Perëndisë me njerëzimin. Perëndia donte që krijesa e tij më e lartë, njeriu, ta njihte, ta donte, t'i shërbente dhe të ishte si ai! Besnikëria e njerëzimit u vu në sprovë (shih Zanafilla 3) dhe çifti i parë dështoi. Kjo çoi në prishjen e marrëdhënies së Perëndisë me njerëzimin (shih Zanafilla 3; Rom. 5;12-21).

Perëndia premtoi se do ta ndreqte dhe rimëkëmbte këtë bashkësi (shih Zan. 3:15). Ai e bën këtë me vullnetin e vet dhe me anë të Birit të vet. Njerëzit janë të paaftë për ta ndrequr këtë çarje (shih Rom. 1:18-3:20).

Pas Rënies, hapi i parë i Perëndisë drejt ripërtëritjes së miqësisë është koncepti i besëlidhjes, i bazuar në ftesën e tij dhe në përgjigjen e njerëzimit me pendim, besim dhe bindje. Për shkak të Rënies, njerëzit s'janë të aftë që të kryejnë veprimin e duhur (shih Rom. 3:21-31; Galatasve 3). Vetë Perëndisë iu desh të merrte nismën për të rimëkëmbur njerëzit që thyen besëlidhjen. Ai e bëri këtë

1. duke e shpallur njerëzimin të drejtë përmes veprës së Krishtit (pra, drejtësia ligjore).
2. duke i dhënë lirisht njerëzimit një drejtësi me anë të veprës së Krishtit (pra, drejtësia e llogaritur).
3. duke siguruar Frymën brendabanues, i cili prodhon drejtësi (pra, ngjashmëria me Krishtin, rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë) në njerëzimin.

Gjithsesi, Perëndia kërkon një përgjigje ndaj besëlidhjes. Ai vendos (pra, jep lirisht) dhe siguron, por njerëzit duhet të përgjigjen dhe të vazhdojnë të përgjigjen me

1. pendim
2. besim
3. bindje në stilin e jetesës
4. qëndresë

Prandaj, drejtësia është një veprim reciprok i besëlidhjes mes Perëndisë dhe krijesës së tij më të larët. Ajo bazohet në karakterin e Perëndisë, veprën e Krishtit dhe aftësimin e Frymës, dhe çdo individ duhet t'i përgjigjet siç duhet, personalisht dhe vazhdimisht. Ky koncept quhet “shfajësim me anë të besimit”. Ky koncept zbulohet në ungjijtë, por jo me këto fjalë. Në fillim, u përcaktua nga Pali, i cili e përdor termin greqisht “drejtësi” në forma të ndryshme mbi 100 herë.

Pali, si rabin i trajnuar, termin *dikaionē* e përdor në kuptimin e saj hebraik *SDQ*, të përdorur edhe nga Septuaginta, dhe jo nga literatura greke. Në shkrimet greke, kjo fjalë përdorej për dikë që përputhej me pritshmëritë e Hyznisë dhe shoqërisë. Në kuptimin e saj hebraik, kjo fjalë strukturohej gjithmonë në kuadër të besëlidhjes. YHWH është Perëndi i drejtë, etik dhe moral. Ai do që populli i tij të reflektojë karakterin e tij. Njerëzimi i shpenguar bëhet krijesë e re. Kjo risi çon në një stil të re jetese me perëndishmëri (fokusi katolik të shfajësimi). Meqë Izraeli ishte teokraci, nuk kishte dallim të qartë mes laikes (rregullave shoqërore) dhe së shenjtës (vullnetit të Perëndisë). Ky dallim shprehet duke i përkthyer fjalët hebraisht dhe greqisht në anglisht si “justice” (drejtësia që lidhet me shoqërinë) dhe “righteousness” (drejtësia që lidhet me fenë).

Ungjilli (lajmi i mirë) i Jezusit është se njerëzimi i rënë është rikthyer në bashkësi me Perëndinë. Kjo është arritur përmes dashurisë, mëshirës dhe hirit të Atit; jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Birit; dhe nxitjes e afrimit që na ka bërë Fryma me ungjillin. Shfajësimi është akt falas i Perëndisë, por duhet të çojë në perëndishmëri (pozicioni i Augustinit, i cili reflekton edhe theksin e reformacionit te natyra falas e ungjillit, por edhe theksin katolik për jetën e ndryshuar plot dashuri dhe besnikëri). Për reformatorët, termi “drejtësi e Perëndisë” është GJINORE KUNDRINORE (pra, akti që e bën njerëzimin e mëkatshëm të pranueshëm nga Perëndia [shenjtërimi pozicional]), ndërsa për katolikët është GJINORE KRYEFJALORE, që nënkupton procesin ku njeriu bëhet gjithnjë e më tepër si Perëndia [shenjtërimi përparues dhe i përjetuar]. Në të vërtetë, ajo është patjetër të dyja bashkë!).

Për mendimin tim, e gjithë Bibla, nga Zanafilla 4 deri te Zbulesa 20, tregon sesi Perëndia rimëkëmb miqësinë e Edenit. Bibla ia nis me miqësinë e Perëndisë me njerëzimin në një kontekst tokësor (shih Zanafilla 1-2) dhe e përfundon me të njëjtin kontekst (shih Zbulesa 21-22). Shëmbëllimi dhe qëllimi i Perëndisë do të rimëkëmbet!

Për të dokumentuar diskutimet e mësipërme, vini re pasazhet e mëposhtme, të përzgjedhura nga DhR, që ilustrjnë grupin e fjalëve greke.

1. Perëndia është i drejtë (shpesh lidhet me Perëndinë si Gjykatës)
 - a. Romakëve 3:26

- b. 2 Thesalonikasve 1:5-6
- c. 2 Timoteut 4:8
- d. Zbulesa 16:5
- 2. Jezusi është i drejtë
 - a. Veprat 3:14; 7:52; 22:14 (titulli i Mesisë)
 - b. Mateu 27:19
 - c. 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7
- 3. Vullneti i Perëndisë për krijimin e vet është drejtësia
 - a. Levitiku 19:2
 - b. Mateu 5:48 (shih 5:17-20)
- 4. Mënyra e Perëndisë për të siguruar dhe prodhuar drejtësinë
 - a. Romakëve 3:21-31
 - b. Romakëve 4
 - c. Romakëve 5:6-11
 - d. Galatasve 3:6-14
 - e. Jepet nga Perëndia
 - 1) Romakëve 3:24; 6:23
 - 2) 1 Korintasve 1:30
 - 3) Efesianëve 2:8-9
 - f. Merret me anë të besimit
 - 1) Romakëve 1:17; 3:22, 26; 4:3, 5, 13; 9:30; 10:4, 6, 10
 - 2) 2 Korintasve 5:7, 21
 - g. Përmes veprave të Birit
 - 1) Romakëve 5:21
 - 2) 2 Korintasve 5:21
 - 3) Filipianëve 2:6-11
- 5. Vullneti i Perëndisë është që ndjekësit e tij të jenë të drejtë
 - a. Mateu 5:3-48; 7:24-27
 - b. Romakëve 2:13; 5:1-5; 6:1-23
 - c. 1 Timoteut 6:11
 - d. 2 Timoteut 2:22; 3:16
 - e. 1 Gjonit 3:7
 - f. 1 Pjetrit 2:24
- 6. Perëndia do ta gjykojë botën me drejtësi
 - a. Veprat 17:31
 - b. 2 Timoteut 4:8

Drejtësia është karakteristikë e Perëndisë, dhe i jepet lirisht njerëzimit të mëkatshëm me anë të Krishtit.

Ajo është

1. vendim i Perëndisë
2. dhuratë e Perëndisë
3. akt i Krishtit

Por ajo është edhe proces i të bërit i drejtë; ky proces duhet ndjekur me forcë dhe këmbëngulje dhe do të përmbushet një ditë, në Ardhjen e Dytë. Bashkësia me Perëndinë rikthehet në çastin e shpëtimit, por përparon gjatë gjithë jetës dhe bëhet takim ballë përballë në çastin e vdekjes, ose në *Parousia*!

Ja një citim i duhur për ta përmbyllur këtë diskutim. Është marrë nga *Dictionary of Paul and His Letters [Fjalori i Palit dhe letrave të tij]*, nga IVP:

“Kalvini, shumë më tepër se Luteri, thekson aspektin e marrëdhënies të drejtësia e Perëndisë. Pikëpamja e Luterit për drejtësinë e Perëndisë duket se përmban aspektin e deklarimit të pafajësisë. Kalvini thekson natyrën e mrekullueshme të komunikimit ose përçimit të drejtësisë së Perëndisë të ne” (f. 834).

Për mua, marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë ka tre aspekte.

1. ungjilli është person (theksi i kishës lindore dhe Kalvinit)
2. ungjilli është e vërtetë (theksi i Augustinit dhe Luterit)

3. ungjilli është jetë e ndryshuar (theksi katolik)

Këto janë të tria të vërteta dhe duhen mbajtur të bashkuara për të patur një krishterim të shëndetshëm, të shëndoshë dhe biblik. Nëse ndonjëra prej tyre mbitheksohet ose nënvlerësohet, shfaqen probleme.

Duhet ta mirëpresim Jezusin!

Duhet t'i besojmë ungjillit!

Duhet të ndjekim ngjashmërinë me Krishtin!



NASB, NKJV “nga besimi në besim”
NRSV “nëpërmjet besimit për besim”
TEV “është nëpërmjet besimit nga fillimi deri në fund”
NJB “tregon se si besimi çon në besim”

Kjo frazë ka dy PARAFJALË, *ek* dhe *eis*, që tregojnë një tranzicion/kalim apo zhvillim. Ai e përdor po këtë strukturë të II Kor. 2:16 dhe *apo* dhe *eis* të II Kor. 3:18. Krishtërimi është një dhuratë që jepet me pritjen/dëshirën/qëllimin që të bëhet një karakteristikë dhe mënyrë jetese.

Ka disa mundësi për ta përkthyer këtë frazë. DHR Williams e përkthen si “Rruga e besimit që çon në besim më të madh.” Pikat kryesore teologjike janë

1. besimi vjen nga Perëndia (“zbulohet”)
2. njerëzimi duhet të përgjigjet dhe të vazhdojë të përgjigjet
3. besimi duhet të rezultojë në një jetë të perëndishme

Një gjë është e sigurt, “besimi” në Krishtin është kyç (krh. 5:1; Fil. 3:9). Oferta e shpëtimit nga Perëndia kushtëzohet nga një përgjigje besimi (krh. Marku 1:15; Gjoni 1:12; 3:16; Vep. 3:16 dhe 19; 20:21). Shih Temat e Veçanta në 1:5; 4:5 dhe 10:4.



NASB “Por njeriu i drejtë do të jetojë me anë të besimit”
NKJV “I drejt(ësuar)i do të jetojë me anë të besimit”
NRSV “Ai që është i drejtë do të jetojë me anë të besimit”
TEV “Ai që është vendosur në një pozicion të drejtë me Perëndinë përmes besimit do të jetojë”
NJB “Njeriu që ecën drejt gjen jetë përmes besimit”

Ky është një citim nga Hab. 2:4, por jo nga Teksti Masoretik (MT) ose nga Septuaginta (LXX). Në DHV “besimi” kishte kuptimin e zgjeruar metaforik të “besueshmërisë,” “besnikërisë,” ose “besnikërisë ndaj” (shih Temën e veçantë të 1:5). Besimi shpëtues bazohet në besnikërinë e Perëndisë (krh. 3:5,21,22,25,26). Megjithatë, besnikëria njerëzore është provë që dikush ka besuar në sigurimin e Perëndisë. I njëjti tekst i DHV citohet në Gal. 3:11 dhe Heb. 10:38. Njësisia letrare e radhës, Rom. 1:18-3:20, zbulon të kundërtën e besnikërisë ndaj Perëndisë.

Mund të jetë e dobishme të listojmë se si e kuptojnë disa komentues të sotëm pjesën e fundit të frazës.

1. Vaughan: “fillon në besim dhe përfundon në besim”
2. Hodge: “vetëm me anë të besimit”
3. Barrett: “mbi bazën e asgjëje tjetër veç besimit”
4. Knox: “besim në fillim dhe në fund”
5. Stagg: “i drejti nga besimi do të jetojë”

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:18-23

¹⁸ Sepse zemërimi i Perëndisë zbulohet nga qielli kundër të gjithë paperëndishmërisë dhe padrejtësisë së njerëzve të cilët e mbytin të vërtetën në padrejtësi,¹⁹ sepse ajo që është e njohur rreth Perëndisë është e dukshme brenda tyre; sepse Perëndia ua bëri të dukshme.²⁰ Sepse që nga krijimi i botës atributet e Tij të padukshme, fuqia e Tij e përjetshme dhe natyra e Tij hyjnore janë parë qartë, duke qenë të kuptuara përmes asaj që është bërë, kështu që ata janë pa justifikim.²¹ Sepse megjithëse e njohën Perëndinë, nuk e nderuan si Perëndi dhe as e falenderuan, por u bënë të kotë në hamendësimet e tyre dhe zemra e tyre e marrë u errësua.²² Duke e deklaruar veten të urtë, u bënë të marrë,²³ dhe e këmbyen lavdinë e Perëndisë së

paprishshëm për një imazh në formën e njeriut të prishshëm dhe të zogjve dhe të kafshëve katër-këmbëshe dhe zvarranikëve.

1:18 “sepse” Vini re numrin e herëve që *gar* (sepse) është përdorur në deklaratën tematike të vargjeve 16-17 – tre herë, dhe tani ajo prezanton pikën e parë të ungjillit nga ana e Palit (1:18-3:31), e cila kontrastohet me fuqinë e Perëndisë për shpëtimin (1:16-17).

■ **“zemërimi i Perëndisë”** Vargjet 18-23 pikturojnë botën pagane të kohës së Palit. Përshkrimi i Palit për botën pagane gjendet gjithashtu edhe në letërsinë hebreje (krh. *Urtësia e Salomonit* 13:1 e tutje dhe *Letra e Aristesit*, 134-38) dhe madje edhe në shkrimet etike greke dhe romake. E njëjta Bibël që na tregon për dashurinë e Perëndisë, na zbulon gjithashtu edhe zemërimin e Tij (krh. 23-32; 2:5,8; 3:5; 4:15; 5:9; 9:22; 12:19; 13:4-5 ayetler).

Edhe zemërimi, edhe dashuria janë terma njerëzorë që i janë aplikuar Perëndisë. Ata shprehin të vërtetën që Perëndia ka një mënyrë si do që besimtarët të përgjigjen dhe të jetojnë. Hedhja poshtë me dashje e vullnetit të Perëndisë (ungjillit të Krishtit) rezulton në pasoja edhe të kësaj kohe, si në këtë varg, edhe eskatologjike/të fundit të kohërave (krh. 2:5). Por, Perëndia nuk duhet parë si hakmarrës. Gjykimi është “puna e tij misterioze” (krh. Isa. 28:21 dhe më tej). Dashuria është karakteri i Tij, krahaso LiP 5:9 deri në 5:10; 7:9. Në Të drejtësia dhe mëshira mbizotërojnë. Megjithatë, të gjithë do t’i japin llogari Perëndisë (krh. Pred. 12:13-14; Gal. 6:7), madje edhe të krishterët (krh. 14:10-12; II Kor. 5:10).

TEMË E VEÇANTË: PERËNDIA I PËRSHKRUAR SI NJERËZOR (GJUHA ANTROPOMORFIKE)

I. Kjo lloj terminologjie është shumë e zakonshme në DhV (disa shembuj)

A. Gjymtyrë fizike

1. sy – Zan. 1:4,31; 6:8; Eks. 33:17; Num. 14:14; LiP. 11:12; Zak. 4:10
2. duar – Eks. 15:17; Num. 11:23; LiP. 2:15
3. krah – Eks. 6:6; 15:16; LiP. 4:43; 5:15
4. veshë – Num. 11:18; 1 Sam. 8:21; 2 Mbret. 19:16; Psa. 5:1; 10:17; 18:6
5. fytyrë – Eks. 33:11; Num. 6:25; LiP. 34:10; Psa. 114:7
6. gisht – Eks. 8:19; 31:18; LiP. 9:10; Psa. 8:3
7. zë – Zan. 3:8, 10; Eks. 15:26; 19:19; LiP. 26:17; 27:10
8. këmbë – Eks. 24:10; Ezek. 43:7
9. formë njerëzore – Eks. 24:9-11; Psa. 47; Isa. 6:1; Ezek. 1:26
10. engjëlli i Zotit – Zan. 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16; Eks. 3:4,13-21; 14:19; Gjyq. 2:1; 6:22-23; 13:3-22

B. Veprime fizike

1. të folurit si mekanizëm i krijimit – Zan. 1:3,6,9,11,14,20,24,26
2. ecja (pra, zhurma e ecjes) në Eden – Zan. 3:8; 18:33; Lev. 26:12; LiP. 23:14
3. mbyllja e derës së arkës së Noes – Zan. 7:16
4. nuhatja e flijimeve – Zan. 8:21; Lev. 26:31; Amosi 5:21
5. zbritja – Zan. 11:5; 18:21; Eks. 3:8; 19:11, 18, 20
6. varrosja e Moisiut – LiP. 34:6

C. Ndjenja njerëzore (disa shembuj)

1. keqardhje/pendim – Zan. 6:6,7; Eks. 32:14; Gjyq. 2:18; 1 Sam. 15:29,35; Amos 7:3,6
2. zemërim – Eks. 4:14; 15:7; Num. 11:10; 12:9; 22:22; 25:3,4; 32:10,13,14; LiP. 6:15; 7:4; 29:20
3. xhelozia – Eks. 20:5; 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15; 32:16,21; Joz. 24:19
4. neveri/pështirosje – Lev. 20:23; 26:30; LiP. 32:19

D. Terma familjarë

1. Atë
 - a. i Izraelit – Eks. 4:22; LiP. 14:1; Isa. 1:2; 63:16; 64:8; Jer. 31:9; Os. 11:1
 - b. i mbretit – 2 Sam 7:11-16; Psa. 2:7
 - c. metafora të veprimeve atërore – LiP. 1:31; 8:5; 32:6-14; Psa. 27:10; Pro. 3:12; Jer. 3:4,22; 31:20; Osea 11:1-4; Mal. 3:17
2. Prind – Osea 11:1-4

3. Nënë – Isa. 49:15; 66:9-13 (analogjia e nënës që jep gji)

4. I dashuri besnik në moshë të re – Osea 1-3

II. Arsyet për përdorimin e kësaj lloj terminologjie

A. Është e domosdoshme që Perëndia t'iu zbulohet vetë qenieve njerëzore. Vetë koncepti i përhapur i Perëndisë si mashkull është antropomorfizëm, pasi Perëndia është frymë!

B. Perëndia merr aspektet më kuptimplota të jetës njerëzore dhe i përdor për t'iu zbuluar njerëzimit (atë, nënë, prind, i dashur)

C. Ndonëse e domosdoshme, Perëndia nuk dëshiron të kufizohet nga asnjë formë fizike (shih Eksodi 20; Ligji i Përtërirë 5)

D. Antropomorfizmi më absolut është mishërimi i Jezusit! Perëndia u bë fizik, i prekshëm (shih 1 Gjonit 1:1-3). Mesazhi i Perëndisë u bë Fjala e Perëndisë (shih Gjoni 1:1-18).

■ **“zbulohet”** Ashtu si ungjilli është një e vërtetë e zbuluar (v. 17), ashtu është edhe zemërimi i Perëndisë! Asnjëri nga ata nuk është një akt i zbulimit apo logjikës njerëzore.

■ **“të cilët e mbytin të vërtetën”** Kjo i referohej hedhjes poshtë me qëllim nga ana e njerëzve, jo paditurisë (krh. vv. 21,32; Gjoni 3:17-21). Kjo frazë mund të ketë kuptimin

1. ata e dinë të vërtetën, por e hedhin poshtë atë
2. jeta e tyre tregon që e hedhin poshtë të vërtetën
3. jeta dhe/ose fjalët e tyre i bëjnë të tjerët që të mos e njohin dhe pranojnë të vërtetën

TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” NË SHKRIMET E PALIT

Përdorimi nga ana e Palit e këtij termi dhe e formave të lidhura me të vjen nga barazvlerësi i tij në DHV *emet*, që do të thotë i besueshëm ose besnik (BDB 53). Në shkrimet hebreje të periudhës ndërthiore ajo përdorej për të vërtetën në kontrast me gënjeshtrenë. Ndoshta paraleli më i afërt do të ishin Rrotullat e Detit të Vdekur “Himnet e falenderimit,” ku ajo përdoret për doktrinat e zbuluara. Anëtarët e Komunitetit Esen u bënë “dëshmitarë të së vërtetës.”

Pali e përdor këtë term si një mënyrë për t'iu referuar ungjillit të Jezu Krishtit.

1. Romakëve 1:18,25; 2:8,20; 3:7; 15:8
2. I Korintasve 13:6
3. II Korintasve 4:2; 6:7; 11:10; 13:8
4. Galatasve 2:5,14; 5:7
5. Efesianëve 1:13; 6:14
6. Kolosianëve 1:5,6
7. II Thesalonikasve 2:10,12,13
8. I Timoteut 2:4; 3:15; 4:3; 6:5
9. II Timoteut 2:15,18,25; 3:7,8; 4:4
10. Titit 1:1,14

Pali gjithashtu e përdor këtë term si një mënyrë për të shprehur faktin që po flet me saktësi.

1. Veprat 26:25
2. Romakëve 9:1
3. II Korintasve 7:14; 12:6
4. Efesianëve 4:25
5. Filipianëve 1:18
6. I Timoteut 2:7

Ai gjithashtu e përdor atë për të përshkruar motivet dhe mënyrën e tij të jetesës te I Kor. 5:8 (gjithashtu për të gjithë të krishterët) në Efe. 4:24; 5:9; Fil. 4:8. Ai ndonjëherë e përdor atë për njerëzit.

1. Perëndia, Rom. 3:4 (krh. Gjoni 3:33; 17:17)
2. Jezusi, Efe. 4:21 (në ngjashmëri me Gjoni 14:6)
3. Dëshmitarët apostolikë, Titit 1:13
4. Pali, II Kor. 6:8

Vetëm Pali e përdor formën foljore (d.m.th., *alētheuō*) në Gal. 4:16 dhe Efe. 4:15, ku ajo i referohet ungjillit.

1:19 “sepse ajo që është e njohur rreth Perëndisë është e dukshme brenda tyre; sepse Perëndia ua bëri të dukshme” Të gjithë njerëzit dinë diçka për Perëndinë nga krijimi (krh. v. 20; Jobi 12:7-10 dhe Ps. 19:1-6 përmes natyrës). Në teologji kjo quhet “zbulesa natyrore.” Ajo nuk është e plotë, por është baza për mbajtjen përgjegjës nga ana e Perëndisë të atyre që nuk janë ekspozuar kurrë ndaj “zbulesës së veçantë” të Perëndisë në Shkrimin e Shenjtë (krh. Ps. 19:7-14) ose, përfundimisht në Jezusin (krh. Kol. 1:15; 2:9).

Termi “njoh” përdoret në dy kuptime në DHR: (1) në kuptimin e tij të DHV të marrëdhënies personale të afërt (krh. Zan. 4:1; Jer. 1:5), dhe (2) në kuptimin grek të fakteve në lidhje me një temë (krh. v. 21). Ungjilli është edhe një Person për t’u mirëpritur, edhe një mesazh në lidhje me atë Person për t’u pranuar dhe besuar! Në këtë varg ai është përdorur në kuptimin e dytë.

TEMË E VEÇANTË: “NJOH” (duke përdorur kryesisht Ligjin e Përtërirë si paradigmë)

Fjala hebraisht “njoh” (BDB 393) ka shumë kuptime (fusha semantike) në formën *Qal*.

1. kuptoj të mirën dhe të keqen – Zan. 3:22; LiP. 1:39; Isa. 7:14-15; Jona 4:11
2. njoh duke kuptuar – LiP. 9:2, 3, 6; 18:21
3. njoh me anë të përvojës – LiP. 3:19; 4:35; 8:2, 3, 5; 11:2; 20:20; 31:13; Joz. 23:14
4. shqyrtoj – LiP. 4:39; 11:2; 29:16
5. njoh personalisht
 - a. një person – Zan. 29:5; Eks. 1:8; LiP. 22:2; 33:9
 - b. një perëndi – LiP. 11:28; 13:2,6,13; 28:64; 29:26; 32:17
 - c. YHWH – LiP. 4:35,39; 7:9; 29:6; Isa. 1:3; 56:10-11
 - d. Seksualisht – Zan. 4:1,17,25; 24:16; 38:26
6. Njohuri ose mjeshtëri e mësuar – Isa. 29:11, 12; Amosi 5:16
7. Të jesh i urtë – LiP. 29:4; Fja. 1:2; 4:1; Isa. 29:24
8. Njohuri e Perëndisë
 - a. nga ana e Moisiut – LiP. 34:10
 - b. nga ana e Izraelit – LiP. 31:21

1:20 Ky varg përmend tri aspekte të Perëndisë.

1. atributet/cilësitë e Tij të padukshme (karakteri i Tij, krh. Kol. 1:15; I Tim. 1:17; Heb. 11:27)
2. fuqia e Tij e përjetshme (e parë në krijim, krh. Ps. 19:1-6)
3. natyra e Tij hyjnore (e parë në veprimet dhe motivet e Tij të krijimit, krh. Zanafilla 1-2)

▣ **“sepse që nga krijimi i botës”** PARAFJALA *apo* është përdorur në një kuptim të përkohshëm. Një frazë e ngjashme gjendet te Marku 10:6; 13:19; II Pjet. 3:4, Perëndia i padukshëm tani bëhet i dukshëm në

1. krijimin fizik (ky varg)
2. Shkrimin e Shenjtë (Ps. 19, 119)
3. më së fundi në Jezusin (krh. Gjonit 14:9).

▣ **“natyra hyjnore”** Nga letërsia greke *theiotēs* mund të përkthehet “madhështi hyjnore.” Kjo shihet në mënyrën më të lartë në Jezusin. Ai mbart në mënyrë unike imazhin hyjnor (krh. II Kor. 4:4; Heb. 1:3). Ai është zbulesa e plotë e Perëndisë në formë njerëzore (Kol. 1:19; 2:9). E vërteta e mrekullueshme e ungjillit është që njerëzimi i rënë, përmes besimit në Krishtin, do të ketë ngjashmëri me Krishtin (krh. Heb. 12:10; I Gjonit 3:2). Imazhi i Perëndisë në njerëzimin (krh. Zan. 1:26-27) është rimëkëmbur (*theios*, krh. II Pjet. 1:3-4)!

▣

NASB “janë parë qartë, duke qenë të kuptuara përmes asaj që është bërë”

NKJV “shihen qartë, duke qenë të kuptuara me anë të gjërave që janë bërë”
NRSV “janë kuptuar dhe parë përmes gjërave që Ai ka bërë”
TEV “janë parë qartë; ato kuptohen në gjërat që Perëndia ka bërë”
NJB “janë parë qartë me anë të të kuptuarit me anë të mendjes të gjërave të krijuara”

Kombinimi i *noeō* (krh. Mateu 15:17) dhe *kathoraō* (të dyja PASIVE TË TASHME) nënkupton një perceptim të vërtetë/real. Perëndia ka shkruar dy libra: (1) natyrën (krh. Ps. 19:1-6) dhe (2) Shkrimin e Shenjtë (krh. Ps. 19:7-14). Të dy ata janë të kuptueshëm për njerëzit dhe kërkojnë një përgjigje (krh. *Urtësia* 13:1-9).

▣ **“kështu që ata janë pa justifikim.”** Kjo është fjalë për fjalë “asnjë mbrojtje ligjore.” Ky term grek (*a plus apologetomai*) përdoret vetëm këtu dhe në 2:1 në DHR. Mbani mend se qëllimi teologjik i 1:18-3:20 është të tregojë gjendjen e humbur shpirtërore të të gjithë njerëzimit. Njerëzit janë përgjegjës për atë njohuri që kanë. Perëndia i mban përgjegjës njerëzit vetëm për atë që ata dinë ose mund të dinë (krh. 4:15; 5:13).

1:21 “sepse megjithëse e njohën Perëndinë” Njerëzit nuk po përparojnë nga ana fetare – ata po bëhen gjithnjë e më të këqij. Që nga Zanafilla 3 njerëzimi ka marrë të tatëpjetën. Errësira po shtohet!

▣ **“ata nuk e nderuan Atë si Perëndi, dhe as e falenderuan”** Kjo është tragjedia e idhujtarisë pagane në vv. 23, 24 (krh. Jer. 2:9-13). Besimtarët “e përlëvdojnë” Perëndinë duke jetuar në ngjashmëri me Krishtin (krh. Mat. 5:16; Rom. 12:1-2; I Kor. 6:20; 10:31; Fil. 1:20; I Pjet. 4:11). YHWH do një popull që reflekton/zbulon karakterin e Tij ndaj një bote të rënë e të verbër!

▣ **“por ata u bënë të kotë në hamendësimet e tyre dhe zemra e tyre të marrë u errësua.”** *The New Testament: A New Translation* nga Olaf M. Morlie e ka “në vend të kësaj ata e zunë veten me hamendësime qesharake në lidhje me Të dhe mendjet e tyre budallaqe kërkonin me tahmin në errësirë.” Sistemet fetare njerëzore janë monumente të rebelimit dhe krenarisë shpirtërore (krh. v. 22; Kol. 2:16-23).

Fjala e përkthyer “të kotë” përdoret në LXX për t’iu referuar idhujve të “kotë,” “jo-ekzistues” të fqinjëve të Izraelit. Pali ishte një mendimtar hebre që e njëjtte Septuagintën. Përdorimi i fjalëve greke në LXX është një udhërrëfyes më i mirë për te mendimet e autorëve të DHR sesa fjalorët e greqishtes.

Të dyja foljet janë DËFTORE PËSORE AORISTE. A nënkupton DIATEZA PËSORE që mungesa e të kuptuarit dhe e përgjigjes së duhur nga ana e tyre ishte për shkak se Perëndia i mbuloi me vel zemrat e tyre, apo që refuzimi i dritës nga ana e tyre ua kishte ngurtësuar zemrat (krh. 10:12-16; II Mbret. 17:15; Jer 2:5; Efe. 4:17-19)? Kjo është e njëjta pyetje teologjike e lidhur me Faraonin tek Eksodi.

Perëndia ia ngurtësoi zemrën

Eksodi 4:21
 9:12
 10:20
 11:10
 14:4
 14:8
 14:17

Faraoni e ngurtësoi zemrën

Eksodi 8:15
 8:32
 9:34

Në 9:35 ngurtësimi mund t’i referohet ose Perëndisë, ose Faraonit. Ky është misteri i sovranitetit hyjnor dhe vullnetit të lirë njerëzor!

▣ **“zemra”** Kjo përdoret në kuptimin e DHV i cili shpreh tërësinë e personit. Megjithatë, shpesh ishte një mënyrë për t’iu referuar procesit të të menduarit dhe të të ndjerit. Shih Temën e Veçantë te 1:24.

1:22

NASB, NKJV “Duke shpallur se ishin të urtë, u bënë të marrë.”
NRSV “Duke pretenduar se ishin të urtë, u bënë të marrë”
TEV “Ata thonë se janë të urtë, por janë të marrë”
NJB “Sa më shumë e quajtën veten filozofë, aq më budallenj u bënë”

Nga fjala greke për “budalla” rrjedh fjala angleze “moron.” Problemi është në krenarinë e njerëzimit dhe në vetëbesimin në njohuritë e tyre (krh. I Kor. 1:18-31; Kol. 2:8-23). Kjo filloi që te Zan. Njohuria solli ndarje dhe gjykim. Nuk është puna që njohuria njerëzore është gjithnjë e gabuar, por thjesht ajo nuk është përfundimtarja!

1:23 Njerëzit, me dashje të paditur, që ishin krijuar në imazhin e Perëndisë (krh. Zan. 1:26-27; 5:1,3; 9:6) e kthyen Perëndinë në imazhe tokësore si

1. kafshë (Egjipti)
2. forcat e natyrës (Persia)
3. forma njerëzore (Greqia/ Roma)—idhuj! Madje edhe vetë njerëzit e Perëndisë e bënë këtë (krh. LiP 4:15-24).

Disa forma të reja të këtij mëkati të vjetër janë

1. ambientalizmi (Nëna Tokë)
2. mendimi lindor i Epokës së Re (misticizmi, spiritualizmi dhe okulti)
3. humanizmi ateist (Marksizmi, utopizmi, idealizmi progresiv dhe besimi përfundimtar në politikë ose arsim)
4. mjekësia holistike (shëndeti dhe jetëgjatësia)
5. arsimimi.

■ “lavdinë” Shih TEMË E VEÇANTË te 3:23.

■ “njeriut të prishshëm” Shih TEMË E VEÇANTË më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SHKATËRROJ, SHKRETOJ, KORRUPTOJ (*PHTHEIRŌ*)

Kuptimi themelor i këtij temi *Phtheirō* është shkatërroj, shkrettoj, korruptoj ose prish. Ai mund të përdoret për

1. shkatërrimin financiar (II Kor. 7:2 ndoshta)
2. shkatërrimin fizik (krh. I Kor. 3:17a)
3. korrupsionin moral (krh. Rom. 1:23; 8:21; I Kor. 15:33,42,50; Gal. 6:8; Zbu. 19:2)
4. joshjen seksuale (krh. II Kor. 11:3)
5. shkatërrimin e përjetshëm (krh. II Pjet. 2:12,19)
6. traditat në zhdukje të njerëzve (krh. Kol. 2:22; I Kor. 3:17b)

Shpesh ky term përdoret në të njëjtin kontekst si i kundërti i tij (krh. Rom. 1:23; I Kor. 9:25; 15:50,53). Vini re kontrastet paralele midis trupave tanë tokësore fizikë dhe trupave tanë qiellorë të përjetshëm.

1. i prishshëm dhe i paprishshëm, I Kor. 15:42,50
2. çnderim dhe lavdi, I Kor. 15:43
3. dobësi dhe fuqi, I Kor. 15:43
4. trup natyror dhe trup frymëror, I Kor. 15:44
5. Adami i parë dhe Adami i fundit, I Kor. 15:45
6. imazhi i tokësorit dhe imazhi i qiellorit, I Kor. 15:49

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:24-25

²⁴Prandaj Perëndia i dorëzoi në epshet e zemrave të tyre për papastërti, në mënyrë që trupat e tyre të çnderoheshin midis tyre. ²⁵Sepse ata e këmbyen të vërtetën e Perëndisë për një gënjeshtër, dhe adhuruan dhe i shërbyen krijesës në vend të Krijesit, që është i bekuar përjetë. Amen.

1:24, 26, 28 “Perëndia i dorëzoi” Ky është gjykimi më i keq i mundshëm. Është sikur Perëndia të thotë “le të bëjë si të dojë njerëzimi i rënë” (krh. Ps. 81:12; Osea 4:17; Vep. 7:42 citon disa tekste të DHV mbi këtë çështje teologjike). Vargjet 23-32 përshkruajnë hedhjen poshtë (zemërimin e përkohshëm) nga Perëndia të botës pagane dhe fetarizmit të tyre (dhe tonit)! Paganizmi ka qenë dhe është i karakterizuar nga perversioni dhe shfrytëzimi seksual!

TEMË E VEÇANTË: ZEMRA

Fjala greke *kardia* përdoret në Septuagintë dhe në DhR për të pasqyruar fjalën hebraisht *lēb* (BDB 523). Ajo përdoret në disa mënyra (shih Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon [Leksik greqisht-anglisht]*, f. 403-404).

1. qendra e jetës fizike, një metaforë për individin (shih Veprat 14:17; 2 Kor. 3:2-3; Jakobi 5:5)
2. qendra e jetës shpirtërore (pra, morale)
 - a. Perëndia njih zemrën (shih Luka 16:15; Rom. 8:27; 1 Kor. 14:25; 1 Thes. 2:4; Zbu. 2:23)
 - b. përdoret për jetën shpirtërore të njerëzimit (shih Mat. 15:18-19; 18:35; Rom. 6:17; 1 Tim. 1:5; 2 Tim. 2:22; 1 Pjet. 1:22)
3. qendra e jetës mendore (pra, intelekti, shih Mat. 13:15; 24:48; Veprat 7:23; 16:14; 28:27; Rom. 1:21; 10:6; 16:18; 2 Kor. 4:6; Efe. 1:18; 4:18; Jakobi 1:26; 2 Pjet. 1:19; Zub. 18:7; zemra është sinonime me mendjen te 2 Kor. 3:14-15 dhe Fil. 4:7)
4. qendra e vullnetit (shih Veprat 5:4; 11:23; 1 Kor. 4:5; 7:37; 2 Kor. 9:7)
5. qendra e ndjenjave (shih Mat. 5:28; Veprat 2:26,37; 7:54; 21:13; Rom. 1:24; 2 Kor. 2:4; 7:3; Efe. 6:22; Fil. 1:7)
6. vendi unik i veprimtarisë së Frymës (shih Rom. 5:5; 2 Kor. 1:22; Gal. 4:6 [pra, Krishti në zemrat tona, Efe. 3:17])
7. Zemra është mënyrë metaforike për të nënkuptuar gjithë njeriun (shih Mat. 22:37, që citon LiP. 6:5). Mendimet, qëllimet dhe veprimet që i atribuohen zemrës zbulojnë llojin e individit. DhV ka disa përdorime goditëse të këtyre termave
 - a. Zan. 6:6; 8:21, “Perëndia u trishtua në zemër”, shih dhe Osea 11:8-9
 - b. LiP. 4:29; 6:5, “me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”
 - c. LiP. 10:16, “zemër e parrethprerë” dhe Rom. 2:29
 - d. Ezek. 18:31-32, “një zemër të re”
 - e. Ezek. 36:26, “një zemër të re” në dallim nga “një zemër guri”

1:25 “e këmbyen të vërtetën e Perëndisë për një gënjeshtër” Kjo mund të kuptohet në disa mënyra.

1. vetë-hyjnizimi i njerëzimit (krh. II Thes. 2:4,11);
2. adhurimi nga ana e njerëzimit e asaj që ai vetë ka bërë - idhujve (krh. Isa. 44:20; Jer. 13:25; 16:19) në vend të YHWH që krijoi të gjitha gjërat (krh. vv. 18-23)
3. hedhja poshtë përfundimisht nga ana e njerëzimit e të vërtetës së ungjillit (krh. Gjoni 14:17; I Gjonit 2:21,27).

Në kontekst numri 2 përputhet më mirë.

▣ “adhuruan dhe i shërbyen” Njerëzimi do të ketë gjithmonë perëndi. Të gjithë njerëzit e ndiejnë që ekziston dikush, një e vërtetë ose diçka përtej vetes së tyre.

▣ “që është i bekuar përjetë. Amen” Pali shpërtheu në një bekim hebre, i cili është kqa karakteristik për të (krh. Rom. 9:5; II Kor. 11:31). Pali lutet shpesh ndërsa shkruan (krh. 9:5; 11:36; 15:33; 16:27).

▣ “përjetë” Shih TEMË E VEÇANTË më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: PËRJETË (IDIOMË GREKE)

Një frazë idiomatike greke është “në epoka” (krh. Luka 1:33; Rom. 1:25; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; I Tim. 1:17), e cila mund të reflektojë shprehjen hebraike *’olam*. Shih Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament*, faqet 319-321 dhe Temën e Veçantë të DHV: Përgjithmonë (*’Olam*). Të tjera fraza të lidhura me të janë “në epokë” (krh. Mateu 21:19 [Marku 11:14]; Luka. 1:55; Gjoni 6:58; 8:35; 12:34; 13:8; 14:16; II Kor. 9:9) dhe “i epokës së epokave” (krh. Efe. 3:21). Duket sikur nuk ka dallim midis këtyre idiomave në greqisht për “përgjithmonë.” Termi “epoka” mund të jetë shumë në një kuptim figurativ të konstruksionit gramatikor rabinik të quajtur “shumësi i madhërisë” ose ai mund t’i referohet konceptit të disa “epokave” në kuptimin hebraik të “epokës së ligësisë.”

- “Amen” Shih TEMË E VEÇANTË më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: AMEN

I. DHIATA E VJETËR

A. Termi “Amen” vjen nga një fjalë hebraike që do të thotë

1. “e vërtetë” (*emeth*, BDB 49)
2. “vërtetësi” (*emun, emunah*, BDB 53)
3. “besim” ose “besnikëri”
4. “besim te dikush” (*dmn*, BDB 52)

B. Etimologjia e saj vjen nga qëndrimi fizik i qëndrueshëm i dikujt. E kundërta do të ishte një njeri që është i paqëndrueshëm, që rrëshqet (shih Psalmi 40:2; 73:18; Jeremia 23:12), ose që pengohet (shih Psa. 73:2). Nga ky përdorim i fjalëpërfjalshëm u zhvillua zgjerimi metaforik i kuptimit “besnik, i besueshëm, i besës dhe me integritet” (shih Zan. 15:6; Hab. 2:4).

C. Përdorimet e veçanta

1. Shtyllë, 2 Mbret. 18:16 (1 Tim. 3:15)
2. Siguri, Eks. 17:12
3. Palëvizshmëri, Eks. 17:12
4. Qëndrueshmëri, Isa. 33:6
5. I vërtetë, 1 Mbret. 10:6; 17:24; 22:16; Fja. 12:22
6. I patundur, 2 Kro. 20:20; Isa. 7:9
7. I besueshëm (Torahu), Psa. 119:43, 142, 151, 160

D. Në DhR përdoren dhe ty fjalë të tjera hebraisht për besimin veprues.

1. *bathahc* (BDB, 105), besim
2. *yra* (BDB 431), frikë, respekt, adhurim (shih Zan. 22:12)

E. Nga kuptimi i besimit ose besueshmërisë u zhvillua dhe një përdorim liturgjik që u përdor për të mbështetur një pohim besnik ose të vërtetë të një tjetri (shih LiP. 27:15-26; Neh. 8:6; Psa. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48).

F. Çelësi teologjik për këtë term nuk është besnikëria e njerëzimit, por ajo e YHWH-së (shih Eks. 34:6; LiP. 32:4; Psa. 108:4; 115:1; 117:2; 138:2). Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është besnikëria besnike dhe e mëshirshme e YHWH-së ndaj besëlidhjes dhe premtimet e tij. Ata që njohin YHWH-në duhet të jenë si ai (shih Hab. 2:4). Bibla është historia që dokumenton ripërtëritjen që i bën Perëndia shëmbëllimit të vet (shih Zan. 1:26-27) në njerëzimin. Shpëtimi i rikthen njerëzimit aftësinë për të patur bashkësi të ngushtë me Perëndinë. Kjo është arsyeja pse jemi krijuar.

II. DHIATA E RE

A. Përdorimi i fjalës “amen” si pohim përmbyllës liturgjik i besueshmërisë së një pohimi të caktuar është i zakonshëm në DhR (shih 1 Kor. 14:16; 2 Kor. 1:20; Zbu. 1:7; 5:14; 7:12).

B. Përdorimi i këtij termi në përmbyllje të lutjeve është i zakonshëm në DhR (shih Rom. 1:25; 9:5; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; 6:18; Efe. 3:21; Fil. 4:20; 2 Thes. 3:18; 1 Tim. 1:17; 6:16; 2 Tim. 4:18).

C. Jezusi është i vetmi që përdori këtë term (shpesh, i dyfishuar te Gjoni) për të prezantuar pohime të rëndësishme (shih Luka 4:24; 12:37; 18:17, 29; 21:32; 23:43)

D. Përdoret si titull për Jezusin te Zbu. 3:14 (ndoshta, titull i YHWH-së nga Isa. 65:16).

E. Koncepti i besueshmërisë, besimit, besnikërisë, ose besimit në dikë shprehet me termin greqisht *pistos* ose *pistis*, që në anglisht përkthehet “besim te dikush”, “besim në dikë”, “besoj”.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:26-27

²⁶Për këtë arsye Perëndia i dorëzoi në pasione degraduese; sepse gratë e tyre e ndërruan funksionin e natyrshëm për atë që është i panatyrshëm, ²⁷në të njëjtën mënyrë gjithashtu burrat e lanë funksionin natyral të gruas dhe u dogjën në dëshirën e tyre kundrejt njëri-tjetrit, burra me burra duke kryer akte të

1:26,27 Homoseksualiteti është një shembull i jetës veçan vullnetit të qartë të Perëndisë në krijim (jini të frytshëm). Ishte mëkat dhe një problem i madh kulturor

1. Në DHV (krh. Lev. 18:22; 20:13; LiP 23:18)
2. në botën greko-romake (krh. I Kor. 6:9; I Tim. 1:10)
3. në kohën tonë

Homoseksualiteti listohet ndoshta si një shembull i jetës së rënë për shkak të orientimit të gjithë kontekstit ndaj Zanafillës 1-3. Njerëzimi u krijua në imazhin e Perëndisë (krh. Zan. 1:26-27; 5:1,3; 9:6). Njerëzimi u krijua mashkull e femër (krh. Zan. 1:27). Urdhri i Perëndisë ishte të ishin të frytshëm e të shumëzoheshin (krh. Zan. 1:28; 9:1,7). Rënia e njerëzimit (krh. Zan. 3) e shkeli planin dhe vullnetin e Perëndisë. Homoseksualiteti është një shkelje e qartë! Megjithatë duhet thënë që ky nuk është i vetmi mëkat i përmendur në këtë kontekst (krh. vv. 29-31). Të gjithë mëkatet tregojnë ndarjen e njerëzimit nga Perëndia dhe ndëshkimin e tij të merituar. Çdo mëkat, sidomos mëkati si stil jetese, është i neveritshëm për Perëndinë.

TEMË E VEÇANTË: HOMOSEKSUALITETI

Ka shumë presion kulturor për ta pranuar homoseksualitetin si një mënyrë jetese të përshtatshme alternative. Bibla e dënon atë si një mënyrë jetese shkatërruese, jashtë vullnetit të Perëndisë për krijimin e Tij.

1. ai shkel urdhrin e Perëndisë të Zan. 1 për të qenë të frytshëm dhe për t'u shumëzuar
2. ai karakterizon adhurimin dhe kulturën pagane (krh. Lev. 18:22; 20:13; Rom. 1:26-27; dhe Juda 7)
3. ai zbulon një pavarësi nga Perëndia që ka në qendër veten (krh. I Kor. 6:9-10)

Megjithatë, para se ta lë këtë temë, le të pohoj dashurinë dhe faljen e Perëndisë ndaj të gjitha qenieve të rëna njerëzore. Të krishterët nuk kanë të drejtë të veprojnë me urrejtje dhe arrogancë ndaj këtij mëkati të veçantë, sidomos kur është e qartë që të gjithë ne mëkatojmë. Lutja, kujdesja, dëshmia dhe dhembshuria bëjnë shumë më tepër në këtë fushë sesa dënimi i ashpër. Fjala e Perëndisë dhe Fryma e Tij do ta bëjnë vetë dënimin nëse i lejojmë. Të gjitha mëkatet seksuale, jo vetëm ky, janë neveri për Perëndinë dhe të çojnë në gjykim. Seksualiteti është një dhuratë nga Perëndia për mirë-qenien dhe gëzimin e njerëzimit dhe për një shoqëri të qëndrueshme. Por kjo shtysë e fuqishme, e dhënë nga Perëndia shpesh kthehet në një mënyrë jetese rebele, egocentrike, kënaqësi-kërkuese me moton, “më shumë për mua me çdo çmim” (krh. Rom. 8:1-8; Gal. 6:7-8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 1:28-32

²⁸Dhe meqenëse nuk e gjetën me vend ta respektonin më Perëndinë, Perëndia i dorëzoi në një mendje të çoroditur, për të bërë ato gjëra që nuk janë të përshtatshme, ²⁹duke qenë të mbushur me çdo padrejtësi, ligësi, lakmi, të keqe; plot zili, vrasje, grindje, mashtrim, keqdashje; *ata janë thashethemxhinj,* ³⁰shpifës, urrejtës të Perëndisë, të pasjellshëm, arrogantë, mburravecë, sajues ligësish, të pabindur ndaj prindërve, ³¹pa gjykim, të pabesë, pa dashuri, të pamëshirshëm; ³²dhe megjithëse e dinë dekretin e Perëndisë, që ata që i bëjnë gjëra të tilla meritojnë vdekjen, jo vetëm që i bëjnë ato, por miratojnë me gjithë zemër ata që i bëjnë.

1:28-31 Kjo është një fjali në greqisht. Ajo karakterizon njerëzimin rebel, të rënë dhe të pavarur (krh. Rom. 13:13; I Kor. 5:11; 6:9; Gal. 5:19-21; Efe. 5:5; I Tim. 1:10; Zbu. 21:8).

Mëkati i njerëzimit ishte që ata zgjodhën ekzistencën të ndarë nga Perëndia. Ferri është ajo ekzistencë e bërë e përhershme. Pavarësia është tragjedi! Njerëzimi ka nevojë për Perëndinë; ai është i humbur, i pamjaftueshëm dhe i papërbushur pa Të. Aspekti më i keq i një ferri të përjetshëm është mungesa marrëdhënore e Perëndisë!

1:29 “një mendje të çoroditur” Ajo që njerëzimi e sheh si liri është vetë-adhurim: “Çdo gjë për mua!” Agjenti i FORMËS JOVEPRORE deklarohet si Perëndia në 1:24,26,28, por në marrëdhënien e këtij konteksti me Zanafillën 1-3 është zgjedhja e njerëzimit e njohurisë dhe vetes ajo që shkaktoi problemin. Perëndia i lejoi krijesat e Tij të vuanin pasojat e zgjedhjeve të tyre, e pavarësisë së tyre.

■ **“duke qenë të mbushur me”** Kjo është një PËRCJELLORE E KRYER JOVEPRORE. Njerëzit janë të mbushur e të karakterizuar nga ajo në të cilën ata banojnë. Rabinët thoshin se në çdo zemër njerëzore është një qen i zi (*yetzer* i keq) dhe një qen i bardhë (*yetzer* i mirë). Atë që ushqejmë më shumë, ai bëhet më i madh.

1:29-31 Këto janë rezultatet dhe simptomat e jetës pa Perëndinë. Ato karakterizojnë individë dhe shoqëri të cilat zgjedhin ta hedhin poshtë Perëndinë e Biblës. Kjo ishte një nga disa listat e mëkateve që Pali dha (krh. I Kor. 5:11; 6:9; II Kor. 12:20; Gal. 5:19-21; Efe. 4:31; 5:3-4; Kol. 3:5-9).

TEMË E VEÇANTË: VESET DHE VIRTYTET NË DHR

Lista me vese dhe virtyte janë të zakonshme në DHR. Shpesh ato reflektojnë edhe lista rabinike, edhe kulturore (helenistike). Listat e DHR të karakteristikave kontrastuese mund të shihen te:

	<u>Vese</u>	<u>Virtyte</u>
1. Pali	Rom. 1:28-32	--
	Rom. 13:13	Rom. 12:9-21
	I Kor. 5:9-11	--
	I Kor. 6:10	I Kor. 6:6-9
	II Kor. 12:20	II Kor. 6:4-10
	Gal. 5:19-21	Gal. 5:22-23
	Efe. 4:25-32	--
	Efe. 5:3-5	--
	--	Fil. 4:8-9
	Kol. 3:5,8	Kol. 3:12-14
	I Tim. 1:9-10	--
	I Tim. 6:4-5	--
	II Tim. 2:22a,23	II Tim. 2:22b,24
Titit 1:7, 3:3	Titit 1:8-9; 3:1-2	
2. Jakobi	Jakobi 3:15-16	Jakobi 3:17-18
3. Pjetri	I Pjet. 4:3	I Pjet. 4:7-11
	II Pjet. 1:9	II Pjet. 1:5-8
4. Gjoni	Zbu. 21:8; 22:15	--

1:30 “arrogantë” Kjo është *huperēfanous* (shih C., më poshtë).

TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI NGA PALI I FJALËVE TË PËRBËRA ME “HUPER”

Pali kishte një prije të veçantë për të krijuar fjalë të reja duke përdorur PARAFJALËN greke *huper*, e cila pak a shumë do të thotë “mbi” ose “i sipërm.” Kur përdoret me rasën GJINORE (RRJEDHORE) ka kuptimin “në emër të.” Ajo mund të ketë kuptimin “rreth” ose “në lidhje me,” si *peri* (krh. II Kor. 8:23; II Thes. 2:1). Kur përdoret me KALLËZOREN ka kuptimin “mbi,” “sipër,” ose “përtej” (krh. A. T. Robertson, *A Grammar of the Greek New Testament in the Light of Historical Research*, fq. 625-633). Kur Pali donte të theksonte një koncept, ai e përdorte këtë PARAFJALË në një fjalë të përbërë. Më poshtë është një listë me përdorimin e veçantë nga Pali të kësaj PARAFJALE në fjalë të përbëra.

A. *apax legomenon* (përdorur vetëm një herë në DHR)

1. *Huperakmos*, dikush që e ka kaluar lulen e jetës, I Kor. 7:36
2. *Huperauxanō*, të shtosh shumë, II Thes. 1:3
3. *Huperbainō*, të tejkalosh ose të shkelësh, I Thes. 4:6
4. *Huperkeina*, përtej, II Kor. 10:16
5. *Huperekteina*, shtrihet përtej, II Kor. 10:14
6. *Huperentugchanō*, të ndërhysh, Rom. 8:26
7. *Hupernikaō*, të jesh fitimtar me bollëk, Rom. 8:37
8. *Huperpleonazō*, të kesh bollëk me tepri, I Tim. 1:14
9. *Huperupsoō*, të lartësosh mbi gjithçka, Fil. 2:9
10. *Huperphroneō*, të kesh mendime të larta, Rom. 12:3

B. Fjalë të përdorura vetëm në shkrimet e Palit.

1. *Huperairomai*, të lartësosh veten, II Kor. 12:7; II Thes. 2:4
2. *Huperballontōs*, mbi masën, me tepri, II Kor. 11:23; (NDAJFOLJE vetëm këtu, por FOLJE në II Kor. 3:10; 9:14; Efe. 1:19; 2:7; 3:19)
3. *Huperbolē*, shtënie me tepri, armatosje e jashtëzakonshme, Rom. 7:13; I Kor. 12:31; II Kor. 1:8; 4:7,17; 22:7; Gal. 1:13
4. *Huperekperissou*, përtej çdo lloj mase, Efe. 3:20; I Thes. 3:10; 5:13
5. *Huperlian*, në shkallën më të lartë ose mbizotëruese, II Kor. 11:5; 12:11
6. *Huperochē*, mbidallim, shkëlqyeshmëri, I Kor. 2:1; I Tim. 2:2
7. *Huperperisseuō*, të teprosh me bollëk, Rom. 5:20 (DIATEZA JOVEPRORE, të jesh i mbushur me bollëk, të derdesh me tepri, II Kor. 7:4)

C. Fjalë të përdorura nga Pali dhe rrallë në shkrimtarë të tjerë të DHR

1. *Huperanō*, shumë lart, Efe. 1:21; 4:10; dhe Heb. 9:5)
2. *Huperehō*, shkëlqyeshmëri, mbidallueshmëri, Rom. 13:1; Fil. 2:3; 3:8; 4:7; I Pjet. 2:13
3. *Huperēphanos*, krenar ose fodull, Rom. 1:30; II Tim. 3:2 dhe Luka 1:51; Jakobi 4:6; I Pjet. 5:5.

Pali ishte një njeri i karakterizuar nga pasion i madh; kur gjërat ose njerëzit ishin mirë, ata ishin shumë mirë dhe kur ishin keq, ata ishin shumë keq. Kjo PARAFJALË e lejonte atë të shprehte ndjenjat e tij sipërore në lidhje me mëkatën, veten dhe Krishtin e Ungjillin.

1:32 “ata që i praktikojnë gjëra të tilla meritojnë vdekjen” Kjo deklaratë reflekton ligjin e Moisiut. Ajo është përmbledhur në Rom. 6:16,21,23; 8:6,13. Vdekja është e kundërta e vullnetit të Perëndisë dhe jetës së Perëndisë (krh. Ezekieli 18:32; I Tim. 2:4; II Pjet. 3:9).

■ **“por miratojnë me gjithë zemër ata që i bëjnë”** Mjerimit i pëlqen shoqëria. Njerëzimi i rënë i përdor mëkatet e të tjerëve si një justifikim, “të gjithë e bëjnë këtë.” Kulturat karakterizohen nga mëkatet e tyre specifike!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

Pse i shkroi Pali kishës në Romë?

Pse është Romakëve një deklaratë kaq e rëndësishme teologjike e krishtëritimit?

Përvijoni me fjalët tuaja 1:18-3:20.

A do të refuzohen ata që nuk e kanë dëgjuar kurrë ungjillin, sepse nuk i besojnë Krishtit?

Shpjegoni ndryshimin midis “zbulesës natyrore” dhe “zbulesës së veçantë.”

Përshkruani jetën njerëzore pa Perëndinë.

A i adresohen vargjet 24-27 çështjes së homoseksualitetit?

ROMAKËVE 2

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Gjykimi i drejtë i Perëndisë	Gjykimi i drejtë i Perëndisë	Hebrenjtë nën gjykim	Gjykimi i Perëndisë	Hebrenjtë nuk përjashtohen nga hakmarrja e Perëndisë
2:1-16	2:1-16	2:1-11	2:1-16	2:1-11
Hebrenjtë dhe Ligji	Hebrenjtë fajtorë si edhe Johebrenjtë	Baza për gjykim	Hebrenjtë dhe Ligji (2:17-3:8)	Ligji nuk do t'i shpëtojë
2:17-3:8	2:17-24	2:12-16 2:17-24	2:17-24	2:112-16 2:17-24
	Rrethprerja nuk vlen			Rrethprerja nuk do t'i shpëtojë
	2:25-29	2:25-29	2:25-29	2:25-29

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE MBI ROMAKËVE 2:1-3:20

- A. Kapitujt 2 dhe 3 plotësojnë njësinë letrare të nisur në 1:18. Ky seksion trajton:
 1. gjendjen e humbur të njerëzimit
 2. gjykimin e Perëndisë mbi mëkat
 3. nevojën e njerëzimit për drejtësinë e Perëndisë përmes Krishtit me anë të besimit dhe pendimit personal
- B. Në kapitullin 2 ka shtatë parime në lidhje me gjykimin e Perëndisë
 1. vargu 2, sipas të vërtetës
 2. vargu 5, faji i grumbulluar
 3. vargjet 6 dhe 7, sipas veprave
 4. vargu 11, pa anësi
 5. vargu 13, mënyra e jetesës
 6. vargu 16, të fshehtat e zemrave të njerëzve

7. vargjet 17-29, pa favorizuar ndonjë grup etnik

C. Ka shumë diskutime midis komentuesve në lidhje me kujt i adresohet kapitulli 2:1-17. Është e qartë që 2:12-29 flet për hebrejtë. Vargjet 1-17 i shërbejnë një qëllimi të dyfishtë duke u folur edhe paganëve të moralshëm si Seneka (normat shoqërore), edhe kombit hebre (Ligji i Moisiut).

D. Në 1:18-21, Pali pohoi se njerëzit mund ta njohin Perëndinë përmes krijimit. Në 2:14-15, Pali pohoi gjithashtu se të gjithë njerëzit kanë një ndërgjegjie të brendshme morale të dhënë nga Perëndia. Këta dy dëshmitarë, krijimi dhe ndërgjegjia, janë baza për dënimin nga ana e Perëndisë të të gjithë njerëzimit, edhe të atyre që nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj DHV ose mesazhit të ungjillit. Njerëzit janë përgjegjës sepse ata nuk kanë jetuar sipas dritës që kanë patur.

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:1-11

¹Prandaj ti nuk ke asnjë justifikim, kushdo nga ju që gjykon, sepse në atë që gjykon një tjetër, ti dënon veten; sepse ti që gjykon praktikon të njëjtat gjëra. ²Dhe ne e dimë se gjykimi i Perëndisë bie me të drejtë mbi ata që praktikojnë të tilla gjëra. ³Por a mendon këtë, o njeri, kur gjykon ata që i praktikojnë të tilla gjëra dhe i bën vetë po ato gjëra, që do t'i shpëtosh gjykimit të Perëndisë? ⁴Apo i merr lehtë pasuritë e mirësisë dhe durimit dhe zemërgjerësisë së Tij, duke mos e ditur që mirësia e Perëndisë të prin në pendim? ⁵Por për shkak të kokëfortësisë tënde dhe zemrës së papenduar ti po grumbullon zemërim për vete në ditën e zemërimit dhe të zbulësës së gjykimit të drejtë të Perëndisë, ⁶i Cili DO T'I JAPË SECILIT SIPAS VEPRAVE TË TIJ: ⁷atyre që duke këmbëngulur në bërjen e së mirës kërkojnë lavdi dhe nder dhe pavdekësi, jetë të përjetshme; ⁸por atyre që janë ambiciozë egoistë dhe nuk i binden të vërtetës, por i binden padrejtësisë, zemërim dhe indinjatë. ⁹Do të ketë mundim dhe ankth për çdo shpirt njeriu që bën të keqen, më parë të hebreat dhe gjithashtu edhe të grekut, ¹⁰por lavdi dhe nder dhe paqe për këdo që bën të mirën, hebreat më parë dhe gjithashtu edhe grekut. ¹¹Sepse tek Perëndia nuk ka anësi.

2:1

NASB	“ti nuk ke justifikim, kushdo nga ju që gjykon”
NKJV	“ti je i pajustificueshëm, o njeri, kushdo që je që gjykon”
NRSV	“ti nuk ke justifikim, kushdo të jesh, kur gjykon të tjerët”
TEV	“Ti nuk ke asnjë justifikim, kushdo të jesh. Sepse atëherë ti gjykon të tjerët”
NJB	“Prandaj kushdo të jesh, nëse gjykon, nuk ke justifikim”

Kjo fjalë për fjalë është “asnjë mbrojtje gjyqësore” (krh. 1:20). U vendos e para në fjalinë greke për të zmadhuar domethënien e saj. Vargjet 1-16 duket se lidhen edhe me legalistët e vetëdrejtë hebrej, edhe me moralistët grekë. Duke gjykuar të tjerët, ata dënojnë vetveten.

E njëjta frazë përdoret në 1:20, por PËREMRI është “ata”; këtu është “ti.” Me sa duket Pali u adresohet grupimeve të ndryshme të mëkatarëve/rebelëve. Në njërin nga grupet ai ishte dikur një anëtar i zellshëm! Ka dy probleme.

1. hedhja poshtë dhe shtrembërimi i njohjes së Perëndisë
2. kthimi i saj në një grup rregullash dhe bërja gjykues dhe i vetëdrejtë

Gjithashtu vini re që “ata” të kapitullit 1 bëhen “ti” në 2:1-8. Ajo universalizohet nga hebrejtë dhe grekët, në “çdo shpirt njeriu” në 2:9-11. Megjithëse ka grupe të ndryshme (ose dy, ose tre grupe) në fund kjo nuk përbën ndonjë ndryshim, të gjithë janë nën gjykim (krh. 3:23).

2:2 “ne e dimë” Ky PËREMËR ndoshta u referohej hebrejve të tjerë, megjithëse ka mundësi t’iu referohet të krishterëve. Në vargjet 2-4, Pali i kthehet teknikës së tij të zakonshme të formatit pyetje-përgjigje, që quhet diatrib (p.sh. vargjet 1-11, 17-29), që ishte një paraqitje e së vërtetës me anë të një kundërshtuesi të supozuar. Ajo është përdorur edhe nga Habakuku, Malakia dhe rabinët, si edhe nga filozofët grekë (si Sokrati dhe Stoikët).

Fraza “ne e dimë se” përdoret disa herë në Romakëve (krh. 2:2; 3:19; 7:14;8:22,28). Pali supozon që dëgjuesit e tij kanë një farë shkalle njohjeje, ndryshe nga paganët imoralë të kapitullit 1.

■ **“gjykimi i Perëndisë”** Bibla është e qartë mbi këtë të vërtetë. Të gjithë njerëzit do t’i japin llogari Perëndisë për dhuratën e jetës (krh. vv. 5-9; Mat. 25:31-46; Zbu. 20:11-15). Madje edhe të krishterët do të dalin përpara Krishtit (krh. 14:10-12; II Kor. 5:10).

2:3 Forma gramatikore e pyetjes retorike të Palit pret një “jo” si përgjigje.

■ **“a mendon këtë”** Kjo është FOLJA greke *logizomai*. Pali e përdor atë shpesh (Rom. 2:3,26; 3:28; 4:3,4,5,6, 8,9,10,11,22,23,24; 6:11; 8:18,36; 9:8;14:14; Gal. 3:6, dhjetë herë te I dhe II Korintasve, dhe dy herë te Filipianëve). Shih shënimet te 4:3 dhe 8:18.

■ **“o njeri”** Kjo përputhet me të njëjtën idiomë në v. 1. Në 9:20 ajo u referohet hebrenjve.

2:4 Edhe kjo është pyetje në greqisht.

NASB	“i merr lehtë”
NKJV, NRSV,	
TEV, REB	“përbuz”
NJB	“duke i shpërfillur”
NIV	“tregon përçmim”
NET	“ke përçmim për”

Duke krahasuar përkthimet e ndryshme në anglisht interpretuesit kanë një ide të spektrit kuptimor të FOLJES. Ky është një term i fortë për hedhjen poshtë/refuzimin me dashje. Shih përdorimin e tij te

1. fjalët e Jezusit, Mat. 6:24; 18:10
2. Pali, I Kor. 11:22; I Tim. 4:12; 6:2
3. Hebrenjve (për Jezusin), 12:2
4. Pjetri, II Pjetrit 2:10
5. EMRI te Veprat 13:41

■ **“pasuritë e mirësisë dhe durimit dhe zemërgjerësisë së Tij”** Njerëzit e kanë keqkuptuar shpesh hirin, mëshirën dhe durimin e Perëndisë dhe i kanë kthyer ata në një mundësi për të mëkatuar në vend që të pendoheshin (krh. II Pjet.3:9).

Pali shpesh i përshkruan atributet e Perëndisë si “pasuritë e” (krh. 9:23; 11:33;Kol. 1:27; Efe. 1:7,18; 2:4,7; 3:8,16; Fil. 4:19).

Emri “durim” përdoret vetëm dy herë në DHR, të dyja herët nga Pali në këtë njësi letrare (1:18-3:31), këtu dhe 3:26. Të dyja i referohen durimit të Perëndisë me mëkatarët.

■ **“të prin në pendim”** Pendimi është thelbësor për një marrëdhënie besimi-besëlidhjeje me Perëndinë (krh. Mat. 3:2; 4:17; Marku 1:15; 6:12; Luka 13:3,5; Veprat 2:38; 3:16,19; 20:21). Termi në hebraisht kishte kuptimin e një ndryshimi të veprimeve, kurse në greqisht kishte kuptimin e një ndryshimi të mendjes. Pendimi është gatishmëria për të ndryshuar nga një ekzistencë e përqendruar tek vetja në një jetë të informuar dhe të drejtuar nga Perëndia. Ai kërkon kthim mbrapa nga skllavëria e vendosjes së vetes të parën. E thënë thjesht është një qëndrim i ri, një botëkuptim i ri, një zotëri i ri. Pendimi është vullneti i Perëndisë për çdo fëmijë të rënë të Adamit të krijuar në imazhin e Tij (krh. Ezek. 18:21,23,32 and II Pjet. 3:9).

Pasazhi i DHR që i reflekton më mirë termat e ndryshëm grekë për pendimin është II Kor. 7:8-11.

1. *lupeō*, “hidhërim” ose “trishtim” në vv. 8 (dy herë), 9 (tri herë), 10 (dy herë), 11
2. *metamelomai*, “keqardhje” ose “shqetësim më pas,” në vv. 8 (dy herë), 9
3. *metanoia*, “pendim,” ose “mendje më pas,” në vv. 9, 10

Kontrasti është pendimi i rremë (*metamelomai*) (krh. Judën, Mat. 27:3 dhe Esaun, Heb. 12:16-17) përkundër pendimit të vërtetë (*metanoēō*).

Pendimi i vërtetë lidhet teologjikisht me

1. Predikimin e Jezusit mbi kushtet e Besëlidhjes së Re (krh. Mat. 4:17; Marku 1:15; Luka 13:3,5)
2. Predikimet apostolike në Veprat (*kerigma*, krh. Veprat 3:16,19; 20:21)
3. dhuratën sovranë të Perëndisë (krh. Veprat 5:31; 11:18 dhe II Tim. 2:25)
4. humbjen (krh. II Pjet. 3:9)

Pendimi nuk është opsional!

TEMË E VEÇANTË: PENDIMI

Pendimi (bashkë me besimin) është një kusht besëlidhor edhe i Besëlidhjes së Vjetër, (*Nacham*, BDB 636, p.sh., 13:12; 32:12,14; *Shuv*, BDB 996, p.sh., I Mbr. 8:47; Ezek. 14:6; 18:30) edhe i Besëlidhjes së Re.

1. Gjon Pagëzori (Mat. 3:2; Marku 1:4; Luka 3:3,8)
2. Jezusi (Mat. 4:17; Marku 1:15; Luka 5:32; 13:3,5; 15:7; 17:3)
3. Pjetri (Veprat 2:38; 3:19; 8:22; 11:18; II Pjet. 3:9)
4. Pali (Veprat 13:24; 17:30; 20:21; 26:20; Rom. 2:4; II Kor. 2:9-10)

Por çfarë është pendimi? A është trishtim? A është ndalim i mëkatit? Kapitulli më i mirë në DHR për të kuptuar nuancat e ndryshme kuptimore të këtij koncepti është II Korintasve 7:8-11, ku përdoren tre terma grekë të lidhur me njëri-tjetrin, por të ndryshëm.

1. “trishtim” (*lupē*, krh. vv. 8 [dy herë], 9 [tri herë], 10 [dy herë], 11). Ai do të thotë hidhërim ose shqetësim dhe ka një nënkuptim neutral teologjik.
2. “pendim” (*metanoō*, krh. vv. 9,10). Është fjalë e përbërë nga “pas” dhe “mendje,” gjë që nënkupton një mendje të re, një mënyrë të re të menduari, një qëndrim të ri ndaj jetës dhe Perëndisë. Ky është pendimi i vërtetë.
3. “keqardhje” (*metamelomai*, krh. vv. 8 [dy herë], 10). Është fjalë e përbërë nga “pas” dhe “shqetësim.” Përdoret për Judën te Mat. 27:3 dhe për Esaun te Heb. 12:16-17. Nënkupton trishtim për pasojat, jo për veprat.

Pendimi dhe besimi janë veprat e domosdoshme të besëlidhjes (krh. Marku 1:15; Vep. 2:38,41; 3:16,19; 20:21). Ka disa tekste që nënkuptojnë se Perëndia e jep pendimin (krh. Veprat 5:31; 11:18; II Tim. 2:25). Por pjesa më e madhe e teksteve e shohin këtë si një përgjigje të nevojshme besëlidhore njerëzore ndaj ofertës së shpëtimit falas që bën Perëndia. Për të kapur kuptimin e plotë të pendimit janë të nevojshme përkufizimet e termave edhe në hebraisht, edhe në greqisht. Hebraishtja kërkon “një ndryshim veprimi,” kurse greqishtja kërkon “një ndryshim të mendjes.” Personi i shpëtuar merr një mendje dhe një zemër të re. Ai mendon ndryshe dhe jeton ndryshe. Në vend të pyetjes “Çfarë fitoj unë?” pyetja tani është “Cili është vullneti i Perëndisë?” Pendimi nuk është një emocion që venitit ose një mungesë e plotë mëkati, por një marrëdhënie e re me Të Shenjtin që e transformon besimtarin në mënyrë progresive në një të shenjtë.

2:5-9 Këto vargje përshkruajnë (1) kokëfortësinë e njerëzimit të rënë dhe (2) zemërimin dhe gjykimin e Perëndisë.

2:5 “kokëfortësisë” Ky EMËR gjendet vetëm këtu në DHR. Izraeli përshkruhet në të njëjtën mënyrë tek Eksodi 32:9; 33:3,5; 34:9; LiP. 9:6,13,27 (gjithashtu vini re Heb. 3:8,15; 4:7).

▣ **“zemrës”** Shih Temën e Veçantë në 1:24.

▣ **“në ditën e zemërimit”** Kjo quhej “Dita e Zotit” në DHV (krh. Joeli, Amosi). Ky është koncepti i Ditës së Gjykimit, ose për besimtarët, Ditës së Ringjalljes. Njerëzimi do t’i japë llogari Perëndisë për dhuratën e Tij të jetës (krh. Mat.25:31-46; Zbu. 20:11-15).

Vini re që janë mëkatarët ata (“ti” dhe “për vetë”) që e grumbullojnë zemërimin. Perëndia thjesht, në një moment, e lejon zemërimin e Tij të grumbulluar të bëhet i dukshëm dhe të shkojë deri në fund.

Zemërimi, si të gjitha fjalët njerëzore për të përshkruar Perëndinë, aplikohen për Hyjninë vetëm në mënyrë analoge (antropomorfe, shih Temë e Veçantë te 1:18)! Perëndia është i përjetshëm, i shenjtë dhe Frymë.

Njerëzit janë të fundëm, mëkatarë dhe truporë. Perëndia nuk është i zemëruar emocionalisht, si ne. Bibla e paraqet Atë si Ai që i do mëkatarët dhe që dëshiron që ata të pendohen, por gjithashtu si Ai që ka një kundërshtim të vendosur ndaj rebelimit njerëzor. Perëndia është personal; Ai e merr mëkatin personalisht dhe ne jemi personalisht përgjegjës për mëkatin tonë.

Edhe një mendim tjetër në lidhje me zemërimin e Perëndisë. Në Bibël ai është edhe në kohë, (i kësaj kohe, krh. 1:24,26,28) edhe në fundin e kohës (eskatologjik, krh. 2:5-8). Dita e Zotit (Dita e Gjykimit) ishte një nga mënyrat si profetët e DHV e paralajmëruan Izraelin të pendohej në kohën e tanishme në mënyrë që e ardhmja e tyre të ishte e bekuar, jo e gjykuar (krh. LIP 27-28). Profetët e DHV shpesh morën një krizë të kohës së tyre dhe e projektuan atë në të ardhmen e kohëve të fundit.

2:6 Ky është një citim nga Psalmi 62:12 (krh. Mat. 16:27). Është parim universal (shih shënimin te 2:1, paragrafi i dytë) që njerëzit janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe do t'i japin llogari Perëndisë (krh. Jobi 34:11; Fja.24:12; Pred. 12:14; Jer. 17:10; 32:19; Mat. 16:27; 25:31-46; Rom. 2:6; 14:12; I Kor. 3:8; Gal. 6:7-10; II Tim. 4:14; I Pjet. 1:17; Zbu. 2:23; 20:12; 22:12). Edhe besimtarët do të japin llogari për jetën dhe shërbimin e tyre ndaj Krishtit (krh. II Kor. 5:10). Besimtarët nuk shpëtohen nga veprat, por për vepra (krh. Efe. 2:8-10 [sid. 2:14-26]; Jakobi dhe I Gjonit). Një jetë e ndryshuar dhe që vazhdon të ndryshojë e karakterizuar nga dashuria, shërbimi dhe mungesa e egoizmit është provë e shpëtimit të vërtetë.

2:7 “atyre që” Ka një kontrast midis personave të përshkruar në v. 7 dhe atyre në v. 8 (“por atyre që”).



NASB	“atyre që duke këmbëngulur në bërjen e së mirës kërkojnë lavdi dhe nder dhe pavdekësi, jetë të përjetshme”
NKJV	“jetë të përjetshme atyre që me anë të këmbënguljes me durim në bërjen e së mirës kërkojnë lavdi, nder dhe pavdekësi”
NRSV	“atyre që duke bërë të mirë me durim kërkojnë për lavdi, nder dhe pavdekësi, ai do t’iu japë jetë të përjetshme”
TEV	“Disa njerëz vazhdojnë të bëjnë të mirën dhe të kërkojnë lavdi, nder dhe jetë të pavdekshme; atyre Perëndia do t’iu japë jetë të përjetshme”
NJB	“Për ata që kërkuan emër dhe nder dhe pavdekësi duke bërë gjithmonë të mirën do të ketë jetë të përjetshme”

Kjo bën fjalë për njerëz si Korneli (krh. Vep. 10:34-35). Ky pasazh mund të tingëllojë si drejtësi me anë të veprave (arritje e drejtësisë përmes përpjekjeve njerëzore), por kjo shkon në kundërshtim me lajtmotivin kryesor të librit të Romakëve. Mbani mend se ose vargjet 1-16, ose vargjet 1-11 janë një paragraf. Kuptimi teologjik i gjithë kësaj është që Perëndia nuk ka anshmëri ndaj njerëzve (v.11) dhe se të gjithë kanë mëkatur (v. 12). Nëse njerëzit do të jetonin në bazë të dritës që kishin (zbulesa natyrore për johebrejtë, zbulesa e veçantë për hebrejtë, krh. 10:5) atëherë ata do të ishin në rregull me Perëndinë. Megjithatë, përmbledhja e 3:9-18,23 tregon që asnjë nuk ka jetuar ndonjëherë në këtë mënyrë, dhe asnjë nuk mundet!

Jeta e ndryshuar e një besimtari shihet si ajo që konfirmon dhe vërteton përgjigjen e tij fillestare të besimit. Një jetë e ndryshuar është provë e Frymës brendabanues të Perëndisë (krh. vv.10,13; Mat. 7; Efe. 2:8-10; Jakobi 2:14-26 dhe I Gjonit). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për të këmbëngulur në 8:25.

■ **“jetë të përjetshme”** Kjo është një frazë karakteristike e shkrimeve të Gjonit dhe përdoret rrallë në Ungjijtë Sinoptikë. Pali duket se e merr frazën nga Dan. 12:2 (krh. Titit 1:2; 3:7), ku ajo tregon jetën e epokës së re, jetën në bashkësi me Perëndinë, jetën e ringjalljes. Ai e përdor atë për herë të parë në Gal. 6:8. Është një lajtmotiv i zakonshëm në pjesën doktrinare të Romakëve (krh. 2:7; 5:21; 6:22,23). Gjithashtu del disa herë në Letrat Pastorale (krh. I Tim. 1:16; Titit 1:2; 3:7).

2:8

NASB	“atyre që janë ambiciozë egoistë”
NKJV, NRSV	“atyre që kërkojnë për veten”
TEV	“të tjerë njerëz janë egoistë”
NJB	“atyre që nga zilia”

Termi fillimisht kishte kuptimin ‘të punosh për pagesë’ (krh. Tob. 2:11).

Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon*, vol. 2, fq. 104, japin dy përdorime të këtij termi.

1. “ambicje egoiste,” duke përdorur Rom. 2:8 në kuptimin “që dëshiron të jetë më i mirë sesa dikush tjetër,” që përputhet me këtë kontekst
2. “armiçësi,” duke përdorur Fil 1:17 duke nënkuptuar “rivalitet” si një mundësi përkthimi (shih edhe II Kor. 12:20; Gal. 5:20; Fil. 2:3; Jakobi 3:14,16)

▣ **“dhe nuk i binden të vërtetës,”** Termi “e vërteta” (*aletheia*) përdorej në kuptimin e tij hebraik (*emeth*) të vërtetësisë dhe besueshmërisë. Në këtë kontekst ai kishte një fokus moral, jo intelektual. Shih Temën e Veçantë: E vërteta në Shkrimet e Palit te 1:18.

2:9 “për çdo shpirt njeriu” Pali e përdori termin grek *pas* të përkthyer “të gjithë” ose “çdo” kaq shpesh në këta kapituj hyrës të Romakëve për të treguar rrjedhojat universale edhe të “lajmit të keq” (gjendjes së humbur të njerëzimit dhe gjykimit të paanshëm të Perëndisë), edhe të “lajmit të mirë” (ofertës së Perëndisë për shpëtim falas dhe falje të plotë në Krishtin për të gjithë që pendohen dhe besojnë).

Ky kontekst nënkupton fort një gjykim universal dhe pasojat e tij. Kjo e vërtetë kërkon një ringjallje edhe të drejtëve, edhe të të këqijve (krh. Dan. 12:2; Gjoni 5:28-29; Vep. 24:15).

Nëse vargjet 6-11 janë një kiazme, atëherë vargjet 8-9 janë vargjet kyçe që tregojnë gjykim për keqbërësit.

2:9-10 “më parë hebreut” Kjo përsëritet për theksim. Hebreu ishte i pari në mundësi, sepse kishte zbulësën e Perëndisë (krh. 1:16; Mat. 10:6; 15:24; Gjoni 4:22; Vep. 3:26; 13:46), por edhe i pari në gjykim (krh. 9-11), sepse kishte zbulësën e Perëndisë (krh. 9:4-5).

2:11

NASB, NKJV	“sepse tek Perëndia nuk ka anësi”
NRSV	“Sepse Perëndia nuk tregon anësi”
TEV	“Sepse Perëndia e gjykon çdonjërin me të njëjtin standard”
NJB	“Nuk ka favorizime tek Perëndia”

Fjalë për fjalë kjo është “të ngresh sytë/fytyrën,” dhe ishte një metaforë nga sistemi gjyqësor i DHV (krh. Lev. 19:15; LiP. 10:17; II Kron. 19:7; Vep. 10:34; Gal. 2:6; Efe. 6:9; Kol. 3:25; I Pjet. 1:17). Nëse një gjykatës do ta shikonte personin të cilin po gjykonte, ekzistonte mundësia për të qenë i anshëm. Prandaj, ai nuk duhet t’i ngrinte sytë për të parë atë që qëndronte para tij.

TEMË E VEÇANTË: RACIZMI

I. Hyrje

- A. Racizmi është shprehje e përbotshme e njerëzimit të rënë brenda shoqërisë së vet. Kjo është egoja e njerëzimit, të mbështesësh veten mbi kurrizin e të tjerëve. Në shumë mënyra, racizmi është fenomen modern, ndërsa nacionalizmi (ose tribalizmi) është fenomen më i lashtë.
- B. Nacionalizmi nisi në Babel (Zanafilla 11) dhe, në fillimisht lidhej me tre bijtë e Noeut, prej të cilëve u zhvilluan të ashtuquajturat raca (Zanafilla 10). Sidoqoftë, është e qartë nga Shkrimi se njerëzimi vjen prej një burimi të vetëm (shih Zanafilla 1-3; Veprat 17:24-26).
- C. Racizmi është vetëm një nga paragjykimet e shumta. Disa të tjera janë (1) snobizmi arsimor; (2) arroganca socio-ekonomike; (3) legalizmi kryeneç fetar; dhe (4) përkatësitë dogmatike politike.

II. Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Zan. 1:27 – Njerëzimi, mashkulli dhe femra, u krijuan në ngjashmërinë dhe shëmbëllimin e Perëndisë, gjë që i bën unikë. Po kështu, kjo tregon dhe vlerën e dinjitetin e çdo individi (shih Gjoni 3:16).
2. Zan. 1:11-25 – regjistron frazën “... sipas llojit të tyre...” dhjetë herë. Kjo është përdorur nga disa për të mbështetur ndarjen racore. Mirëpo, nga konteksti, është e qartë se kjo u referohet kafshëve dhe bimëve, dhe jo njerëzimit.

3. Zan. 9:18-27 – Kjo është përdorur për të mbështetur dominimin racor. Duhet të kujtojmë se Kanaanin nuk e mallkoi Perëndia. Atë e mallkoi Noeu, i gjyshi, pasi u zgjua nga dehja. Bibla nuk thotë askund se Perëndia e mbështeti këtë betim/mallkim. Edhe sikur ta kishte bërë, kjo nuk prekte aspak racën e zezë. Kanaani ishte ati i atyre që banuan në Palestinë, dhe arti mural egjiptian tregon se ata nuk ishin të zinj.
4. Jozueu 9:23 – Është përdorur për të provuar se njëra racë do t'i shërbejë tjetrës. Mirëpo, në këtë kontekst, gibeonastit ishin nga i njëjti grup racor si judenjtë.
5. Ezra 9-10 dhe Nehemia 13 – Shpesh, këto janë përdorur në kuptimin racor, por konteksti tregon se ato martesat u dënuan, jo për shkak të racës (ata vinin nga i njëjti bir i Noeut, Zanafilla 10), por për arsye fetare.

B. Dhiata e Re

1. Ungjijtë

- a. Jezusi e përdori në një sërë rastesh si shembull urrejtjen mes judenjve dhe samaritanëve, gjë që tregon se urrejtja racore është e pavend.
 - (1) shëmbëlltyra e Samaritanit të Mirë (Luka 10:25-37)
 - (2) gruaja te pusi (Gjoni 4)
 - (3) lebrozi mirënjohës (Luka 17:11-19)
- b. Ungjilli është për gjithë njerëzimin
 - (1) Gjoni 3:16
 - (2) Luka 24:46-47
 - (3) Hebrenjve 2:9
 - (4) Zbulesa 14:6
- c. Mbretëria do të përfshijë gjithë njerëzimin
 - (1) Luka 13:29
 - (2) Zbulesa 5

2. Veprat

- a. Veprat 10 është një pasazh vendimtar për dashurinë e përbotshme të Perëndisë dhe për mesazhin e përbotshëm të ungjillit.
- b. Pjetri u sulmua për veprimet e tij në Veprat 11, dhe ky problem nuk u zgjidh derisa u mblodh Këshilli i Jerusalemit (Veprat 15) dhe arriti në një zgjidhje. Tensioni mes judenjve dhe johebrenjve në shekullin e parë ishte shumë i lartë.

3. Pali

- a. Nuk ka pengesa në Krishtin
 - (1) Gal. 3:26-28
 - (2) Efe. 2:11-22
 - (3) Kol. 3:11
- b. Perëndia nuk bën dallime mes njerëzve
 - (1) Rom. 2:11
 - (2) Efe. 6:9

4. Pjetri dhe Jakobi

- a. Perëndia nuk bën dallime mes njerëzve (1 Pjet. 1:17)
- b. Për shkak se Perëndia nuk tregon anshmëri, as populli i tij s' duhet ta bëjë (Jakobi 2:1)

5. Gjoni

- a. Një nga pohimet më të forta të përgjegjësive së besimtarëve gjendet në 1 Gjonit 4:20

III. Përfundim

A. Racizmi, si dhe paragjykimet e çdo lloji, janë plotësisht të pavend për fëmijët e Perëndisë. Ja një citim nga Henlee Barnette, që foli në një forum në Glorieta të Nju Meksikos, për Komisionin e Jetës së Krishterë më 1964.

“Racizmi është heretik, sepse është jobiblik dhe jo i krishterë, për të mos përmendur faktin se është dhe joshkencor”.

B. Ky problem u jep të krishterëve mundësinë që të tregojnë dashurinë, faljen dhe kuptueshmërinë e tyre të krishterë ndaj një bote të humbur. Refuzimi i të krishterit në këtë zonë tregon papjekuri

dhe i jep mundësinë të ligut që të vonojë besimin, sigurinë dhe rritjen e besimtarit. Po kështu, kjo do të veprojë si pengesë që njerëzit e humbur të vijnë te Krishti.

C. Çfarë mund të bëj unë? (Kjo pjesë është marrë nga një trakt i Komisionit të Jetës së Krishterë, me titull “Marrëdhëniet racore”

“NË NIVELIN PERSONAL”

- ★ Prano përgjegjësinë tënde për të zgjidhur problemet që lidhen me racën.
- ★ Përmes lutjes, studimit biblik dhe bashkësisë me njerëz nga raca të tjera, përpiku të çlirosh jetën tënde nga paragjykimet racore.
- ★ Shpreh bindjet e tua për racën, sidomos aty ku ata që nxisin urrejtjen racore nuk sfidohen prej askujt.

“NË JETËN FAMILJARE”

- ★ Prano rëndësinë e ndikimit familjar në zhvillimin e qëndrimeve kundrejt racave të tjera.
- ★ Përpiku të zhvillosh qëndrime të krishtera duke folur për ato që dëgjojnë prindërit dhe fëmijët për problemet racore jashtë shtëpisë.
- ★ Prindërit duhet të kujdesen që të bëhen shembull i krishterë në marrëdhëniet me njerëzit e racave të tjera.
- ★ Gjej mundësi për të bërë miqësi familjare përtej kufijve racorë.

“NË KISHË”

- ★ Duke predikuar dhe mësuar të vërtetën biblike për racat, bashkësia mund të motivohet të bëhet shembull për gjithë komunitetin.
- ★ Sigurohuni që adhurimi, bashkësia dhe shërbesa në kishë të jetë e hapur për të gjithë, ashtu si kishat e DhR nuk kishin fare pengesa racore (Efe. 2:11-22; Gal. 3:26-29).

“NË JETËN E PËRDITSHME”

- ★ Ndihmo në mposhtjen e çdo diskriminimi racor në vendin e punës.
- ★ Punoni, nëpërmjet organizatave komunitare të të gjitha llojeve, që të siguroni të drejta dhe mundësi të barabarta, duke mos harruar se duhet të sulmoni problemin racor, jo njerëzit. Synimi është të nxisni mirëkuptimin, jo të ngjallni zemërim.
- ★ Nëse ju duket e mençur, organizoni një komitet të veçantë me qytetarë të shqetësuar me qëllim që të hapni linja komunikimi në komunitet për edukimin e publikut të gjerë dhe për veprime të veçanta në përmirësimin e marrëdhënieve racore.
- ★ Mbështesni legjislacione dhe legjislatorë në aprovimin e ligjeve që përkrahin drejtësinë racore dhe u kundërvihen atyre që e shfrytëzojnë paragjykimin për përfitime politike.
- ★ Lavdëroni zyrtarët e zbatimit të ligjit që i zbatojnë ligjet pa diskriminim.
- ★ Qëndroni larg dhunës dhe nxisni respektin për ligjin, duke bërë të pamundurën si qytetarë të krishterë që të siguroheni që strukturat ligjore të mos bëhen mjete në duart e atyre që nxisin diskriminimin.
- ★ Mishëroni mendjen dhe frymën e Krishtit në çdo marrëdhënie njerëzore.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:12-16

¹²Sepse të gjithë që kanë mëkatuar pa Ligjin do të humbasin gjithashtu pa Ligjin, dhe të gjithë që kanë mëkatuar nën Ligjin do të gjykojnë nga Ligji; ¹³sepse nuk janë dëgjuesit e Ligjit ata që janë të drejtë para Perëndisë, por bërësit e Ligjit do të drejtësohen. ¹⁴Sepse kur johebrenjtë që nuk e kanë Ligjin bëjnë instinktivisht gjërat e Ligjit, këta, duke mos e patur Ligjin janë një ligj për veten e tyre, ¹⁵në atë që ata tregojnë punën e Ligjit të shkruar në zemrat e tyre, me ndërjegjen e tyre që dëshmon dhe me mendimet e tyre që herë i akuzojnë e herë i mbrojnë, ¹⁶në ditën kur, sipas ungjillit tim, Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve përmes Krishtit Jezus.

2:12 “Sepse të gjithë që kanë mëkatuar pa Ligjin” Perëndia do t’iu kërkojë llogari të gjithë njerëzve, edhe nëse ata kurrë nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj DHV ose ungjillit. Të gjithë njerëzit e kanë njëfarë njohurie për Perëndinë nga krijimi (krh. 1:19-20; Psa. 19:1-6), dhe një sens të brendshëm moral, (krh. 2:14-15). Tragjedia është që të gjithë e kanë injoruar me vullnetin e tyre dritën që kanë patur (krh. 1:21-23; 3:9,19,23; 11:32; Gal. 3:22).

■ **“Ligjin”** Nuk ka NYJE (shquese ose joshquese) për termin “ligj.” Kjo strukturë gramatikore zakonisht theksonte cilësinë e EMRIT. Megjithatë, te Romakëve Pali përdor “ligjin” (e shquar) për t’iu referuar disa gjërave.

1. Ligjit Romak
2. Ligjit të Moisiut
3. konceptit të zakoneve morale të shoqërisë njerëzore në përgjithësi

Konteksti, jo NYJA (shquese), duhet ta tregojë se cili nga këta kuptime është. Ky kontekst thekson se të gjithë njerëzit kanë njëfarë njohurie për zbuluesin natyror të Perëndisë të Vetes së Tij në zemrat e tyre (krh. v. 15).

2:13 “sepse nuk janë dëgjuesit e Ligjit ata që janë të drejtë para Perëndisë” Termi “dëgjuesit” mund t’i referohet (1) përdorimit rabinik i cili përdorej specifikisht për studentët rabinikë të Torah-ut ose (2) ata që i dëgjonin Shkrimet kur lexoheshin në sinagogë. Kujtoni që shkruesit e DHR ishin mendimtarë hebrej që shkruanin në greqishten koine. Prandaj, analiza e fjalëve duhet të fillojë me Septuagintën, jo me një fjalor të greqishtes.

Termi “i drejtë” ose “i drejtësuar/i shfajësuar” (*dikē* in all its forms) është një term kyç në teologjinë e Palit (krh. 3:4,20,24,26,28,30; 4:2,5; 5:1,9; 6:7; 8:30,33). Fjalët “i drejtë,” “drejtësoj,” “drejtësim,” “e drejtë,” dhe “drejtësi” rrjedhin të gjitha nga *dikaïos*. Shih Temën e Veçantë: Drejtësia te 1:17. Në hebraisht (*tsadag*, BDB 843) ajo fillimisht i referohej një kallami të gjatë e të drejtë (5-7 m) i cili përdorej për të matur gjëra, si mure ose gardhe, për të përcaktuar nëse ishin drejt vertikalisht. Filloi të përdorej në mënyrë metaforike për Perëndinë si standarti i gjykimit.

Në shkrimet e Palit termi kishte dy fokuse. Së pari, drejtësia e vetë Perëndisë i jepet njerëzimit mëkatar si një dhuratë falas përmes besimit në Krishtin. Kjo shpesh quhet drejtësi e veshur/e atribuuar/e llogaritur ose drejtësi ligjore. Ajo i referohet pozicionit gjyqësor të dikujt përpara një Perëndie të drejtë. Kjo është origjina e lajtmotivit të famshëm të Palit “shfajësim/drejtësim me anë të hirit, nëpërmjet besimit.”

Së dyti, veprimtaria e Perëndisë për rikthimin e njerëzimit mëkatar në imazhin e Tij (krh. Zan. 1:26-27), ose për ta thënë ndryshe, për ta sjellë në ngjashmëri me Krishtin. Ky varg – si Mat. 7:24; Luka 8:21 dhe 11:28; Gjoni 13:17; Jakobi 1:22-23,25 – i nxit besimtarët të jenë bërës, jo thjesht dëgjues. Drejtësia e veshur/e llogaritur/e atribuuar (drejtësimi) duhet të rezultojë në jetesë të drejtë (shenjtërim). Perëndia i fal dhe i ndryshon mëkatarët! Përdorimi që i bën Pali kësaj fjale është edhe ligjor, edhe etik. Dhiata e Re u jep njerëzve një pozicion ligjor, por edhe kërkon një mënyrë jetese të perëndishme. Është falas, por kushton.

■ **“por bërësit e Ligjit”** Perëndia kërkon një mënyrë jetese të re në bindje (krh. Lev. 18:5; Mat. 7:24-27; Luka 8:21; 1:28; Gjoni 13:17; Jakobi 1:22-25; 2:14-28). Në shumë mënyra ky koncept imiton termin hebre *shema* (BDB 1033), i cili do të thotë të dëgjosh në mënyrë që të bësh (krh. LiP. 5:1; 6:4;9:1; 20:3; 27:9-10).

2:14

NASB	“Sepse kur johebrenjtë që nuk e kanë Ligjin bëjnë instinktivisht gjërat e Ligjit, këta, duke mos e patur Ligjin janë një ligj për veten e tyre”
NKJV	“sepse kur johebrenjtë, të cilët nuk e kanë ligjin, nga natyra bëjnë gjërat që përmbahen në ligj, këta, megjithëse nuk e kanë ligjin, janë një ligj për veten e tyre”
NRSV	“Kur johebrenjtë, të cilët nuk e zotërojnë ligjin, bëjnë instinktivisht ato që kërkon ligji, këta, megjithëse nuk e kanë ligjin, janë një ligj për veten e tyre”
TEV	“Johebrenjtë nuk e kanë Ligjin, por kurdoherë që me vullnetin e tyre të lirë ata bëjnë ato që urdhëron Ligji, ata janë një ligj për veten, megjithëse nuk e kanë Ligjin”
NJB	“Për shembull paganët, të cilët nuk kanë dëgjuar kurrë për Ligjin, por drejtohen nga arsyeja të bëjnë atë që urdhëron Ligji, mund të mos e ‘zotërojnë’ Ligjin, por mund të thuhet se ‘janë’ Ligji”

Të gjitha kulturat e kanë një ligj të brendshëm moral, një normë shoqërore. Ata janë përgjegjës për dritën që kanë (krh. 1 Kor. 9:21). Ky varg nuk do të thotë që ata mund të jenë në rregull me Perëndinë nëse jetojnë në dritën e kulturës së tyre, por që ata janë përgjegjës për njohurinë e tyre të brendshme për Perëndinë.

2:15 “me ndërgjegjen e tyre që dëshmon dhe me mendimet e tyre që herë i akuzojnë e herë i mbrojnë” Ekziston një zë i brendshëm moral. Por vetëm Shkrimi, i ndriçuar nga Fryma, mund të besohet plotësisht. Rënia

na e ka ndikuar ndërgjegjen. Megjithatë, krijimi (1:18-20) dhe ky ligj i brendshëm, moral (2:14-15) është e gjithë njohuria për Perëndinë që zotërojnë disa njerëz. Nuk kishte një term hebre të barazvlefshëm me fjalën greke për “ndërgjegje” (*sineidesis*). Koncepti grek për një sens të brendshëm moral të së drejtës dhe të së gabuarës diskutohej shpesh nga filozofët stoikë. Pali i njihte mirë filozofët grekë (ai citon Kleantin te Veprat 17:28; Menanderin te 1 Kor. 15:33 dhe Epimenidin tek Titi 1:12) nga shkollimi i tij i hershëm në Tars. Qyteti i tij i lindjes ishte i njohur për shkollat e tij të shkëlqyera të retorikës dhe filozofisë greke.

2:16 “në ditën” Shih shënimin te 2:5

■ **“sipas ungjillit tim”** Në kontekst kjo i referohet predikimit nga Pali të zbulesës së Jezu Krishtit. PËREMRI “im” reflekton të kuptuarit e Palit të administrimit të ungjillit që i ishte besuar atij (krh. 16:25; I Kor. 15:1; Gal. 1:11; I Tim. 1:11; II Tim. 2:8). Nuk ishte në mënyrë unike i tiji, por si Apostulli i Johebrenjve ai kishte një ndjenjë të madhe përgjegjësie për përhapjen e së vërtetës në lidhje me Jezusin në botën greko-romake.

■ **“Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve”** Perëndia i njeh zemrat e të gjithë njerëzve (krh. I Sam. 2:7; 16:7; I Mbret. 8:39; I Kron. 28:9; II Kron. 6:30; Ps. 7:9; 44:21; 139:1-6; Fja. 15:11; 21:2; Jer. 11:20; 17:10; 20:12; Luka 15:16; Vep. 1:24; 15:8; Rom. 8:27; Zbu. 2:23). Ati, përmes Birit, do të gjykojë edhe motivet, edhe veprimet e njerëzve (krh. Mat. 25:31-46; Zbu. 20:11-15).

■ **“përmes Krishtit Jezus”** Jezusi nuk erdhi të vepronte si gjykatës (krh. Gjoni 3:17-21). Ai erdhi të zbulonte Perëndinë Atë, të vdiste një vdekje zëvendësuese dhe t’iu jepte besimtarëve një shembull për të ndjekur. Kur njerëzit e refuzojnë Jezusin, ata gjykojnë veten.

Megjithatë, DHR gjithashtu mëson se Jezusi do të veprojë si përfaqësues i Atit në gjykim (krh. Gjoni 5:22, 27; Vep. 10:42; 17:31; II Tim. 4:1). Tensionimi midis Jezusit si Gjykatës dhe/ose Shpëtimtar mund të shihet në Ungjillin e Gjonit (krh. 3:17-21 përkundër 9:39).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:17-24

¹⁷Por nëse ti mban emrin “hebre” dhe mbështetesh mbi Ligjin dhe mburresh në Perëndinë, ¹⁸dhe e njeh vullnetin e Tij dhe miraton gjërat që janë thelbësore, duke qenë i mësuar nga Ligji, ¹⁹dhe je i sigurt se ti vetë je udhërrëfyes për të verbrit, dritë për ata që janë në errësirë, ²⁰korrigjues i të marrëve, mësues i të papjekurve, duke patur në Ligjin mishërimin e njohurisë dhe së vërtetës, ²¹ti, pra, që mëson një tjetër, nuk mëson veten? Ti që predikon se nuk duhet vjedhur, a vjedh? ²²Ti që thua se nuk duhet kryer kurorëshkelje, a kryen kurorëshkelje? Ti që i neverit idhujt, a i grabit tempujt? ²³Ti që mburresh në Ligjin, përmes shkeljes së Ligjit, a e çnderon Perëndinë? ²⁴Sepse “EMRI I PERËNDISË BLASFEMOHET MIDIS JOHEBRENJVE PËR SHKAKUN TUAJ,” tamam siç është shkruar.

2:17 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Ky kusht shkon deri tek v. 20 por nuk ka konkluzion, prandaj, TEVI i përkthen ato si pohime të supozuara që do t’i bënte Jezusi. Hebrenjtë po i besonin prejardhjes, traditave dhe performancës së tyre për të siguruar shpëtimin (krh. Mat. 3:9; Gjoni 8:33,37,39).

■ **“mburresh në Perëndinë”** Shumë hebrenj po mbështeteshin në (1) prejardhjen e tyre nga Abrahami dhe në (2) mbajtjen e tyre personale të Ligjit të Moisiut si mjet për të qenë të pranuar nga Perëndia. Megjithatë, legalizmi i tyre i vetë-drejtë i ndante nga Perëndia (krh. Mat. 5:20; Gal. 3). Çfarë ironie tragjike!

Pali e zhvillon idenë e mburrjes te 1 Korintasve. Pali përballej me një Izrael arrogant dhe një intelektualizëm grek arrogant. Përfundimi është që asnjë mish nuk do të lavdërohet para Perëndisë.

TEMË E VEÇANTË: MBURRJA

Këto terma greke, *kauchaomai*, *kauchēma* dhe *kauchēsis* përdoren rreth tridhjetë e pesë herë nga Pali dhe vetëm dy herë në pjesën tjetër të DHR (të dyja tek Jakobi). Përdorimi i tij kryesor është në 1 dhe 2 Korintasve.

Ka dy të vërteta kryesore të lidhura me mburrjen.

* Asnjë mish nuk do të lavdërohet/mburret para Perëndisë (krh. I Kor. 1:29; Efe. 2:9)

* Besimtarët duhet të lavdërohen në Zotin (krh. I Kor. 1:31; II Kor. 10:17, që është një aluzion ndaj Jer. 9:23-24)

Prandaj, ka mburrje/lavdërim (d.m.th. krenari) të duhur dhe jo të duhur.

A. E duhur

1. në shpresën e lavdisë (krh. Rom. 4:2)
2. në Perëndinë përmes Zotit Jezus (krh. Rom. 5:11)
3. në kryqin e Zotit Jezu Krisht (d.m.th., tema kryesore e Palit, krh. I Kor. 1:17-18; Gal. 6:14)
4. Palë mburret për
 - a. Shërbesën e tij pa shpërblim (krh. I Kor. 9:15,16; II Kor. 10:12)
 - b. Autoritetin e tij nga Krishti (krh. II Kor. 10:8,12)
 - c. Faktin që nuk mburret me punën e të tjerëve (siç bënin disa në Korint, krh. II Kor. 10:15)
 - d. Prejardhjen e tij etnike (siç bënin të tjerë në Korint, krh. II Kor. 11:17; 12:1,5,6)
 - e. Kishat e tij
 - (1) Korinti (II Kor. 7:4,14; 8:24; 9:2; 11:10)
 - (2) Selaniku (krh. II Thes. 1:4)
 - (3) Sigurinë e tij në ngushëllimin dhe çlirimin e Perëndisë (krh. II Kor. 1:12)

B. Jo e duhur

1. në lidhje me trashëgiminë e tij hebreje (krh. Rom. 2:17,23; 3:27; Gal. 6:13)
2. disa në kishën e Korintit po mburreshin
 - a. në njerëzit (krh. I Kor. 3:21)
 - b. në urtësinë (krh. I Kor. 4:7)
 - c. në lirinë (krh. I Kor. 5:6)
3. mësuesit e rremë u përpoqën të mburreshin me kishën në Korint (krh. II Kor. 11:12)

2:18 “miraton” Kjo është FOLJA greke *dokimazō* në KOHËN E TASHME TË MËNYRËS DËFTORE. Shih Temë e Veçantë mbi Vënien në provë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: TERMAT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE

Ka dy fjalë greke që përçojnë idenë e vënies dikujt në provë për një qëllim të caktuar.

1. *Dokimazō, Dokimion, Dokimasia*

Kjo fjalë është term metalurgjik për vënien në provë të autenticitetit të diçkaje (pra, metaforikisht, të dikujt) me anë të zjarrit. Zjarri zbulon metalin e vërtetë dhe djeg (pra, pastron) skoriet. Ky proces fizik u shndërrua në zhargon të fuqishëm teologjik ku Perëndia, dhe/ose Satani, dhe/ose njerëzit vënë në sprovë të tjerët. Kjo fjalë përdoret vetëm në kuptimin pozitiv të sprovimit me synim që dikush të miratohet. Në Dhr përdoret për të vënë në sprovë

- a. qetë – Luka 14:19
- b. vetveten – I Kor. 11:28
- c. besimin tonë – Jakobi 1:3
- d. madje dhe Perëndinë – Heb. 3:9

Rezultatet e këtyre sprovave merren si pozitive (shih Rom. 2:18; 14:22; 16:10; 2 Kor. 10:18; 13:3; Fil. 2:27; 1 Pje. 1:7), prandaj, ky term përçon idenë e shqyrtimit dhe miratimit të dikujt si

- a. i vlefshëm
- b. i mirë
- c. i vërtetë
- d. i vyer
- e. i nderuar

2. *Peirazō, Peirasmos*

Shpesh, ky term ka ngjyrimin e shqyrtimit me qëllim gjetjen e të metave, ose refuzimin. Shpesh, përdoret në lidhje me tundimin e Jezusit në shkretëtirë.

- a. Përçon përpjekjen për ta shtënë Jezusin në kurth (shih. Mat. . 4:1; 16:1; 19:3; 22:18, 35; Marku 1:13; Luka 4:2; Heb. 2:18).
- b. Kjo fjalë (*peirazōn*) përdoret edhe si titull i Satanit në Mat. 4:3; 1 Thes. 3:5.
- c. Përdoret nga Jezusi për të na paralajmëruar që të mos e vëmë Perëndinë në sprovë (shih Mat. 14:7; Luka 4:12) [ose Krishtin, shih 1 Kor. 10:9]. Po kështu, ajo nënkupton përpjekjen për të bërë diçka që ka dështuar (shih Heb. 11:29). Përdoret në lidhje me tundimin dhe sprovat e besimtarëve (shih 1 Kor. 7:5; 10:9, 13; Gal. 6:1; 1 Thes. 3:5; Heb. 2:18; Jakobi 1:2, 13, 14; 1 Pje. 4:12; 2 Pje. 2:9). Perëndia i lejon tre armiqtë e njerëzimit (pra, botën, mishin dhe djallin) që të shfaqen në kohë dhe vende të caktuara.

▣ **“Ligji”** Vargjet 17 e tutje flasin për hebrenjtë, prandaj termi “Ligji” duhet t’i referohet në këtë kontekst Ligjit të Moisiut. Kjo konfirmohet nga v. 25 i cili flet për rrethprerjen.

2:18-20 Udhëheqësit hebrenj besonin se rruga e tyre (sekti i tyre i Judaizmit) ishte rruga e duhur, e vetmja rrugë për te Perëndia. Ata ishin të sigurt se ata ishin mësuesit e vërtetë në lidhje me çështjet fetare (krh. Mat. 15:14). Privilegji sjell me vete edhe përgjegjësi (krh. Luka 12:48).

Vini re frazat paralele që flasin për sigurinë e tyre (krh. Mat. 15:14; 23:16,24; Luka 6:39).

1. udhërrëfyes për të verbrit, v. 19
2. dritë për ata që janë në errësirë, v. 19
3. korrigjues i të marrëve, v. 20
4. mësues i të papjekurve, v. 20
5. duke patur në Ligjin mishërimin e njohurisë dhe së vërtetës, v. 20

2:21-24 Nëse do të besojmë në bindjen personale, atëherë ajo bindje duhet të jetë e plotë (krh. Mat. 5:20,48; Gal.3:10, që është citim nga LiP. 27:26, dhe Jakobi 2:10). Kjo është e pamundur për njerëzimin e rënë. Pali u parashtron pyetje retorike lexuesve/dëgjuesve të tij hebrenj në vv. 21-23.

2:22 Është e vështirë të dimë se për se po fliste Pali te vv. 22-23. Meqenëse përshkrimi nuk u shkon shumicës së hebrenjve të kohës së Palit, është e mundur që këto mëkate të jenë përdorur në kuptimin shpirtëror në mënyrë të ngjashme me atë si e interpretoi Jezusi Ligjin te Mat. 5:20-48. Xhorxh Lad (George Ladd) në librin e tij *A Theology of the New Testament (Një teologji e Dhiatës së Re)*, thotë, “Pali duhet ta ketë fjalën për vjedhjen ndaj Perëndisë të nderit që i takon Atij, kurorëshkeljen shpirtërore dhe blasfemimin e devotshmërisë që i takon vetëm Perëndisë duke e lartësuar veten e tyre si gjykatës dhe zot mbi krijesat e tjera si ata.” fq. 505.

2:22 “neverit idhujt” Kuptimi rrënjësor i këtij termi është largimi nga diçka për shkak të erës së rëndë të saj.

▣ **“a i grabit tempujt”** Nga ana historike është e paqartë se për se është fjala këtu, por ishte e lidhur disi me idhujtarinë.

2:23 “mburresh” Shih Temën e Veçantë: Mburra në 2:17.

2:24 Ky është një citim nga Isaia 52:5 në Septuagintë. Bekimi i Perëndisë ndaj Izraelit për mbajtjen e besëlidhjes (krh. LiP 27-28) kishte qëllim të ishte një dëshmi ndaj botës. Megjithatë, Izraeli kurrë nuk e mbajti besëlidhjen, e prandaj, bota pa vetëm gjykimin e Perëndisë (krh. Ezek. 36:22-32). Izraeli duhej të ishte një mbretëri priftërinjsh (krh. Eksodi 19:5-6), për ta sjellë gjithë botën në besimin te YHWH (krh. Zan. 12:3; Efe. 2:11-3:13). Shih Temën e Veçantë: Anësitë Ungjillore të Bobit në 1:5.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 2:25-29

²⁵Sepse në të vërtetë rrethprerja të vlen nëse e praktikon Ligjin; por nëse je shkelës i Ligjit, rrethprerja jote është bërë parrethprerje. ²⁶Prandaj, nëse i parrethpreri i mban kërkesat e Ligjit, a nuk do të konsiderohet parrethprerja e tij si rrethprerje? ²⁷Dhe ai që është fizikisht i parrethprerë, nëse e mban Ligjin, a nuk do të të gjykojë ty që, megjithëse e ke shkronjën e Ligjit dhe rrethprerjen, je shkelës i Ligjit? ²⁸Sepse hebre nuk është ai që duket nga jashtë, dhe rrethprerja nuk është ajo që është e jashtme në mish.

²⁹Por hebre është ai që është i tillë nga brenda; dhe rrethprerja është ajo që është e zemrës, me anë të Frymës, jo me anë të shkronjës; dhe lavdërimi i tij nuk është nga njerëzit, por nga Perëndia.

2:25 “rrethprerja” Pali po përdor përsëri një diatrib. Dikush do të thotë që, të paktën ne jemi të rrethprerë (krh. Zan. 17:10-11). Ne jemi nga linja e Abrahamit. Pali haptas dhe me guxim e çarmatos këtë pretendim të çmuar të hebrenjve (krh. Mat. 3:7-10; Gjoni 8:31-59).

Të gjithë fqinjët e Izraelit, përveç Filistejve, ishin të rrethprerë. Nuk ishte akti në vetvete ai që kishte rëndësi; ishte besimi në vazhdimësi i atij që e kishte rrethprerjen (krh. vv. 26-27; LiP 10:16; 30:6). Kjo është e vërtetë për të gjitha rritat fetare. Njerëzit fetarë shpesh duan bekimet e besëlidhjes së Perëndisë, por pa përgjegjësitë.

2:25-26 “nëse...nëse...nëse” Këto janë tre FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË që u referohen veprimeve të mundshme në të ardhmen. Bindja (krh. LiP 27-30) është çelësi në argumentin e Palit në kapitullin 2, por jo në 3:21-31 (krh. Gal. 3). Bindja është rezultat i shpëtimit, por hiri është baza (krh. Efe. 2:8-10).

2:26-27 Këto vargje prezantojnë si të mundshme shpresën se disa johebrej janë përgjigjur ndaj dritës që kanë (gramatika pret një përgjigje “po” në v. 26). I vetmi shembull biblik i mundshëm i kësaj do të ishte Korneli i Veprave 10. Megjithatë, ai nuk i shkon shumë mirë këtij vargu sepse ishte druajtës i Perëndisë dhe adhuronte në sinagogën lokale.

Këto vargje janë në të vërtetë një kundërpikë ndaj argumentit të Palit në lidhje me nevojën e shpëtimit për hebrenjtë. Romakëve 3:23 është përmbledhja që të gjithë njerëzit janë shpirtërisht të humbur pa Krishtin. Nëse ka johebrej të cilët jetojnë sipas dritës që kanë nga krijimi dhe ndjeshmëria e brendshme morale, Perëndia do të sigurojë një mundësi që ata t’i përgjigjen Krishtit – disi, në ndonjë mënyrë, dikur.

2:28-29 “Sepse hebre nuk është...hebre është” Ky është një diskutim jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse disa teologë të ditëve të sotme përpiqen ta ndajnë ose izolojnë popullin e Perëndisë të DHV dhe popullin e Perëndisë të DHR. Ka vetëm një besëlidhje dhe një popull (krh. Rom. 9:6; Gal. 3:7-9, 29; 6:16; I Pjet. 3:6). Besëlidhja e re është një zhvillim dhe plotësim i të vjetrës. Populli i Perëndisë ka qenë gjithmonë i tillë me anë të besimit, jo me anë të prejardhjes racore. Ata janë “popull i zemrës” jo popull i ritualit apo i një race të caktuar. Besimi, jo prindi, është çelësi. Mendësia e besëlidhjes, jo shenja e besëlidhjes është shenja dalluese.

■ **“mish”** Shih Temën e Veçantë në 1:3.

2:29 Shenja e besëlidhjes e rrethprerjes (krh. Zan. 17:14) ishte një metaforë në DHV për hapjen e dikujt ndaj Perëndisë. Ajo u zhvillua në mënyrë metaforike në disa mënyra

1. rrethprerja e zemrës (krh. LiP. 10:16; 30:6; Jer. 4:4; 9:24-25)
2. rrethprerja e veshëve (krh. Jer. 6:10)
3. rrethprerja e buzëve (krh. Eks. 6:12, 30)

Ligji nuk u dha për të qenë një kod i jashtëm, por një marrëdhënie e përditshme, transformuese me YHWH që u zbulonte karakterin dhe premtimet e Tij të gjithë fëmijëve të Adamit. Shih Temë e Veçantë: Pikëpamja e Palit për Ligjin në 13:9.

■

NASB	“ajo që është e zemrës, me anë të Frymës, jo me anë të shkronjës”
NKJV	“ajo e zemrës, në Frymë, dhe jo në shkronjë”
NRSV	“një çështje e zemrës – është shpirtërore dhe jo e fjalëpërfjalshme/fizike”
TEV	“e cila është puna e Frymës së Perëndisë, jo e Ligjit të shkruar”
NJB	“në zemër — diçka jo nga shkronja, por nga fryma”

Kjo frazë është me dy kuptime në greqisht. Disa përkthime e marrin sikur i referohet shpirtërores përkundër të fjalëpërfjalshmes/fizikes (krh. NRSV, Dhiatën e Re të Shekullit të Njëzetë, përkthimin e Noksit, përkthimin

Lamsa të Peshitës, përkthimin Uilliams dhe Versionin e Ri Berkli¹. Përkthime të tjera e shohin sikur kontrasti është midis Frymës së Shenjtë (krh. 7:6; II Kor. 3:6, ku gjendet një konstrukcion i ngjashëm) dhe tekstit të shkruar (krh. NASB, NKJV, NEB, NIV dhe TEV). *The Jerome Biblical Commentary*, fq. 299, jep sugjerimin që bazuar në II Kor. 3:6 ishte mënyra metaforike/letrare e Palit për t'iu referuar Besëlidhjes së Vjetër dhe Besëlidhjes së Re; e para karakterizohet nga një kod i jashtëm dhe e dyta nga një mendje e re dhe një frymë e re e brendshme dhënë nga Fryma e Shenjtë në epokën e re të Frymës.

Pali ka qenë duke diskutuar faktin që disa johebrenj mund të sillen në mënyrë të pëlqyeshme për Perëndinë pa Ligjin. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë fëmijët e Perëndisë përfshinin më shumë sesa ata që ishin rrethprerë vetëm fizikisht (krh. Galatasve). Familja e Perëndisë është më e madhe sesa hebrenjtë (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5); Jobi, Melkisedeku, Jethroja, Kalebi, Rahabi dhe Ruthi nuk ishin hebrenj nga raca. Edhe fisi i Efraimit dhe Manasit ishin gjysmë egjiptianë (krh. Zan. 41:50-52).

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si e ndikon premtimin e Perëndisë mosbesnikëria e hebrenjve (3:3-4)?
2. A ka ndonjë avantazh përpara Perëndisë në qenien hebre (3:1-8)?
3. Çfarë është një diatrib?
4. Cili është qëllimi i atij që duket si diatrib në vv. 5-8?
5. A ka vërtet rëndësi mënyra si jeton nëse shfajësimi është me anë të hirit nëpërmjet besimit pa veprat (3:8)?
6. Cili është koncepti teologjik i korrupsionit total (3:10-18)?
7. Cili është qëllimi i Ligjit të Moisiut, ose i ligjit në përgjithësi (3:20; Gal. 3:24-25)?
8. Pse nuk përmendet fare Satani në kapitujt 1-3 të cilët trajtojnë gjendjen e humbur të njeriut?
9. A janë të kushtëzuara apo të pakushtëzuara premtimet e DHV?
10. Cili është qëllimi i Ligjit të Moisiut në jetën e: (1) johebrenjve; dhe (2) hebrenjve?
11. Përvijoni me fjalët tuaja argumentet e Palit në 1:18-3:20 paragraf pas paragrafi.

¹ Anglisht: NRSV, the Twentieth Century New Testament, the Knox translation, the Lamsa translation of the Peshitta, the Williams translation and the New Berkeley Version (shën. i përkth.).

ROMAKËVE 3

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Hebrenjtë dhe Ligji (2:17-3:8)	Mbrojtja e gjykit të Perëndisë	Avantazhi i hebrenjve	Hebrenjtë dhe Ligji (2:17-3:8)	Premtimet e Perëndisë nuk do t'i shpëtojnë ata
3:1-8	3:1-8	3:1-8	3:1-4 3:5-6 3:7-8	3:1-8
Nuk ka asnjë të drejtë	Të gjithë kanë mëkatuar	Të gjithë janë fajtorë	Asnjë njeri nuk është i drejtë	Të gjithë janë fajtorë
3:9-20	3:9-20	3:9-18 3:19-20	3:9-18 3:19-20	3:9-18 3:19-20
Drejtësi nëpërmjet besimit	Drejtësia e Perëndisë nëpërmjet besimit	Drejtësia e vërtetë	Si i drejtësoi Perëndia njerëzit	Zbulimi i gjykit të Perëndisë
3:21-26	3:21-26	3:21-26	3:21-26	3:21-26
	Mburra përjashtohet	Mburra është përjashtuar		Çfarë bën besimi
3:27-31	3:27-31	3:27-31	3:27-31	3:27-31

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Vargjet 1-8 janë të lidhura me njëri-tjetrin, por është e vështirë të ndjekësh logjikën e Palit, sepse ai po përdor një teknikë letrare të quajtur diatrib (një kundërshtues imagjinar).
- B. Duket sikur Pali po imagjnon se si do të reagojnë ndaj 2:17-29 disa hebrenj, kështu që ai u përgjigjet kundërshtimeve të tyre (Corley, Vaughan, *Romans*, fq. 37-39).
 1. Pyetja e parë. A nuk ka ndonjë avantazh për hebrenjtë? (vv. 1-2)

2. Pyetja e dytë. A ka dështuar Fjala e Perëndisë sepse disa hebrenj ishin jobesnikë? (vv. 3-4)
3. Pyetja e tretë. Nëse Perëndia i përdori hebrenjtë për të zbuluar karakterin e Tij, a janë ende ata përgjegjës para ligjit? (vv. 5-8)

C. Konkluzioni gjendet tek 2:11. Te Perëndia nuk ka anësi. Të gjithë njerëzit do të japin llogari nëse kanë jetuar ndryshe nga drita që u është dhënë (zbulesa natyrore dhe/ose zbulesa e veçantë).

D. Vargjet 9-18 përmbajnë një seri citimesh nga DHV që deklarojnë mëkatën e hebrenjve.

E. Vargjet 19-20 përmbledhin gjendjen shpirtërore të Izraelit dhe qëllimin e DHV (krh. Galatasve 3).

F. Vargjet 21-31 janë përmbledhja e 1:18-3:20. Ata janë pika e parë teologjike e ungjillit (shih përvijimin e shkurtër, fq. 2).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:1-8

¹Atëherë çfarë avantazhi ka hebreu? Ose cili është përfitimi i rrethprerjes? ²I madh në çdo aspekt. Para së gjithash, që atyre iu besuan orakujt e Perëndisë. ³Çfarë pastaj? Nëse disa nuk besuan, mosbesimi i tyre nuk do ta anulojë besnikërinë e Perëndisë, apo jo? ⁴Kurrë mos qoftë! Përkundrazi, le të dalë Perëndia i vërtetë, edhe sikur çdo njeri të dalë gënjeshtar, siç është shkruar, “QË TI TË SHFAJËSOHESH NË FJALËT E TUA, DHE TË TRIUMFOSH KUR TË GJYKOHESH.” ⁵Por, nëse padrejtësia jonë vë në pah drejtësinë e Perëndisë, çfarë do të themi? Perëndia që derdh zemërimin nuk është i padrejtë, apo jo? (Po flas në terma njerëzorë.) ⁶Kurrë mos qoftë! Sepse përndryshe, si do ta gjykojë Perëndia botën? ⁷Por nëse përmes gënjeshtërisë sime e vërteta e Perëndisë teproi për lavdinë e Tij, pse gjykojem ende si mëkatar? ⁸Dhe pse të mos themi (siç shpifin për ne dhe siç thonë disa se themi), “Le të bëjmë të keqen që të vijë e mira”? Dënimi i tyre është i drejtë.

3:1 “çfarë avantazhi ka hebreu” Pali po vazhdon të përdorë teknikën letrare të diatribit, ose të një kundërshtuesi imagjinar, për të komunikuar mesazhin e tij. Për një listë të privilegjeve të hebrenjve, shih 3:2 dhe 9:4-5. Pali e zhvillon këtë paragraf në kapitujt 9-11.

3:2 “Para së gjithash” Pali përdor “së pari” në 1:8, por pa përmendur atë që ishte së dyti. Ai bën të njëjtën gjë këtu. Shkrimi i Palit ishte shumë intensiv; shto edhe faktin që diktohej, dhe rezultati është që shpesh ndërtimet e tij gramatikore janë të paplota.

■ **“atyre iu besuan orakujt e Perëndisë”** Pasja e zbulesës së Perëndisë është një përgjegjësi e jashtëzakonshme, si edhe një privilegj i madh (krh. 9:4-5). Ata ishin administratorë të dhuratës së Perëndisë (AORISTE, PËSORE, krh. I Thes.2:4)

Fjala *logion* (orakuj) përdoret në Septuagintë për fjalë nga Perëndia (krh. Num. 24:4,16; LiP. 33:9; Ps. 107:11; 119:67; Isa. 5:24; 28:13), gjë që tregon DHV. Ajo përdoret vazhdimisht në të njëjtin kuptim në DHR (krh. Vep 7:38; Heb. 5:12; I Pjet. 4:11).

3:3 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË e cila merret e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Vargjet 5 dhe 7 janë gjithashtu FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË.

Gramatika e v. 3 pret një përgjigje “jo”.

■

NASB, NKJV “disa nuk besuan”

NRSV, NJB “disa ishin jobesnikë”

TEV “po sikur disa prej tyre të ishin jobesnikë”

Kjo mund t’i referohet ose (1) mosbesnikërisë së izraelitëve individualë, ose (2) mungesës së besimit personal në YHWH. Është e vështirë të bashkohet nga ana intelektuale premtimet e pakushtëzuara të Perëndisë

(d.m.th. shpengimin e një njerëzimi të rënë) dhe mandatin e kushtëzuar të reagimit njerëzor. Shih Temën e Veçantë: Besëlidhja në 9:4. Megjithatë ky është një paradoks biblik (krh. 3:4-5). Perëndia është besnik edhe kur njerëzit e Tij nuk janë (krh. Osea 1, 3; II Tim. 2:13).

■ “**anulojë**” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: ANULOJ DHE SHFUQIZOJ (*KATARGEË*)

Kjo (*katargeë*) ishte një nga fjalët e preferuara të Palit. Ai e përdori atë të paktën njëzet e pesë herë, por ajo ka një spektër shumë të gjerë semantik (kuptimor).

A. Rrënja e saj etimologjike është nga *argos* që kishte kuptimin

1. Joaktiv/e
2. Jo në punë
3. I/e papërdorur
4. I/e papërdorshëm/me
5. Joveprues/e

B. Bashkimi me *kata* përdorej për të shprehur

1. Mungesë aktiviteti
2. Papërdorshmëri/pavlefshmëri
3. Diçka që ishte anuluar
4. Diçka që ishte flakur tej
5. Diçka që ishte krejtësisht e paefektshme

C. Përdoret një herë te Luka për të përshkruar një pemë pa fryte, e si të tillë, të pavlerë (krh. Luka 13:7)

D. Pali e përdor në kuptim figurativ në dy mënyra kryesore

1. Perëndia i bën jovepruese gjërat që janë armiqësore ndaj njerëzimit
 - a. Natyrën mëkatore të njerëzimit – Rom. 6:6
 - b. Ligjin e Moisiut në lidhje me premtimin nga Perëndia të “farës” – Rom. 4:14; Gal. 3:17; 5:4, 11; Efe. 2:15
 - c. Forcat frymërore – I Kor. 15:24
 - d. Njeriun e “pau dhë” – II Thes. 2:8
 - e. Vdekjen fizike – I Kor. 15:26; II Tim. 1:16 (Heb. 2:14)
2. Perëndia zëvendëson të vjetrën (besëlidhjen, epokën) me të renë
 - a. Gjërat e lidhura me Ligjin e Moisiut – Rom. 3:3,31; 4:14; II Kor. 3:7,11,13,14
 - b. Analogjia e martesës përdoret për Ligjin – Rom. 7:2,6
 - c. Gjërat e kësaj epoke – I Kor. 13:8,10,11
 - d. Këtë trup – I Kor. 6:13
 - e. Udhëheqësit e kësaj epoke – I Kor. 1:28; 2:6

Kjo fjalë përkthehet në shumë mënyra të ndryshme, por kuptimi i saj kryesor është ta bësh diçka të padobishme, të zhvlerësuar dhe të shfuqizuar, jovepruese, të pafuqishme, por jo patjetër joekzistente, të shkatërruar apo të asgjësuar.

■ “**besnikërinë e Perëndisë**” Kjo e vërtetë (krh. I Kor. 1:9; 10:13; II Kor. 1:18) është themelore për besimin e njerëzve në

1. karakterin e pandryshueshëm dhe
2. premtimet e përjetshme

të Perëndisë (krh. LiP. 7:9; Isa. 49:7). Ai e ka zbuluar Vetën e Tij në krijim, në zbulesë, në besëlidhje dhe në Mesian! Edhe në mes të mosbesnikërisë njerëzore, Ai mbetet besnik (krh. II Tim. 2:13)!

3:4

NASB
NKJV, TEV
NRSV

“Kurrë mos qoftë!”
“Patjetër që jo!”
“Në asnjë mënyrë!”

NJB

“Kjo do të ishte absurde.”

Ky është një përdorim i rrallë i MËNYRËS DËSHIRORE e cila shpreh një dëshirë ose një lutje dhe kjo frazë duhet përkthyer, “Kurrë mos qoftë!” Ajo mund të reflektojë një idiomë hebraike. Kjo frazë e “mosbesimit të habitur” përdoret shpesh nga Pali për shkak të teknikës së tij letrare të diatribit (krh. 3:4,6,31; 6:2,15; 7:7,13; 9:14; 11:1; I Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Ishte mënyra e tij për të mohuar në mënyrë kategorike një thënie supozuese.

Vini re mënyrat letrare si Pali hedh poshtë pyetjet dhe deklaratat e kundërshtuesit imagjinar.

1. “Kurrë mos qoftë,” vv. 4,6
2. “le të dalë Perëndia i vërtetë, edhe sikur çdo njeri të dalë gënjeshtar,” v. 4
3. “(Po flas në terma njerëzorë),” v. 5
4. “(siç shpifin për ne dhe siç thonë disa se themi),” v. 8

▣ **“le të dalë Perëndia i vërtetë, edhe sikur çdo njeri të dalë gënjeshtar”** Kjo është URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE. Ky ndërtim fokusohet në gjendjen e vazhdueshme të kryefjalës; Perëndia është besnik dhe i vërtetë (shih Temën e Veçantë në 1:18), njerëzit janë jobesnikë dhe gënjeshtarë! Ky është një aluzion ndaj Psalmi 116:11 dhe është i ngjashëm me atë që iu desh Jobit të mësonte në 32:2; 40:8.

Vini re elementin universal të mëkatshmërisë në këtë kapitull, përfaqësuar nga përdorimi nga ana e Palit të *pas* (të gjitha, çdo) në vv. 4,9,12,19,20,23,24, por lavdi Perëndisë, gjithashtu edhe ofertën universale të shpëtimit ndaj të gjithëve (krh. 3:22).

▣ **“siç është shkruar”** Fjalë për fjalë, “ka qenë dhe vazhdon të jetë shkruar.” Kjo është një formë në MËNYRËN DËFTORE KOHA E TASHME DIATEZA PËSORE. Ajo u bë një idiomë teknike e përdorur për të pohuar frymëzimin e Shkrimeve nga Perëndia (krh. Mat. 5:17-19). Ajo prezanton një citim nga Psalmi 51:4 nga Septuaginta (LXX).

3:5-6 Argumenti që Pali po shtjellon në këto vargje lidhet me zgjedhjen e veçantë të Izraelit si mjeti i Tij për arritjen e botës (krh. Zan. 12:3; Eks. 19:5-6). Në DHV “zgjedhja” i referohej shërbimit, jo privilegjit të veçantë. Perëndia bëri një besëlidhje me ta. Ai ishte besnik; ata ishin jobesnikë (krh. Nehemia 9). Fakti që Perëndia i gjykoj izraelitët jobesnikë është provë e drejtësisë së Tij.

Izraeli duhej të ishte një mjet për arritjen e johebrenjve. Ata dështuan (krh. 3:24)! Qëllimi i Perëndisë për shpëtimin universal (krh. Zan. 3:15) nuk ndikohet nga dështimi i Izraelit. Në fakt, besnikëria e Perëndisë ndaj besëlidhjes së Tij fillestare konfirmohet te Rom 9-11. Izraeli mosbesues hidhet poshtë, por një Izrael besues do të kulminojë planin e shpengimit të Perëndisë.

Diatribi i Palit në vv. 5-6 paralelizohet në vv. 7-8.

3:5 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Vargjet 3 dhe 7 janë gjithashtu FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË.

▣ **“nëse padrejtësia jonë vë në pah drejtësinë e Perëndisë”** Ky PËREMËR, “jonë,” duhet t’i referohet në një kuptim kolektiv të gjithë hebrenjve. Shih Temën e Veçantë në 1:17.

▣ **“çfarë do të themi”** Pali po përdor ende diatrib (krh. 3:5; 7:7; 8:31; 9:14,39). Pali po e qartëson prezantimin e tij duke përdorur një kundërshtues imagjinar (krh. Mal. 1:2,6,7,12,13; 2:14,17 [dy herë]; 3:7,13,14).

▣

NASB	“(Po flas në terma njerëzorë)”
NKJV	“(Flas si njeri)”
NRSV	“(Flas në mënyrë njerëzore)”
TEV	“(Këtu flas siç flasin njerëzit)”
NJB	“ – për të përdorur një analogji njerëzore – ”

Pali shpesh përdori logjikën njerëzore në argumentet e tij teologjike (krh. 6:19; I Kor. 9:8; Gal. 3:15). Këtu kjo funksionon si një mënyrë për të hedhur poshtë pohimet e kundërshtuesit imagjinar.

3:7-8 Ka një paralel të qartë midis vv. 5 dhe 7 (të dy fillojnë me *ei de*). Pali ose

1. po vazhdon të përdorë teknikën letrare të diatribit, një kundërshtues imagjinar (krh. 3:5,7; 7:7; 8:31; 9:14,30), ose
2. po reagon ndaj kritikës që i bëhet predikimit të tij të shfajësimit/drejtësisimit vetëm me anë të besimit (krh. v. 8)

Pali nuk shpjegohet dhe as i përgjigjet akuzës me detaje, por dënon me forcë akuzimin. Është e mundur që kundërshtimi ndaj një shfajësimi falas me anë të besimit ishte që kjo do të çonte në shthurje ose në më shumë mosbindje pa besim. Pali besonte se hiri falas do të çonte në ngjashmëri me Krishtin përmes një fryme të re dhe një jete mirënjohëse! Hebrejtë, moralistët grekë dhe Pali donin një jetë me etikë në të kthyerit e tyre! Por ajo vjen, jo nga konformizmi me një kod të jashtëm, por nga një zemër e re, një mendje e re dhe një shpirt i ri (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-36).

3:7 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË (gjithashtu vv. 3 dhe 5) që supozohet si e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare.

■ **“teproi”** Shiko Temën e Veçantë të 15:13.

■ **“lavdinë e Tij”** Shiko shënimin tek 3:23.⁹

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 3:9-18

⁹Çfarë atëherë? A jemi ne më të mirë se ata? Aspak; sepse tashmë e kemi thënë se si hebrejtë edhe grekët janë të gjithë nën mëkat; ¹⁰siç është shkruar, “NUK KA ASNJË TË DREJTË, AS EDHE NJË; ¹¹NUK KA ASNJË QË TË KUPTOJË, NUK KA ASNJË QË TË KËRKOJË PERËNDINË; ¹²TË GJITHË KANË DEVIJUAR, SË BASHKU JANË BËRË TË PADOBISHËM; NUK KA ASNJË QË TË BËJË TË MIRËN, AS EDHE NJË.” ¹³“GRYKA E TYRE ËSHTË NJË VARR I HAPUR, ME GJUHËT E TYRE ATA VAZHDOJNË TË MASHTROJNË,” “HELM GJARPËRINJSH KA NËN BUZËT E TYRE”; ¹⁴“GOJËT E TYRE JANË PLOT MALLKIM DHE HIDHËSI”; ¹⁵KËMBËT E TYRE JANË TË SHPEJTA PËR TË DERDHUR GJAK, ¹⁶SHKATËRRIM DHE MJERIM KA NË SHTIGJET E TYRE, ¹⁷DHE SHTEGUN E PAQES NUK E KANË NJOHUR.” ¹⁸“NUK KA FRIKË PERËNDIE PARA SYVE TË TYRE.”

3:9 “A jemi ne më të mirë se ata” Gramatika në këtë pikë është me dy kuptime. Është e qartë që e vërteta kryesore e këtij pasazhi është që i gjithë njerëzimi ka nevojë për hirin e Perëndisë (krh. 3:9,19,23; 11:32; Gal. 3:22). Megjithatë, është e paqartë nëse referenca specifike është ndaj hebrejve (Palit dhe faresit të tij, krh. TEV, RSV) apo të krishterëve (Palit dhe bashkëbesimtarëve pa marr parasysh hirin e Perëndisë). Hebrejtë kishin në të vërtetë disa avantazhe (krh. vv. 1-2; 9:4-5), por këto avantazhe i bënin ata edhe më përgjegjës (krh. Luka 12:48)! Të gjithë njerëzit janë të humbur shpirtërisht dhe kanë nevojë për hirin e Perëndisë.

Termi “më të mirë” kuptohet nga një pakicë studiuesish si DIATEZA PËSORE në vend të asaj JOVEPRORE (“më mirë”), gjë që rezulton në përkthimin “na e kalojnë” ose “jemi mbrapa...”

Është thënë shpesh se Romakëve është më neutralja lokalisht nga letrat e Palit. Pjesa më e madhe e letrave të Palit i adresohet një nevojë apo krize lokale (dokumente të rastit). Megjithatë, në sfondin e kapitujve 1-3 dhe 9-11 mund të jetë xhelozia midis udhëheqësve hebrej dhe udhëheqësve johebrej në kishën në Romë.

■ **“sepse tashmë e kemi thënë se si hebrejtë edhe grekët janë të gjithë nën mëkat”** Kjo folje (AORISTE JOVEPRORE) [deponente] DËFTORE) gjendet vetëm këtu në DHR. Pali po i referohet argumentit të tij të gjatë të 1:18-2:29.

■ **“nën mëkat”** Pali e personifikon “mëkatin” (*Jerome Biblical Commentary*, fq. 300) si një qehaja mizor mbi njerëzimin e rënë (krh. 6:16-23).

3:10-18 “siç është shkruar” Kjo frazë ndeshet edhe në v. 4. Deklaratat e mëposhtme janë një seri citimesh nga DHV që përdorin metafora të trupit njerëzor për të theksuar gjendjen e rënë të njerëzimit.

1. vv. 10-12, Pred. 7:20 ose Ps. 14:1-3
2. v.13, Ps. 5:9 dhe 140:3
3. v.14, Ps. 10:7
4. vv. 15-17, Isa. 59:7-8 dhe Fja. 1:16

5. v.18, Ps. 36:1
Është për t'u habitur që Pali nuk përdori Isa. 53:6.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:19-20

¹⁹Tani ne e dimë se gjithçka që thotë Ligji, ua thotë atyre që janë nën Ligj, në mënyrë që çdo gojë të mbyllet dhe e gjithë bota t'i japë llogari Perëndisë; ²⁰sepse me anë të veprave të Ligjit asnjë mish nuk do të shfajësohet para syve të Tij; sepse përmes Ligjit vjen njohja e mëkatit.

3:19 “ne e dimë se” Shih shënimin te 2:2.

▣ “**Ligji**” Në këtë kontekst kjo duhet t'i referohet të gjithë DHV (krh. v. 21) për shkak të pasazheve që nuk janë në Pentatuk të cituara në vv. 10-18. Pali e personifikon “ligjin” siç bëri edhe me “mëkatit” në v. 9 (krh. 6:16-23).

▣ “**atyre që janë nën Ligj**” Kjo i referohet ekskluzivisht hebrenjve dhe të kthyerve në besimin judaik nga johebrenjtë. Megjithëse duhet thënë se disa nga citimet e DHV të përdorura u referohen johebrenjve në kontekstin e tyre origjinal. Të gjithë njerëzit janë mëkatarë (krh. 3:23)!

▣

NASB	“në mënyrë që çdo gojë të heshtë dhe e gjithë bota t'i japë llogari Perëndisë”
NKJV	“që çdo gojë të mbyllet, dhe e gjithë bota të mund të bëhet fajtores para Perëndisë”
NRSV	“në mënyrë që çdo gojë të heshtë dhe e gjithë bota të mund t'i japë llogari Perëndisë”
TEV	“me qëllim që të ndalojë të gjitha justifikimet njerëzore dhe ta sjellë të gjithë botën nën gjykimin e Perëndisë”
NJB	“por ka si qëllim të bëjë çdo njeri të heshtë dhe ta hapë të gjithë botën ndaj gjykimit të Perëndisë”

Kjo është ideja madhore e kapitullit 1:18-3:20 që përmbledhet në 3:23.

▣ “**çdo gojë**” Janë disa fraza në vv. 19-20 që përshkruajnë të gjithë njerëzimin.

1. “çdo gojë,” v. 19
2. “e gjithë bota,” v. 19
3. “asnjë mish,” v. 20

3:20 “sepse me anë të veprave të Ligjit asnjë mish nuk do të shfajësohet para syve të Tij” Ky është një aluzion ndaj Psalmit 143:2 (gjithashtu vini re Jobi 4:17; 9:2; 25:4; Ps. 130:3; Fja. 20:9; Pred. 7:20; I Mbr. 8:46; II Kro. 6:36), por me një frazë hyrëse të shtuar. Ky ishte një aspekt madhor i ungjillit të Palit (krh. Gal. 2:16; 3:11). Si një Farise i përkushtuar, Pali e njihte shumë mirë paaftësinë e entuziazmit fetar dhe mbajtjes së hollësishme të rregullave për të sjellë paqe të brendshme.

Për “mishi” shihni Temën e Veçantë në 1:3.

▣

NASB, NRSV	“përmes Ligjit vjen njohja e mëkatit”
NKJV	“sepse nga Ligji është njohja e mëkatit”
TEV	“ajo që bën Ligji është ta bëjë njeriun të dijë se ka mëkatuar”
NJB	“gjithçka që bën ligji është të na thotë se çfarë është e mëkatshme”

Ky ishte një nga qëllimet e DHV. Shih Temën e Veçantë në 13:9. Ai nuk kishte kurrë qëllim t'i sillte shpëtim njerëzimit të rënë. Qëllimi i tij ishte të zbulonte mëkatshmerinë dhe t'i shtynte të gjithë njerëzit tek mëshira e YHWH (krh. 4:15; 5:13,20; 7:7; Gal. 3:19-22, 23-29).

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si i ndikon mosbesnikëria e hebrenjve premtimet e Perëndisë? (3:3-4)
2. A ka ndonjë avantazh para Perëndisë të qenit hebre? (3:1-8)
3. Cila është ideja e kundërshtimit të supozuar (diatribit) në vv. 5-8?
4. A ka rëndësi se si jeton dikush nëse shfajësimi është me anë të hirit, nëpërmjet besimit pa veprat (krh. 3:8)?
5. Përshkruani konceptin teologjik (të Kalvinit) të shthurjes totale (krh. 3:10-18).
6. Cili është qëllimi i Ligjit të Moisiut, ose ligjit në përgjithësi (krh. 3:20; Gal. 3:24-25)?
7. Pse nuk përmendet fare Satani në kapitujt 1-3 që trajtojnë gjendjen e humbur të njerëzimit?

UDHËZIME KONTEKSTUALE PËR ROMAKËVE 3:21-31

- A. Romakëve 3:21-31
1. përmbledhja kulmore e 1:18-3:20
 2. një amplifikim i 1:16-17
 3. një hyrje për kapitujt 4-8 (sid. 3:28)
- B. Kjo përmbledhje kulmore e doktrinës së shfajësimit me anë të hirit nëpërmjet besimit u karakterizua nga Reformatorët
1. Martin Luteri si “ideja kryesore dhe vendi qendror i letrës dhe i gjithë Biblës”
 2. Zhan Kalvin si “ndoshta nuk ka në të gjithë Biblën një pasazh që e parashtron më thellësisht drejtësinë e Perëndisë në Krishtin”
- C. Ky është vetë thelbi teologjik i krishtërimin. Të kuptosh këtë kontekst është të kuptosh krishtërimin. Ky është ungjilli në një përmbledhje prej dy paragrafësh siç është Gjoni 3:16 ungjilli në një varg. Kjo është zemra dhe shpirti i paraqitjes së ungjillit nga Pali. Tre pyetjet kyçe interpretuese janë:
1. Çfarë do të thotë termi “ligj”?
 2. Çfarë do të thotë fraza “drejtësia e Perëndisë”?
 3. Çfarë kuptimi kanë termat “besim” dhe “besoj”?
- D. E falenderoj Perëndinë për fjalën “të gjithë” në v. 22 (krh. v. 29) dhe fjalën “dhuratë” në v. 24 (krh. 5:15, 17; 6:23).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:21-26

²¹Por tani veçan nga Ligji është shfaqur drejtësia e Perëndisë, që dëshmohet nga Ligji dhe Profetët, ²²drejtësia e Perëndisë përmes besimit në Jezu Krishtin për të gjithë ata që besojnë; sepse nuk ka dallim; ²³sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë, ²⁴për t'u shfajësuar si dhuratë me anë të hirit të Tij përmes shpengimit që është në Krishtin Jezu; ²⁵të Cilin Perëndia e shfaqti publikisht si një pajtimorë në gjakun e Tij përmes besimit. *Kjo u bë për të demonstruar drejtësinë e Tij, sepse në durimin e Perëndisë Ai i mbikaloi mëkatet e kryera më parë; ²⁶për demonstrim, *them*, të drejtësisë së Tij në kohën e tanishme, në mënyrë që Ai të jetë i drejtë dhe shfajësues i atij që ka besim në Jezusin.*

3:21 “Por tani” Pali po kontraston Besëlidhjen e Vjetër me Besëlidhjen e Re, epokën e vjetër të rebelimit, me epokën e re të drejtësisë. Kjo është paralel me “në kohën e tanishme” (krh. v. 26; “por tani” të 6:22; 7:6).

■ **“tani veçan nga Ligji”** Shpesh është e vështirë të jesh i sigurt nëse Pali po i referohet Ligjit të Moisiut (NASB) apo ligjit në përgjithësi (NRSV, TEV, NJB, NIV) në këta kapituj hyrës. Në këtë kontekst Ligji Hebre i përshtatet më mirë argumentit të Palit. Të gjithë njerëzit kanë shkelur çdo komplet udhëzimesh morale apo shoqërore, qoftë

të brendshme, qoftë të jashtme. Problemi ynë si njerëzim i rënë është që ne nuk duam udhëzime fare përveç dëshirave tona egoiste dhe ego-centrike (krh. Zanafilla 3) që e karakterizon kaq mirë individualizmin e sotëm perëndimor.



NASB “drejtësia e Perëndisë”

NKJV, NRSV “drejtësia e Perëndisë”

TEV “mënyra e Perëndisë për t’i vendësuar njerëzit në një pozitë të drejtë me Vetën”

NJB “drejtësia shpëtuese e Perëndisë”

Fjala “drejtësi” nuk ka NYJE shquese. Kjo nuk i referohet karakterit të Perëndisë, por mënyrës së Perëndisë për t’iu dhënë falje dhe pranim njerëzve mëkatarë. Pikërisht kjo frazë u përdor në lajtmotivin teologjik të Rom. 1:16-17. Mekanizmi i zbuluar qartë është besimi në Jezu Krishtin e kryqëzuar (krh. v. 22, 24-26).

Fakti që ky term (*dikaioisunē*) dhe fjalët e prejardhura prej tij (shih shënimin në 2:13) përdoren kaq shpesh në këtë kontekst tregon rëndësinë e tij (krh. 1:17; 3:5,21,22,25,26;4:3,5,6,9,11,13,22; 5:17,21; 6:13,16,18,19,20; 8:10; 9:28,30,31; 10:3,4,5,6,10,17). Ky term grek vjen nga një metaforë ndërtimi e DHV (*tsadak*) e “një standardi” apo “kallami matës” (shih Temën e Veçantë në 1:17). Standardi është vetë Perëndia. Ky term reflekton karakterin e Perëndisë i cili i jepet falas gjithë njerëzimit të rënë përmes Krishtit (krh. kap. 4; II Kor. 5:21). Pohimi i nevojës dhe pranimi i dhuratës së Perëndisë ishte, dhe është, kaq përlules për njerëzimin krenar, ego-centrik – sidomos për atë legalist dhe fetar.

■ **“është shfaqur”** Kjo frazë është shumë e ngjashme me 1:17. Megjithatë, KOHA E FOLJES është e ndryshme. FOLJA këtu mund të përkthehet, “ka qenë shfaqur dhe vazhdon të shfaqet qartë.” Është NË MËNYRËN DËFTORE, DIATEZA PËSORE, KOHA E KRYER, kurse sinonimi në 1:17 është DËFTORE, PËSORE E TASHME. Perëndia e ka zbuluar qartë ungjillin edhe në DHV (krh. kapitullin 4) edhe në Jezusin.

■ **“që dëshmohet nga Ligji dhe Profetët”** Ligji dhe Profetët ishin dy nga tre ndarjet e kanonit hebraik (Ligji, Profetët dhe Shkrimet). Këta dy të parët përdorshin për t’iu referuar të gjithë kanonit (shih shënimet në 3:19; Mat. 5:17). Kjo tregon qartë se ungjilli përmbahej në formë paraprake në DHV (krh. Luka 24:27,44; Veprat 10:43). Ai nuk ishte një mendim i mëpasmë, “Plani B,” ose një program emergjent i minutës së fundit (krh. 1:2).

3:22 “përmes besimit në Jezu Krishtin” Kjo është fjalë për fjalë “përmes besimit të Jezu Krishtit.” Është një ndërtim i RASËS GJINORE. Ai përsëritet te Gal. 2:16 dhe Fil. 3:9 si edhe me një formë të ngjashme te Rom. 3:26; Gal. 2:16,20; 3:22. Ai mund të ketë kuptimin

1. besimi apo besnikëria e Jezusit (gjinore subjektive/kryefjalore)
2. Jezusi si objekti i besimit tonë (gjinore objektive/kundrinore)

I njëjti ndërtim gramatikor te Gal. 2:16 e bën numrin 2 zgjedhjen më të mirë.

Kjo tregon aspektin kryesor të shfajësimit të Perëndisë. Është drejtësia e Perëndisë e bërë vepruese në jetën e dikujt me anë të dhuratës falas të Perëndisë përmes Krishtit (krh. 4:5; 6:23), e cila duhet pranuar me anë të besimit/zënies besë (krh. Efe. 2:8-9) dhe duhet jetuar në jetën e përditshme (krh. Efe. 1:4; 2:10).

■ **“për të gjithë”** Ungjilli është për të gjithë njerëzit (krh. v. 24; Isa. 53:6; Ezek. 18:23,32; Gjoni 3:16-17; 4:42; I Tim.2:4; 4:10; Titit 2:11; II Pjet. 3:9; I Gjonit 2:1; 4:14). Çfarë e vërtete e mrekullueshme! Kjo duhet të balancojë të vërtetën biblike të zgjedhjes. Zgjedhja e Perëndisë nuk duhet kuptuar në sensin islamik të determinizmit dhe as në sensin ultra-Kalvinist të disave përkundër të tjerëve, por në sensin besëlidhor. Zgjedhja e Dhiatës së Vjetër ishte për shërbim, jo për privilegj! Perëndia premtoi të shpengonte të gjithë njerëzimin e rënë (krh. Zan. 3:15). Perëndia e thirri dhe e zgjodhi të gjithë njerëzimin përmes Izraelit (krh. Zan. 12:3; Eks. 19:5-6). Perëndia zgjedh përmes besimit në Krishtin. Perëndia gjithmonë merr iniciativën në shpëtim (krh. Gjoni 6:44,65). Efesianëve 1 dhe Romakëve 9 janë pasazhet më të forta biblike mbi doktrinën e paracaktimit që u theksua teologjikisht nga Augustini dhe Kalvini.

Perëndia i zgjodhi besimtarët jo vetëm për shpëtim (shfajësim), por edhe për shenjtërim (krh. Efe. 1:4; Kol. 1:12). Kjo mund të lidhet me

1. pozicionin tonë në Krishtin (krh. II Kor. 5:21)
2. dëshirën e Perëndisë për të riprodhuar karakterin e Tij në fëmijët e Tij (krh. Rom. 8:28-29; Gal. 4:19; Efe. 2:10)

Vullneti i Perëndisë për fëmijët e Tij është edhe parajsa një ditë, edhe ngjashmëria me Krishtin tani!

Synimi i paracaktimit është shenjtëria (krh. Efe. 1:4), jo privilegji! Thirrja e Perëndisë nuk ishte ndaj pak të zgjedhurve nga fëmijët e Adamit, por ndaj të gjithëve! Ajo ishte një thirrje për te karakteri i vetë Perëndisë (krh. I Thes. 5:23; II Thes. 2:13). Ta kthesh paracaktimin në një tezë teologjike në vend të një jete të shenjtë është një tragedi e sistemeve teologjike njerëzore. Shpesh syzet tona teologjike i shtrembërojnë tekstet biblike!

Shih Temën e Veçantë: Zgjedhja/paracaktimi dhe nevoja për një balancë teologjike te 8:33.

■ **“që besojnë”** Jezusi vdiq për të gjithë njerëzit. Potencialisht të gjithë mund të shpëtohen. Është pranimi personal i njerëzimit (PËRCJELLORE, shih Temën e Veçantë në 10:4) ai që e bën drejtësinë e Jezusit të aplikueshme për jetët e tyre (krh. 1:16; Gjoni 1:12; 3:16;20:31; Rom. 10:9-13; I Gjonit 5:13). Bibla paraqet dy kritere për drejtësinë e veshur/e atribuar/e llogaritur: besimin dhe pendimin (krh. Marku 1:15; Veprat 3:16,19;20:31 dhe shih shënimin në 1:5). Ky tekst e zbulon qartë ofertën universale të shpëtimit, por tragjedia dhe misteri është që jo të gjithë do të shpëtohen.

■ **“sepse nuk ka dallim”** Ka vetëm një mënyrë dhe një Person me anë të të Cilit njerëzit (hebrenj dhe johebrenj) mund të shpëtohen (krh. Gjoni 10:1-2,7; 11:25; 14:6). Të gjithë dhe kushdo mund të shpëtohen me anë të besimit në Krishtin (krh. 1:16; 4:11,16; 10:4,12;Gal. 3:28; Kol. 3:11).

3:23-26 Kjo është një fjali në greqisht.

3:23

NASB, NKJV,

NRSV

“sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë”

TEV

“të gjithë njerëzit kanë mëkatuar dhe janë larg nga”

NJB

“mëkatuan dhe e humbën”

Kjo është një përmbledhje e 1:18-3:20. Çdo njeri ka nevojë të shpëtohet nga Krishti (krh. 3:9,19; 11:32; Gal. 3:22; Isa. 53:6). “Mëkatuan” është në AORISTE DËFTORE VEPROR, kurse “vazhdon të mos e arrijë” është DËFTORE E TASHME JOVEPROR. Ndoshta kjo frazë i referohet edhe (1) rënies kolektive të njerëzimit në Adamin (krh. 5:12-21) edhe (2) veprave të tij të vazhdueshme individuale të rebelimit. Asnjë nga këto përkthime të sotme të anglishtes nuk e reflekton në mënyrë specifike këtë dallim.

Ky varg lidhet teologjikisht me v. 21 dhe jo drejtpërdrejt me v. 24.

■ **“lavdinë e Perëndisë”** Njerëzit u krijuan në imazhin e Perëndisë (krh. Zan. 1:26-27), gjë që nuk ishte e vërtetë për ndonjë gjë tjetër të krijuar. Njerëzit duhej të kishin bashkësi me Perëndinë e lavdisë dhe të reflektonin karakterin e Tij! Mëkati e dëmtoi imazhin, por hiri i Perëndisë përmes vdekjes së Krishtit dhe besimit të besimtarëve e ka restauruar imazhin (krh. Kol. 3:10).

Në DHV fjala më e zakonshme hebraike për “lavdi” (*kbd*) ishte fillimisht një term komercial (që i referohej një peshoreje) që do të thoshte “të jesh i rëndë.” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: LAVDIA

Koncepti biblik i “lavdisë” është i vështirë për t’u përkufizuar. Lavdia e besimtarëve është që ata e kuptojnë ungjillin dhe lëvdohen në Perëndinë, jo në veten e tyre (krh. Jer. 9:23-24).

Në DHV fjala më e zakonshme hebraike për “lavdi” (*kbd*, BDB 217) ishte fillimisht një term komercial i lidhur me peshoret (“të jesh i rëndë”). Ajo që ishte e rëndë ishte e çmuar ose kishte vlerë të brendshme. Shpesh koncepti i shkëlqyeshmërisë i shtohet fjalës për të shprehur madhështinë e Perëndisë (krh. Eksodi 19:16-18; 24:17; Isa. 60:1-2). Vetëm Ai është i denjë dhe i nderueshëm. Ai është tepër i shkëlqyeshëm për sytë e njerëzimit (krh. Eks. 33:17-23; Isa. 6:5). YHWH mund të njihet me të vërtetë vetëm përmes Krishtit (krh. Gjoni 14:8-11; Kol. 1:15; Heb. 1:3; Jak. 2:1).

Termi “lavdi” është disi i dykuptimshëm.

1. ai mund të jetë paralel me “drejtësinë e Perëndisë”
2. ai mund t’i referohet “shenjtërisë” apo “përsosmërisë” së Perëndisë

3. ai mund t'i referohet imazhit të Perëndisë në të cilin u krijua njerëzimi (krh. Zan. 1:26-27; 5:1; 9:6), por që më vonë u shtrembërua nga rebelimi (krh. Zan. 3:1-22).

Është përdorur fillimisht për praninë e YHWH me popullin e Tij gjatë periudhës së endjeve në shkretëtirë tek Eks. 16:7, 10; Lev. 9:23; dhe Num. 14:10.

3:24 “duke qenë shfajësuar si dhuratë me anë të hirit të Tij” Kjo është një PËRCJELLORE PËSORE. Këtu fillon ungjilli – hiri i Perëndisë që jep drejtësi (krh. 5:15-17; 6:23; Efe. 2:8-9). Termi grek “shfajësoj” (*dikaioō*) ishte nga e njëjta rrënjë si “drejtësi” (*dikaosunē*, shih Temën e Veçantë në 1:17). Perëndia e merr iniciativën gjithmonë (krh. Gjoni 6:44,65).

Në vargjet 24-25 ka tre metafora që përdoren për të përshkruar shpëtimin.

1. “të shfajësuar” që ishte një term ligjor që donte të thoshte “të mos i japësh dënim” ose ta shpallësh dikë jo fajtor
2. “shpengim” që ishte nga tregu i skllevërve dhe donte të thoshte “i riblerë” ose “të çlirosh”
3. “pajtimore/pajtues” e cila ishte nga sistemi i flijimeve dhe donte të thoshte vendi i mbulimit apo i shlyerjes

Ajo i referohej kapakat të Arkës së Besëlidhjes ku vendosej gjaku i flijimeve Ditën e Shlyerjes (krh. Levitiku 16; Heb. 9:5).

TEMË E VEÇANTË: PROVA TË DHR PËR SHPËTIMIN PERSONAL

Bazohet në Besëlidhjen e Re (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) në Jezusin:

1. në karakterin e Atit (shih Gjoni 3:16), veprën e Frymës (shih 2 Kor. 5:21) dhe shërbesën e Frymës (shih Rom. 8:14-16), jo në përpjekjet njerëzore, as në shpërblimin për shkak të bindjes, as në kredot
2. është dhuratë (shih Rom. 3:24; 6:23; Efe. 2:5, 8-9)
3. është jetë e re, botëkuptim i ri (shih Jakobi dhe 1 Gjonit)
4. është njohuri (ungjilli), bashkësi (besimi në dhe me Jezusin) dhe stil i ri jetese (ngjashmëri me Krishtin, nën udhëheqjen e Frymës); të tria së bashku, jo njëra në dallim nga të tjerat
5. Shih provat e shpëtimit të vërtetë në Mësimet Kontekstuale në 1 Gjonit 2:3-27, C.

■ **“dhuratë”** Pali e përdor këtë koncept disa herë duke përdorur terma të ndryshëm.

1. *dōrean*, NDAJFOLE, “lirisht”
2. *dōrea*, EMËR, “dhuratë falas”
3. *dōron*, EMËR, “dhuratë” (krh. Efe. 2:8)
4. *charisma*, EMËR, “borxh falas” ose “nder/favor falas” (krh. 1:11; 5:15,16; 6:23; 11:29; 12:6)
5. *charisomai*, FOLJE, “jap si një nder/favor falas” (krh. 8:32)
6. *charis*, EMËR, “nder/favor falas” ose “dhuratë falas” (krh. 4:4,16; 11:5,6; Efe. 2:5,8)

■ **“përmes shpengimit që është në Krishtin Jezus”** Mekanizmi për shpëtimin tonë është vdekja zëvendësuese dhe ringjallja e Jezusit. Fokusi biblik nuk është mbi atë se sa u pagua ose kujt iu pagua çmimi (Augustini), por në faktin që njerëzimi është çliruar nga faji dhe ndëshkimi i mëkatit me anë të një zëvendësuesi të pafajshëm (krh. Gjoni 1:29,36; II Kor. 5:21; I Pjet. 1:19).

Vargu gjithashtu tregon shtrenjtësinë e Zan. 3:15. Jezusi mbarti mallkimin (krh. Gal. 3:13) dhe vdiq (krh. II Kor. 5:21) si një zëvendësues për njerëzimin e rënë. Shpëtimi mund të jetë falas, por sigurisht që nuk ka kushtuar lirë.

TEMË E VEÇANTË: SHPËRBLEJ/SHPENGOJ

I. DHIATA E VJETËR

- A. Ka kryesisht dy terma ligjorë hebraikë që e përcjellin këtë koncept.

1. *Ga'al* (BDB 145, I), i cili pak a shumë do të thotë “të çlirosh dikë duke paguar një çmim.” Një formë e termit *go'el* i shton konceptit një ndërmjetës personal, zakonisht një anëtar i familjes (d.m.th. një i afërm shpengues). Ky aspekt kulturor i të drejtës për të riblerë objekte, kafshë, tokë (krh. Levitiku 25,27), ose të afërm (krh. Ruthi 4:15; Isa. 29:22) i transferohet teologjikisht çlirimit nga YHWH të Izraelit nga Egjipti (krh. Eks. 6:6; 15:13; Ps. 74:2; 77:15; Jer. 31:11). Ai bëhet “shpenguesi” (krh. Jobi 19:25; Ps. 19:14; 78:35; Fja. 23:11; Isa. 41:14; 43:14; 44:6,24; 47:4; 48:17; 49:7,26; 54:5,8; 59:20; 60:16; 63:16; Jer. 50:34).
2. *Padah* (BDB 804), i cili pak a shumë ka kuptimin “të çlirosh” ose “të shpëtosh nga rreziku”
 - a. Shpengimi i të parëlindurve (Eks. 13:13,14 dhe Num. 18:15-17)
 - b. Shpengimi fizik kontrastohet me shpengimin shpirtëror (Ps. 49:7,8,15)
 - c. YHWH do ta shpengojë Izraelin nga mëkati dhe rebelimi i tij (Ps. 130:7-8)

B. Koncepti teologjik përfshin disa çështje të lidhura me njëra-tjetrën.

1. Ekziston një nevojë, një robëri, një humbje, një burgosje.
 - a. Fizike
 - b. Shoqërore
 - c. Shpirtërore (krh. Ps. 130:8)
2. Duhet paguar një çmim për liri, çlirim dhe rikthim.
 - a. Të kombit të Izraelit (krh. LiP 7:8)
 - b. Të individit (krh. Jobi 19:25-27; 33:28)
3. Dikush duhet të veprojë si ndërmjetës dhe mirëbërës. Në *gaal* ai është zakonisht një anëtar i familjes ose i afërm (d.m.th. *go'el*, BDB 145).
4. YHWH shpesh e përshkruan veten në terma familjarë.
 - a. Atë
 - b. Bashkëshort
 - c. I afërm shpengues/hakmarrës

Shpengimi u sigurua përmes ndërhyrjes personale të YHWH; u pagua një çmim dhe u realizua shpengimi!

II. DHIATA E RE

- A. Ka disa terma që përdoren për të përçuar konceptin teologjik.
 1. *Agorazō* (krh. I Kor. 6:20; 7:23; II Pjet. 2:1; Zbu. 5:9; 14:3-4). Ky është një term tregtar i cili reflekton një çmim që paguhet për diçka. Ne jemi njerëz të blerë me gjak që nuk i kemi në kontroll vetë jetët tona. Ne i përkasim Krishtit.
 2. *Exagorazō* (krh. Gal. 3:13; 4:5; Efë. 5:16; Kol. 4:5). Edhe ky është term tregtar. Ai reflekton vdekjen zëvendësuese të Jezusit në vendin tonë. Jezusi mbarti “mallkimin” e një ligji të bazuar te performanca (d.m.th. Ligji i Moisiut. Krah. Efë. 2:14-16; Kol. 2:14), të cilin njerëzit mëkatarë nuk mund ta mbanin. Ai mbarti mallkimin (krh. LiP 21:23) për të gjithë ne (krh. Marku 10:45; II Kor. 5:21)! Në Jezusin, drejtësia dhe dashuria e Perëndisë bashkohen në falje, praninë dhe akses të plotë!
 3. *Luō*, “të çlirosh”
 - a. *Lutron*, “një çmim i paguar” (krh. Mat. 20:28; Marku 10:45). Këto janë fjalë të fuqishme nga goja e vetë Jezusit në lidhje me qëllimin e ardhjes së Tij, për të qenë Shpëtimtari i botës duke paguar një borxh-mëkati që nuk ishte i Tij (krh. Gjoni 1:29).
 - b. *Lutroō*, “të lësh të lirë”
 - (1) për të shpenguar Izraelin (Luka 24:21)
 - (2) për të dhënë Vetën për të shpenguar dhe pastruar një popull (Tit 2:14)
 - (3) për të qenë një zëvendësues pa mëkat (I Pjet. 1:18-19)
 - c. *Lutrōsis*, “shpengim,” “çlirim,” ose “lirim”
 - (1) Profecia e Zakarias në lidhje me Jezusin, Luka 1:68
 - (2) Lavdërimi i Anës ndaj Perëndisë për Jezusin, Luka 2:38
 - (3) Flijimi më i mirë, një herë e përgjithmonë, i Jezusit, Heb. 9:12
 4. *Apolytrōsis*

- a. Shpengimi në Ardhjen e Dytë (krh. Veprat 3:19-21)
 - (1) Luka 21:28
 - (2) Romakëve 8:23
 - (3) Efesianëve 1:14; 4:30
 - (4) Hebrenjve 9:15
- b. Shpengimi në vdekjen e Krishtit
 - (1) Romakëve 3:24
 - (2) I Korintasve 1:30
 - (3) Efesianëve 1:7
 - (4) Kolosianëve 1:14
5. *Antilytron* (krh. I Tim. 2:6). Ky është një tekst kyç (si edhe Titi 2:14) që e lidh çlirimin me vdekjen zëvendësuese të Jezusit në kryq. Ai është i vetmi flijim i pranueshëm, ai që vdes për “të gjithë (krh. Gjoni 1:29; 3:16-17; 4:42; I Tim. 2:4; 4:10; Titit 2:11; II Pjet. 3:9; I Gjonit 2:2; 4:14).

B. Koncepti Teologjik në DHR.

1. Njerëzimi është i skllavëruar nga mëkati (krh. Gjoni 8:34; Rom. 3:10-18; 6:23).
2. Skllavëria e njerëzimit ndaj mëkatit është zbulua nga Ligji i Moisiut në DHV (krh. Galatasve 3) dhe nga Predikimi në Mal i Jezusit (krh. Mateu 5-7). Performanca njerëzore është bërë dënim me vdekje (krh. Kol. 2:14).
3. Jezusi, qengji i patëmetë i Perëndisë ka ardhur dhe ka vdekur në vendin tonë (krh. Gjoni 1:29; II Kor. 5:21). Ne jemi blerë nga mëkati që t’i shërbejmë Perëndisë (krh. Romakëve 6).
4. Në mënyrë të nënkuptuar, edhe YHWH, edhe Jezusi janë “i afërmi ynë i afërt” që veprojnë për ne. Kjo i vazhdon metaforat familiare (d.m.th. baba, bashkëshort, bir, vëlla, i afërm i afërt).
5. Shpengimi nuk ishte një çmim që iu pagua Satanit (siç thuhet në Teologjinë Mesjetare), por ishte pajtimi i fjalës së Perëndisë dhe drejtësisë së Perëndisë me dashurinë dhe asaj që Perëndia siguroi plotësisht në Krishtin. Në kryq u rivendos paqja, u fal rebelimi njerëzor, shëmbëllimi/imazhi i Perëndisë tek njerëzimi tani është përsëri plotësisht funksional në bashkësi intime!
6. Por ekziston edhe një aspekt i ardhshëm i shpengimit (krh. Rom. 8:23; Efe. 1:14; 4:30), që përfshin trupat tanë të ringjallur dhe intimitetin personal me Perëndinë Triun. Trupat tanë të ringjallur do të jenë si i Tiji (krh. I Gjonit 3:2). Ai pati një trup fizik, por me një aspekt ekstra-dimensional. Është e vështirë ta përkufizosh paradoksin e I Kor. 15:12-19 me I Kor. 15:35-58. Me sa duket ekziston një trup fizik, tokësor dhe do të ekzistojë një trup qiellor, frymëror. Jezusi i pati të dy!

3:25

NASB “të Cilin Perëndia e shfaq publikisht”

NKJV “të cilin Perëndia e parashtror”

NRSV “të cilin Perëndia e paraqiti”

TEV “Perëndia e ofroi”

NJB “i cili u caktua nga Perëndia”

Kjo është një formë AORISTE DËFTORE JOVEPRORE e *protithēmi* (në Rom. 1:13 dhe Efe. 1:9 ajo ka kuptimin “kam si synim,” ashtu si edhe EMRI në Rom. 8:28), që do të thotë se Perëndia Vetë e zbuloi zemrën dhe qëllimin e Tij nëpërmjet vdekjes së Krishtit (krh. Efe. 1:9; Gal. 3:1). Plani i përjetshëm shpengues i Perëndisë (krh. Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; 26:22; dhe Temën e Veçantë në 1:5) përfshinte flijimin e Jezusit (krh. Isa. 53:10; Zbu. 13:8). Shih shënimin te 9:11.

■ **“për të demonstruar”** Ky term grek *endeiknumai* (*endeixis*, krh. 3:25,26) përdoret disa herë te Romakëve (krh. 2:15; 9:17,23; LXX Eksodi 9:16). Kuptimi i tij themelor është të manifestosh apo të shfaqësh. Perëndia donte që njerëzimi ta kuptonte qartë qëllimin, planin dhe drejtësinë e Tij shpenguese. Ky kontekst po parashtron një pikëpamje biblike

1. në lidhje me karakterin e Perëndisë

2. në lidhje me punën e Krishtit
3. në lidhje me nevojën e njerëzimit
4. në lidhje me qëllimin e shpengimit.

Perëndia do që ne të kuptojmë! Ky kontekst është kyç për një të kuptuar të duhur të krishtërimin. Disa nga fjalët dhe frazat janë dykuptimëshe ose mund të kuptohen në disa mënyra, por kuptimi i së tërës është shumë i qartë dhe i thjeshtë. Ky kontekst është Ylli Polar teologjik për ungjillin.



NASB	“si një pajtimore në gjakun e Tij”
NKJV	“për të qenë një pajtimore me anë të gjakut të Tij”
NRSV	“si një flijim shlyes me anë të gjakut të tij”
TEV	“në mënyrë që me anë të gjakut të tij ai të bëhej mjete me anë të të cilit falen mëkatet e njerëzve”
NJB	“për të flijuar jetën e tij në mënyrë që të fitonte pajtimin”

Në botën greko-romake kjo fjalë mbartte konceptin e rivendosjes së miqësisë me një hyjni të zemëruar me anë të një çmimi që paguhej. Megjithatë nuk përdoret në këtë kuptim në Septuagintë. Në Septuagintë dhe te Heb. 9:5 u përdor për të përkthyer “pajtuesi” (krh. Eksodi 25:21-22; Lev. 16:12-15), i cili ishte kapaku i Arkës së Besëlidhjes që gjendej në Shenjtëroren e Shenjtëroreve, vendi ku sigurohej shlyerja për kombin në Ditën e Shlyerjes së mëkatit (krh. Levitiku 16). Me sa duket Pali po përdor metafora flijimi nga sistemi i flijimeve i Izraelit (d.m.th. Levitiku 1-7). Këto metafora (d.m.th. pajtimore, shpërblese, flijim) kuptohen vetëm në lidhje me orakujt e Perëndisë në DHV. Pali atëherë duhet ta shpjegojë lidhjen e tyre me gjithë njerëzimin. YHWH ia zbuloi Vetën Abrahamit/Izraelit për t’ua zbuluar Vetën të gjithëve; të gjithë janë në imazhin e Tij; të gjithë janë rebeluar; të gjithë mund të shpëtohen përmes besimit në Krishtin (Mesian e hebrenjve).

Ky term duhet marrë në një mënyrë që nuk e zvogëlon neverinë e Perëndisë ndaj mëkatit, por pohon qëndrimin e Tij pozitiv shpengues ndaj mëkatarëve. Një diskutim i mirë i kësaj çështjeje gjendet në librin e James Stewart, *A Man in Christ*, fq. 214-224. Një mënyrë për ta arritur këtë është ta përkthejmë termin në mënyrë të tillë që ai të reflektojë punën e Perëndisë në Krishtin; “një flijim pajtues”; ose “me fuqi pajtuese.”

“Në gjakun e Tij” është një mënyrë hebraike referimi ndaj flijimit zëvendësues të qengjit të pafajshëm të Perëndisë (krh. Gjoni 1:29). Levitiku 1-7 si edhe Dita e Shlyerjes së mëkatit në kapitullin 16 janë kyç për ta kuptuar këtë koncept plotësisht. Gjaku i referohet një jete të pamëkat të dhënë për fajtorët (krh. Isa. 52:13-53:12). Një vdiq për të gjithë (krh. 5:12-21)!

■ **“përmes besimit”** Këtu përsëri kemi mekanizmin (krh. 1:17; 3:22,25,26,27,28,30) për përfitim personal të kujtdo dhe të çdo njeriu të disponueshëm në vdekjen zëvendësuese të Jezusit.

Kjo frazë është hequr në dorëshkrimin e lashtë uncial A të shekullit të 5-të (gjithashtu edhe në tekstin grek të përdorur nga Joan Gojarti¹) dhe në një dorëshkrim uncial të shekullit të 12-të (2127). Ajo gjendet në të gjithë dorëshkrimet e tjera të lashta në greqisht. Disa kanë NYJËN SHQUESE (krh. dorëshkrimet P⁴⁰, B, C³, D³) me fjalën “besim” dhe disa jo (krh. dorëshkrimet α , C*, D*, F, G), megjithatë, kjo nuk e ndikon kuptimin. UBS³ e përcakton përfshirjen e saj si B (pothuaj të sigurt).

■ **“për të demonstruar drejtësinë e Tij”** Perëndia duhet t’i qëndrojë besnik karakterit dhe fjalës së Tij (krh. Mal. 3:6). Në DHV shpirti që mëkaton duhet të vdesë (krh. Zan. 2:17; Ezek. 18:4,20). Perëndia tha që nuk do ta falte të ligun (krh. Eksodi 23:7). Dashuria e Perëndisë për njerëzimin e rënë është kaq e madhe, saqë Ai ishte i gatshëm të bëhej njeri, të përmbushte Ligjin, dhe të vdiste në vendin e njerëzimit të rënë (krh. 5:12-21). Dashuria dhe drejtësia e Perëndisë takohen në Jezusin (krh. v. 26).



NASB, NKJV,	
NRSV	“Ai i mbikaloi mëkatet e kryera më parë”
TEV	“në të kaluarën ai ishte i duruar dhe nuk u mor me mëkatet e njerëzve”

¹ Në shqip e ndeshim edhe me emrin Gjon Krisostomi. Krisostom (greqisht) do të thotë Gojë-artë (shën. i përkth.)

Termi “mbikaloi” është *paresis*, dhe përdoret vetëm këtu në DHR dhe asnjëherë në Septuagintë. Etërit grekë dhe Jeromi e morën atë në kuptimin e drejtpërdrejtë në greqisht të “faljes së një borxhi” (krh. Moulton dhe Milligan, fq. 493). Megjithatë, *pariēmi*, FOLJA nga e cila vjen, do të thotë “të lësh të kalojë pranë” ose “të lirosh/zbutësh” (krh. Luka 11:42).

Pra pyetja është a i fali Perëndia mëkatet në të shkuarën duke parë drejt punës së ardhme të Krishtit, apo Ai thjesht i mbikaloi/injoroi ato, duke e ditur se vdekja e ardhme e Krishtit do ta zgjidhte problemin e mëkatit? Rezultati është i njëjtë. Mëkati njerëzor, i shkuar, i tashëm dhe i ardhëm zgjidhet nga flijimi i Krishtit.

Ky ishte një veprim i kaluar i hirit të Perëndisë që shikonte përpara drejt punës së Krishtit (krh. Vep. 17:30; Rom. 4:15; 5:13) si edhe një veprim i tashëm dhe i ardhëm (v. 26). Perëndia nuk e mori dhe nuk e merr mëkatit lehtë, por Ai e pranon flijimin e Krishtit si një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare të rebelimit njerëzor. Ai nuk është më një pengesë për bashkësinë e ngushtë me Vetën e Tij, gjë që ishte qëllimi i krijimit (krh. Zan. 1:26-27).

3:26 Termi “drejtësi” në v. 25 është i lidhur etimologjikisht me termat “i drejtë” dhe “shfajësues” të v. 26. Perëndia dëshiron që karakteri i Tij të manifestohet në jetët e besimtarëve përmes besimit në Krishtin. Jezusi bëhet drejtësia jonë (krh. II Kor. 5:21), por besimtarët duhet gjithashtu të konformohen me drejtësinë e Tij, ngjashmërinë e Tij (krh. 8:29; Mat. 5:48; Lev. 19:2). Shih Temën e Veçantë te 1:17.



NASB, NKJV,

NRSV “atij që ka besim në Jezusin”

TEV “çdokujt që beson në Jezusin”

NJB “çdokujt që ka besim në Jezusin”

REB “kujtdo që e vendos besimin në Jezusin”

NET “atij që jeton për shkak të besnikërisë së Jezusit”

Teksti në greqisht e ka “*atij* të besimit të Jezusit.” Vështirësia vjen në shumësinë e përdorimeve të GJINORES (shih G. B. Caird, *The Language and Imagery of the Bible*, fq. 99). Shumica e përkthimeve në anglisht e shohin atë si zënien besë/besimin personal të një personi në Jezusin. Bibla NET e merr sikur ajo i referohet 3:22. Megjithatë, v. 22 ka një referencë ndaj të dyjave

1. besnikërisë së Jezusit

2. besimit të besimtarëve

Shpëtimi është rezultat i besnikërisë së Jezusit e cila duhet pranuar (krh. v. 30).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:27-30

²⁷Ku është atëherë mburrja? Është e përjashtuar. Prej cilit ligj? Atij të veprave? Jo, por prej ligjit të besimit. ²⁸Sepse ne këmbëngulim se një njeri është i shfajësuar me anë të besimit pa veprat e Ligjit. ²⁹Apo mos është Perëndia vetëm *Perëndia* i hebrenjve? A nuk është Ai edhe *Perëndia* i johebrenjve? Po, edhe i johebrenjve, ³⁰meqenëse vërtet Perëndia i Cili do të shfajësojë të rrethprerin me anë të besimit dhe të parrethprerin përmes besimit është një.

3:27 “Ku atëherë është mburrja” Prania e NYJËS me “mburrja” mund të reflektojë krenarinë e hebrenjve (krh. 2:17,23). Ungjilli është pëkulës. Njerëzimi i rënë (hebrenj dhe johebrenj) nuk mund ta ndihmojë veten (krh. Efe. 2:8-9). Shih Temën e Veçantë: Mburrja tek 2:17.

Një shënim i shkurtër për të qartësuar thënien time të mëparshme. Megjithëse njerëzit nuk mund ta meritojnë dashurinë dhe faljen e Perëndisë, kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë asnjë rol në shpëtimin e tyre. Njerëzit duhet ta ndiejnë mëkatit/fajin e tyre dhe ta përqafojnë ofertën e Perëndisë në Krishtin. Perëndia hyn në marrëdhënie me njerëzimin e rënë me anë të “besëlidhjes.” Ne duhet të përgjigjemi dhe të vazhdojmë të përgjigjemi.

1. pendim

2. besim

3. bindje

4. këmbëngulje

Ne kemi një rol kyç në marrëdhënien tonë me Perëndinë. Ne jemi reagues! Por ne duhet të reagojmë! Vullneti i lirë është një doktrinë biblike po aq kyçe sa edhe sovraniteti. Bibla, duke qenë libër lindor, e paraqet të vërtetën në dyshe që janë në tension midis tyre.

TEMË E VEÇANTË: LITERATURA LINDORE

Tabloja e madhe – paradokset biblike

1. Ky zbulim ka qenë më i dobishmi për mua personalisht si dikush që e do dhe i beson Biblës si Fjala e Perëndisë. Duke u përpjekur ta merrja Biblën seriozisht, u bë e qartë që tekste të ndryshme e zbulojnë të vërtetën në mënyra të përzgjedhura, jo sistematike. Një tekst i frymëzuar nuk mund ta anulojë ose zhvlefësojë një tekst tjetër të frymëzuar! E vërteta vjen duke e njohur të gjithë Shkrimin (i gjithë Shkrimi është i frymëzuar, jo vetëm një pjesë, krh. II Tim. 3:16-17), jo duke cituar një pasazh të vetëm (citimi jashtë kontekstit)!
2. Pjesa më e madhe e të vërtetave biblike (letërsia lindore) paraqiten në dyshe dialektike apo paradoksale (kujtoni që autorët e DHR, përveç Lukës, janë mendimtarë hebrej që shkruajnë në greqisht. Literatura e Urtësisë dhe Literatura Poetike e paraqesin të vërtetën në vargje paralele. Paralelizmi antitetik funksionon si paradoks. Ky paralelizëm sintetik funksionon si pasazhe paralele). Disi të dy janë njësoj të vërtetë! Këto paradokse janë të dhimbshme për traditat tona të çmuara thjeshtëzuese!
 - a. Paracaktimi përkundër vullnetit të lirë njerëzor
 - b. Siguria e besimtarit përkundër nevojës për këmbëngulje
 - c. Mëkati origjinal/fillestar përkundër mëkatit të vullnetshëm
 - d. Jezusi si Perëndi përkundër Jezusi si njeri
 - e. Jezusi si i barabartë me Atin përkundër Jezusi si i nënshtruar Atit
 - f. Bibla si Fjala e Perëndisë përkundër autorësisë njerëzore
 - g. Pamëkatshmëria (perfeksionizmi, krh. Rom. 6) përkundër mëkatimit më pak
 - h. Shfajësimi dhe shenjtërimi i menjëhershëm fillestar përkundër shenjtërimit progresiv
 - i. Shfajësimi me anë të besimit (Romakëve 4) përkundër shfajësimit të konfirmuar nga veprat (krh. Jakobi 2:14-26)
 - j. Liria e krishterë (krh. Rom. 14:1-23; I Kor. 8:1-13; 10:23-33) përkundër përgjegjësisë së krishterë (krh. Gal. 5:16-21; Efe. 4:1)
 - k. Përtëjkësitshmëria e Perëndisë përkundër gjithëbrendapranisë së Tij (fakti që Perëndia është përtëj, i veçuar dhe më lart krijimit të Tij përkundër faktit që Ai është njëkohësisht tërësisht i pranishëm në krijimin e Tij, *shpjegim i përkthyesit*)
 - l. Perëndia si në thelb i panjohshëm përkundër i njohshëm në Shkrimet dhe në Krishtin
 - m. Metaforat e shumta të Palit për shpëtimin
 - (1) Adoptimi
 - (2) Shenjtërimi
 - (3) Shfajësimi
 - (4) Shpengimi
 - (5) Përlëvdimi
 - (6) Paracaktimi
 - (7) Pajtimi
 - n. Mbretëria e Perëndisë si e pranishme përkundër realizimit të ardhshëm
 - o. Pendimi si dhuratë e Perëndisë përkundër pendimi si një përgjigje e domosdoshme për shpëtim (krh. Marku 1:15; Veprat 20:21)
 - p. DHV është e përhershme përkundër DHV ka kaluar dhe është anuluar dhe shfuqizuar (krh. Mat. 3:17-19 përkundër 5:21-48; Romakëve 7 përkundër Galatasve 3)
 - q. Besimtarët janë shërbëtorë/skllëvër apo fëmijë/trashëgimtarë

■ **“është e përjashtuar”** Ky term (*ek* [jashtë] plus *kleiō* [mbyll]) përdoret vetëm këtu dhe te Gal. 4:17. Fjalë për fjalë do të thotë “të kyçësh përjashta.”

■ **“prej ligjit të besimit”** Besëlidhja e Re e Perëndisë e Jer. 31:31-34 (Ezek. 36:22-28) nuk bazohet në performancë, por në besim/zënie besë (*pistis*) në karakterin e hirshëm dhe premtimet e Tij. Edhe Besëlidhja e Vjetër, edhe Ajo e Re kishin si synim ta bënin njerëzimin e rënë sipas karakterit të Perëndisë (të drejtë, d.m.th., Lev. 19:2; Mat. 5:48; Rom. 8:29).

3:28 “ne këmbëngulim se një njeri është i shfajësuar me anë të besimit pa veprat e Ligjit.” Kjo është një përmbledhje e 3:21-26 dhe një parahije e kapitujve 4-8 (krh. II Tim. 1:9; Titit 3:5). Shpëtimi është dhuratë falas përmes besimit në veprën e përfunduar të Krishtit (krh. 3:24; 5:15,17; 6:23; Efe. 2:8-9). Megjithatë, pjekuria është një jetë “që të kushton gjithçka” në bindje, shërbim dhe adhurim (krh. Gal. 5:6; Efe. 2:10; Fil. 2:12; dhe shih shënimin në 1:5).

3:29 Qëllimi i Perëndisë ka qenë gjithmonë të shpengonte të gjithë njerëzit të krijuar në imazhin e Tij (Zan. 1:26,27; 5:1; 9:6). Premtimi shpengues i Zan. 3:15 është për të gjithë fëmijët e Adamit. Ai zgjodhi Abrahamin me qëllim që të zgjidhte botën (krh. Zan. 12:31; Eksodi 19:4-6; Gjoni 3:16).

Ky varg, si 3:9, mund të reflektojë tensionin në kishën romane midis udhëheqësve besimtarë hebrenj, të cilët mund të ishin larguar nga Roma pas dekretit të Neronit që e ndalonte adhurimin hebre, gjë që rezultoi në udhëheqje besimtarësh johebrej që i zëvendësuan. Kapitujt 9-11 mund t’i adresohen po ashtu të njëjtit tension.

3:30

NASB	“meqenëse vërtet Perëndia është një”
NKJV	“meqenëse ka një Perëndi”
NRSV	“meqenëse Perëndia është një”
TEV	“Perëndia është një”
NJB	“meqenëse ka vetëm një Perëndi”

Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË e cila merret si e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Nëse monoteizmi është i vërtetë, atëherë Perëndia duhet të jetë Perëndia i të gjithë njerëzve.

TEMË E VEÇANTË: MONOTEIZMI

Koncepti i “monoteizmit” (vetëm një Perëndi), dhe jo thjesht i “perëndisë së lartë” të politeizmit, apo perëndisë së mirë të dualizmit iranian (zoroastrianizmi), është unik për Izraelin (Abrahami, 2000 para K.). Vetëm një përjashtim i rrallë ekzistoi shkurtimisht në Egjipt (Amenhotepi IV, i njohur edhe si Akhenateni, 1367-1350, ose 1386-1361 para K.).

Ky koncept shprehet me një sërë frazash në DhV.

1. “askush s’është si Jahve, *Elohim* ynë”, (Eks. 8:10; 9:14; LiP. 33:26; 1 Mbr. 8:23)
2. “askush tjetër përveç tij” (LiP. 4:35,39; 32:39; 1 Sam. 2:2; 2 Sam. 22:32; Isa. 45:21; 44:6,8; 45:6,21)
3. “Jahve është një” (LiP. 6:4; Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4,6; 1 Tim. 2:5; Jakobi 2:19)
4. “askush si ti” (2 Sam. 7:22; Jer. 10:6)
5. “Vetëm ti je Perëndi” (Psa. 86:10; Isa. 37:16)
6. “Para meje nuk ishte formuar asnjë perëndi, dhe s’do të ketë tjetër pas meje” (Isa. 43:10)
7. “Nuk ka tjetër; përveç meje... nuk ka tjetër” (Isa. 45:5, 6, 22)
8. “S’ka asnjë Perëndi tjetër” (Isa. 45:14, 18)
9. “S’ka tjetër veç meje” (Isa. 45:21)
10. “nuk ka tjetër... nuk ka tjetër si unë” (Isa. 46:9)

Duhet pranuar se kjo doktrinë kyçe është zbuluar në mënyrë të shkallëzuar. Pohimet e hershme mund të kuptohen si “henoteizëm”, ose si monoteizëm praktik (ekzistojnë perëndi të tjerë, por vetëm një perëndi për ne; shih Eks. 15:11; 20:2-5; LiP. 3:28; 5:7; 6:4,14; 10:17; 32:12; 1 Mbre. 8:23; Psa. 83:18; 86:8; 136:1-2).

Pasazhet e parë që fillojnë të vënë në dukje faktin se ka vetëm një perëndi (monoteizmi filozofik) janë të hershëm (shih Eks. 8:10; 9:14; LiP. 4:35, 39; 33:26). Pohimet e plota dhe tërësore gjenden te Isaia 43-36 (shih 43:11; 44:6, 8; 45:7, 14, 18, 22; 46:59, 9).

DhR aludon për LiP. 6:4 te Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4, 6; Efe. 4:6; 1 Tim. 2:5; dhe Jakobi 2:19. Jezusi e citon

si urdhërimin e parë të Mat. 22:36-37; Marku 12:29-30; Luka 10:27. DhV, ashtu si DhR, pohon realitetin e qenieve të tjera shpirtërore (demonët, engjëjt), por vetëm një krijues/Perëndi shpengues (YHWH, Zan. 1:1).

Monoteizmi biblik karakterizohet nga si më poshtë:

1. Perëndia është një dhe i pashoq (ontologjia e tij merret si fakt i kryer, nuk specifikohet)
2. Perëndia është personal (shih Zan. 1:26-27; 3:8)
3. Perëndia është etik (shih Eks. 34:6; Neh. 9:17; Psa. 103:8-10)
4. Perëndia i krijoi njerëzit në shëmbëllimin e vet (Zan. 1:26-27) për bashkësi me ta (shih #2). Ai është Perëndi xheloz (shih Eks. 20:2-3)

Nga DhR:

1. Perëndia ka tre shfaqje të përjetshme dhe personale (shih Tema e Veçantë: Trinia, në 8:11)
2. Perëndia është zbuluar në mënyrë të përsosur dhe të plotë në Jezusin (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:15-19; Heb. 1:2-3)
3. Plani i përjetshëm i Perëndisë për shpengimin e njerëzimit të rënë është ofrimi flijues i Birit të tij të vetëm (Isaia 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21; Fil. 2:6-11; Hebrenjve)

■ **“Ai do të shfajësojë të rrethprerën me anë të besimit”** Fjala greke “shfajësoj” është nga e njëjta rrënjë si fjala “drejtësi.” Shih Temën e Veçantë në 1:17. Ka vetëm një mënyrë për të qenë në pozitë të drejtë me Perëndinë (krh. Rom. 9:30-32). Dy kriteret e shpëtimit janë besimi dhe pendimi (krh. Marku 1:15; Veprat 3:16,19; 20:21; shih shënimin të 1:5). Kjo është e vërtetë edhe për hebrejtë, edhe për grekët.

■ **“me anë të besimit...nëpërmjet besimit”** Është e qartë që ka paralelizëm midis këtyre dy fjalive të varura. PARAFJALËT *ek* dhe *dia* janë përdorur këtu në mënyrë sinonimike. Nuk është synimi të tregohet ndonjë dallim.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 3:31

³¹**A e anulojmë atëherë Ligjin nëpërmjet besimit? Kurrë mos qoftë! Përkundrazi, ne e konsolidojmë Ligjin.**

3:31

NASB “A e anulojmë atëherë Ligjin nëpërmjet besimit”
NKJV “A e zhvleftësojmë atëherë ligjin nëpërmjet besimit”
NRSV “A e përmbysim atëherë ligjin me anë të këtij besimi”
TEV “A do të thotë kjo se me anë të këtij besimi ne e heqim qafe Ligjin”
NJB “A duam të themi që besimi e bën Ligjin pa kuptim”

DHR e paraqet DHV në dy mënyra të ndryshme

1. ajo është zbuluesë e frymëzuar, e dhënë nga Perëndia që nuk do të kalojë kurrë (krh. Mat. 5:17-19; Rom. 7:12,14,16)

2. ajo është e vjetëruar dhe ka kaluar (krh. Heb. 8:13).

Pali e përdori termin “anuloj” të paktën njëzet e pesë herë. Ai përkthehet “bëj të pavlefshëm,” “bëj të pafuqishëm,” dhe “bëj pa efekt.” Shih Temën e Veçantë të 3:3. Për Palin Ligji ishte një kujdestar (krh. Gal. 3:23) dhe mësues (krh. Gal. 3:24), por ai nuk mund të jepte jetë të përjetshme. Ai është baza për dënimin e njeriut (krh. Gal. 3:13; Kol. 2:14). Ligji i Moisiut funksiononte edhe si zbuluesë, edhe si provim moral, si edhe “Pema e njohjes të së Mirës dhe të së Keqes.”

Ka paqartësi se çfarë donte të thoshte Pali me “Ligji.”

1. një sistem veprash të drejta të Judaizmit

2. një fazë nëpër të cilën besimtarët johebrej duhej të kalonin rrugës për në shpëtimin në Krishtin (Judaistët tek Galatasve)

3. një standard të cilin të gjithë njerëzit nuk e arrijnë (krh. Rom. 1:18-3:20; 7:7-25; Gal. 3:1-29).

■ **“ne e konsolidojmë Ligjin”** Nën dritën e frazës pararendëse, çfarë do të thotë kjo frazë? Ajo mund të ketë kuptimin që

1. Ligji nuk ishte mënyrë shpëtimi, por ishte një udhërrëfyes i vazhdueshëm moral

2. ai dëshmonte për doktrinën e “shfajësimit me anë të besimit,” 3:21; 4:3 (Zan. 15:6; Ps. 32:1-2,10-11)

3. dobësia e Ligjit (rebelimi njerëzor, krah. Rom. 7; Gal.3) u korrigjua plotësisht nga vdekja e Krishtit, 8:3-4

4. qëllimi i zbuluesës është të restaurojë/ndreqë/rikthejë/rivendosë imazhin e Perëndisë të njeriut

Ligji, pas drejtësisë ligjore, bëhet një udhërrëfyes për tek drejtësia e vërtetë ose ngjashmëria me Krishtin. Shih Temën e Veçantë: Pikëpamja e Palit për Ligjin e Moisiut te 13:9.

Paradoksi tronditës është që Ligji nuk arriti të vendosë drejtësinë e Perëndisë, por përmes anulimit të tij, me anë të dhuratës së hirit të Perëndisë nëpërmjet besimit, i krishteri jeton një jetë të drejtë e të perëndishme. Synimi i Ligjit është përmbushur, jo nga performanca njerëzore, por nga dhurata falas e hirit të Perëndisë në Krishtin! Për “konsolidoj” shih Temën e Veçantë: Qëndroj te 5:2.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Përvijojeni Romakëve 3:21-31 me fjalët tuaja.
2. Pse Perëndia i mbikaloi/injoroi mëkatet e njerëzve në kohët e kaluara (v. 25)?
3. Si shpëtohej nga mëkati besimtari i DHV (3:25)?
4. Si e konfirmon Ligjin besimi në Jezusin (3:31)?

ROMAKËVE 4

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shembulli i Abrahamit 4:1-12	Abrahami i shfajësuar me anë të besimit 4:1-4 Davidi feston të njëjtën të vërtetë 4:5-8 Abrahami i shfajësuar para rrethprerjes 4:9-12	Abrahami i shfajësuar me anë të besimit 4:1-8 4:9-12	Shembulli i Abrahamit 4:1-8 4:9-12	Abrahami i shfajësuar me anë të besimit 4:1-8 I shfajësuar para rrethprerjes 4:9-12
Premtimi i realizuar nëpërmjet besimit 4:13-25	Ajo që iu premtua iu dha nëpërmjet besimit 4:13-25	Pasardhësit e vërtetë të Abrahamit 4:13-15 4:16-25	Premtimi i Perëndisë u mor 4:13-15 4:16-25	Nuk u shfajësua me anë të bindjes ndaj ligjit 4:13-17 Besimi i Abrahamit një model për besimin e krishterë 4:18-25

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Teologjia tronditëse e Palit e parashtruar në 3:21-31 pohoi se njerëzimi i rënë ishte shpallur i drejtë me Perëndinë si dhuratë falas, krejt në mënyrë të pavarur nga Ligji i Moisiut. Me sa duket Pali kishte në mendje kundërshtimet e hebrenjve! Pali tani përpiket të provojë se ungjilli i tij nuk ishte një gjë e re (krh. 3:21b) duke dhënë shembuj të DHV si nga Abrahami, edhe nga Davidi (krh. vv. 6-8).
- B. Romakëve 4 paraqet prova të nxjerra nga Ligji i Moisiut, Zanafilla – Ligji i Përtërirë, për doktrinën e shfajësimit me anë të hirit nëpërmjet besimit. Kjo përmbledhet në 3:21-31. Për një hebre, një citim nga

shkrimet e Moisiut kishte peshë të madhe teologjike, sidomos në lidhje me Abrahamin, i cili shikohej si ati i kombit hebre. Davidi shikohej si një tip i Mesias që do të vinte (krh. II Samuelit 7).

- C. Tensioni në Romë midis besimtarëve hebrej dhe besimtarëve johebrej mund të ketë qenë rasti për këtë diskutim. Është e mundur që udhëheqësit e krishterë hebrej të jenë ndjerë të detyruar nga Neroni (i cili i anuloi të gjitha ritualet hebreje) të largohen nga Roma. Në periudhën e ndërmjetme ata u zëvendësuan nga udhëheqës të krishterë johebrej. Kthimi i grupit të parë shkaktoi debat në lidhje me kush duhej të ishte në pozicion udhëheqësie.
- D. Romakëve 4 tregon se njerëzimi i rënë është shpëtuar gjithnjë nga hiri i Perëndisë nëpërmjet besimit dhe pendimit ndaj Perëndisë sipas dritës shpirtërore që ka (Zan. 15:6; Rom. 4:3). Në shumë mënyra Besëlidhja e Re (ungjilli, krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) nuk është rrënjësisht e ndryshme nga Besëlidhja e Vjetër.
- E. Kjo rrugë e drejtësisë me anë të hirit nëpërmjet besimit është e hapur për të gjithë, jo thjesht për Patriarkët apo kombin e Izraelit. Pali këtu po e zhvillon dhe zgjeron argumentin e tij teologjik duke përdorur Abrahamin, që ai e kishte zhvilluar në Galatasve 3.
- F. Duhet ta pranoj se si ungjillor, Rom. 3:21-31; 4:1-25; 5:1-21 dhe Galatasve 3 janë tekste kyçe. Ata e shpjegojnë krishtërimin në mënyrë të tillë që unë mund ta kuptoj! Shpresa ime gjendet në
 - 1. hirin e Perëndisë
 - 2. punën e Krishtit
 - 3. besueshmërinë e Shkrimit
 - 4. shkrimet e qarta të Palit

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:1-8

¹Atëherë çfarë do të themi se ka gjetur Abrahami, paraardhësi ynë sipas mishit? ²Sepse nëse Abrahami do të ishte shfajësuar me anë të veprave, ai ka diçka për të cilën të mburret, por jo përpara Perëndisë. ³Sepse çfarë thotë Shkrimi? “ABRAHAMI I BESOI PERËNDISË, DHE KJO IU LLOGARIT ATIJ SI DREJTËSI.” ⁴Tani atij që punon, pagesa e tij nuk i llogaritet si favor, por si diçka që i takon. ⁵Por atij që nuk punon, por beson në Atë që shfajëson të paperëndishmin, besimi i tij i llogaritet si drejtësi, ⁶ashtu siç flet edhe Davidi për bekimin e njeriut të cilit Perëndia i llogarit drejtësi pa vepra: ⁷“LUM ATIJ QË I JANË FALUR SHKELJET, DHE QË I JANË MBULUAR MËKATET.” ⁸“LUM NJERIU TË CILIT ZOTI NUK DO T’IA LLOGARITË MËKATIN.”

4:1 “Atëherë çfarë do të themi se ...Abrahami, paraardhësi ynë” Emri i Abrahamit do të thoshte “atë i një shumice” (krh. vv. 16-18). Emri i tij fillestar, Abram, do të thoshte “atë i lartësuar.”

Kjo teknikë letrare e përdorur këtu quhet diatrib (krh. 4:1; 6:1; 7:7; 8:31; 9:14,30). Arsyeja që përdoret Abrahami (Za. 11:27-25:11) si shembull është ose

- 1. sepse hebrejtë i japin shumë rëndësi origjinës së tyre racore (krh. Mat. 3:9; Gjoni 8:33,37,39)
- 2. sepse besimi i tij personal shëmbëllen modelin besëlidhor (Zan. 15:6)
- 3. besimi i tij ishte përpara dhënies së Ligjit të Moisiut (krh. Eksodi 19-20)
- 4. ai përdorej nga mësuesit e rremë (d.m.th., judaistët, krh. Galatasve)

Për një arsye skribët e hershëm u lëkundën midis

- 1. paraardhës, dorëshkrimet \aleph^{*2} , A, C*
- 2. atë, dorëshkrimet \aleph^1 , C³, D, E, G

Ndoshta kishte të bënte me çështjen e Abrahamit si paraardhës (d.m.th., Patriark, Pali po u adresohet hebrejve) i kombit të Izraelit përkundër Abrahamit si ati i të gjithëve të ushtrojnë besimin në Perëndinë (atë edhe i hebrejve, edhe i johebrejve, 2:28-29).

■ **“mishit”** Shih Temën e Veçantë te 1:3.

4:2 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË (krh. A. T. Robertson, *Word Pictures*, vol. 4, fq. 350), e cila supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Ky është një shembull i mirë i një FJALIE KUSHTORE TË KLASIT TË PARË që është e rreme në realitet, por shërben për të nxjerrë një përfundim teologjik (krh. v. 14).

Joseph A. Fitzmyer, *The Anchor Bible*, vol. 33, fq. 372, thotë që kjo mund të jetë një FJALI KUSHTORE E PËRZIER me pjesën e parë të KLASIT TË DYTË (e kundërt me faktin, “nëse” Abrahami u shfajësua nga veprat, që nuk ishte e vërtetë...”) dhe pjesa e dytë është e KLASIT TË PARË.

■ **“shfajësuar me anë të veprave”** Kjo është e kundërta e shfajësimit me anë të hirit nëpërmjet besimit në Krishtin. Nëse kjo mënyrë shpëtimit përmes përpjekjeve njerëzore (4:4) do të ishte e mundur, ajo do ta kishte bërë shërbesën e Krishtit të panevojshme. Shfajësimi me anë të veprave të Ligjit është pikërisht ajo që shumë rabinë pohonin në lidhje me Abrahamin (krh. *Urtësia* 10:5; *Kishtari*¹ 44:20-21; *I Mak.* 2:52; *Jubilejtë* 6:19-20; 15:1-2). Pali, si nxënës i rabinëve, do të kishte qenë tërësisht në dijeni të këtyre teksteve.

Megjithatë, DHV tregon qartë paaftësinë e njerëzimit të rënë për të kryer veprat besëlidhore të Perëndisë. Prandaj, DHV u bë një mallkim, një dënim me vdekje (krh. Gal. 3:13; Kol. 2:14).

Studiuesit hebrenj e dinin se Abrahami jetoi përpara Ligjit të Moisiut, por ata besonin se ai i parapriu Ligjit dhe e mbajti atë (krh. *Kishtari* 44:20 dhe *Jubilejtë* 6:19; 15:1-2).

■ **“ai ka diçka për të cilën të mburret”** Ky lajtmotiv del shpesh në shkrimet e Palit. Prejardhja e tij si farise e bënte të ndjeshëm atë ndaj këtij problemi (krh. 3:27; I Kor. 1:29; Efe. 2:8-9). Shih Temën e Veçantë: Mburra te 2:17.

4:3

NASB, NKJV,

NRSV, TEV

“Abrahami i besoi Perëndisë”

NJB

“Abrahami e vendosi besimin e tij në Perëndinë”

Ky është një citim nga Zan. 15:6. Pali e përdor atë tre herë në këtë kapitull (krh. 4:3,9,22), që tregon rëndësinë e tij në të kuptuarit teologjik të shpëtimit nga ana e Palit. Termi “besim” në DHV donte të thoshte besnikëri ndaj dikujt, apo besueshmëri dhe ishte një përshkrim i natyrës së Perëndisë, jo tonës. Ajo vinte nga një term hebraik (*emun, emunah*) që donte të thoshte “të jesh i sigurt apo stabël.” Besimi shpëtues është

1. rënie dakord mendërisht (një komplet të vërtetash)
2. përkushtim i vullnetshëm (vendim)
3. mënyrë morale të jetuari (mënyrë jetese)
4. së pari një marrëdhënie (mirëpritja e një personi)

Shih Temën e Veçantë: Besoj, zë besë, besim dhe besnikëri në DHV te 1:5

Duhet theksuar se besimi i Abrahamit nuk ishte në një Mesia të ardhshëm, por në premtimin e Perëndisë që ai do të kishte një fëmijë dhe pasardhës (krh. Zan. 12:2; 15:2-5; 17:4-8; 18:14). Abrahami iu përgjigj këtij premtimi duke i besuar Perëndisë. Ai ende kishte dyshime dhe probleme në lidhje me këtë premtim, i cili deshi ende edhe trembëdhjetë vjet që të përmbushej. Megjithatë, besimi i tij i papërsosur prapëseprapë u pranua nga Perëndia. Perëndia është i gatshëm të punojë me qenie njerëzore që kanë të meta të cilët i përgjigjen Atij dhe premtimeve të Tij me besim, edhe nëse ai besim është sa një kokërr sinapi (krh. Mat. 17:20).

4:3,4,5,6,8,9,10,22,23,24

NASB, NRSV

“kjo iu llogarit atij”

NKJV

“kjo iu numërua”

TEV

“sepse Perëndia e pranoi atë”

¹ Në anglisht, *Ecclesiasticus* ose *Wisdom of Sirach*, një nga librat apokrifalë, apo deuterokanonikë që gjenden në disa Bibla bashkë me librat e DHV. Po ashtu edhe *Urtësia* dhe *Makabejtë*. *Jubilejtë* është pjesë e një grupi shkrimesh të vjetra të quajtura *Pseudoepigrafa*. (Shën i përkth)

NJB “ky besim u konsiderua”

“Kjo” i referohet besimit të Abrahamit në premtimet e Perëndisë.

“iu llogarit” (*logizomai*, krh. 3:28 dhe 11 herë në kapitullin 4) është një term kontabiliteti që do të thotë “iu atribuuu” apo “iu depozitua në llogari dikujt” (krh. LXX Zan. 15:6; Lev. 7:18; 17:4). Po kjo e vërtetë shprehet bukur në II Kor. 5:21 dhe Gal. 3:6. Është e mundur që Pali i kombinoi Zan. 15:6 dhe Ps. 32:2 sepse të dy përdorin termin “llogarit.” Ky kombinim i teksteve është një parim hermeneutik i përdorur nga rabinët.

Përdorimi i këtij termi në DHV në Septuagintë nuk është aq shumë një term bankar sesa një term kontabiliteti, ndoshta i lidhur me “librat” e Dan. 7:10; 12:1. Këta dy libra metaforikë (kujtesa e Perëndisë) janë

1. libri i veprave apo i kujtimit (krh. Ps. 56:8; 139:16; Isa. 65:6; Mal. 3:16; Zbu. 20:12-13)
2. libri i jetës (krh. Eks. 32:32; Ps. 69:28; Isa. 4:3; Dan. 12:1; Luka 10:20; Fil. 4:3; Heb. 12:23; Zbu. 3:5; 13:8; 17:8; 20:15; 21:27).

Libri në të cilin besimi i Abrahamit u shënuar nga Perëndia si drejtësi është “libri i jetës.”

4:3,5,6,9,10,11,13,22,25 “si drejtësi” Kjo reflektonte termin e DHV “kallam matës” (*tsadak*). Ishte një metaforë nga ndërtimi e përdorur për karakterin e Perëndisë. Perëndia është i drejtë dhe të gjithë njerëzit janë të shtrembër. Në DHR përdorej në një kuptim pozicional, ligjor i cili me shpresë po ecën drejt karakteristikave të një mënyre jetese të perëndishme. Synimi i Perëndisë për çdo të krishterë është karakteri i Tij, ose e thënë ndryshe, ngjashmëria me Krishtin (krh. 8:28-29; Gal. 4:19). Shih Temën e Veçantë: Drejtësia në 1:17.

4:5 Thelbi i besimit është reagimi apo përgjigjia ndaj Perëndisë i Cili na e zbulon Vetën, pa u mbështetur përfundimisht në përpjekjet apo meritën personale. Kjo nuk do të thotë që pasi shpëtohemi dhe kemi Frymën brendabanues mënyra jonë e jetesës nuk ka rëndësi. Synimi i krishtërit nuk është vetëm qielli/parajsa kur të vdesim, por edhe ngjashmëria me Krishtin tani. Ne nuk shpëtohemi, shfajësohemi, apo na jepet një pozitë e drejtë nga veprat tona, por ne shpengohemi për vepra të mira (krh. Efe. 2:8-9 & Jakobi dhe I Gjonit). Një jetë e ndryshuar dhe në ndryshim është prova që dikush është i shpëtuar. Shfajësimi duhet të prodhojë shenjtërim!

■ **“beson”** Kjo është një PËRCJELLORE VEPRORE. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË : BESIM, BESOJ, OSE ZË BESË/KAM BESIM (*Pistis* [EMËR] *Pisteuō* [FOLJE], *Pistos* [MBIEMËR])

A. Ky është një term shumë i rëndësishëm në Bibël (shih Heb. 11:1, 6). Është tema e predikimit të hershëm të Jezusit (shih Marku 1:15). Ekzistojnë të paktën dy kërkesa për besëlidhjen e re: pendimi dhe besimi (Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21).

B. Etimologjia e tij

1. Termi “besim” në DhV donte të thoshte besnikëri ose besueshmëri dhe ishte përshkrim i natyrës së Perëndisë, jo sonës
2. Vinte nga një term hebraisht (*emun, emunah*), që donte të thoshte “të jesh i sigurt, ose i qëndrueshëm”. Besimi shpëtues është pranimit mendtor (grup të vërtetash), jetesë morale (stil jetese) dhe, pikë së pari, një përkushtim në marrëdhënie (mirëseardhja e një personi) dhe i vullnetshëm (një vendim) ndaj atij personi.

C. Përdorimi i saj në DhV

Duhet theksuar se besimi i Abrahamit nuk ishte në një Mesi të ardhshëm, por në premtimin e Perëndisë se do të kishte një fëmijë dhe pasardhës (shih Zanafilla 12:2; 15:2-5; 17:4-8; 18:14). Abrahami iu përgjigj këtij premtimi duke besuar në Perëndinë. Ai ende kishte dyshime dhe probleme për këtë premtim, për të cilin u deshën trembëdhjetë vjet për t’u përmbushur. Megjithatë, Perëndia ia pranoi besimin e tij të papërsosur. Perëndia është i gatshëm të punojë me qenie njerëzore me të meta, të cilët i përgjigjen atij dhe premtimeve të tij me besim, edhe nëse ky besim ka madhësinë e një fare sinapi (shih Mat. 17:20).

D. Përdorimi i saj në DhR

Termi “besoi” vjen nga fjala greke (*pisteuō*), që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “siguri në diçka”. Për shembull, ky EMËR nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Në Gjoni 2:23-25 ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termimit “besoj” gjenden në Gjoni 8:31-59 dhe Veprat

8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa reagim fillestar. Ai duhet pasuar nga procesi i dishepullizimit (shih Mat. 13:20-22, 31-32).

E. Përdorimi i saj me PARAFJALË

1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vënë besimin në Jezusin
 - a. në emrin e tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjonit 5:13)
 - b. në të (Gjoni 2:11; 3:15,18; 4:39; 6:40; 7:5,31,39,48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45,48; 12:37,42; Mat. 18:6; Veprat 10:43; Fil. 1:29; 1 Pje. 1:8)
 - c. në mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25,26; 12:44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20)
 - d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjonit 5:10)
 - e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat 19:4; Gal. 2:16)
 - f. në Dritën (Gjoni 12:36)
 - g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)
2. *en* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat 5:14
3. *epi* do të thotë “në” ose mbi, si te Mat. 27:42; Veprat 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5,24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pjet. 2:6
4. RASA DHANORE pa asnjë PARAFJALË, si te Gal. 3;6; Veprat 18:8; 27:25; 1 Gjonit 3:23; 5:10
5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, jep përmbajtjen e asaj që duhet besuar
 - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)
 - b. Jezusi është Unë Jami (Gjoni 8:24)
 - c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në të (Gjoni 10:38)
 - d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)
 - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)
 - f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
 - g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
 - h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)
 - i. Jezusi e identifikoi veten me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
 - j. Ne do të jetojmë me të (Rom. 6:8)
 - k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)



NASB, NKJV “besimi i tij”
NRSV “besim i tillë”
TEV, NJB “është ky besim”

Besimi i Abrahamit iu numërua atij si drejtësi. Kjo nuk u bazua në veprimet e Abrahamit, por në përgjigjen/reagimin e tij. Veprimet e tij e konfirmuan besimin e tij (krh. Jakobi 2:14-26).

Fjala “llogarit” përdoret gjithashtu edhe për Finehasin në LXX Ps. 106:31, i cili i referohet Num. 25:11-13. Në këtë rast llogaritja bazohej në veprimet e Finehasit, por nuk ishte kështu me Abrahamin te Zan. 15:6!

■ **“por beson në Atë që shfajëson të paperëndishmin, besimi i tij i llogaritet si drejtësi”** Kjo është një deklaratë shokuese! Është një paralel i qartë ndaj Abrahamit në v. 3 (Zan. 15:6). Drejtësia është dhuratë e Perëndisë (shih shënimin te 3:24), jo rezultat i performancës njerëzore. Shih Temën e Veçantë te 1:17.

■ **“Davidi”** Ashtu si Abrahami nuk ishte individ i përsosur, megjithatë ishte në pozitë të drejtë me Perëndinë me anë të besimit, po ashtu edhe Davidi mëkatar (krh. Ps. 32 dhe 51). Perëndia e do njerëzimin e rënë dhe punon me atë (Zanafilla 3) që tregon besim në Të (DHV) dhe në Birin e Tij (DHR).

4:6 “pa vepra” Pali e thekson këtë frazë duke e vendosur atë pikërisht përpara citimit të tij nga DHV (krh. Ps. 32:1-2). Njerëzimi është në rregull me Perëndinë me anë të hirit të Tij të ndërmjetësuar përmes Krishtit nëpërmjet besimit të personit individual, jo performancës fetare (krh. 3:21-31; Efe. 2:8-9).

4:7-8 Ky është një citim nga Ps. 32:1-2. Të dyja FOLJET në v. 7, “i janë falur” dhe “i janë mbuluar” janë AORISTE PËSORE. Perëndia është agjenti i nënkuptuar. Vargu 8 përmban një MOHIM TË DYFISHTË të fortë, “në asnjë

rrethanë, nuk do t'ia" atribuojë, llogaritë, marrë parasysh. Vini re të tre FOLJET në këtë citim; të gjitha tregojnë heqjen/mosngarkimin e mëkatit.

4:7 “që i janë mbuluar mëkatet” Ky është një citim nga Ps. 32:1. Koncepti i “mbulimit” ishte qëndror për aspektin e fljimeve fesë së Izraelit (d.m.th., Levitiku 1-7). Perëndia duke e mbuluar mëkatit (AORISTE PËSORE DËFTORE), Ai e hiqte atë nga sytë e Tij (krh. Isa. 38:17; Mik. 7:19, Brown, Driver, Briggs, fq. 491). Po ky koncept, por me një fjalë tjetër hebraike për “mbulim” (*capfar*), përdorej në ritualin e Ditës së Shlyerjes së mëkatit (mbulimit), ku gjaku i vendosur mbi “pajturesin” mbulonte mëkatet e Izraelit (d.m.th., Levitiku 16). Një metaforë biblike e lidhur me të do të ishte “fshij (me gomë)” (krh. Isa. 1:18; 43:25) ose “shuaj (me bojë)” (krh. Veprat 3:19; Kol. 2:14; Zbu. 3:5) mëkatit e dikujt.

4:8 “Lum njeriu të cilit Zoti nuk do t'ia llogaritë mëkatit” Ky është një citim nga Ps. 32:2. Është termi “llogarit,” “ngarkoj,” ose “depozitoj në llogarinë e një tjetri,” përdorur në kuptimin negativ. Perëndia nuk e ngarkon mëkatit (MOHORE E DYFISHTË) në llogarinë bankare shpirtërore të një besimtari; Ai ngarkon drejtësinë. Kjo bazohet në karakterin e hirshëm të Perëndisë, në dhuratën dhe shpalljen e Tij, jo në meritën, arritjen apo vlerën njerëzore!

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 4:9-12

⁹A është kjo lumturi atëherë për të rrethprerët, apo edhe për të parrethprerët? Sepse ne themi, “Besimi iu llogarit Abrahamit si drejtësi.” ¹⁰Si iu llogarit? Kur ai ishte i rrethprerë, apo i parrethprerë? Jo kur ishte i rrethprerë, por kur ishte i parrethprerë; ¹¹dhe ai mori shenjën e rrethprerjes, një vulë të drejtësisë së besimit të cilin ai e kishte kur ishte i parrethprerë, në mënyrë që të mund të jetë ati i të gjithëve të besojnë pa qenë të rrethprerë, që drejtësia të mund t'iu llogaritet atyre, ¹²dhe ati i rrethprerjes për ata që jo vetëm janë nga rrethprerja, por që gjithashtu ecin në gjurmët e besimit të atit tonë Abraham, të cilin ai e pati kur ishte ende i parrethprerë.

4:9-12 Pali ndoshta e përfshiu këtu këtë diskutim të rrethprerjes për shkak të theksit të judaistëve mbi nevojën e rrethprerjes për shpëtim (krh. librin e Galatasve dhe Këshillin e Jerusalemit te Veprat 15).

Pali i trainuar në eksegjezën rabinike, e dinte se në Zan. 15:6 dhe Ps. 32:2 del e njëjta FOLJE (edhe në tekstin hebraik, edhe në Septuagintë). Kjo do t'i kishte bashkuar këto pasazhe për qëllime teologjike.

4:9 Pyetja e v. 9 pret një përgjigje “jo.” Perëndia i pranon të gjithë njerëzit, edhe johebrenjtë, me anë të besimit. Zanafilla 15:6 citohet sërish. Abrahami, ati i kombit hebre, u llogarit i drejtë (krh. Zanafilla 15) përpara Ligjit të Moisiut (v. 13) dhe para se të rrethpritej (krh. Zanafilla 17).

4:10-11 “shenjën e rrethprerjes, një vulë të drejtësisë së besimit” Pasi Abrahami ishte thirrur dhe llogaritur si i drejtë, Perëndia i dha atij rrethprerjen si një shenjë e besëlidhjes (Zan. 17:9-14). Të gjithë popujt e Lindjes së Afërme në lashtësi ishin të rrethprerë, me përjashtim të Filistejve të cilët ishin me origjinë greke nga Ishujt e Egjeut. Rrethprerja për ta ishte një rit kalimi nga fëmijëria në burri. Në jetën hebreje ajo ishte një simbol fetar i anëtarësisë në besëlidhje, që kryhej tek meshkujt në ditën e tetë pas lindjes.

Në këtë varg, “shenjë” dhe “vulë” janë paralele dhe të dyja i referohen besimit të Abrahamit. Rrethprerja ishte një shenjë e dukshme e dikujt që ushtronte besim në Perëndinë. Frazja GJINORE “të drejtësisë së besimit” përsëritet në v. 13. Kyçi për të qenë i deklaruar i drejtë me një Perëndi të shenjtë nuk ishte rrethprerja, por besimi.

4:11 “në mënyrë që të mund të jetë ati i të gjithëve të besojnë pa qenë të rrethprerë” Libri i Romakëve u shkrua pas librit të Galatasve. Pali ishte i ndjeshëm ndaj prirjes hebreje të të besuarit në (1) prejardhjen e tyre racore (krh. Mat. 3:9; Gjoni 8:33,37,39) dhe (2) në mbajtjen e interpretimeve judaike të besëlidhjes Moisiiane (Tradita Gojore, apo tradita e pleqve e cila më vonë u shkrua dhe u quajt Talmudi). Prandaj, ai e përdori Abrahamin si modelin e atyre që besojnë me anë të besimit (ati i johebrenjve të parrethprerë, që besojnë, krh. 2:28-29; Gal. 3:29).

■ **“vula”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: VULA

Vula mund të ketë qenë mënyrë e lashtë për të treguar

1. të vërtetën (shih Gjoni 3:33)
2. pronësinë (shih Gjoni 6:27; 2 Tim. 2:19; Zbu. 7:2-3)
3. siguri ose mbrojtje (shih Zan. 4:15; Mat. 27:66; Rom. 15:28; 2 Kor. 1:22; Efe. 1:13; 4:30)
4. mund të jetë edhe shenjë e realitetit të premtimit të një dhurate nga Perëndia (shih Rom. 4:11 dhe 1 Kor. 9:2)

Qëllimi i kësaj vule është të identifikojë popullin e Perëndisë në mënyrë që zemërimi i Perëndisë të mos i prekë. Vula e Satanit identifikon njerëzit e tij, të cilët janë objekt i zemërimit të Perëndisë. Në Zbulesë, “mundimi” (pra, *thlipsis*) nënkupton gjithmonë përndjekjen e besimtarëve nga jobesimtarët, ndërsa zemërimi/tërbimi (pra, *orgē* ose *thumos*) është gjithmonë gjykimi i Perëndisë mbi jobesimtarët në mënyrë që ata të pendohen dhe të kthehen në besim te Krishti. Ky synim pozitiv i gjykitimit mund të shihet në mallkimet/bekimet e besëlidhjes të Ligji i Përtërirë 27-28.

Fraza “Perëndia i gjallë” është lojë fjalësh me titullin YHWH (shih Eks. 3:14; Psa. 42:2; 84:2; Mat. 16:16). Kjo lojë fjalësh gjendet edhe në zotimet biblike, “ashtu si Zoti jeton”.

4:12 “ecin në gjurmët” Ky ishte një term ushtarak (*stoicheō*) për ushtarët që marshonin në njësh-kolonë (krh. Vep. 21:24; Gal. 5:25; 6:16; Fil. 3:16). Pali po flet në këtë varg për hebrenjtë (“ati i rrethprerjes”) që besojnë. Abrahami është ati i të gjithëve që ushtrojnë besim në Perëndinë dhe premtimet e Tij.

Për shkak të njëjës së dyfishtë (*tois*) është e mundur që ky aspekt i dytë (“ecja në gjurmët e”) shton konceptin e besimit si mënyrë jetese (PËRCJELLORE JOVEPRORE [deponente]) dhe jo një besimi që ndodh vetëm një herë. Shpëtimi është një marrëdhënie e vazhdueshme, jo thjesht një vendim apo moment i vullnetshëm.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 4:13-15

¹³Sepse premtimi ndaj Abrahamit apo pasardhësve të tij që ai do të ishte trashëgimtar i botës nuk ishte përmes Ligjit, por përmes drejtësisë së besimit. ¹⁴Sepse, nëse ata që janë nga Ligji janë trashëgimtarë, besimi zhvleftësohet dhe premtimi anulohet; ¹⁵sepse Ligji sjell zemërim, por ku nuk ka ligj, nuk ka as shkelje.

4:13 “sepse premtimi ndaj Abrahamit apo pasardhësve të tij” Perëndia i bëri premtimin për “tokën dhe farën” Abrahamit (krh. Zan. 12:1-3; 15:1-6; 17:1-8; 22:17-18). DHV u fokusua te toka (Palestina), por DHR u fokusua te “fara” (Jezusi, Mesia, krh. Gal. 3:16,19), por këtu “fara” u referohet njerëzve të besimit (krh. Gal. 3:29). Premtimet e Perëndisë janë baza për besimin e të gjithë besimtarëve (cf. Gal. 3:14,17,18,19, 21, 22,29; 4:28; Heb. 5:13-18).

▣ **“që ai do të ishte trashëgimtar i botës”** Kjo deklaratë universale është shumë domethënëse nën dritën e Zan. 12:3; 18:18; 22:18 dhe Eksodit 19:5-6. Perëndia e thirri Abrahamin për të thirrur gjithë njerëzimin (krh. Zan. 1:26-27; 3:15)! Abrahami dhe pasardhësit e tij duhej të ishin një mjet zbuluese për të gjithë botën. Kjo është një mënyrë tjetër referimi për Mbretërinë e Perëndisë në tokë (krh. Mat. 6:10).

▣ **“nuk ishte përmes Ligjit”** Ligji i Moisiut ende nuk ishte zbuluar. Kjo frazë ishte e para në fjalinë në greqisht për të shprehur rëndësinë e saj. Kjo ishte një pikë shumë e rëndësishme e cila thekson dallimin midis përpjekjeve njerëzore dhe hirit hyjnor (krh. 3:21-31). Hiri e ka bërë ligjin të papërdorshëm si një mënyrë shpëtimi (krh. Heb. 8:7, 13). Shih Temën e Veçantë: Pikëpamjet e Palit për Ligjin e Moisiut te 13:9.

4:14 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i autorit apo për qëllimet e tij letrare. Pali po e përdorte këtë deklaratë befasuese për të thurur argumentin e tij logjik. Ky është një shembull i mirë i një FJALIE KUSHTORE TË KLASIT TË PARË të përdorur për theksim retorik. Ai nuk besonte se kjo thënie ishte e vërtetë, por e tha për të nxjerrë në pah gabimin e saj të qartë (krh. v. 2).

Hebrenjtë si racë, me shenjë e dukshme të rrethprerjes nuk do të jenë trashëgimtarë të botës, por ata që ushtrojnë besim në vullnetin dhe fjalën e Perëndisë janë trashëgimtarë. Nuk është rrethprerja fizike shenja e vërtetë e besëlidhjes, por besimi (krh. 2:28-29).



NASB, NKJV “besimi zhvleftësohet”
NRSV “besimi është asgjë”
TEV “besimi i njeriut nuk do të thotë asgjë”
NJB “besimi bëhet i pakuptimtë”

Kjo është një formë E KRYER PËSORE DËFTORE e *kenoō*, që thekson një gjendje të stabilizuar të një FOLJEJE të fortë greke që do të thotë “të zbrazësh”, “të tregosh se është pa themel,” madje edhe “të falsifikosh” (krh. I Kor. 1:17). Ky term u përdor nga Pali edhe në I Kor. 1:17; 9:15; II Kor. 9:3 dhe Fil. 2:7.



NASB “premtimi anulohet”
NKJV “premtimi bëhet pa efekt”
NRSV “premtimi është i pavlefshëm”
TEV “premtimi i Perëndisë është i pavlerë”
NJB “premtimi nuk vlen asgjë”

Edhe kjo është një formë E KRYER PËSORE DËFTORE, që thekson një gjendje të stabilizuar të një FOLJEJE greke që do të thotë “të zbrazësh,” “të anulosh,” “të japësh fund,” dhe madje “të shkatërrosh apo asgjësosh.” Ky term u përdor nga Pali edhe te Rom. 3:3,31; 6:6; 7:2,6; I Kor. 2:6; 13:8; 15:24,26; II Kor. 3:7; Gal. 5:4; II Thes. 2:8. Në këtë varg ka një paralelizëm të qartë. Nuk ka dy rrugë për në shpëtim. Besëlidhja e re e hirit i ka anuluar dhe shfuqizuar veprat e besëlidhjes së vjetër! Shih Temën e Veçantë: Anuloj dhe Shfuqizoj te 3:3.

4:15 “Ligji...ligji” Përdorimi i parë i këtij termi e ka NYJEN në greqisht, kurse i dyti jo. Megjithëse është e rrezikshme të tërheqësh shumë vëmendje në praninë apo mungesën e NYJES në greqisht, në këtë rast duket sikur kjo ndihmon për të treguar se Pali po e përdorte këtë term në dy kuptime.

1. Ligji i Moisiut me Traditën e tij Gojore në të cilën po besonin disa hebrenj për shpëtimin e tyre
2. koncepti i ligjit në përgjithësi

Ky kuptim më i gjerë do të përfshinte edhe johebrenjtë e vetëdrejtë që konformoheshin me këtë apo atë kod etik kulturor ose me rite fetare dhe ndjeheshin të pranuar nga hyjnia bazuar mbi performancën e tyre/atë që bënin.

▣ **“Ligji sjell zemërim”** Kjo është një deklaratë tronditëse (krh. 3:20; Gal. 3:10-13; Kol. 2:14). Ligji i Moisiut nuk kishte asnjëherë synim të ishte një rrugë shpëtimi (krh. Gal. 3:23-29). Kjo do të kishte qenë një e vërtetë shumë e vështirë për t’u kuptuar apo pranuar nga çdo hebre (apo legalist), por është themeli i argumentit të Palit. Shih Temën e Veçantë te 13:9.

▣ **“por ku nuk ka ligj, nuk ka as shkelje”** Perëndia e mban njerëzimin përgjegjës për dritën që ka. Johebrenjtë nuk do të gjykohen me anë të Ligjit të Moisiut, të cilin ata kurrë nuk e dëgjuan. Ata do të jepnin llogari sipas zbulësës natyrore (krh. 1:19-20; 2:14-15).

Kjo e vërtetë çohet një hap më tej në argumentin e Palit këtu. Përpara se Ligji i Moisiut të zbulonte qartësisht Perëndinë, Ai nuk i regjistroi shkeljet e njerëzimit (krh. 3:20,25; 4:15; 5:13,20; 7:5,7-8; Vep. 14:16; 17:30; I Kor. 15:56).

TEKSTI I NASB I PËRDITËSUAR: 4:16-25

¹⁶Për këtë arsye është me anë të besimit, që të *mund të jetë* në përputhje me hirin, në mënyrë që premtimi t’iu garantohet të gjithë pasardhësve, jo vetëm atyre që janë nga Ligji, por edhe atyre që janë nga besimi i Abrahamit, i cili është ati i ne të gjithëve, ¹⁷(siç është shkruar, “UNË TË BËRA ATË TË SHUMË KOMBEVE”) në praninë e Atij të Cilit ai i besoi, Perëndisë, që u jep jetë të vdekurve dhe thërret në ekzistencë atë që nuk ekziston. ¹⁸Me shpresë kundër çdo shprese ai besoi, që të mund të bëhej atë i shumë kombeve sipas asaj që ishte thënë, “KËSHTU DO TË JENË PASARDHËSIT E TU.” ¹⁹Pa u bërë i dobët në besim ai mendoi trupin e tij, tani gati si i vdekur meqë ishte rreth njëqind vjeç, dhe vdekësinë e mitrës së Sarës; ²⁰megjithatë, në lidhje me premtimin e Perëndisë ai nuk u lëkund në mosbesim, por u forcua në besim, duke i dhënë lavdi Perëndisë, ²¹dhe duke qenë plotësisht i sigurt se atë që Perëndia kishte premtuar, Ai ishte i aftë edhe ta realizonte. ²²Prandaj gjithashtu KJO IU LLOGARIT ATIJ SI DREJTËSI. ²³Tani jo vetëm për hir të tij u shkrua

se kjo i llogarit atij, ²⁴por edhe për hirin tonë, që do të na llogaritet, si ata që besojnë në Atë i Cili ngjalli Jezusin, Zotin tonë, nga të vdekurit, ²⁵Ai i Cili u dorëzua për shkak të shkeljeve tona, dhe u ringjall për shkak të shfajësimit tonë.

4:16 Kjo është një përmbledhje e bukur e argumentit të Palit nga v. 14,

1. njerëzit duhet të përgjigjen me anë të besimit
2. ndaj premtimit të hirit të Perëndisë
3. premtimi ishte i sigurt për të gjithë pasardhësit e Abrahamit (hebrenj dhe johebrenj) që ushtrojnë besim
4. Abrahami ishte modeli i të gjithëve që janë nga besimi



NASB, NRSV,

TEV, NIV “garantohet”

NKJV “i sigurt”

REB “i vlefshëm”

NET “i padyshimtë”

Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: GARANCI

Ky është termi grek *bebaios*, i cili ka tre nuanca kuptimore.

1. ajo që është e sigurt, e padyshimtë, apo mbi të cilën mund të mbështetesh (krh. Rom. 4:16; II Kor. 1:7; Heb. 2:20; 3:6,14; 6:19; II Pjet. 1:10,19)
2. procesi me anë të të cilit tregohet apo vërtetohet besueshmëria e diçkaje (krh. Rom. 15:8; Heb. 2:2, krh. Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament*, Vol. 1, fq. 340,377,670).
3. në papiruse u bë një term teknik për një garanci ligjore (krh. Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament*, fq. 107-8).

Kjo do të ishte antiteza e v. 14. Premtimet e Perëndisë janë të sigurt!

■ “të gjithë...të gjithëve” Këto iu referohet të gjithë besimtarëve (hebrenj dhe johebrenj).

4:17-23 Pali përsëri e përdori Abrahamin për të treguar përparësinë e (1) premtimeve të hirit të iniciuara nga Perëndia (besëlidhje) dhe (2) reagimit të nevojshëm nga ana e njerëzimit me besim fillestar dhe besim të vazhdueshëm (besëlidhje, shih shënimin te 1:5). Besëlidhjet gjithmonë përfshijnë veprimet e të dy palëve.

4:17 “siç është shkruar, ‘ATË TË SHUMË KOMBEVE’” Ky është një citim nga Zan. 17:5. Septuaginta (LXX) e ka “johebrenjve.” Perëndia gjithnjë ka dashur shpengimin e të gjithë fëmijëve të Adamit (krh. Zan. 3:15), jo thjesht të fëmijëve të Abrahamit. Emri i ri i Abramit, Abraham, do të thotë “ati i një shumice.” Tani ne e dimë që kjo përfshin jo thjesht pasardhësit fizikë, por pasardhësit e besimit.

■ “që u jep jetë të vdekurve” Në kontekst kjo u referohet aftësive të ripërtëritura seksuale të Abrahamit dhe Sarës (krh. v. 19).

■ “thërret në ekzistencë atë që nuk ekziston” Në kontekst kjo i referohet shtatzanisë së Sarës me Isakun, por gjithashtu ajo tregon një aspekt kyç të besimit (krh. Heb. 11:1).

4:18

NASB “me shpresë kundër çdo shprese ai besoi”

NKJV “i cili, kundër shpresës, me shpresë besoi”

NRSV “duke shpresuar kundër shpresës, ai besoi”

TEV “Abrahami besoi dhe shpresoi, madje edhe kur nuk kishte asnjë arsye për të shpresuar”

NJB “Megjithëse nuk dukej asnjë shpresë, ai shpresoi dhe besoi”

Tema e Veçantë mbi “shpresën” gjendet në 12:12. Termi ka një fushë të gjerë semantike. Harold K. Moulton, *The Analytical Greek Lexicon Revised*, fq. 133, liston disa përdorime.

1. kuptimi bazë, shpresë (krh. Rom. 5:4; Veprat 24:15)
2. objekti i shpresës (krh. Rom. 8:24; Gal. 5:5)
3. autori ose burimi (krh. Kol. 1:27; I Tim. 1:1)
4. besim, siguri (krh. I Pjet. 1:21)
5. në siguri me një garanci (krh. Veprat 2:26; Rom. 8:20)

Në këtë kontekst shpresa përdoret në dy kuptime të ndryshme. Shpresë në aftësinë dhe fuqinë njerëzore (krh. vv. 19-21) përkundër shpresës në premtimin e Perëndisë (krh. v. 17).



NASB, NKJV “Kështu do të jenë pasardhësit e tu”
NRSV “Kaq të shumtë do të jenë pasardhësit e tu”
TEV “pasardhësit e tu do të jenë të shumtë”
NJB “pasardhësit e tu do të jenë të shumtë si yjet”

Ky është një citim nga Zan. 15:5 që theksoi sigurinë e premtimit të Perëndisë ndaj Abrahamit në lidhje me një bir (krh. vv. 19-22). Mbani mend se Isaku lindi

1. trembëdhjetë vjet pas premtimit
2. pasi Abrahami u përpoq ta jepte Sarën (dy herë, krh. Zan. 12:10-19; 20:1-7)
3. pasi Abrahami pati një bir me Agarën, shërbyesen egjiptase të Sarës (krh. Zan. 16:1-16)
4. pasi edhe Sara, (krh. Zan. 18:12) edhe Abrahami (krh. Zan. 17:17) qeshën me premtimin

Abrahami dhe Sara nuk kishin besim të përsosur! Falë Perëndisë, shpëtimi nuk kërkon besim të përsosur, por vetëm objektin e duhur (Perëndinë në DHV dhe Birin e Tij në DHR).

4:19 “ai mendoj” Ky tekst ndjek dorëshkrimet \aleph , A, B, C. Por disa dorëshkrime të lashta unciale shtojnë një PJESËZ mohore (*ou*), D, F, G. UBS⁴ nuk është në gjendje të marrë një vendim (klasifikimi “C”), por ka shtypur tekstin më të shkurtër. Bibla NET po ashtu mbështet tekstin më të shkurtër.

4:20 Fillimisht Abrahami nuk e kuptoi plotësisht premtimin, që fëmija do të vinte nga Sara. Madje as besimi i Abrahamit nuk ishte i përsosur. Perëndia e pranon dhe punon me besimin e papërsosur, sepse Ai i do njerëzit e papërsosur!

■ **“nuk u lëkund në mosbesim”** E njëjta FOLJE, *diakrinō*, përdoret nga Jezusi te Mat. 21:21; Marku 11:23. Abrahami kishte arsye (krh. v. 19) për ta vënë në dyshim fjalën e Perëndisë (premtimin), por në vend të kësaj, ai u forcua.

Të dyja foljet në v. 20 janë AORISTE PËSORE DËFTORE. DIATEZA PËSORE nënkupton se agjenti veprues është Perëndia, por Abrahami duhej të lejonte (besëlidhja) që fuqia e Perëndisë ta fuqizonte atë!

■ **“duke i dhënë lavdi Perëndisë”** Shih Temën e Veçantë te 3:23.

4:21

NASB “duke qenë plotësisht i sigurt”
NKJV, NRSV “duke qenë plotësisht i bindur”
TEV “ishte absolutisht i sigurt”
NJB “plotësisht i bindur”

Kjo është një PËRCJELLORE AORISTE PËSORE, e cila tregon një siguri të plotë për diçka (krh. Luka 1:1; Kol. 4:12) ose dikë (krh. Rom. 4:21; 14:5). EMRI përdoret për sigurinë e plotë te Kol. 2:2 dhe I Thes. 1:5. Kjo siguri në vullnetin, fjalën dhe fuqinë e Perëndisë bën të mundur që njerëzit të veprojnë me besim!

■ **“atë që Perëndia kishte premtuar, Ai ishte i aftë edhe ta realizonte”** Kjo është E KRYER, JOVEPRORE (deponente) DËFTORE, që kishte kuptimin se një veprim në të shkuarën ka arritur në pikën e konsumimit dhe kalon në një gjendje të qeni. Thelbi i besimit është që dikush beson në karakterin dhe premtimet e Perëndisë (krh. 16:25; Efe. 3:20; Juda 24) dhe jo në performancën njerëzore. Besimi beson në Perëndinë e premtimeve (krh. Isa. 55:11).

4:22 Ky është një aluzion për Zan. 15:6 (krh. v. 3), e cila është pika kyçe teologjike e argumentit të Palit në lidhje me se si Perëndia ua jep drejtësinë e Tij njerëzve mëkatarë.

4:23-25 Këto vargje janë një fjali në greqisht. Vini re progresionin.

1. për hir të Abrahamit, v. 23
2. për hir të të gjithë besimtarëve, v. 24
3. me anë të ringjalljes së Jezusit nga Perëndia, v. 24
4. Jezusi u dha për mëkatin tonë (krh. Gjoni 3:16), Jezusi u ringjall që mëkatet tona të falen (shfajësimi), v. 25

4:24 Besimi i Abrahamit u bë një model që ta ndiqnin të gjithë pasardhësit e vërtetë. Abrahami i besoi (shih Temën e Veçantë te 4:5) Perëndisë në lidhje me një bir të premtuar dhe pasardhës. Besimtarët e Besëlidhjes së Re besojnë se Jezus Mesia është përmbushja e të gjitha premtimeve të Perëndisë ndaj njerëzimit të rënë.

Termi “farë” është edhe NJËJËS, edhe SHUMËS (një bir, një popull).

■ për “ngjalli” shih shënimin në 8:11.

4:25 “i Cili u dorëzua për shkak të shkeljeve tona” Ky ishte një term ligjor që do të thoshte “të dorëzosh dikë për ndëshkim.” Vargu 25 është një deklaratë e mrekullueshme Kristologjike që reflekton Septuagintën (LXX) e Isa. 53:11-12.

■ **“u ringjall për shkak të shfajësimit tonë”** Dy fjalitë e varura të v. 25 janë paralele (e njëjta PARAFJALË dhe të dyja janë AORISTE, PËSORE, DËFTORE), por për arsye stilistike, jo teologjike (krh. 5:9-10; II Kor. 13:4). Përkthimi i Frank Stagg (*New Testament Theology*, p. 97) “dorëzuar për shkak të shkeljeve tona dhe ringjallur me qëllimin për të na bërë të drejtë” është për t’u përgëzuar. Ky interpretim përfshin dy aspekte të përdorimit nga Pali të termit “shfajësoj” (1) një pozicion ligjor dhe (2) një jetë e krishterë e perëndishme! Shih Temën e Veçantë te 1:17.

Ringjallja e Jezusit është një e vërtetë qendrore teologjike për Palin (krh. 1:3-4; 4:24-25; 6:4,9; 7:4; 8:11,34; 10:9; I Kor. 6:14; 15:3-11,20-23; II Kor. 1:9; 4:14; 5:15; 13:4; Gal. 1:1; Efe. 2:20; Kol. 2:12; I Thes. 1:10; II Tim. 2:8). Varri është bosh, ose përndryshe krishtërimi është gënjeshtër (krh. I Kor. 15:12-19)!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Pse është kaq i rëndësishëm ky seksion i Romakëve?
2. Pse përdori Pali Abrahamin dhe Davidin si shembuj?
3. Përkufizoni fjalët kyçe të mëposhtme, sipas përdorimit të Palit (jo përkufizimin tuaj)
 - a. “drejtësi”
 - b. “llogaritur”
 - c. “besim”
 - d. “premtim”
4. Pse ishte rrethprerja kaq e rëndësishme për hebrenjtë (vv. 9-12)?
5. Kujt i referohet “fara” në vargjet 13 dhe 16?

ROMAKËVE 5

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME					
UBS⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB	
Rezultatet e shfajësimit	Besimi triumfon në telashe	Pasojat e shfajësimit	Të drejtë me Perëndinë	Besimi shpëtimin	garanton
5:1-11	5:1-5 Krishti në vendin tonë 5:6-11	5:1-5 5:6-11	5:1-5 5:6-11	5:1-11	
Adami dhe Krishti	Vdekje në Adamin, jetë në Krishtin	Adami dhe Krishti; analogji dhe kontrast	Adami dhe Krishti	Adami dhe Jezus Krishti	
5:12-14	5:12-21	5:12-14	5:12-14b 5:14c-17	5:12-14	
5:15-21		5:15-17 5:18-21	5:18-19 5:20-21	5:15-21	

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Vargjet 1-11 janë një fjali në greqisht. Ata zhvillojnë konceptin strumbullar të Palit të “Shfajësimit me anë të hirit nëpërmjet besimit” (krh. 3:21-4:25).
- B. Përvijime të mundshme të vv. 1-11:

Vargjet 1-5	Vargjet 6-8	Vargjet 9-11
1. Përfitimet e shpëtimit	1. Baza për shpëtim	1. Siguria e ardhme e shpëtimit

2. Përvojat subjektive të shfajësimit	2. Faktet objektive të shfajësimit	2. Siguria e ardhme e shfajësimit
3. Shfajësimi	3. Shenjtërimi progresiv	3. Përlëvdimi
4. Antropologjia	4. Teologjia	4. Eskatologjia

C. Vargjet 12-21 janë një diskutim i Jezusit si Adami i dytë (krh. I Kor. 15:21-22, 45-49; Fil. 2:6-8). Ai thekson konceptet teologjike si të mëkatit individual, ashtu edhe të fajit kolektiv. Shtjellimi që i bën Pali rënies së njerëzimit (dhe të krijimit) në Adamin ishte shumë unik dhe i ndryshëm nga i rabinëve (të cilët e zhvillonin doktrinën e tyre të mëkatit nga Zanafilla 6), kurse pikëpamja e tij e kolektivitetit ishte shumë e ngjashme me mësimet rabinike. Kjo tregon aftësinë e Palit nën frymëzim për të përdorur ose shtuar të vërtetat që i ishin mësuar gjatë trainimit të tij në Jerusalem nën Gamalielin (krh. Veprat 22:3).

Doktrina e reformuar ungjillore e mëkatit fillestar nga Zanafilla 3 u zhvillua nga Augustini dhe Kalvini. Ajo pak a shumë thotë se njerëzit janë të lindur mëkatarë (ligësia/shthurja totale). Shpesh Psalmi 51:5; 58:3 dhe Jobi 15:14 përdoren si baza nga DHV. Pozicioni alternativ teologjik që njerëzit janë përgjegjës në mënyrë progresive, morale dhe shpirtërore për zgjedhjet dhe fatin e tyre u zhvillua nga Pelagius dhe Arminius. Ka disa prova për pikëpamjen e tyre në LiP. 1:39; Isa. 7:15 dhe Jona 4:11; Gjoni 9:41; 15:22,24; Veprat 17:30; Rom. 4:15. Domethënia kryesore e pozicionit të tyre teologjik do të ishte që fëmijët janë të pafajshëm deri në një moshë të përgjegjësisë morale (për rabinët kjo ishte 13 vjeç për djemtë dhe 12 vjeç për vajzat).

Ekziston një pozicion i ndërmjetëm në të cilin janë të vërteta si një prirje e lindur për të bërë të keqen, dhe një moshë e përgjegjësisë morale! E keqja nuk është vetëm kolektive, por një e keqe që zhvillohet e individit për të mëkatuar (jeta bëhet gjithnjë e më e larguar nga Perëndia). Ligësia e njerëzimit nuk vihet në diskutim (krh. Zan. 6:5,11-12,13; Rom. 3:9-18,23), por kur, në lindje apo më vonë në jetë?

D. Ka patur një sërë teorish në lidhje me domethënien e v. 12

1. të gjithë njerëzit vdesin, sepse të gjithë njerëzit zgjodhën të mëkatonin (Pelagius)
2. mëkati i Adamit e ndikoi mbarë krijimin dhe kështu të gjithë vdesin (vv. 18-19, Augustini)
3. në realitet është ndoshta një kombinim i mëkatit fillestar dhe mëkatit të vullnetshëm

E. Krahasimi i Palit “ashtu si” që fillon në v. 12 nuk përfundon deri në v. 18. Vargjet 13-17 formojnë një parantezë e cila është shumë karakteristike e shkrimeve të Palit.

F. Kujtoni që prezantimi i ungjillit nga Pali, 1:18-8:39, është një argument i gjatë. Duhet parë i gjithi që të interpretohen dhe vlerësohen siç duhet të gjitha pjesët.

G. Martin Luteri ka thënë për kapitullin 5, “Në të gjithë Biblën zor se ka ndonjë kapitull tjetër që mund të barazohet me këtë tekst triumfal.”

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:1-5

¹Prandaj, duke qenë të shfajësuar me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë përmes Zotit tonë Jezus Krisht ²përmes të Cilit gjithashtu kemi fituar hyrjen tonë me anë të besimit në këtë hir në të cilin qëndrojmë; dhe ngazëllohemi në shpresën e lavdisë së Perëndisë. ³Dhe jo vetëm këtë, por edhe ngazëllohemi në mundimet tona, duke ditur se mundimi sjell këmbënguljen; ⁴dhe këmbëngulja karakter të provuar; dhe karakteri i provuar, shpresë; ⁵dhe shpresa nuk zhgënjën, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur brenda zemrave tona përmes Frymës së Shenjtë që na u dha.

5:1 “Prandaj” Kjo fjalë shpesh sinjalizonte

1. përmbledhjen e argumentit teologjik deri në këtë pikë
2. konkluzionet që bazoheshin në këtë prezantim teologjik
3. besimi i tij ishte përpara dhënies së Ligjit të Moisiut (krh. Eksodi 19-20)

▣ **“duke qenë të shfajësuar”** Kjo është një PËRCJELLORE PËSORE E KRYER; Perëndia i ka shfajësuar besimtarët. Kjo vendoset e para në fjalinë në greqisht (vv. 1-2) për theksim. Duket se ka një sekuençë kohore në vv. 1-11.

1. vv. 1-5, përjetimi ynë i tanishëm i hirit
2. vv. 6-8, puna e përfunduar e Krishtit në emrin tonë/për ne
3. vv. 9-11, shpresa jonë e ardhme dhe siguria e shpëtimit

Shih përvijimin, B. te Të Dhëna Kontekstuale.

Sfondi i DHV (mbani mend që autorët e DHR janë mendimtarë hebrej që shkruajnë në greqishten e rrugës) i termit “i shfajësuar” (*dikaioō*) ishte një “teh i drejtë” ose “kallam matës.” Ajo u përdor në mënyrë metaforike për Perëndinë Vetë. Shih Temën e Veçantë: Drejtësia te 1:17. Karakteri, shenjtëria e Perëndisë janë i vetmi standard gjykimi (krh. LXX e Lev. 24:22; dhe teologjikisht te Mateu 5:48). Për shkak të vdekjes flijuese, zëvendësuese të Jezusit (krh. Isaia 53), besimtarët kanë një qëndrim pozicional ligjor përpara Perëndisë (shih shënimin te 5:2). Kjo nuk nënkupton mungesën e fajit te besimtari, por diçka si amnisti. Dikush tjetër e ka paguar gjobën (krh. II Kor. 5:21). Besimtarët janë shpallur të falur (krh. vv. 9,10).

▣ **“me anë të besimit”** Besimi është dora që pranon dhuratën e Perëndisë (krh. v. 2; Rom. 4:1e më tej). Besimi nuk fokusohet në shkallën apo intensitetin e përkushtimit apo vendosmërisë së besimtarit (krh. Mat. 17:20), por në karakterin dhe premtimet e Perëndisë (krh. Efe. 2:8-9). Fjala e DHV për “besim” fillimisht i referohej dikujt në një pozicion ku mund të ishte i qëndrueshëm. Me kalimin e kohës u përdor në mënyrë metaforike për dikë që ishte besnik, i besueshëm dhe i besës. Besimi nuk fokusohet në besnikërinë apo besueshmërinë tonë, por në atë të Perëndisë. Shih Temën e Veçantë: Besimi te 4:5.

▣ **“kemi paqe”** Këtu ka një variant në dorëshkrimet në greqisht. Kjo FOLJE është ose E TASHME VEPRORE LIDHORE (*echōmen*), dorëshkrimet κ^* , A, B*, C, D) ose E TASHME VEPRORE DËFTORE (*echomen*, dorëshkrimet κ^1 , B², F, G). E njëjta dykuptimshmëri gramatikore gjendet në vv. 1, 2 & 3.

1. Nëse është në MËNYRËN LIDHORE do të përkthehej “le të vazhdojmë të gëzojmë paqe” ose “vazhdojmë të gëzojmë paqe.”
2. Nëse është në MËNYRËN DËFTORE atëherë do të përkthehej “kemi paqe.”

Konteksti i vv. 1-11 nuk është nxitja, por deklarimi i atyre gjërave që besimtarët janë dhe kanë tashmë përmes Krishtit. Prandaj, FOLJA është ndoshta E TASHME VEPRORE DËFTORE “kemi paqe.” USB⁴ i jep këtij opsioni një vlerësim “A” (i sigurt).

Shumë dorëshkrime në greqisht u bënë në këtë mënyrë: një person e lexonte tekstin dhe disa të tjerë bënin kopje. Fjalët që shqiptoheshin në mënyrë të ngjashme shpesh ngatërroheshin. Ky është një rast ku konteksti dhe disa herë stili dhe fjalori i zakonshëm i autorit ndihmon për ta bërë vendimin e përkthimit më të lehtë.

▣ **“paqe”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: PAQE (kuptime të ndryshme)

Ky term në greqisht fillimisht kishte kuptimin “të lidhësh atë që ishte e thyer.” DHR flet për paqen në tre mënyra:

1. një aspekt objektiv, paqja jonë me Perëndinë përmes Krishtit (krh. Kol. 1:20)
2. një aspekt subjektiv, fakti që jemi në rregull me Perëndinë (krh. Gjoni 14:27; 16:33; Fil. 4:7)
3. që Perëndia ka bashkuar në një trup të ri, përmes Krishtit, edhe hebrejtë besimtarë, edhe johebrejtë besimtarë (krh. Efe. 2:14-17; Kol. 3:15). Pasi kemi paqe me Perëndinë, ajo duhet të rezultojë në paqe me të tjerët! Vertikalja duhet të bëhet horizontale.

Newman dhe Nida, *A Translator's Handbook on Paul's Letter to the Romans*, fq. 92, ka një koment të mirë në lidhje me “paqe.”

“Edhe në Dhiatën e Vjetër, edhe në Dhiatën e Re termi paqe ka një spektër të gjerë kuptimor. Kryesisht ai përshkruan mirë-qenien totale të jetës së një personi; madje ishte adoptuar midis hebrenjve si një formulë përshëndetjeje (*shalom*). Ky term kishte një kuptim kaq të thellë, sa që mund të përdorej nga hebrenjtë edhe si përshkrim i shpëtimit Mesianik. Për shkak të këtij fakti, ka raste kur ai përdoret pothuaj sinonimisht me termin e përkthyer ‘të jesh në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë.’ Këtu termi duket se përdoret si një përshkrim i marrëdhënies harmonioze të vendosur midis njeriut dhe Perëndisë mbi bazën e faktit që Perëndia e ka vendosur njeriun në një pozitë të drejtë me Vetën e Tij” (fq. 92).

▣ **“me Perëndinë përmes Zotit tonë Jezu Krisht”** Jezusi është agjenti veprues (*dia*, krh. vv. 2,9,11,17,21; i Frymës në v. 5) që sjell paqe me Perëndinë. Jezusi është e vetmja mënyrë për të patur paqe me Perëndinë (krh. Gjoni 10:7-8; 14:6; Veprat 4:12; I Tim. 2:5). Për termat në titullin “Zoti Jezu Krisht” shih shënimet te 1:4.

5:2 “kemi fituar hyrjen tonë” Kjo FOLJE është E KRYER VEPRORE DËFTORE; ajo flet për një veprim të shkuar i cili është konsumuar dhe tani rezulton në një gjendje.

Termi “hyrje” fjalë për fjalë do të thotë “mundësi hyrjeje” ose “pranim” (*prosagōgē*, krh. Efe. 2:18; 3:12). Ajo me kalimin e kohës u përdor në mënyrë metaforike për të treguar

1. që dikush prezantohej personalisht përpara personave mbretërorë nga një palë e tretë
2. që dikush sillej shëndoshë e mirë në një port (krh. I Pjet. 3:18)

Kjo frazë përmban një variant në dorëshkrimet greke. Disa dorëshkrime të lashta shtojnë “me anë të besimit” (krh. \aleph^{*2} , C, si edhe disa versione në latinishten e vjetër, në Vulgatë, në gjuhën siriake dhe në gjuhën kopte). Dorëshkrime të tjera i shtojnë një parafjalë frazës “me anë të besimit” (krh. \aleph^1 , A, dhe disa versione të Vulgatës). Megjithatë, dorëshkrimet uncialle B, D, F dhe G nuk e kanë farë këtë frazë. Duket se skribët thjesht plotësuan paralelizmin e 5:1 dhe 4:16 (dy herë), 19, dhe 20. “Me anë të besimit” është lajtmotivi i përsëritur i Palit!

▣ **“në këtë hir”** Ky term (*haris*) kishte kuptimin e dashurisë së pamerituar dhe pa kushte të Perëndisë (krh. Efe. 2:4-9). Ajo shihet qartë në vdekjen e Krishtit për njerëzimin mëkatar (krh. v. 8).

▣ **“në të cilin qëndrojmë”** Kjo është një tjetër formë E KRYER VEPRORE DËFTORE; fjalë për fjalë “ne qëndrojmë dhe vazhdojmë të qëndrojmë.” Kjo reflekton pozicionin teologjik të besimtarëve në Krishtin dhe përkushtimin e tyre për të mbetur në besim, gjë që kombinon paradoksin teologjik të sovranitetit të Perëndisë (krh. I Kor. 15:1) dhe vullnetit të lirë të njeriut (krh. Efe. 6:11, 13,14).

TEMË E VEÇANTË: QËNDROJ (HISTËMI)

Ky term i zakonshëm përdoret në disa kuptime teologjike në Dhiatën e Re

1. përforcoj/konsolidoj
 - a. Ligjin e DHV, Rom. 3:31
 - b. Drejtësinë e dikujt, Rom. 10:3
 - c. Besëlidhjen e Re, Heb. 10:9
 - d. Një porosi, II Kor. 13:1
 - e. Të vërtetën e Perëndisë, II Tim. 2:19
2. rezistoj shpirtërisht
 - a. ndaj djallit, Efe. 6:11
 - b. në ditën e gjykimit, Zbu. 6:17
3. rezistoj duke qëndruar i patundur
 - a. metaforë ushtarake, Efe. 6:14
 - b. metaforë civile, Rom. 14:4
4. një pozicion në të vërtetën, Gjoni 8:44
5. një pozicion në hir
 - a. Rom. 5:2

- b. I Kor. 15:1
 - c. I Pjet. 5:12
6. një pozicion në besim
- a. Rom. 11:20
 - b. I Kor. 7:37
 - c. I Kor. 15:1
 - d. II Kor. 1:24

7. një pozicion arrogance, I Kor. 10:12

Ky term shpreh edhe hirin dhe mëshirën besëlidhore të një Perëndie sovran, edhe faktin që besimtarët duhet t'i përgjigjen atij (hirit) dhe të mbahen pas tij me anë të besimit! Të dyja janë të vërteta biblike. Ato duhet të mbahen së bashku!

■ **“ngazëllohemi”** Kjo formë gramatikore mund të kuptohet si (1) E TASHME JOVEPRORE (deponente) DËFTORE “ne ngazëllohemi” ose (2) E TASHME JOVEPRORE (deponente) LIDHORE, “le të ngazëllohemi.” Studiuesit janë të ndarë mbi këta dy opsione. Nëse e marrim “ne kemi” në v. 1 si DËFTORE, atëherë përkthimi duhet të jetë konsistent deri në v. 3.

Rrënja e fjalës “ngazëllohemi” është “mburrem” (NRSV, JB). Shih Temën e Veçantë në 2:17. Besimtarët nuk ngazëllohen në veten e tyre (krh. 3:27), por në atë që Zoti ka bërë për ta (krh. Jer. 9:23-24). E njëjta rrënjë në greqisht përsëritet në vv. 3 dhe 11.

■ **“në shpresën e”** Pali shpesh e përdorte këtë term në disa kuptime të ndryshëm, por të lidhur me njëri-tjetrin. Shih shënimin në 4:18. Shpesh ai shoqërohej me kulminimin e besimit të besimtarit. Kjo mund të shprehet si lavdi, jetë e përjetshme, shpëtim përfundimtar, Ardhja e Dytë, etj. Kulminimi është i sigurt, por elementi kohë është i ardhshëm dhe i panjohur. Ai shpesh shoqërohej me “besim” dhe “dashuri” (krh. I Kor. 13:13; Gal. 5:5-6; Efe. 4:2-5; I Thes. 1:3; 5:8). Një listë e pjesshme e disa prej përdorimeve të Palit është më poshtë.

1. Ardhja e Dytë, Gal. 5:5; Efe. 1:18; Titit 2:13
2. Jezusi është shpresa jonë, I Tim. 1:1
3. Besimtari do t'i paraqitet Perëndisë, Kol. 1:22-23; I Thes. 2:19
4. Shpresë që ruhet në qiej, Kol. 1:5
5. Shpëtimi përfundimtar, I Thes. 4:13
6. Lavdia e Perëndisë, Rom. 5:2; II Kor. 3:12; Kol. 1:27
7. Siguria e shpëtimit, I Thes. 5:8-9
8. Jeta e përjetshme, Titit 1:2; 3:7
9. Rezultatet e pjekurisë së krishterë, Rom. 5:2-5
10. Shpengimi i gjithë krijimit, Rom. 8:20-22
11. Një titull për Perëndinë, Rom. 15:13
12. Kulminimi i adoptimit, Rom. 8:23-25
13. DHV si udhërrëfyes për besimtarët e DHR, Rom. 15:4

TEMË E VEÇANTË: SIGURIA

A. A mund ta dinë të krishterët që janë shpëtuar (krh. 1 Gjonit 5:13)? I Gjonit ka tri prova apo dëshmi.

1. Doktrinare (besimi) (vv. 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16; 5:11-12)
2. Të mënyrës së jetesës (bindja) (vv. 2-3; 2:3-6; 3:1-10; 5:18)
3. Shoqërore (dashuria) (vv. 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)

B. Siguria është bërë çështje denominacionale

1. Zhan Kalvin e bazoi sigurinë në zgjedhjen e Perëndisë. Ai tha që ne nuk mund të jemi kurrë të sigurt në këtë jetë.
2. Xhon Uesli e bazoi sigurinë në përjetimin fetar. Ai besonte se ne kemi aftësinë të jetojmë mbi (ta mposhtim) mëkatën e njohur.
3. Katolikët dhe Kisha e Krishtit e bazojnë sigurinë në një Kishë autoritative. Çelësi për sigurinë është grupi ku bën pjesë dikush.

4. Shumica e ungjillorëve e bazojnë sigurinë në premtimet e Biblës, të lidhura me frytin e Frymës në jetën e besimtarit (krh. Gal. 5:22-23).
- C. Unë mendoj që siguria parësore e njerëzimit të rënë është e lidhur me karakterin e Perëndisë Triun.
1. Dashurinë e Perëndisë Atë
 - a. Gjoni 3:16; 10:28-29
 - b. Romakëve 8:31-39
 - c. Efesianëve 2:5,8-9
 - d. Filipianëve 1:6
 - e. I Pjetrit 1:3-5
 - f. I Gjonit 4:7-21
 2. Veprimet e Perëndisë Bir
 - a. Vdekja për ne
 - 1) Veprat 2:23
 - 2) Romakëve 5:6-11
 - 3) II Korintasve 5:21
 - 4) I Gjonit 2:2; 4:9-10
 - b. Lutja kryepriiftërore (Gjoni 17:12)
 - c. Ndërhytja e vazhdueshme
 - 1) Romakëve 8:34
 - 2) Hebrenjve 7:25
 - 3) I Gjonit 2:1
 3. Shërbesën e Perëndisë Frymë e Shenjtë
 - a. Thirrja (Gjoni 6:44, 65)
 - b. Vulosja
 - 1) II Korintasve 1:22; 5:5
 - 2) Efesianëve 1:13-14; 4:3
 - c. Sigurimi
 - 1) Romakëve 8:16-17
 - 2) I Gjonit 5:7-13
- D. Por njerëzit duhet t'i përgjigjen ofertës së besëlidhjes së Perëndisë (edhe fillimisht, edhe vazhdimisht)
1. Besimtarët duhet të kthehen nga mëkati (pendimi) për te Perëndia përmes Jezusit (besimi)
 - a. Marku 1:15
 - b. Veprat 3:16,19; 20:21
 2. Besimtarët duhet ta pranojnë ofertën e Perëndisë në Krishtin
 - a. Gjoni 1:12; 3:16
 - b. Romakëve 5:1 (dhe nga analogjia 10:9-13)
 - c. Efesianëve 2:5,8-9
 3. Besimtarët duhet të vazhdojnë në besim
 - a. Marku 13:13
 - b. I Korintasve 15:2
 - c. Galatasve 6:9
 - d. Hebrenjve 3:14
 - e. II Pjetrit 1:10
 - f. Juda 20-21
 - g. Zbulesa 2:2-3,7,10,17,19,25-26; 3:5,10,11,21
 4. Besimtarët përballen me tri prova
 - a. doktrinare (vv. 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16)
 - b. të mënyrës së jetesës (vv. 2-3; 2:3-6; 3:1-10)
 - c. shoqërore (vv. 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)
- E. Siguria është e vështirë sepse
1. shpesh besimtarët kërkojnë përjetime që nuk premtohen në Bibël
 2. shpesh besimtarët nuk e kuptojnë plotësisht ungjillin
 3. shpesh besimtarët vazhdojnë të mëkatojnë me vetëdije (krh. I Kor. 3:10-15; 9:27; I Tim. 1:19-20; II

Tim. 4:10; II Pjet. 1:8-11)

4. disa lloje personaliteti (d.m.th. perfeksionistët) nuk mund ta pranojnë kurrë pranimin dhe dashurinë pa kushte
5. në Bibël ka shembuj të rrëfimeve të rreme të besimit (krh. Mat. 13:3-23; 7:21-23; Marku 4:14-20; II Pjet. 2:19-20; I Gjonit 2:18-19)

▣ **“lavdia e Perëndisë”** Kjo frazë është një idiomë e DHV për praninë personale të Perëndisë. Kjo i referohej qëndrimit të besimtarit përpara Perëndisë në besim-drejtësinë e siguruar nga Jezusi në Ditën e Ringjalljes (krh. II Kor. 5:21). Shpesh thirret me termin teologjik “përlëvdim” (krh. vv. 9-10; 8:30). Besimtarët do të kenë ngjashmëri me Jezusin (krh. I Gjonit 3:2; II Pjetrit 1:4). Shih Temën e Veçantë: Lavdia te 3:23.

5:3

NASB “dhe jo vetëm këtë, por”

NKJV “dhe jo vetëm atë, por”

NRSV “dhe jo vetëm atë, por”

TEV –e heqin–

NJB “jo vetëm atë”

Pali e përdor këtë kombinim termash disa herë (krh. 5:3,11; 8:23; 9:10, dhe II Kor. 8:19).

▣

NASB “edhe ngazëllohemi në mundimet tona”

NKJV “edhe gëzohemi në mundime”

NRSV “edhe mburremi në vuajtjet tona”

TEV “edhe mburremi në telashet tona”

NJB “le të ngazëllohemi edhe në vështirësitë tona”

Nëse bota e urreu Jezusin, ajo do të urrejë edhe ndjekësit e Tij (krh. Mat. 10:22; 24:9; Gjoni 15:18-21). Jezusi u poq/maturua, në kuptimin njerëzor, me anë të vuajtjeve që vuajti (krh. Heb. 5:8). Vuajtja prodhon besim dhe pjekuri. Ngjashmëria me Krishtin është plani i Perëndisë për çdo besimtar dhe vuajtja është pjesë e tij (krh. 8:17-19; Acts 14:22; James 1:2-4; I Pet. 4:12-19)!

TEMË E VEÇANTË: PSE VUAJNË TË KRISHTERËT?

1. Për shkak të mëkatit personal (gjykim i përkohshëm). Kjo nuk do të thotë që të gjitha problemet dhe rrethanat negative janë rezultat i mëkatit (krh. Jobi; Ps. 73; Luka 14:1-5; Neh. 9; Veprat 5:1-11; I Kor. 11:29-30; Gal. 6:7).
2. Për t’u bërë më shumë si Krishti (Heb. 5:8). Edhe Jezusi, nga ana njerëzore, duhejt të piquej, dhe po kështu edhe ndjekësit e Tij (krh. Rom. 5:3-4, 8:28-29; II Kor. 12:7-10; Fil. 3:10; Heb. 12:5-12; Jakobi 1:2-4; I Pjet. 1:7).
3. Për të krijuar një dëshmi të fuqishme, efektive (krh. Mat. 5:10-12; Gjoni 15:18-22; I Pjet. 2:18-21, 3:13-17).
4. Si shenjë e dhimbjeve të lindjes të Epokës së Re (krh. Mat. 24:6; Marku 13:8).

▣ **“duke ditur”** Kjo është një PËRCJELLORE E KRYER e “*oida*.” Është e kryer por funksionon si një KOHË E TASHME. Të kuptuarit e të vërtetave të ungjillit nga ana e besimtarëve dhe lidhja e këtyre të vërtetave me vuajtjen i lejon ata ta përballojnë jetën me një gëzim dhe siguri që nuk varet nga rrethanat, madje edhe gjatë përndjekjes (krh. Fil. 4:4; I Thes. 5:16,18). Besimtarët ngazëllohen “në” mundime, jo “për shkak të” tyre!

5:3 “mundim” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: MUNDIMI

Duhet të ketë një dallim teologjik midis mënyrës si e përdor Pali këtë term (*thlipsis*) dhe si e përdor Gjoni.

- A. Përdorimi i Palit (i cili reflekton përdorimin nga Gjoni)
1. probleme, vuajtje, të këqija që gjenden në një botë të rënë
 - a. Mat. 13:21
 - b. Rom. 5:3
 - c. I Kor. 7:28
 - d. II Kor. 7:4
 - e. Efe. 3:13
 2. probleme, vuajtje, të këqija të shkaktuara nga jobesimtarët
 - a. Rom. 5:3; 8:35; 12:12
 - b. II Kor. 1:4,8; 6:4; 7:4; 8:2,13
 - c. Efe. 3:13
 - d. Fil. 4:14
 - e. I Thes. 1:6
 - f. II Thes. 1:4
 3. probleme, vuajtje, të këqija të kohës së fundit
 - a. Mat. 24:21,29
 - b. Marku 13:19,24
 - c. II Thes. 1:6-9
- B. Përdorimi nga Gjoni
1. Gjoni bën një dallim specifik midis *thlipsis* dhe *orgē* apo *thumos* (zemërimi) të Zbulesa. *Thlipsis* është ajo që jobesimtarët u bëjnë besimtarëve dhe *orgē* dhe *thumos* është ajo që Perëndia u bën jobesimtarëve.
 - a. *thlipsis* – Zbu. 1:9; 2:9-10,22; 7:14
 - b. *orgē* – Zbu. 6:16-17; 11:18; 16:19; 19:15
 - c. *thumos* – Zbu. 12:12; 14:8,10,19; 15:2,7; 16:1; 18:3
 2. Gjoni gjithashtu e përdor këtë term në Ungjillin e tij për të reflektuar problemet që ndeshin besimtarët në çdo epokë – Gjoni 16:33.

5:3,4 “këmbëngulja” Ky term do të thoshte “vullnetare,” “aktive,” “e qëndrueshme,” “qëndrueshmëri.” Ishte një term që lidhej me durimin si me njerëzit, ashtu edhe me rrethanat. Shih Temën e Veçantë të 8:25.

5:4

NASB “karakter të provuar”
NKJV, NRSV “karakter”
TEV “miratimin e Perëndisë”
NJB “karakter të sprovuar”

Në LXX e Zan. 23:16; I Mbr. 10:18; I Kron. 28:18 ky term është përdorur për të provuar metalet për pastërti dhe vërtetësi (krh. II Kor. 2:9; 8:2; 9:13; 13:3; Fil. 2:22; II Tim. 2:15; Jakobi 1:12). Sprovat e Perëndisë janë gjithmonë për të forcuar (krh. Heb. 12:10-11)! Shih Temën e Veçantë: Vënia në provë të 2:18.

TEMË E VEÇANTË: RITJA E KRISHTERË

Romakëve 5:3-4

Mundimi shkakton

- * Qëndrueshmëri
- * Karakter të provuar
- * Shpresë (krh. v. 2)

Galatasve 5:22-23

Fryti i Frymës

- * Dashuria
- * Gëzimi
- * Paqja
- * Durimi
- * Mirëdashja
- * Mirësia

Jakobi 1:3-4

Sprovat prodhojnë

- * Qëndrueshmëri
- * Pjekuri
- 1. përsosmëri
- 2. plotësi

II Pjetrit 1:5-7

Zbatimi i zellit

- * shkëlqyeshmëri morale/virtyt
- * njohuri/dituri
- * vetë-kontroll
- * qëndresë
- * përëndishmëri

* Besimi
 * Zemërbutësia
 * Vetë-kontrolli

* dashuri vëllazërore
 (*philadelphia*)
 * dashuri të krishterë
 (*agapē*)

5:5 “shpresa nuk zhgënjën” Ky mund të jetë një aluzion ndaj një idiome hebreje (d.m.th. turpëron, krh. Ps. 25:3,20; 31:1,17; 119:116; Isa. 28:16 [cituar në Rom. 9:33]; Fil. 1:20).

▣ **“sepse dashuria e Perëndisë është derdhur brenda zemrave tona”** Kjo është E KRYER PËSORE DËFTORE; fjalë për fjalë, “dashuria e Perëndisë është derdhur dhe vazhdon të derdhet.” Kjo FOLJE përdorej shpesh për Frymën e Shenjtë (krh. Veprat 2:17,18,33; 10:45 dhe Titit 3:6), dhe mund të reflektojë Joelin 2:28-29 (Isa. 32:15).

FRAZA GJINORE, “dashuria e Perëndisë” gramatikisht mund t’i referohet (1) dashurisë sonë për Perëndinë, ose (2) dashurisë së Perëndisë për ne (krh. Gjoni 3:16; II Kor. 5:14). Numri dy është i vetmi option duke u nisur nga konteksti.

▣ **“Frymës së Shenjtë që na u dha”** Kjo është një PJESORE E KRYER PËSORE. Diateza pësore shpesh përdoret për të shprehur se agjenti është Perëndia. Kjo nënkupton se besimtarët nuk kanë nevojë për më shumë nga Fryma. Ata ose e kanë Frymën, ose nuk janë të krishterë (krh. 8:9). Dhënia e Frymës ishte shenja e Epokës së Re (krh. Joeli 2:28-29), Besëlidhjes së Re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-32).

▣ Vini re praninë e të tre personave hyjnorë të Trinisë në këtë paragraf.

1. Perëndia, vv. 1,2,5,8,10
2. Jezusi, vv. 1,6,8,9,10
3. Fryma, v. 5

Shih Temën e Veçantë: Trinia te 8:11.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:6-11

⁶Sepse ndërsa ishim ende të pandihmë, në kohën e duhur Krishti vdiq për të paperëndishmit. ⁷Sepse vështirë se ndonjë do të vdesë për një njeri të drejtë; megjithëse ndoshta për njeriun e mirë dikush mund edhe të guxonte të vdiste. ⁸Por Perëndia e tregon dashurinë e Tij ndaj nesh në atë që ndërsa ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne. ⁹Aq më tepër atëherë, pasi jemi tani të shfajësuar nga gjaku i Tij, do të shpëtohem nga zemërimi i Perëndisë nëpërmjet Tij. ¹⁰Sepse nëse, ndërsa ishim armiq, u pajtuam me Perëndinë përmes vdekjes së Birit të Tij, aq më tepër, pasi kemi qenë pajtuar, do të shpëtohem me anë të jetës së Tij. ¹¹Dhe jo vetëm kjo, por gjithashtu ngazëllohem në Perëndinë përmes Zotin tonë Jezu Krisht, përmes të Cilit kemi marrë tani pajtimin.

5:6

NASB “sepse ndërsa ishim ende të pandihmë”
NKJV “sepse kur ishim ende pa forcë”
NRSV “sepse ndërsa ishim ende të dobët”
TEV “sepse kur ishim ende të pandihmë”
NJB “kur ishim ende të pandihmë”

Kjo FOLJE është një PËRCJELLORE. Kjo i referohej natyrës së rënë Adamike të njerëzimit. Njerëzit janë të pafuqishëm kundrejt mëkatit. PËREMRI “ne” shpjegon dhe është paralel me EMRIN përshkrues në v. 6b “të paperëndishmit,” v. 8 “mëkatarë,” dhe v. 10 “armiq.” Vargjet 6 dhe 8 janë paralele nga ana teologjike dhe strukturore.

Vini re paralelizmin:

	(1)	(2)	(3)
v. 6	Ishim ende të pandihmë	Krishti vdiq për të paperëndishmit	---
v. 8	Ishim mëkatarë	Krishti vdiq për ne	---

v. 9	---	Me anë të gjakut të Tij	Pasi jemi tani të shfajësuar
v. 10	Ishim armiq	Vdekjes së Birit të Tij	Kemi marrë pajtimin

Të vërtetat kryesore janë përsëritur për theksim.

1. nevoja jonë
2. sigurimi i Krishtit
3. pozicioni ynë i ri



NASB, NRSV “në kohën e duhur”
NKJV “në kohën e përshtatshme”
TEV “në kohën që zgjodhi Perëndia”
NJB “në momentin e Tij të caktuar”

Kjo mund t’i referohet historikisht

1. paqes romake (dhe rrugëve) që lejonin lëvizje të lirë
2. gjuhës greke që lejonte komunikimin ndërkulturor
3. dështimit të perëndive greke dhe romake që kishte krijuar një botë në pritje dhe të uritur shpirtërisht (krh. Marku 1:15; Gal. 4:4; Efe. 1:10; Titit 1:3)

Teologjikisht mishërimi ishte një ngjarje e planifikuar, hyjnore (krh. Luka 22:22; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; Efe. 1:11).

5:6,8,10 “vdiq për të paperëndishmit” Kjo është AORISTE VEPRORE DËFTORE. Ajo e shikonte jetën dhe vdekjen e Jezusit si një ngjarje të unifikuar. “Jezusi pagoi një borxh që nuk e kishte të vetin, dhe ne kishim një borxh që nuk mund ta paguanim” (krh. Gal. 3:13; I Gjonit 4:10).

Vdekja e Krishtit është një temë që shfaqet herë pas here në shkrimet e Palit. Ai përdori disa terma të ndryshëm për t’iu referuar vdekjes zëvendësuese të Jezusit.

1. “gjaku” (krh. 3:25; 5:9; I Kor. 11:25,27; Efe. 1:7; 2:13; Kol. 1:20)
2. “e dha Vetën e Tij” (krh. Efe. 5:2,25)
3. “u dha” (krh. Rom. 4:25; 8:32)
4. “flijim” (krh. I Kor. 5:7)
5. “vdiq” (krh. Rom. 5:6; 8:34; 14:9,15; I Kor. 8:11;15:3; II Kor. 5:15; Gal. 5:21; I Thes. 4:14; 5:10)
6. “kryq” (krh. I Kor. 1:17-18; Gal. 5:11; 6:12-14; Efe. 2:16; Fil. 2:8; Kol. 1:20; 2:14)
7. “kryqëzim” (krh. I Kor. 1:23;2:2; II Kor. 13:4; Gal. 3:1)

PARAFJALA *huper* në këtë kontekst ka kuptimin

1. përfaqësim, “në emrin tonë”
2. zëvendësim, “në vendin tonë”

Normalisht kuptimi kryesor i *huper* me GJINOREN është “në emër të” (Louw dhe Nida). Ajo shpreh një avantazh që u kalon personave (*The New International dictionary of New Testament Theology*, vol. 3, fq. 1196). Megjithatë, *huper* e ka kuptimin e *anti*, që do të thotë “në vendin e,” duke iu referuar kështu teologjikisht një shlyerje zëvendësuese të deleguar (krh. Mark 10:45; Gjoni 11:50; 18:14; II Kor. 5:14; I Tim. 2:6). M. J. Harris (NIDNTT, vol. 3, fq.1197) thotë, “por pse nuk thotë Pali kurrë që Krishti vdiq *anti hēmōn* (I Tim. 2:6 është versioni më i afërt–*antilutron huper pantōn*)? Ndoshta sepse parafj. *huper*, ndryshe nga *anti*, mund të shprehë në të njëjtën kohë përfaqësim dhe zëvendësim.”

M. R. Vincent, *Word Studies*, vol. 2, thotë

“Është diskutuar shumë nëse *huper*, në emër të, është ndonjëherë e barazvlershme me *anti*, në vend të. Autorët klasikë na japin raste ku kuptimet duken se janë të ndërkëmbyera...Kuptimi i këtij pasazhi, megjithatë, është kaq i paqartë, saqë nuk mund të citohet si provë. Parafjala mund të ketë një kuptim vendor, *mbi* të vdekurit. Asnjë nga këta pasazhe nuk mund të konsiderohet si vendimtar. Më e shumta që mund të thuhet është që *huper* është shumë afër me kuptimin e *anti*. Në vend të rekomandohet kryesisht për arsye dogmatike. Në pjesën më të madhe të pasazheve kuptimi është qartazi *për hir të, në emër të*. Shpjegimi i

vërtetë duket të jetë që, në pasazhet që janë kryesisht në diskutim, domethënë ato që lidhen me vdekjen e Krishtit, si këtu, Gal. 3:13; Rom. 14:15; I Pjet. 3:18, *huper* karakterizon tezën më të pacaktuar dhe të përgjithshme – Krishti vdiq në emër të – duke e lënë kuptimin e veçantë të *në emër të* të pacaktuar, dhe për t'u vendosur nga pasazhet e tjera. Kuptimi *në vend të* mund të përfshihet në të, por vetëm logjikisht” (fq. 692).

5:7 Ky varg tregon dashurinë njerëzore, ndërsa vargu 8 dashurinë e Perëndisë!



NASB, NKJV,

TEV

“për një njeri të drejtë”

NRSV

“për një person të drejtë”

NJB

“për një njeri të mirë”

Ky term u përdor në të njëjtin kuptim siç ishin njerëz të drejtë ose të patëmetë Noeu dhe Jobi. Ata zbatonin rregullat fetare të kohës së tyre. Kjo nuk nënkupton pamëkatshmëri. Shih Temën e Veçantë te 1:17.

5:8 “Perëndia e tregon dashurinë e Tij” Kjo është E TASHME VEPRORE DËFTORE (krh. 3:5). Ati dërgoi Birin (krh. 8:3,32; II Kor. 5:19). Dashuria e Perëndisë nuk është sentimentale, por e orientuar nga veprimi (krh. Gjoni 3:16; I Gjonit 4:10) dhe konstante.

■ **“në atë që ndërsa ishim ende mëkatarë”** Tronditemi kur e kuptojmë se dashuria e Perëndisë iu manifestua “mëkatarëve,” jo njerëzve të perëndishëm, apo njerëzve të një origjine të caktuar kombëtare, por rebelëve! Hiri, jo merita, është e vërteta themelore! Perëndia ende dëshiron miqësi/bashkësi me njerëzit. Është karakteri i Tij i pandryshueshëm që na jep paqe dhe shpresë (krh. Eks. 34:6; Neh. 9:17; Ps. 103:8; 145:8).

5:9 “aq më tepër” Kjo ishte një nga shprehjet e preferuara të Palit (krh. vv. 10,15,17). Nëse Perëndia i deshi besimtarët aq shumë ndërsa ishin ende mëkatarë, sa më tepër i do tani që ata janë fëmijët e Tij (krh. 5:10; 8:22).

■ **“pasi jemi tani të shfajësuar”** Kjo është një PJESORE E KRYER PËSORE që thekson shfajësimin si një akt të përfunduar të kryer nga Perëndia. Pali po përsërit të vërtetën e v. 1. Gjithashtu vini re paralelizmin midis termave “shfajësuar” (v. 9) dhe “pajtuar” (vv. 10-11).

■ **“me anë të gjakut të Tij”** Kjo ishte një referencë për vdekjen flijuese të Krishtit (krh. 3:5; 4:25; Marku 10:45; II Kor. 5:21). Ky koncept i flijimit, një jetë e pafajshme e dhënë në vend të një jete fajtoresh, e ka origjinën që të Levitikut 1-7 dhe ka mundësi që nga Eksodi 12 (qengji i Pashkës), dhe iu aplikua teologjikisht Jezusit te Isa. 53:4-6. Zhvillohet në një kuptim kristologjik në librin e Hebrenjve (krh. kap. 9-10). Hebrenjve në fakt krahason Dhiatën e Vjetër me Dhiatën e Re në disa pika.

■ **“do të shpëtohem”** Kjo është E ARDHME PËSORE DËFTORE (krh. v. 10). Kjo i referohej shpëtimit tonë përfundimtar, që quhet “përlëvdim” (krh. v. 2; 8:30, I Gjonit 3:2).

DHR e përshkruan shpëtimit në të gjitha kohët e FOLJES.

1. një veprim i përfunduar (AORISTE), Veprat 15:11; Rom. 8:24; II Tim. 1:9; Titit 3:5
2. veprim i shkuar që rezulton në një gjendje të tanishme (E KRYER), Efe. 2:5,8
3. proces progresiv (E TASHME), I Kor. 1:18; 15:2; II Kor. 2:15; I Thes. 4:14; I Pjet. 3:21
4. kulminim i ardhshëm (E ARDHME), Rom. 5:9,10; 10:9.

Shih Temën e Veçantë te 10:4. Shpëtimi fillon me një vendim fillestar (krh. 10:9-13; Gjoni 1:12; 3:16) por përparon në një marrëdhënie moment pas momenti që një ditë do të arrijë pikën kulmore. Ky koncept shpesh përshkruhet me anë të tre termave teologjikë.

1. shfajësim, që do të thotë “të çlirohesh nga dënimi i mëkatit”
2. shenjtërim, që do të thotë “të çlirohesh nga pushteti i mëkatit”
3. përlëvdim, që do të thotë “të çlirohesh nga prania e mëkatit”

Ia vlen të vërejmë se shfajësimi dhe shenjtërimi janë të dy vepra të hirshme të Perëndisë, që i jepen besimtarit përmes besimit në Krishtin. Megjithatë, DHR flet për shenjtërimin si një proces i vazhdueshëm i ngjashmërisë me Krishtin. Për këtë arsye teologët flasin për “shenjtërim pozicional” dhe “shenjtërim progresiv.” Ky është misteri i një shpëtimi falas të lidhur me një jetë të perëndishme! Shih Temën e Veçantë te 6:4.

▣ **“nga zemërimi i Perëndisë”** Kjo është në një kontekst eskatologjik. Bibla na tregon për dashurinë e madhe, të pamerituar të Perëndisë, por gjithashtu na tregon qartë për kundërshtimin e vendosur të Perëndisë ndaj mëkatit dhe rebelimit. Perëndia ka siguruar një rrugë për shpëtim dhe falje përmes Krishtit, por ata që e refuzojnë Atë janë nën zemërim (krh. 1:18-3:20). Kjo është një frazë antropomorfike (shih Temën e Veçantë te 1:18), por ajo shpreh një realitet. Është gjë e tmerrshme të biesh në duart e një Perëndie të zemëruar (Heb. 10:31).

5:10 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Njerëzimi, krijimi më i lartë i Perëndisë (krh. Zan. 1:26-27), u bë armik! Njeriu (krh. Zan. 3:5) kishte një dëshirë për kontroll, një dëshirë për t’u bërë perëndi.

▣ **“u pajtuam me Perëndinë ... pasi kemi qenë pajtuar”** Kjo është edhe AORISTE PËSORE DËFTORE edhe PJESORE E KRYER PËSORE. FOLJA “pajtuar” (krh. I Kor. 7:11; II Kor. 5:18,19,20; gjithashtu vini re Kol. 1:20) fillimisht kishte kuptimin “shkëmbej.” Perëndia e ka shkëmbyer mëkatin tonë me drejtësinë e Jezusit (krh. Isa. 53:4-6). Paqja është rivendosur (krh. v. 1)!

▣ **“përmes vdekjes së Birit të Tij”** Ungjilli i faljes është i themeluar në

1. dashurinë e Perëndisë (krh. Gjoni 3:16)
2. veprën e Krishtit (8:32; Gal. 1:4; 2:20)
3. tërheqjen e Frymës (Gjoni 6:44,65),
4. reagimin me besim/pendim të një individi (Marku 1:15; Gjoni 1:12; Veprat 20:21)

Nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të qenë në rregull me Perëndinë (krh. 10:1-2,7-8; Gjoni 14:6; Veprat 4:12; I Tim. 2:5). Siguria e shpëtimit bazohet në karakterin e Perëndisë Triun (krh. Eks. 34:6; Neh. 9:17; Ps. 103:8; 145:8), jo në performancën njerëzore! Paradoksi është që performanca njerëzore pas shpëtimit është tregues i një shpëtimi falas (krh. Jakobi dhe I Gjonit).

▣ **“do të shpëtohem”** DHR flet për shpëtimin si të shkuar, të tashëm dhe të ardhëm. Këtu e ardhmja i referohet shpëtimit tonë përfundimtar, të plotë, në Ardhjen e Dytë (krh. I Gjonit 3:2). Shih shënimin te v. 9 dhe Temën e Veçantë te 10:13.

▣ **“me anë të jetës së Tij”** Ky term në greqisht për jetën është *zoa*. Ky term në shkrimet e Gjonit gjithmonë i referohet jetës së ringjallur, jetës së përvetshme ose jetës së mbretërisë. Pali gjithashtu e përdori atë në këtë kuptim teologjik. Kuptimi kryesor i këtij konteksti është që, meqë Perëndia pagoi një çmim kaq të lartë për faljen e besimtarëve, Ai patjetër do ta vazhdojë efektivitetin e tij.

“Jeta” mund t’i referohet ose

1. ringjalljes së Jezusit (krh. 8:34; I Kor. 15)
2. veprës ndërhyrëse të Jezusit (krh. 8:34; Heb. 7:25; I Gjoni 2:1)
3. Frymës që formon Krishtin në ne (krh. Rom. 8:29; Gal. 4:19)

Pali tha që jeta tokësore e Jezusit si edhe jeta e Tij e lartësuar (ngjitja në qiell, Veprat 1) janë baza për pajtimin tonë.

5:11 “Dhe jo vetëm kjo” Shih shënimin në vargun 3.

▣ **“gjithashtu ngazëllohem”** Shih shënimin te 5:2. Ky është përdorimi i tretë i “ngazëllohem” (mburrem) në këtë kontekst.

1. ngazëllohem në shpresën e lavdisë, v. 2
2. ngazëllohem në mundime, v. 3
3. ngazëllohem në pajtimin, v. 11

Mburrja negative shihet te 2:17 dhe 23!

▣ **“kemi marrë tani pajtimin”** Kjo është e KRYER VEPRORE DËFTORE, një veprim i përfunduar. Pajtimi i besimtarëve (“shkëmbej”) diskutohet edhe në v. 10 dhe II Kor. 5:18-21; Efe. 2:16-22; Kol. 1:19-23. Në këtë kontekst “pajtimi” është sinonimi teologjik i “shfajësimit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:12-14

¹²Prandaj, ashtu si nëpërmjet një njeriu mëkati hyri në botë, dhe vdekja përmes mëkatit, dhe kështu vdekja u përhap tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan – ¹³sepse deri te Ligji mëkati ishte në botë, por mëkati nuk llogaritet kur nuk ka ligj. ¹⁴Megjithatë vdekja mbretëroi nga Adami deri te Moisiu, madje edhe mbi ata që nuk kishin mëkatuar në ngjashmëri me shkeljen e Adamit, i cili është një tip i Atij që do të vinte.

5:12 “Prandaj” Letra e Romakëve ka disa “prandaj” të vendosura në mënyrë strategjike (krh 5:1; 8:1; 12:1). Pyetja interpretuese është me çfarë lidhen ato. Ato mund të jenë një mënyrë për t’iu referuar të gjithë argumentit të Palit. Me siguri kjo këtu lidhet me Zanafillën dhe, si e tillë, ndoshta edhe me Rom. 1:18-32.

■ **“ashtu si nëpërmjet një njeriu mëkati hyri në botë”** Të trija FOLJET në v. 12 janë në KOHËN AORISTE. Rënia e Adamit solli vdekjen (krh. I Kor. 15:22). Bibla nuk ndalet gjatë në origjinën e mëkatit. Mëkati ndodhi edhe në sferën engjëjlore (krh. Zan 3 dhe Zbu. 12:7-9). Si dhe kur janë të paqarta (krh. Isa. 14:12-27; Ezek. 28:12-19; Jobi 4:18; Mat. 25:41; Luka 10:18; Gjoni 12:31; Zbu. 12:7-9).

Mëkati i Adamit përfshinte dy aspekte (1) mosbindjen ndaj një urdhërimi specifik (krh. Zan. 2:16-17), dhe (2) krenaria e orientuar nga vetja (krh. Zan. 3:5-6). Kjo vazhdon aluzionin ndaj Zanafillës 3 të filluar te Rom. 1:18-32.

Është teologjia e mëkatit ajo që e ndan Palin shumë qartë nga mendimi rabinik. Rabinët nuk fokusoheshin te Zanafilla 3; në vend të kësaj ata thoshin se kishte dy “synime” (*yetzer*) në çdo person. Thënia e famshme rabinike ishte “Në zemrën e çdo njeriu është një qen i zi dhe një qen i bardhë. Ai që e ushqen më shumë, bëhet më i madh.” Pali e shikonte mëkatin si një barrierë madhore midis Perëndisë së shenjtë dhe krijimit të Tij. Pali nuk ishte një teolog sistematik (krh. librin e James Steward *A Man in Christ*). Ai dha disa origjina të mëkatit (1) rënia e Adamit, (2) tundimi satanik, dhe (3) rebelimi i vazhdueshëm njerëzor (shih Efe. 2:2-3).

Në kontrastet teologjike midis Adamit dhe Jezusit janë të pranishme dy rrjedhoja logjike të mundshme.

1. Adami ishte një person historik i vërtetë.
2. Jezusi ishte një qenie e vërtetë njerëzore

Të dyja këto të vërteta e mbështesin Biblën dhe jo mësimet e rreme. Vini re përdorimin e përsëritur të “një njeriu” ose “njërit.” Këto dy mënyra të referimit ndaj Adamit dhe Jezusit përdoren njëmbëdhjetë herë në këtë kontekst.

■ **“një njeriu”** Kjo frazë e përgjithshme (fj. për fj. *henos anthrōpou*) përdoret për të paraqitur Adamin (vv. 12,16,17,18,19) ose Jezusin (vv. 15 [dy herë], 17 [dy herë], 18,19). Secili përfaqëson një grup ose komunitet (dm.th., “shumë,” krh. vv. 15 [dy herë], 19 [dy herë]; “të gjithë,” krh. vv. 12,13,18 [dy herë]).

■ **“vdekja përmes mëkatit”** Augustini ishte i pari që krijoi termin “mëkati fillestar/original.” Ai përshkruan pasojat e zgjedhjeve të Adamit/Evës te Zanafilla 3. Rebelimi i tyre e ka ndikuar të gjithë krijimin. Njerëzit ndikohen nga

1. një sistem botëror i rënë
2. një tundues personal
3. një natyrë e rënë

Mëkati fillestar (vv. 12-14,16a,17) formon një parteritet me mëkatin personal (vv. 12d,16b) për t’i bërë të gjithë njerëzit mëkatarë! Mëkati rezulton në “vdekje” (krh. 1:32; 6:13,16,21,23; 7:5,9,10,11,13,24; 8:13).

The Jerome Biblical Commentary (fq. 308) përmend traditën rabinike që kishte tri periudha të historisë.

1. Adami – Moisiu
2. Moisiu – Mesia
3. Mesia – eskaton/fundi i kohërave

Nëse Pali po mendonte për këto tri ndarje atëherë

1. Adami – Moisiu (mëkati fillestar, s’kishte ligj, por vdekje)
2. Moisiu – Mesia (mëkati personal, shkelje e ligjit)
3. Mesia – (çlirim nga Ligji/ligji përmes hirit)

■ **“vdekja u përhap tek të gjithë njerëzit”** Theksi kryesor i këtij paragrafi është universaliteti i pasojave të mëkatit (krh. vv. 16-19; I Kor. 15:22; Gal. 1:10), që është vdekja.

1. vdekja shpirtërore – Zan. 2:17; 3:1-24; Isa. 59:2; Rom. 7:10-11; Efe. 2:1; Kol. 2:13; Jakobi 1:15

2. vdekja fizike – Zan. 3:4-5; 5:1-32
3. vdekja e përrjetshme– Zbu. 2:11; 20:6,14; 21:8

▣ **“sepse të gjithë mëkatuan”** Të gjithë njerëzit mëkatojnë në Adamin në tërësi (d.m.th., trashëguan një gjendje mëkatore dhe një prirje mëkatore). Për këtë shkak çdo person zgjedh të mëkatojë personalisht dhe në mënyrë të përsëritur. Bibla e thekson që të gjithë njerëzit janë mëkatarë, edhe bashkarisht, edhe individualisht (krh. I Mbr. 8:46; II Kron. 6:36; Ps. 14:1-2; 130:3; 143:2; Fja. 20:9; Pred. 7:20; Isa.9:17; 53:6; Rom. 3:9-18,23; 5:18;11:32; Gal. 3:22; I Gjonit 1:8-10).

Prapëseprapë duhet thënë se theksi kontekstual (krh. vv. 15-19) është që një veprim shkaktoi vdekjen (Adami) dhe një veprim shkakton jetë (Jezusi). Megjithatë, Perëndia e ka strukturuar marrëdhënien e Tij me njerëzimin në mënyrë të tillë që vullneti njerëzor të jetë një aspekt domethënës i “humbjes” dhe “shfajësimit.” Njerëzit janë të përfshirë me vullnet në fatet e tyre të përrjetshme! Ata vazhdojnë të zgjedhin mëkat, ose të zgjedhin Krishtin. Ata nuk mund t’i shkaktojnë këto dy zgjedhje, por me vullnetin e tyre tregojnë se cilës i përkasin!

Përkthimi “sepse” është i zakonshëm, por kuptimi i tij shpesh vihet në diskutim. Pali përdori *ef hō* në II Kor. 5:4; Fil. 3:12; dhe 4:10 në kuptimin e “sepse.” Kështu që çdo njeri zgjedh të marrë pjesë personalisht në mëkat dhe rebelim ndaj Perëndisë. Disa, duke hedhur poshtë zbuluesën e veçantë, por të gjithë duke hedhur poshtë zbuluesën natyrore (krh. 1:18-3:20).

5:13-14 E njëjta e vërtetë mësohet te Rom. 3:20; 4:15 dhe Veprat 17:30. Perëndia është i drejtë. Njerëzit janë përgjegjës vetëm për atë që është e disponueshme ndaj tyre. Ky varg po flet ekskluzivisht për zbuluesën e veçantë (DHV, Jezusi, DHR), jo për zbuluesën natyrore (Ps. 19:1-6; Rom. 1:18-23; 2:11-16).

Vini re që NKJV e sheh krahasimin e v. 12 si të ndarë nga një parantezë e gjatë (krh. vv. 13-17) nga mbyllja e tij në vv. 18-21.

5:14

NASB, NKJV,

NJB “vdekja mbretëroi”

NRSV “vdekja ushtroi pushtet”

TEV “vdekja sundoi”

Vdekja mbretëroi si një Mbret (krh. vv. 17 dhe 21). Ky personifikim i vdekjes dhe i mëkatit si tiranë ruhet gjatë gjithë këtij kapitulli dhe kapitullit 6. Përrjetimi universal i vdekjes konfirmon mëkatit universal të njerëzimit. Në vargjet 17 dhe 21, personifikohet hiri. Hiri mbretëron! Njerëzit kanë një zgjedhje (dy rrugët e DHV, d.m.th., vdekjen ose jetën, krh. LiP 11:26; 30:1,19), vdekjen ose jetën. Cila mbretëron në jetën tënde?

▣ **“madje edhe mbi ata që nuk kishin mëkatuar në ngjashmëri me shkeljen e Adamit”** Adami shkeli një urdhërim të qartë të Perëndisë (d.m.th., Zan. 2:15-17), kurse Eva nuk mëkatoi në të njëjtën mënyrë. Ajo dëgjoi nga Adami në lidhje me pemën, jo drejtpërdrejt nga Perëndia. Njerëzit nga Adami deri te Moisiu u ndikuan nga rebelimi i Adamit! Ata nuk shkelën një urdhërim specifik nga Perëndia, por 1:18-32, e cila është sigurisht pjesë e këtij konteksti teologjik, shpreh të vërtetën që ata shkelën dritën që kishin nga krijimi dhe si rezultat janë përgjegjës ndaj Perëndisë për rebelim/mëkat. Prirja mëkatore e Adamit u përhap tek të gjithë fëmijët e tij.

▣

NASB, NKJV,

NRSV “i cili është një tip i Atij që do të vinte”

TEV “Adami ishte një figurë e atij që do të vinte”

NJB “Adami parafiguroi Atë që do të vinte”

Kjo shpreh në një mënyrë shumë konkrete tipologjinë Adam-Krisht (krh. I Kor. 15:21-22,45-49; Fil. 2:6-8). Të dy shihen si të parët në një seri, origjina/fillimi e/i një race (krh. I Kor. 15:45-49). Adami është i vetmi person nga DHV që quhet specifikisht “tip” nga DHR (për “Izraelin” shih I Kor. 10:6). Shih Temën e Veçantë: Formë (*Tupos*) te 6:17.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:15-17

¹⁵Por dhurata falas nuk është si shkelja. Sepse, nëse nga shkelja e njërit të shumtët vdiqën, shumë më

tepër hiri i Perëndisë dhe dhurata me anë të hirit të një Njeriu, Jezus Krishtit, teproi për të shumtët.¹⁶Dhurata nuk është si ajo që erdhi nëpërmjet atij që mëkatoi; sepse nga njëra anë gjykimi u nxit nga një shkelje duke rezultuar në dënim, por nga ana tjetër dhurata falas u nxit nga shumë shkelje duke rezultuar në shfajësim.¹⁷Sepse, nëse me anë të shkeljes së njërit, vdekja mbretëroi përmes atij njërit, shumë më tepër ata që marrin bollëkun e hirit dhe të dhuratës së drejtësisë do të mbretërojnë në jetë përmes Njërit, Jezus Krishtit.

5:15-19 Ky është një argument i zgjatur duke përdorur fraza paralele. NASB, NRSV, dhe TEV e ndajnë paragrafin te v. 18. Kurse UBS⁴, NKJV, dhe JB e përkthejnë atë si një njësi. Mbani mend që çelësi për interpretimin e synimit origjinal të autorit është një e vërtetë kryesore për paragraf.

Vini re që termi “shumë,” vv. 15 & 19, është sinonim me “të gjithë” në vv. 12 dhe 18. Kjo është gjithashtu e vërtetë te Isa. 53:11-12 dhe v. 6. Nuk duhen bërë dallime teologjike (të zgjedhurit përkundër të pazgjedhurit e Kalvinit) bazuar në këto terma!

5:15 “dhurata falas” Ka dy fjalë të ndryshme greke për “dhuratë” të përdorura në këtë kontekst – *charisma*, vv. 15,16 (6:23) dhe *dorea/dorama*, vv. 15, 16, 17 (shih shënimin te 3:24)—por ato janë sinonime. Ky është vërtet Lajmi i Mirë për shpëtimin. Është një dhuratë falas nga Perëndia përmes Jezus Krishtit (krh. 3:24; 6:23; Efe. 2:8,9) ndaj të gjithëve që besojnë në Krishtin.

■ **“nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Mëkati i Adamit u solli vdekjen të gjithë njerëzve. Kjo paralelizohet në v. 17.

■ **“teproi”** Shih Temën e Veçantë te 15:13.

5:16 “dënim...shfajësim” Të dy këta janë terma ligjorë. Shpesh DHV e paraqet mesazhin e profetit si një skenë gjyqi. Pali përdor këtë formë (krh. Rom. 8:1, 31-34).

5:17 “nëse” Kjo është një tjetër FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË e cila supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Shkelja e Adamit rezultoi vërtet në vdekjen e të gjithë njerëzve.

■ **“shumë më tepër ata që marrin”** Vargjet 18-19 nuk janë tamam të ekuilibruara teologjikisht. Kjo frazë nuk mund të nxirret nga konteksti i Romakëve 1-8 dhe të përdoret si tekst për të provuar universalizmin (që të gjithë do të shpëtohen më në fund). Njerëzit duhet ta marrin (v. 17b) ofertën e Perëndisë në Krishtin. Shpëtimi është i disponueshëm për të gjithë, por duhet pranuar individualisht (krh. Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13).

Ky një akt rebelimi i Adamit rezultoi në rebelimin total të të gjithë njerëzve. Ky një akt mëkatar është zmadhuar! Por në Krishtin një flijim i drejtë zmadhohet për të mbuluar mëkatet e shumta individuale si edhe ndikimin e përgjithshëm të mëkatit. “Shumë më tepër” e aktit të Krishtit theksohet (krh. vv. 9,10,15,17). Hiri tepron!

5:17,18 “dhuratës së drejtësisë do të mbretërojnë në jetë...shfajësimin e jetës” Jezusi është dhurata dhe sigurimi i Perëndisë për të gjitha nevojat frymërore të njerëzimit të rënë (krh. I Kor. 1:30). Këto fraza paralele mund të kenë kuptimin

1. njerëzimit mëkatar i jepet një pozicion i drejtë me Perëndinë nëpërmjet veprës së përfunduar të Krishtit, gjë që rezulton në një “jetë të perëndishme”
2. kjo frazë është sinonime me “jetën e përjetshme”

Konteksti mbështet opsionin e parë. Për një studim fjale mbi drejtësinë shih Temën e Veçantë te 1:17.

Folja “mbretëroj” përdoret disa herë në këtë kontekst.

1. “vdekja mbretëroi nga Adami deri te Moisiu,” v. 14 (AORISTE VEPRORE DËFTORE)
2. “vdekja mbretëroi përmes atij njërit,” v. 17 (AORISTE VEPRORE DËFTORE)
3. “shumë më tepër ata që marrin bollëkun e hirit dhe të dhuratës së drejtësisë do të mbretërojnë në jetë,” v. 17 (E ARDHME VEPRORE DËFTORE)
4. “mëkati mbretëroi në vdekje,” v. 21 (E KRYER VEPRORE DËFTORE)
5. “hiri të mbretëronte,” v. 21 (E KRYER VEPRORE LIDHORE)

6. “le të mos mbretërojë mëkati,” 6:12 (E TASHME VEPRORE URDHËRORE)

Personifikimi nga ana e Palit i mëkatit dhe vdekjes përkundër dhuratës së hirit është një mënyrë e fuqishme për të shprehur të vërtetën teologjike!

TEMË E VEÇANTË: MBRETËRIMI NË MBRETËRINË E PERËNDISË

Koncepti i mbretërimit me Krishtin është pjesë e një kategorie teologjike më të madhe të quajtur “Mbretëria e Perëndisë.” Kjo është një mbartje nga koncepti i DHV i Perëndisë si mbreti i vërtetë i Izraelit (krh. I Sam. 8:7). Ai mbretëroi në mënyrë simbolike (I Sam. 8:7; 10:17-19) përmes një pasardhësi nga fisi i Judës (krh. Zan. 49:10) dhe nga familja e Jeseut (krh. II Sam. 7).

Jezusi është përmbushja e premtuar e profecisë së DHV në lidhje me Mesian. Ai e përuroi Mbretërinë e Perëndisë me mishërimin e Tij në Betlehem. Mbretëria e Perëndisë u bë shtylla qendrore e predikimit të Jezusit. Mbretëria kishte ardhur plotësisht në Të (krh. Mat. 10:7; 11:12; 12:28; Marku 1:15; Luka 10:9,11; 11:20; 16:16; 17:20-21).

Megjithatë, Mbretëria ishte edhe e ardhme (eskatologjike). Ishte e pranishme, por jo e kulminuar/konsumuar (krh. Mat. 6:10; 8:11; 16:28; 22:1-14; 26:29; Luka 9:27; 11:2; 13:29; 14:10-24; 22:16,18). Jezusi erdhi herën e parë si një shërbëtor i vuajtur (krh. Isa. 52:13-53:12); si i përulur (krh. Zak. 9:9) por Ai do të kthehet si Mbreti i Mbretërve (krh. Mat. 2:2; 21:5; 27:11-14). Koncepti i “mbretërimit” është padyshim një pjesë e kësaj teologjie të “mbretërisë.” Perëndia ua ka dhënë mbretërinë ndjekësve të Jezusit (shih Luka 12:32).

Koncepti i mbretërimit me Krishtin ka disa aspekte dhe pyetje.

1. A i referohen “mbretërimit” pasazhet që pohojnë se Perëndia ua ka dhënë besimtarëve “mbretërinë” përmes Krishtit (krh. Mat. 5:3,10; Luka 12:32)?
2. A u referohen fjalët e Jezusit drejtuar dishepujve fillestarë në kontekstin hebre të shekullit të parë të gjithë besimtarëve (krh. Mat. 19:28; Luka 22:28-30)?
3. Theksi i Palit mbi mbretërimin në këtë jetë tani a i kundërshton apo i plotëson tekstet e mësipërme (krh. Rom. 5:17; I Kor. 4:8)?
4. Si lidhet vuajtja me mbretërimin (krh. Rom. 8:17; II Tim. 2:11-12; I Pjet. 4:13; Zbu. 1:9)?
5. Lajtmotivi i përsëritur i Zbulesës është pjesëmarrja në mbretërimin e përlëvdur të Krishtit, por ai mbretërim është
 - a. Tokësor, 5:10
 - b. Mijëvjeçar, 20:5,6
 - c. I përjetshëm, 2:26; 3:21; 22:5 dhe Dan. 7:14,18,27

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 5:18-21

¹⁸Kështu pra, ashtu si përmes një shkeljeje erdhi dënimi tek të gjithë njerëzit, po ashtu përmes një akti drejtësie erdhi shfajësimi i jetës tek të gjithë njerëzit. ¹⁹Sepse ashtu si përmes mosbindjes së një njeriu të shumtët u bënë mëkatarë, po ashtu përmes bindjes së Njërit të shumtët do të bëhen të drejtë. ²⁰Ligji hyri në mënyrë që shkelja të shtohet; por atje ku mëkati u shtua, hiri teproi edhe më shumë, ²¹në mënyrë që, ashtu si mëkati mbretëroi në vdekje, po ashtu hiri do të mbretëronte përmes drejtësisë në jetë të përjetshme përmes Jezu Krishtit, Zotit tonë.

5:18

NASB

“po ashtu përmes një akti drejtësie erdhi shfajësimi i jetës tek të gjithë njerëzit”

NKJV

“po ashtu përmes aktit të drejtë të një Njeriu dhurata falas erdhi tek të gjithë njerëzit”

NRSV

“kështu akti i drejtësisë së një njeriu çon në shfajësim dhe jetë për të gjithë”

TEV

“në të njëjtën mënyrë ai një akt i drejtë i çliroi të gjithë njerëzit dhe u jep atyre jetë”

NJB

“kështu një akt i mirë i një njeriu i sjell jetë kujtdo dhe e bën atë të shfajësuar”

Kjo nuk do të thotë që çdo njeri do të shpëtohet (universalizmi). Ky varg nuk mund të interpretohet veçmas nga mesazhi i të gjithë librit të Romakëve dhe konteksti i tij i menjëhershëm. Kjo i referohet shpëtimit të

mundshëm të të gjithë njerëzve përmes jetës/vdekjes/ringjalljes së Jezusit. Njerëzimi duhet t'i përgjigjet ofertës së ungjillit me anë të pendimit dhe besimit (krh. Marku 1:15; Veprat 3:16,19; 20:21). Perëndia gjithmonë e merr iniciativën (krh. Gjoni 6:44,65), por Ai ka zgjedhur që çdo individ duhet të përgjigjet personalisht (krh. Mat. 11:28-29; Gjoni 1:12; 3:16; dhe Rom. 10:9-13). Oferta e Tij është universale (krh. I Tim. 2:4,6; II Pjet.3:9; I Gjonit 2:2), por misteri i paudhësisë është që shumë njerëz thonë “jo.”

“Akti i drejtësisë” është ose

1. E gjithë jeta e Jezusit në bindje dhe mësim që e zbuloi plotësisht Atin
2. Specifikisht vdekja e Tij në vend të njerëzimit mëkatar

Ashtu si jeta e një njeriu i ndikonte të gjithë (kolektiviteti/korporaliteti hebre, krh. Jozueu 7), po ashtu, një jetë e pafajshme i ndikonte të gjithë (Levitiku 1-7,16). Këta dy akte janë paralele, por jo të barabartë. Të gjithë ndikohen nga mëkati i Adamit, por të gjithë ndikohen vetëm potencialisht nga jeta e Jezusit, sepse janë vetëm besimtarët ata që e marrin dhuratën e shfajësimit. Akti i Jezusit gjithashtu ndikon, për ata që besojnë dhe e pranojnë, gjithë mëkatin njerëzor, të shkuar, të tashëm dhe të ardhëm!

5:18-19 “dënimi tek të gjithë njerëzit...shfajësimi i jetës tek të gjithë njerëzit...të shumtët u bënë mëkatarë... të shumtët do të bëhen të drejtë” Këto janë fraza paralele që tregojnë se termi “të shumtët” nuk është kufizues, por përfshirës. I njëjti paralelizëm gjendet tek Isa. 53:6 “të gjithë” dhe 53:11,12 “shumë.” Termi “shumë” nuk mund të përdoret në një kuptim kufizues për të limituar ofertën e Perëndisë për shpëtim ndaj të gjithë njerëzimit (të zgjedhurit përkundër të pazgjedhurit e Kalvinit).

Vini re DIATEZËN PËSORE të dy FOLJEVE. Ato i referohen veprimtarisë së Perëndisë. Njerëzit mëkatojnë në marrëdhënie me karakterin e Perëndisë (shkelet një standard) dhe ata shfajësohen në marrëdhënie me karakterin e Tij (një dhuratë e hirit të Tij).

5:19 “mosbindjes së një njeriu... bindjes së Njërit” Pali po përdorte konceptin teologjik të kolektivitetit/korporalitetit të Dhiatës së Vjetër. Veprimet e një personi e ndikojnë të gjithë komunitetin (krh. Akani tek Jozueu 7). Mosbindja e Adamit dhe Evës solli gjykimin e Perëndisë mbi gjithë krijimin (krh. Zanafilla 3). I gjithë krijimi është ndikuar nga pasojat e rebelimit të Adamit (krh. 8:18-25). Bota nuk është siç ishte në fillim. Njerëzit nuk janë siç ishin. Vdekja u bë fundi i çdo jete tokësore (krh. Zanafilla 5). Kjo nuk është bota që kishte ndërmend Perëndia!

Në të njëjtin kuptim kolektiv, një akt bindjeje i Jezusit, Kalvari, rezultoi në (1) një epokë të re, (2) një popull të ri, dhe (3) një besëlidhje të re. Kjo teologji përfaqësuese quhet “tipologjia Adam-Krisht” (krh. Fil. 2:6). Jezusi është Adami i dytë. Ai është fillimi i ri për racën e rënë njerëzore.

▣ **“bëhen të drejtë”** Shih Temën e Veçantë te 1:17

5:20

NASB	“Ligji hyri në mënyrë që shkelja të shtohet”
NKJV	“Për më tepër, ligji hyri që shkelja të mund të tepronte”
NRSV	“Por ligji hyri, me rezultatin që shkelja u shumëfishua”
TEV	“Ligji u prezantua me qëllim që të shtonte keqbërjen”
NJB	“Kur erdhi ligji, kjo u bë që të shumëfishonte mundësitë e rënies”

Qëllimi i Ligjit nuk ishte asnjëherë që ta shpëtonte njerëzimin, por të nxirrte në pah nevojën dhe pafuqinë e njerëzimit të rënë (krh. Efe. 2:1-3) dhe kështu t'i sillte ata te Krishti (krh. 3:20; 4:15; 7:5; Gal. 3:19, 23-26). Ligji është i mirë, por njerëzimi është mëkatar (krh. Romakëve 7)!

▣ **“hiri teproi edhe më shumë”** Ky ishte argumenti kryesor i Palit në këtë seksion. Mëkati është i tmerrshëm dhe i shpërhapur, por hiri tepron dhe e tejkalon ndikimin e tij vdekjeprurës! Kjo ishte një mënyrë për të inkurajuar kishën e mitur të shekullit të parë. Ata ishin fitimtarë në Krishtin (krh. 5:9-11; 8:31-39; I Gjonit 5:4). Kjo nuk është një leje për të mëkatuar më shumë! Shih Temën e Veçantë: Përdorimi nga ana e Palit e fjalëve të përbëra me *Huper* te 1:30.

Shih Temën e Veçantë mbi një fjalë të lidhur me këtë (teproj) të përdorur në v. 15 te Rom. 15:13.

5:21 Edhe “mëkati” edhe “hiri” janë personifikuar si mbretër. Mëkati mbretëroi me anë të fuqisë së vdekjes universale (vv. 14, 17). Hiri mbretëron përmes fuqisë së drejtësisë së veshur/llogaritur përmes veprës së përfunduar të Jezu Krishtit dhe besimit personal të besimtarëve dhe përgjigjes me pendim ndaj ungjillit.

Si populli i ri i Perëndisë, si trupi i Krishtit, të krishterët gjithashtu mbretërojnë me Krishtin (krh. 5:17; II Tim. 2:12; Zbu.22:5). Ky mund të shihet si një mbretërim tokësor ose mijëvjeçar (krh. Zbu. 5:9-10; 20). Bibla gjithashtu flet për të njëjtën të vërtetë duke pohuar se Mbretëria u është dhënë shenjtorëve (krh. Mat. 5:3,10; Luka 12:32; Efe. 2:5-6). Shih Temën e Veçantë: Mbretërimi në Mbretërinë e Perëndisë te 5:17,18.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Përkufizo “drejtësinë” e Perëndisë.
2. Cili është dallimi teologjik midis “shenjtërimit pozicional” dhe “shenjtërimit progresiv”?
3. A jemi ne të shpëtuar me anë të hirit apo besimit (krh. Efe. 2:8-9)?
4. Pse vuajnë të krishterët?
5. A jemi ne të shpëtuar apo duke u shpëtuar apo do të shpëtohem?
6. A jemi ne mëkatarë sepse mëkatojmë, apo mëkatojmë sepse jemi mëkatarë?
7. Si janë të lidhur me njëri-tjetrin termat “të shfajësuar,” “të shpëtuar” dhe “të pajtuar” në këtë kapitull?
8. Pse më mban përgjegjës Perëndia mua për mëkatin e një njeriu tjetër që jetoi mijëra vjet më parë (vv.12-21)?
9. Pse vdiqën të gjithë që nga Adami e deri te Moisiu, nëse mëkati nuk numërohej gjatë kësaj periudhe (vv. 13-14)?
10. A janë termat “të gjithë” dhe “shumë” sinonime (vv. 18-19, Isa. 53:6, 11-12)?

ROMAKËVE 6

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Të vdekur për mëkatin, por të gjallë në Krishtin	Të vdekur për mëkatin, por të gjallë për Perëndinë	Vdekja dhe ringjallja me Krishtin	Të vdekur për mëkatin, por të gjallë në Krishtin	Pagëzimi
6:1-11	6:1-14	6:1-4 6:5-11	6:1-4 6:5-11	6:1-7 6:8-11 Zotëria ynë duhet të jetë shenjtëria, jo mëkati
6:12-14	Nga sklevër të mëkati në sklevër të Perëndisë	6:12-14	6:12-14	6:12-14 I krishteri është i çliruar nga skllavëria e mëkatit
Sklevër të drejtësisë	Nga sklevër të mëkati në sklevër të Perëndisë	Dy skllavëritë	Sklevër të drejtësisë	I krishteri është i çliruar nga skllavëria e mëkatit
6:15-23	6:15-23	6:15-19 6:20-23	6:15-19 6:20-23	6:15-19 Shpërblimi i mëkatit dhe shpërblimi i drejtësisë 6:20-23

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Kapitujt 6:1-8:39 formojnë një njësi mendimi (njësi letrare) që ka të bëjë me marrëdhënien e të krishterit me mëkatin (d.m.th. shenjtërimi). Kjo është një temë shumë e rëndësishme, sepse ungjilli bazohet në hirin e pamerituar të Perëndisë përmes Krishtit (3:21-5:21), atëherë pra, si e ndikon mëkati besimtarin? Kapitulli 6 bazohet në dy pyetje të supozuara, vv. 1 dhe 15. Vargu 1 lidhet me 5:20, kurse v. 15 lidhet me 6:14. E para lidhet me mëkatin si një mënyrë jetese (KOHA E TASHME), e dyta me akte individuale mëkati (KOHA AORISTE). Është e qartë që vv. 1-14 trajtojnë lirinë e besimtarëve nga zotërimi i mëkatit, kurse vv.

15-23 trajtojnë lirinë e besimtarëve për t'i shërbyer Perëndisë ashtu siç i shërbenin më parë mëkatit – krejtësisht, plotësisht dhe me gjithë zemër.

- B. Shenjtërimi është edhe (shih Temën e Veçantë në 6:4)
1. një pozicion (i veshur/ i atribuar ashtu si edhe drejtësia në momentin e shpëtimit, 3:21-5:21)
 2. një ngjashmëri me Krishtin që sa vjen e bëhet më e madhe
 - a. 6:1-8:39 e shprehin këtë të vërtetë teologjikisht
 - b. 12:1-15:13 e shprehin atë praktikisht (Shih Temën e Veçantë në 6:40)
- C. Shpesh komentuesit duhet ta ndajnë teologjikisht temën e shfajësimit dhe shenjtërimit pozicional për të na ndihmuar të rrokim kuptimet e tyre biblike. Në realitet ata janë akte të njëkohshme hiri (pozicional, I Kor. 1:30; 6:11). Mekanizmi për të dy është i njëjtë – hiri i Perëndisë i shfaqur në jetën, vdekjen dhe ringjalljen/ngjitjen në qiell të Jezusit që merret me anë të besimit (krh. Efe. 2:8-9).
- D. Ky kapitull mëson pjekurinë e plotë potenciale (pamëkatshmërinë, krh. I Gjonit 3:6,9; 5:18) të fëmijëve të Perëndisë në Krishtin. Kapitulli 7 dhe I Gjonit 1:8-2:1 tregojnë realitetin e vazhdimësisë së mëkatshmërisë së besimtarëve. Një pjesë e madhe e konfliktit mbi pikëpamjen e Palit mbi faljen (d.m.th., shfajësimin me anë të hirit nëpërmjet besimit) kishte lidhje me çështjen e moralitetit. Hebrenjtë donin të siguroheshin për një jetë me perëndishmëri duke kërkuar që të kthyerit e rinj në besim të ndiqnin ligjin e Moisiut. Duhet pranuar se disa i përdorën atëherë, dhe i përdorin edhe tani, pikëpamjet e Palit si një lejë për të mëkatuar (krh. vv. 1,15; II Pjet. 3:15-16). Pali besonte se ishte Fryma brendabanues, dhe jo një kod i jashtëm, Ai që do të prodhonte ndjekës të perëndishëm dhe të ngjashëm me Krishtin. Në realitet ky është ndryshimi midis Besëlidhjes së Vjetër (krh. Ligji i Përtërirë 27-28) dhe Besëlidhjes së Re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:26-27).
- E. Pagëzimi është thjesht një ilustrim fizik i realitetit frymëror të shfajësimit/shenjtërimit. Te Romakëve doktrinën binjake të shenjtërimit pozicional (shfajësimit) dhe shenjtërimit eksperiencial (ngjashmërisë me Krishtin) theksohen të dyja. Të varrosesh me Të (v. 4) është paralel me “të jesh kryqëzuar me Të” (v. 6).
- F. Çelësat për mposhtjen e tundimit dhe mëkatit në jetën e krishterë janë
1. Njih kush je në Krishtin. Njih çfarë ka bërë Ai për ty. Ti je i/e çliruar nga mëkati! Ti je i/e vdekur për mëkatin!
 2. Llogarite/numëroje pozicionin tënd në Krishtin në situatat e jetës tënde të përditshme.
 3. Ne nuk i përkasim vetvetes! Ne duhet t'i shërbejmë/bindemi Zotërisë sonë. Ne i shërbejmë/i bindemi nga mirënjohja dhe dashuria Atij që na deshi i pari dhe e dha Vetën për ne!
 4. Jeta e krishterë është një jetë e mbinatyrshe. Ajo, ashtu si edhe shpëtimi, është një dhuratë nga Perëndia në Krishtin. Ai e fillon dhe Ai siguron fuqinë për të. Ne duhet të përgjigjemi me pendim dhe besim, si në fillim, ashtu edhe në mënyrë të përditshme.
 5. Mos luaj me mëkatin. Etiketoje ashtu siç është. Kthehu mbrapsht prej tij; arratisju atij. Mos e vendos veten në vendin e tundimit.
 6. Mëkati në besimtarin është një varësi që mund të thyhet, por kërkon njohurinë e Ungjillit, praninë e Frymës, kohë, përpjekje dhe vullnet.

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:1-7

¹ Çfarë të themi atëherë? A të vazhdojmë në mëkat, që të shtohet hiri? ² Kurrë mos qoftë! Ne që vdiqëm për mëkatin, si do të jetojmë ende në të? ³ Apo nuk e dini që të gjithë ne që u pagëzuam në Krishtin Jezus jemi pagëzuar në vdekjen e Tij? ⁴ Prandaj, ne jemi varrosur me Të përmes pagëzimit në vdekje, në mënyrë që ashtu si Krishti u ngjall nga të vdekurit përmes lavdisë së Atit, ashtu edhe ne të mund të ecim në risinë e jetës. ⁵ Sepse, nëse jemi bashkuar me Të në ngjashmërinë e vdekjes së Tij, patjetër që do të bashkohemi edhe në ngjashmërinë e ringjalljes së Tij, ⁶ duke ditur këtë, që vetja jonë e vjetër u kryqëzua me Të, me qëllim që trupi ynë i mëkatit të shfuqizohej, që ne të mos ishim më skllëvër të mëkatit; ⁷ sepse ai që ka vdekur, është çliruar nga mëkati.

NASB	“A të vazhdojmë në mëkat, që të shtohet hiri”
NKJV	“Të vazhdojmë në mëkat që të teprojë hiri”
NRSV	“A duhet të vazhdojmë në mëkat me qëllim që të teprojë hiri”
TEV	“Që duhet të vazhdojmë të jetojmë në mëkat në mënyrë të të rritet hiri i Perëndisë”
NJ	“A rrjedh nga kjo që duhet të mbetemi në mëkat në mënyrë që ta lejojmë hirin të ketë shtrirje më të madhe”

Kjo është E TASHME VEPRORE LIDHORE. Ajo në mënyrë të fjalëpërfjalshme shtron pyetjen, një duhet të krishterët “të banojnë me” apo “ta përqafojnë” mëkatin? Kjo pyetje ka lidhje me atë që thuhet te 5:20. Pali përdori një kundërshtar hipotetik (diatrib) për të trajtuar keqpërdorimin e mundshëm të hirit (krh. I Gjoni 3:6,9; 5:18). Hiri dhe mëshira e Perëndisë nuk janë për të lejuar jetesën në rebelim.

Ungjilli i Palit i një shpëtimi falas si dhuratë e hirit të Perëndisë përmes Krishtit (krh. 3:24; 5:15, 17; 6:23) ngriti shumë pyetje në lidhje me drejtësinë si mënyrë jetese. Në ç’mënyrë një dhuratë e tillë prodhon drejtësi morale? Shfajësimi dhe shenjtërimi nuk duhen ndarë (krh. Mat. 7:24-27; Luka 8:21; 11:28; Gjoni 13:17; Rom. 2:13; Jakobi 1:22-25; 2:14-26).

Në lidhje me këtë pikë më lejoni të citoj nga F. F. Bruce te *Paul: Apostle of the Heart Set Free*, (Pali: Apostulli i zemrës së çliruar)

“pagëzimi i të krishterëve përbënte vijën ndarëse midis ekzistencës së tyre të vjetër të parilindur dhe jetës së tyre të re në Krishtin: ai shënonte vdekjen e tyre ndaj rendit të vjetër, kështu që për një të krishterë të pagëzuar vazhdimi në mëkat do të ishte po aq absurd sa do të ishte për një skllav të liruar të qëndronte në skllavërinë e pronarit të tij të mëparshëm (krh. Rom. 6:1-4, 15-23) ose për një të ve të mbetej e nënshtuar ndaj ‘ligjit të burrit të saj’” (fq. 281-82, krh. Rom. 7:1-6).

Në librin e James S. Stewart, *A Man in Christ*, (Një njeri në Krishtin) ai shkruan:

“Pasazhi klasik për të gjithë këtë anë të mendimit të apostujve gjendet te Rom. 6. Atje Pali, me një përpjekje të fuqishme dhe madhështore ngulit në zemër dhe në vetëdije mësimin se të jesh i bashkuar me Jezusin në vdekjen e Tij do të thotë për besimtarin një shkëputje e plotë dhe drastike me mëkatin” (fq. 187-88).

6:2 “kurrë mos qoftë” Kjo është një formë e rrallë OPTATIVE që ishte një MËNYRË gramatikore që përdorej për një dëshirë ose lutje. Ishte mënyra stilistike e Palit (d.m.th., idiomë hebraike) e të përgjigjurit ndaj një kundërshtuesi hipotetik. Ajo shprehte tronditjen dhe tmerrin e Palit ndaj keqkuptimit dhe abuzimit të hirit nga ana e njerëzimit jobesimtar (krh. 3:4,6).

☐ **“ne që vdiqëm për mëkatin”** Kjo është një AORISTE VEPRORE DËFTORE, që ka kuptimin “ne kemi vdekur.” “Mëkati” në NUMRIN NJËJËS përdoret shumë shpesh në të gjithë këtë kapitull. Ai duket se i referohet “natyrës sonë mëkatore” të trashëguar nga Adami (krh. Rom. 5:12-21; I Kor. 15:21-22). Pali shpesh përdor konceptin e vdekjes si një metaforë për të treguar marrëdhënien e re të besimtarit me Jezusin. Besimtari nuk është më subjekt i zotërimit të mëkatit.

☐ **“jetojmë ende në të”** Fjalë për fjalë kjo është “ecim.” Kjo metaforë është përdorur për të theksuar ose besimin tonë si mënyrë jetese (krh. Efe. 4:1; 5:2,15) ose mëkatin si mënyrë jetese (krh. v. 4; Efe. 4:17). Besimtarët nuk mund të jenë të lumtur në mëkat!

6:3-4 “jemi pagëzuar...jemi varrosur” Këto janë të dyja AORISTE PËSORE DËFTORE. Kjo formë gramatikore shpesh theksonte një veprim të përfunduar të kryer nga një agjent i jashtëm, këtu Fryma. Ato janë paralele në këtë kontekst.

TEMË E VEÇANTË: PAGËZIMI

Curtis Vaughan, *Vëprat*, ka një shënim interesant në fund të faqes në fq. 28.

“Fjala greke për ‘pagëzuar’ është një urdhërore e vetës së tretë; fjala për ‘pendohu,’ urdhërore e vetës së

dytë. Ky ndryshim nga urdhri më i drejtpërdrejtë i vetës së dytë në atë më pak të drejtpërdrejtë të vetës së tretë të ‘pagëzuar’ nënkupton se thirrja kryesore e Pjetrit është për pendim.”

Kjo ndjek theksin e predikimit të Gjon Pagëzorit (krh. Mat. 3:2) dhe Jezusit (krh. Mat. 4:17).

Pendimi duket se është një çelës shpirtëror dhe pagëzimi është një shprehje e jashtme e këtij ndryshimi shpirtëror. Në Dhiatën e Re nuk shohim besimtarë të papagëzuar! Për kishën e hershme pagëzimi ishte rrëfimi publik i besimit. Ai është rasti për rrëfim publik të besimit në Krishtin, jo mekanizmi për shpëtim! Duhet mbajtur mend se pagëzimi nuk përmendet në predikimin e dytë të Pjetrit, megjithëse pendimi përmendet (krh. 3:19; Luka 24:17). Pagëzimi ishte një shembull që na e la Jezusi (krh. Mat. 3:13-18). Pagëzimi u urdhërua nga Jezusi (krh. Mat. 28:19). Çështja që shtrohet sot, nëse është i nevojshëm pagëzimi për shpëtim, nuk trajtohet në Dhiatën e Re; të gjithë besimtarët duhet të pagëzohen. Megjithatë, duhet të kemi kujdes edhe ndaj kthimit të sakramenteve në diçka mekanike! Shpëtimi është çështje besimi, jo çështje e vendit të duhur, fjalëve të duhura, ritualit të duhur!

☐ **“në Krishtin Jezus”** Përdorimi i *eis* (në) është paralel me Porosinë e Madhe të Mat. 28:19, ku besimtarët e rinj pagëzohen *eis* (në) emrin e Atit dhe të Birit dhe të Frymës së Shenjtë. Kjo PARAFJALË përdoret edhe për të përshkruar pagëzimin e besimtarëve nga Fryma në trupin e Krishtit te I Kor. 12:13. *Eis* në këtë kontekst është sinonim me *en* (në Krishtin) në v. 11, e cila është mënyra e preferuar e Palit për të përshkruar besimtarët. Ajo është një PARAFJALË VENDORE E SFERËS. Besimtarët jetojnë dhe lëvizin dhe ekzistojnë në Krishtin. Këto parafjalë shprehin këtë bashkim të ngushtë, këtë sferë bashkësie, këto marrëdhënie degë-hardhi. Besimtarët identifikohen dhe bashkohen me Krishtin në vdekjen e Tij (krh. v. 6; 8:17), në ringjalljen e Tij (krh. v.5), në shërbimin e Tij të bindur ndaj Perëndisë dhe në Mbretërinë e Tij!

☐ **“në vdekjen e Tij. . . jemi varrosur me Të”** Pagëzimi me anë të zhytjes ilustron vdekjen dhe varrosjen (krh. v. 5 dhe Kol. 2:12). Jezusi e përdori pagëzimin si një metaforë për vdekjen e Tij (krh. Mark 10:38-39; Luka 12:50). Theksi këtu nuk është doktrina e pagëzimit, por ajo e marrëdhënies së re e të ngushtë të të krishterit me vdekjen dhe varrosjen e Krishtit. Besimtarët identifikohen me pagëzimin e Krishtit, me karakterin e Tij, me flijimin e Tij, me misionin e Tij. Mëkati nuk ka asnjë pushtet mbi besimtarët!

6:4 “jemi varrosur me Të përmes pagëzimit në vdekje” Në këtë kapitull, siç është karakteristikë e të gjithë shkrimeve të Palit, ai përdor shumë fjalë të përbëra me *sun* (me) (p.sh., tre te Efe. 2:5-6).

1. *sun* + *thaptō*= bashkë-varrosur, v. 4; Kol. 2:12; gjithashtu vini re v. 8

2. *sun* + *phuō*= bashkë-mbjellë, v. 5

3. *sun*+ *stauroō*= bashkë-kryqëzuar, v. 6; Gal. 2:20

4. *sun* + *zaō* = bashkë-ekzistoj, v. 8; II Tim. 2:11 (gjithashtu ka bashkë-vdekur dhe bashkë-mbretëroj)

☐ **“që edhe ne të mund të ecim në risinë e jetës”** Kjo është një AORISTE VEPRORE LIDHORE. Rezultati i pritshëm i shpëtimit është shenjtërimi. Për shkak se besimtarët kanë marrë hirin e Perëndisë përmes Krishtit dhe janë brendabanuar nga Fryma, jetët e tyre duhet të jenë ndryshe. Jeta jonë e re (*zoē*) nuk na sjell shpëtimin, por është rezultat i shpëtimit (krh. vv. 16, 19; 8:4; 13:13; 14:15; dhe Efe. 1:4; 2:8-9,10; Jakobi 2:14-26). Kjo nuk është çështje kjo apo ajo, besimi apo veprat, por është një renditje njëri pas tjetrit.

TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIMI

DHR pohon se, kur mëkatarët kthehen te Jezusi me pendim dhe besim, shfajësohen aty për aty dhe shenjtërohen. Ky është pozicioni i tyre i ri në Krishtin. Drejtësia e tij u është llogaritur atyre (shih Romakëve 4). Ata shpallen të drejtë dhe të shenjtë (akt ligjor i Perëndisë).

Por, gjithashtu, DHR u bën thirrje besimtarëve për shenjtëri, ose shenjtërim. Ky është edhe pozicioni teologjik në bazë të veprës së përfunduar të Jezu Krishtit, edhe thirrje për të qenë si Krishti në qëndrim dhe në veprime në jetën e përditshme. Ashtu si shpëtimi është dhuratë falas dhe stil jetese që të kushton gjithçka, kështu ndodh dhe me shenjtërimin.

Përgjigjja fillestare
Veprat 20:23; 26:18

Ngjashmëria gjithnjë e më madhe me Krishtin
Romakëve 6:19

Romakeve 15:16

1 Korintasve 1:2-3; 6:11

2 Thesalonikasve 2:13

Hebrenjve 2:11; 10:10, 14; 13:12

1 Pjetrit 1:12

2 Korintasve 7:1

Efesianëve 1:4; 2:10

1 Thesalonikasve 3:13; 4:3-4, 7; 5:23

1 Timoteut 2:15

2 Timoteut 2:21

Hebrenjve 12:14

1 Pjetrit 1:15-16

■ **“risinë e jetës”** Kjo është “e re” në cilësi, jo thjesht e re në kohë. Ajo përdoret në një shumëllojshmëri mënyrash në DHR për të folur për ndryshimin radikal që sjell Mesia. Është epoka e re, krh. Isaia 40-66.

1. besëlidhje e re, Luke 22:20; I Kor. 11:25; II Kor. 3:6; Heb. 8:8,13; 9:15

2. urdhërim i ri, Gjoni 13:34; I Gjoni 2:7,8; II Gjoni v. 5

3. krijim i ri, II Kor. 5:17; Gal. 6:15

4. risi e jetës, Rom. 6:4

5. risi e frymës, Rom. 7:6

6. njeri i ri, Efe. 2:15; 4:24

7. qiell i ri dhe tokë e re, II Pjet. 3:13; Zbu. 21:1 (krh. Isa. 66:22)

8. emër i ri, Zbu. 2:17; 3:12 (krh. Isa. 62:2)

9. Jerusalemi i ri, Zbu. 3:12; 21:2

10. këngë e re, Zbu. 5:9; 14:3 (krh. Isa. 42:10)

■ **“Krishti u ngjall”** Në këtë kontekst pranimi dhe miratimi nga Ati i fjalëve dhe veprave të Birit shprehen në dy ngjarje të mëdha.

1. ringjallja e Jezusit nga të vdekurit

2. ngjitja e Jezusit në të djathtën e Atit

Që të tre personat e Trinisë u përfshinë në ngjalljen e Jezusit nga bota e të vdekurve. Shih shënimin e plotë në v. 9 dhe 8:11.

■ **“lavdisë së Atit”** Për “lavdi” shih Temën e Veçantë në 3:23. Për “Atë” shih Temën e Veçantë në 1:7.

6:5 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i shkrimtarit ose për qëllimet e tij letrare. Pali supozoi se lexuesit e tij ishin besimtarë.

■ **“jemi bashkuar me Të”** Kjo është E KRYER VEPRORE DËFTORE që mund të përkthehej, “jemi bashkuar dikur dhe vazhdojmë të jemi të bashkuar së bashku” ose “jemi mbjellë dhe vazhdojmë të mbillemi së bashku me.” Kjo e vërtetë është analoge teologjikisht me “qëndrimin” te Gjoni 15. Nëse besimtarët janë identifikuar me vdekjen e Jezusit (krh. Gal. 2:19-20; Kol. 2:20; 3:3-5), teologjikisht ata duhet të jenë identifikuar me jetën e Tij të ringjalljes (krh. v. 10).

Ky aspekt metaforik i pagëzimit si vdekje kishte qëllim të tregonte

1. se kemi vdekur ndaj jetës së vjetër, besëlidhjes së vjetër

2. jemi të gjallë ndaj Frymës, besëlidhjes së re

Prandaj, pagëzimi i krishterë nuk është i njëjtë me pagëzimin e Gjon Pagëzorit, i cili ishte profeti i fundit i Dhiatës së Vjetër. Pagëzimi ishte mundësia e kishës së hershme për rrëfimin publik të besimit nga ana e besimtarit. Formula më e hershme e pagëzimit, që përsëritej nga kandidati, ishte “Unë besoj se Jezusi është Zot” (krh. Rom. 10:9-13). Kjo shpallje publike ishte një akt formal, ritual i asaj që kishte ndodhur dhe ishte përjetuar më përpara. Pagëzimi nuk ishte mekanizmi i faljes, shpëtimit apo i ardhjes së Frymës, por rasti për shpalljen dhe rrëfimin e tyre publik (krh. Vep 2:38). Megjithatë, ai nuk ishte opsional. Jezusi e urdhëroi atë (krh. Mat. 28:19-20), dhe na e la edhe si shembull, (krh. Mat. 3; Mark 1; Luka 3) dhe ai u bë pjesë e predikimeve dhe procedurave Apostolike të Veprave.

6:6

NASB “duke ditur këtë, që vetja jonë e vjetër u kryqëzua me Të”

NKJV “duke ditur këtë, që njeriu ynë i vjetër u kryqëzua me Të”

NRSV “Ne e dimë se vetja jonë e vjetër u kryqëzua me të”
TEV “Dhe ne dimë këtë: qenia jonë e vjetër është vrarë me Krishtin në kryqin e tij”
NJB “Ne duhet ta kuptojmë se vetet tona të vjetra janë kryqëzuar me të”

Kjo është AORISTE PËSORE DËFTORE dhe ka kuptimin “vetja jonë e vjetër është kryqëzuar një herë e përgjithmonë prej Frymës.” DIATEZA PËSORE tregon që agjenti veprues është hyjnor. Kjo e vërtetë është kyçe për jetën e krishterë fitimtare. Besimtarët duhet ta kuptojnë marrëdhënien e tyre të re me mëkatin (krh. Gal. 2:20; 6:14). Vetja e vjetër e njerëzimit (natyra Adamike) ka vdekur me Krishtin (krh. v.7; Efe. 4:22 dhe Kol. 3:9). Si besimtarë ne tani kemi një zgjedhje për mëkatin, ashtu siç kishte Adami në fillim.

■
NASB, NKJV “që trupi ynë i mëkatit të shfuqizohej”
NRSV “në mënyrë që trupi i mëkatit të shkatërrohej”
TEV “me qëllim që fuqia e vetes mëkatore të mund të shkatërrohej”
NJB “për të shkatërruar trupin mëkatar”

Pali e përdor fjalën “trup” (*soma*) me disa fraza GJINORE.

1. trupi i mëkat(it), Rom. 6:6
2. trupi i kësaj vdekjeje, Rom. 7:24
3. trupi i mishit, Kol. 2:11

Pali po flet për jetën fizike të kësaj epoke mëkati dhe rebelimi. Trupi i ri i ringjallur i Jezusit është trupi i epokës së re të drejtësisë krh. II Kor. 5:17). Problemi nuk është jeta fizike (filozofia greke), por mëkati dhe rebelimi. Trupi nuk është i keq. Krishtërimi e pohon besimin në një trup fizik në përjetësi (krh. I Korintasve 15). Megjithatë, trupi fizik është fushë-beteja e tundimit, mëkatit dhe vetes.

Kjo është AORISTE PËSORE LIDHORE. Faza “të shfuqizohej” kishte kuptimin “të bëhej jofunksionale,” “të bëhej e pafuqishme,” ose “të bëhej joproduktive,” jo “të shkatërrohej.” Kjo ishte një fjalë e preferuar e Palit, e përdorur më shumë se njëzet e pesë herë. shih Temën e Veçantë: Anuloj dhe Shfuqizoj (*katargeō*) në 3:3. Trupi ynë fizik është moralisht neutral, por ai është gjithashtu fushë-beteja për konfliktin e vazhdueshëm frymëror (krh. vv. 12-13; 5:12-21; 12:1-2).

6:7 “ai që ka vdekur, është çliruar nga mëkati” Kjo është PJESORE AORISTE VEPRORE dhe E KRYER PËSORE DËFTORE, që do të thotë “ai që ka vdekur është çliruar dhe vazhdon të çlirohet nga mëkati.” Për shkak se besimtarët janë krijesa të reja në Krishtin, ata janë çliruar dhe vazhdojnë të çlirohen nga skllavëria e mëkatit dhe e vetes, të trashëguara nga rënia e Adamit (krh. 7:1-6).

Termi grek i përkthyer këtu si “çliruar” është termi i përkthyer gjetkë në hyrjet e kapitujve si “shfajësuar” (ASV). Në këtë kontekst “çliruar” (NKJV, NRSV) ka shumë më tepër kuptim (në ngjashmëri me përdorimin e saj te Veprat 13:39). Mbani mend, konteksti është ai që e përcakton kuptimin e fjalës, jo një fjalor apo një përkufizim teknik i caktuar që më parë. Fjalët kanë kuptim vetëm në fjali, dhe fjalitë kanë kuptim vetëm në paragrafë.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:8-11

⁸ Tani nëse kemi vdekur me Krishtin, ne besojmë se edhe do të jetojmë me Të, ⁹ duke ditur që Krishti, duke qenë ngjallur nga të vdekurit, nuk vdes më kurrë; vdekja nuk është më zotëruese mbi Të. ¹⁰ Sepse vdekjen që vdiq, e vdiq për mëkatin një herë e përgjithmonë; por jetën që jeton, e jeton për Perëndinë. ¹¹ Në të njëjtën mënyrë, konsiderojeni veten të vdekur ndaj mëkatit, por të gjallë për Perëndinë në Krishtin Jezus.

6:8 “Nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozohet të jetë e vërtetë nga këndvështrimi i shkrimtarit ose për qëllimet e tij letrare. Pagëzimi i besimtarit shëmbëllen në mënyrë vizuale/pamore vdekjen e tij me Krishtin.

■ **“edhe do të jetojmë me Të”** Ky kontekst kërkon një orientim “këtu dhe tani” (krh. I Gjoni 1:7), jo një sfond ekskluzivisht të ardhshëm. Vargu 5 flet për pjesëmarrjen tonë në vdekjen e Krishtit, kurse vargu 8 flet për

pjesëmarrjen tonë në jetën e Tij. Ky është i njëjti tension i qenësishëm në konceptin biblik të Mbretërisë së Perëndisë. Ajo është këtu dhe tani, e megjithatë edhe e ardhshme. Hiri falas duhet të prodhojë vetëkontroll, jo shthurje.

6:9 “duke qenë ngjallur nga të vdekurit” Kjo është një PJESORE AORISTE PËSORE (shih 6:4, AORISTE PËSORE DËFTORE).

DHR pohon që të tre personat e Trinisë ishin aktivë në ringjalljen e Jezusit.

1. Fryma (krh. Rom. 8:11)

2. Biri (krh. Gjoni 2:19-22; 10:17-18)

3. dhe më shpesh, Ati (krh. Veprat 2:24,32; 3:15,26; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9)

Veprimet e Atit ishin konfirmim i pranimit nga ana e Tij të jetës, vdekjes dhe mësimëve të Jezusit. Ky ishte një aspekt madhor i predikimit të hershëm të Apostujve. Shih Temën e Veçantë: *Kerygma* në 1:2.



NASB “vdekja nuk është më zotëruese mbi Të”

NKJV, NRSV “Vdekja nuk ka më zotërim mbi Të”

TEV “vdekja nuk do të sundojë më mbi të”

NJB “Vdekja nuk ka më pushtet mbi të”

FOLJA *kurieuō* vjen nga termi *kurios* (d.m.th., Zot), që do të thotë “pronar,” “zotërues,” “bashkëshort,” ose “zot,” Jezusi është tani zot mbi vdekjen (krh. Zbu. 1:18). Jezusi është fryti i parë i ringjalljes. Ka patur disa njerëz që

1. janë marrë në qiell të gjallë (d.m.th., zhvendosur, Enoku dhe Elija)

2. janë risjellë në jetën fizike (d.m.th., risjellë në jetë)

Jezusi është i vetmi që është ringjallur me një trup të epokës së re. Jezusi është i pari që e ka thyer fuqinë e vdekjes (krh. I Korintasve 15)!

6:10 “sepse vdekjen që vdiq, e vdiq për mëkatën” Jezusi jetoi në një botë mëkatore dhe, megjithëse nuk mëkatoi asnjëherë, bota mëkatore e kryqëzoi (krh. Heb. 10:10). Vdekja zëvendësuese e Jezusit në vend të njerëzimit i anuloi kërkesat e Ligjit dhe pasojat e tyre mbi ta (krh. Gal. 3:13; Kol 2:13-14).

■ **“një herë e përgjithmonë”** Në këtë kontekst, Pali po thekson kryqëzimin e Jezusit. Vdekja e tij një herë për mëkatën ka shkaktuar vdekjen e ndjekësve të Tij ndaj mëkatit. Edhe Libri i Hebrenjve thekson përgjithmonshmërinë e vdekjes një herëshe, flijuese të Jezusit. Ky shpëtim dhe kjo falje që janë realizuar një herë, janë përgjithmonë (krh. “një herë” [*ephapax*], 7:27; 9:12; 10:10 dhe “një herë e përgjithmonë” [*hapax*], 6:4; 9:7,26,27,28; 10:2; 12:26,27). Ky është pohimi i përsëritur, i plotësuar, flijues.

■ **“por jetën që jeton, e jeton për Perëndinë”** Të dyja AORISTET e v. 10a kontrastohen me dy DËFTORET E TASHME VEPRORE në v. 10b. Besimtarët vdiqën me Krishtin; besimtarët jetojnë për Perëndinë, përmes Krishtit (krh. Gal. 2:19-20). Synimi i ungjillit nuk është vetëm falja (shfajësimi) por shërbimi ndaj Perëndisë (shenjtërimi). Besimtarët shpëtohen për të shërbyer!

6:11 “Në të njëjtën mënyrë, konsiderojeni veten të vdekur ndaj mëkatit” Kjo është një URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE (deponente). Ky është një urdhërim i vazhdueshëm, zakon për besimtarët. Njohuria e të krishterëve për punën e Krishtit për ta është kyçe për jetën e përditshme. Termi “konsiderojeni” (krh. 4:4,9), ishte një term finance që do të thoshte “mblidhi me kujdes” dhe pastaj vepra mbi atë njohuri. Vargjet 1-11 e pranionin pozicionin e dikujt në Krishtin (shenjtërimin pozicional), kurse 12-13 theksonin ecjen në Të (shenjtërimin progresiv). Shih Temën e Veçantë në v. 4.



NASB, NRSV,

TEV, NJB “Krishtin Jezus”

NKJV “Krishtin Jezus Zotin tonë”

Leximi më i shkurtër gjendet në MSS P⁴⁶, A, B, D, F, G. UBS⁴ i jep atij një rankim/renditje “A” (i sigurt). Faza më e zgjeruar është herët (MSS P⁹⁴, ⋈, C), por ka të ngjarë të jetë shtuar nga një kopist nga v. 23. Si shumica e varianteve tekstuale, ai sjell pak ndryshim në kuptimin e tekstit.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:12-14

¹² Prandaj mos e lejoni mëkatit të mbretërojnë në trupin tuaj të vdekshëm në mënyrë që t’u bindeni epsheve të tij, ¹³ dhe mos vazhdoni t’ia paraqitni gjymtyrët e trupit tuaj mëkatit si instrumente të padrejtësisë; por paraqitini vetet tuaja te Perëndia si ata që janë të gjallë nga të vdekurit, dhe gjymtyrët tuaja si instrumente të drejtësisë te Perëndia. ¹⁴ Sepse mëkati nuk do të jetë më zotërues mbi ju, sepse ju nuk jeni më nën ligj, por nën hir.

6:12 “Prandaj mos e lejoni mëkatit të mbretërojnë në trupin tuaj të vdekshëm” Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE, e cila zakonisht kishte kuptimin të ndaloje një veprim që ishte tashmë në proces. Termi “mbretëroj” lidhet me 5:17-21 dhe 6:23. Pali personifikon disa koncepte teologjike.

1. vdekja mbretëroi si mbret (krh. 5:14,17; 6:23)
2. hiri mbretëroi si mbret (krh. 5:21)
3. mëkati mbretëroi si mbret (krh. 6:12,14)

Pyetja e vërtetë është kush po mbretëron në jetën tënde? Besimtari ka fuqinë në Krishtin që të zgjedhë! Tragjedia për individin, kishën lokale dhe Mbretërinë e Perëndisë është kur besimtarët zgjedhin veten dhe mëkatit, madje ndërsa flasin për hir!

Shih Temën e Veçantë: Mbretërimi në Mbretërinë e Perëndisë në 5:17-18.

6:13 “mos vazhdoni t’ia paraqitni gjymtyrët e trupit tuaj mëkatit” Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE, e cila zakonisht kishte kuptimin të ndaloje një veprim që ishte tashmë në proces. Ajo tregon potencialin për vazhdim të mëkatit në jetët e besimtarëve (krh. 7:1e më tej; I Gjoni 1:8-2:1). Por domosdoshmëria e mëkatit është eliminuar në marrëdhënien e re të besimtarit me Krishtin, vv. 1-11.

▣ **“si instrumente”** Ky term (*hoplon*) i referohej “armëve të një ushtari” (krh. 13:12; Gjoni 18:3; II Kor. 6:7; 10:4). Trupi ynë fizik është fushë-beteja për tundimin (krh. vv. 12-13; 12:1-2; I Kor. 6:20; Fil. 1:20). Jetët tona e shpalosin publikisht ungjillin.

▣ **“por paraqitini vetet tuaja te Perëndia”** Kjo është një AORISTE VEPRORE URDHËRORE që ishte thirrje për një veprim deciziv (krh. 12:1). Besimtarët e bëjnë këtë në momentin e shpëtimit me anë të besimit, por ata duhet të vazhdojnë ta bëjnë këtë gjatë gjithë jetës së tyre.

Vini re paralelizmin e këtij vargu.

1. e njëjta FOLJE dhe të dyja URDHËRORE
2. metafora lufte
 - a. armë të padrejtësisë
 - b. armë të drejtësisë
3. besimtarët mund t’ia paraqesin trupat e tyre mëkatit, ose vetet e tyre Perëndisë

Mbani mend, ky varg u referohet besimtarëve—zgjedhja vazhdon; beteja vazhdon (krh. 6:12,19; I Kor. 6:18-19; Efe. 6:10-18)!

6:14 “Sepse mëkati nuk do të jetë më zotërues mbi ju” Kjo është E ARDHME VEPRORE DËFTORE (krh. Ps. 19:13) që funksionon si URDHËRORE, “mëkati nuk duhet të jetë zotërues mbi ju!” Mëkati nuk është zotërues mbi besimtarët sepse nuk është zotërues mbi Krishtin, (krh. v. 9; Gjoni 16:33).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:15-19

¹⁵ Çfarë atëherë? Të mëkatojmë sepse nuk jemi nën ligj, por nën hir? Kurrë mos qoftë! ¹⁶ A nuk e dini se kur ia paraqisni vetet tuaja dikujt si skllëvër për bindje, jeni skllëvër të atij që i bindeni, ose mëkatit që

rezulton në vdekje, ose bindjes që rezulton në drejtësi? ¹⁷ Por faleminderit Perëndisë që megjithëse ju ishit skllëvër të mëkatit, u bëtë të bindur nga zemra ndaj asaj forme mësimi ndaj së cilës u përkushtuat, ¹⁸ dhe duke qenë çliruar nga mëkati, ju u bëtë skllëvër të drejtësisë. ¹⁹ Po flas në terma njerëzore për shkak të dobësisë së mishit tuaj. Sepse, ashtu siç i paraqitët gjymtyrët tuaja si skllëvër të papastërtisë dhe paudhësisë, që çonte në më tepër paudhësi, po ashtu tani paraqitini gjymtyrët tuaja si skllëvër të drejtësisë, që çon në shenjtërim.

6:15 Kjo pyetje e dytë e supozuar (diatrib) është e ngjashme me 6:1. Të dyja u përgjigjen pyetjeve të ndryshme për marrëdhënien e të krishterit me mëkatin. Vargu 1 trajton flet për hirin që nuk duhet përdorur si leje për të mëkatuar, kurse v. 15 flet për nevojën e të krishterit për të luftuar, ose për t’iu rezistuar veprave individuale të mëkatit. Gjithashtu, në të njëjtën kohë besimtari duhet t’i shërbejë Perëndisë tani me të njëjtin entuziazëm me të cilin i shërbente në të kaluarën mëkatit (krh. 6:14).



NASB, NKJV,

TEV

“Të mëkatojmë”

NRSV

“Duhet të mëkatojmë”

NJB

“që jemi të lirë të mëkatojmë”

Përkthimet Williams dhe Phillips të dy e përkthejnë këtë AORISTE VEPRORE LIDHORE si TË TASHME VEPRORE LIDHORE njësoj si v. 1. Ky nuk është fokusi i duhur. Vini re përkthimet alternative

1. KJV, ASV, NIV – “të mëkatojmë?”
2. The Centenary Translation – “të kryejmë një vepër mëkati?”
3. RSV – “një duhet të mëkatojmë?”

Kjo pyetje është emfatike në greqisht dhe priste një përgjigje “po.” Kjo ishte metoda diatribe e Palit për komunikimin e një të vërtete. Ky varg shpreh teologji të rreme! Pali i përgjigjet kësaj me shprehjen e tij karakteristike “Kurrë mos qoftë.” Ungjilli i Palit i hirit falas radikal të Perëndisë u keqkuptua dhe u keqpërdor nga shumë mësues të rremë.

6:16 Pyetja pret një përgjigje “po”. Njerëzit i shërbejnë diçkaje ose dikujt. Cili mbretëron në jetën tënde, mëkati apo Perëndia? Ai të cilit i binden njerëzit tregon se cilit i shërbejnë (krh. Gal. 6:7-8).

6:17 “Por faleminderit Perëndisë” Pali shpesh shpërthen në lavdërim ndaj Perëndisë. Shkrimet e tij rrjedhin nga lutjet e tij dhe lutjet e tij nga njohja e ungjillit nga ana e tij. Shih Temën e Veçantë: Lutja, lavdërimi dhe falenderimi i Palit ndaj Perëndisë në 7:25.

☐ **“u ishit. . .u bëtë”** Kjo është KOHA E PAKRYER E FOLJES “jam,” që përshkruante gjendjen e tyre në të shkuarën (skllëvër të mëkatit) e ndjekur nga një KOHË AORISTE që pohon prerë që gjendja e tyre e rebelimit ka marrë fund.

☐ **“u bëtë të bindur nga zemra ndaj asaj forme mësimi”** Në kontekst, kjo i referohet shfajësimit të tyre me anë të hirit nëpërmjet besimit, që duhet të çojë në ngjashmëri të përditshme me Krishtin. Termi “mësimi” i referohet mësimit apostolik, ose ungjillit.

☐ **“heart”** Shih Temën e Veçantë: Zemra në 1:24.



NASB

“asaj forme mësimi ndaj së cilës u përkushtuat”

NKJV

“asaj forme të doktrinës tek e cila u dorëzuat”

NRSV, NIV

“formës së mësimit tek e cila u besuat”

TEV

“të vërtetës që gjendet në mësimin që morët”

NJB

“modelit të mësimit me të cilin u prezantuat”

Ky mendim është paralel me I Kor. 15:1 dhe i referohet të vërtetave të ungjillit që këta besimtarë dëgjuan dhe pranuan. Ungjilli është

1. një person për ta mirëpritur

2. të vërteta në lidhje me atë person për t'u besuar
3. një jetë si e atij personi për t'u jetuar!

▣ **“forme”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: FORMË (TUPOS)

Problemi me fjalën *tupos* është që ka një larmi përdorimesh.

1. Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament* [Fjalori i Dhiatës së Re greqisht], f. 645
 - a. Model
 - b. Plan
 - c. Formë ose mënyrë shkrimi
 - d. Dekret ose porosi
 - e. Verdikt ose vendim
 - f. Model trupi njerëzor si oferta kushtimore për perëndinë shërues
 - g. FOLJA përdoret në kuptimin e përforsimit të porosive të ligjit
2. Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon* [Leksiku greqisht-anglisht], vëll. 2, f. 249
 - a. Vragë (shih Gjoni 20:25)
 - b. Shëmbëllim (shih Veprat 7:43)
 - c. Model (shih Heb. 8:5)
 - d. Shembull (shih 1 Kor. 10:6; Fil. 3:17)
 - e. Arketip (shih Rom. 5:14)
 - f. Lloj (shih Veprat 23:25)
 - g. Përmbajtje (shih Veprat 23:25)
3. Harold K. Moulton, *The Analytical Greek Lexicon Revised* [Leksiku analitik greqisht, i rishikuar], f. 411
 - a. Goditje, vragë, shenjë (shih Gjoni 20:25)
 - b. Përvijim
 - c. Shëmbëllim (shih Veprat 7:43)
 - d. Formulë, skemë (shih Rom. 6:17)
 - e. Formë, përmbajtje (shih Veprat 23:25)
 - f. Figurë, përkim (shih 1 Kor. 10:6)
 - g. Simbol parathënës, tip (shih Rom. 5:14; 1 Kor. 10:11)
 - h. Model (shih Veprat 7:44; Heb. 8:5)
 - i. Model moral (shih Fil. 3:17; 1 Thes. 1:7; 2 Thes. 3:9; 1 Tim. 4:12; 1 Pje. 5:3)

Në këtë kontekst, #1 më sipër duket më e sakta. Ungjilli ka edhe rrjedhoja doktrimore, edhe rrjedhoja për stilin e jetesës. Dhurata falas e shpëtimit në Krishtit kërkon dhe një jetë në ngjashmëri me Krishtin!

6:18 “duke qenë çliruar nga mëkati” Kjo është një PJESORE AORISTE PËSORE. Ungjilli i ka çliruar besimtarët me anë të veprimit të Frymës nëpërmjet punës së Krishtit. Besimtarët janë çliruar edhe nga ndëshkimi i mëkatit (shfajësimi), edhe nga tirania e mëkatit (shenjtërimi, krh. vv. 7 dhe 22). Një ditë ata do të jenë të lirë nga prania e mëkatit (përlëvdimi, krh. 8:29-30).

▣ **“ju u bëtë skllavër të drejtësisë”** Kjo është një AORISTE PËSORE DËFTORE, “ju u skllavëruat ndaj drejtësisë.” Shih Temën e Veçantë në 1:17. Besimtarët janë çliruar nga mëkati për t'i shërbyer Perëndisë (krh. vv. 14,19,22; 7:4; 8:2)! Synimi i hirit falas është një jetë e perëndishme. Shfajësimi është edhe një shpallje ligjore, edhe një shtysë për drejtësi personale. Perëndia dëshiron të na shpëtojë dhe të na ndryshojë në mënyrë që të arrijmë të tjerë! Hiri nuk ndalon me shpëtimin e besimtarit individual (krh. Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8).

6:19 “Po flas në terma njerëzore për shkak të dobësisë së mishit tuaj” Pali po iu drejtohet besimtarëve në Romë. A po i adresohet ai një problemi lokal për të cilin kishte dëgjuar (xhelozit midis besimtarëve hebrenj dhe besimtarëve johebrej) apo po thekson një të vërtetë për të gjithë besimtarët? Pali e përdori këtë frazë më herët te Rom. 3:5, siç bën edhe te Gal. 3:15.

Vargu 19 është paralel me v. 16. Pali i përsërit përfundimet e tij teologjike për theksim.

Disa do të thoshin që kjo frazë ka kuptimin që Pali po kërkonte falje që po përdorte një metaforë skllavërie. Megjithatë, “për shkak të dobësisë së mishit tuaj” nuk përputhet me këtë interpretim. Skllavëria nuk shikohej si një gjë e keqe nga shoqëria e shekullit të parë, veçanërisht në Romë. Ajo ishte thjesht kultura e kohës. Dy të tretat e botës romake ishin skllavër.

▣ **“mishit”** Shih Temën e Veçantë në 1:3.

▣ **“që çon në shenjtërim”** Ky është synimi i shfajësimit (krh. v. 22). DHR e përdor këtë term në dy kuptime teologjike të lidhura me shpëtimin.

1. shenjtërim pozicional, i cili është dhuratë e Perëndisë (aspekti objektiv) e dhënë në momentin e shpëtimit bashkë me shfajësimin nëpërmjet besimit në Krishtin (krh. Veprat 26:18; I Kor. 1:2; 6:11; Efe. 5:26-27; I Thes. 5:23; II Thes. 2:13; Heb. 10:10; 13:12; I Pjet. 1:2)
2. shenjtërim progresiv i cili është gjithashtu vepër e Perëndisë përmes Frymës së Shenjtë me anë të të Cilit jeta e besimtarit shndërrohet në imazhin dhe pjekurinë e Krishtit (aspekti subjektiv, krh. II Kor. 7:1; I Thes. 4:3,7; I Tim. 2:15; II Tim. 2:21; Heb. 12:10,14)

Shih Temën e Veçantë: Shenjtërim at 6:4.

Shenjtërimi është edhe dhuratë, edhe urdhërim! Është pozicion (qëndrim) dhe veprimtari (mënyrë jetese)! Është DËFTOR (deklaratë) dhe URDHËROR (urdhër)! Ai vjen në fillim, por nuk përfundon deri në fund (krh. Fil. 1:6; 2:12-13).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 6:20-23

²⁰ Sepse kur ishit skllavër të mëkatit, ishit të lirë në lidhje me drejtësinë. ²¹ Atëherë pra, çfarë përfitimi po merrni ju atëherë nga gjërat për të cilat tani turpërohemi? Sepse rezultati i atyre gjërave është vdekja. ²² Por tani duke qenë të çliruar nga mëkati dhe të skllavëruar ndaj Perëndisë, ju merrni përfitimin tuaj, që rezulton në shenjtërim, dhe rezultati, jetë e përjetshme. ²³ Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhurata falas e Perëndisë është jeta e përjetshme në Krishtin Jezus Zotin tonë.

6:20-21 Këtu thjesht thuhet e të kundërta e of vv. 18 dhe 19. Besimtarët mund t’i shërbejnë vetëm një zotërie (krh. Luka 16:13).

6:22-23 Këto vargje formojnë një progresion logjik të pagës që paguan ai që të cilit i shërbehet. Faleminderit Perëndisë që ky diskutim i mëkatit dhe besimtarit përfundon me një fokus hiri! E para është dhurata e shpëtimit përmes bashkëpunimit tonë, dhe pastaj dhurata e jetës së krishterë, gjithashtu përmes bashkëpunimit tonë. Të dyja janë dhurata që merren përmes besimit dhe pendimit.

6:22 “ju merrni përfitimin tuaj, që rezulton në shenjtërim, dhe rezultati, jetë e përjetshme” Termi “përfitim,” fjalë për fjalë “fryt” është përdorur në v. 21 për të folur për pasojat e mëkatit, por në v. 22 ai flet për pasojat e shërbimit ndaj Perëndisë. Përfitimi i menjëhershëm është ngjashmëria e besimtarit me Krishtin. Përfitimi përfundimtar dhe më i madhi është të jemi me Të dhe si Ai përjetësisht (krh. I Gjonit 3:2). Nëse nuk ka rezultat të menjëhershëm (jetë të ndryshuar, krh. Jakobi 2) rezultati përfundimtar mund të vihet me të drejtë në pikëpyetje (jeta e përjetshme, krh. Mat. 7). “Nëse nuk ka fryt, do të thotë që nuk ka rrënjë!”

6:23 Kjo është përmbledhja e të gjithë kapitullit. Pali e pikturoi zgjedhjen bardh e zi. Zgjedhja është jona – mëkat dhe vdekje, ose hir falas përmes Krishtit dhe jetë të përjetshme. Kjo është shumë e ngjashme me “dy rrugët” e letërsisë së ertësisë së DHV (LiP. 30:1,17; Psalmi 1; Fjalët e Urta 4; 10-19; Mat. 7:13-14).

■ **“paga e mëkatit”** Mëkati personifikohet si (1) skllavopronar, (2) gjeneral ushtarak, ose (3) mbret që jep paga (krh. 3:9; 5:21; 6:9,14,17).

■ **“dhurata falas e Perëndisë është jeta e përjetshme”** Kjo fjalë, e përkthyer “dhurata falas” (*charisma*) vinte nga rrënja për hir (*charis*, krh. 3:24; 5:15, 16, 17; Efe.2:8-9). Shih shënimin te 3:24.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si lidhen veprat e mira me shpëtimin (krh. Efe. 2:8-9,10)?
2. Si lidhet mëkati i vazhdueshëm në jetën e besimtarit me shpëtimin (krh. I Gjonit 3:6,9)?
3. A mëson ky kapitull “përsosmërinë e pamëkat?”
4. Si lidhet kapitulli 6 me kapitujt 5 dhe 7?
5. Pse diskutohet këtu pagëzimi?
6. A e ruajnë të krishterët natyrën e vjetër? Pse?
7. Cili është nënkuptimi i FORMAVE FOLJORE TË KOHËS SË TASHME që mbizotërojnë v. 1-14 dhe FORMAVE FOLJORE TË KOHËS AORISTE në 15-23?

ROMAKËVE 7

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Një analogji nga martesë	Të çliruar nga ligji	Një analogji nga martesë	Një ilustrim nga martesë	I krishteri është i çliruar nga skllavëria ndaj ligjit
7:1-6	7:1-6	7:1-3 7:4-6	7:1-6	7:1-6
Problemi i mëkatit brendabanues	Avantazhi i mëkatit në Ligj	Ligji dhe Mëkati	Ligji dhe Mëkati	Funksioni i Ligjit
7:7-12	7:7-12	7:7-12	7:7-11	7:7-8 7:9-11
7:13-25	7:13-25	Ligji nuk mund të shpëtojë dikë nga mëkati	7:12-13	7:12-13
		7:13 Konflikti i brendshëm	Konflikti te njeriu	Beteja e brendshme
		7:14-20	7:14-20	7:14-20
		7:21-25a	7:21-25a	7:21-23 7:24-25a
		7:25b	7:25b	7:25b

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE MBI VARGJET 1-6

- A. Kapitulli 7 duhet interpretuar
- nën dritën e kapitullit 6, veçanërisht vv. 12-14 (gjithashtu 3:20,21-31; 4:13-16; 5:20)
 - gjithashtu ai duhet lidhur me tensionin në kishën e Romës midis besimtarëve johebrenj dhe atyre hebrej, që duket në kapitujt 9-11
- Natyra e saktë e problemit është e paqartë; ai mund të ketë qenë
- theksi i judenjve mbi faktin që Moisiu erdhi i pari, pastaj Krishti,
 - legalizmi i bazuar mbi Ligjin e Moisiut,
 - keqkuptim për mënyrën si zbatohet ungjilli ndaj hebrenjve,
 - keqkuptim i marrëdhënies midis Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re.
 - Xhelozia në lidhje me faktin që udhëheqësia hebreje në kishë ishte zëvendësuar me udhëheqësi johebreje gjatë dekretit të perandorit, që i ndaloi të gjitha ritualet hebreje në Romë.
- Shumë hebrej besimtarë mund të ishin larguar gjithashtu.
- B. Romakëve 7:1-6 vazhdon gjuhën figurative të kapitullit 6 për marrëdhënien e të krishterit me jetën e tij të vjetër. Metaforat e përdorura janë
- vdekja dhe çlirimi nga skllavëria ndaj një zotërie tjetër (kapitulli 6)
 - vdekja dhe çlirimi nga detyrimet martesore (kapitulli 7)
- C. Kapitujt 6 dhe 7 janë në paralel letrar; kapitulli 6 trajton marrëdhënien e besimtarit me “mëkatin” dhe kapitulli 7 marrëdhënien e besimtarit me “ligjin.” Analogjia e vdekjes që e çliron një skllav (6:12-23) vihet paralel me atë të vdekjes që zgjidh lidhjen martesore (7:1-6).

Kapitulli 6	Kapitulli 7
6:1 “mëkati”	7:1 “ligji”
6:2 “vdiqët për mëkatin”	7:4 “vdiqët ndaj Ligjit”
6:4 “që të mund të ecim në risinë e jetës”	7:6 “që të mund të shërbejmë në risinë e frymës”
6:7 “ai që ka vdekur është çliruar nga mëkati”	7:6 “ne jemi çliruar nga ligji pasi kemi vdekur ndaj asaj që na mbante”
6:18 “duke qenë çliruar nga mëkati”	7:3 “të lirë nga ligji”

(marrë nga *Commentary on Romans*, nga Anders Nygren përthyer nga Carl C. Rasmussen, fq. 268)

- D. Ligji me dekretet e tij ishte një dënim me vdekje. Të gjithë njerëzit qëndrojnë të dënuar nën Ligjin (krh. Rom. 6:14; 7:4; Gal. 3:13; Efe. 2:15; Kol. 2:14). Ligji i Moisiut u bë mallkim!
- E. Ka patur katër teori kryesore në lidhje me mënyrën e interpretimit të kapitullit 7
- Pali po flet për veten (autobiografik)
 - Pali po flet si përfaqësues i gjithë njerëzimit (përfaqësues, Krisostomi)
 - Pali po flet për përjetimin e Adamit (Theodori i Mopsuetias)
 - Pali po flet për përjetimin e Izraelit

- F. Në shumë mënyra Romakëve 7 funksionon si Zanafilla 3. Ai tregon tërheqjen për poshtë të rebelimit edhe për ata që janë të njohur me Perëndinë. Njohuria nuk mund ta çlirojë njerëzimin e rënë; vetëm hiri i Perëndisë, vetëm një zemër e re, një mendje e re dhe një frymë e re mund ta bëjnë këtë (Besëlidhja e Re, krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:26-27). Madje edhe atëherë, ka një betejë të vazhdueshme (krh. 6:12,19; I Kor. 6:10-19; Efe. 6:10-18)!

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:1-3

¹ Apo nuk e dini, vëllezër (sepse po u flas atyre që e njohin ligjin), që ligji ka fuqi mbi një person për sa kohë ai jeton? ² Sepse gruaja e martuar është e detyruar nga ligji ndaj burrit tësaj sa kohë ai është gjallë; por, nëse i shoqi vdes, ajo është e çliruar nga ligji në lidhje me burrin. ³ Atëherë pra, nëse sa kohë i shoqi është gjallë, ajo bashkohet me një burrë tjetër, ajo do të quhet shkelëse e kurorës; por nëse i shoqi vdes, ajo është e liruar nga ligji, kështu që ajo nuk është shkelëse e kurorës megjithëse bashkohet me një burrë tjetër.

7:1 “(sepse po u flas atyre që e njohin ligjin)” Kjo mund t’i referohej

1. vetëm hebrenjve besimtarë
2. konfliktit midis besimtarëve hebrenj dhe johebrej në kishën e Romës
3. ligjit në një kuptim të përgjithshëm të lidhur me gjithë njerëzimin (krh. 2:14-15)
4. besimtarëve të rinj johebrej të përfshirë në mësimin në lidhje me besimin e tyre të ri (katekizëm, 6:17) nga Shkrimet e DHV.

■ **“ligji”** Kjo është pika kryesore e kapitullit (krh. vv. 1,2,4,5,6, etj). Megjithatë, Pali e përdor këtë term në disa kuptime të ndryshme (ligji i natyrës; Ligji i Moisiut; normat shoqërore). Duket që diskutimi i Palit u nxit nga 6:14. Prezantimi i tij është paralel me strukturën e kapitullit 6. Shih Të Dhëna Kontekstuale, C. Ligji i Moisiut dhe marrëdhënia e tij me Besëlidhjen e Re në Krishtin diskutohet edhe në 3:21-31 dhe 4:13-16.

■

NASB	“ligji ka fuqi mbi një person për sa kohë ai jeton”
NKJV	“që ligji ka zotërim mbi një njeri për sa kohë ai jeton”
NRSV	“që ligji është detyruar mbi një person vetëm gjatë jetës së atij personi”
TEV	“Ligji sundon mbi një njeri vetëm për sa kohë ai jeton”
NJB	“që ligji e ndikon një person vetëm gjatë jetës së tij”

Kjo fjalë për fjalë është “të jesh zot i dikujt” (*kurieuō*, krh. 6:9,14). Ligji i Moisiut ishte edhe një bekim i madh (krh. Ps. 19; 119), edhe një mallkim i tmerrshëm (krh. Gal. 3:13; Efe. 2:15; Kol. 2:14). Me vdekjen fizike, detyrimet ndaj Ligjit pushojnë. Kjo është e njëjta metaforë e përdorur në kapitullin 6 në lidhje me vdekjen e besimtarit ndaj mëkatit.

7:2 **“sepse gruaja e martuar”** Ky është ilustrimi kryesor i Palit në vv. 1-6. Në kapitullin 6 ai mori ilustrimin e vdekjes që i jep fund detyrimit të një personi si skllav. Këtu fokusi është martesë dhe detyrimet/obligimet e saj. Ilustrimi është kokëposhtë, sepse është burri ai që vdiq, kështu që e veja mund të rimartohej, kurse në analogjinë e Palit, është besimtari ai që vdiq, dhe prandaj, është i gjallë për Perëndinë.

■ **“ajo është e çliruar”** Kjo është e njëjta FOLJE si në 6:6; ajo ka kuptimin “të bësh jofunksional,” “të bësh të papërdorshëm,” ose “të shfuqizosh.” Në 6:6, ishte në AORISTE PASIVE, këtu është E KRYER PASIVE, dhe ka kuptimin “ka qenë dhe vazhdon të jetë e çliruar.” Shih Temën e Veçantë në 3:3.

7:3 **“ajo do të quhet shkelëse e kurorës”** Ky koment është i lidhur me mosmarrëveshjen midis shkollave rabinike të Shammai-t dhe Hillel-it mbi LiP 24:1-4; veçanërisht në lidhje me shprehjen “diçka të turpshme.” Shkolla e Hillel-it ishte grupi liberal që e lejonte divorcin për çfarëdo arsye. Shkolla e Shammai-it ishte grupi

konservator që e lejonte divorcin vetëm për kurorëshkelje, ose për ndonjë shkelje tjetër seksuale (krh. Mat. 5:32; 19:9).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:4-6

⁴ Prandaj, vëllezërit e mi, edhe ju vdiqët ndaj Ligjit përmes trupit të Krishtit, që të mund të bashkoheni me një tjetër, me Atë që u ngjall nga të vdekurit, me qëllim që të mund të japim fryt për Perëndinë. ⁵ Sepse ndërsa ishim në mish, pasionet mëkatore, që u zgjuan nga Ligji, vepronin në gjymtyrët e trupit tonë për të dhënë fryt për vdekjen. ⁶ Por tani jemi çliruar nga Ligji, pasi kemi vdekur ndaj çfarë na kishte lidhur, që të shërbejmë në risinë e Frymës, dhe jo në vjetërsinë e shkronjës.

7:4 “edhe ju vdiqët” Kjo është pika kryesore e këtij paragrafi (dhe kapitullit 6). Ajo lidhet me analogjinë në kapitullin 6 e vdekjes së të krishterëve ndaj mëkatit sepse ata janë “bashkë-varrosur” (6:4) dhe “bashkë-kryqëzuar” (6:6) me Krishtin (krh. II Kor. 5:14-15; Gal. 2:20). Besimtarët janë krijesa të reja në Krishtin (shih shënimin e plotë në 6:4), në këtë epokë të re të Frymës (krh. II Kor. 5:17). Pagëzimi shënon kufirin midis epokës së vjetër, njeriut të vjetër, dhe epokës së re, njeriut të ri.

▣ **“përmes trupit të Krishtit”** Kjo nuk i referohet konceptit teologjik të kishës si trupi i Krishtit (krh. I Kor. 12:12,27), por trupit fizik të Krishtit si në 6:3-11 ku, kur vdiq Krishti, besimtarët, me anë të identifikimit përmes pagëzimit, vdiqën me Të. Vdekja e Tij ishte vdekja e tyre (krh. II Kor. 5:14-15; Gal. 2:20). Jeta e Tij e ringjallur i çliroi ata për t’i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve.

▣ **“që të mund të japim fryt për Perëndinë”** Kjo ishte gjithashtu paralel me kapitullin 6, veçanërisht 6:22. Besimtarët janë tani të lirë përmes Krishtit për t’ia nënshtruar veten Krishtit. Kjo është analogjia e martesës në vazhdim. Ashtu siç Krishti vdiq për besimtarët, ashtu ata tani duhet të vdesin ndaj mëkatit (II Kor. 5:13-14; Gal. 2:20). Ashtu siç Krishti u ringjall, ashtu edhe ata ringjallen në një jetë të re shpirtërore shërbimi ndaj Perëndisë (krh. Rom. 6:22; Efe. 2:5-6) dhe njëri-tjetrit (krh. I Gjonit 3:16).

7:5

NASB

“Sepse ndërsa ishim në mish”

NKJV

“Sepse kur ishim në mish”

NRSV

“Ndërsa jetonim në mish”

TEV

“Sepse kur jetonim sipas natyrës sonë njerëzore”

NJB

“Përpara se të konvertoheshim”

Ky varg është në kontrast me v. 4. Vargu 4 lidhet me përrjetimin e një besimtari, ashtu si edhe v. 6. Vargu 5 përshkruan “frytin” e jetës pa fuqinë e Perëndisë (Gal. 5:18-24). Ligji u tregon besimtarëve mëkatit (vv. 7-9; Gal. 3:23-25), por nuk mund t’iu japë atyre fuqinë për ta mposhtur atë.

Në kontekst kjo frazë i referohet natyrës së rënë dhe mëkatore të besimtarëve të trashëguar nga Adami (krh. 6:19). Pali e përdor këtë term *sarx* në dy mënyra të ndryshme (1) natyra mëkatore (njeriu i vjetër) dhe (2) trupi fizik (krh. 1:3; 4:1; 9:3,5). Këtu është negative, por vini re Rom. 1:3; 4:1; 9:3,5; Gal. 2:20. Mishi/trupi (*sarx/soma*) nuk është i keq në vetvete, por ai, si edhe mendja (*nous*), është fushëbeteja, vendi i konfrontimit mes forcave të këqija të kësaj epoke dhe Frymës së Shenjtë. Pali e përdor këtë term në një mënyrë që është konsistente me Septuagintën, jo me letërsinë greke. Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarx*) në 1:3.

▣ **“që u zgjuan nga Ligji”** Ky aspekt i natyrës rebele njerëzore, që reagon me agresivitet ndaj çdo kufizimi, duket qartë tek Zanafilla 3 dhe në të gjitha qeniet njerëzore. Ligji caktonte kufij (krh. vv. 7-8). Këta kufij ishin për mbrojtjen e njerëzimit, por njerëzit i shikonin si zinxhirë dhe kufizime. Shpirti mëkatar dhe i pavarur u nxit nga Ligji i Perëndisë. Problemi nuk ishin kufijtë (ligji, krh. vv. 12-13), por autonomia dhe kokëfortësia njerëzore.

▣ **“për të dhënë fryt për vdekjen”** Çfarë kontrasti i fortë midis

1. v. 5 – të japësh fryt për Perëndinë
2. v. 6 – të japësh fryt për vdekjen

Besimtarët kanë vdekur ndaj vdekjes, mëkatit dhe Ligjit dhe tani ata jetojnë për të dhënë fryt për Mbretërinë! Pali pikturon me ngjyra bardh e zi (ose më mirë në kategori paradoksale, shih shënimin te 8:2). Një person është në njërin nga dy grupet—Adamin, ose Jezusin (krh. 5:12-21). Ata në Jezusin janë të lirë, të çliruar dhe të rinj (krh. Gal. 2:19-20)! Ecni në të! Ngazëllohuni në të!

7:6 “Por tani” Newman dhe Nida, *A Translator’s Handbook on Paul’s Letter to the Romans*, ka një koment interesant.

“Është e rëndësishme të vihen re paralelet midis vargjeve 5 dhe 6, dhe në të njëjtën kohë marrëdhënia e tyre me atë që pason. Vargu 5 përshkruan përjetimin para se personi të ishte i krishterë dhe e ka paralelin e vet në 7:7-25; vargu 6 përshkruan jetën e tashme të besimit nën udhëheqjen e Frymës së Perëndisë, dhe e ka paralelin e vet në 8:1-11” (fq. 130).

■ **“jemi çliruar”** Kjo është një AORISTE PËSORE DËFTORE. Kjo është në kontrast me KOHËN E PAKRYER JOVEPRORE DËFTORE të v. 5. Besimtarët kanë qenë vazhdimisht robër të mëkatit siç zbulohet në Ligj, por tani janë çliruar nga Fryma përmes lajmit të mirë të ungjillit. Po kjo fjalë përdoret për gruan, burri i së cilës vdes në v. 2.

■ **“pasi kemi vdekur ndaj çfarë na kishte lidhur”** Kjo është një PJESORE AORISTE VEPRORE e ndjekur nga një E PAKRYER PËSORE DËFTORE. Perëndia i çliron besimtarët përmes vdekjes së Krishtit nga

1. mallkimi i DHV
2. vetet e tyre të brendshme mëkatore

Ata kanë qenë të lidhur vazhdimisht nga rebelimi i tyre ndaj vullnetit të zbuluar të Perëndisë, nga natyra e rënë, nga mëkati personal dhe nga tundimi mbinatyror (krh. Efe. 2:2-3)!

■ **“risinë. . .vjetërsinë”** Kjo mënyrë e re shpirtërore duket se i referohet Besëlidhjes së Re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-32). Termi grek “i ri” (*kainos - kainotēs*) përdoret nga Pali për

1. risinë e jetës, Rom 6:4 (shih shënimin e plotë në 6:4)
2. risinë e Frymës, Rom. 7:6
3. besëlidhjen e re, I Kor. 11:2; II Kor. 3:6
4. krijimin e ri, II Kor. 5:17; Gal. 6:15
5. njeriun e ri, Efe. 2:15; 4:24

Termi “i vjetër” i referohet Ligjit të Moisiut dhe ka kuptimin “tërisisht i vjetëruar.” Pali po vë në kontrast Besëlidhjen e Vjetër dhe Besëlidhjen e Re, siç bën edhe autori i Hebrenjve (krh. 8:7 dhe 13).

■

NASB, NKJV “që të shërbejmë në risinë e Frymës”

NRSV “që të jemi skllëvër jo nën kodin e vjetër të shkruar, por në jetën e re të Frymës”

TEV “por në mënyrën e re të Frymës”

NJB “të lirë të shërbejmë në mënyrën e re frymërore”

Kjo është fjalë për fjalë “në risinë e frymës.” Është e paqartë nëse i referohet frymës së rilindur njerëzore apo Frymës së Shenjtë. Shumica e përkthimeve në anglisht e shkruajnë me shkronjë të madhe, që nënkupton Frymën e Shenjtë, i cili përmendet me dy kuptime për herë të parë te Romakëve 8 (15 herë). Termi “frymë” mund t’i referohet frymës njerëzore të rilindur dhe të fuqizuar nga ungjilli dhe Frymës te Rom. 1:4,9; 2:29; 7:6; 8:15; 11:8; 12:11; I Kor. 2:11; 4:21; 5:3,4,5; 7:34; 14:15,16,32; 16:18.

Në shkrimet e Palit “mishi” dhe “fryma” shpesh kontrastohen si dy mënyra të dallueshme të të menduarit dhe të të jetuarit (krh. 7:14; 8:4; Gal. 3:3; 5:16,17,25; 6:8). Jeta fizike pa Perëndinë është “mish” (shih Temën e Veçantë te 1:3), por jeta me Perëndinë është “frymë” ose “Frymë.” Fryma e Shenjtë brendabanues (krh. 8:9,11) e transformon besimtarin në një krijesë të re në Krishtin (në aspektin pozicional dhe atë të përjetimit).

TË DHËNA KONTEKSTUALE MBI ROMAKËVE 7:7-25

- A. Romakëve 7:7-25 shpreh një realitet njerëzor. Të gjitha qeniet njerëzore, edhe të shpëtuar, edhe të humbur, e kanë përjetuar tensionin e të mirës dhe të keqes në botën e tyre dhe në zemrat dhe mendjet e tyre. Pyetja hermeneutike (interpretuese) është, “Si donte Pali që të kuptohej ky pasazh?” Ai duhet të jetë

i lidhur kontekstualisht me kapitujt 1:18-6:23 dhe 8:1-39. Disa mendojnë se ai fokusohet mbi të gjitha qeniet njerëzore dhe, për këtë arsye, e shohin përvojën e Palit si model. Ky interpretim quhet “teoria autobiografike.”

Pali e përdori “unë” në një kuptim jopersonal te I Kor. 13:1-3. Ky përdorim jopersonal i “unë” mund të dokumentohet edhe nga rabinët hebrej. Nëse është i vërtetë këtu, ky pasazh i referohet tranzicionit të njerëzimit nga pafajësia përmes bindjes për mëkat në shpëtim (kapitulli 8) “teoria përfaqësuese” (shih, *Jerome Biblical Commentary*, fq. 312).

Megjithatë, të tjerë mendojnë se këto vargje kanë lidhje me betejën e fortë e të vazhdueshme të një besimtari me natyrën e rënë njerëzore (p.sh., Augustini, Tomas Akuinas, Martin Luteri, Xhon Kalvini, Karl Barthi). Klithma që të këput shpirtin ev. 24 e shpreh këtë tension të brendshëm. KOHËT E FOLJEVE AORISTE DHE TË PAKRYERA mbizotërojnë vv. 7-13, kurse KOHËT E TASHME DHE TË KRYERA mbizotërojnë vv. 14-25. Kjo duket se i jep besueshmëri “teorisë autobiografike” që Pali po përshkruan përvojën e tij nga pafajësia, në bindjen për mëkat, në shfaqjesim dhe rrugën e mbushur me tension të shenjtërimit progresiv (krh. *autos egō*, “unë vetë,” krh. v. 25). Është e mundur edhe që të dyja pikëpamjet të jenë të vërteta. Në vv. 7-13 dhe 25b Pali po flet në mënyrë autobiografike, kurse në vv. 14-25a, ai po flet për përvojën e tij të betejës së brendshme me mëkat, si përfaqësues i të gjithë njerëzimit të shpenguar. Megjithatë, duhet mbajtur mend që i gjithë ky pasazh duhet parë edhe kundrejt sfondit të Palit si një fetar hebre i përkushtuar përpara se të rilindej. Përvoja e Palit ishte në mënyrë unikale e tija.

- B. Ligji është i mirë. Ai është nga Perëndia. Ai i shërbente dhe vazhdon t’i shërbejë një qëllimi hyjnor (krh. 7:7, 12, 14, 22, 25; Mat. 5:17-19). Ai nuk mund të sjellë paqe apo shpëtim (krh. Galatasve 3). James Stewart në librin e tij *A Man in Christ*, tregon të menduarit dhe të shkruarit paradoksal të Palit:
- “Natyrshëm do të prisnim që një njeri i cili i ishte futur punës për të ndërtuar një sistem mendimi dhe doktrine do t’i fiksonte në mënyrë sa më të ngurtë kuptimet e termave që do të përdorte. Do të prisnim që ai të synonte precizion në frazeologjinë e ideve të tij kryesore. Do të kërkonim që një fjalë, pasi të ishte përdorur njëherë nga shkrytari ynë në një kuptim të caktuar, duhej ta ruante atë kuptim gjithandej. Por nëse do ta kërkojmë këtë te Pali, do të zhgënjehemi. Pjesa më e madhe e frazeologjisë së tij është fluide, jo e ngurtë. . . ‘Ligji është i shenjtë,’ shkruan ai, ‘Unë gjej kënaqësi të madhe në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm’ (krh. Rom. 7:12-13) por është qartësisht një aspekt tjetër i *nomos* që e bën të thotë në një vend tjetër, ‘Krishti na ka shpenguar nga mallkimi i ligjit (krh. Gal. 3:13)’” (fq. 26).
- C. Provat tekstuale që kanë të bëjë me pyetjen, “A po i referohet Pali një personi të shpëtuar, apo të pashpëtuar në vv. 14-25?” është si më poshtë
1. Person i pashpëtuar
 - a. Ky ishte interpretimi i Etërve të hershëm greqishtfolës të kishës
 - b. Frazat e mëposhtme e mbështesin këtë pikëpamje
 - (1) “Unë jam prej mishi,” v. 14
 - (2) “i shitur në skllavëri ndaj mëkatit,” v. 14
 - (3) “asgjë e mirë nuk banon në mua,” v. 18
 - (4) “duke më bërë të burgosur të ligjit të mëkatit që është në gjymtyrët e mia,” v. 23
 - (5) “Njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga trupi i kësaj vdekjeje?” v. 24
 - c. Konteksti imediat/imenjehershëm i kapitullit 6 është që ne jemi të lirë nga zotërimi i mëkatit. Konteksti i kap. 8 fillon me “Atëherë pra.”
 - d. Mungesa e ndonjë reference ndaj Frymës ose Krishtit deri në mbyllje të këtij konteksti (v. 25).
 2. Person i shpëtuar
 - a. Ky ishte interpretimi i Augustinit, Kalvinit, dhe i traditës së Reformuar
 - b. Frazat e mëposhtme e mbështesin këtë pikëpamje
 - (1) “ne e dimë që Ligji është frymëror,” v. 14
 - (2) “unë bie dakord me Ligjin, duke rrëfyer që ai është i mirë,” v. 16
 - (3) “të mirën që dëshiroj, nuk e bëj...,” v. 19
 - (4) “unë me gëzim bie dakord me ligjin e Perëndisë në njeriun e brendshëm,” v. 22
 - c. Konteksti më i gjerë i Romakëve e vendos kapitullin 7 në seksionin që flet për shenjtërimin.

d. Ndryshimi që bie në sy i kohëve të foljeve nga E PAKRYER dhe AORISTE në vv. 7-13 në përdorimin e qëndrueshëm të kohës SË TASHME në vv. 14-24 nënkupton një seksion të ri dhe të ndryshëm të jetës së Palit (d.m.th., kthimin në besim).

D. Sa më shumë që një besimtar të mundohet për të qenë si Krishti, aq më shumë ai përjeton mëkatshmerinë e tij/saj. Ky paradoks përshtatet mirë me këtë kontekst dhe me personalitetin e Palit (dhe, për atë punë, të shumicës së besimtarëve; për një pikëpamje të kundërt shikoni Gordon Fee, *Paul, The Spirit, and the People of God*).

Një strofë nga një himn Luteran nga Henry Twells:

“dhe asnjë, O Zot, s’ka paqe të përsosur,
sepse asnjë nuk është plotësisht i çliruar nga mëkati;
dhe ata që do të donin të të shërbenin ty më mirë
janë më të vetëdijshëm për gabimet përbrenda.”

Unë mendoj se Pali po luftonte me të kaluarën e tij fariseike që i dha strukturë paraqitjes së tij të “Ligjit” dhe “mëkatit/vdekjes.” Megjithatë, unë ndikohem edhe nga beteja ime me tundimin dhe mëkatin pas shpëtimit. Kjo patjetër që e ka ngjyrosur interpretimin tim. Mendoj se libri i Gordon Fee, *Paul, the Spirit, and the People of God*, paraqet një përvojë dhe këndvështrim tjetër të mirëqenë të një krishteri. Një gjë e di, tensioni ose konflikti midis

1. epokës së re – epokës së vjetër
2. njeriut të vjetër – njeriut të ri
3. ligjit – frymës

është zgjidhur në Krishtin! Fitorja është e jona. Mos u fokusoni kurrë në kapitullin 7 pa vënë re edhe kapitujt 6 dhe 8. Fitorja është e jona në Të!

E. Fjalë të përbëra me *Sun* (PARAFJALË në 8:32) te Romakëve 8

1. v. 16 – *sun* + dëshmoj
2. v. 17 – *sun* + trashëgimtar
3. v. 17 – *sun* + vuaj
4. v. 17 – *sun* + përlëvdoj
5. v. 22 – *sun* + rënkoj
6. v. 22 – *sun* + dhimbje të lindjes
7. v. 26 – *sun* + marr në zotërim
8. v. 28 – *sun* + punoj me/bashkëpunoj
9. v. 29 – *sun* + konformuar

Këto fjalë të përbëra tregojnë “bashkëpjesëmarrje” ose “bashkëpunim me.”

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:7-12

⁷Çfarë të themi atëherë? Është Ligji mëkat? Kurrë mos qoftë! Përkundrazi, unë nuk do të kisha arritur ta njihja mëkatin përveçse përmes Ligjit; sepse nuk do të kisha ditur për lakminë nëse Ligji nuk do të kishte thënë, “NUK DO TË LAKMOSH.” ⁸Por mëkati, duke përfutur nga urdhërimi, prodhoi në mua lakmi të çdo lloji; sepse pa Ligjin, mëkati është i vdekur. ⁹Unë isha dikur i gjallë pa Ligjin; por kur erdhi urdhërimi, mëkati u ngjall dhe unë vdiqa; ¹⁰dhe ky urdhërim, i cili duhej të rezultonte në jetë, doli se rezultoi në vdekje për mua; ¹¹sepse mëkati, duke përfutur nga urdhërimi, më mashtroi dhe përmes tij më vrau. ¹²Atëherë pra, Ligji është i shenjtë dhe urdhërimi është i shenjtë dhe i drejtë dhe i mirë.

7:7 “Çfarë të themi atëherë” Pali po i rikthehet përdorimit të diatribit (krh. 6:1,15; 7:1,13).

■ “Është Ligji mëkat” Një nga paradokset e zbulues është që Perëndia përdori shenjtërinë dhe mirësinë e Ligjit për të zbuluar mëkatin, në mënyrë që ta sillte njerëzimin e rënë në pendim dhe besim (krh. vv. 12-13; Galatasve 3). Gjithashtu, për çudi, Ligji vazhdon të funksionojë në shenjtërim, por jo në shfajësim (shih Temën e Veçantë: Pikëpamjet e Palit për Ligjin e Moisiut te 13:9).

■ **“Kurrë mos qoftë”** Mënyra karakteristike e Palit për të hedhur poshtë një pohim të rremë (krh. v. 13; 3:4,6,31; 6:2,15; 9:14; 11:1,11; Gal. 2:17; 3:21).

■ **“përkundrazi”** Stili letrar i Palit te Romakëve përdor kontraste të forta për të parashtruar idetë e tij (krh. 3:4,6,31; 6:2,15; 7:13; 9:14; 11:1,11).

■ **“unë”** Shënojeni në Biblën tuaj sa herë dalin përemrat vetorë dhe pronorë “unë,” “im,” ose “mua” në kontekstin evv. 7-25. Do të mahniteni. Dalin mbi dyzet herë.

■ **“unë nuk do të kisha arritur ta njihja mëkatin përveçse përmes Ligjit”** Ky është një nga pasazhet kyçe që zbulojnë konceptin që Ligji i Moisiut funksionon si një pasqyrë për të zbuluar mëkatin personal (krh. 3:20; 4:65; 5:20; Gal.3:14-29, sidomos v. 24). Të shkelje Ligjin një herë ishte të shkelje Besëlidhjen, dhe si rrjedhojë të mbaje pasojat (krh. v. 10 dhe Jakobi 2:10)!

■ **“përveçse përmes Ligjit”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË DYTË që quhet “e kundërt me faktin.” Pali ishte i bindur për mëkat. Ky është i vetmi shembull i këtij tipari gramatik te Romakëve. Pali e përdor edhe te Gal. 1:10; 3:21, si edhe te I Kor. 2:8; 5:10; 11:31; and II Kor. 12:11.

■ **“NUK DO TË LAKMOSH”** Ky është një citim i urdhërimit të fundit të Dhjetë Urdhërimeve (krh. Eksodi 20:17; LiP 5:21). Ky urdhërim i fundit fokusohet në qëndrimin e duhur, gjë që është në të vërtetë thelbi i të gjithë urdhërimeve (krh. Mateu 5-7). Ligjit i referohet shpesh si “urdhërimi” (krh. vv. 8,9,11,12,13).

Termi “lakmoj” do të thotë “ta kesh mendjen te diçka” ose “të dëshirosh fort.” Perëndia u ka dhënë njerëzve (të humbur e të shpëtuar) shumë gjëra të mira përmes krijimit, por njerëzit prirën t’i çojnë dhuratat e Perëndisë përtej kufijve të dhënë nga Perëndia. “Gjithmonë e më shumë për mua me çdo çmim” bëhet motoja e tyre! Vetja është një tiran i tmerrshëm! Shih Temën e Veçantë: Shënime mbi Eksodin 20:17 te 13:8-9.

7:8

NASB, NKJV

“duke përfituar”

NRSV

“duke e kapur mundësinë”

TEV

“gjeti rastin”

NJB

“përfitoi”

Ky ishte një term ushtarak që përdorej për një fortesë ose bazë operacionesh (krh. vv. 8 and 11). Është e personalizuar në këtë kontekst (krh. vv. 9,11). Mëkati është personifikuar si një operacion ushtarak (krh. v.11) i udhëhequr nga një udhëheqës ushtarak (krh. vv. 11 dhe 17; 6:12, 14, 16).

■ **“sepse pa Ligjin, mëkati është i vdekur”** Mëkati është rebelim ndaj vullnetit të Perëndisë (krh. Rom. 4:15; 5:13; I Kor. 15:56). Nuk ka FOLJE në këtë frazë; ajo duhet shtuar. Nëse shtojmë NJË FOLJE NË KOHËN E TASHME, nënkupton që ky është një parim universal. Nëse do të shtojmë një KOHË AORISTE, ajo i referohet jetës së Palit specifikisht.

7:9 **“Unë isha dikur igjallë”** Kjo mund t’i referohet Palit si (1) fëmijë gjatë moshës së pafajësisë (d.m.th., përpara *Bar Mitzvah*) ose (2) si Farise i përkushtuar përpara se e vërteta e ungjillit t’i hynte në zemër (krh. Vep 23:1; Fil. 3:6; II Tim. 1:3). E para paraqet “teorinë autobiografike” të interpretimit të kapitullit 7 dhe e dyta “teorinë përfaqësuese” të interpretimit të kapitullit 7.

■ **“kur erdhi urdhërimi, mëkati u ngjall dhe unë vdiqa”** Fryma rebeluese e njerëzimit fuqizohet nga ndalimet. “Mos-et” e Ligjit të Perëndisë nxitin krenarinë vetë-drejtuese të njerëzimit të rënë (krh. Zan. 2:16-17; 3:1-6). Vini re se si mëkati vazhdon të personifikohet, si në 5:21 dhe 7:8,11,17,20.

7:10 “urdhërimi, i cili duhej të rezultonte në jetë, doli se rezultoi në vdekje për mua” Kjo është ndoshta një referencë ndaj premtimit të Lev. 18:5; LiP 4:1; ose ndoshta Rom. 2:13. Ligji premtoi atë që nuk mund ta përmbushte, jo sepse ai është mëkatar, por sepse njerëzimi është i rënë dhe rebel. Ligji u bë dënim me vdekje (krh. Gal. 3:13; Efe. 2:15; Kol. 2:14).

7:11 “më mashtroi dhe përmes tij më vrau” Këto janë të dyja FOLJE AORISTE VEPRORE DËFTORE. Ky term, “mashtroi,” është përdorur për gjarprin që mashtroi Evën në Septuagintën (LXX) e Zan. 3:13. Pali e përdor këtë FOLJE disa herë (krh. Rom. 16:18; I Kor. 3:18; II Kor. 11:3; II Thes. 2:3; I Tim. 2:14). Problemi i Adamit dhe Evës ishte edhe lakmia (krh. II Kor. 11:3; I Tim. 2:14). Adami dhe Eva vdiqën shpirtërisht duke mos iu bindur urdhërimit të Perëndisë (tani të zbuluar në Ligj, krh. I Kor. 15:56), dhe po ashtu edhe Pali dhe po ashtu edhe të gjithë njerëzit (1:18-3:20).

7:12 Ky është pohimi i Palit për mirësinë e Ligjit. Ai nuk është problemi. Megjithatë, struktura paralele e Palit, që përdor “mëkat” në kapitullin 6 dhe “ligj” në kapitullin 7, duhet t’i ketë shqetësuar besimtarët legalistë hebrej (të dobët të 14:1-15:13) në kishën e Romës.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:13

¹³ Atëherë, ajo që është e mirë u bë *shkak* vdekjeje për mua? Kurrë mos qoftë! Përkundrazi ishte mëkati, me qëllim që ai të tregohej se ishte mëkat duke shkaktuar vdekjen time përmes asaj që është e mirë, në mënyrë që përmes urdhërimit mëkati të bëhej tërësisht mëkatar.

7:13

NASB “mëkati, me qëllim që ai të tregohej se ishte mëkat . . . mëkati të bëhej tërësisht mëkatar”
NKJV “mëkati, që ai të dukej mëkat. . . të mund të bëhej jashtëzakonisht mëkatar”
NRSV “që mëkati të mund të tregohej se është mëkat. . . mëkatar përtej masës”
TEV “me qëllim që natyra e tij e vërtetë si mëkat të mund të zbulohet”
NJB “mëkati, për ta treguar veten në ngjyrat e tij të vërteta. . . ishte në gjendje të ushtronte gjithë fuqinë e tij mëkatore”

Natyra e keqe e mëkatisht shihet qartë në faktin që ai mori diçka aq të mirë, aq të shëndetshme dhe aq të perëndishme si Ligji i Moisiut (krh. Ps. 19, 119) dhe e shtrembëroi në një instrument dënimi dhe vdekjeje (krh. Efe. 2:15; Kol. 2:14). Njerëzimi i rënë e ka çuar çdo dhuratë të mirë që Perëndia ka dhënë përtej kufijve që Perëndia ka caktuar!

Vini re dy fjalitë e varura me *hina* (qëllimore) të përkthyer “me qëllim që” dhe “në mënyrë që.” PARAFJALËT e qartësojnë qëllimin e autorit!

■ **“tërësisht mëkatar”** Shih Temën e Veçantë: Përdorimi nga ana e Palit e fjalëve të përbëra me *Huper* te 1:30. Mëkati personifikohet për të treguar natyrën personale të së keqes. Shih Temën e Veçantë: E keqja personale te 16:20.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:14-20

¹⁴ Sepse ne e dimë se Ligji është frymëror, por unë jam prej mishi, i shitur në skllavëri ndaj mëkatisht. ¹⁵ Sepse atë që bëj, nuk e kuptoj; sepse nuk po praktikoj atë që *do të doja të bëja*, por po bëj pikërisht gjënë që urrej. ¹⁶ Por nëse unë bëj pikërisht gjënë që nuk dua *të bëj*, unë bie dakord me Ligjin, *duke e rrëfyer se Ligji është i mirë*. ¹⁷ Pra tani, nuk jam më unë që e bëj, por mëkati që banon në mua. ¹⁸ Sepse unë e di se në mua nuk banon asgjë e mirë, domethënë, në mishin tim; sepse dëshira është e pranishme në mua, por bërja e të mirës jo. ¹⁹ Sepse të mirën që e dëshiroj, nuk e bëj, por praktikoj pikërisht të keqen që nuk e dëshiroj. ²⁰ Por nëse po bëj pikërisht gjënë që nuk e dëshiroj, nuk jam më unë që e bëj, por mëkati që banon në mua.

7:14 “Ligji është frymëror” Ligji i Perëndisë është i mirë. Nuk është ai problemi (krh. vv. 12 & 16b).

■ **“unë jam prej mishi”** Ky term përdoret nga Pali (1) në një kuptim neutral për trupin fizik (krh. 1:3; 2:28; 4:1; 9:3,5); dhe (2) në një kuptim negativ për natyrën e rënë të njerëzimit në Adamin (krh. v. 5). Është e paqartë se cili është kuptimi këtu.

■ **“i shitur në skllavëri ndaj mëkatit”** Kjo është një PJESORE PËSORE E KRYER që ka kuptimin “Unë kam qenë dhe vazhdoj të jem i shitur në skllavëri ndaj mëkatit.” Mëkati përsëri personifikohet, këtu si pronar skllavërisht. Agjenti i DIATEZËS PËSORE është i paqartë. Mund t’i referohet Satanit, mëkatit, Palit, ose Perëndisë.

Në DHV termi kryesor që përshkruan Perëndinë që tërheq njerëzimin përsëri te Vetja është “shpengoj” (dhe sinonimet e tij). Në origjinal kuptimi ishte “të riblesh” (dhe sinonimet e tij. Shih Temën e Veçantë në 3:24). Koncepti i kundërt është fraza e përdorur këtu, “shitur në duart e . . .” (krh. Gjyq. 4:2; 10:7; I Sam. 12:9).

7:15-24 Fëmija i Perëndisë ka “natyrën hyjnore” (krh. II Pjet. 1:4), por edhe natyrën e rënë (krh. Gal. 5:17). Nga ana potenciale, mëkati është bërë jofunksional (krh. Rom. 6:6), por eksperiencia njerëzore ndjek kapitullin 7. Hebrejtë thonë se në çdo njeri është një qen i bardhë dhe një qen i zi. Ai që e ushqen më shumë, bëhet më i madh.

Ndërsa lexoj këtë pasazh unë e ndiej literalisht dhimbjen e Palit ndërsa përshkruan konfliktin e përditshëm të dy natyrave tona. Besimtarët janë çliruar nga natyra e tyre e rënë, por, Perëndia na ndihmoftë, ne vazhdojmë t’i dorëzohemi joshjes së saj. Është shpesh e vërtetë për habi që beteja më intensive shpirtërore fillon pas shpëtimit. Pjekuria është një bashkësi e përditshme, e mbushur me tension, me Perëndinë Triun dhe një konflikt i përditshëm me të keqen (krh. 8:12-25,26; Gal. 5:16-18; Efe. 6:10-18; Kol. 3:5-10; shih J. D. G. Dunn, *Jesus and the Spirit*).

7:16,20 “nëse” Këto janë të dyja FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, që shikohen si të vërteta nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare.

7:18 “unë e di se në mua nuk banon asgjë e mirë, domethënë, në mishin tim” Pali nuk po thotë që trupi fizik është i keq, por që ai është fushëbeteja midis natyrës së rënë dhe Frymës së Perëndisë. Grekët thoshin se trupi, bashkë me gjithë materien, ishte i keq. Kjo u zhvillua në herezinë dualiste të Gnosticizmit (krh. Efesianëve, Kolosianëve dhe I Gjonit). Grekët prireshin të fajësonin “fiziken” për problemet shpirtërore. Pali nuk e shikon konfliktin shpirtëror në këto terma. Ai e personifikoi mëkatin dhe e përdori rebelimin e njerëzimit ndaj Ligjit të Perëndisë si mundësinë për pushtimin e natyrës njerëzore nga e keqja. Termi “mish” në shkrimet e Palit mund të ketë kuptimin (1) e trupit fizik që është moralisht neutral (krh. 1:3; 2:28; 4:1; 9:3,5) dhe (2) natyrës së rënë mëkatore të trashëguar nga Adami (krh. v. 5). Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarx*) te 1:3.

7:20 “mëkati që banon në mua” Është interesante që libri i Romakëve e tregon kaq qartë mëkatin e njerëzimit, por Satani nuk përmendet deri në 16:20. Njerëzit nuk mund t’ia hedhin fajin Satanit për problemin e tyre me mëkatin. Ne kemi një zgjedhje. Mëkati personifikohet si një mbret, tiran, pronar skllavërisht. Ai na tundon dhe na josh për pavarësi nga Perëndia, për ta treguar veten me çdo kusht. Personifikimi që i bën Pali mëkatit i lidhur me zgjedhjen njerëzore reflekton Zan. 4:7.

Pali e përdor termin “banon” disa herë në këtë kapitull (krh. vv. 17,18,20). Natyra mëkatore nuk shkatërrohet dhe as hiqet në momentin e shpëtimit, por bëhet potencialisht jofunksionale. Vazhdimësia e pafuqisë së saj varet nga bashkëpunimi ynë me Frymën brendabanues (krh. 8:9,11). Perëndia ka siguruar për besimtarët gjithçka që është e nevojshme për ta luftuar të keqen e personifikuar (letrare) dhe personale (Satanin dhe demoniken). Ajo është prania dhe fuqia e Frymës së Shenjtë. Ndërsa pranojmë dhuratën falas të shpëtimit nga Perëndia, ne gjithashtu duhet të pranojmë edhe dhuratën e Perëndisë që është Fryma e Shenjtë, i Cili është Ai që e lufton këtë të keqe në mënyrë efektive. Shpëtimi dhe jeta e krishterë janë një proces i përditshëm që fillon dhe mbaron me vendimet e përditshme të besimtarëve. Perëndia ka siguruar gjithçka që na nevojitet: Frymën (Romakëve 8), armatimin shpirtëror (Efe. 6:11), zbulesën (Efe. 6:17), dhe lutjen (Efe. 6:18).

Beteja është e ashpër (Romakëve 7), por beteja është fituar (Romakëve 8).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 7:21-25

²¹Shoh, pra, parimin që e keqja është e pranishme në mua, në mua që dua të bëj të mirën. ²²Sepse unë me gëzim bie dakord me ligjin e Perëndisë në njeriun e brendshëm, ²³por shoh një ligj tjetër në gjymtyrët e trupit tim, që lufton kundër ligjit të mendjes sime dhe që më bën rob të ligjit të mëkatit që është në gjymtyrët e mia. ²⁴O njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga trupi i kësaj vdekjeje? ²⁵Qoftë falenderuar Perëndia përmes Jezu Krishtit Zotit tonë! Kështu pra, nga njëra anë unë vetë me mendjen time po i shërbej ligjit të Perëndisë, por nga ana tjetër, me mishin tim ligjit të mëkatit.

7:22 “**ligjin e Perëndisë**” Për hebrenjtë kjo i referohej Ligjit të Moisiut. Për johebrenjtë kjo i referohej

1. dëshmisë së natyrës (krh. Rom. 1:19-20; Ps. 19:1-6)
2. ndërgjegjes së brendshme morale (krh. Rom. 2:14-15)
3. normave apo ligjeve shoqërore



NASB	“në njeriun e brendshëm”
NKJV	“sipas njeriut të brendshëm”
NRSV, NJB	“në brendësinë e vetes sime”
TEV	“qenia ime e brendshme”

Pali e kontraston njeriun e jashtëm (fizik) me njeriun e brendshëm (shpirtëror) te II Kor. 4:16. Në këtë kontekst fraza i referohet asaj pjese të Palit apo të njerëzimit të shpëtuar që e miraton vullnetin dhe ligjin e Perëndisë.

1. “ligji është frymëror,” 7:14
2. “atë që do të doja të bëja,” 7:15
3. “unë bie dakord me Ligjin, duke e rrëfyer se Ligji është i mirë,” 7:16
4. “dëshira është e pranishme në mua,” 7:18
5. “të mirën që e dëshiroj,” 7:19
6. “praktikoj pikërisht të keqen që nuk e dëshiroj,” 7:19
7. “po bëj pikërisht gjënë që nuk e dëshiroj,” 7:20
8. “në mua që dua të bëj të mirën,” 7:21
9. “me gëzim bie dakord me Ligjin e Perëndisë,” 7:22
10. “ligjit të mendjes sime,” 7:23
11. “unë vetë me mendjen time po i shërbej ligjit të Perëndisë,” 7:25

Kapitulli 7 tregon që njohuria e Perëndisë dhe e Fjalës së Tij nuk mjafton. Besimtarët kanë nevojë për Frymën (kapitulli 8)!

7:23 Ka një kontrast të vërtetë mes 6:2; 8:2 dhe 7:23. Ky varg tregon qartë përdorimin nga ana e Palit të fjalës “ligj” (*nomos*) për t’iu referuar (1) ligjit të mëkatit (krh. vv. 21,25) dhe (2) ligjit të Perëndisë (krh. vv. 22, 25). Më herët në vv. 4,5,6,7,9 dhe 12 Pali e përdor termin për t’iu referuar DHV. Pali nuk ishte teolog sistematik. Ai kishte vështirësi me konceptin e “ligjit.” Në një kuptim ai ishte zbulesa e Perëndisë, një dhuratë e mrekullueshme ndaj njerëzimit, por nga ana tjetër ai ishte ai që e përkufizoi mëkatit dhe caktoi qartë kufij që njerëzimi i rënë nuk ishte në gjendje t’i mbante. Këta kufij nuk ishin vetëm zbulesa e DHV (krh. Ps. 19:7-14; 119, por të gjitha udhëzimet morale: zbulesa natyrore (krh. Ps. 19:1-6; Rom. 1:18-3:31) ose normat dhe ligjet shoqërore. Njerëzit janë rebelë që duan të jenë në kontroll të plotë të jetëve të tyre!

7:24 A mund të jetë kjo një deklaratë nga një person i shpëtuar? Disa thonë jo, dhe prandaj, ky kapitull për ta i referohet personave të moralshëm, fetarë, por të pashpenguar. Të tjerë thonë po, që ai i referohet tensionit të ungjillit, “po vjen, madje ka ardhur” në jetën e besimtarëve. Plotësimi eskatologjik nuk është manifestuar akoma. Besimtari i pjekur e ndjen më shumë këtë mospërputhje.



NASB	“trupi i kësaj vdekjeje”
NKJV, NRSV	“ky trup i vdekjes”

Trupi fizik dhe mendja nuk janë të këqij në vetvete. Ata u krijuan nga Perëndia për jetë në këtë planet dhe për bashkësi me Të. Ata u krijuan “shumë të mirë” (krh. Zan. 1:31). Por, Zanafilla 3 e ndryshoi njerëzimin dhe planetin. Kjo nuk është bota që Perëndia donte të ishte dhe ne nuk jemi njerëzit që Perëndia donte të ishim. Mëkati e ka ndikuar në mënyrë rrënjësore krijimin. Mëkati ka marrë atë që ishte e mirë dhe e ka shtrembëruar në të keqe të përqendruar te vetja. Trupi dhe mendja janë bërë fushëbeteja e tundimit dhe mëkatit. Pali e ndjen shumë këtë betejë! Ai ka mall për epokën e re, për trupin e ri, për bashkësinë me Perëndinë (krh. 8:23).

7:25 Kjo është një përmbledhje dhe një një tranzicion për në sipërfaqen më të lartë të Romakëve 8. Megjithatë, edhe në kapitullin 8 i njëjti tension shihet në vv. 5-11.

Pyetja për interpretuesit rrotullohet rreth çështjes se për kë po flet Pali?

1. për veten dhe për eksperiencën e tij brenda Judaizmit
2. për gjithë të krishterët
3. për Adamin si shembull i qenieve njerëzore
4. për Izraelin dhe njohurinë që ai kishte për Ligjin, por mosbindjen ndaj tij

Personalisht, unë kombinoj #1 (vv. 7-13,25b) dhe #2 (vv. 14-25a). Shih Të Dhëna Kontekstuale për Rom. 7:7-25. Dhimbja dhe agonia e kapitullit 7 kompensohet dhe tejkalohet nga madhështia e kapitullit 8!

■ “Qoftë falenderuar Perëndia” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: LAVDËRIMI, LUTJA DHE FALENDERIMI I PALIT NDAJ PERËNDISË

Pali ishte një njeri i lavdërimit. Ai e njihte Dhiatën e Vjetër. Secila nga katër ndarjet (d.m.th., librat) e Psalmeve përfundon me doksologji (krh. Ps. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48). Ai e lavdëron dhe e lartëson Perëndinë në disa mënyra të ndryshme.

1. Paragrafët e hyrjes në letrat e tij
 - a. bekimet apo përshëndetjet e hyrjes (krh. Rom. 1:7; I Kor. 1:3; II Kor. 1:2)
 - b. bekimet e hyrjes (*eulogētos*, krh. II Kor. 1:3-4; Efe. 1:3-14)
2. shpërthime të shkurtra lavdërimi
 - a. Rom. 1:25; 9:5
 - b. II Kor. 11:31
3. doksologji (të karakterizuara nga përdorimi i [1] *doxa* {d.m.th., lavdi} dhe [2] “në përjetësi/përjetë”)
 - a. Rom. 11:36; 16:25-27
 - b. Efe. 3:20-21
 - c. Fil. 4:20
 - d. I Tim. 1:17
 - e. II Tim. 4:18
4. falenderime (d.m.th., *eucharisteō*)
 - a. hyrje të letrave (krh. Rom. 1:8; I Kor. 1:4; II Kor. 1:11; Efe. 1:16; Fil. 1:3; Kol. 1:3,12; I Thes. 1:2; II Thes. 1:3; Filemon v. 4; I Tim. 1:12; II Tim. 1:3)
 - b. thirrje për falenderim (krh. Efe. 5:4,20; Fil. 4:6; Kol. 3:15,17; 4:2; I Thes. 5:18)
5. shpërthime të shkurtra falenderimi
 - a. Rom. 6:17; 7:25
 - b. I Kor. 15:57
 - c. II Kor. 2:14; 8:16; 9:15
 - d. I Thes. 2:13
 - e. II Thes. 2:13
6. bekime të mbylljes
 - a. Rom. 16:20,24(?)
 - b. I Kor. 16:23-24

- c. II Kor. 13:14
- d. Gal. 6:18
- e. Efe. 6:24

Pali e njihte Perëndinë Triun teologjikisht dhe nga përvoja. Në shkrimet e tij ai e fillon me lutje dhe me lavdërim. Në mes të prezantimeve të tij ai shpërthen në lavdërim dhe falenderim. Në mbyllje të letrave të tij, ai gjithmonë kujtohet të lutet, të lavdërojë dhe të falenderojë Perëndinë. Shkrimet e Palit janë plot me lutje, lavdërime dhe falenderime. Ai e njihte Perëndinë, e njihte veten dhe e njihte ungjillin.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si lidhet kapitulli 6 me kapitullin 7?
2. Cila është marrëdhënia e ligjit të Dhiatës së Vjetër me besimtarët e Dhiatës së Re? (krh. II Kor. 3:1-11; Heb. 8:7, 13)
3. Cilat janë ato dy ilustrime që përdor Pali në kapitujt 6 dhe 7 për të përshkruar marrëdhënien tonë me jetën tonë të vjetër?
4. Si lidhet i krishteri me Ligjin e Moisiut?
5. Shpjegoni me fjalët tuaja dallimin midis teorive autobiografike dhe përfaqësuese të interpretimit të Romakëve 7:7-25.
6. A është Romakëve 7 përshkrimi i një personi të humbur, një besimtari të papjekur apo i të gjithë besimtarëve?

ROMAKËVE 8

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jetë në Frymë	Të çliruar nga mëkati brendabanues	Akti shpëtues i Perëndisë	Jetë në Frymën	Jeta e Frymës
8:1-11	8:1-11	8:1-4	8:1-8	8:1-11
		Jeta në Mish dhe në Frymë		
		8:5-8		
		8:9-11	8:9-11	
		Fryma dhe Birësimi		
8:12-17	8:12-17	8:12-17	8:12-17	8:12-13
				Fëmijë të Perëndisë
				8:14-17
Lavdia që do të jetë	Nga vuajtja në lavdi	Shpresa e plotësimit	Lavdia e ardhshme	Lavdia si fati ynë
8:18-25	8:18-30	8:18-25	8:18-25	8:18-25
		Ndihmë në dobësitë njerëzore		
8:26-30		8:26-27	8:26-27	8:26-27
				Perëndia na ka thirrur të marrim pjesë në lavdinë e Tij
		8:28-30	8:28-30	8:28-30
Dashuria e Perëndisë	Dashuria e përjetshme e Perëndisë	Siguria jonë në dashurinë e Perëndisë	Dashuria e Perëndisë në Krishtin Jezus	Një himn për dashurinë e Perëndisë
8:31-39	8:31-39	8:31-39	8:31-39	8:31-39

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

1.Paragrafi i parë

2.Paragrafi i dytë

3.Paragrafi i tretë

4. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Ky kapitull është kulmi i argumentit të Palit të filluar në 1:18. Ai fillon me “asnjë dënim” (pozicioni ligjor) dhe përfundon me “asgjë nuk do të na ndajë” (bashkësia personale). Teologjikisht, ai kalon nga shfajësimi, përmes shenjtërimit në përlëvdim (krh. vv. 29-30).
- B. Ky është zhvillimi teologjik i argumentit të Palit mbi faktin që Perëndia u jep Frymën e Tij besimtarëve (krh. prezantimin e Gjonit të Gjonit 14:12-31; 16:7-16). Fryma është agjenti i FOLJES NË PËSORE të v. 14 që lidhet me bërjen aktiv të ungjillit në jetët e njerëzve të rënë. Fryma qëndron me ta dhe në ta dhe fillon të formojë Krishtin në ta. Kapitulli 8 përdor termin frymë, *pneuma*, mbi 21 herë, ndërkohë që në kapitullin 7 ai mungon fare (po ashtu edhe në kapitujt 3-6 dhe del vetëm tri herë në kapitujt 1-2; është e vështirë të jesh i sigurt se kur *pneuma* i referohet frymës njerëzore dhe kur Frymës së Shenjtë).
- C. Në jetë ka dy këndvështrime (botëkuptime personale), dy mënyra jetese, dy përparësi, dy rrugë (rruga e gjerë dhe rruga e ngushtë) që njerëzit ndjekin, këtu mishin ose Frymën. Njëri çon në vdekje, tjetri në jetë. Kjo tradicionalisht është quajtur “dy rrugët” e letërsisë së DHV (krh. Ps. 1 dhe Fja. 4:10-19). Jeta e përrjetshme, jeta e Frymës, ka karakteristika të vëzhgueshme (d.m.th., sipas mishit përkundër sipas Frymës).
Vini re mungesën që bie në sy të Satanit në gjithë këtë kontekst teologjik (krh. Romakëve 1-8). Ai nuk përmendet te Romakëve deri në 16:20. Në fokus është natyra e rënë Adamike e njerëzimit. Kjo ishte mënyra e Palit për të hequr nga rruga justifikimin e njerëzimit (d.m.th., “Djali më detyroi ta bëja!”) për tundim mbinatyror për rebelimin e tyre kundër Perëndisë. Njerëzimi është përgjegjës!
- D. Ky kapitull është shumë i vështirë për t’u përvijuar, sepse mendimi zhvillohet duke endur së bashku disa fije të vërtete në modele të përsëritura, por pa njësi kontekstuale.
- E. Vargjet 12-17 e informojnë besimtarin për një siguri të patundur besimi
1. E para është një botëkuptim dhe një mënyrë jetese e ndryshuar që është arritur përmes Frymës.
 2. E dyta është që frika jonë nga Perëndia është zëvendësuar me një ndjesi dashurie familjare nga Fryma.
 3. E treta është një konfirmim i brendshëm i birërisë sonë nga Fryma i Shenjtë brendabanues.
 4. E katërta është që ky konfirmim është edhe më i sigurt në mes të problemeve dhe vështirësive të kësaj bote të rënë.
- F. Vargjet 31-39 janë një skenë gjyqi, që është një teknikë letrare tipike e profetëve të DHV. Perëndia është Gjykatësi; Satani është akuzuesi; Jezusi është avokati mbrojtës (parakleti); engjëjt janë spektatorët dhe njerëzimi që beson është nën akuzimet e Satanit (krh. Jobi 1-2; Zakaria 3).
1. terma ligjorë
 - a. kundër nesh (v. 31)
 - b. akuzë (v. 33)
 - c. shfajëson (v. 33)
 - d. dënon (v. 34)
 - e. ndërmjetëson (v. 34)
 2. pala e akuzës, “kush” (vv. 31,33,34 [tri herë],35)
 3. sigurimi i Perëndisë në Krishtin (vv. 32, 34b)
 4. asnjë ndarje nga Perëndia
 - a. rrethana tokësore (v. 35)

- b. citim i DHV nga Ps. 44:22 (v. 36)
- c. fitore (vv. 37,39)
- d. rrethana apo agjentë mbinatyrorë (vv. 37-39)

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:1-8

¹Prandaj nuk ka tani asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus. ²Sepse ligji i Frymës i jetës në Krishtin Jezus të ka çliruar nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes. ³Sepse atë që Ligji nuk mund ta bënte, i dobët siç ishte përmes mishit, e bëri Perëndia: duke dërguar Birin e Vet në ngjashmërinë e mishit mëkatar dhe si një ofrim për mëkatin, Ai e dënoi mëkatin në mish, ⁴ në mënyrë që kërkesa e Ligjit të mund të përmbushet në ne, që nuk ecim sipas mishit, por sipas Frymës. ⁵Sepse ata që janë sipas mishit e vendosin mendjen në gjërat e mishit, por ata që janë sipas Frymës, në gjërat e Frymës. ⁶Sepse mendja e vendosur në mish është vdekje, por mendja e vendosur në Frymën është jetë dhe paqe, ⁷sepse mendja e vendosur në mish është armiqësore ndaj Perëndisë; sepse ajo nuk ia nënshtron veten ligjit të Perëndisë, sepse as nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ⁸ dhe ata që janë në mish nuk mund ta kënaqin Perëndinë.

8:1

NASB	“Prandaj nuk ka tani”
NKJV, NRSV	“nuk ka pra tani”
TEV	“Nuk ka”
NJB	“prandaj, arsyeja”

Kjo lidhet me kontekstin e mëparshëm. Disa mendojnë se lidhet me 7:24-25 por duket më mirë ta çojmë deri te 3:21-7:25.

▣ **“asnjë”** “Asnjë” është e para në fjalinë në greqisht. Është e theksuar, “asnjë dënim” për ata në Krishtin (krh. vv. 1-3), dhe ata që ecin sipas Frymës (krh. vv. 4-11). Këtu janë të dyja anët e besëlidhjes së re.

1. është një dhuratë falas në Krishtin

2. kërkohet një mënyrë jetese e caktuar, një përgjigje ndaj besëlidhjes

Shfajësimi (krh. 5:1-11) është edhe objektiv (DËFTORE) edhe subjektiv (URDHËRORE). Është edhe gjendje, edhe mënyrë jetese.

▣ **“dënim”** Ky term *katakrima* nuk përdoret shpesh në Septuagintë, por reflekton mallkimin e mosbindjes te LiP 27:26 (krh. LiP 27:26 i cituar te Gal. 3:10 ku ai është i barabartë me “mallkimin”). Kjo do të thotë “ndëshkim që pason një verdikt gjyqësor.” Është e kundërta ligjore e shfajësimit. Është një term i rrallë në shkrimet e Palit (krh. 5:16,18) dhe nuk është përdorur asgjekundi tjetër në DHR.

Koncepti i dënimit së pari del në skenën kur Satani akuzon popullin e Perëndisë për shkelje të besëlidhjes dhe më vonë joizraelitë si Jobi (krh. Job 1-2). Por tani besimtarët kanë vdekur me Krishtin ndaj ligjit (krh. Romakëve 6) dhe, prandaj, as ligji, as Satani nuk kanë baza për akuza.

The King James Version (Versioni i Mbretit Xhejms) shton te vargu 1, “që nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës.” Kjo frazë nuk del në shumë dorëshkrime të lashta në greqisht në vargun 1. UBS⁴ i jep heqjes së tij një vlerësim “A” (i sigurt). Por ai gjendet në v. 4. Është krejt e papërshtatshme nga ana teologjike në v. 1, por përputhet në mënyrë të përsosur në v. 4. Vargjet 1-3 trajtojnë shenjtërimin pozicional (DËFTORE), kurse vargjet 4-11 trajtojnë shenjtërimin e përjetuar (shih Special Topic at 6:4) ose ndryshe, ngjashmërinë me Krishtin (URDHËRORE, shih shënimin te 8:29). Vini re shënimin në fund të faqes në faqen 289 në *Romans Verse by Verse* të William R. Newell. (Moody, 1938).

“The Revised Version (Versioni i Rishikuar) me të drejtë e lë jashtë “që nuk ecin sipas mishit, por sipas Frymës.” Qysh nga përkthimi i King James, më shumë se 300 vjet më parë, janë zbuluar shumë dorëshkrime në greqisht që janë më të mirat dhe më të saktat që kemi; dhe njerëz të perëndishëm e të zellshëm i janë futur me këmbëngulje punës së lodhshme, por të frytshme të ndreqjes së gabimeve që kanë hyrë në procesin e kopjimit. Sepse, siç e dimë të gjithë, ne nuk kemi dorëshkrimet origjinale të Shkrimeve: Perëndisë i ka pëlqyer t’ua mohojë ato krijesave kaq të prirura ndaj idhujtarisë siç janë bijtë e njerëzve.

Ne duhet ta mbyllim vargun 1 me fjalët “në Krishtin Jezus,” për katër arsye: (1) Dëshmia e dorëshkrimeve në greqisht është me shumicë në favor të heqjes së pjesës “që nuk ecin sipas mishit, por

sipas Frymës” nga vargu 1,—ashtu siç është e plotë për përfshirjen e këtyre fjalëve në vargun 4, (2) Dallimi frymëror gjithashtu bie dakord, sepse prezantimi i këtyre fjalëve në vargun 1 bën të duket sikur siguria jonë varet nga ecja jonë, dhe jo nga Fryma e Perëndisë. Por të gjithë që janë në Krishtin Jezus janë të çliruar nga dënimi, siç mësohet qartë në të gjitha letrat. Përndryshe, siguria jonë varet nga ecja jonë dhe jo nga pozicioni ynë në Krishtin. (3) Kjo pjesë është e qartë që është në vendin e duhur në fundin e vargut 4,—ku përshkruhet mënyra e ecjes së besimtarit, jo siguria e tij nga dënimi. (4) Që pjesa në fund të vargut 1 në King James është një *gloss* (shënim anësor nga ndonjë kopist) duket, jo vetëm nga mungesa e saj në dorëshkrimet e mëdha uncialle, Aleph, A, B, C, D, F, G; A, D (corr.); si edhe në disa dorëshkrime korsive dhe në disa versione të mira të lashta (shih Olshausen, Meyer, Alford, J. F. dhe B., dhe diskutimin e shkëlqyer të Darby-t në *Synopsis in loc*); por gjithashtu duket edhe nga ngjashmëria e kësaj gloss-e në shtesa të ngjashme të bëra nga frika e ligjit, që gjenden në pasazhe të tjera. Që Perëndia zgjodhi që Fjala e Tij të përkthehej dhe ende të ishte autoritative duket nga përdorimi në Dhiatën e Re të përkthimit grek të Dhiatës së Vjetër, Septuagintës.

Ne duhet ta falenderojmë Perëndinë për ata njerëz të përkushtuar që kanë kaluar një jetë të tërë në studimin e thellë të dorëshkrimeve që na ka lënë Perëndia, dhe që na kanë dhënë këtë përkthim kaq mrekullisht të përsosur që kemi. Ne duhet t’i dallojmë studiues të tillë absolutisht dhe përgjithmonë nga “Modernistët” arrogantë (ose, siç quheshin më parë, “Kritikët Më Të Lartë”), të cilët marrin përsipër ta na thonë se çfarë *duhet* të thotë Perëndia në Bibël, në vend që me përulesë të thellë të kërkojnë të kuptojnë se çfarë na *ka* thënë Perëndia” (fq. 289).

■ **“për ata që janë në Krishtin Jezus”** Kjo frazë karakteristike (d.m.th., një VENDORE E SFERËS) e Palit është e barazvlefshme me shprehjen e sotme “marrëdhënie personale.” Pali e njihte, e donte, i shërbente dhe gëzohej në Jezusin. Ungjilli është edhe një mesazh për t’u besuar, dhe një Person për t’u mirëpritur. Fuqia për të jetuar rridhte nga marrëdhënia e tij me Krishtin e Ringjallur, të Cilin ai e takoi në Rrugën e Damaskut (krh. Veprat 9). Përjetimi i tij me Jezusin i parapriu teologjisë së tij të Jezusit. Përjetimi i tji rrodhi jo në një misticizëm të mbyllur, por në shërbim misionar të palodhur (krh. Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8). Ta njohësh Atë do të thotë t’i shërbesh Atij. Krishtërimi i pjekur është një mesazh, një Person, dhe një mënyrë jetese! (Shih shënimin në 1:5)

8:2 “ligji i Frymës i jetës. . . ligji i mëkatit dhe i vdekjes” Kjo mund t’i referohet

1. kontrastit midis ligjit të mëkatit (krh. Rom. 7:10,23,25) dhe ligjit të ri të Perëndisë (krh. Rom. 7:6,22,25)
2. “ligjit të dashurisë” (krh. Jakobi 1:25; 2:8,12) përkundër “Ligjit të Moisiut” (krh. 7:6-12)
3. epokës së vjetër përkundër epokës së re
4. besëlidhjes së vjetër përkundër besëlidhjes së re (krh. Jer. 31:31-34; libri i Hebrenjve në DHR)

Ky stil kontrastues ruhet.

1. Ligji i Frymës i jetës në Krishtin përkundër ligjit të mëkatit dhe vdekjes, v. 2
2. sipas mishit përkundër sipas Frymës, vv. 4 & 5
3. gjërat e mishit përkundër gjërave të Frymës, v. 5
4. mendja e vendosur në gjërat e mishit përkundër mendja e vendosur në gjërat e Frymës, v. 55.
5. mendja e vendosur në mish, përkundër mendja e vendosur në Frymë, v. 6
6. në mish përkundër në Frymë, v. 9
7. trupi është i vdekur përkundër Fryma është e gjallë, v. 10
8. duhet të vdisni përkundër do të jetoni, v. 13
9. jo frymën e skllavërisë përkundër frymën e birësimit, v. 15

The NASB Study Bible (Bibla e Studimit NASB) (fq. 1645) ka një listë interesante të përdorimit nga ana e Palit të termit “ligj” në Romakëve.

1. një fuqi kontrolluese, 8:2
2. ligji i Perëndisë, 2:17-20; 9:31; 10:3-5
3. Pentatuku, 3:21b
4. gjithë DHV, 3:19
5. një princip, 3:27

■

NASB, NRSV,
NJB
NKJV, TEV

“të ka çliruar”
“më kishte çliruar”

Vargjet 2-3 janë mesazhi teologjik i kapitullit 6. Ka disa PËREMRA të ndryshëm që dalin në tekstet në greqisht

1. “më” del në dorëshkrimet A, D, K & P
2. “të” del në κ, B, F & G
3. “na” del më vonë në një dorëshkrim uncial, Ψ

Hartuesit e UBS⁴ i japin “të” (NJËJËS) një vlerësim “B” (pothuaj i sigurt). UBS³ i dha një vlerësim “D” (vështirësi e madhe).

Variantet e dorëshkrimeve të lidhura me PËREMRA “neve,” “ty” ose “mua/ne” gjenden shpesh në shkrimet e Palit.

8:3 “atë që ligji nuk mund ta bënte” Ligji i Moisiut është i mirë dhe i shenjtë, por njerëzimi është i dobët dhe mëkatar (krh. 7:12, 16). FOLJA këtu është në të vërtetë MBIEMRI *adunaton*, i cili zakonisht ka kuptimin “i pamundur” (krh. Mat. 19:26; Heb. 6:4,18; 10:4; 11:6), por mund të ketë kuptimin “pa forcë” (krh. Veprat 14:8; Rom. 15:1). Ligji ishte i paaftë për të sjellë çlirim (krh. Gal. 3:21). Përkundrazi, ai solli vetëm dënim, vdekje dhe mallkim (krh. Galatasve 3)!

▣ **“i dobët siç ishte përmes mishit”** Ky është argumenti bazë i Palit i kapitullit 7. Ligji i Perëndisë është i mirë dhe i shenjtë, por njerëzimi mëkatar, i rënë dhe rebel nuk mund t’i mbajë kërkesat e tij. Pali, ndryshe nga rabinët, theksoi pasojat e Zanafillës 3. Shumica e rabinëve ia atribuojnë hyrjen e së keqes në botë Zanafillës 6.

▣ **“e bëri Perëndia: duke dërguar Birin e Vet”** Atë që njerëzimi i rënë nuk mund ta bënte nën Besëlidhjen e Vjetër, Perëndia e bëri nën Besëlidhjen e Re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-36) përmes Jezusit (krh. Isa. 53; Gjoni 3:16). Në vend të kërkesave të jashtme, Perëndia siguroi një Frymë të brendshëm dhe një zemër dhe një mendje të re. Kjo Besëlidhje e Re bazohet në pendimin dhe besimin në veprën e përfunduar të Krishtit, jo në performancën njerëzore (krh. Efe. 2:8-9). Megjithatë, të dyja besëlidhjet kërkojnë një mënyrë jetese të re të perëndishme (krh. Efe. 1:4; 2:10).

▣ **“në ngjashmërinë e mishit mëkatar”** E njëjta e vërtetë pohohet te Fil. 2:7-8. Jezusi kishte një trup të vërtetë njerëzor (por jo natyrë mëkatore, krh. Fil. 2:7-8; Heb. 7:26). Ai është vërtet një me ne. Ai u tundua në të gjitha mënyrat si ne, por pa mëkat (krh. Heb. 4:15). Ai na kupton. Ai ndërhyr/ndërmjetëson për ne (krh. 8:34; Heb. 7:25; 9:24).

▣ **“si një ofrim për mëkatin”** Fjalët me shkronja të pjerrëta nënkuptohen në NJB dhe në shënimin në fund të faqes të NRSV. Po i njëjti koncept pohohet te II Kor. 5:21 dhe I Pjet. 2:24. Jezusi erdhi për të vdekur (krh. Isa. 53:4-6,10-12; Marku 10:45). Jeta e pafajshme e Jezusit u bë një ofertë për mëkat (krh. Gjoni 1:29) për të gjithë njerëzimin (krh. Heb. 10:6,8; 13:11).

▣ **“Ai e dënoi mëkatin në mish”** Vdekja fizike e Jezusit vuri në dukje dhe zgjidhi problemin e natyrës mëkatore të njerëzimit, jo thjesht të akteve individuale të mëkatit (siç bënte Ligji i Moisiut). Ishte jeta, vdekja, ringjallja dhe ngjitja e Tij në qiell që përmbushën qëllimin e përjetshëm shpengues të Perëndisë (krh. Vep 2:23; 3:18; 4:28; 13:29). Ai gjithashtu na tregoi sesi mund dhe duhet të jenë njerëzit (krh. Gjoni 13:15; I Pjet. 2:21).

8:4 Ky varg ndoshta i referohet Besëlidhjes së Re (krh. Jer. 31:33 & Ezek. 36:26-27). Ai trajton dy aspekte të shpëtimit tonë.

1. Jezusi përmbushi kërkesat e Besëlidhjes së Vjetër dhe, përmes besimit në Të, kjo drejtësi u jepet besimtarëve si një dhuratë falas pa meritë personale. Ne e quajmë këtë shfaqësim ose shenjtërim pozicional.
2. Perëndia u jep besimtarëve një zemër të re, një mendje të re dhe një frymë të re. Ne ecim tani në Frymë, jo në mish. Ky quhet “shenjtërim progresiv.”

Krishërimi është një besëlidhje e re e cila ka edhe të drejta, (dhuratën e shpëtimit) edhe përgjegjësi (ngjashmërinë me Krishtin, krh. 6:13).

Jerome Bible Commentary (fq. 315) bën komentin interesant gramatikor që PJESORJA E TASHME plus PJESËZËN MË tregon një deklaratë të kushtëzuar duke nënkuptuar që një jetë e krishterë efektive nuk rrjedh

automatikisht nga pagëzimi. Ne si njerëz kemi një zgjedhje në shpëtim dhe një zgjedhje në ngjashmërinë me Krishtin! Fryma udhëheq dhe inkurajon, por nuk e detyron bindjen!

▣ **“që nuk ecim sipas mishit, por sipas Frymës”** I njëjti kontrast gjendet te Gal. 5:16-25. Drejtësia juridike duhet të shoqërohet nga një drejtësi si mënyrë jetese. Zemra dhe jeta e re e Besëlidhjes së Re nuk është baza e shpëtimit tonë, por rezultati i tij. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme (Mateu 7)!

8:5 Pali e vë në kontrast jetën në “mish” dhe në “Frymë” në vv. 5-8 (“veprat e mishit,” krh. Gal. 5:19-21 me “frytin e Frymës,” krh. 5:22-25). Shih shënimin e plotë në 8:2.

8:6 “mendja e vendosur në” Hebrejët e kuptonin se sytë dhe veshët janë dritaret e shpirtit. Mëkati fillon në mendime. Ne bëhemi si ajo për të cilën mendojmë më shumë (krh. Rom. 12:1-2; Fil. 4:8)!

Pali nuk e ndoqi saktësisht pikëpamjen tradicionale rabinike të dy “qëllimeve” (*yetzer-ëve*) te njerëzit. Për Palin qëllimi i mirë nuk ishte i pranishëm në krijesën e rënë, por vinte me kthimin në besim. Për Palin është Fryma i Shenjtë brendabanues që e fillon konfliktin e brendshëm frymëror (krh. Gjoni 16:7-14).

▣ **“jetë”** Kjo (*zoē*) i referohet jetës së përjetshme, jetës së epokës së re.

▣ **“paqe”** Ky term fillimisht kishte kuptimin “të lidhësh atë që është e këputur” (krh. Gjoni 14:27; 16:33; Fil. 4:7). Shih Temën e Veçantë: Paqe në 5:1. DHR flet për paqen në tri mënyra:

1. e vërteta objektive e paqes sonë me Perëndinë përmes Krishtit (krh. Kol. 1:20)
2. ndjenja jonë subjektive që jemi në rregull me Perëndinë (krh. Gjoni 14:27; 16:33; Fil. 4:7)
3. Perëndia, që i bashkon në një trup të ri, përmes Krishtit, hebrenjtë dhe johebrejët (krh. Efe. 2:14-17; Kol. 3:15)

8:7-11 Pali e përshkroi njerëzimin e ndarë nga Perëndia në disa mënyra.

1. armiqësor ndaj Perëndisë, v. 7
 2. i panënshtuar ndaj Perëndisë, v. 7
 3. i paaftë për t’i pëlqyer Perëndisë, v. 8
 4. i vdekur shpirtërisht që do të rezultojë në vdekje të përjetshme, vv.10-11
- Shih paralelin te Rom. 5:6, 8, dhe 10.

8:7

NASB, NRSV

“mendja e vendosur në mish është armiqësore ndaj Perëndisë”

NKJV

“mendja mishore është armiqësi kundër Perëndisë”

TEV

“njerëzit bëhen armiq të Perëndisë”

NJB

“këndvështrimi i natyrës së çrregulluar njerëzore është në kundërshtim me Perëndinë”

Vini re që kjo frazë është paralele me “mendja e vendosur në mish është vdekje” të v. 6 dhe “ata që ecin sipas mishit” të v. 5. Vini re, gjithashtu, që natyra e rënë njerëzore është edhe një mentalitet (botëkuptim), edhe një mënyrë jetese (krh. 7:5). Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarx*) te 1:3.

▣ **“sepse as nuk është në gjendje ta bëjë këtë,”** Njerëzimi i rënë jo vetëm që nuk zgjedh ta ndjekë Perëndinë, por ai nuk është as i aftë ta ndjekë Perëndinë. Njerëzimi i rënë, pa ndihmën e Frymës së Shenjtë, nuk mund t’iu përgjigjet gjërave frymërore (krh. Isa. 53:6; I Pjet. 2:24-25). Perëndia duhet ta marrë gjithnjë iniciativën (krh. Gjoni 6:44,65). Kjo nuk i përjashton zgjedhjet e besëlidhjes, por pohon qartë se njerëzit janë ata që përgjigjen, jo iniciatorët.

8:8 “ata që janë në mish” Pali e përdor këtë frazë në dy mënyra.

1. trupi fizik (krh. Rom.1:3; 2:28; 4:1; 9:3,5)
2. përpjekjet e njerëzimit pa Perëndinë (krh. Rom. 7:5; 8:4-5)

Këtu është #2. I referohet njerëzimit rebel, jobesimtar. Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarx*) te 1:3

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:9-11

⁹Megjithatë, ju nuk jeni në mish, por në Frymë, nëse vërtet Fryma i Perëndisë banon në ju. Por nëse dikush nuk e ka Frymën e Krishtit, ai nuk i përket Atij. ¹⁰Nëse Krishti është në ju, megjithëse trupi është i vdekur për shkak të mëkatit, përsëri fryma është e gjallë për shkak të drejtësisë. ¹¹Por nëse Fryma i Atij që e ngjalli Jezusin nga të vdekurit banon në ju, Ai që e ngjalli Krishtin Jezus nga të vdekurit edhe do t'ju japë jetë trupave tuaj të vdekshëm përmes Frymës së Tij që banon në ju.

8:9 “nëse” Ka një seri me FJALI KUSHTORE në vv. 9,10,11,13 (dy herë),17 (dy herë). Ato janë të gjitha FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, që supozohen të vërteta nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Pali po supozonte se lexuesit e tij në kishën e Romës ishin të krishterë (krh. v. 9a).

☐ **“Fryma e Krishtit”** Personat ose e kanë Frymën dhe janë besimtarë, ose nuk e kanë Frymën dhe janë të humbur frymërisht. Ne e marrim të gjithë Frymën e Shenjtë në momentin e shpëtimit. Ne nuk kemi nevojë për më shumë Frymë; Ai ka nevojë për më shumë ne!

Frazat “Fryma” e 9a; “Fryma e Perëndisë” e 9b, dhe “Fryma e Krishtit” e 9c janë të gjitha sinonime.

TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA

Ekziston një rrjedhshmëri mes veprës së Frymës dhe asaj të Birit. G. Campbell Morgan tha se emri më i mirë për Frymën është “Jezusi tjetër” (sidoqoftë, ata janë persona të veçantë e të përvetshëm). Më poshtë vijon skica e krahasimit të veprës dhe titujve të Frymës dhe të Birit.

1. Fryma quhet “Fryma e Jezusit”, ose me shprehje të ngjashme (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11).
2. Të dy thirren me të njëjtat fjalë
 - a. “e vërteta”
 - 1) Jezusi (Gjoni 14:6)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:17; 16:13)
 - b. “avokati”
 - 1) Jezusi (1 Gjonit 2:1)
 - 2) Fryma (Gjoni 14:16, 26; 15:26; 16:7)
 - c. “I Shenjtë”
 - 1) Jezusi (Marku 1:24; Luka 1:35; Veprat 3:14; 4:27, 30)
 - 2) Fryma (Luka 1:35; 4:34)
3. Të dy brendabanojnë besimtarët
 - a. Jezusi (Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
 - b. Fryma (Gjoni 14:16-17; Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
 - c. Ati (Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)

8:10 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË (ei me një FOLJE NË DËFTORE “jam” të supozuar). Pali e merr të mirëqenë që lexuesit e tij (d.m.th. kisha në Romë) janë

1. të brendabanuar nga Krishti
2. kanë Krishtin në mesin e tyre

☐ **“Krishti është në ju”** “ju” është SHUMËS. Termi “Krishti” i referohet Birit/Frymës brendabanues (krh. Gjoni 14:16-17; Kol. 1:27). Njerëzit kanë Birin/Frymën ose përndryshe nuk janë të krishterë (krh. I Gjoni 5:12). Për Palin, “në Krishtin” është teologjikisht e njëjtë si “në Frymën.”

☐ **“megjithëse trupi është i vdekur për shkak të mëkatit”** Edhe të krishterët do të vdesin fizikisht për shkak të mëkatit të Adamit, një bote të rënë dhe rebelimit personal (krh. 5:12-21). Mëkati gjithmonë bën punën e vet. Vdekja frymërore (krh. Zanafilla 3; Efe. 2:1) rezultoi në vdekje fizike (krh. Zanafilla 5; Heb. 9:27, shih shënimin te 8:13). Besimtarët jetojnë edhe në epokën e re të Frymës, (krh. Joeli 2:28-29; Vep. 2:16) edhe në epokën e vjetër të mëkatit dhe rebelimit (krh. vv. 21, 35).

☉ **“përsëri fryma është e gjallë për shkak të drejtësisë”** Ka patur ca mosmarrëveshje midis përkthimeve dhe komentuesve mbi çështjen nëse fjala “frymë” i referohet frymës njerëzore (krh. NASB, ASV, NIV, Williams, Jerusalem Bible), apo Frymës së Shenjtë (krh. KJV, TEV, REB, Karl Barth, C. K. Barrett, John Murray, dhe Everett Harrison).

Konteksti më i gjerë na e zgjeron të kuptuarit të kësaj fraze të shkurtër. Edhe ata që kanë besuar në Krishtin do të vdesin, sepse jetojnë në një botë të rënë. Megjithatë, për shkak të drejtësisë që vjen përmes besimit në Jezusin ata e kanë tashmë jetën e përjetshme (krh. Efe. 2:4-6). Ky është ai tensioni “po vjen, madje ka ardhur” i Mbretërisë së Perëndisë. Epoka e vjetër dhe epoka e re kanë mbivendosje në kohë.

☉ **“Drejtësia”** Në këtë kontekst ajo mund t’i referohet

1. drejtësisë së veshur/atribuuar (shfajësimi dhe shenjtërimi pozicional) që vjen përmes besimit në Krishtin (krh. Romakëve 4)
 2. jetës së re në Frymën (shenjtërimi progresiv) që është prova e një jete të shpenguar
- Shih Temën e Veçantë te 1:17.

8:11 “nëse” Shih shënimin në vargun 9.

☉ **“Fryma i Atij që e ngjalli Jezusin nga të vdekurit banon në ju”** Cili Person i Trinisë brendabanon besimtarët? Shumica e të krishterëve do të përgjigjeshin “Fryma.” Kjo është patjetër e vërtetë, por në realitet, të tre Personat e Trinisë i brendabanojnë besimtarët.

1. Fryma, Gjoni 14:16-17; Rom. 8:11; I Kor. 3:16; 6:19; II Tim. 1:14
2. Biri, Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; II Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27
3. Ati, Gjoni 14:23; II Kor. 6:16

Kjo frazë është një mundësi e shkëlqyer për të treguar se DHR shpesh ia atribuon veprat e shpengimit të tre personave të Trinisë.

1. Perëndia Atë e ringjalli Jezusin (krh. Vep. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; I Kor. 6:14; II Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; I Thes. 1:10)
2. Perëndia Bir u ringjall Vetë (krh. Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë e ringjalli Jezusin (krh. Rom. 8:11)

Po i njëjti theks Trinitar mund të shihet në vv. 9-11.

TEMË E VEÇANTË: TRINIA

Vini re veprimtarinë e të tre Personave të Trinisë në kontekste të bashkuara. Termi “trini”, i shpikur së pari nga Tertuliani, nuk është fjalë biblike, por koncepti i saj shfaqet kudo.

- A. Ungjijtë
 1. Mat. 3:16-17; 28:19 (dhe paralelet e saj)
 2. Gjoni 14:26
- B. Veprat – Veprat 2:32-33 38-39
- C. Pali
 1. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10
 2. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
 3. 2 Kor. 1:21-22; 13:14
 4. Gal. 4:4-6
 5. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4-6
 6. 1 Thes. 1:2-5
 7. 2 Thes. 2:13
 8. Titi 3:4-6
- D. 1 Pjet. 1:2
- E. Juda – v. 20-21

Në DhV, aludohet për një shumësi personash në Perëndinë.

A. Përdorimi i SHUMËSIT për Perëndinë

1. Emri *Elohim* është SHUMËS, por kur përdoret për Perëndinë ka gjithmonë një FOLJE në NJËJËS

2. “Ne” te Zanafilla 1:26-27; 3:22; 11:7
- B. Engjëlli i Zotit ishte përfaqësues i dukshëm i Hyjnisë
 1. Zanafilla 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16
 2. Eksodi 3:2,4; 13:21; 14:19
 3. Gjyqtarët 2:1; 6:22-23; 13:3-22
 4. Zakaria 3:1-2
- C. Perëndia dhe Fryma e tij janë të pandashëm, Zan. 1:1-2; Ps. 104:30; Isa. 63:9-11; Ezek. 37:13-14
- D. Perëndia (YHWH) dhe Mesia (*Adon*) janë të veçantë, Psa. 45:6-7; 110:1; Zak. 2:8-11; 10:9-12
- E. Mesia dhe Fryma janë të veçantë, Zak. 12:10
- F. Të tre përmenden te Isa. 48:16; 61:1

Natyra hyjnore e Jezusit dhe personaliteti i Frymës shkaktonin probleme për besimtarët e hershëm që ishin monoteistë të rreptë.

1. Tertuliani – ia nënshtroi Birin Atit
2. Origeni – nënshtroi esencën hyjnore të Birit dhe të Frymës
3. Ari – mohoi natyrën hyjnore të Birit dhe të Frymës
4. Monarkianizmi – besonte në shfaqjen e njëpasnjëshme të të njëjtit Perëndi si Atë, si Bir dhe, pastaj, si Frymë

Trinia është një formulim i zhvilluar nga ana historike, por i informuar nga materiali biblike

1. Natyra e plotë hyjnore e Jezusit, i barabartë me Atin, gjë që u pohua në 325 pas K. nga Këshilli i Nikesë
2. Personaliteti dhe natyra e plotë hyjnore e Frymës, i barabartë me Atin dhe me Birin, u pohua nga Këshilli i Kostandinopojës (381 pas K.)
3. Doktrina e Trinisë shprehet në mënyrë të plotë në veprën e Augustinit *De Trinitate*

Këtu kemi vërtet një mister. Por DhR duket se pohon një esencë të vetme hyjnore me tre shfaqje të përjetshme personale.

☐ **“edhe do t’ju japë jetë trupave tuaj të vdekshëm”** FOLJA është DËFTORE E ARDHME VEPRORE që tregon drejt Ditës së Ringjalljes. Ringjallja edhe e Jezusit, edhe e ndjekësve të Tij është një doktrinë kryesore (krh. I Kor. 15:1ff; II Kor. 4:14). Krishtërimi pohon se besimtarët do të kenë një ekzistencë trupore në përjetësi (krh. I Gjoni 3:2). Nëse Krishti u ringjall nga Fryma (krh. I Kor. 15:12-21), po ashtu do të ringjallen edhe ndjekësit e Tij (krh. v. 23).

☐

NASB, NKJV,

NRSV, NJB

REB, NET

NRSV shënim në fund të faqes

TEV

“përmes Frymës”

“për shkak të Frymës”

“me anë të pranisë së Frymës së Tij”

Ka një variant në dorëshkrime të lidhur me formën gramatikore të kësaj fraze.

1. GJINORE, MSS α , A, C, P^c
2. KALLËZORE, MSS B, D, F, G

UBS⁴ i jep GJINORES një vlerësim “B” (pothuaj e sigurt).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:12-17

¹²Prandaj, vëllezër, ne jemi nën detyrim jo ndaj mishit, që të jetojmë sipas mishit— ¹³sepse nëse po jetoni sipas mishit, duhet të vdisni; por, nëse me anë të Frymës ju po i bëni të vdesin veprat e trupit, do të jetoni. ¹⁴Sepse të gjithë që po udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë, këta janë bij të Perëndisë. ¹⁵Sepse ju nuk keni marrë një frymë skllavërie që ju çon përsëri në frikë, por keni marrë një frymë birësimi si bij me anë të të cilit ne thërrasim, “Abba! Atë!” ¹⁶Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi fëmijë të Perëndisë, ¹⁷dhe nëse fëmijë, edhe trashëgimtarë, trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë me Krishtin, nëse vërtet vuajmë me *Të* që të mund edhe të përlëvdohemi me *Të*.

8:12 “Prandaj” Pali vazhdon të nxjerrë degëzimet kuptimore të prezantimit të tij të vv. 1-11.

■ **“ne jemi nën detyrim”** Kjo është ana tjetër e lirisë së krishterë (krh. 14:1-15:13). Ky është përfundimi i nxjerrë nga diskutimi i shenjtërimit në vv. 1-11, i cili është edhe pozicional, (DËFTORE) edhe progresiv (URDHËRORE, shih Temën e Veçantë në 6:4). Ai gjithashtu tregon qartë që besimtarët ende duhet të luftojnë me natyrën e vjetër të rënë (d.m.th., 6:12,19; 7:7-24; I Kor. 6:18-19; Efe. 6:10-19). Duhet bërë një zgjedhje fillestare (besimi i fillimit) dhe duhen bërë zgjedhje të vazhdueshme (besimi si mënyrë jetese)!

8:13 “nëse Ka një seri FJALISH KUSHTORE në vv. 9,10,11,13 (dy herë), dhe 17 (dy herë). Ato janë të gjitha FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË, që merren si të vërteta nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Pali e mori si të mirëqenë që lexuesit e tij në kishën e Romës ishin të krishterë që jetonin me anë të Frymës. Por ka një rrethanë jo krejt të sigurt (d.m.th., bashkëpunimi njerëzor).

■ **“po jetoni sipas mishit, duhet të vdisni”** Të dyja FORMAT FOLJORE në v. 13 janë në KOHËN E TASHME, gjë që tregon veprim të vazhdueshëm. Bibla zbulon tri faza të vdekjes.

1. vdekja frymërore (krh. Zan. 2:17; 3:1-7; Efe. 2:1)
2. vdekja fizike (krh. Zanafilla 5)
3. vdekja e përjetshme (krh. Zbu. 2:11; 20:6,14; 21:8)

Ajo për të cilën flitet në këtë pasazh është vdekja frymërore e Adamit (krh. Zan. 3:14-19) që rezultoi në vdekjen fizike të racës njerëzore (krh. Zanafilla 5).

Mëkati i Adamit solli vdekjen në eksperiencën njerëzore (krh. 5:12-21). Secili nga ne ka zgjedhur të marrë pjesë në mëkat me vullnetin e vet. Nëse zgjedhim të mbetemi/qëndrojmë në të, ai do të na vrasë “përjetësisht” (krh. Zbu. 20:6, 14, “vdekja e dytë”). Si të krishterë ne duhet të vdesim ndaj mëkatit dhe vetes me anë të identifikimit me anë të besimit me Krishtin dhe të jetojmë për Perëndinë (krh. Romakëve 6).

■ **“nëse me anë të Frymës ju po i bëni të vdesin veprat e trupit, do të jetoni”** Siguria e shpëtimit të besimtarëve konfirmohet ose demonstron nga mënyra e tyre e krishterë e jetesës (krh. the librat e DHR të Jakobit dhe I e Gjonit). Besimtarët nuk e jetojnë këtë jetë të re me forcat e tyre, por me anë të veprimit të Frymës (krh. v.14). Megjithatë, ata duhet ta dorëzojnë veten e tyre çdo ditë ndaj kontrollit të Tij (krh. Efe. 5:17-18; 6:10-18).

Në këtë kontekst “veprat e trupit” shihen si jeta e epokës së vjetër të mëkatit (krh. Gal. 5:19-21). Ky nuk është mohim i përjetësisë së ekzistencës trupore (krh. 8:23), por kontrasti midis Frymës brendabanues (epokës së re) dhe betejës së vazhdueshme frymërore me mëkatit (epokës së vjetër).

8:14 “të gjithë që po udhëhiqen nga Fryma e Perëndisë” Kjo është një PJESORE E TASHME PËSORE, e cila tregon udhëheqje të vazhdueshme nga Fryma. Fryma na tërheq te Krishti (krh. Gjoni 6:44,65) dhe pastaj e formon Krishtin në ne (krh. v. 29-30). Krishtërimi është më shumë sesa një vendim. Në të vërtetë ai është një dishepullizim i vazhdueshëm (krh. Mat. 28:19) që fillon me një vendim (krh. 10:9-13; Gjoni 1:12; 3:16). Këtu nuk është fjala për ngjarje, kohë apo shërbesa të veçanta, por për veprimtari të përditshme.

■ **“bij të Perëndisë”** Kjo frazë në SHUMËS përdoret në DHV për engjëjt dhe rrallë për njerëzit (shih Temën e Veçantë online në www.freebiblecommentary.org). NJËJËSI është përdorur për Adamin, Izraelin, Mbretin e tij dhe për Mesian. Këtu iu referohet të gjithë besimtarëve (krh. Gal. 4:6-7). Në v. 14 përdoret termi grek *huios* (bij), në v. 16, *tekna* (fëmijë). Ata përdoren si sinonime në këtë kontekst. Besimtarët nuk janë më skllavër, por pjesëtarë të familjes (krh. vv. 15-17; Gal. 4:7).

8:15 “një frymë” Ky varg, ashtu si v. 10, është me dy kuptime. Ai mund t’i referohet frymës së re të njerëzimit të shpënguar në Krishtin, ose Frymës së Shenjtë. Të dy gjenden në vargun 16.

Ka disa vende në shkrimet e Palit ku ky ndërtim gramatikor përdoret për të përshkruar se çfarë prodhon Fryma e Shenjtë në besimtarin individual.

1. Këtu “jo një frymë skllavërie,” “një frymë birësimi,” v. 15
2. “një frymë butësie,” I Kor. 4:21
3. “një frymë besimi (besëplotësie), II Kor. 4:13
4. “një frymë urtësie dhe zbuluese,” Efe. 1:17
5. “jo një frymë ndrojtjeje,” II Tim. 1:7

Ka disa vende, sidomos te I Korintasve, ku Pali përdor *pneuma* për t'iu referuar vetes (krh. I Kor. 2:11; 5:3,14; 7:34; 16:8; dhe Kol. 2:5). Në këtë kontekst patjetër vv. 10 dhe 15 i përshtaten më mirë kësaj kategorie.

▣ **“skllavërie që ju çon përsëri në frikë”** Karakteristika e natyrës së vjetër është frika (krh. Heb. 2:15). Karakteristika e natyrës së re përshkruhet në vv. 14-17.

▣ **“birësimi si bij”** Ligji romak e bënte shumë të vështirë birësimin, por pasi kryhej, ishte i përhershëm (krh. Gal. 4:4-6). Kjo metaforë mbështet të vërtetën teologjike të sigurisë së besimtarit (shih Temën e Veçantë në 5:2). Një bir natyral mund të përjashtohet nga trashëgimia, ose edhe të vritej, por jo një i birësuar. Kjo ishte një nga metaforat familjare më të preferuara të Palit për të përshkruar shpëtimin (krh. vv. 15, 23). Gjoni dhe Pjetri përdorën një tjetër metaforë familjare, “të lindur sërish” (krh. Gjoni 3:3; I Pjetrit 1:3,23). Për shënimin e plotë shih Galatasve 4:5 online në www.freebiblecommentary.org.

▣ **“Abba”** Ky term aramaik përdorej nga fëmijët për të thirrur baballarët e tyre në shtëpi (“babi” ose “babush”). Jezusi dhe Apostujt flisnin gjuhën aramaike (krh. Mark 5:41; 14:36; I Kor. 16:22). Besimtarët mund të vijnë tani te një Perëndi i shenjtë me anë të gjakut të Krishtit, përmes Frymës brendabanues me një besim të palëkundur dhe me konfidencë familjare (krh. Mark 14:36; Gal. 4:6). A nuk është e mahnitshme që njerëzit e rënë mund ta thërrasin Perëndinë, Atë, dhe që I Shenjti i përjetshëm e dëshiron këtë! Shih Temën e Veçantë: Atë te 1:7.

8:16 “Vetë Fryma” Fjala greke për Frymë është në GJININË ASNJANËSE, prandaj, KJV e përkthen këtë “the Spirit, itself,¹” por Fryma është person; Ai mund të trishtohet (krh. Efe. 4:30; I Thes. 5:19), prandaj “Himself²” është një përkthim më i mirë. Shih Temën e Veçantë: Personaliteti i Frymës në 8:27.

▣ **“i dëshmon frymës sonë se ne jemi fëmijë të Perëndisë”** Siç u vu re në v. 13, një aspekt i sigurisë së besimit është jeta e ndryshuar ose në ndryshim e besimtarëve (krh. librat e DHR të Jakobit dhe I e Gjonit). Një aspekt tjetër i sigurisë është që Fryma brendabanues e ka zëvendësuar frikën e Perëndisë me dashurinë familjare (krh. I Gjonit 4:17-18).

Vini re përkthimet dhe pikësimet e RSV dhe NRSV, “kur ne thërrasim, Abba! Atë! Është Fryma Vetë që i dëshmon frymës sonë që ne jemi fëmijë të Perëndisë” (krh. Gal. 4:6). Kjo nënkupton që siguria vjen kur besimtarët mund t'i thërrasin Perëndisë, Atë, me anë të Frymës.

Dëshmia e brendshme e Frymës nuk është e dëgjueshme, por praktike.

1. faj për mëkatin
2. dëshirë për të qenë si Krishti
3. dëshirë për të qenë me familjen e Perëndisë
4. uri për Fjalën e Perëndisë
5. ndjerja e një nevoje për të bërë ungjillizim
6. ndjerja e një nevoje për dhënie të krishterë sakrifikuese

Këto janë ato lloj dëshirash të brendshme që sigurojnë një provë besimi për kthimin në besim.

Siguria e shpëtimit është kthyer në çështje denominacionale.

1. Teologjia Katolike Romane e mohon mundësinë e sigurisë së plotë në këtë jetë, por e bazon njëfarë sigurie në qenien anëtar i kishës së “vërtetë”
2. Zhan Kalvin (tradita e Reformimit) e bazonte sigurinë në zgjedhjen (paracaktimin), por njeriu nuk mund ta dinte me siguri deri pas kësaj jete në Ditën e Gjykimit
3. John Wesley (tradita Metodiste) e bazonte sigurinë në një dashuri të përsosur (të jetuarit pa mëkat me dijeni)
4. Shumica e Baptistëve kanë tentuar ta bazojnë sigurinë në premtimet biblike të hirit falas (por duke injoruar të gjitha porositë dhe paralajmërimet).

Ka dy rreziqe të lidhura me prezantimin paradoksal të DHR të sigurisë së krishterë.

1. theksimi më tepër sesa duhet mbi “nëse shpëtohesh një herë, je gjithmonë i shpëtuar”
2. theksimi më tepër sesa duhet mbi performancën njerëzore në ruajtjen e shpëtimit.

Hebrenjve 6 mëson qartë “nëse përjashtohesh një herë, je gjithmonë i përjashtuar.” Përpjekja njerëzore (veprat e mira) nuk i mban të shpëtuar besimtarët (krh. Gal. 3:1-14). Por veprat e mira janë synimi i jetës së krishterë

¹ Në anglisht *itself* është përemri vetvetor në gjininë asnjane (shën i përkth)

² *Himself* dmth Vetë (Ai) gjinia mashkullore (shën i përkth)

(krh. Efe. 2:10). Ato janë rezultati i natyrshëm i takimit të Perëndisë dhe pasjes së Frymës brendabanues. Ato janë prova të kthimit të vërtetë në besim.

Siguria e shpëtimit nuk duhet ta dobësojë thirrjen e Biblës për shenjtëri! Nëse flasim nga ana teologjike, siguria e shpëtimit bazohet në karakterin dhe veprimet e Perëndisë Triun.

1. Dashuria dhe mëshira e Atit
2. Vepra e përfunduar sakrifikuere e Birit
3. Puna e Frymës në tërheqjen e personit tek Krishti dhe pastaj në formimin e Krishtit në besimtarin e penduar

Prova e këtij shpëtimi është një botëkuptim i ndryshuar, një zemër e ndryshuar, një mënyrë jetese e ndryshuar dhe një shpresë e ndryshuar! Ai nuk mund të bazohet në një vendim të kaluar emocional që nuk ka prova në mënyrën e jetesës (d.m.th., fryte, krh. Mat. 7:15-23; 13:20-22; Gjoni 15). Siguria e shpëtimit, ashtu si shpëtimi, ashtu si jeta e krishterë fillon me një përgjigje ndaj mëshirës së Perëndisë dhe e vazhdon atë përgjigje gjatë gjithë jetës. Është një jetë besimi e ndryshuar dhe në ndryshim e sipër!

■ **“dëshmon”** Kjo është një tjetër fjalë e përbërë me *syn*. Fryma bashkë-dëshmon me frymën e besimtarit. Pali e përdor këtë term të përbërë te 2:15; 8:16 dhe 9:1.

8:17 “nëse” Ka një seri FJALISH KUSHTORE në vv. 9,10,11,13 (dy herë), dhe 17 (dy herë). Këto janë të gjitha FJALISH KUSHTORE TË KLASIT TË PARË që merren si të vërteta nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Pali e merr të mirëqenë që lexuesit e tij në Romë ishin të krishterë.

■ Në këtë varg ka tri fjalë të përbëra që përdorin *syn*, që do të thotë “bashkë-pjesëmarrje me”

1. besimtarët janë bashkëtrashëgimtarë me Krishtin
2. besimtarët janë bashkëvuajtës me Krishtin
3. besimtarët do të ndajnë lavdinë me Krishtin

Ka edhe më shumë fjalë të përbëra me *syn* në vv. 22 (dy herë), 26,28. Efe. 2:5-6 gjithashtu ka tri fjalë të përbëra me *syn* që përshkruajnë jetën e besimtarit në Krishtin.

■ **“trashëgimtarë”** Kjo është një tjetër metaforë familjare për të përshkruar besimtarët (krh. 4:13-14; 9:8; Gal. 3:29). Shih Temën e Veçantë që vjen më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: TRASHËGIMIA E BESIMTARËVE

Shkrimi flet për faktin që besimtarët trashëgojnë (krh. Vep 20:32; 26:18; Efe. 1:4; Kol. 1:12; 3:24) shumë gjëra për shkak të marrëdhënies të tyre familjare me Jezusin i Cili është trashëgimtar i të gjitha gjërave (krh. Heb. 1:2), dhe ata bashkë-trashëgimtarë (krh. Rom. 8:17; Gal. 4:7) të

- mbretërisë (krh. Mat. 25:34, I Kor. 6:9-10; 15:50; Efe. 5:5)
- jetës së përvetshme (krh. Mat. 19:29; Heb. 9:15)
- premtimeve të Perëndisë (krh. Heb. 6:12)
- mbrojtjes nga ana e Perëndisë të premtimeve të Tij (krh. I Pjet. 1:4-5)

■ **“bashkëtrashëgimtarë”** Kjo është një tjetër fjalë e përbërë me *syn*. Pali krijon shumë nga këta terma të rinj në kapitullin 8 për të theksuar vdekjen dhe jetën e përbashkët të Krishtit dhe besimtarëve.

1. bashkë-trashëgimtarë, v. 17
2. bashkë-vuajmë, v. 17
3. bashkë-përlëvdohemi, v. 17

■

NASB, NKJV “nëse vërtet vuajmë me Të”
NRSV “nëse, në fakt, vuajmë me të”
TEV “sepse nëse marrim pjesë në vuajtjet e Krishtit”
NJB “duke marrë pjesë në vuajtjet e Tij”

Vuajtja është norma për besimtarët në një botë të rënë (krh. Mat. 5:10-12; Gjoni 15:18-21; 16:1-2; 17:14; Vep 14:22; Rom.5:3-4; 8:17; II Kor. 4:16-18; Fil. 1:29; I Thes. 3:3; II Tim. 3:12; Jakobi 1:2-4; I Pjet. 4:12-19). Jezusi

dha shembullin (krh. Heb. 5:8). Pjesa tjetër e këtij kapitulli e zhvillon këtë motiv. Shih Temën e Veçantë: Pse vuajnë të krishterët? te 5:3.

☐ **“përlëvdohemi me Të”** Në shkrimet e Gjonit, sa herë që Jezusi foli për Vetën, e quajti “përlëvdim.” Jezusi u përlëvduar me anë të vuajtjes së Tij. Besimtarët, nga ana pozicionale, dhe shpesh edhe e përjetimit, marrin pjesë në ngjarjet e jetës së Jezusit (krh. Romakëve 6). Shih Temën e Veçantë: Mbretërimi në Mbretërinë e Perëndisë në 5:17-18.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:18-25

¹⁸Sepse unë llogarit se vuajtjet e kësaj kohe të tanishme nuk janë të denja të krahasohen me lavdinë që do të na zbulohet neve. ¹⁹Sepse dëshira e zjarrtë e krijimit pret me padurim për zbulimin e bijve të Perëndisë. ²⁰Sepse krijimi iu nënshtrua kotësisë, jo me dëshirë, por për shkak të Atij që e nënshtroi, me shpresë ²¹se edhe vetë krijimi do të çlirohet nga skllavëria e tij ndaj prishjes në lirinë e lavdisë së fëmijëve të Perëndisë. ²²Sepse ne e dimë se i gjithë krijimi rënkon dhe vuan dhimbjet e lindjes së bashku deri tani. ²³Dhe jo vetëm kjo, por edhe ne vetë, që kemi frytet e para të Frymës, edhe ne vetë rënkojmë brenda vetes, duke pritur me padurim për birësimin tonë si bij, shpengimin e trupit tonë. ²⁴Sepse në shpresë jemi shpëtuar, por shpresa që shihet nuk është shpresë; sepse kush shpreson për atë që *tashmë* e shikon? ²⁵Por nëse shpresojmë për atë që nuk e shohim, me këmbëngulje presim me padurim për të.

8:18 “llogarit” Kjo fjalë për fjalë do të thotë “mbledh një shumë.” Ajo është DËFTORE E TASHME JOVEPRORE. Pali vazhdon të llogaritë rrjedhojat e vuajtjes së krishterë. Ky ishte një term kontabiliteti për arritjen në një konkluzion të studiuar mirë. Kjo është një temë e përsëritur te Romakëve (shih shënimin në 2:3). Besimtarët duhet të jetojnë në dritën e të vërtetave shpirtërore që kuptojnë.

☐ **“vuajtjet”** Ne marrim njëfarë ideje për vuajtjet e përfshira në shërbimin ndaj Krishtit nga I Kor. 4:9-12; II Kor. 4:7-12; 6:4-10; 11:24-27; Heb. 11:35-38.

☐ **“e kësaj kohe të tanishme”** Hebrenjtë besonin se historia e botës ndahej në dy epoka, epoka e tanishme e keqe dhe epoka e drejtësisë që do të vinte (krh. Mat. 12:32; Mark 10:30). DHV priste që Mesia që do të vinte do ta inauguronte këtë epokë të re të drejtësisë. Megjithatë, të dyja ardhjet e Krishtit, njëra si Shpëtimtar (mishërimi) dhe e dyta si Zot (Ardhja e Dytë), bënë që këto dy epoka të mbivendoseshin pjesërisht. Besimtarët jetojnë në tensionin midis “tashmë” dhe “ende jo” (ose “po vjen, madje ka ardhur” -shën i përkth) të Mbretërisë së Perëndisë. Shih Temën e Veçantë: Kjo epokë dhe epoka që do të vijë në 12:2.

☐ **“të denja. . lavdinë”** Të dy këta terma lidhen me konceptin e DHV të peshës – gjërat e rënda ishin të çmuara. “E denjë” ishte nga një term komercial që do të thoshte “peshon po aq sa edhe.” Termi hebre “lavdi” vinte nga një rrënjë “të jesh i rëndë,” në kuptimin e të qenit i çmuar, si ari. Shih shënimin e plotë te 3:23.

Termi “lavdi” në shkrimet e Palit ka një orientim eskatologjik (krh. II Kor. 4:16-18). Ai i referohet shkëlqimit dhe fuqisë së Krishtit të përlëvdur dhe të lartësuar që kthehet përsëri (krh. Kol. 3:4). Shih Temën e Veçantë: Lavdia te 3:23.

☐ **“që do të na zbulohet neve”** Kjo DIATEZË PËSORE i referohet veprimit të Perëndisë ose Frymës (krh. v. 20). Besimtarët jetojnë në këtë jetë me anë të besimit, jo me anë të shikimit (krh. v. 24; I Kor. 2:9; 13:12; II Kor. 5:7; Heb. 11:1).

Fjala përdoret disa herë te Romakëve nga Pali dhe thekson se e vërteta është nga Perëndia, jo një zbulim i njerëzve.

1. Si FOLJE

- a. 1:17 – drejtësia e Perëndisë është zbuluar (E TASHME PËSORE DËFTORE)
- b. 1:18 – zemërimi i Perëndisë është zbuluar (E TASHME PËSORE DËFTORE)
- c. 8:18 – lavdia që po vjen është zbuluar (AORISTE PËSORE INFINITIVE)

2. si EMËR

- a. 2:5 – në ditën e zemërimit dhe të zbulimit të drejtë të Perëndisë
- b. 8:19 – krijimi pret me padurim për zbulimin e bijve të Perëndisë

c. 16:25 – sipas zbulimit të misterit

8:19 “dëshira e zjarrtë e krijimit pret me padurim” Krijimi fizik personifikohet si një person me qafën të zgjatur duke parë horizontin. Krijimi u ndikua negativisht kur Adami dhe Eva rebeluan (krh. Zan. 3:17-19). I gjithë krijimi më në fund do të shpengohet (përveç engjëjve që rebeluan, njerëzve që nuk besuan dhe vendit të përgatitur për izolimin e tyre, krh. Bruce Corley dhe Curtis Vaughan, *Romans (Romakëve)*, fq. 95, shënimi në fund nr. 46).

FOLJA “pret me padurim” (E TASHME JOVEPRORE [deponente] DËFTORE) shfaqet tri herë në këtë kontekst.

1. v. 19 – krijimi pret me padurim për epokën e re
2. v. 23 – besimtarët presin me padurim për trupa të rinj
3. v. 25 – besimtarët presin me padurim me shpresë për epokën e re

Pali e përdor të njëjtën FOLJE në një kuptim të ngjashëm te I Kor. 1:7; Gal. 5:5; Fil. 3:20. Ardhja e Dytë nuk është një ngjarje e frikshme për besimtarët, por një ribashkim familjar!

TEMË E VEÇANTË: BURIMET NATYRORE

I. Hyrje

- A. I gjithë krijimi është sfondi ose skena për marrëdhënien e dashurisë së Perëndisë me njerëzimin.
- B. Ai merr pjesë në rënie (krh. Zan. 3:17; 6:1ff; Isa. 24:3-8; Rom. 8:18-20). Ai do të marrë pjesë edhe në shpengimin eskatologjik (krh. Isa. 11:6-9; Rom. 8:20-22; Zbu. 21-22).
- C. Njerëzimi i rënë e ka shkatërruar mjedisin natyror me moskokëçarje egoiste. Më poshtë është një citim nga *The Canon of Westminster* nga Edward Carpenter.
“...sulmi i pandalshëm i njeriut, në një kontekst global, mbi universin përreth tij—domethënë mbi krijimin e Perëndisë—një sulm mbi ajrin të cilin ai e ndot; rrugët natyrale ujore që ai i fëlli; dheun, të cilin e helmon; pyjet që i pret, pa menduar për efektet afatgjata të këtij shkatërrimi mizor. Ky sulm është pak nga pak dhe i pakoordinuar. Pak rëndësi i kushtohet ndonjë ekuilibri të natyrës dhe si rrjedhojë pak ndjenjë përgjegjësie për atë që një brez i detyrohet një tjetri.”
- D. Jo vetëm që ne po korrim rezultatet e ndotjes dhe shfrytëzimit të planetit tonë, por pasardhja jonë do të korë pasoja edhe më të ashpra, e të parikthyeshme.

II. Materiali Biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Zanafilla 1-3

- a. Krijimi është një vend i veçantë i krijuar nga Perëndia për bashkësi me njerëzimin (krh. Zan. 1:1-25).
- b. Krijimi është i mirë (krh. Zan. 1:4,10,12,18,21,25), po, shumë i mirë (krh. Zan. 1:31). Ai është bërë për të qenë dëshmi për Perëndinë (krh. Ps. 19:1-16).
- c. Njerëzimi është qëllimi kurorëzues i krijimit (krh. Zan. 1:26-27).
- d. Njerëzimi u krijua për të ushtruar sundim (Hebraisht, “të shkelësh”) si administrator i Perëndisë (krh. Zan. 1:28-30; Psalmi 8:3-8; Hebrenjve 2:6-8). Perëndia është dhe mbetet Krijuesi/Mbështetësi/Shpenguesi/Zoti i krijimit (krh. Eks. 19:5; Jobi 37-41; Ps. 24:1-2; 95:3-5; 102:25; 115:15; 121:2; 124:8; 134:3; 146:6; Isa. 37:16).
- e. Administrimi i krijimit nga njeriu mund të shihet te Zan. 2:15, “me qëllim që ta punonte dhe ta ruante” (krh. Lev. 25:23; I Kron. 29:14).

2. Perëndia e do krijimin, sidomos kafshët.

- a. Ligjet e Moisiut për trajtimin e duhur të kafshëve
- b. YHWH luan me Leviathanin (krh. Ps. 104:26)
- c. Perëndia interesohet për kafshët (krh. Jona 4:11)
- d. Prania eskatologjike e natyrës (krh. Isa. 11:6-9; Zbulesa 21-22)

3. Natyra, në njëfarë, mase e përlëvdon Perëndinë.

- a. Psalmi 19:1-6
- b. Psalmi 29:1-9
- c. Jobi 37-41

4. Natyra është një mjet me anë të të cilit Perëndia tregon dashurinë dhe besnikërinë e Tij ndaj besëlidhjes.

- a. LiP. 27-28; I Mbret. 17

b. Tek të gjithë profetët

B. Dhiata e Re

1. Perëndia shihet si krijuesi. Ka vetëm një Krijues, Perëndia Triun (Elohim, Zan. 1:1; Fryma, Zan. 1:2; dhe Jezusi, DHR). Gjithçka tjetër është e krijuar.
 - a. Veprat 17:24
 - b. Hebrenjve 11:3
 - c. Zbulesa 4:11
2. Jezusi është agjenti i krijimit i Perëndisë
 - a. Gjoni 1:3,10
 - b. I Korintasve 8:6
 - c. Kolosianëve 1:16
 - d. Hebrenjve 1:2
3. Jezusi flet për kujdesin e Perëndisë për natyrën në mënyrë të tërthortë në predikimet e Tij
 - a. Mateu 6:26,28-30, zogjtë e qiellit dhe zambakët e fushës
 - b. Mateu 10:29, harabelat
4. Pali thotë që të gjithë njerëzit janë përgjegjës për njohurinë e Perëndisë nëpërmjet krijimit (d.m.th. zbulesa natyrore, krh. Rom. 1:19-20; Zbu. 21-22).

III. Konkluzion

- A. Ne jemi të lidhur me këtë rend natyror!
- B. Njerëzimi mëkatar e ka keqtrajtuar natyrën, dhuratën e Perëndisë, siç ka bërë edhe me të gjitha dhuratat e tjera të Perëndisë.
- C. Ky rend natyror është i përkohshëm. Ai do të kalojë (II Pjet. 3:7). Perëndia po e çon botën tonë drejt një fokusi historik. Mëkati do ta bëjë punën e vet, por Perëndia ia ka caktuar kufijtë. Krijimi do të shpengohet (krh. Rom. 8:18-25).

▣ **“për zbulimin”** Ky term do të thoshte “hap perden” për të zbuluar ose informuar. Ai është gjithashtu edhe titulli i librit të fundit të Dhiatës së Re, “Apokalipsi.” Ardhja e Dytë shpesh përmendet si një zbulesë ose ardhje (krh. I Kor. 1:7-8; I Pjetrit 17,13).

▣ **“bijve të Perëndisë”** Kjo ishte një metaforë e zakonshme familjare që përdorej për të përshkruar të krishterët (krh. 8:14,16). Ajo flet për Perëndinë si Atë dhe për Jezusin si birin e Tij unik/të vetëm (krh. Gjoni 1:18; 3:16,18; Heb. 1:2; 3:6; 5:8; 7:28; I Gjoni 4:9).

Në DHV Izraeli ishte biri i Perëndisë (krh. Osea 11:1), por edhe Mbreti ishte biri i Perëndisë (krh. II Sam. 7). Ky koncept përmendet për herë të parë në DHR te Mateu 5:9 (krh. edhe Gjoni 1:12; II Kor. 6:18; Gal. 3:26; I Gjoni 3:1,10; Zbu. 21:7).

8:20

NASB, NKJV,

NRSV

TEV

NJB

“sepse krijimi iu nënshtrua kotësisë”

“Sepse krijimi u dënua për t’u bërë i pavlerë”

“Nuk ishte për ndonjë faj nga ana e krijimit që ai u bë i paaftë për të arritur qëllimin e tij”

Kjo mund të përkthehet “pavlefshmëri.” Ajo përdoret në disa kuptime në Septuagintë—pa kuptim, pa vlerë, e padobishme, perënditë e rreme (idhujt), dhe zbrazëti. I gjithë krijimi u bë i padobishëm për qëllimin që kishte Perëndia (krh. Zan. 3:17-19; Isa. 24:3-8), por një ditë Perëndia do ta heqë mallkimin e Rënies (krh. Zbu. 22:3). Kjo nuk është bota që Perëndia donte!

▣ **“por për shkak të Atij që e nënshtroi, me shpresë”** FOLJA është AORISTE PËSORE dhe duket se i referohet Perëndisë (krh. NASB, NKJV, TEV). Ai e nënshtroi krijimin fizik ndaj kotësisë

1. për shkak të rebelimit njerëzor

2. si një përpjekje për ta kthyer njerëzimin te Vetja (krh. LiP 27-29)

Kjo kotësi e qëllimshme do të jetë vetëm për një periudhë kohe (krh. Rom. 11:11-32). Njerëzimi i shpenguar ka një të ardhme fizike të premtuar (trupit dhe bota).

Perëndia e dinte që më parë për rebelimin e Adamit. Ai e lejoi të ndodhte dhe zgjodhi të punonte me një njerëzim të rënë në një botë të rënë. Kjo botë nuk është ashtu siç e donte Perëndia. Dhe kjo nuk është bota që do të jetë një ditë (krh. II Pjet. 3:10; Zbu. 21:1-3). Shih shënimet mbi “shpresën” te 5:2.

8:21 “vetë krijimi do të çlirohet nga skllavëria e tij ndaj prishjes” Natyra do të jetë pjesë e përjetësisë (krh. Isa. 11:6-10). Parajsja është rikthimi në një tokë të rikrijuar (krh. Mat. 5:18; 24:35; II Pjet. 3:10; Zbu. 21:1). E ardhmja mund të jetë një rikthim në lumturinë e Edenit; bashkësia midis Perëndisë dhe njeriut, individit me individin, njeriut me kafshët dhe njeriut me tokën! Bibla fillon me Perëndinë, njeriun dhe kafshët (shih Isa. 11:6-9) në bashkësi dhe harmoni në një kopsht (krh. Zan. 1-2) dhe Bibla përfundon në mënyrë të ngjashme (krh. Zbulesa 21-22).

■ **“prishjes”** Shih Temën e Veçantë te 1:23.

■ **“në lirinë e lavdisë së fëmijëve të Perëndisë”** Në v. 14 besimtarët quhen “bijtë e Perëndisë,” në v. 16 “fëmijët e Perëndisë,” dhe në v. 17 “trashëgimtarë të Perëndisë.” Në v. 18 lavdia eskatologjike e Perëndisë u zbulohet besimtarëve. Tani në 19 krijimi pret për zbulimin e bijve të Perëndisë, sepse ai do të ketë pjesë në lavdinë e tyre eskatologjike (krh. v. 21). Ky restaurim i krijimit, dhe veçanërisht i njerëzve, do të lejojë që të përmbushet qëllimi fillestar i krijimit—Perëndia dhe njeriu (i krijuar në imazhin e Tij) në bashkësi intime.

8:22 “i gjithë krijimi rënkon” Kjo është një tjetër nga fjalët e përbëra me *syn* të Palit, “rënkon së bashku me.” Ai duhet t’i ketë krijuar vetë shumë prej tyre. Ka mundësi që ai po aludonte për Jer. 12:4,11 (krh. LiP 27-29), ku toka e Izraelit mban zi për shkak të shkretimit të shkaktuar nga mëkati njerëzor.

Vini re që “rënkimi” përmendet tri herë në këtë kontekst.

1. Krijimi rënkon (E TASHME VEPRORE DËFTORE) për ardhjen e epokës së re, v. 22 (krh. vv. 19-21)
2. besimtarët rënkojnë për shpëtimin e tyre të plotë (d.m.th., një trup të ri, krh. II Kor. 5:2,4), v. 23
3. Fryma i Cili e jep Vetën si fryti i parë i epokës së re gjithashtu rënkon (lutet për, E TASHME VEPRORE DËFTORE) besimtarët, v. 26

■ **“vuan dhimbjet e lindjes”** Në qarqet hebreje ky koncept shpesh quhej “dhimbjet e lindjes së epokës së re” (krh. Mark 13:8). Agimi i ditës së re të drejtësisë nuk do të jetë pa probleme. Kushtet morale dhe shpirtërore të këtij planeti të rënë do të bëhen gjithnjë e më të këqija (krh. Mateu 24; Marku 13; Luka 21; II Thes. 2:1-12; dhe gjithashtu vini re shtatë vultat, boritë dhe kupat e Zbulesës 5-18). Megjithatë, dhimbjet e lindjes janë dhimbje shprese dhe gëzimi për lindjen që do të pasojë, e po kështu është edhe me epokën e re!

8:23 “ne vetë. . .ne vetë. . .vetë” PËREMRRAT janë theksues dhe të përsëritur.

■ **“frytet e para të Frymës”** Ky term (*aparchē*) është teologjikisht analog me “vulën e Frymës” në II Kor. 1:22; dhe “kaparin e Frymës” në II Kor. 5:5; dhe Efe. 1:14.

Frytet e para në DHV ishin një premtim për të korrën që do të pasonte. Ato simbolizonin faktin që Perëndia ishte i zoti i të gjithë të korrave (krh. LiP. 26:1-11). Fryma është fryti i parë i epokës së re, ashtu si Jezusi ishte fryti i parë i ringjalljes (krh. I Kor. 15:20). Besimtarët si fëmijë të Perëndisë, që tani përjetojnë diçka nga gëzimet e parajsës me anë të Frymës së Shenjtë që banon me ta dhe në ta. Ky është ai tensioni midis “tashmë” por “ende jo” (ose “po vjen, madje ka ardhur” -shën i përkth) i mbivendosjes së dy epokave hebreje. Besimtarët janë qytetarë të qiellit dhe banorë në tokë!

■ **“ne vetë rënkojmë brenda vetes”** Kjo duket se i referohet tensionit dialektik midis “tashmë” por “ende jo” të mbivendosjes së dy epokave hebreje (shih Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How To Read the Bible For All Its Worth*³, fq. 145-148). Mbretëria e Perëndisë është e pranishme, por jo e kulminuar. Besimtarët kanë jetë të ringjallur, e megjithatë ata ende do të vdesin fizikisht (krh. II Kor. 5:2-4). Ne jemi të shpëtuar nga mëkati, por ende luftojmë me të (Romakëve 7; Efe. 6:10-18).

³ Tani edhe në shqip me titullin *Si ta lexojmë Biblën për të gjithë vlerën që ka* botuar nga Fondacioni “Kisha shqiptare e Nazaretasit” përkth. Rezarta Shëngjergji dhe Genti Suli. Shtypur nga Vernon Publishing 2012

■ **“duke pritur me padurim për birësimin tonë si bij”** Birësimi është metafora familjare e preferuar e Palit për shpëtimin (krh. v. 15). Shpëtimi i besimtarëve është një proces që fillon me një vendim fillestar pendimi dhe besimi dhe zhvillohet në një ngjashmëri me Krishtin që sa vjen e rritet. Besimtarët nuk do të shpëtohen plotësisht deri në Ditën e Ringjalljes (krh. v. 30 dhe I Gjoni 3:2).

Termi “birësim” mungon në disa dorëshkrime në greqisht (krh. MSS P⁴⁶, D, F, G, dhe në disa versione në latinishten e vjetër. Megjithatë, ai gjendet në X, A, B, C, dhe në disa versione të tjera të latinishtes së vjetër, të Vulgatës, siriake, koptike dhe armene. UBS⁴ e vlerëson praninë e tij në origjinal si “A”(të sigurt).

■ **“shpengimin e trupit tonë”** Ky term do të thotë “të riblesh.” Ky koncept përdoret në DHV për të përshkruar çlirimin e dikujt nga skllavëria prej një të afërmi (*go’el*). Me kalimin e kohës u përdor në mënyrë metaforike për çlirimin e Perëndisë për njerëzimin e rënë nga skllavëria e mëkatit. Çmimi që u pagua ishte jeta e pamëkat e Birit të mishëruar. Shih Temën e Veçantë te 3:24.

Krishtërimi, ashtu si judaizmi (krh. Job 14:14-15; 19:25-26; Dan. 12:2), pohon se besimtarët do të kenë një trup fizik (megjithëse jo patjetër humanoid, krh. I Kor. 15:35-49) në përjetësi. Trupat frymërorë të besimtarëve do të jenë të përgatitur në mënyrë të përsosur për jetë në epokën e re, jetë në bashkësi intime me Perëndinë.

8:24 “në shpresë jemi shpëtuar” Kjo është një AORISTE PËSORE DËFTORE. Ashtu siç v. 23 i referohet shpëtimit tonë të ardhshëm, v. 24 i referohet shpëtimit tonë të shkuar përmes veprimit të Frymës. DHR përdor disa KOHË FOLJESH për të përshkruar shpëtimin (shih Temën e Veçantë në 10:4).

1. AORISTE, Vep. 15:11 (Rom. 8:24; II Tim. 1:9; Titit 3:5; dhe Rom. 13:11 kombinon AORISTEN me një orientim TË ARDHËM)
2. E KRYER, Efe. 2:5,8
3. E TASHME, I Kor. 1:18; 15:2; II Kor. 2:15 I Pjet. 3:21; 4:18
4. E ARDHME (në kohën e foljes ose në kuptimin kontekstual), Rom. 5:9,10; 10:9; I Kor. 3:15; Fil. 1:28; I Thes. 5:8-9; Heb. 1:14; 9:28.

Prandaj, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi dhe vijon në një proces besimi si mënyrë jetese që një ditë do të kulminojë në shikim (krh. I Gjoni 3:2).

8:25 “shpresë” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: SHPRESA

Pali e përdor këtë term shpesh në disa kuptime të ndryshme, por të lidhur me njëri-tjetrin. Shpesh ai lidhet me kulminimin e besimit të besimtarit (p.sh., I Tim. 1:1). Kjo mund të shprehet si lavdi, jetë e përjetshme, shpëtim përfundimtar, Ardhja e Dytë, etj. Kulminimi është i sigurt, por elementi kohë është i ardhëm dhe i panjohur.

Ai shpesh lidhet me “besimin” dhe “dashurinë” (krh. I Kor. 13:13; I Thes. 1:3; II Thes. 2:16). Një listë e pjesshme e disa prej përdorimeve të këtij termi nga ana e Palit është:

1. Ardhja e Dytë, Gal. 5:5; Efe. 1:18; 4:4; Titus 2:13
2. Jezusi është shpresa jonë, I Tim. 1:1
3. Besimtari duhet t’i paraqitet Perëndisë, Kol. 1:22-23; I Thes. 2:19
4. Shpresa ruhet në qiell, Kol. 1:5
5. Besim në ungjillin, Kol. 1:23; I Thes. 2:19
6. Shpëtim përfundimtar, Kol. 1:5; I Thes. 4:13; 5:8
7. Lavdia e Perëndisë, Rom. 5:2, II Kor. 3:12; Kol. 1:27
8. Shpëtimi i besimtarëve prej Krishtit, Kol. 1:27
9. Siguria e shpëtimit, I Thes. 5:8
10. Jeta e përjetshme, Titit 1:2; 3:7
11. Rezultatet e pjekurisë së krishterë, Rom. 5:2-5
12. Shpengimi i gjithë krijimit, Rom. 8:20-22
13. Kulminimi i birësimit, Rom. 8:23-25
14. Titull për Perëndinë, Rom. 15:13
15. Dëshira e Palit për besimtarët, II Kor. 1:7
16. DHV si një udhëzues për besimtarët e DHR, Rom. 15:4

■ **“me këmbëngulje”** Ky term *hupomonē* është përdorur edhe në 5:3 dhe 15:4-5. Shpëtimi i besimtarëve është në procesin e pjekurisë dhe një ditë ai do të kulminojë/arrijë qëllimin e tij. Këmbëngulja (krh. Zbu. 2:8,11,17,26; 3:5,12,21; 21:7) është ekuilibri i duhur biblik ndaj mbitheksimit mbi “shpëtimin fillestar.” Shumica e të vërtetave biblike (krh. Literaturën Lindore, shih Temën e Veçantë në 3:27) shprehen në çifte dialektike të mbushura me tension.

TEMË E VEÇANTË: NEVOJA PËR TË KËMBËNGULUR

Doktrinat biblike të lidhura me jetën e krishterë janë të vështira për t’u shpjeguar, sepse ato paraqiten në çifte dialektikë tipikë lindorë. Këta çifte duken kontradiktorë, e megjithatë janë të dy biblike. Të krishterët perëndimorë kanë patur prirjen për të zgjedhur njëren nga të vërtetat dhe të shpërfillin ose nënvlerësojnë të vërtetën e kundërt. Më lejoni ta ilustruj.

- A. A është shpëtimi një vendim fillestar për t’i besuar Krishtit, apo një përkushtim për gjithë jetën ndaj dishepullizimit?
- B. A është shpëtimi një zgjedhje me anë të hirit nga një Perëndi sovran, apo besimi dhe përgjigjia me pendim e njerëzimit ndaj një oferte hyjnore?
- C. Pasi merret një herë shpëtimi, a është e pamundur për ta humbur, apo ka nevojë për zell të vazhdueshëm?

Çështja e këmbënguljes ka qenë çështje debati përgjatë gjithë historisë së kishës. Problemi fillon me pasazhet në dukje konfliktuale të DHR:

- A. Tekste mbi sigurinë
 1. Deklaratat e Jezusit (Gjoni 6:37; 10:28-29)
 2. Deklaratat e Palit (Rom. 8:35-39; Efe. 1:13; 2:5,8-9; Fil. 1:6; 2:13; II Thes. 3:3; II Tim. 1:12; 4:18)
 3. Deklaratat e Pjetrit (I Pjet. 1:4-5)
- B. Tekste mbi nevojën për këmbëngulje
 1. Deklaratat e Jezusit (Mat. 10:22; 13:1-9,24-30; 24:13; Marku 13:13; Gjoni 8:31; 15:4-10; Zbu. 2:7,17,20; 3:5,12,21)
 2. Deklaratat e Palit (Rom. 11:22; I Kor. 15:2; II Kor. 13:5; Gal. 1:6; 3:4; 5:4; 6:9; Fil. 2:12; 3:18-20; Kol. 1:23)
 3. Deklaratat e autorit të Hebrenjve (2:1; 3:6,14; 4:14; 6:11)
 4. Deklaratat e Gjonit (I Gjoni 2:6; II Gjoni 9)
 5. Deklarata e Atit (Zbu. 21:7)

Shpëtimi biblik rrjedh nga dashuria, mëshira dhe hiri i një Perëndie sovran Triun. Asnjë njeri nuk mund të shpëtohet pa punën e Frymës (krh. Gjoni 6:44,65). Hyjnia vjen i pari dhe cakton axhendën, por njerëzit duhet të përgjigjen me besim dhe pendim, si në fillim, ashtu edhe vazhdimisht. Perëndia punon me njerëzimin në një marrëdhënie besëlidhore. Ka privilegje dhe përgjegjësi!

Shpëtimi u ofrohet të gjithë njerëzve. Vdekja e Jezusit e zgjidhi problemin e mëkatit të krijimit të rënë. Perëndia ka siguruar një mënyrë dhe dëshiron që të gjithë ata që janë krijuar në imazhin e Tij të reagojnë ndaj dashurisë dhe sigurimit të Tij në Jezusin.

Nëse doni të lexoni më shumë mbi këtë temë nga një këndvështrim jo-kalvinist, shikoni

1. Dale Moody, *The Word of Truth*, Eerdmans, 1981 (fq. 348-365)
2. Howard Marshall, *Kept by the Power of God*, Bethany Fellowship, 1969
3. Robert Shank, *Life in the Son*, Westcott, 1961

Bibla u adresohet dy problemeve të ndryshme në këtë fushë: (1) marrja e sigurisë së shpëtimit si një lejim për të jetuar në mënyrë egoiste dhe të pafrytshme dhe (2) inkurajimi i atyre që luftojnë me shërbesën dhe mëkatit personal. Problemi është që grupet e gabuar po marrin mesazhin e gabuar dhe po ndërtojnë sisteme teologjike mbi pasazhe biblike të kufizuara. Disa të krishterë kanë nevojë të dëshpëruar për mesazhin e sigurisë së shpëtimit, kurse të tjerë kanë nevojë për paralajmërimet e rrepta!

Në cilin grup je ti?

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:26-27

²⁶Në të njëjtën mënyrë edhe Fryma ndihmon dobësitë tona; sepse ne nuk dimë si të lutemi siç duhet, por Fryma Vetë ndërhyr për ne me rënkime tepër të thella për fjalë; ²⁷dhe Ai që heton zemrën e di cila është mendja e Frymës, sepse Ai ndërmjetëson për shenjtoret sipas vullnetit të Perëndisë.

8:26 “në të njëjtën mënyrë” Kjo e lidh shërbesën ndërmjetësuese të Frymës me “rënkimin dhe shpresën” të përmendura në vv. 18-25.

▣ **“edhe Fryma ndihmon”** Kjo është një DËFTORE E TASHME JOVEPRORE (deponente). FOLJA ka një përbërje të dyfishtë, *syn* (krh. v. 28) dhe *anti*. Ajo përkthehet më mirë “të mbash me.” Ky term gjendet vetëm këtu dhe te Luka 10:40. I gjithë Perëndia Triun është për besimtarët. Ati dërgoi Birin të vdiste në vend të njerëzimit (krh. Gjoni 3:16, dhe dhe Ai gjithashtu ndërmjetëson për ne (krh. v. 34; Heb. 7:25; 9:24; I Gjoni 2:1). Fryma e sjell njerëzimin të Krishti dhe formon Krishtin në ta (krh. Gjoni 16:8-15). Megjithatë, FOLJA “ndihmon,” që ka kuptimin “të mbash bashkë me dikë tjetër,” nënkupton që edhe besimtarët kanë një pjesë në përvetësimin e ndihmës së Frymës (ndërmjetësimit).

▣ **“dobësi”** Ky EMËR përdoret nga Pali në disa kuptime (BAGD, fq. 115).

1. Dobësi trupore apo sëmundje, II Kor. 11:30; 12:5,9,10; Gal. 4:13; I Tim. 5:23
2. Situata njerëzore, I Kor. 15:43; II Kor. 13:4
3. Figurë për
 - a. ndrojtjen, I Kor. 2:3
 - b. gjykimin, Rom. 6:19
 - c. mungesën e të kuptuarit fetar, Rom. 8:26

FOLJA përdoret në mënyra të ngjashme.

1. Dobësi trupore, Fil. 2:26-27; II Tim. 4:20
2. Situata njerëzore, Rom. 8:3; II Kor. 11:21; (vini re Mat. 8:17; citim nga Isa. 53:4)
3. Figurë për
 - a. Dobësinë morale apo fetare, Rom. 14:2; I Kor. 8:11-12
 - b. Të dobët në besim, Rom. 4:19; 14:1
 - c. Zemërdobët dhe plot frikë, II Kor. 11:29

Mbani mend që konteksti përcakton kuptimin brenda një parametri semantik. Fjalorët listojnë vetëm kuptimet dhe përdorimet e mundshme.

▣ **“Fryma Vetë ndërhy për ne me rënkime tepër të thella për fjalë”** Besimtarët rënkojnë në gjendjen e tyre të rënë, dhe Fryma rënkon në ndërmjetësim për ta. Fryma brenda të shpenguarve lutet për ta. Edhe Jezusi në të djathtë të Perëndisë gjithashtu lutet për ta, (krh. vv. 27,34; Heb. 7:25; 9:24; I Gjoni 2:1). Ky ndërmjetësim e fuqizon besimtarin të lutet (krh. v. 15; Gal. 4:6). Ky pasazh në kontekst nuk i referohet dhuntisë frymërore të të folurit në gjuhë, por ndërmjetësimit të Frymës tek Ati për besimtarët.

▣

NASB, NRSV “tepër të thella për fjalë”
NKJV “që nuk mund të shqiptohen”
TEV “që fjalët nuk mund ta shprehin”
NJB “që nuk mund të thuhet me fjalë”

Kjo fjalë është fjala e zakonshme për “të folurit,” “gjuhën” (krh. I Kor. 13:1) me PARASHTESËN A MOHUESE (ALFA PRIVATIVE). Ajo gjendet vetëm këtu në gjithë DHR. Një tjetër formë e kësaj fjale përdoret në Ungjillin e Markut për njerëzit shurdh-memecë (krh. 7:37; 9:17,25).

▣ **“ndërmjetëson”** Shih Temën e Veçantë: Përdorimi nga ana e Palit e fjalëve të përbëra me *Huper* në 1:30.

8:27 “Ai që heton zemrën” Ky ishte një motiv i përsëritur në DHV (krh. I Sam. 2:7; 16:7; I Mbr. 8:39; I Kron. 28:9; II Kron. 6:30; Ps. 7:9; 44:21; Fja. 15:11; 20:27; 21:2; Jer. 11:20; 17:9-10; 20:12; Luka 16:15; Vep. 1:24; 15:8). Perëndia na njeh me të vërtetë dhe ende na do (krh. Psalmi 139).

▣ **“Ai ndërmjetëson për shenjtorët”** Detyrat e Frymës përvijohen qartë te Gjoni 16:2-15. Një prej tyre është ndërmjetësimi.

Termi “shenjtorë” është gjithmonë në SHUMËS, përveç te Fil. 4:21 ku edhe aty i referohet të gjithë besimtarëve. Të krishterët janë anëtarë të familjes së Perëndisë, trupi i Krishtit, tempulli i ri i ndërtuar nga

besimtarë individualë. Ky është një ekuilibër i nevojshëm ndaj individualizmit perëndimor (amerikan). Shih Temën e Veçantë: Shenjtorët në 1:7.

TEMË E VEÇANTË: PERSONALITETI I FRYMËS

Në DHV, “Fryma e Perëndisë” (pra, *ruach*) ishte një forcë që përmbushte synimin e YHWH, por nuk na aludohet se ai ishte person (pra, në monoteizmin e DHV). Mirëpo, në DHR, dokumentohet personaliteti i plotë i Frymës.

1. Ai mund të shahet/blasfemohet (shih Mat. 12:31; Marku 3:29)
2. Mëson të tjerët (shih Luka 12:12; Gjoni 14:26)
3. Dëshmon (shih Gjoni 15:26)
4. Bind, drejton (shih Gjoni 16:7-15)
5. Quhet “dikush” (pra, *hos*, Efe. 1:14)
6. Mund të brengoset (shih Efe. 4:30)
7. Mund të shuhet (shih 1 Thes. 5:19)

Edhe pasazhet trinitare flasin për tre persona.

1. Mat. 28:19
2. 2 Kor. 13:14
3. 1 Pjet. 1:2

Fryma lidhet me veprimtarinë njerëzore.

1. Veprat 15:28
2. Rom. 8:26
3. 1 Kor. 12:1
4. Efe. 4:30

Roli i Frymës theksohet që në fillim të Veprave. Dita e Rrëshajave nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Jezusi e kishte gjithmonë Frymën. Pagëzimi i tij nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Luka e përgatiti kishën për një kapitull të ri shërbese të efektshme. Jezusi është ende fokusi, fryma është ende mjeti i efektshëm dhe synimi është dashuria, falja e Atit dhe rimëkëmbja e gjithë njerëzve të krijuar në shëmbëllimin e Tij!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:28-30

²⁸Dhe ne e dimë se Perëndia i shkakton të gjitha gjërat të bashkëpunojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë thirrur sipas qëllimit të Tij. ²⁹Sepse ata që i paranjohu, edhe i paracaktoi për t'u konformuar me imazhin e Birit të Tij, që Ai të mund të ishte i parëlinduri midis shumë vëllezërve; ³⁰dhe ata që i paracaktoi, edhe i thirri; dhe ata që i thirri, edhe i shfajësoi; dhe ata që i shfajësoi, edhe i përlëvdoi.

8:28 “Dhe ne e dimë” Kjo FOLJE (*oida*) del katër herë në këtë kontekst.

1. besimtarët e dinë se i gjithë krijimi rënkon (v. 22)
2. besimtarët nuk dinë si të luten (v. 26)
3. Ati njih/di zemrat e njerëzve dhe mendjen e Frymës (v. 27)
4. besimtarët e dinë se të gjitha gjërat bashkëpunojnë për të mirë (v. 28)

■ NASB, TCNT “Perëndia i shkakton të gjitha gjërat”

NKJV, NRSV,

NET

“të gjitha gjërat”

TEV, NIV

“në të gjitha gjërat Perëndia punon”

Pyetja tekstuale është sa herë del fjala “*Theos*” (ose “*Theon*”) në këtë varg?

Nuk ka variant në dorëshkrime në lidhje me frazën “për ata që e duan Perëndinë,” por ka një variant të lidhur me frazën “të gjitha gjërat bashkëpunojnë për të mirë.”

1. Disa dorëshkrime shtojnë “*ho Theos*” pas FOLJES, P⁴⁶, A, B, 81, dhe disa versione koptike dhe etiopase.

2. Shumica e dorëshkrimeve nuk e kanë atë, ⱥ, C, D, F, G, dhe Vulgata, Peshitta, versionet armene. UBS⁴ i jep mungesës së saj një vlerësim “B” (pothuajse të sigurt).

NASB e përfshin për të theksuar idenë e veprimtarisë hyjnore. Ka mundësi nga konteksti që të jetë fjala për veprimin e Frymës (krh. v. 27; NEB, REB).

▣ **“të bashkëpunojnë për të mirë”** Kjo është E TASHME VEPRORE DËFTORE. Është një tjetër fjalë e përbërë me *syn* (krh. v. 26). Prandaj, ajo fjalë për fjalë ka kuptimin “të gjitha gjërat vazhdojnë të punojnë në bashkëveprim me njëra-tjetrën për të mirë.” Ky është një koncept i vështirë në një botë të së keqes dhe vuajtjes (dy libra ndihmues mbi këtë temë janë *The Goodness of God* nga Wenham dhe Hannah Whithall Smith, *The Christian’s Secret of a Happy Life*). “E mira” këtu përkufizohet në v. 29 si “konformuar me imazhin e Birit të Tij.” Plani i pandryshueshëm i Perëndisë për çdo besimtar është ngjashmëria me Krishtin, dhe jo mirëqenia, fama apo shëndeti.

▣ **“për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë thirrur sipas qëllimit të Tij”** Këto janë dy PJESORE TË TASHME VEPRORE. Këta janë dy kushte që vazhdojnë ta lejojnë besimtarin ta shikojë jetën në një dritë pozitive, pavarësisht rrethanave (krh. v. 15). Përsëri vini re dy aspektet binjake të besëlidhjeve: liria njerëzore (“duan”) dhe sovraniteti i Perëndisë (“thirrur”).

Termi “qëllim” në lidhje me planet e përjetshme të Perëndisë gjendet te Rom. 9:11; Efe. 1:11; 3:11; dhe II Tim. 1:9. Perëndia ka një plan shpengues për njerëzimin e rënë. Shih Temën e Veçantë: Anësitë ungjillore të Bobit te 1:5.

8:29-30 FOLJET në këto vargje janë të gjitha AORISTE VEPRORE DËFTORE. Ato formojnë një zinxhir që nga përpara kohës e deri sa koha të mos jetë më. Perëndia na njeh dhe është ende në anën tonë dhe dëshiron që ne të jemi me Të. Ky është një kontekst i përbashkët/kolektiv, jo individual. Akti final i përlëvdimit është ende i ardhshëm, por në këtë kontekst shprehet si një ngjarje e përfunduar.

8:29 “paranjohu” Pali e përdor këtë term dy herë, këtu edhe në 11:2. Në 11:2 ai i referohej dashurisë besëlidhore të Perëndisë për Izraelin përpara kohërave. Mbani mend që termi “njoh” në hebraisht kishte kuptimin e një marrëdhënieje të ngushtë, personale, jo të dijenisë së fakteve në lidhje me dikë (krh. Zan. 4:1; Jer. 1:5). Këtu ai është përfshirë në një zinxhir ngjarjesh (krh. vv. 29-30). Ky term është i lidhur me paracaktimin. Megjithatë, duhet thënë se paranjohja e Perëndisë nuk është baza e zgjedhjes, sepse po të ishte kështu, atëherë zgjedhja do të bazohej në reagimin e ardhshëm të njerëzimit të rënë, që do të ishte performancë njerëzore. Ky term gjendet gjithashtu edhe në Vep. 26:5; I Pjet. 1:2,20 dhe II Pjet. 3:17.

▣ **“paracaktioi”** Termit “paranjoh” (*proginōskō*) apo “paracaktioj” (*proorizō*) janë të dy fjalë të përbëra me PARAFJALËN “përpara” (*pro*) dhe prandaj duhen përkthyer “të njohësh që përpara,” “të caktosh kufijtë që përpara,” ose “të shënosh që përpara.”

Pasazhet e padiskutueshme mbi paracaktimin në DHR janë Rom. 8:28-30; Efe. 1:3-14 dhe Romakëve 9. Këta tekste qartësisht theksojnë se Perëndia është sovran. Ai është në kontroll të plotë të të gjitha gjërave, duke përfshirë këtu edhe historinë njerëzore. Ka një plan shpengimi të hartuar qysh përpara, i cili po zbatohet në kohë. Megjithatë, ky plan nuk është arbitrar apo përzgjedhës. Ai bazohet jo vetëm në sovranitetin dhe paranjohjen e Perëndisë, por edhe në karakterin e Tij të pandryshueshëm të dashurisë, mëshirës dhe hirit të pamerituar.

Ne duhet të kemi kujdes nga individualizmi ynë perëndimor (amerikan) dhe nga zelli ynë ungjillor që e ngjyros këtë të vërtetë të mrekullueshme. Ne duhet të ruhem edhe nga polarizimi në konfliktet historike dhe teologjike midis Augustinit dhe Pelagiusit apo Kalvinizmit dhe Arminianizmit.

Paracaktimi nuk është një doktrinë që ka si synim kufizimin e dashurisë, hirit dhe mëshirës së Perëndisë, dhe as të përjashtojë disa nga ungjilli. Ajo ka si synim t’i forcojë besimtarët duke i dhënë formë botëkuptimit të tyre. Perëndia është në favor të të gjithë njerëzimit (krh. Gjoni 3:16; I Tim. 2:4; II Pjet. 3:9). Perëndia është në kontroll të të gjitha gjërave. Kush apo çfarë mund të na ndajë nga Ai (krh. Rom. 8:31-39)? Paracaktimi formon një nga dy mënyrat për ta parë jetën. Perëndia e shikon të gjithë historinë si të tashme; njerëzit janë të kufizuar në kohë. Këndvështrimi dhe aftësitë tona mendore janë të kufizuara. Nuk ka kontradiktë mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë të njeriut. Kjo është një strukturë besëlidhore. Ky është një tjetër shembull i dhënies së të vërtetës biblike në formën e një tensioni dialektik (shih Temën e Veçantë: Literatura Lindore në 3:27). Doktrinën biblike prezantohen zakonisht nga këndvështrime të ndryshme. Ato shpesh duken paradoksale. E vërteta është një

ekuilibër midis çifteve në dukje të kundërta. Ne nuk duhet ta heqim tensionin duke zgjedhur njëren nga të vërtetat. Ne nuk duhet të izolojmë asnjë të vërtetë biblike në një sistem teologjik të palidhur me një kontekst specifik.

Është gjithashtu e rëndësishme të shtojmë se synimi i zgjedhjes nuk është vetëm parajsja kur të vdesim, por edhe ngjashmëria me Krishtin tani (krh. Efe. 1:4; 2:10)! Ne u zgjodhëm për të qenë “të shenjtë dhe të panjollë.” Perëndia zgjedh të na ndryshojë në mënyrë që të tjerët të mund të shohin ndryshimin dhe të reagojnë me besim ndaj Tij në Krishtin. Paracaktimi nuk është një privilegj personal, por një përgjegjësi besëlidhore!

■ **“për t’u konformuar me imazhin e Birit të Tij”** Kjo është një e vërtetë madhore e këtij pasazhi. Ky është synimi i krishtërimin (krh. 8:9; II Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 2:10; 4:13; I Thes. 3:13; 4:3; I Pjet. 1:15). Shenjtëria është vullneti i Perëndisë për çdo besimtar. Zgjedhja e Perëndisë është për ngjashmëri me Krishtin (krh. Efe. 1:4), jo një pozitë e veçantë. Imazhi i Perëndisë që iu dha njerëzimit në krijim (krh. Zan. 1:26; 5:1,3; 9:6) duhet restauruar/rikthyer (krh. Kol. 3:10). Shih shënimin në 8:21 dhe Temën e Veçantë: Të thirrur në 1:6.

■ **“që Ai të mund të ishte i parëlinduri midis shumë vëllezërve”** Te Psalmi 89:27 “i parëlindur” është një titull për Mesian. Në DHV biri i parëlindur kishte përparësinë dhe privilegjin. Termi është përdorur te Kol. 1:15 për të treguar përparësinë e Jezusit në krijim dhe te Kol. 1:18 dhe Zbu. 1:5 për të treguar përparësinë në ringjallje. Në këtë tekst besimtarët sillen prej Tij në përparësinë e Tij!

Ky term nuk i referohet mishërimit të Jezusit, por Atij si kreu i një race të re (krh. 5:12-21), i pari në një rradhë, udhëçelësi i besimit tonë, kanali i bekimit të Atit për familjen e besimit! Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: I PARËLINDURI

Kjo fjalë “i parëlinduri” (*prōtotokos*) përdoret në Bibël në disa kuptime të dallueshme.

1. Sfondi i saj i DHV i referohet përparësisë së djalit të parëlindur të familjes (krh. Ps. 89:27; Luka 2:7; Rom. 8:29; Heb. 11:28)
2. Përdorimi i saj te Kol. 1:15 flet për Jezusin si të parin e krijimit që është një aluzion i mundshëm nga DHV te Fja. 8:22-31, ose agjenti i krijimit i Perëndisë (krh. Gjoni 1:3; I Kor. 8:6; Kol. 1:15-16; Heb. 1:2)
3. Përdorimi i saj te Kol. 1:18; I Kor. 15:20 (dhe këtu) i referohet Jezusit si i parëlinduri nga të vdekurit
4. Ai është një titull i DHV i përdorur për Mesian (krh. Ps. 89:27; Heb. 1:6; 12:23). Është një titull që bashkon disa aspekte të parësisë dhe pozicionit qendror të Jezusit. Në këtë kontekst #3 ose #4 përshtatet më mirë.

8:30 “përlëvdoi” Perëndia shpesh përshkruhet në Bibël me anë të termit “lavdi.” Ky term vinte nga një fjalë tregtare që kishte kuptimin “i rëndë” dhe si rrjedhojë, i çmuar, si ari. Shih Temën e Veçantë në 3:23. Teologjikisht Perëndia po e shpengon njerëzimin e rënë përmes një sërë hapash të listuar në vv. 29-30. Hapi i fundi është “përlëvdimi.” Ky do të jetë shpëtimi i plotë i besimtarëve. Ai do të ndodhë në Ditën e Ringjalljes kur atyre t’u jepen trupat e rinj frymërorë (krh. I Kor. 15:50-58) dhe të bashkohen plotësisht me Perëndinë Triun dhe njëri-tjetrin (krh. I Thes. 4:13-18; I Gjoni 3:2).

Shpesh procesi i përmendur në vv. 29-30 vendoset në kategori teologjike.

1. shfajësimi, v. 30 – të çliruar nga ndëshkimi i mëkatit (birësimi, trashëgimtarë, vv. 16-17)
2. shenjtërimi (d.m.th., “të konformuar me imazhin e Birit të Tij”), v. 29 – të çliruar nga pushteti i mëkatit (të jetuarit në ngjashmëri me Krishtin)
3. përlëvdimi, v. 30 – të çliruar nga prania e mëkatit (d.m.th., qielli/parajsja)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 8:31-39

³¹Çfarë të themi atëherë në lidhje me këto gjëra? Nëse Perëndia është në anën tonë, kush është kundër nesh? ³²Ai që nuk kurseu Birin e Vet, por e dha për ne të gjithë, si nuk do të na japë bashkë me Të lirisht edhe të gjitha gjërat? ³³Kush do t’i akuzojë të zgjedhurit e Perëndisë? Perëndia është Ai që shfajëson; ³⁴kush është ai që dënon? Krishti Jezus është Ai që vdiq, po, ose më mirë që u ringjall, i Cili është në të djathtën e Perëndisë, që gjithashtu ndërmerjetëson për ne. ³⁵Kush do të na ndajë ne nga dashuria e Krishtit? Vallë mundimi, apo vështirësia, apo përndjekja, apo uria, apo të zhveshurit, apo rreziku, apo

shpata? ³⁶Ashtu siç është shkruar, “PËR HIRIN TËND NE PO VRITEMI GJITHË DITËN; U KONSIDERUAM SI DELE PËR T’U THERUR.” ³⁷Por në të gjitha këto gjëra ne fitojmë me tepri përmes Atij që na deshi. ³⁸Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta, as engjëjt, as principatat, as gjërat e tashme, as gjërat që do të vijnë, as pushtetet, ³⁹as lartësia, as thellësia, as ndonjë gjë tjetër e krijuar, nuk do të mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë, që është në Krishtin Jezus Zotin tonë.

8:31 “Çfarë të themi atëherë në lidhje me këto gjëra” Kjo ishte një frazë e preferuar e Palit që reflekton formën e tij të prezantimit si diatrib (krh. 3:5; 4:1; 6:1; 7:7; 9:14,30). Kjo pyetje lidhet me të vërtetat e dhëna më parë. Është e paqartë se sa larg e ka referencën. Mund t’i referohet 3:21-31 ose 8:1 ose 8:18. Për shkak të përdorimit të “prandaj” në 8:1 dhe kontekstit, 8:18 është ndoshta një mundësi e mirë.

■ **“Nëse”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që merret si e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Është mahnitëse që në mes të të gjitha luftërave tona me mëkatën, Perëndia është në anën tonë!

■ **“kush është kundër nesh”** PËREMRI “kush” përsëritet në vv. 33,34,35. Ai i referohet Satanit (i cili nuk përmendet me emër deri në 16:20). Ky paragraf, nga 31-39, po përdor teknikën letrare të DHV të Profetëve, një rast gjyqësor (krh. Mikea 1, 6). YHWH e çon popullin e Tij në gjyq për kurorëshkelje frymërore. Është një aluzion ndaj Isa. 50:8-9.

Vini re termat ligjorë: “kundër,” v. 31; “akuzojë,” v. 33; “shfajëson,” v. 33; “dënon,” v. 34; dhe “ndërmjetëson,” v. 34. Perëndia është Gjykatësi. Krishti është avokati mbrojtës. Satani është prokurori i akuzës (por ai është i heshtur). Engjëjt e mbushin dhomën e gjyqit si vëzhgues (krh. I Kor. 4:9; Efe. 2:7; 3:10).

8:32 “Ai që nuk kurseu Birin e Vet” Perëndia Atë i ka dhënë njerëzimit të rënë më të mirën e Tij. Ai nuk do t’i lërë besimtarët tani, dhe as do t’iu japë më pak (krh. Gjoni 3:16; Rom. 5:8). Sa larg realitetit është koncepti që Perëndia i DHV është hakmarrës dhe vetëm Jezusi është i dashur! Kjo dhuratë kaq e madhe reflektohet në atë që Perëndia i tha Abrahamit në Zan. 22:12, 16. Rabinët e përdornin këtë pasazh nga DHV për të mbështetur doktrinën e shlyerjes zëvendësuese për farën e Abrahamit.

■ **“por e dha për ne të gjithë”** Fjala “të gjithë” në këtë tekst është e rëndësishme. Jezusi vdiq për mëkatet e botës (krh. Luka 2:10-11; Gjoni 3:16; 4:42; 11:51; I Tim. 4:10; I Gjoni 2:2; 4:14). Kjo reflekton tipologjinë Adam-Krisht të 5:12-21. Vdekja e Jezusit e zgjidhi problemin e mëkatit. Tani ai është një problem “beso dhe prano”.

■ **“lirisht të na japë të gjitha gjërat”** Kjo FOLJE është nga një rrënjë greke për hirin. “Të gjitha gjërat” i referohet v. 17. Shih shënimin te 3:24.

8:33-34 “akuzojë. . shfajëson. . dënon. . ndërmjetëson” Këta janë të gjithë terma ligjorë. Vargjet 31-39 janë një skenë gjyqi në qiell. Kjo mund të jetë një aluzion ndaj Isaias 50:8-9.

8:33 “të zgjedhurit e Perëndisë” Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë për të gjithë njerëzit (Barth). Pasazhet më të qarta dhe më të plota mbi këtë të vërtetë në DHR janë Efe. 1:3-4 dhe Rom. 9:14-26. Ati zgjodhi Jezusin për të zgjedhur gjithë njerëzimin. Jezusi është “po-ja” e Perëndisë për “jo!-në” e njerëzimit të rënë.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhiatën e Vjetër, kjo fjalë përdorej pikësëpari për shërbesë; në Dhiatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovranë të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në Të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e

njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte një yll i përkundërt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të të vërtetave doktrinale:

1. Paracaktimi kundërt vullnetit të lirë njerëzor
2. Siguria e besimtarëve përkundërt nevojës për qëndresë
3. Mëkati fillestar përkundër mëkatit të vullnetshëm
4. Mungesa e mëkatit (“përsosmëria”) kundërt mëkatimit më pak
5. Shfajësimi dhe shenjtërimi i atypëratyshëm fillestar dhe shenjtërimi i përshkallëzuar
6. Liria e krishterë përkundërt përgjegjësisë së krishterë
7. Transcendenca e Perëndisë kundërt imanencës së Perëndisë
8. Perëndia si i panjohshëm në mënyrë absolute përkundërt Perëndisë si i njohshëm në Shkrimet
9. Mbretëria e Perëndisë si e tashme përkundërt përmbushjes së ardhshme
10. Pendimi si dhuratë e Perëndisë kundërt pendimit si reagim i domosdoshëm njerëzor ndaj besëlidhjes
11. Jezusi si hyjnor kundërt Jezusit si njerëzor
12. Jezusi është i barabartë me Atin kundërt Jezusit si i nënshtuar ndaj Atit

Koncepti teologjik i “besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë Ai që merr iniciativën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat 3:16, 19; 20:21). Ruhë që të mos e përdorësh vargje “provë” për një rënë anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën, ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

8:34 Ky varg liston një sërë arsyes pse nuk ka “asnjë dënim” (krh. v. 1).

1. Ai vdiq
2. Ai u ringjall
3. Ai është në të djathtë të Perëndisë
4. Ai ndërmjetëson për besimtarët

Vdekja e Jezusit pagoi dënimin për mëkatin tonë (krh. Isaia 53; Marku 10:45; II Kor. 5:21). Ringjallja e Jezusit tregon se Ati e pranoi shërbesën e Birit dhe jep shpresë (fryti i parë i atyre që kanë fjetur) përballë përndjekjes dhe vdekjes. Përlëvdimi i Jezusit në të djathtë të Atit dhe ndërmjetësimi i Tij për besimtarët u jep atyre guxim për të luftuar luftën e mirë të besimit.

■ **“në të djathtë të Perëndisë”** Kjo është një metaforë antropomorfike (shih Temën e Veçantë në 1:18). Perëndia nuk ka trup fizik. Ai është “frymë.” Kjo metaforë flet për pozitën e fuqisë, pushtetit dhe parësisë. Pali nuk e përdor shpesh këtë shprehje (krh. Efe. 1:20; Kol. 3:1). Pali mund të ketë cituar ndonjë kredo/besore të hershme të krishterë në v. 34 (krh. Fil. 2:6ff.; I Tim. 3:16).

■ **“ndërmjetëson”** Shërbesa e Jezusit vazhdon. Jezusi ndërmjetëson për ne (krh. Heb. 4:4-16; 7:25; 9:24; I Gjoni 2:1) ashtu si edhe Fryma (vv. 26-27). Kjo është nga termi *paraklet*, që përdoret për Frymën te Gjoni 14:16 dhe për Birin te I Gjoni 2:1. Ky është një tjetër aluzion ndaj këngës së shërbëtorit të vuajtur (krh. Isa. 53:12).

8:35 “dashuria e Krishtit” Kjo është GJINORE ose KRYEFJALORE, ose KUNDRINORE. Ajo mund të jetë ose (1) dashuria e Krishtit për besimtarët, ose (2) dashuria e besimtarëve për Krishtin. Numri 1 përshtatet më mirë në këtë kontekst (dhe II Kor. 5:14) sepse dashuria e besimtarëve për Krishtin vjen e ikën, por dashuria e Krishtit për ne është e sigurt dhe e qëndrueshme.

Ka një variant në dorëshkrimet në greqisht në lidhje me këtë frazë.

1. Një tekst i vjetër në greqisht e ka “dashuria e Perëndisë” (krh. MS X).
2. Një dorëshkrim i vjetër i kombinon ato së bashku, “dashuria e Perëndisë në Krishtin” (krh. MS B).
3. Hartuesit e UBS⁴ i japin “dashuria e Krishtit” një vlerësim “A” (të sigurt). Ajo del në MSS C, D, F, G, dhe pjesën më të madhe të versioneve në latinishten e vjetër dhe në Vulgatë dhe Peshitta.

■ **“Vallë mundimi, apo vështirësia, apo përndjekja”** Të krishterët do të kenë probleme në këtë botë, por as këto probleme, as fuqitë e këqija nuk mund t’i ndajnë ata nga Perëndia. Shih Temën e Veçantë: Mundimet te 5:3.

8:36 Ky është një citim nga Ps. 44:22. Në këtë Psalm Perëndia thirret për t’i dhënë çlirim popullit të Tij të lënduar.

8:37

NASB “Por në të gjitha këto gjëra ne fitojmë me tepri”
NKJV “Megjithatë në të gjitha këto gjëra ne jemi më shumë sesa fitimtarë”
NRSV “Jo, në të gjitha këto gjëra ne jemi më shumë sesa fitimtarë”
TEV “Jo, në të gjitha këto gjëra ne kemi fitore të plotë përmes tij”
NJB “këto janë prova përmes të cilave ne triumfojmë”

Kjo ishte një formë e intensifikuar e termit “fitoj.” Pali duhet ta ketë krijuar vetë këtë term (*huper + nikaō*). Kjo është një metaforë e mrekullueshme e përzier, “dele fitimtare.” Besimtarët janë fitimtarë përmes Krishtit (krh. Gjoni 16:33; I Gjoni 2:13-14; 4:4; 5:4). Shih Temën e Veçantë: Përdorimi nga ana e Palit e fjalëve të përbëra me *Huper* te 1:30.

■ **“përmes Atij që na deshi”** Ky PËREMËR mund t’i referohet Atit ose Birit.

8:38 “unë jam i bindur” Kjo është një E KRYER PËSORE DËFTORE, që ka kuptimin “kam qenë dhe vazhdoj të jem i bindur.”

■ **“engjëjt”** Rabinët mendonin se engjëjt ishin xhelozë për dashurinë dhe vëmendjen e Perëndisë ndaj njerëzimit dhe, prandaj, ishin armiqësorë ndaj tyre. Mësuesit e rremë gnostikë pohonin se shpëtimi ishte i disponueshëm vetëm me anë fjalëkalimesh të fshehta përmes sferave armiqësore engjëllore *eone* (krh. Kolosianëve dhe Efesianëve).

George Eldon Ladd ka një përmbledhje të mirë të termave të përdorur nga Pali për engjëjt në librin e tij *A Theology of the New Testament*:

“Pali nuk u referohet vetëm engjëjve të mirë dhe të këqij, Satanit dhe demonëve; ai përdor një tjetër grup fjalësh për të përshkruar rangje të frymërave engjëllore. Terminologjia është si më poshtë:

‘Sundues’ [*arche*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21; Kol. 2:10

‘Sundues’ (shumës) [*archai*; RSV, “principata’], Efe. 3:10; 6:12; Kol. 1:16; 2:15; Rom. 8:38

‘Autoritet’ [*exousia*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21; Kol. 2:10

‘Autoritete’ [*exousiai*; RSV, “autoritete”], Efe. 3:10; 6:12; Kol. 1:16; 2:15

‘Fuqi’ [*dynamis*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21

‘Fuqi’ (shumës) [*dynameis*], Rom. 8:38

‘Frone’ [*thronoi*], Kol. 1:16

‘Zotërim’ [*kyriotes*; RSV, “zotërim”], Efe. 1:21

‘Zotërim’ [*kyriotetes*], Kol. 1:16

‘Sunduesit e botës së kësaj errësire,’ Efe. 6:12

‘(Ushtritë) frymërore të së keqes në qielloret,’ Efe. 6:12

‘Autoriteti i errësirës,’ Kol. 1:13

‘Çdo emër që përmendet,’ Efe. 1:21

‘Qeniet qiellore, tokësore dhe nëntokësore,’ Fil. 2:10” (fq. 401).

Nuk ka informacion të drejtpërdrejtë biblik në lidhje me mënyrën si lidhen engjëjt e rënë të DHV me demonët e DHR. Shumë njerëz e marrin të mirëqenë që ata janë identikë. Në literaturën apokaliptike hebreje, megjithatë, demonët janë frymërat e Nefilimëve të Zanafillës 6, që ishin gjysmë engjëj dhe gjysmë njerëz. Trupat e tyre u shkatërruan në përmytje, dhe prandaj ata kërkojnë të trupëzohen! Ky është vetëm hamendësim. Bibla nuk u përgjigjet të gjitha pyetjeve tona për origjinat. Qëllimi i saj është shpengimi i njerëzve, jo kurioziteti i tyre!

■ **“principatat. . . pushtetet”** Kjo i referohet (1) forcave të këqija engjëllore ose demonike të kësaj epoke (krh. Efe. 2:2; 6:12; I Kor. 15:24; Kol. 1:16) ose (2) ka mundësi strukturave jopersonale të botës së rënë (feja, qeveria, arsimit, mjekësia, etj.) që e lejojnë njerëzimin e rënë të jetë i pavarur nga Perëndia (krh. Hendrickus Berkhoff, *Principalities dhe Powers*). Shih shënimin te 13:1.

TEMË E VEÇANTË: ARCHË

Termi “zotërim” është fjala greke *archē*, që do të thotë “fillimi” ose “origjina” e diçkaje.

1. fillimi i rendit të krijuar (shih Gjoni 1:1; 1 Gjonit 1:1; Heb. 1:10)
2. fillimi i ungjillit (shih Marku 1:1; Fil. 4:15; 2 Thes. 2:13; Heb. 2:3)
3. dëshmitarët e parë (shih Luka 1:2)
4. shenjat e fillimit (mrekullitë, shih Gjoni 2:11)
5. parimet fillestare (shih Heb. 5:12)
6. siguria fillestare, bazuar në të vërtetat e ungjillit (shih Heb. 3:14)
7. fillimi (Kol. 1:18; Zbu. 3:14)

Më vonë, u përdor për “sundimin”, ose “autoritetin”

1. për zyrtarët qeveritarë njerëzorë
 - a. Luka 12:11
 - b. Luka 20:20
 - c. Romakëve 13:3; Titi 3:1
2. për autoritetet engjëjlore
 - a. Romakëve 8:38
 - b. 1 Kor. 15:24
 - c. Efe. 1:21; 3:10; 6:12
 - d. Kol. 1:16; 2:10, 15
 - e. Juda 6

Këta mësues të rremë përçmojnë çdo autoritet, tokësor dhe qiellorë qoftë. Ata janë njerëz të shturur antinomianë⁴. Ata vendosin veten dhe dëshirat e tyre përpara Perëndisë, engjëjve, autoriteteve civile dhe drejtuesve të kishave.

8:39 “Iartësia as thellësia” Këta terma përdoren për apogjeun dhe perigjeun e yjeve, që besoheshin se ishin perëndi që kontrollonin jetët e njerëzve (astrologjia). Më vonë ata u bënë terma teknikë në herezinë e quajtur Gnosticizëm për *eonet* ose nivelet engjëjlore midis perëndisë së shenjtë dhe perëndisë më të vogël që krijoi materien mëkatore.

▣ **“ndonjë tjetër gjë e krijuar”** Kjo është fjalë për fjalë “krijesë e një lloji tjetër” (*heteros*). Konteksti kërkon që kjo të jetë një referencë tjetër ndaj fuqive engjëjlore. Dallimi midis PARAFJALËS greke *heteros*, një tjetër i një lloji tjetër, dhe *allos*, një tjetër i të njëjtit lloj, ishte duke u shuar në Greqishten Koine, por ky kontekst ende tregon një farë dallimi.

▣ **“as. . as. . nuk do të mund të na ndajnë nga dashuria e Perëndisë”** Çfarë deklaratë madhështore sigurie! Ky kapitull nis me asnjë dënim dhe përfundon me asnjë ndarje. Askush nuk mund t’ia marrë shpëtimin besimitarit. Megjithatë, ai duhet të përgjigjet edhe në fillim (krh. 3:21-31), edhe vazhdimisht (krh. kapitujt 4-8). Fryma është çelësi, por ka një reagim besëlidhor të kushtëzuar që është i detyrueshëm. Pendimi dhe besimi janë të domosdoshëm (krh. Marku 1:15; Veprat 3:16,19; 20:21), e po ashtu edhe bindja dhe këmbëngulja!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

⁴Antinomian është dikush që beson (në mënyrë jobiblike, dhe vepron sikur) hiri e ka çliruar nga çdo detyrim për të zbatuar ligjin moral. (Shën i përkth)

1. Si lidhet kapitulli 8 me kapitullin 7?
2. Nëse nuk ka asnjë dënim, si ndikon mëkati në jetën e besimtarit?
3. Kush i brendabanon besimtarët, Fryma, apo Jezusi (v. 9)?
4. Si u ndikua natyra nga mëkati i njeriut (vv. 19-22)? A do të jetë natyra pjesë e qiellit/parajsës (krh. Isa. 11:6-10)?
5. Si lutet Fryma për ne (vv. 26-27)? A është fjala këtu për “të folurit në gjuhë”?
6. Si mund të thotë Bibla që të gjitha gjërat veprojnë për të mirë në një botë kaq të keqe (v. 28)? Përkufizoni “të mirën” (v.29).
7. Pse është lënë shenjtërimi jashtë zinxhirit të ngjarjeve teologjike në v. 30?
8. Pse thuhet se vv. 31-39 janë një skenë gjyqi?
9. Listo katër gjërat që thotë vargu 34 për Jezusin.

ROMAKËVE 9

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Zgjedhja e Perëndisë	Hedhja poshtë e Krishtit nga Izraeli	Problemi i mosbesimit të Izraelit	Perëndia dhe populli i Tij	Privilegjet e Izraelit
9:1-5	9:1-5	9:1-5	9:1-5	9:1-5
	Hedhja poshtë e Izraelit dhe qëllimi i Perëndisë	Premtimi i Perëndisë ndaj Izraelit nuk ka rënë poshtë		Perëndia e ka mbajtur premtimin e Tij
9:6-13	9:6-13	9:6-13	9:6-9 9:10-13	9:6-13
	Hedhja poshtë e Izraelit dhe drejtësia e Perëndisë	E drejta e Perëndisë për të zgjedhur		Perëndia nuk është i padrejtë
9:14-18	9:14-29	9:14-18	9:14-18	9:14-18
Zemërimi dhe mëshira e Perëndisë			Zemërimi dhe mëshira e Perëndisë	
9:19-29		9:19-26	9:19-21 9:22-29	9:19-21 9:22-24 Gjithçka është parathënë në DHV 9:25-29
		9:27-29		
Izraeli dhe ungjilli	Gjendja e tashme e Izraelit	Drejtësia e vërtetë është me anë të besimit	Izraeli dhe ungjilli	
9:30-10:4	9:30-33	9:30-10:4	9:30-10:4	9:30-33

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

- A.Paragrafi i parë
- B.Paragrafi i dytë
- C.Paragrafi i tretë
- D.Etj.

LIDHJA E KAPITUJVE 9-11 ME KAPITUJT 1-8

- A. Ka patur dy mënyra për ta kuptuar marrëdhënien e kësaj njësie letrare me kapitujt 1-8.
1. Është një temë krejt e veçuar, një parantezë teologjike
 - a. Ka një kontrast drastik dhe mungesë lidhjeje logjike midis 8:39 dhe 9:1.
 - b. Është e lidhur drejtpërdrejt me tensionin historik në kishën e Romës midis hebrenjve besimtarë dhe johebrenjve besimtarë. Kjo ka mundësi që ishte e lidhur me rritjen e udhëheqësisë johebrenje në Kishë.
 - c. Kishte keqkuptim në lidhje me predikimin e Palit në lidhje me Izraelin (dhe Ligjin) dhe apostullimin e tij ndaj johebrenjve (oferta e hirit falas), prandaj, ai merret me këtë temë në këtë seksion.
 2. Është kulmi dhe përfundimi logjik i prezantimit të ungjillit nga Pali.
 - a. Pali e mbyll kapitullin 8 me premtimin që “asgjë nuk do ta na ndajë nga dashuria e Perëndisë.” Po mosbesimi i popullit të besëlidhjes?
 - b. Romakëve 9-11 i përgjigjet paradoksit të ungjillit në lidhje me mosbesimin e Izraelit!
 - c. Pali i është adresuar kësaj çështjeje gjatë gjithë letrës (krh. 1:3,16; 3:21,31 dhe 4:1ff).
 - d. Pali shpall se Perëndia i qëndron Fjalës së Tij. Po fjalës së Tij në DHV ndaj Izraelit? A janë zhvlerësuar ato premtime?
- B. Ka disa mënyra për ta përvijuar këtë njësi letrare
1. Me anë të përdorimit nga ana e Palit të një kundërshtari imagjinar (diatrib)
 - a. 9:6
 - b. 9:14
 - c. 9:19
 - d. 9:30
 - e. 11:1
 - f. 11:11
 2. Romakëve 9-11 formon një njësi letrare (ndarjet në kapituj dhe vargje nuk janë të frymëzuara dhe u shtuan më vonë). Ajo duhet interpretuar së bashku si një e tërë. Megjithatë, ka të paktën tri ndarje madhore tematike.
 - a. 9:1-29 (fokusohet në sovranitetin e Perëndisë)
 - b. 9:30-10:21 (fokusohet në përgjegjësinë njerëzore)
 - c. 11:1-32 (qëllimi shpengues, i përjetshëm, përfshirës i Perëndisë)
 3. Me anë të temave kryesore: një përvijim i mirë i këtij seksioni te Romakëve gjendet në ndarjet në paragrafe të NKJV nga Thomas Nelson Publishers
 - a. Hedhja poshtë e Krishtit nga Izraeli, 9:1-5
 - b. Hedhja poshtë e qëllimit të Perëndisë nga Izraeli, 9:6-13
 - c. Hedhja poshtë e drejtësisë së Perëndisë nga Izraeli, 9:14-29
 - d. Gjendja e tanishme e Izraelit, 9:30-33
 - e. Izraeli dhe ungjilli, 10:1-13
 - f. Hedhja poshtë e ungjillit nga Izraeli, 10:14-21
 - g. Hedhja poshtë e Izraelit jo totale, 11:1-10
 - h. Hedhja poshtë e Izraelit jo finale, 11:11-36
- C. Ky seksion është po aq një thirrje nga zemra sa është edhe një paraqitje nga mendja (përvijim logjik). Pasioni i kësaj pjese të kujton zemrën e thyer të Perëndisë për Izraelin rebel te Osea 11:1-4,8-9.
Në shumë mënyra dhimbja dhe mirësia e Ligjit në kapitullin 7 barazohen në kapitujt 9-10.
Në të dy rastet, zemra e Palit po thyhej nga ironia e faktit që një ligj nga Perëndia sollli vdekje në vend të jetës!
- D. Përdorimi nga ana e Palit e mbi 25 citimeve nga DHV në kapitujt 9-11 tregon dëshirën e tij për ta ilustruar paradoksin e Izraelit nga burime të DHV, ashtu siç bëri në kapitullin 4, jo thjesht nga përvoja aktuale. Pjesa më e madhe e pasardhësve fizikë të Abrahamit e kishin hedhur poshtë Perëndinë, edhe në të kaluarën (krh. Veprat 7; Nehemia 9).
- E. Ky tekst, si Efe. 1:3-14, merret me qëllimet e përjetshme të Perëndisë për shpengimin e gjithë njerëzimit. Në fillim duket sikur përshkruan Perëndinë duke zgjedhur disa individë dhe duke hedhur poshtë disa të tjerë (Kalvinizëm supralapsarian), megjithatë, mendoj se fokusi nuk është mbi individët, por mbi planin e

përjetshëm të Perëndisë për shpengimin (krh. Zan. 3:15; 12:3; Veprat 2:23; 3:18; 4:28; dhe 13:29, shih Temën e Veçantë në 8:28).

The Jerome Biblical Commentary, vëll. 2, “The New Testament,” (“Dhiata e Re”) redaktuar nga Joseph A. Fitzmyer dhe Raymond E. Brown, thotë:

“Është e rëndësishme të kuptojnë që nga filimi se perspektiva e Palit është kolektive; ai nuk po diskuton përgjegjësinë e individëve. Nëse duket sikur ngre çështjen e paracaktimit hyjnor, kjo nuk ka lidhje fare me paracaktimin e individëve për në lavdi” (fq. 318).

TË DHËNA KONTEKSTUALE MBI KAPITULLIN 9

- A. Çfarë ndryshim drastik qëndrimi ndodh midis kapitullit 8 dhe kapitullit 9.
- B. Kjo njësi letrare (9-11) trajton teologjikisht
1. Bazën e shpëtimit
 2. Qëllimin e Perëndisë për zgjedhjen
 3. Pabesinë e Izraelit mosbesues përkundër besnikërisë së YHWH
 4. Përfshirjen e gjithë njerëzimit në shpengimin e Jezusit
- C. Kapitulli 9 është një nga pasazhet më të forta të DHR mbi sovranitetin e Perëndisë (d.m.th., të qenies tjetër, Efe. 1:3-14) ndërsa kapitulli 10 shpall qartë dhe në mënyrë të përsëritur vullnetin e lirë njerëzor (krh. “çdo njeri” v. 4; “kushdo” vv. 11,13; “të gjithë” v. 12 [dy herë]). Pali asnjëherë nuk përpiqet ta pajtojë këtë tension teologjik. Ato janë të dyja të vërteta! Pjesa më e madhe e doktrinave biblike paraqiten në çifte paradoksale ose dialektike. Pjesa më e madhe e sistemeve teologjike janë logjike, por marrin vargje që mbështesin vetëm njërin aspekt të së vërtetës biblike. Edhe Augustinianizmi, edhe Calvinizmi përkundër semi-Pelagianizmit dhe Arminianizmit kanë elemente të vërtete dhe gabimi. Tensioni biblik midis doktrinave është i preferueshëm ndaj një sistemi teologjik të njëanshëm, dogmatik dhe racional që e fut Biblën me forcë përmes një site interpretuese të paramenduar! Shih Temën e Veçantë: Literatura lindore në 3:27.
- D. 9:30-33 është një përmbledhje e kapitullit 9 dhe lajtmotivi i kapitullit 10.
- E. Vini re sa shumë përdor Pali tekste të DHV për të përforcuar argumentin e tij. Kjo presupozon lexues hebrej në Romë.
1. v. 7 – Zan. 21:12
 2. v. 9 – Zan. 18:10,14
 3. v. 12 – Zan. 25:32
 4. v. 13 – Mal. 1:2-3
 5. v. 15 – Eks. 33:19
 6. v. 17 – Eks. 9:16
 7. v. 25 – Osea 2:23
 8. v. 26 – Osea 1:10
 9. v. 27 – Isa. 10:22
 10. v. 28 – Isa. 10:23
 11. v. 29 – Isa. 1:9
 12. v. 33 – Isa. 28:16 dhe 8:14
- Ka edhe shumë citime të tjera nga DHV në kapitujt 9 dhe 11!

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:1-5

¹Po them të vërtetën në Krishtin, nuk po gënjej, ndërgjegjia ime dëshmon me mua në Frymën e Shenjtë, ²që kam një trishtim të madh dhe hidhërim të vazhdueshëm në zemrën time. ³Sepse mund të dëshiroja që

unë vetë të isha i mallkuar, i ndarë nga Krishti për hir të vëllezërve të mi, të afërmve të mi sipas mishit, ⁴që janë Izraelitë, të cilëve u përket adoptimi si bij, dhe lavdia dhe besëlidhjet dhe dhënia e Ligjit dhe shërbimi i tempullit dhe premtimet, ⁵të të cilëve janë etërit dhe nga të cilët është Krishti sipas mishit, që është mbi të gjithë, Perëndi i bekuar përjetë. Amen.

9:1-2 Vargjet 1 dhe 2 formojnë një fjali në greqisht. Pali është duke dhënë disa arsye se si ata (kisha në Romë) mund ta dinte se ai po thoshte të vërtetën.

1. Bashkimi i tij me Krishtin, v. 1
2. Ndërgjegjia e tij e udhëhequr nga Fryma, v. 1
3. Ndjenjat e tij të thella për Izraelin, v. 2

9:1 “Po them të vërtetën në Krishtin, nuk po gënjej” Pali shpesh bënte këtë lloj deklarate për vërtetësinë e tij (krh. II Kor. 11:10; Gal. 1:20; I Tim. 2:7) ose një të ngjashme për faktin që Perëndia ishte dëshmitari i tij (krh. Rom. 1:9; II Kor. 1:23; 11:31; Fil. 1:8; I Thes. 2:5,10). Ishte mënyra e tij e pohimit të vërtetësisë së mësimit dhe predikimit të tij. Ajo që përjetoi rrugës për në Damask ndryshoi gjithçka!

■ **“ndërgjegjia ime”** Kjo i referohet sensit moral të besimtarit, që ia ka dhënë Perëndia dhe që udhëhiqet nga Fryma. Në një kuptim, ai është një burim kyç autoriteti për besimtarët. Është Fjala e Perëndisë e kuptuar dhe e zbatuar nga Fryma e Perëndisë në mendjet tona (krh. I Tim. 1:5,19). Problem bëhet kur besimtarët—dhe, për atë punë, edhe jobesimtarët—vazhdojnë ta hedhin poshtë Fjalën dhe Frymën; kështu pastaj bëhet më e lehtë justifikimi i mëkatit (krh. I Tim. 4:2). Ndërgjegjet tona mund të jenë shumë të ndikuara nga kultura dhe nga përvoja.

TEMË E VEÇANTË: NDËRGJEGJIA

Pali e përdor termin “ndërgjegje” në letrat drejtuar Korintasve (krh. 4:4; 8:7, 10, 12; 10:25, 27, 28, 29; II Kor. 1:12; 4:2; 5:11). Ajo i referohet atij sensi moral të brendshëm që na thotë se çfarë është e duhur dhe çfarë e gabuar (krh. Veprat 23:1). Ndërgjegjia mund të ndikohet nga e shkuara jonë, nga zgjedhjet tona të gabuara, ose nga Fryma e Perëndisë. Ajo nuk është një udhërrëfyese e pagabueshme, por i përcakton kufijtë e besimit individual. Prandaj, dhunimi i ndërgjegjes sonë, edhe nëse e ka gabim apo është e dobët, është një problem madhor i besimit.

Ndërgjegjia e besimtarit ka nevojë të formësohet gjithnjë e më shumë nga Fjala e Perëndisë dhe nga Fryma e Perëndisë (krh. I Tim. 3:9). Perëndia do t’i gjykojë besimtarët në bazë të dritës që kanë (d.m.th., të dobët ose të fortë), por të gjithë ne duhet të jemi të hapur ndaj Biblës dhe Frymës për më shumë dritë dhe të rritemi në njohjen e Zotit Jezu Krisht. Shih shënimin më të plotë mbi “ndërgjegjen” te II Kor. 10:25. Shih Temën e Veçantë: Dobësia.

■	
NASB, NKJV	“dëshmon me mua në Frymën e Shenjtë”
NRSV	“e konfirmon me anë të Frymës së Shenjtë”
TEV	“e sunduar nga Fryma e Shenjtë”
NJB	“në bashkim me Frymën e Shenjtë më pohon”

Pali besonte se kishte një thirrje dhe një mandat të veçantë nga Krishti (krh. Veprat 9:1-22; Gal. 1:1).

FORMA FOLJORE (PJESORE E TASHME VEPRORE, krh. 2:15) është fjalë e përbërë me *sun* (kaq e zakonshme te Pali). Ai ishte i bindur për të kuptuarin e tij të ri bazuar në

1. zbulesën e Krishtit
 - a. rruga e Damaskut
 - b. mësuar në Arabi (Nabateas)
2. dëshmia e brendshme e Frymës

Ai ishte Apostull dhe fliste me autoritet hyjnor (krh. I Kor. 7:25,40). Ai merrte pjesë në hidhërimin e Perëndisë për mosbesimin dhe ngurtësimin e Izraelit etnik (krh. v. 2). Ata kishin aq shumë avantazhe (krh. vv. 4-5).

9:3

NASB, NKJV,

NRSV

TEV

NJB

“Sepse mund të dëshiroja . . .”

“Për hir të tyre mund të dëshiroja”

“Do të isha i gatshëm . . .”

Pali kishte një keqardhje kaq të thellë për popullin e tij, Izraelin, saqë nëse ndarja e tij nga Krishti mund të shkaktonte përfshirjen e tyre, ai do të ishte i gatshëm, v. 3. Ky varg ka një ndërtim gramatikor kaq të fortë dhe theksues (DËFTORE E PAKRYER JOVEPRORE me *autos* dhe *egō*, dhe një INFINITIV TË TASHËM). Intensiteti dhe barra e kësaj lutjeje është shumë e ngjashme me lutjen ndërmjetësuese të Moisiut për Izraelin mëkatar tek Eksodi 32:30-35. Kjo kuptohet më mirë si një deklaratë dëshire, jo fakt. Është e ngjashme me përdorimin e KOHËS SË PAKRYER te Gal. 4:20.

Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: LUTJA NDËRMJETËSUESE

I.

Hyrje

A. Lutja është e rëndësishme për shkak të shembullit të Jezusit.

1. Lutja personale (Marku 1:35; Luka 3:21; 6:12; 9:29; 22:31-46)
2. Pastrimi i Tempullit (Mat. 21:13; Marku 11:17; Luka 19:46)
3. Lutja model (Mat. 6:5-13; Luka 11:2-4)

B. Lutja është vënia në veprim konkret e besimit tonë në Perëndinë personal dhe të dashur i cili është i pranishëm, i gatshëm dhe ia aftë të veprojë për hirin tonë dhe të tjerëve, përmes lutjeve tona.

C. Perëndia e ka kufizuar personalisht veten për të vepruar në bazë të lutjeve të fëmijëve të tij në shumë zona (shih Jakobi 4:2)

D. Synimi kryesor i lutjes është bashkësia dhe koha jonë me Perëndinë triumfues.

E. Gama e lutjes është gjithçka ose kushdo që preokupon besimtarët. Ne mund të lutemi një herë (me besim), ose në mënyrë të përsëritur, sa herë që na kthehet në mendje preokupimi në fjalë.

F. Lutja mund të përfshijë një sërë elementesh

1. lavdërimi dhe adhurimi i Perëndisë triumfues
2. falënderimi i Perëndisë për praninë, miqësinë dhe furnizimin e tij
3. rrëfimi i mëkatit tonë, si të kaluar ashtu dhe të tashëm
4. lutje për nevojat ose dëshirat tona të perceptuara
5. ndërmjetësim, kur sjellim para Atit nevojat e të tjerëve

G. Lutja ndërmjetësuese është mister. Perëndia i do shumë më tepër se ne personat për të cilët lutemi, mirëpo, shpesh, lutjet tona shkaktojnë një ndryshim, përgjigje, ose nevojë, jo vetëm në ne, por edhe ë ta.

II.

Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Disa shembuj të lutjes ndërmjetësuese:

- a. Abrahami përgjërohet për Sodomën (Zan. 18:22 e më tej)
- b. Lutjet e Moisiut për Izraelin
 - (1) Eksodi 5:22-23
 - (2) Eksodi 32:31 e më tej
 - (3) Ligji i Përtërirë 5:5
 - (4) Ligji i Përtërirë 9:18, 25 e më tej
- c. Samueli lutet për Izraelin:
 - (1) 1 Samuelit 7:5-6, 8-9
 - (2) 1 Samuelit 12:16-23
 - (3) 1 Samuelit 15:11
- d. Davidi lutet për fëmijën e vet, 2 Samueli 12:16-18

2. Perëndia kërkon ndërmjetësues, Isaia 59:16

3. Mëkati i njohur dhe i parrëfyer, ose qëndrimi i papënduar, ndikon në lutjet tona

- a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2; 64:7
- B. Dhiata e Re
1. Shërbesa ndërmjetësuese e Birit dhe Frymës
 - a. Jezusi
 - (1) Romakëve 8:34
 - (2) Hebrenjve 7:25
 - (3) 1 Gjonit 2:1
 - b. Fryma e Shenjtë, Romakëve 8:26-27
 2. Shërbesa ndërmjetësuese e Palit
 - a. Lutet për judenjtë
 - (1) Romakëve 9:1 e më tej
 - (2) Romakëve 10:1
 - b. Lutet për kishat
 - (1) Romakëve 1:9
 - (2) Efesianëve 1:16
 - (3) Filipianëve 1:3-4, 9
 - (4) Kolosianëve 1:3, 9
 - (5) 1 Thesalonikasve 1:2-3
 - (6) 2 Thesalonikasve 1:11
 - (7) 2 Timoteut 1:3
 - (8) Filemonit, v. 4
 - c. Pali u kërkoi kishave të luten për të
 - (1) Romakëve 15:30
 - (2) 2 Korintasve 1:11
 - (3) Efesianëve 6:19
 - (4) Kolosianëve 4:3
 - (5) 1 Thesalonikasve 5:25
 - (6) 2 Thesalonikasve 3:1
 3. Shërbesa ndërmjetësuese e kishës
 - a. Lutuni për njëri-tjetrin
 - (1) Efesianëve 6:18
 - (2) 1 Timoteut 2:1
 - (3) Jakobit 5:16
 - b. Kërkohen lutje për grupe të veçanta
 - (1) Armiqtë tanë, Mat. 5:44
 - (2) Punëtorët e krishterë, Hebrenjve 13:18
 - (3) Sundimtarët, 1 Timoteut 2:2
 - (4) Të sëmurët, Jakobit, 5:13-16
 - (5) Ata që rrëshqasin në besim, 1 Gjonit 5:16
- III. Kushtet për lutjen që merr përgjigje
- A. Marrëdhënia jonë me Krishtin dhe me Frymën
 1. Qëndroni në të, Gjoni 15:7
 2. Në emër të tij, Gjoni 14:13, 14; 15:16; 16:23-24
 3. Në Frymën, Efesianëve 6:18; Juda 20
 4. Sipas vullnetit të Perëndisë, Mateu 6:10; 1 Gjonit 3:22; 5:14-15
 - B. Motivet
 1. Pa u lëkundur, Mateu 21:22; Jakobi 1:6-7
 2. Përlësi dhe pendim, Luka 18:9-14
 3. Kur kërkohet gabim, Jakobi 4:3
 4. Egoizmi, Jakobi 4:2-3
 - C. Aspekte të tjera
 1. Qëndresa

- a. Luka 18:1-8
- b. Kolosianëve 4:2
- 2. Kërkoni vazhdimisht
 - a. Mateu 7:7-8
 - b. Luka 11:5-13
 - c. Jakobi 1:5
- 3. Mosmarrëveshjet në familje, 1 Pjetrit 3:7
- 4. Të mos keni asnjë mëkat të ditur
 - a. Psalmi 66:18
 - b. Fjalët e Urta 28:9
 - c. Isaia 59:1-2
 - d. Isaia 64:7

IV. Përmbyllje teologjike

- A. Sa privilegj, mundësi, detyrë dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme!
- B. Jezusi është shembulli ynë. Fryma është udhërrëfyesi ynë. Ati po na pret me shumë përmallim.
- C. Kjo mund të të ndryshojë ty, familjen, miqtë dhe botën.



NASB	“të isha i mallkuar, i ndarë nga Krishti”
NKJV	“të isha i mallkuar nga Krishti”
NRSV	“të isha i mallkuar dhe i përjashtuar nga Krishti”
TEV	“të isha nën mallkimin e Perëndisë dhe i darë nga Krishti”
NJB	“i gatshëm të isha i dënuar dhe i përjashtuar nga Krishti”

Etimologjia bazë e fjalës “i shenjtë” është të veçosh për Perëndinë për përdorimin e Tij. I njëjti koncept lidhet me këto terma për “i mallkuar” (*anathema*, krh. I Kor. 12:3; 16:22; Gal. 1:8,9). Diçka ose dikush është ndarë mënjanë për Perëndinë. Kjo mund të jetë një përvojë pozitive (krh. Lev. 27:28; Luka 21:5) ose një përvojë negative (krh. Joz. 6-7; Rom. 9:3), në varësi të kontekstit.

TEMË E VEÇANTË: MALLKIM (ANATHEMA)

Ka disa fjalë në hebraisht për “mallkim.” *Herem* (BDB 356) përdorej për diçka që i jepej Perëndisë (krh. LXX si *anathema* (BAGD 54), Lev. 27:28), zakonisht për shkatërrim (krh. LiP. 7:26; Joz. 6:17-18; 17:12). Ishte një term i përdorur në konceptin e “luftës së shenjtë.” Perëndia tha të shkatërronin Kanaanejtë dhe Jerikoja ishte mundësia e parë, “frytet e para.”

Në DHR *anathema* dhe format e tjera të lidhura me të, përdoren në disa kuptime të ndryshme:

1. si një dhuratë ose ofrim për Perëndinë (krh. Luka 21:5)
2. si një betim vdekjeje (krh. Veprat 23:14)
3. për të mallkuar dhe për t’u betuar (krh. Marku 14:71)
4. një formulë mallkimi e lidhur me Jezusin (krh. I Kor. 12:3)
5. dhënia e dikujt ose diçkaje për gjykim ose shkatërrim nga Perëndia (krh. Rom. 9:3; I Kor. 16:22; Gal. 1:8-9).

■ “të afërmve të mi sipas mishit” Shih Temën e Veçantë te 1:3.

9:4-5 Kjo seri FRAZASH EMËRORE numëron me detaje grafike privilegjet e Izraelit. Mosbesimi i tyre ishte edhe më i pafalshëm nën dritën e këtyre avantazheve. Kujt i është dhënë shumë, shumë i kërkohet (krh. Luka 12:48)!

9:4 “**Izraelitë**” Ky ishte emri besëlidhor i DHV për farën e Abrahamit. Pas një takimi monumental me Perëndinë, emri i Jakobit u ndryshua në Izrael (krh. Zan. 32:28). Ai u bë emri kolektiv për kombin hebre. Etimologjia e tij mund të jetë “*El* (Perëndia) këmbëngultë” dhe si nënkuptim, jo mashtrimi i Jakobit.

TEMË E VEÇANTË: IZRAEL (emri)

- I. Kuptimi i emrit është i paqartë (BDB 975).
 - A. *El* këmbëngul
 - B. Le të këmbëngulë *El* (URDHËRORE)
 - C. *El* ruan
 - D. Le të luftojë *El*
 - E. *El* lufton
 - F. Ai që lufton me Perëndinë (Zan. 32:28)
- II. Përdorime në DHV
 - A. Emri i Jakobit (uzurpator, kapës i thembrës, BDB 784, krh. Zan. 25:26) ndryshohet pas përlëshjes me një personazh frymëror në lumin Jabok (krh. Zan. 32:22-32; Eksodi 32:13). Shpesh kuptimet e emrave hebraikë janë lojë me tingullin, jo etimologji (krh. 32:28). Izrael bëhet emri i tij (p.sh., Zan. 35:10).
 - B. Ai u bë emri kolektiv për të dymbëdhjetë bijtë e tij (p.sh., Zan. 32:32; 49:16; Eksodi. 1:7; 4:22; 28:11; LiP. 3:18; 10:6).
 - C. Ai me kalimin e kohës u bë emri i kombit të formuar nga dymbëdhjetë fiset përpara eksodit (krh. Zan. 47:27; Eksodi. 4:22; 5:2) dhe pas (krh. LiP. 1:1; 18:6; 33:10).
 - D. Pas monarkisë së bashkuar të Saulit, Davidit dhe Salomonit, fiset u ndanë nën Roboamin (krh. I Mbret. 12).
 1. dallimi fillon që përpara ndarjes zyrtare (p.sh., II Sam. 3:10; 5:5; 20:1; 24:9; I Mbret. 1:35; 4:20)
 2. bëhet emri i fiseve veriore deri në rënien e Samarisë në duart e Asirisë në vitin 722 para Krishtit (krh. II Mbret. 17).
 - E. Përdoret për Judën në disa vende (p.sh., Isaia 1; Mikea 1:15-16).
 - F. Pas mërgimeve asiriane dhe babilonase ai u bë përsëri emri kolektiv për të gjithë pasardhësit e Jakobit (p.sh., Isa. 17:7,9; Jer. 2:4; 50:17,19).
 - G. Përdorur për popullin në dallim nga priftërinjtë (krh. I Kron. 9:2; Ezdra 10:25; Neh. 11:3).

■ **“të cilëve u përket adoptimi si bij”** Në DHV SHUMËSI i “bijve” zakonisht iu referohej engjëjve (krh. Jobi 1:6; 2:1; 38:7; Dan. 3:25; Ps. 29:1; 89:6-7), ndërkohë NJËJËSI i referohej

1. Mbretit të Izraelit (krh. II Sam. 7:14)
2. kombit (krh. Eksodi. 4:22,23; LiP. 14:1; Osea 11:1)
3. Mesias (krh. Ps. 2:7)
4. Mund t’iu referohej njerëzve (krh. LiP. 32:5; Ps. 73:15; Ezek. 2:1; Os. 1:10. Zanafilla 6:2 është me dy kuptime; mund të jetë njëri ose tjetri). Në DHR i referohet dikujt që i përket familjes së Perëndisë.

Metafora kryesore e Palit për shpëtimin ishte “birësimi” (krh. Rom. 8:15,23; Gal. 4:5; Efe. 1:5), ndërsa për Pjetrin dhe Gjonin ishte “të lindurit sërish.” Të dyja janë metafora të familjes. Nuk është metaforë hebreje, por romake. Birësimi ishte një procedurë ligjore shumë e shtrenjtë dhe që kërkonte kohë nën ligjin romak. Pasi birësohej, personi konsiderohej një person i ri që nuk mund të mohojë ligjërisht, dhe as të vritej nga babai birësues.

■ **“lavdia”** Rrënja hebraike do të thoshte “të jesh i rëndë” që ishte metaforë për diçka që ishte e çmuar.

Këtu i referohet

1. Perëndisë që e zbuloi Vetën në Malin Sinai (krh. Eksodi. 19:18-19)
2. Reja *Shekinah* e lavdisë që i udhëhoqi Izraelitët gjatë Periudhës së Endjeve në Shkretëtirë (krh. Eksodi. 40:34-38) YHWH ia zbuloi Vetën në mënyrë unike Izraelit. Pranisë së YHWH i referoheshin si lavdia e Tij (krh. I Mbret. 8:10-11; Ezek. 1:28). Shih Temën e Veçantë në 3:23.

■ **“besëlidhjet”** Në dorëshkrimet e lashta greke P⁴⁶, B, F, dhe G fjala “besëlidhje” është në NJËJËS.

Por në dorëshkrimet K, C, dhe në disa versione në latinishten e vjetër, Vulgatë dhe në gjuhën kopte përdoret SHUMËSI. UBS⁴ i jep SHUMËSIT një vlerësim “B” (pothuaj i sigurt). Megjithatë, SHUMËSI nuk përdoret asnjëherë në DHV. Në DHV ka disa besëlidhje specifike: me Adamin, Noeun, Abrahamin, Moisiun dhe Davidin. Meqenëse menjëherë pas kësaj përmendet dhënia e Ligjit, kjo ndoshta i referohet Besëlidhjes Abrahamike, e cila ishte ajo që Pali e shikonte si themeltare (krh. 4:1-25; Gal. 3:16-17) dhe që u përsërit disa herë (krh. Zanafilla 12, 15, 17) dhe me secilin nga Patriarkët.

TEMË E VEÇANTË: BESËLIDHJA

Termi i DHV *berith* (BDB 136), besëlidhje nuk përkufizohet lehtë. Nuk ka asnjë FOLJE që t'i korrespondojë në hebraisht. Të gjitha përpjekjet për të nxjerrë një përkufizim etimologjik kanë dalë jo bindëse. Megjithatë, fakti që ky koncept është qendror i ka detyruar studiuesit të shqyrtojnë përdorimin e fjalës, në përpjekje për të përcaktuar kuptimin e saj funksional.

Besëlidhja është mjeti me anë të të cilit Perëndia i vetëm i vërtetë hyn në marrëdhënie me krijimin e Tij njerëzor. Koncepti i besëlidhjes, traktatit, apo marrëveshjes është thelbësor për të kuptuar zbuluesën biblike. Tensioni mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor shihen qartë në konceptin e besëlidhjes. Disa besëlidhje bazohen ekskluzivisht në karakterin dhe veprimet e Perëndisë.

1. Vetë krijimi (krh. Zanafilla 1-2)
2. Thirrja e Abrahamit (krh. Zanafilla 12)
3. Besëlidhja me Abrahamin (krh. Zanafilla 15)
4. Mbajtja e premtimitndaj Noeut (krh. Zanafilla 6-9)

Megjithatë, vetë natyra e besëlidhjes kërkon një reagim/përgjigje.

1. Me anë të besimit Adami duhej t'i bindej Perëndisë dhe të mos hante nga pema në mes të Edenit
2. Me anë të besimit Abrahami duhej ta linte familjen, të ndiqte Perëndinë dhe të besonte se do të kishte pasardhës në të ardhmen
3. Me anë të besimit Noeu duhej të ndërtonte një varkë të madhe në një vend pa ujë dhe të mblidhte kafshët
4. Me anë të besimit Moisiu i nxori Izraelitët nga Egjipti dhe i çoi në malin Sinai ku mori udhëzime specifike për jetën fetare dhe shoqërore me premtimet e bekimit dhe të mallkimit (krh. LiP 27-28)

I njëjti tension që gjendet në marrëdhënien e Perëndisë me njerëzimin adresohet në “besëlidhjen e re.” Tensioni mund të shihet qartë kur krahason Ezekielin 18 me Ezek. 36:27-37 (veprimet e YHWH). A bazohet besëlidhja mbi veprimet e hirshme të Perëndisë, apo mbi përgjigjen e urdhëruar njerëzore? Kjo është çështja e nxehtë e Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re. Synimet e të dyjave janë të njëjta: (1) rimëkëmbja/restaurimi i bashkësisë me YHWH që humbi në Zanafilla 3 dhe (2) krijimi i një populli të drejtë që reflekton karakterin e Perëndisë.

Besëlidhja e re e Jer. 31:31-34 e zgjidh tensionin duke i hequr veprat njerëzore si mjetin për arritjen e pranimit. Ligji i Perëndisë bëhet një dëshirë e brendshme në vend që të jetë një kod i jashtëm ligjor. Synimi i një populli të perëndishëm e të drejtë mbetet i njëjtë, por metodologjia ndryshon. Njerëzimi i rënë e provoi veten që nuk ishte i aftë për të qenë imazhi i reflektuar i Perëndisë. Problemi nuk ishte besëlidhja e Perëndisë, por mëkatshmëria dhe dobësia njerëzore (krh. Romakëve 7; Galatasve 3).

I njëjti tension midis besëlidhjeve të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara të DHV mbetet në DHR. Shpëtimi është tërësisht falas në veprën e përfunduar të Jezu Krishtit, por ai kërkon pendim dhe besim (si në fillim, ashtu edhe në vazhdim). Ai është edhe një pozicion ligjor, edhe një thirrje për t'u bërë të ngjashëm me Krishtin, një fjali dëftore pranimi dhe një urdhër për shenjtërim! Besimtarët nuk shpëtohen me anë të veprave që bëjnë, por për bindje (krh. Efe. 2:8-10). Jetesa e perëndishme bëhet prova e shpëtimit, jo mjeti i shpëtimit. Megjithatë, jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme! Ky tension shihet qarte tek Hebrenjve.

■ “dhënia e Ligjit dhe shërbimi i tempullit” Kjo duhet t'i referohet

1. Dhënies së Ligjit nga Moisiu në Malin Sinai (krh. Eksodi 19-20)
2. Tabernakullit të Periudhës së Endjeve në Shkretëtirë (krh. Eksodi 25-40 dhe Levitiku)

■ “premtimet” Perëndia i ka zbuluar planet e Tij të ardhme (krh. 1:2; Veprat 13:32; Titit 1:2; Heb. 1:1) gjatë gjithë DHV.

Meqenëse “besëlidhjet” janë përmendur më herët, “premtimet” ndoshta i referohet Mesias (krh. v. 5, p.sh., Zan. 3:15; 49:10; LiP. 18:15,18-19; II Sam. 7; Ps. 16:10; 118:22; Isa. 7:14; 9:6; 11:1-5; Dan. 7:13,27; Mikea 5:2-5a; Zak. 2:6-13; 6:12-13; 9:9; 11:12).

Këta premtime (besëlidhje) janë edhe të kushtëzuara, edhe të pakushtëzuara. Ata ishin të pakushtëzuara në lidhje me atë që do të bënte Perëndia (krh. Zan. 15:12-21), por të kushtëzuara nga besimi dhe bindja e njerëzimit (krh. Zan. 15:6 dhe Romakëve 4). Vetëm Izraeli e kishte zbuluesën e Perëndisë përpara ardhjes së Krishtit (por me disa përjashtime, si Jobi, Jethroja).

9:5 “etërit” Kjo i referohet Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, Patriarkëve të Zanafillës 12-50 (krh. Rom. 11:28; LiP. 7:8; 10:15).

■ **“nga të cilët është Krishti sipas mishit”** Kjo i referohet prejardhjes fizike të Mesias (krh. 1:3, shih Temën e Veçantë: Mesia te 1:4), të Vajosurit, shërbëtorit të zgjedhur e të veçantë të Perëndisë, i cili do të përmbushte premtimet dhe planet e Perëndisë, (krh. 10:6).

Termi “Krisht” është përkthimi grek i fjalës hebraike për “i Vajosur.” Në DHV tre grupe udhëheqësish vajoseshin me vaj të shenjtë.

1. Mbretërit e Izraelit
2. Kryeprihtërinjtë e Izraelit
3. Profetët e Izraelit

Kjo ishte një simbol i zgjedhjes dhe pajisjes nga Perëndia për shërbim ndaj Tij. Jezusi i përmbushi të tre këta ofiqe të vajosur (krh. Heb. 1:2-3). Ai është zbulesa e plotë e Perëndisë, sepse ishte Perëndia i mishëruar (krh. Isa. 7:14; 9:6; Mikea 5:2-5a; Kol. 1:13-20).

Për “mish” shih Temën e Veçantë te 1:3.

■

NASB “Krishti sipas mishit, që është mbi të gjithë, Perëndi i bekuar përjetë”
NKJV “Krishti erdhi, që është mbi të gjithë, Perëndia i bekuar përjetësisht”
NRSV “vjen Mesia, që është mbi të gjithë, Perëndi i bekuar përjetë”
TEV “dhe Krishti si njeri, i përket racës së tyre. Perëndia, që sundon mbi të gjithë, qoftë i lëvduar përjetë”
NJB “erdhi Krishti që është mbi të gjithë, Perëndi i bekuar përjetë”

Gramatikisht, kjo mund të ishte një doksologji ndaj Atit (TEV, duke ndjekur traditën hebreje), por konteksti favorizon pohimin nga ana e Palit të hyjnisë së Jezusit (nuk ndjek modelin e doksologjive hebraike ndaj YHWH në LXX; shih J. Murray, II, fq. 245-248). Pali nuk e përdor *Theos* për Jezusin shpesh, por e përdor (krh. Veprat 20:28; II Thes. 1:12; Titit 2:13; Fil. 2:6). Të gjithë Etërit e kishës së hershme e interpretuan këtë tekst se i referohej Jezusit. Bruce Metzger, *A Textual Commentary On the Greek New Testament*, fq. 520-522, tregon që opsionet e ndryshme lidhen me vendin e shenjave të pikësimit. Dorëshkrimet e lashta uncialle nuk kishin

1. Shkronja të mëdha/kapitale
2. Shenja pikësimi
3. Ndarje në paragrafë
4. Madje as hapësirë midis fjalëve

■ **“që është mbi të gjithë”** Kjo mund të jetë një frazë përshkruese për Perëndinë Atin, ose për Jezusin, Birin. Ajo e reflekton deklaratën e Jezusit te Mat. 28:19 dhe atë të Palit te Kol. 1:15-20. Kjo frazë madhështore tregon sa i marrë u tregua Izraeli kur hodhi poshtë Jezusin e Nazaretit.

■ **“përjetë”** Kjo është fjalë për fjalë fraza idiomatike greke “në epoka” (krh. Luka 1:33; Rom. 1:25; 11:36; Gal. 1:5; I Tim. 1:17). Kjo është një nga disa frazat e lidhura me njëra-tjetrën (1) “në epokë” (krh. Mat. 21:19 [Marku 11:14]; Luka 1:55; Gjoni 6:5,58; 8:35; 12:34; 13:8; 14:16; II Kor. 9:9) ose (2) “e epokave të epokave” (krh. Efe. 3:21). Duket sikur nuk ka ndonjë dallim midis këtyre idiomave për “përjetë.” Termi “epoka” mund të jetë SHUMËS në një kuptim figurativ si një ndërtim gramatikor i përdorur nga rabinët që quhej “shumësi i madhërisë”, ose mund t’i referohet konceptit të disa “epokave” në kuptimin hebraik të “epoka e pafajësisë,” “epoka e ligësisë,” “epoka që do të vijë,” ose “epoka e drejtësisë.”

■ **“Amen”** Shih Temën e Veçantë te 1:25.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:6-13

⁶Por nuk është sikur fjala e Perëndisë ka dështuar. Sepse nuk janë të gjithë Izrael ata që rrjedhin nga Izraeli; ⁷as nuk janë të gjithë fëmijë sepse janë pasardhës të Abrahamit, por: **“PËRMES ISAKUT DO TË QUHET PASARDHJA JOTE.”** ⁸Domethënë, nuk janë fëmijët e mishit që janë fëmijë të Perëndisë, por fëmijët e premtimit konsiderohen si pasardhës. ⁹Sepse kjo është fjala e premtimit: **“NË KËTË KOHË DO**

TË VIJ, DHE SARA DO TË KETË NJË BIR.” ¹⁰Dhe jo vetëm kjo, por ishte edhe Rebeka, kur kishte mbetur shtatzënë *me binjakë* nga një njeri, ati ynë, Isaku; ¹¹sepse, megjithëse *binjakët* nuk kishin lindur ende, dhe nuk kishin bërë asnjë gjë të mirë ose të keqe, në mënyrë që qëllimi i Perëndisë sipas zgjedhjes së Tij të qëndronte, jo për shkak të veprave, por për shkak të Atij që thërret, ¹²iu tha asaj, “**MË I MADHI DO T’I SHËRBEJË MË TË VOGLIT.”** ¹³Ashtu siç është shkruar, “**JAKOBIN E DESHA, POR ESAUN E URREVA.**”

9:6 “fjala e Perëndisë” Në këtë kontekst kjo frazë u referohet premtimeve besëlidhore të DHV. Premtimet e Perëndisë janë të sigurta (krh. Num. 23:19; Jozueu 21:45; 23:14; II Mbret. 10:10; Isa. 40:8; 55:11; 59:21).



NASB, NRSV,

TEV, NJB “ka dështuar”

NKJV

“nuk ka patur efekt”

Ky term (*ekpiptō*) është përdorur në Septuagintë disa herë për diçka (krh. Isa. 6:13) ose dikë (krh. Isa. 14:12) që bie. Këtu është DËFTORE E KRYER VEPRORE, që tregon gjendje me rezultate afatgjata (por është e mohuar). Shih shënimin më lart për sigurinë e fjalës së Perëndisë.



NASB

“Sepse nuk janë të gjithë Izrael ata që rrjedhin nga Izraeli”

NKJV

“Sepse nuk janë të gjithë Izrael ata që janë të Izraelit”

NRSV

“Sepse jo të gjithë izraelitët i përkasin me të vërtetë Izraelit”

TEV

“Sepse jo të gjithë njerëzit e Izraelit janë populli i Perëndisë”

NJB

“Jo të gjithë ata që rrjedhin nga Izraeli janë Izrael”

Kuptimi i kësaj deklarate paradoksale rrotullohet rreth kuptimeve të ndryshme biblike të termit “Izrael.”

1. Izrael, në kuptimin e pasardhësve të Jakobit (krh. Zan. 32:22-32)
2. Izrael, në kuptimin populli i zgjedhur i Perëndisë (krh. TEV)
3. Izraeli frymëror, Izraeli në kuptimin e kishës, (krh. Gal. 6:16; I Pjet. 2:8,9; Zbu. 1:6) përkundër Izraelit natyror (krh. vv. 3-6)

Vetëm disa nga fëmijët e Abrahamit ishin fëmijët e premtimit (krh. v. 7). Madje as hebrenjtë nuk ishin në marrëdhënie të drejtë me Perëndinë bazuar vetëm në prejardhjen e tyre (krh. v. 7), por bazuar në besimin e tyre (krh. 2:28-29; 4:1ff.; Gjoni 8:31-59; Gal. 3:7-9; 4:23). Ishin ata, mbetja që besonte, (shih Temën e Veçantë në 9:27-28) që i morën premtimet e Perëndisë dhe ecën në to me anë të besimit (krh. 9:27; 11:5).

Vargu 6 fillon një seri kundërshtimesh të supozuara (krh. 9:14,19,30; 11:1). Kjo vazhdon formatin e diatribit të Palit. Ky format e përçon të vërtetën me anë të një kundërshtari të supozuar (d.m.th., Mal. 1:2,6,7 [dy herë], 12,13; 2:14,17 [dy herë]; 3:7,13,14).

9:7 Gjysma e dytë e këtij vargu është një citim nga Zan. 21:12d. Jo të gjithë fëmijët e Abrahamit ishin fëmijët e premtimit besëlidhor të Perëndisë (krh. Zan. 12:1-3; 15:1-11; 17:1-21; 18:1-15; Gal. 4:23). Kjo tregon dallimin midis Ismaelit dhe Isakut në vv. 8-9, dhe Jakobit dhe Esaut në vv. 10-11.

9:8 Këtu Pali po përdor termin “mish” për t’iu referuar prejardhjes kombëtare (krh. 1:3; 4:1; 9:3,5, shih Temën e Veçantë në 1:3). Ai po vë në kontrast fëmijët natyralë të Abrahamit (hebrenjtë e 9:3) me fëmijët frymërorë (fëmijët e premtimit) të Abrahamit (ata që do t’i zënë besë Mesias së premtuar të Perëndisë me anë të besimit, krh. 2:28-29). Ky nuk është i njëjti kontrast me 8:4-11, njerëzimi i rënë përkundër njerëzimit të shpenguar.

9:9 Ky është një citim nga Zanafilla 18:10,14. Fëmija i premtuar (“fara”) do të vijë nga Sara me iniciativën e Perëndisë. Kjo do të kulminojë më në fund me lindjen e Mesias. Isaku ishte një përmbushje e veçantë e premtimit të Perëndisë ndaj Abrahamit në Zan. 12:1-3 trembëdhjetë vjet më përpara.

9:10 Bashkëshortet e Abrahamit, Isakut dhe Jakobit ishin shterpa; ato nuk mund të mbeteshin shtatzëna. Pamundësia e tyre për të patur një fëmijë ishte një nga mënyrat e Perëndisë për të treguar se Ai ishte në kontroll të premtimeve të besëlidhjes, të linjës Mesianike.

Mënyra tjetër ishte që linja e vërtetë Mesianike nuk rrjedh asnjëherë nga biri më i madh i Patriarkëve (gjë që ishte pritshmëria kulturore). Kyçi është zgjedhja e Perëndisë (krh. vv. 11-12).

9:11-12 Vargjet 11-12 janë një fjali në greqisht. Historia është marrë nga Zan. 25:19-34. Ky shembull është përdorur për të vërtetuar që është zgjedhja e Perëndisë (krh. v. 16), jo (1) prejardhja njerëzore apo (2) merita apo arritjet njerëzore (krh. v. 16). Ky është mekanizmi i ri i ungjillit, besëlidhja e re (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-36). Megjithatë, duhet mbajtur mend që zgjedhja e Perëndisë nuk ishte për të përjashtuar, por për të përfshirë! Mesia do të vijë nga një farë e përzgjedhur, por Ai do të vijë për të gjithë (ata që ushtrojnë besimin, krh. 2:28-29; 4:3,22-25; kapitulli 10).

9:11 “qëllimi” Ky është termi i përbërë *pro plus tithēmi*, i cili ka disa kuptime.

1. te Rom. 3:25
 - a. nxjerr përpara publikisht
 - b. dhuratë shlyese
2. planifikoj që më përpara
 - a. për Palin, Rom. 1:13
 - b. për Perëndinë, Efe. 1:9

Forma EMËRORE (*prothesis*), e përdorur në këtë tekst, do të thotë “të vësh përpara”

1. është përdorur për bukën e paraqitjes në tempull, Mat. 12:4; Mark 2:26; Luka 6:4
2. është përdorur për një qëllim të paracaktuar, shpengues të Perëndisë, Rom. 8:28; 9:11; Efe. 1:5,11; 3:10; II Tim. 1:9; 3:10

Pali përdor disa terma të përbërë me PARAFJALËN *pro* (përpara) në kapitujt 8 dhe 9 të Romakëve dhe Efesianëve 1 (ata tregojnë veprimtarinë e planifikuar të Perëndisë).

1. *proginōskō* (paranjoh), Rom. 8:29
2. *proorizō* (planifikoj që përpara), Rom. 8:29 (Efe. 1:5,11), 30 (Efe. 1:9)
3. *prothesis* (qëllim i paracaktuar), Rom. 9:11
4. *proetoimazō* (përgatit që më parë), Rom. 9:23
5. *prolegō* (thënë më parë), Rom. 9:29
6. *proelpizō* (shpresuar qysh më parë), Efe. 1:12)

9:12 Ky është një citim nga profecia e Zan. 25:23 e lidhur me Esaun dhe Jakobin. Kjo tregon që Rebeka dhe Jakobi vepruan për shkak të profecisë, jo për fitim personal, kur e mashtuan Isakun në lidhje me bekimin!

9:13 “por Esaun e urreva” Ky është citim nga Mal. 1:2-3. “Urrej” është një idiomë hebraike krahasimi. Ajo tingëllon e ashpër në anglisht (edhe në shqip, shën i përkth), por krahasojeni me Zan. 29:31-33; LiP. 21:15; Mat. 10:37-38; Luka 14:26; dhe Gjoni 12:25. Termat antropomorfikë “dua” dhe “urrej” nuk lidhen me emocionet e Perëndisë kundrejt këtyre individëve, por me përkushtimin e Tij ndaj premtimit dhe linjës mesianike. Jakobi ishte biri i premtimit bazuar në profecinë e Zan. 25:23. Esau, te Mal. 1:2-3, i referohet kombit të Edomit (pasardhësve të Esaut).

TEMË E VEÇANTË: PERËNDIA I PËRSHKRUAR SI NJERI (TERMINOLOGJIA ANTROPOMORFIKE)

- I. Kjo lloj terminologjie është shumë e zakonshme në DhV (disa shembuj)
 - A. Gjymtyrë fizike
 1. sy – Zan. 1:4,31; 6:8; Eks. 33:17; Num. 14:14; LiP. 11:12; Zak. 4:10
 2. duar – Eks. 15:17; Num. 11:23; LiP. 2:15
 3. krah – Eks. 6:6; 15:16; LiP. 4:43; 5:15
 4. veshë – Num. 11:18; 1 Sam. 8:21; 2 Mbret. 19:16; Psa. 5:1; 10:17; 18:6
 5. fytyrë – Eks. 33:11; Num. 6:25; LiP. 34:10; Psa. 114:7
 6. gisht – Eks. 8:19; 31:18; LiP. 9:10; Psa. 8:3
 7. zë – Zan. 3:8, 10; Eks. 15:26; 19:19; LiP. 26:17; 27:10
 8. këmbë – Eks. 24:10; Ezek. 43:7
 9. formë njerëzore – Eks. 24:9-11; Psa. 47; Isa. 6:1; Ezek. 1:26

10. engjëlli i Zotit - Zan. 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16; Eks. 3:4,13-21; 14:19; Gjyq. 2:1; 6:22-23; 13:3-22
- B. Veprime fizike
1. të folurit si mekanizëm i krijimit - Zan. 1:3,6,9,11,14,20,24,26
 2. ecja (pra, zhurma e ecjes) në Eden – Zan. 3:8; 18:33; Lev. 26:12; LiP. 23:14
 3. mbyllja e derës së arkës së Noeut – Zan. 7:16
 4. nuhatja e fljimeve – Zan. 8:21; Lev. 26:31; Amosi 5:21
 5. zbritja – Zan. 11:5; 18:21; Eks. 3:8; 19:11, 18, 20
 6. varrosja e Moisiut – LiP. 34:6
- C. Ndjenja njerëzore (disa shembuj)
1. keqardhje/pendim - Zan. 6:6,7; Eks. 32:14; Gjyq. 2:18; 1 Sam. 15:29,35; Amos 7:3,6
 2. zemërim - Eks. 4:14; 15:7; Num. 11:10; 12:9; 22:22; 25:3,4; 32:10,13,14; LiP. 6:15; 7:4; 29:20
 3. xhelozit - Eks. 20:5; 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15; 32:16,21; Joz. 24:19
 4. neveri/pështirosje - Lev. 20:23; 26:30; LiP. 32:19
- D. Terma familjarë
1. Atë
 - a. i Izraelit - Eks. 4:22; LiP. 14:1; Isa. 1:2; 63:16; 64:8; Jer. 31:9; Os. 11:1
 - b. i mbretit - 2 Sam 7:11-16; Psal. 2:7
 - c. metafora të veprimeve atërore - LiP. 1:31; 8:5; 32:6-14; Psal. 27:10; Pro. 3:12; Jer. 3:4,22; 31:20; Osea 11:1-4; Mal. 3:17
 2. Prind – Osea 11:1-4
 3. Nënë – Isa. 49:15; 66:9-13 (analogjia e nënës që jep gji)
 4. I dashuri besnik në moshë të re – Osea 1-3
- II. Arsyet për përdorimin e kësaj lloji terminologjie
- A. Është e domosdoshme që Perëndia t’u zbulohet vetë qenieve njerëzore. Vetë koncepti i përhapur i Perëndisë si mashkull është antropomorfizëm, pasi Perëndia është frymë!
 - B. Perëndia merr aspektet më kuptimplota të jetës njerëzore dhe i përdor për t’iu zbuluar njerëzimit (atë, nënë, prind, i dashur)
 - C. Ndonëse e domosdoshme, Perëndia nuk dëshiron të kufizohet nga asnjë formë fizike (shih Eksodi 20; Ligji i Përtërirë 5)
 - D. Antropomorfizmi më absolut është mishërimi i Jezusit! Perëndia u bë fizik, i prekshëm (shih 1 Gjonit 1:1-3). Mesazhi i Perëndisë u bë Fjala e Perëndisë (shih Gjonit 1:1-18).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:14-18

¹⁴Çfarë të themi atëherë? Nuk ka padrejtësi te Perëndia, apo jo? Kurrë mos qoftë! ¹⁵Sepse Ai i thotë Moisiut, “DO TË KEM MËSHIRË PËR ATË QË DO TË KEM MËSHIRË, DHE DO TË KEM DHEMBSHURI PËR ATË QË DO TË KEM DHEMBSHURI.” ¹⁶Prandaj pra, nuk varet nga njeriu që dëshiron, apo nga njeriu që vrapon, por nga Perëndia që ka mëshirë. ¹⁷Sepse Shkrimi i thotë Faraonit, “PËR KËTË ARSYE TË NGRITA, PËR TË DEMONSTRUAR FUQINË TIME NË TY, DHE QË EMRI IM TË SHPALLET NË TË GJITHË BOTËN.” ¹⁸Prandaj, pra Ai ka mëshirë mbi atë që dëshiron, dhe ngurtëson atë që dëshiron.

9:14 “Çfarë të themi atëherë” Pali shpesh përdor këtë formë diatribi (krh. 3:5; 4:1; 6:1; 7:7; 8:31; 9:14,19,30).

■ **“Nuk ka padrejtësi te Perëndia, apo jo?”** Gramatika pret një “jo” për përgjigje. Si mund t’i mbajë përgjegjës Perëndia njerëzit nëse sovraniteti i Perëndisë është faktori vendimtar (krh. v. 19)? Ky është misteri i zgjedhjes. Theksi kyç në këtë kontekst është që Perëndia është i lirë të bëjë çfarë të dojë me njerëzimin (njerëzimin mëkatar), megjithatë, sovraniteti i Perëndisë shprehet në mëshirë (shih shënimin te v. 15), jo në ushtrim të fortë të pushtetit.

Gjithashtu duhet thënë se zgjedhjet sovraane të Perëndisë nuk bazohen në paranjohjen e zgjedhjeve dhe veprimeve të ardhshme njerëzore. Nëse do të ishte kështu, atëherë përfundimisht baza e zgjedhjeve të Perëndisë

do të ishin zgjedhjet, veprimet dhe meritat individuale (krh. v. 16; I Pjet. 1:2). Prapa kësaj është pikëpamja tradicionale hebraike e begatisë për të drejtët (krh. LiP 27-28; Jobi dhe Psalmi 73). Por, Perëndia zgjedh të bekojë të padenjët nëpërmjet besimit (jo veprave, krh. 5:8). Perëndia i di të gjitha gjërat, por Ai ka zgjedhur t'i kufizojë zgjedhjet (1) në mëshirë dhe (2) në premtim. Ka një reagim njerëzor të domosdoshëm, por ai ndjek, dhe përfundimisht konfirmon, zgjedhjen jetëndryshuese të Perëndisë.

■ **“Kurrë mos qoftë”** Kjo është një FORMË e rrallë e MËNYRËS DËSHIRORE që përdorej shpesh nga Pali për një mohim të fortë, zakonisht ndaj pyetjeve të kundërshtarit të tij diatrib (krh. 3:4,6,31; 6:2,15; 7:7,13; 11:1,11 edhe I Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Ka mundësi që të jetë një idiomë hebraike.

9:15 Ky është citim nga Eksodi 33:19. Perëndia është i lirë të veprojë sipas qëllimeve të Tij shpenguese. As Moisiu nuk e meritoi bekimin e Perëndisë (krh. Eksodi 33:20). Ai ishte vrasës (krh. Eksodi 2:11-15). Çelësi është që zgjedhjet e Tij janë në mëshirë (krh. vv. 16,18-23; 11:30,31,32).

9:15-16 “mëshirë” Kjo fjalë greke (*eleos*, krh. vv. 15,16,18,23; 11:30,31,32) është përdorur në Septuagintë (LXX) për të përkthyer termin e veçantë hebraik *hesed* (mbani mend që shkruesit e DHR ishin mendimtarë hebrenj që shkruanin në greqishten e popullit), që kishte kuptimin “besnikëri e palëkundur, besëlidhore.” Mëshira dhe zgjedhja e Perëndisë janë shumë, kolektive, (hebrenjtë [Isaku], jo arabët [Ismaeli]; Izraeli [Jakobi], jo Edomi [Esau], por hebrenjtë që besojnë dhe johebrenjtë që besojnë, krh. v. 24) si edhe individët që besojnë. Kjo e vërtetë është një nga çelësat për të çkyçur misterin e doktrinës së paracaktimit (shpengimi universal). Çelësi tjetër në kontekstin e kapitujve 9-11 është karakteri i pandryshueshëm i Perëndisë—mëshira (krh. 9:15,16,18,23; 11:30,31,32), dhe jo performanca njerëzore/veprat. Mëshira përmes zgjedhjes më në fund do të arrijë të gjithë ata që besojnë në Krishtin. Njëri e hap derën e besimit për të gjithë (krh. 5:18-19).

TEMË E VEÇANTË: DASHAMIRËSI (*HESED*)

Ky term ka një fushë të gjerë semantike. BDB e karakterizon në këtë mënyrë (338-339).

- A. I përdorur në lidhje me qeniet njerëzore
 1. mirësi ndaj njerëzve të tjerë (shih 1 Sam. 20:14; 2 Kro. 24:22)
 2. mirësi ndaj të varfërve dhe nevojtarëve (p.sh., Mikea 6:8)
 3. mirëdashje (shih Jer. 2:2; Os. 6:4)
 4. dukje (shih Isa. 40:6)
- B. I përdorur në lidhje me Perëndinë
 1. dashuri dhe besnikëri besëlidhjeje
 - a. “në shpengim nga armiqtë dhe vështirësitë” (p.sh., Jer. 31:3; Esdra 7:28; 9:9)
 - b. “në ruajtjen e jetës nga vdekja” (p.sh., Jobi 10:12; Psa. 86:13)
 - c. “në ringjalljen e jetës shpirtërore” (p.sh., Psa. 119:41, 76, 88, 124, 149, 150)
 - d. “në shpengimin nga mëkati” (shih Psa. 25:7; 51:1)
 - e. “në zbatimin e besëlidhjeve” (p.sh., 2 Kro. 6:14; Neh. 1:5; 9:32)
 2. përshkruan një cilësi hyjnore (p.sh., Eks. 34:6; Mikea 7:20)
 3. mirësia e Perëndisë
 - a. “e pasur” (p.sh., Neh. 9:17; Psa. 103:8)
 - b. “e madhe në shtrirje” (p.sh., Eks. 20:6; LiP. 5:10; 7:9)
 - c. “e përjetshme” (p.sh., 1 Kro. 16:34, 41; 2 Kro. 5:13; 7:3, 6; 20:21; Esdra 3:11)
 4. vepra dashamirësie (p.sh., 2 Kro. 6:42; Psa. 89:2; Isa. 55:3; 63:7; Vaj. 3:22)

9:17-18 Vargu 17 është një citim i fuqishëm universal nga Eksodi. 9:16; vargu 18 është përfundimi i nxjerrë nga citimi. Tek Eksodi. 8:15,19,32; 9:34 thuhet që Faraoni e ngurtësoi zemrën. Tek Eksodi. 4:21; 7:3; 9:12; 10:20,27; 11:10 thuhet që Perëndia ia ngurtësoi zemrën. Ky shembull është përdorur për të treguar personalitetin e Perëndisë për të përmbushur vullnetin e Tij për Izraelin (krh. v. 18).

Gjithashtu vini re që veprimet e Perëndisë në lidhje me Faraonin ishin shpengues në qëllim; dhe përfshirës në diapazon. Ata kishin qëllim:

1. të tregonin fuqinë e Perëndisë (përkundër perëndive të natyrës dhe kafshë të Egjiptasve, ashtu siç bën Zanafilla 1 me hyjnitë yjore babilonase)
2. t'ia zbulonin Perëndinë Egjiptit dhe, si rrjedhojë, gjithë tokës (krh. v. 17)

Mendimi perëndimor (Amerikan) madhëron individin, por mendimi lindor fokusohet në nevojën e tërësisë së kolektivit. Perëndia e përdori Faraonin për t'ia zbuluar Veten një bote nevojtare. Ai do të bëjë të njëjtën gjë me Izraelin mosbesues (krh. kapitulli 11). Në këtë kontekst të drejtat e njërit zbehen nën dritën e nevojave të të gjithëve. Kujtoni, gjithashtu shembujt kolektivë të DHV të

1. fëmijëve të parë të Jobit që vdiqën për shkak të diskutimit të Perëndisë me Satanin (krh. Jobi 1-2)
2. ushtarëve të Izraelit që vdiqën për shkak të mëkatit të Akanit (krh. Jozueu 7)
3. fëmijës së parë të Davidit me Bathshebën që vdiq për shkak të mëkatit të Davidit (krh. II Sam. 12:15).

Ne të gjithë ndikohemi nga zgjedhjet e të tjerëve. Kolektiviteti mund të shihet në DHR te Rom. 5:12-21.

■ **“Sepse Shkrimi i thotë. . .”** Personifikimi i Shkrimit është një mënyrë për të treguar se ai është i gjallë dhe aktual (krh. 10:6-8). Pali personifikon “mëkatën” dhe “vdekjen” te Romakëve 6-7!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:19-26

¹⁹Ti do të më thuash atëherë, “Pse na kritikon Ai ne ende? Sepse kush i reziston vullnetit të Tij?”
²⁰Përkundrazi, kush je ti, o njeri, që i kthen fjalën Perëndisë? Gjëja së cilës i jepet formë nuk i thotë atij që i jep formë, “Pse më bërë kështu,” apo jo? ²¹Apo nuk ka të drejtë poçari mbi argjilën, për të bërë nga e njëjta masë një enë për përdorim të nderuar, dhe një tjetër për përdorim të përditshëm? ²²Çfarë të themi nëse Perëndia, megjithëse i gatshëm për të demonstruar zemërimin e Tij dhe për ta bërë të njohur fuqinë e Tij, duroi me shumë durim enët e zemërimit të përgatitura për shkatërrim? ²³Dhe Ai e bëri këtë për të bërë të njohura pasuritë e lavdisë së Tij mbi enët e mëshirës, që Ai i përgatiti që më parë për lavdi, ²⁴ne, që edhe na thirri, jo vetëm nga hebrenjtë, por edhe nga johebrenjtë. ²⁵Siç thotë edhe te Osea, “UNË DO T’I QUAJ ATA QË NUK ISHIN POPULLI IM, ‘POPULLI IM,’ DHE ATË QË NUK ISHTE E DASHUR, ‘TË DASHUR.’” ²⁶DHE DO TË NDODHË QË NË VENDIN KU U ISHTE THËNË, ‘JU NUK JENI POPULLI IM,’ ATJE ATA DO TË QUHEN BIJ TË PERËNDISË SË GJALLË.”

9:19 “kush i reziston vullnetit të Tij” Kjo është DËFTORE VEPRORË E KRYER, që thekson një fakt të përfunduar me rezultate që vazhdojnë (krh. II Kron. 20:6; Job 9:12; Ps. 135:6; Dan. 4:35). Diatribi vazhdon. Logjikisht, ndjekja e diatribit të Palit është mënyra më e mirë për të përvijuar dhe kuptuar mendimin e Palit. Shih hyrjen e kapitullit, B., 1. Vullneti i Perëndisë duhet parë në dy nivele. I pari është planet e Tij shpenguese për gjithë racën e rënë njerëzore (krh. Zan. 3:15). Këto plane nuk ndikohen nga zgjedhjet individuale njerëzore. Por në nivelin e dytë, Perëndia zgjedh të përdorë instrumente njerëzore (krh. Eksodi 3:7-9 dhe 10). Njerëzit zgjidhen për të përmbushur planet e Tij (si në mënyrë pozitive, Moisiu, ashtu edhe negative, Faraoni).

9:20-21 Kjo figurë është marrë nga Isa. 29:16; 45:9-13; 64:8 dhe Jer. 18:1-12. Metafora e YHWH si një poçar përdorej shpesh për Perëndinë si krijues, sepse njerëzimi është bërë nga argjila (krh. Zan. 2:7). Pali e sqaroi argumentin e tij të sovranitetit të Krijuesit duke përdorur edhe tre pyetje të tjera—dy të parat në v. 20 dhe e treta në v. 21. Pyetja e fundit i kthehet analogjisë së zgjedhjes pozitive të Perëndisë në Moisiun dhe të zgjedhjes negative në Faraonin. I njëjti kontrast shihet në

1. Isak – Ismael, vv. 8-9
2. Jakob – Esau në vv. 10-12
3. kombi i Izraelit dhe kombi i Edomit në v. 13

Po e njëjta analogji zhvillohet për të reflektuar situatën bashkëkohore të Palit të hebrenjve besimtarë dhe atyre jobesimtarë. Zgjedhja pozitive e Perëndisë shprehet në mënyrën më të qartë në përfshirjen e johebrenjve besimtarë (vv. 24-29, 30-33)!

Forma gramatikore kërkon

1. një përgjigje “jo” ndaj pyetjes së v. 20
2. një përgjigje “po” ndaj pyetjes së v. 21

9:22 “nëse” Kjo është një FJALI e pjesëshme KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, por pa konkluzion gramatikor. Vargjet 22-24 janë një fjali në greqisht. Vargu 22 shpreh karakterin shpengues të Perëndisë. Perëndia është Perëndi i drejtësisë. Ai do t’i kërkojë llogari njerëzimit për

veprat e tyre. Por Ai është edhe Perëndi i mëshirës. Të gjithë njerëzit meritojnë të vdesin (krh. 1:18-3:21). Drejtësia nuk është lajm i mirë! Karakteri i Perëndisë është kryesisht mëshira, jo zemërimi (krh. LiP.5:9-10; 7:9; Osea 11:8-9). Zgjedhjet e Tij janë për shpengim (krh. Ezek. 36:22-33). Ai është i duruar me njerëzimin mëkatar (krh. Ezek. 18). Ai madje përdor edhe të keqen për qëllimet e Tij shpenguese (p.sh., Satanin, Faraonin, mediumen e En Dorit, Asirinë, Nebukadnetsarin, Kirin, dhe në kapitullin 11, Izraelin mosbesues)!



NASB “i gatshëm për të demonstruar zemërimin e Tij”
NKJV “duke dashur të tregonte zemërimin e Tij”
NRSV “duke dëshiruar të tregonte zemërimin e tij”
TEV “donte të tregonte inatin e tij”
NJB “është gati të tregojë inatin e tij”

Perëndia e demonstroi zemërimin e Tij për të bërë të njohur edhe fuqinë e Tij, (krh. v. 22) edhe pasuritë e lavdisë së Tij (krh. v. 23). Veprimet e Perëndisë gjithmonë kanë qëllime shpenguese (përveç *Gehennës*, që është izolimi final i mosbesimit dhe mëkatit të ngurtësuar).

▣ **“enët e zemërimit”** Ky term vazhdon metaforën e Palit të argjilës nga vv. 20 dhe 21. Ato me sa duket iu referohen qenieve njerëzore mosbesuese që Perëndia i përdor për të çuar përpara planin e Tij të shpengimit.



NASB, NKJV “të përgatitura”
NRSV “janë bërë”
TEV “destinuar”
NJB “projektuar”

Kjo është një PJESORE E KRYER PËSORE. Fjala është përdorur në papiruset (Moulton dhe Milligan) për diçka të përgatitur për fatin e saj përfundimtar. Mosbesimi rebelues do të ketë ditën e tij të drejtësisë dhe pasojat. Megjithatë, Perëndia zgjedh të përdorë jobesimtarët për të përmbushur qëllimet e Tij më të gjera, gjithëpërfshirëse shpenguese.

M. R. Vincent, *Word Studies*, vëll. 2, thotë “Jo të përgatitur nga Perëndia për shkatërrim, por në një kuptim MBIEMËROR, *gati, të pjekur* për shkatërrim, duke qenë se pjesorja tregon një gjendje të tashme të formuar më parë, por nuk na tregon asgjë se si është formuar” (p. 716).

▣ **“shkatërrim”** Shih Temën e Veçantë te 3:3.

9:23 “për të bërë të njohura pasuritë e lavdisë së Tij mbi enët e mëshirës” Kjo FJALI E VARUR QËLLIMORE tregon synimin e përgjeshëm të Perëndisë (d.m.th., mëshirën). FOLJA është në MËNYRËN LIDHORE AORISTE VEPRORE. Perëndia i bëri të njohura pasuritë e Tij duke dërguar Jezusin!

Pali shpesh u referohet pasurive të

1. mirësisë, zemërgjerësisë dhe durimit të Tij, Rom. 2:4
2. lavdisë së Tij ndaj enëve të mëshirës, Rom. 9:23
3. hirit të Tij, Efe. 1:7
4. lavdisë së trashëgimisë së Tij, Efe. 1:18
5. hirit të Tij në mirësi ndaj nesh në Krishtin, Efe. 2:7
6. Krishtit ndaj johebrenjve, Efe. 3:8
7. lavdisë së Tij, Efe. 3:16
8. lavdisë së misterit të Tij ndër johebrenjtë, që është Krishti në ju, shpresa e lavdisë, Kol. 1:27

▣ **“që Ai i përgatiti që më parë për lavdi”** E njëjta e vërtetë thuhet edhe te Rom. 8:29-30 dhe Efe. 1:4,11. Ky kapitull është shprehja më e fortë e sovranitetit të Perëndisë në DHR. Nuk mund të ketë diskutim që Perëndia është në kontroll të plotë të krijimit dhe shpengimit! Kjo e vërtetë e madhe nuk duhet zbutur asnjëherë dhe as duhet justifikuar me mjeshtëri. Megjithatë, ajo duhet balancuar me zgjedhjen nga ana e Perëndisë të besëlidhjes si një mjet për të ndërvepruar me krijimin njerëzor, të bërë në imazhin e Tij. Është patjetër e vërtetë që disa besëlidhje të DHV, si Zan. 9:8-17 dhe 15:12-21, janë të pakushtëzuara dhe nuk lidhen fare me reagimin njerëzor, por besëlidhje të tjera janë të kushtëzuara nga reagimi njerëzor (d.m.th., Edeni, Noeu, Moisiu, Davidi). Perëndia ka një plan shpengimi për krijimin e Tij dhe asnjë qenie njerëzore nuk mund ta ndikojë këtë plan. Perëndia ka

zgjedhur të lejojë individët që të marrin pjesë në planet e Tij. Kjo mundësi për pjesëmarrje është një tension teologjik midis sovranitetit (Romakëve 9) dhe vullnetit të lirë njerëzor (Romakëve 10).

Nuk është mirë të përzgjedhësh një theks biblik dhe të injorosh tjetrin. Ka tension midis doktrinave sepse popujt lindorë i paraqesin të vërtetat në çifte dialektike, ose të mbushura me tension. Doktrinat duhen mbajtur në marrëdhënie me doktrina të tjera. E vërteta është një mozaik të vërtetash.

Patjetër që këtu ka një mister! Pali nxjerr konkluzionin logjik që jobesimtarët janë përgatitur (*kataptizō*) për zemërim (v. 22) dhe besimtarët përgatitur (*proetoimazō*) për lavdi (v. 23). Është zgjedhja e Perëndisë i vetmi faktor, apo bazohet zgjedhja e Perëndisë në mëshirë për të gjithë, por disa e hedhin poshtë ofertën e Tij? A luan njerëzimi ndonjë rol në të ardhmen e tij (krh. 9:30-10:21)? Ka mbitheksime nga të dyja anët (Augustin - Pelagius). Për mua koncepti i besëlidhjes i bashkon të dyja me theksin mbi Perëndinë. Njerëzimi mund të reagojë vetëm ndaj iniciativave të Perëndisë (p.sh., Gjoni 6:44,65). Por për mua, karakteri i Perëndisë nuk është kapriçoz, por i mëshirshëm. Ai i zgjat dorën gjithë krijimit të vetëdijshëm njerëzor të bërë në imazhin e Tij (krh. Zan. 1:26,27). Unë e kam të vështirë me këtë kontekst. Ai është kaq i fuqishëm, e megjithatë pikturon bardh e zi. Fokusi i tij është mosbesimi hebre, që rezulton në përfshirjen e johebrenjve (kapitulli 11)! Por ky nuk është i vetmi tekst mbi karakterin e Perëndisë!

■ **“lavdi”** Shih shënimin te 3:23.

9:24 Ky varg tregon që objekti i premtimit të Perëndisë është më i gjerë sesa Izraeli si komb. Perëndia ka treguar mëshirë mbi njerëzimin bazuar në zgjedhjen e Tij. Premtimi i Zan. 3:15 lidhet me të gjithë njerëzimin (sepse nuk ka hebrenj deri në kapitullin 12). Thirrja e Abrahamit kishte lidhje me të gjithë njerëzimin, Zan. 12:3. Thirrja e Izraelit si një mbretëri priftërinjsh kishte lidhje me të gjithë njerëzimin (krh. Eksodi 19:5-6)! Ky është misteri i Perëndisë, që ishte fshehur, por tani është zbuluar plotësisht (krh. Efe. 2:11-3:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11).

Deklarata e Palit në v. 24 do të ilustron nga një seri citimesh nga DHV (vv. 25-29).

1. vargu 25, Osea 2:23
2. vargu 26, Osea 1:10b
3. vargu 27, Isaia 10:22 dhe/ose Osea 1:10a
4. vargu 28, Isaia 10:23
5. vargu 29, Isaia 1:9

9:25-26 Në kontekst ky pasazh është nga Septuaginta (LXX) e Osea 2:23 (me disa modifikime) dhe 1:10, ku ai i referohet Dhjetë Fiseve të Veriut, por këtu Pali u referohet johebrenjve. Kjo është tipike e përdorimit të DHV nga autorët e DHR. Ata e shikonin kishën si përmbushjen e premtimeve ndaj Izraelit (krh. II Kor. 6:16; Titit 2:14; I Pjet. 2:5-9). Në kontekst pasazhi te Osea i referohet Izraelit të pabesë. Nëse Perëndia mund të restauronte Dhjetë Fiset Veriore idhujtare, Pali e pa këtë si provë të dashurisë dhe faljes së Perëndisë që një ditë do të përfshinte edhe paganët idhujtarë (johebrenjtë).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:27-29

²⁷Isaia thërret në lidhje me Izraelin, “EDHE SIKUR NUMRI I BIJVE TË IZRAELIT TË ISHTE SI RËRA E DETIT, ËSHTË MBETJA QË DO TË SHPËTOHET; ²⁸SEPSE ZOTI DO TA EKZEKUTOJË FJALËN E TIJ MBI TOKË, TËRËSISHT DHE SHPEJT.” ²⁹Dhe ashtu si e paratha Isaia, “NËSE ZOTI I SABAOTHIT NUK DO TË NA KISHTE LËNË NJË PASARDHJE, NE DO TË ISHIM BËRË SI SODOMA, DHE DO T’I NGJANIM GOMORRËS.”

9:27

NASB, NKJV,

NRSV, NJB “edhe sikur”

TEV

“edhe nëse”

Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË (*ean* plus MËNYRËN LIDHORE), që tregon veprim të mundshëm.

9:27-28 Ky është një citim i lirshëm nga Septuaginta (LXX) e Isaia 10:22-23. Textus Receptus shtoi një frazë përmblyëse nga Septuaginta e Isa. 10:23. Por ajo mungon te dorëshkrimet në greqisht P⁴⁶, X, A, dhe B, gjë që tregon se kjo ishte një shtesë e mëvonshme nga një kopist. UBS⁴ e vlerëson mungesën e saj si “të sigurt.”

9:27 “SI RËRA E DETIT” Kjo është pjesë e gjuhës metaforike, hiperbolike të premtimeve të Perëndisë ndaj Abrahamit (krh. Zan.15:5; 22:17; 26:4).

■ **“MBETJA QË DO TË SHPËTOHET”** Termi “mbetje” është përdorur shpesh në Profetët e DHV për t’iu referuar atyre Izraelitëve që u çuan në mërgim, por që do të silleshin përsëri në tokën e premtuar nga Perëndia. Në përdorimin nga Pali të termit, ai u referohet atyre hebrenjve që kishin një marrëdhënie besimi me Perëndinë dhe/ose atyre që e dëgjuan ungjillin dhe reagues me besim ndaj Krishtit.

Edhe brenda Izraelit të Besëlidhjes ndodhi një ndarje shpirtërore, vetëm disa ishin në marrëdhënie të drejtë me Perëndinë. Zgjedhja e Izraelit nuk e përjashtonte nevojën për një reagim individual me besim (krh. Isa. 1:16-20).

Pali po përdor frazën e DHV që fillimisht i referohej mërgimtarëve hebrenj, vetëm një pjesë e të cilëve u kthyen në Palestinë, për t’iu referuar atyre që e dëgjuan ungjillin, por numri më i madh i tyre nuk besoi dhe nuk e pranoi Krishtin. Vetëm një përqindje e vogël e dëgjuesve të shekullit të parë (hebrenj dhe johebrenj) iu përgjigjën mesazhit të ungjillit. Pali i quan ata që u përgjigjën, mbetja.

TEMË E VEÇANTË: MBETJA, TRE KUPTIME

Koncepti i DHV i “një mbetjeje besnike” është një temë e përsëritur e Profetëve (kryesisht në profetët e shekullit të tetë dhe Jeremia). Ajo përdoret në tre kuptime:

1. ata që i mbijetuan mërgimit (p.sh., Isa. 10:20-23; 17:4-6; 37:31-32; Jer. 42:15,19; 44:12,14,28; Amos 1:8)
2. ata që mbeten besnikë ndaj YHWH (p.sh., Isa. 4:1-5; 11:11,16; 28:5; Joel 2:32; Amos 5:14-15; Mikea 2:12-13; 4:6-7; 5:7-9; 7:18-20)
3. ata që janë pjesë e ripërtëritjes dhe rikrijimit eskatologjik (p.sh., Amos 9:11-15)

Në këtë kontekst Perëndia zgjedh vetëm disa (ata me një zell besnik) nga mbetja (të mbijetuarit e Mërgimit) për t’i kthyer në Judë. Siç e kemi parë më parë në këtë kapitull, përsëriten lajtmotive nga e kaluara e Izraelit (v. 6). Perëndia po i redukton numrat në mënyrë që Ai të tregojë fuqinë, sigurimin dhe kujdesin e Tij (p.sh., Gedeoni, Gjyq. 6-7).

9:28

NASB	“tërësisht dhe shpejt”
NKJV	“mbarojë. . .ndërpresë”
NRSV	“shpejt dhe vendosmërisht”
TEV	“shpejt do ta mbyllë plotësisht llogarinë”
NJB	“pa hezitim apo vonesë”
REB	“do të jetë përbyllëse dhe përfundimtare”
NIV	“me shpejtësi dhe përfundimisht”
NET	“plotësisht dhe shpejt”

Të dyja fjalët greke përbëjnë një lojë fjalësh (fjalët e përbëra me *sun* kaq të zakonshme te Pali).

1. *suntelōn*, PJESORE E TASHME VEPRORE e
 - a. *sun*
 - b. *teleō*

që kryesisht do të thotë “të finalizosh” apo “të jetë plotësisht e realizuar” (krh. Marku 13:4; Luka 4:2,13; Veprat 21:27; Heb. 8:8)

2. *suntemnōn*, PJESORE E TASHME VEPRORE e
 - a. *sun*
 - b. *temnō*

që kryesisht do të thotë “të ndërpresësh” ose “të ekzekutosh shpejt” (gjendet vetëm këtu, por një formë e lidhur me të është në Veprat 24:4)

Atje ku përdoren këto lojëra me tingullin, vetëm konteksti të ndihmon, jo etimologjia apo paralelet.

Perëndia ka një qëllim dhe plan për shpëtimin e popullit të Tij të vërtetë dhe për gjykimin e të gjithë të tjerëve!

Ky varg është i vështirë për t'u interpretuar prandaj disa skribë më vonë u përpoqën t'i shtonin fraza për ta qartësuar kuptimin e tij sipas mendimit të tyre. UBS⁴ i jep tekstit më të shkurtër vlerësimin "A" (i sigurt).

9:29 Ky është një citim nga LXX e Isaia 1:9, që dënon mëkatshmerinë e Izraelit etnik.

■ **"ZOTI I SABAOTHIT"** Ky ishte një titull i DHV për YHWH, që zakonisht përkthehej "Zoti i Ushtrive" (krh. Jakobi 5:4). Në varësi të kontekstit, ai i referohej Perëndisë në një kuptim ushtarak, "kapiteni i ushtrive të qiellit" (krh. Joz. 5:13-15), ose në një kuptim administrativ, zakonisht në një kontekst të politeizmit yjor babilonas që lidhej me trupat qiellorë, "Zoti i trupave qiellorë." Yjet janë krijime, jo perëndi; ata nuk i kontrollojnë dhe nuk u japin formë ngjarjeve (krh. Zan. 1:16; Psa. 8:3; 147:4; Isa. 40:26).

TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË

A. *El* (BDB 42, KB 48)

1. Kuptimi fillestar i këtij termi të përgjithshëm e të lashtë për Perëndinë është i paqartë, ndonëse shumë studiues besojnë se vjen nga rrënja akadiane "jam i fortë", ose "jam i fuqishëm" (shih Zan. 17:1; Num. 23:19; LiP. 7:21; Psa. 50:1).
2. Në panteonin kanaanit, perëndia i lartë është *El* (tekstet e Ras Shamras).
3. Në Bibël, zakonisht, *El* shoqërohet me terma të tjerë. Këto kombinime bëhen një mënyrë për të karakterizuar Perëndinë.
 - a. *El-Eljon* (Perëndia Shumë i Lartë, BDB 42 & 751 II), Zan. 14:18-22; LiP. 32:8; Isa. 14:14
 - b. *El-Roi* ("Perëndia që sheh", ose "Perëndia që zbulon veten", BDB 42 & 909), Zan. 16:13
 - c. *El-Shaddai* ("Perëndia i Gjithëfuqishëm", ose "Perëndia i Gjithëmëshirshëm", ose "Perëndia i malit", BDB 42 & 994), Zan. 17:1; 35:11; 43:14; 49:25; Eks. 6:3
 - d. *El-Olam* (Perëndia i Përjetshëm, BDB 42 & 761), Zan. 21:33. Ky term lidhet nga ana teologjike me premtimin e Perëndisë për Davidin, 2 Sam. 7:13, 16
 - e. *El-Berit* ("Perëndia i Besëlidhjes", BDB 42 & 136), Gjyq. 9:46
4. *El* barazohet me
 - a. YHWH, në Psa. 85:8; Isa. 42:5
 - b. *Elohim* në Zan. 46:3; Jobi 5:8, "Unë jam *El*, *Elohim* i atit tuaj"
 - c. *Shaddai*, në Zan. 49:25
 - d. "xhelozinë", në Eks. 34:14; LiP. 4:24; 5:9; 6:15
 - e. "mëshirën" në LiP. 4:31; Neh. 9:31;
 - f. "i madh dhe i mahnitshëm" në LiP. 7:21; 10:17; Neh. 1:5; 9:31; Dan. 9:4
 - g. "njohurinë", në 1 Sam. 2:3
 - h. "streha ime e fuqishme", në 2 Sam. 22:33
 - i. "hakmarrësi im", në 2 Sam. 22:49
 - j. "i shenjti", në Isa. 5:16
 - k. "fuqi", në Isa. 10:21
 - l. "shpëtimi im", në Isa. 12:2
 - m. "i madh dhe i fuqishëm", në Jer. 32:19
 - n. "shpagim", në Jer. 51:56
5. Një kombinim i të gjithë emrave kryesore të Perëndisë në DhV gjendet në Jozueu 22:22 (*El*, *Elohim*, *YHWH*, të përsëritur)

B. *Eljon* (BDB 751, KB 832)

1. Kuptimi bazë i kësaj fjale është "i lartë", "i lartësuar", ose "i ngritur lart" (shih Zan. 40:17; 1 Mbret. 9:8; 2 Mbret. 18:17; Neh. 3:25; Jer. 20:2; 36:10; Psa. 18:13).
2. Përdoret në kuptim paralel me disa emra/tituj të tjerë të Perëndisë.
 - a. *Elohim* - Ps. 47:1-2; 73:11; 107:11
 - b. *YHWH* - Zan. 14:22; 2 Sam. 22:14
 - c. *El-Shaddai* - Psa. 91:1, 9
 - d. *El* - Num. 24:16
 - e. *Elah* - përdoret shpesh te Danieli 2-6 dhe Esdra 4-7, lidhet me *illair* (aramaisht, "Perëndia i Lartë"), te Dan. 3:26; 4:2; 5:18, 21

3. Përdoret shpesh nga johebrenjtë.
 - a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:16
 - c. Moisiu, që u flet kombeve te LiP. 32:8
 - d. Ungjilli i Lukës në DhR, që u shkruhet johebrenjve, përdor ekuivalentin grek *Hupsistos* (shih 1:32, 35, 76; 6:35; 8:28; Veprat 7:48; 16:17)
- C. *Elohim* (SHUMËS), *Eloah* (NJËJËS), që përdoren kryesisht në poezi (BDB 43, KB 52)
 1. Ky term nuk gjendet jashtë Dhiatës së Vjetër.
 2. Kjo fjalë mund të nënkuptojë Perëndinë e Izraelit ose perënditë e kombeve (shih Eks. 12. 12; 20:3). Familja e Abrahamit ishte politeiste (shih Joz. 242).
 3. Mund t’u referohet gjyqtarëve të Izraelit (shih Eks. 216; Psa. 82:6).
 4. Termi *elohim* përdoret edhe për qenie të tjera shpirtërore (engjëjt, demonët), si te LiP. 32:8 (LXX) Psa. 8:5; Jobi 1:6; 38:7.
 5. Në Bibël, ky është emri/titulli i parë i Hyjnisë (shih Zan. 1:1). Është i vetmi që përdoret deri te Zan. 2:4, ku kombinohet me YHWH. Në thelb, nga ana teologjike, nënkupton Perëndinë si krijues, ruajtës dhe sigurues i gjithë jetës në këtë planet (shih Psalmi 104).
 Është sinonim me *El* (shih LiP. 32:15-19). Mund të jetë edhe term paralel me YHWH, pasi Psalmi 14 (*Elohim*) është plotësisht njësoj si Psalmi 53 (YHWH), me përjashtim të ndryshimit të emrave hyjnorë.
 6. Ndonëse SHUMËSI mund të përdoret edhe për perënditë e tjera, shpesh, ky term nënkupton Perëndinë e Izraelit, por zakonisht ajo që tregon kuptimin monoteist është FOLJA në NJËJËS.
 7. Ky term gjendet në gojën e joizraelitëve si emri i hyjnisë.
 - a. Melkicedeku, Zan. 14:18-22
 - b. Balaami, Num. 24:2
 - c. Moisiu, kur flet për kombet, LiP. 32:8
 8. Është e çuditshme që një emër i zakonshëm i Perëndisë monoteiste të Izraelit është në SHUMËS! Ndonëse nuk ka siguri, këto janë teoritë.
 - a. Hebraishtja ka shumë SHUMËSA, që shpesh përdoren për theksim. E lidhur ngushtë me këtë është një veçori e mëvonshme gramatikore e hebraishtes, që quhet “shumësi i madhështisë”, ku SHUMËSI përdoret për të përforcuar një koncept.
 - b. Kjo mund t’i referohet këshillit të engjëjve, me të cilët Perëndia takohet në qiell dhe të cilët bëjnë vullnetin e tij (shih 1 Mbret. 22:19-23; Jobi 1:6; Psa. 82:1; 89:5, 7).
 - c. Madje, është e mundur që kjo të reflektojë zbulësën në DhR e të një Perëndie në tre persona. Te Zan. 1:1, Perëndia krijon; Zan. 1:2, Fryma rri mbi ujërat, dhe, nga DhR, Jezusi është vepruesi i krijimit të Atit Perëndi (shih Gjoni 1:3, 1 Rom. 11:36; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15; Heb. 1:2; 2:10).
- D. YHWH (BDB 217, KB 394)
 1. Ky është emri që reflekton Hyjninë si Perëndia që bën besëlidhje; Perëndia si shpëtimtar, shpengues! Njerëzit i thyejnë besëlidhjet, kurse Perëndia është besnik ndaj fjalës, premtimit, besëlidhjes së vet (shih Psalmi 103).
 Ky emër përmendet për herë të parë në kombinim me *Elohim* në Zan. 2:4. Te Zan. 1-2 nuk gjenden dy rrëfime të krijimit, por dy theksime të tij: (1) Perëndia si krijuesi i universit (fizik) dhe (2) Perëndia si krijuesi i veçantë i njerëzimit. Zanafilla 2:4-3:24 nis zbulësën e veçantë për pozicionin dhe synimin e privilegjuar të njerëzimit, si dhe për problemin e mëkatit dhe rebelimit që shoqërojnë këtë pozitë unike.
 2. Në Zan. 4:26, thuhet se “njerëzit filluan t’i bënin thirrje emrit të ZOTIT” (YHWH). Mirëpo Eks. 6:3 nënkupton se populli i hershëm i besëlidhjes (patriarkët dhe familjet e tyre) e njihnin Perëndinë vetëm si *El-Shaddai*. Emri YHWH shpjegohet vetëm një herë në Eks. 3:13-16, sidomos në v. 14. Megjithatë, shkrimet e Moisiut shpesh i interpretojnë fjalët me lojëra të njohura fjalësh, jo me etimologji (shih Zan. 17:5; 27:36; 29:13-35). Ka patur disa teori për kuptimin e këtij emri (marrë nga IDB, vëll. 2 f. 409-11).

- a. nga një rrënjë fjale arabisht, “tregoj dashuri të zjarrtë”
 - b. nga një rrënjë fjale arabisht, “fryj” (YHWH si Perëndia i fortunës)
 - c. nga një rrënjë fjale ugarite (kanaanite), “flas”
 - d. nga një mbishkrim fenikas, një PJESORE SHKAKORE që do të thotë “Ai që mban”, ose “Ai që themelon”
 - e. nga forma *Kal* në hebraisht, “Ai që është”, ose “Ai që është i pranishëm” (në kuptimin e ardhshëm, “Ai që do të jetë”)
 - f. nga forma *Hifil* në hebraisht, “Ai që bën të jetë”
 - g. nga rrënja e fjalës hebraisht “jetoj” (p.sh. Zan. 3:20), që do të thotë “Ai që është i vetmi që jeton dhe që jeton gjithmonë”
 - h. nga konteksti i Eks. 3:13-16, një lojë fjalësh me formën E PAKRYER të përdorur në një kuptim TË KRYER, “Unë do të vazhdoj të jem ai që isha”, ose “do të vazhdoj të jem ai që kam qenë gjithmonë” (shih J. Wash Watts, *A Survey of Syntax në the Old Testament*, f. 67). Emri i plotë YHWH shpesh shprehet në formë të shkurtuar, ose, mundësisht, në një formë fillestare.
 - (1) *Jah* (p.sh. Halelu – jah, BDB 219, shih Eks. 15:2; 17:16; Psa. 89:8; 104:35)
 - (2) *Jahu* (fundi i emrave me “jah”, p.sh., Isa-jah)
 - (3) *Jo* (emrat që fillojnë me “Jo”, p.sh., Jozueu ose Joeli)
3. Në judaizmin e mëvonshëm, ky emër i besëlidhjes u bë caq i shenjtë (tetragramatoni), saqë judenjtë druheshin ta përdornin se mos shkelnin urdhrin e Eks. 20:7; LiP. 5:11; 6:13. Kështu, ata e zëvendësuan me termin hebraisht “pronar”, “zotëri”, “bashkëshort”, “zot” – *adon* ose *adonai* (zoti im). Kur vinin te fjala YHWH në leximin e pasazheve të DhV, ata shqiptonin “zot”. Ja pse YHWH shkruhet me të mëdha ZOT në përkthimet në anglisht.
4. Si në rastin e *El*-it, edhe YHWH shpesh kombinohet me terma të tjerë për të theksuar disa karakteristika të Perëndisë së Besëlidhjes me Izraelin. Ndonëse ka shumë terma të mundshëm për këto kombinime, ja disa prej tyre.
- a. *YHWH – Jire* (YHWH do të sigurojë, BDB 217 & 906), Zan. 22:14
 - b. *YHWH – Rofekha* (YHWH është shëruesi yt, BDB 217 & 950, PJESORJA *Kal*), Eks. 15:26
 - c. *YHWH – Nissi* (YHWH është flamuri im, BDB 217 & 651), Eks. 17:15
 - d. *YHWH – Mekaddishkem* (YHWH, Ai që të shenjtëron, BDB 217 & 872, PJESORE *Piel*), Eks. 31:13
 - e. *YHWH – Shalom* (YHWH është Paqe, BDB 217 & 1022), Gjyq. 6:24
 - f. *YHWH – Sabaoth* (YHWH i ushtrive, BDB 217 & 878), 1 Sam. 1:3, 11; 4:4; 15:2; shpesh në Profetët
 - g. *YHWH – Ro’I* (YHWH është bariu im, BDB 217 & 944, PJESORE *Kal*), Psa. 23:1
 - h. *YHWH – Cidkenu* (YHWH është drejtësia jonë, BDB 217 & 841), Jer. 23:6
 - i. *YHWH – Shamma* (YHWH është aty, BDB 217 & 1027), Ezek. 48:35



NASB	“nëse nuk. . .na kishte lënë një pasardhje”
NKJV	“nëse nuk. . .na kishte lënë një farë”
NRSV	“nuk kishte lënë të mbijetuar”
TEV	“nuk na kishte lënë disa pasardhës”
NJB	“nuk na kishte lënë disa të mbijetuar”

Teksti në hebraisht i Isa. 1:9 e ka “mbetje,” por Septuaginta e përktheu “farë” (NKJV). Gjykimi i Perëndisë ndaj Izraelit gjithmonë kurseu (1) mbetjen besimtare ose (2) linjën Mesianike. Perëndia kurseu të paktët për të arritur të shumtët.

■ “Sodoma. . .Gomorra” vargu 28 lidhet me gjykimin e Perëndisë. Ky varg përmend specifikisht dy qytete paganë që u shkatërruan nga Perëndia në Zan. 19:24-26, por ata u bënë një idiomë/shprehje frazeologjike për gjykimin e Perëndisë (krh. LiP. 29:34; Isa. 13:19; Jer. 20:16; 49:18; 50:40; Amos 4:11).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 9:30-33

³⁰Çfarë të themi atëherë? Që johebrenjtë, që nuk e ndoqën drejtësinë, e arritën drejtësinë, madje drejtësinë që është me anë të besimit; ³¹por Izraeli, duke ndjekur një ligj drejtësie, nuk arriti tek ai ligj. ³²Pse? Sepse ata nuk e ndoqën atë me anë të besimit, por sikur të ishte me anë të veprave. Ata u penguan te guri i pengesës, ³³ashtu siç është shkruar, “Ja, unë po vë në Sion një gur pengese dhe një shkëmb ofendimi, dhe ai që beson në Të nuk do të zhgënjehet.”

9:30-31 Ky është përfundimi habitës i qëllimit zgjedhës të Perëndisë. Vargjet 30-33 janë një përmbledhje e kapitullit 9 dhe një hyrje për kapitullin 10. Johebrenjtë besimtarë janë pajtuar me Perëndinë, por jo të gjithë hebrenjtë (krh. v. 6)!

Perëndia hyn në marrëdhënie me njerëzimin në mënyrë besëlidhore. Perëndia gjithmonë merr iniciativën dhe vendos kushtet.

Individët duhet të përgjigjen me pendim dhe besim, bindje dhe këmbëngulje. A shpëtohen njerëzit

1. prej sovranitetit të Perëndisë
2. prej mëshirës së Perëndisë përmes besimit në punën e përfunduar të Mesias
3. prej një akti personal besimi?

Për “ndjek” shih shënimin te 14:19.

9:30 “Drejtësia” Për këtë grup fjalësh shih Temën e Veçantë te 1:17. EMRI përdoret tri herë në v. 30 dhe një herë në v. 31. “Drejtësia” e besimit vihet në kontrast me “drejtësinë” e ligjit. Përsëri kontrasti midis besëlidhjes së vjetër dhe besëlidhjes së re. Problemet me besëlidhjen e vjetër hapin derën e ungjillit për të gjithë botën në kapitullin 11.

9:32 “me anë të veprave” Textus Receptus shtoi “të ligjit.” Kjo ishte një shtesë nga kopist i mëvonshëm. Pali shpesh përdori këtë frazë “veprat e ligjit” (krh. 3:20,28; Gal. 2:16; 3:2,5,10). Megjithatë, dorëshkrimet e lashta greke P⁴⁶, κ*, A, B, F, dhe G nuk e kanë këtë term në këtë varg. UBS⁴ e vlerëson tekstin më të shkurtër “B” (pothuaj të sigurt).

Çelësi për drejtësinë e Perëndisë nuk është performanca/veprat njerëzore, por karakteri dhe dhurata e Perëndisë përmes Krishtit. Drejtësia është një arritje e pamundur për njerëzimin e rënë, por ajo është një dhuratë e ofruar falas përmes besimit në Krishtin (krh. 3:21-31). Megjithatë, ajo duhet marrë (krh. v. 33; Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 4:1ff; 10:9-13; Efe. 2:8-9). Kjo është e vërteta që nuk kuptojnë hebrenjtë e sinqertë, fetarë dhe moralë (dhe të gjithë legalistët)!

George Eldon Ladd në librin e tij *A Theology of the New Testament (Një teologji e Dhiatës së Re)*, thotë diçka me vend:

“Mësimi i Palit në lidhje me Ligjin shpesh shihet nga këndvështrimi i përvojës historike, ose të Palit vetë, si rabin hebre, ose të një hebreu tipik të shekullit të parë nën Ligjin. Megjithatë, mendimi i Palit nuk duhet parë as si rrëfim i autobiografisë së tij shpirtërore, as si një përshkrim i karakterit legalist të Fariseizmit të shekullit të parë, por si një interpretim teologjik nga një mendimtar i krishterë i dy rrugëve të drejtësisë: legalizmit dhe besimit” (fq. 495).

9:33 Kjo është marrë nga Isa. 28:16 bashkuar me 8:14.

“Ja, unë vë në Sion një gur,” 28:16a

“pengese dhe një shkëmb ofendimi,” 8:14b

“dhe ai që beson në Të nuk do të zhgënjehet,” 28:16b

Duke i bashkuar këto dy vargje në këtë mënyrë (teknikë rabinike) ai ndryshon kuptimin e Isa. 28:16 nga pozitiv në negativ. Pali e manipulon DHV për qëllimet e tij.

1. Ai zgjedh cilin përkthim (LXX, MT, ose të tjin)
2. Ai ndryshon referencat (nga mërgimi tek johebrenjtë)
3. Ai bashkon tekste
4. Ai transferon tituj dhe PËREMRA që i referohen YHWH tek Jezusi

■ **“ai që beson në Të nuk do të zhgënjehet”** Kjo është nga Isa. 28:16b. Ajo citohet edhe te Rom. 10:11 dhe është e ngjashme me Joelin 2:32, që citohet në Rom. 10:13. Çelësi për shpëtim është edhe (1) objekti (guri i qoshes), edhe (2) pranimi personal i individit (besimi në Të). Shih Temën e Veçantë: Besoj në 4:5.

■ **“NJË GUR”** Ky ishte fillimisht një titull për Perëndinë (krh. Ps. 18:1-2,31,46; LiP. 32:18; I Sam. 2:2; Ps. 28:1; 31:3; 42:9; 71:3; 78:35), por me kalimin e kohës u bë titull Mesianik (krh. Zan. 49:24; Ps. 118:22; Isa. 8:14; 28:16; Dan. 2:34-35, 44-45; Mat. 21:42-44). Elementi kyç i premtimit besëlidhor të Perëndisë (Mesias) u keqkuptua dhe u refuzua/u hodh poshtë (krh. I Kor. 1:23). Hebrejët keqkuptuan jo vetëm qëllimin e Mesias, por edhe kërkesat themelore të besëlidhjes së Perëndisë. Krishti u bë për hebrejët një shkak për t’u penguar (krh. Isa. 8:14; Luka 2:34), por për besimtarët, qofshin ata hebrej apo johebrej, Ai u bë guri i themelit (krh. Isa. 28:16; I Pjet. 2:6-10).

TEMË E VEÇANTË: GURI I QOSHES

I. Përdorimet e DHV

1. Koncepti i një guri si një send i fortë dhe i qëndrueshëm që formonte një themel të mirë përdorej për të përshkruar YHWH (krh. Ps. 18:2).
2. Pastaj ai u bë me kalimin e kohës një titull Mesianik (krh. Zan. 49:24; Ps. 118:22; Isa. 28:16).
3. Filloi të përfaqësonte një gjykim nga YHWH prej Mesias (krh. Isa. 8:14; Dan. 2:34-35,44-45).
4. Kjo u kthye në një metaforë ndërtimi.
 1. një gur themeli, ai që vendosej i pari, që ishte i sigurt dhe përcaktonte këndet për pjesën tjetër të ndërtesës, i quajtur “guri i qoshes”
 2. ai mund t’i referohej edhe gurit të fundit që vendosej në vend, që i mbante muret së bashku (krh. Zak. 4:7; Efe. 2:20,21), i quajtur “guri i kreut,” nga hebraishtja *rush* (d.m.th., kokë)
 3. ai mund t’i referohej “gurit kyç,” që është në qendër të harkut të derës dhe mban peshën e gjithë murit

II. Përdorimet e DHR

1. Jezusi e citoi Psalmin 118 disa herë duke iu referuar Vetes (krh. Mat. 21:41-46; Mark 12:10-11; Luka 20:17)
2. Pali e përdori Psalmin 118 në lidhje me hedhjen poshtë nga YHWH të Izraelit të pabesë dhe rebel (krh. Rom. 9:33)
3. Pali përdor konceptin e një “guri qosheje” në Efe. 2:20-22 duke iu referuar Krishtit
4. Pjetri e përdor këtë koncept të Jezusit të I Pjet. 2:1-10. Jezusi është guri i qoshes dhe besimtarët janë gurët e gjallë (d.m.th., besimtarët si tempuj, krh. I Kor. 6:19), të ndërtuar mbi Të (d.m.th., Jezusi është Tempulli i ri, krh. Mark 14:58; Mat. 12:6; Gjoni 2:19-20). Hebrejët hodhën poshtë vetë themelin e shpresës së tyre kur hodhën poshtë Jezusin si Mesia.

III. Deklarata teologjike

1. YHWH lejoi Davidin/Salomonin të ndërtonin një tempull. Ai u tha atyre që nëse do ta mbanin besëlidhjen, Ai do t’i bekonte dhe do të ishte me ta (krh. II Samuelit 7), por nëse jo, tempulli do të rrënohej (krh. I Mbret. 9:1-9)!
2. Judaizmi rabinik fokusohej në formën dhe ritualin, dhe e linte pas dore aspektin personal të besimit (krh. Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). Perëndia kërkon një marrëdhënie të përditshme, personale, të perëndishme me ata që janë krijuar në imazhin e Tij (krh. Zan. 1:26-27). Luka 20:17-18 përmban fjalë frikësuese gjykimi, e po ashtu edhe Mat. 5:20, që i drejtohen judaizmit.
3. Jezusi e përdori konceptin e tempullit për të përfaqësuar trupin e Tij fizik (krh. Gjoni 2:19-22). Kjo vazhdon dhe zgjeron konceptin që besimi personal në Jezusin si Mesia është kyç për një marrëdhënie me YHWH (d.m.th., Gjoni 14:6; I Gjoni 5:10-12).
4. Shpëtimi ka si synim të restaurojë imazhin e dëmtuar të Perëndisë në qeniet njerëzore (Zan. 1:26-27 dhe kapitulli 3) në mënyrë që të bëjë të mundur bashkësinë me Perëndinë. Synimi i krishtërit është ngjashmëri me Krishtin tani. Besimtarët duhet të bëhen gurë të gjallë (d.m.th., tempuj të vegjël të ndërtuar/modeluar sipas Krishtit).
5. Jezusi është themeli i besimit tonë dhe guri i kreut i besimit tonë (d.m.th., Alfa dhe Omega). E megjithatë, edhe guri i pengimit dhe shkëmbi i ofendimit. Të mos kesh Atë, është të humbasësh çdo gjë. Nuk mund të ketë rrugë të mesme këtu!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si lidhet kapitulli 9 (paracaktimi) me kapitullin 10 (vullneti i lirë i njeriut)?
2. Cili është lajtmotivi kryesor i kapitullit 9:1-29?
3. A e ka shkelur Perëndia premtimin e Tij ndaj Izraelit?
4. Listo privilegjet që ka gëzuar kombi i Izraelit (9:4-5).
5. A ishin të gjithë hebrenjtë në pozitë të drejtë me Perëndinë? Pse po, ose pse jo (9:6)?
6. Nëse njeriu detyrohet të bëjë vullnetin e Perëndisë a është ai moralisht përgjegjës?
7. Si është “mëshira” kyç për paracaktimin (krh. 15, 16, 18, 23; 11:30-32)?

ROMAKËVE 10

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Izraeli dhe ungjilli 9:30-10:4	Izraeli ka nevojë për ungjillin 10:1-13	Drejtesia e vërtetë është me anë të besimit 9:30-10:4	Izraeli dhe ungjilli 9:30-10:4	Izraeli nuk arrin të shohë që është Perëndia Ai që na bën të shenjtë 10:1-4
Shpëtimi për të gjithë 10:5-13	Izraeli e refuzon ungjillin	Izraeli është përgjegjës për dështimet e tij 10:5-13	Shpëtimi është për të gjithë 10:5-13	Dëshmia e Moisiut 10:5-13
10:14-21	10:14-21	10:14-17 10:18-21	10:14-17 10:18-21	10:14-15 10:16-17 10:18-21

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

- A. Paragrafi i parë
- B. Paragrafi i dytë
- C. Paragrafi i tretë
- D. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Kapitulli 10 fokusohet në mundësitë e Izraelit për t'iu përgjigjur ofertës së hirshme të shpëtimit në Krishtin që u bëri YHWH. Kapitulli 9 fliste për zgjedhjen e hebrenjve nga Perëndia me qëllimin e zgjedhjes së botës (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6), por hebrenjtë refuzuan ta përqaфонin zgjedhjen e Tij (d.m.th., bindjen besëlidhore, krh. LIP 27-29).
- B. Pali po vazhdon ta përdorë DHV për të mbrojtur argumentin e tij për ungjillin (shih Të dhëna kontekstuale, pika E e kapitullit 9). Kjo është karakteristike e predikimeve apostolike të Veprave, që njihen si *kerygma* (d.m.th., ajo që shpallej). Shih Temën e Veçantë: *Kerygma* në 1:2.

- C. Të vërtetat qendrore të 9:30-10:4 janë
1. Johebrenjtë kanë drejtësinë e Perëndisë përmes besimit në Krishtin
 2. Hebrenjtë nuk e kanë drejtësinë e Perëndisë për shkak të mungesës së besimit në Krishtin
 3. Ligji nuk mund të jepte drejtësi. Ajo është dhuratë e Perëndisë përmes besimit në Krishtin dhe nuk mund të fitohet me anë të veprave njerëzore (krh. 3:21-31)
- D. Bruce Corley dhe Curtis Vaughan në *A Study Guide Commentary, Romans*, botuar nga Zondervan, fq. 115-116, kanë një listë të mëkateve të hebrenjve që është e dobishme
1. krenari fetare, 10:2a
 2. verbëri shpirtërore, 10:2b, 3a
 3. vetë-drejtësi, 10:3b
 4. kokëfortësi të palëkundur, 10:4a
- Gjithashtu më pëlqejnë edhe shënimet e tyre përmbyllëse në fund të kapitullit 9 në lidhje me kapitullin 10, “Zgjedhja ndodh në predikimin e kryqit (krh. I Thes. 1:4-10), gjë që shpjegon se si mbrojtja klasike e sovranitetit hyjnor (9:6-29) mund të ndiqet nga pasazhi më i madh misionar në letrat e Palit (10:1-21). Mandati më i lartë për të predikuar ungjillin është njohuria që, duke e bërë atë, Perëndia është besnik të përmbushë qëllimin e Tij zgjedhës në Krishtin” (fq. 114).
- E. Ashtu si kapitulli 9, edhe kapitulli 10 ka citime të shumta nga DHV.
1. v. 5 – Lev. 18:5
 2. v. 6 – LiP. 30:12 me aluzion hyrës ndaj LiP. 9:4
 3. v. 7 – LiP. 30:13 me aluzion ndaj Ps. 107:26
 4. v. 8 – LiP. 30:14
 5. v. 11 – Isa. 28:16
 6. v. 13 – Joeli 2:32
 7. v. 15 – Isa. 52:7 ose Nahumi 1:15
 8. v. 16 – Isa. 53:1
 9. v. 18 – Ps. 19:4
 10. v. 19 – LiP. 32:21
 11. v. 20 – Isa. 65:1
 12. v. 21 – Isa. 65:2

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:1-4

¹Vëllezër, dëshira e zemrës sime dhe lutja ime te Perëndia për ta është për shpëtimin e tyre. ²Sepse unë dëshmoj për ta se ata kanë një zell për Perëndinë, por jo në përputhje me njohurinë. ³Sepse duke mos ditur për drejtësinë e Perëndisë dhe duke kërkuar të vendosin të tyren, ata nuk ia nënshtruan veten drejtësisë së Perëndisë. ⁴Sepse Krishti është përfundimi i ligjit për drejtësi ndaj kujtdo që beson.

10:1 “Vëllezër” Ky term shpesh është përdorur nga Pali për të prezantuar një temë të re (krh. 1:13; 7:1,4; 8:12).

▣ **“dëshira e zemrës sime dhe lutja ime te Perëndia për ta është për shpëtimin e tyre”** Pali besonte se hebrenjtë mund të shpëtoheshin dhe se lutja e tij për ta kishte ndikim. Ky është për habi argumenti ekuilibruar ndaj paracaktimit! Shih Temën e Veçantë: Lutja ndërmjetësuese në 9:3.

Ka një variacion në dorëshkrimet greke për “për ta.” Textus Receptus e zëvendëson me “për Izraelin.” Megjithatë, provat e dorëshkrimeve favorizojnë “për ta” (MSS P⁴⁶, κ*, B, C, D*, F, G). UBS⁴ i jep asaj një vlerësim “A” (të sigurt).

10:2 “ata kanë një zell për Perëndinë” Sinqeriteti dhe entuziazmi nuk mjaftojnë (krh. vv. 3-4). Pali e dinte mirë këtë (krh. Veprat 9:1; Gal. 1:14; Fil. 3:6)!

10:2-3 “por jo në përputhje me njohurinë. Sepse duke mos ditur për drejtësinë e Perëndisë” Termi “di/njoh” (v. 2, *epiginōskō*) mund të funksionojë në dy mënyra.

1. hebrejët nuk e kuptuan një ungujll falas (kuptimi grek i “di/njoh”)
2. hebrejët nuk kishin një marrëdhënie besimi me Perëndinë (kuptimi hebraik i “di/njoh,” krh. Zan. 4:1; Jer. 1:5)

Hebrejët nuk ishin të paditur për nevojën për një reagim/përgjigje ndaj Perëndisë (vv. 16,18,19), por ata e zëvendësuan besimin me veprat/performancën njerëzore, gjë që çoi në krenari, arrogancë dhe ekskluzivizëm/qëndrim përjashtues ndaj të tjerëve (v. 3a)!

TEMË E VEÇANTË: NJOH (duke përdorur si paradigmë kryesisht Ligjin e Përtërirë)

Fjala hebraisht “njoh” (BDB 393) ka një sërë kuptimesh (fushash semantike) në formën *Qal*.

1. kuptoj të mirën dhe të keqen – Zan. 3:22; LiP. 1:39; Isa. 7:14-15; Jona 4:11
2. njoh duke kuptuar – LiP. 9:2, 3, 6; 18:21
3. njoh përmes përvojës – LiP. 3:19; 4:35; 8:2, 3, 5; 11:2; 20:20; 31:13; Joz. 23:14
4. shqyrtoj – LiP. 4:39; 11:2; 29:16
5. njoh personalisht
 - a. një person – Zan. 29:5; Eks. 1:8; LiP. 22:2; 33:9
 - b. një perëndi – LiP. 11:28; 13:2, 6, 13; 28:64; 29:26; 32:17
 - c. YHWH – LiP. 4:35, 39; 7:9; 29:6; Isa. 1:3; 56:10-11
 - d. seksualisht – Zan. 4:1, 17, 25; 24:16; 38:26
6. një aftësi ose njohuri e mësuar – Isa. 29:11, 12; Amosi 5:16
7. të jesh i mençur – LiP. 29:4; Fja. 1:2; 4:1; Isa. 29:24
8. njohuria e Perëndisë
 - a. për Moisiun – LiP. 34:10
 - b. për Izraelin – LiP. 31:21, 27, 29

10:3 “drejtësinë e Perëndisë” Në kontekstin e kapitujve 9-11 kjo frazë i referohej pozitës së drejtë me Perëndinë që Ai ua vesh/llogarit njerëzve (Romakëve 4) bazuar vetëm në

1. mëshirën e Tij
2. veprën e përfunduar të Krishtit
3. tërheqjen e Frymës
4. reagimit me pendim dhe besim të njerëzimit mëkatar dhe bindjes dhe këmbënguljes së vazhdueshme

Ne mund ta kuptojmë lehtë se si hebrejët e keqkuptuan drejtësinë e Perëndisë. DHV theksonte bindjen ndaj Ligjit (krh. LiP. 4:28-6:3,17,24-25). Ajo që ata nuk kuptuan ishte ekuilibri i nevojshëm i besimit dhe pendimit (krh. LiP. 5:29-30; 6:5). Ligji i Përtërirë thotë qartë se Perëndia veprroi për Izraelin jo për shkak të drejtësisë së tyre, por për shkak të karakterit të Tij (krh. 9:6,7,13,24,27; 10:12-22; Ezek. 36:22-38). Madje edhe Kanaanejtë nuk u shpronësuan për shkak të drejtësisë së Izraelit, por për shkak të mëkatit të vet (krh. 9:4-6; Zan. 15:16). Shih Temën e Veçantë te 1:17.

■ **“ata nuk ia nënshtruan veten drejtësisë së Perëndisë”** FOLJA është një AORISTE PËSORE DËFTORE, por është përkthyer si DIATEZË JOVEPRORE (krh. TEV). Funkcioni i DIATEZËS JOVEPRORE po zëvendësohej nga DIATEZA PËSORE në greqishten Koine. Konteksti është faktori vendimtar.

Kjo është fjalë për fjalë “nënshtror” i cili është një term ushtarak për një zinxhir komande. Hebrejët u përpoqën ta fitonin drejtësinë e Perëndisë, por ajo ishte dhuratë (krh. 3:24; 5:15; 6:23; Efe. 2:8-9). Pali e pa këtë të vërtetë qartë në rrugën për në Damask.

TEMË E VEÇANTË: NËNSHTRIMI (HUPOTASSŌ)

Septuaginta e përdor këtë term për të përkthyer dhjetë fjalë të ndryshme hebraike. Kuptimi i tij kryesor në DHV

ishite “të urdhërosh” ose “e drejta e komandës.” Kjo merret në Septuagintë (LXX).

1. Perëndia urdhëron (krh. Lev. 10:1; Jona 2:1; 4:6-8)
2. Moisiu urdhëron (krh. Eks. 36:6; LiP. 27:1)
3. mbretërit urdhërojnë (krh. II Kron. 31:13)

Në DHR ky kuptim vazhdon si në Veprat 10:48, ku urdhëron një apostull. Megjithatë, në DHR ka edhe nuanca të tjera kuptimore.

1. del në pah një aspekt vullnetar (shpesh në DIATEZËN JOVEPRORE)
2. ky veprim vetë-kufizues mund të shihet në nënshtrimin e Jezusit ndaj Atit (krh. Luka 2:51)
3. besimtarët u nënshtrohen aspekteve të kulturës në mënyrë që ungjilli të mos ndikohet për keq
 - a. besimtarëve të tjerë (krh. Efe. 5:21)
 - b. bashkëshortet besimtare (krh. Kol. 3:18; Efe. 5:22-24; Titit 2:5; I Pjet. 3:1)
 - c. besimtarët ndaj qeverive pagane (krh. Rom. 13:1-7; I Pjet. 2:13)

Besimtarët veprojnë nga motive dashurie, për Perëndinë, për Krishtin, për Mbretërinë, për të mirën e të tjerëve. Ashtu si me *agapaō* (dua) kisha e mbushi këtë term me kuptim të ri bazuar në nevojat e Mbretërisë dhe në nevojat e të tjerëve. Ky term merr një fisnikëri të re vetëmohimi, jo bazuar në një urdhër, por në një marrëdhënie të re me një Perëndi vetë-dhënës dhe Mesian e Tij. Besimtarët i binden dhe nënshtrohen për të mirën e të tërës dhe për bekimin e familjes së Perëndisë.

10:4

NASB, NKJV,

NRSV “sepse Krishti është përfundimi i ligjit”

TEV “sepse Krishti e ka përfunduar ligjin”

NJB “por tani ligji ka marrë fund me Krishtin”

Kjo deklaratë është në një linjë me Mat. 5:17-48. Qëllimi, synimi ose përfundimi (*telos*) i Ligjit nuk ishte shpëtimi, por bindja për mëkat, dhe ai qëllim vazhdon (krh. Gal. 3:24-25). Tekstet klasike të DHR mbi këtë temë janë Gal. 3:1-29 dhe libri i Hebrejve.

Kur diskutohet kjo çështje, konteksti është kyç. Pali e përdor DHV në disa mënyra të ndryshme. Kur bëhet fjalë për jetën e krishterë, DHV është zbulosa e Perëndisë (krh. Rom. 15:4; I Kor. 10:6,11), por kur bëhet fjalë për shpëtimin, ajo është anuluar dhe ka kaluar (krh. Heb. 8:13). Kjo është sepse ajo është një metaforë për epokën e vjetër. Ungjilli i besimit në Jezusin është epoka e re e Frymës. Ligjit i ka kaluar koha! Shih Temën e Veçantë: Pikëpamjet e Palit mbi Ligjin e Moisiut në 13:9.



NASB, NKJV “për drejtësi ndaj kujt do që beson”

NRSV “në mënyrë që të ketë drejtësi për këdo që beson”

TEV “në mënyrë që kushdo që beson vendoset në pozitë të drejtë me Perëndinë”

NJB “në mënyrë që të gjithë që kanë besim të shfajësohen/drejtësohen”

Kapitujt 9-11 duhen interpretuar së bashku. Theksi mbi sovranitetin e Perëndisë i shprehur kaq fort në kapitullin 9 duhet mbajtur në tension me thirrjen ndaj të gjithëve që të besojnë në kapitullin 10 (krh. vv. 4,9,11,13; 3:22; 4:11,16).

Universaliteti i dashurisë së Perëndisë dhe i qëllimit të Tij shpengues u shpall në Zan. 3:15 dhe u nënkuptua fort në Zan. 12:3 dhe Eks. 19:5-6. Profetët folën shpesh për dashurinë universale të Perëndisë dhe për planin e Tij për ta bashkuar të gjithë njerëzimin. Fakti që ka një Perëndi dhe që Ai i krijoi të gjithë njerëzit në imazhin e Tij siguron një ftesë universale ndaj të gjithëve për t’u shpëtuar. Megjithatë, misteri është që asnjë nuk mund të përgjigjet pa veprimin e Frymës (krh. Gjoni 6:44,65). Atëherë pyetja bëhet, “A i tërheq Perëndia të gjithë njerëzit në shpëtim?” Përgjigjia duhet të jetë, “Po!” (krh. Gjoni 3:16; 4:42; I Gjoni 2:2; 4:14; I Tim. 2:4; II Pjet. 3:9). Paradoksi i dhimbshëm i mëkatit, rënies dhe Satanit është që disa thonë “Jo.” Kur Pali predikoi, disa hebrenj u përgjigjën, disa jo; disa johebrenj u përgjigjën, disa jo!

Termi “besoj” (*pisteuō*) përkthehet me tre terma, “besoj,” “kam besim,” dhe “zë besë.” Ai është në KOHËN E TASHMË, që flet për besim të vazhdueshëm. Nuk është pranimi i fakteve (teologjia, detajet historike, informacioni i ungjillit) ai që merr dhuratën e hirit të Perëndisë përmes Krishtit. DHR është një besëlidhje; Perëndia cakton axhendën dhe inicion përgjigjen e nevojshme, por individit duhet të përgjigjet me besim dhe

pendim në fillim dhe pendim dhe besim në vazhdim. Bindja dhe këmbëngulja janë vendimtare. Synimi është ngjashmëria me Krishtin dhe shërbesa!

TEMË E VEÇANTË: KOHËT E FOLJEVE GREQISHT QË PËRDOREN PËR SHPËTIMIN

Shpëtimi nuk është produkt, por marrëdhënie. Nuk përfundon kur njeriu beson në Krishtin; sapo ka filluar! Nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por një jetë ku njeriu sa vjen e bëhet si Krishti. Në Amerikë ekziston një proverb që thotë se, sa më tepër të jetojë çifti së bashku, aq më tepër i ngjasin njëri-tjetrit. Ky është synimi i shpëtimit!

SHPËTIMI SI VEPRIM I PLOTËSUAR (AORIST)

- Veprat 15:11
- Romakëve 8:24
- 2 Timoteut 1:9
- Titit 3:5
- Romakëve 13:11 (kombinon AORISTIN me një orientim TË ARDHSHËM)

SHPËTIMI SI GJENDJE EKZISTENCE (E KRYERA)

- Efesianët 2:5, 8

SHPËTIMI SI PROCES I VAZHDUAR (E TASHMJA)

- 1 Korintasve 1:18; 15:2
- 2 Korintasve 2:15
- 1 Pjetrit 3:21

SHPËTIMI SI PËRMBUSHJE E ARDHSHME (KOHA E ARDHME në FOLJE, ose konteksti)

- Romakëve 5:9, 10; 10:9, 13
- 1 Korintasve 3:15; 5:5
- Filipianëve 1:28
- 1 Thesalonikasve 5:8-9
- Hebrejve 1:14; 9:28
- 1 Pjetrit 1:5, 9

Si rrjedhojë, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13), por kjo duhet të rezultojë në një proces besimi në stilin e jetesës (shih Rom. 8:29; Gal. 2:19-20; Efe. 1:4; 2:10), që, një ditë, do të përmbushet me shikim (shih 1 Gjonit 3:2). Kjo gjendje përfundimtar quhet përlëvdim. Kjo mund të ilustruhet si

1. Shpëtimi fillestar – shfajësimi (shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit)
2. Shpëtimi përparues – shenjtërimi (shpëtuar nga fuqia e mëkatit)
3. Shpëtimi përfundimtar – përlëvdimi (shpëtuar nga prania e mëkatit)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:5-13

⁵Sepse Moisiu shkruan se njeriu që praktikon drejtësinë që bazohet në ligj do të jetojë me anë të asaj drejtësie. ⁶Por drejtësia e bazuar në besim flet kështu: “MOS THUAJ NË ZEMRËN TËNDE, ‘KUSH DO TË NGJITET NË QIELL?’ (domethënë, për të zbritur Krishtin poshtë), ⁷ose ‘KUSH DO TË ZBRESË NË HUMNERË?’ (domethënë, për ta sjellë Krishtin nga të vdekurit).” ⁸por çfarë thotë? “FJALA ËSHTË PRANË TEJE, në gojën tënde dhe në zemrën tënde”— domethënë, fjala e besimit që ne predikojmë, ⁹nëse e rrëfen me gojën tënde Jezusin si Zot, dhe e beson në zemrën tënde që Perëndia e ngjalli Atë nga të vdekurit, ti do të shpëtohesh; ¹⁰sepse me zemër njeriu beson, gjë që çon në drejtësi, dhe me gojë rrëfen, që çon në shpëtim. ¹¹Sepse Shkrimi thotë, “KUSHDO QË BESON NË TË NUK DO TË ZHGËNJEHET.” ¹²Sepse nuk ka dallim midis hebreat dhe grekut; sepse i njëjti Zot është Zot i të

gjithëve, që ka pasuri me bollëk për të gjithë që e thërrasin; ¹³sepse “KUSHDO QË DO TA THËRRASË EMRIN E ZOTIT DO TË SHPËTOHET.”

10:5 Ky varg është një aluzion ndaj Lev. 18:5. Premtimi i tij është i sigurt. Nëse dikush mund ta mbante Ligjin, ai do të ishte i pranueshëm për Perëndinë (krh. Luka 10:28; Gal. 3:12). Problemi është që Rom. 3:9,10-18,19,23; 5:18; 11:32 thotë si është realiteti. Të gjithë kanë mëkatuar. Shpirti që mëkaton do të vdesë (krh. Zan. 2:17; LiP. 30:18; Ezek. 18:4,20). Kjo rrugë e besëlidhjes së vjetër është mbyllur. Ajo është bërë një dënim me vdekje, një mallkim (krh. 7:10; Gal. 3:13; Kol. 2:14).

10:6-8 Ky është një aluzion ndaj ndaj LiP. 30:11-14 në Septuagintë (LXX), që Pali e modifikoi për qëllimet e tij. Ky tekst fillimisht u fol nga Moisiu duke iu referuar ligjit (fokusi i kontekstit ishte në dashurinë dhe zemrën e rrethprerë, krh. LiP. 30:6,16,20), por këtu ai e aplikon për mishërimin, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit (krh. v. 9; Efe. 4:9-10). Argumenti i Palit është që shpëtimi është lehtësisht i disponueshëm në Jezusin, Mesian, përmes besimit (krh. LiP. 30:15-20). Ai është i lehtë; është i disponueshëm; është për të gjithë, gjë që është kaq e ndryshme nga kodi i Ligjit të Moisiut.

10:6 “por drejtësia e bazuar në besim flet” Pali e ka personifikuar më parë “mëkatin,” “hirin,” dhe “Shkrimin,” tani ai personifikon “drejtësinë me anë të besimit.” Ajo flet në citimet e DHV në vv. 6,7, dhe 8.

▣ **“ZEMRËN”** Zemra përfaqëson anën reflektive të vetes. Shih Temën e Veçantë te 1:24.

▣ **“NGJITET. . ZBRESË”** Njerëzit nuk kanë pse të shkojnë ta kërkojnë Krishtin; Perëndia e ka dërguar Atë publikisht për të gjithë. Kërkimi njerëzor nuk është i nevojshëm.

10:8 “FJALA ËSHTË PRANË TEJE” Ky është një citim nga LiP. 30:14. Në LiP. 30:11 është theksi se vullneti i YHWH për popullin e Tij, Izraelin, ishte i arritshëm (krh. vv. 12-13). Pali përdor paragrafin (vv. 11-14) për të theksuar disponueshmërinë e menjëhershme të ungjillit!

10:9 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË, që kishte kuptimin e veprimit të mundshëm të ardhshëm. Vargu 9 është përmbajtja (*hoti*) e mesazhit të besimit.

▣ **“rrëfen”** Ky term i përbërë, *homologeō*, është fjalë për fjalë “të thuash” dhe “të njëjtën gjë,” dhe kishte kuptimin “të biesh dakord me dikë publikisht” (të flasësh me zë të lartë që të dëgjojnë të tjerët). Një rrëfim publik i besimit në Krishtin është shumë i rëndësishëm (krh. Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; I Tim. 6:12; I Gjoni 2:23; 4:15). Rrëfimi publik i kishës së hershme ishte pagëzimi. Kandidati e rrëfente besimin në Krishtin në formulën “Unë besoj që Jezusi është Zot.” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: RRËFIMI

- A. Ka dy forma të së njëjtës rrënjë greqisht që përdoren për rrëfimin e mëkatin ose rrëfimin e besimit, *homolegeō* dhe *eksomologeō*. Termi i përbërë që përdor Jakobi vjen nga *homo*, “i njëjtë”; *legō*, “flas”; dhe *eks*, “jashtë nga”. Kuptimi bazë është të thuash të njëjtën gjë, të pajtohesh me dikë. *Eks* i shtohet idesë së shpalljes publike.
- B. Përkthimet e grupit të kësaj fjale janë
 1. Lavdëroj
 2. Pajtohem
 3. Shpall
 4. Rrëfej (besimin)
 5. Rrëfej (fajin)
- C. Ky grup fjalësh ka dy lloj përdorimesh që, në dukje, janë të kundërta
 1. Lavdëroj (Perëndinë)
 2. Pranoj mëkatin

Këto mund jenë zhvilluar nga ndjesia që ka njerëzimi për shenjtërinë e Perëndisë dhe për

mëkatin e vet. Kur pranon njërën të vërtetë, ke pranuar dhe tjetrën.

D. Përdorimet në DhR të këtij grupi fjalësh janë

1. Premtoj (shih Mat. 14:7; Veprat 7:17)
2. Bie dakord, ose jap miratimin, për diçka (shih Gjoni 1:20; Luka 22:6; Veprat 24:14; Heb. 11:13)
3. Lavdëroj (shih Mat. 11:25; Luka 10:21; Rom. 14:11; 15:9)
4. Jap miratimin për
 - a. Një person (shih Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; Rom. 10:9; Fil. 2:11; 1 Gjonit 2:23; Zbu. 3:5)
 - b. Një të vërtetë (shih Veprat 23:8; 1 Gjonit 4:2)
5. Bëj një shpallje publike (kuptimi ligjor u zhvillua në pohim fetar, shih Veprat 24:14; 1 Tim. 6:13)
 - a. pa pranuar fajin (shih 1 Tim. 6:12; Heb. 10:23)
 - b. me një pranim faji (shih Mat. 3:6; Veprat 19:18; Heb. 4:14; Jakobi 5:16; 1 Gjonit 1:9)



NASB "Jezusin si Zot"

NKJV "Zotin Jezus"

NRSV, TEV,

NJB "Jezusi është Zot"

Kjo ishte përmbajtja teologjike e rrëfimit të besimit dhe e liturgjisë së pagëzimit të kishës së hershme. Përdorimi i "Zot" pohonte hyjninë e Jezusit (krh. Joel 2:32; Veprat 2:32-33,36; 10:36; I Kor. 12:3; II Kor. 4:5; Fil. 2:11; Kol. 2:6), ndërsa emri "Jezus" pohonte anën e Tij njerëzore historike (krh. I Gjoni 4:1-3). Pohimi funksiononte edhe si një thirrje në dishepullim/ngjashmëri me Krishtin.

Përdorimi i "Zot" lidhej me zëvendësimin rabinik të YHWH me *Adon* kur lexoheshin Shkrimet. Shih Temën e Veçantë: Emrat për hyjninë te 9:29. Kjo konfirmohet nga citimi nga Joeli 2:32 që është në v. 13.

Jezusit i janë dhënë disa tituj të fuqishëm.

1. Jezusi është Mesia/Krishti – Veprat 5:42; 9:22; 17:3; 18:5,28; I Kor. 1:23
2. Jezusi është Biri i Perëndisë – Mat. 4:3,6; Veprat 9:20; 13:33; Rom. 1:4
3. Jezusi është Zot – shih më sipër

TEMË E VEÇANTË: EMRI I ZOTIT

Kjo ishte një frazë e zakonshme e DHR për praninë personale dhe fuqinë aktive të Perëndisë Triun në kishë. Nuk ishte formulë magjike, por një apel ndaj karakterit të Perëndisë.

Shpesh kjo frazë i referohet Jezusit si Zot (krh. Fil. 2:11)

1. Në rrëfimin e besimit të dikujt në momentin e pagëzimit (krh. Rom. 10:9-13; Veprat 2:38; 8:12,16; 10:48; 19:5; 22:16; I Kor. 1:13,15; Jakobi 2:7)
2. Në dëbimin e demonëve (krh. Mat. 7:22; Mark 9:38; Luka 9:49; 10:17; Veprat 19:13)
3. Në shërim (krh. Veprat 3:6,16; 4:10; 9:34; Jakobi 5:14)
4. Në një akt shërbese (krh. Mat. 10:42; 18:5; Luka 9:48)
5. Në kohën e disiplinës së kishës (krh. Mat. 18:15-20)
6. Gjatë predikimit ndaj johebrenjve (krh. Luka 24:47; Veprat 9:15; 15:17; Rom. 1:5)
7. Në lutje (krh. Gjoni 14:13-14; 15:2,16; 16:23; I Kor. 1:2)
8. Si një mënyrë për t'iu referuar krishtërit (krh. Veprat 26:9; I Kor. 1:10; II Tim. 2:19; Jakobi 2:7; I Pjet. 4:14)

Çfarëdo që ne bëjmë si shpallës, shërbëtorë, ndihmës, shërues, dëbues demonësh, etj., ne e bëjmë në karakterin e Tij, në fuqinë e Tij, në sigurimin e Tij – në Emrin e Tij!

■ "beson në zemrën tënde" Kjo frazë është paralel me rrëfej, duke dhënë kështu aspektet binjake të besimit. Termi biblik "besoj" (*pistis*, shih Temën e Veçantë në 4:3 dhe 4:5) përfshin

1. Zënie bese personale (Hebraisht)
2. Dakortësinë intelektuale (Greqisht)
3. Një përkushtim të vazhdueshëm të vullnetit (krh. LiP. 30:20)

Termi “zemër” u përdor në kuptimin e tij të DHV të tërësisë së personit. Pali përmend “gojë” dhe “zemër” në këtë kontekst për shkak të citimit të tij nga LiP. 30:14 cituar në v. 8. Kjo nuk ishte me synimin që të vendosej një rregull i prerë që dikush duhej të lutej me zë të lartë që të shpëtohej.

▣ **“që Perëndia e ngjalli Atë nga të vdekurit”** Krishtërimi qëndron ose bie mbi realitetin e varrit bosh (krh. 4:24; 8:11; I Korintasve 15). Është një e vërtetë qendrore në predikimet apostolike (*kerygma*, shih Temën e Veçantë në 1:2) të Veprat (d.m.th., 2:31-32; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,37).

Fakti që Ai e ringjalli Birin është provë e pranimit nga ana e Tij të jetës, mësimit dhe flijimit të Jezusit. DHR pohon se të tre Personat e Trinisë ishin të përfshirë në ringjalljen e Jezusit.

1. Ati – Veprat 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 8:11; 10:9; I Kor. 6:14; II Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; I Thes. 1:10
2. Fryma – Rom. 8:11
3. Biri – Gjoni 2:19-22; 10:17-18

10:10 “që çon në drejtësi” Synimi i Perëndisë për çdo besimtar nuk është vetëm parajsja një ditë, por ngjashmëria me Krishtin tani! Pasazhi tjetër mbi paracaktimin, Efe. 1:3-14, e shpreh fuqishëm këtë të vërtetë në v. 4. Besimtarët u zgjodhën për të qenë të shenjtë dhe të patëmetë! Zgjedhja nuk është vetëm doktrinë, por një mënyrë jetese (krh. LiP. 30:15-20).

Vargu 10 reflekton theksin e dyfishtë të Porosisë së Madhe (krh. Mat. 28:19-20), shpëtimin (bëni dishepuj) dhe drejtësinë (mësojini të mbajnë gjithë sa ju urdhërova). I njëjti ekuilibër gjendet në Efe. 2:8-9 (shpëtim falas me anë të hirit të Perëndisë përmes Krishtit) dhe një thirrje për “vepra të mira” në Efe. 2:10. Dëshira e Perëndisë ka qenë gjithmonë një popull në imazhin e Tij.

10:11 Ky është një citim nga Isa. 28:16 të cilit Pali i ka shtuar fjalën “kushdo.” Te Isaia kjo i referohej besimit në Mesian, gurin e qoshes së Perëndisë (krh. 9:32-33). Ndërsa Romakëve 9 madhëron sovranitetin e Perëndisë, kapitulli 10 madhëron nevojën që individët t’i përgjigjen Krishtit. Oferta universale duket qartë në “kujtdo” të v. 4 dhe në “kushdo” të vv. 11, 13, dhe “të gjithë/ve” të v. 12 (dy herë)! Ky është ekuilibri teologjik për theksin përzgjedhës (paracaktimin) të kapitullit 9.

▣ **“beson në Të”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE me PARAFJALËN *epi* (krh. 4:24; 9:33; I Tim. 1:16). Besimi nuk është vetëm një përgjigje fillestare, por një kusht i vazhdueshëm për shpëtim! Nuk është vetëm teologjia e duhur (të vërtetat e ungjillit) që shpëton, por marrëdhënia personale (personi i ungjillit) që rezulton në një mënyrë jetese të perëndishme (të jetuarit e ungjillit). Ruhuni nga “besimi” i lehtë që e ndan të vërtetën nga jeta, shfajësimin nga drejtësimi. Një besim që shpëton është një besim që këmbëngul dhe ndryshon! Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme! Shih Temën e Veçantë: Beson në 4:5.

▣
NASB, TEV “nuk do të zhgënjehet”
NKJV, NRSV “nuk do të turpërohet”
NJB “nuk do të ketë shkak për turp”

Ata që i zënë besë (“besojnë”) Krishtit nuk do të dëbohen. Ky është citim nga Isa. 28:16, që ishte varg kyç në prezantimin e Palit në 9:33.

10:12 “Sepse nuk ka dallim midis hebreat dhe grekut” Ky është fokusi madhor i Besëlidhjes së Re (krh. Rom. 3:22,29; Gal. 3:28; Efe. 2:11-3:13; Kol. 3:11). I vetmi Perëndi ka shpenguar krijimin e Tij përmes veprimeve të Veta. Ai dëshiron që të gjithë njerëzit që janë krijuar në imazhin e Tij të vijnë tek Ai dhe të jenë si Ai! Të gjithë mund të vijnë tek Ai!

Natyra universale e ungjillit (“të gjithë” është përdorur dy herë në v. 12) ka dy aspekte.

1. nuk ka asnjë dallim midis hebrenjve dhe johebrenjve; të gjithë janë të humbur (krh. 3:9,19,22-23; 11:32)
2. nuk ka asnjë dallim midis hebrenjve dhe johebrenjve; të gjithë mund të shpëtohen

Ungjilli i largon të gjitha barrierat njerëzore (krh. Joeli 2:28-29; I Kor. 12:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11), të paktën në fushën e shpëtimit.

■ **“që ka pasuri me bollëk”** Kur Pali mendon për hirin e Perëndisë në Krishtin, ai përdor fjalën “pasuri” shpesh (krh. 2:4; 9:23; 11:12 [dy herë],33; I Kor. 1:5; II Kor. 8:9; Efe. 1:7,18; 2:7; 3:8,16; Fil. 4:19; Kol. 1:27; 2:2).

10:13 Ky citim i famshëm nga Joeli 2:32 ka dy thekse të rinj në përdorimin nga Pali

1. te Joeli përdoret emri i YHWH; Pali te Romakëve dhe Pjetri te Veprat 2:21 e zëvendësuan me emrin e Jezusit (gjithashtu vini re Gjoni 12:41 dhe Isa. 6:9-10; Fil. 2:9 dhe Isa. 45:22-25; Rom. 9:33 dhe Isa. 8:13-14)
2. te Joeli “i shpëtuar” nënkuptonte çlirim fizik; te Romakëve i referohet faljes frymërore dhe shpëtimit të përgjeshëm

Koncepti i DHV i “thirrjes së emrit” nënkuptonte një rrëfim publik besimi në një ambient adhurimi. I njëjti koncept shihet në Veprat 7:59; 9:14,21; 22:16; I Kor. 1:2; II Tim. 2:22. Shih Temën e Veçantë: Të thirrur në 1.6.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:14-15

¹⁴Si do ta thërrasin Atë të Cilit nuk i kanë besuar? Si do të besojnë në Atë për të Cilin nuk kanë dëgjuar? dhe si do të dëgjojnë pa një predikues? ¹⁵Si do të predikojnë nëse nuk janë dërguar? Ashtu siç është shkruar, “SA TË BUKURA JANË KËMBËT E ATYRE QË SJELLIN LAJME TË MIRA PËR GJËRA TË MIRA!”

10:14-15 Ka një seri pyetjesh të ndjekura nga citime të DHV që argumentojnë se Izraeli nuk u është përgjigjur asnjëherë mesazheve dhe lajmëtarëve të YHWH (krh. Nehemia 9; Veprat 7). Perëndia i dërgon lajmëtarët (profetë, apostuj, predikues, mësues, ungjilltarë). Këta lajmëtarë janë bekimet e Perëndisë ndaj një bote nevojtare. Ndërsa Perëndia me hir dërgon lajmëtarë të ungjillit, dëgjuesit duhet të përgjigjen siç duhet ndaj mesazhit të tyre. Pali e konfirmoi këtë mendim me një citim nga Isa. 52:7. Pali e zgjeron këtë varg të DHV për t’iu referuar predikuesve të ungjillit.

Besimi shpëtues ka disa elementë: (1) një mesazh që duhet besuar; (2) një person që duhet pranuar; (3) një reagim fillestar dhe i vazhdueshëm pendimi dhe besimi; (4) një jetë bindjeje; dhe (5) këmbëngulje (shih shënimin në 1:5).

10:15 Ky është një citim nga Isa. 52:7. Ai është porosia e madhe e Romakëve. Shpëtimi vjen nga dëgjimi i ungjillit dhe nga pranimi i ungjillit. Predikuesit dërgohen që “të gjithë” të shpëtohen!

Disa tekste të lashta greke (d.m.th., MSS 2x, D, F, G, dhe shumë versione) shtojnë një frazë nga LXX e Isa. 52:7. UBS⁴ i jep tekstit më të shkurtër një vlerësim “A” (të sigurt).

NASB, NKJV,

NRSV, NJB

“sa të bukura janë këmbët”

TEV

“sa e mrekullueshme është ardhja”

NET

“Sa në kohë është mbërritja”

NET footnote

“ardhja në kohën e duhur ose të përshtatshme”

Termi “të bukura” është përdorur në një kuptim metaforik. Këtu i referohet “kohës” jo pamjes.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:16-17

¹⁶Megjithatë, jo të gjithë ia vunë veshin lajmit të mirë; sepse Isaia thotë, “ZOT, KUSH I KA BESUAR PREDIKIMIT TONË?” ¹⁷Prandaj besimi vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi nga fjala e Krishtit.

10:16 Përsëri Pali përdor deklarata profetike të DHV, të cilat fillimisht i referoheshin mesazhit të YHWH ndaj Izraelit, për t’iu referuar ungjillit të Jezusit Mesias. Ashtu siç hebrenjtë e DHV e hodhën poshtë mesazhin e Perëndisë, po ashtu edhe hebrenjtë e kohës së Palit e hodhën poshtë atë. Ky është një citim nga Isa. 53:1 por është edhe i lidhur teologjikisht me hedhjen poshtë nga ana e Izraelit të mesazhit të Perëndisë te Isa. 6:9-13.

10:17 Ungjilli është së pari një mesazh (krh. Gal. 3:2). Por mesazhi i shpallur bëhet një fjalë personale, “fjala e Krishtit e pranuar” (krh. Kol. 3:15-16).

■ **“fjala e Krishtit”** Për shkak të kontekstit kjo duhet t’i referohet mesazhit për Krishtin që u predikua. Predikimi i ungjillit është mënyra e Perëndisë për t’ia përcjellë botës ofertën e Tij në Krishtin.

Ka një variacion të dorëshkrimeve të lashta greke në këtë pikë.

1. MSS P⁴⁶, s*, B, C, D* e kanë “fjala e Krishtit”
2. MSS s, A, Dc, K, P e kanë “fjala e Perëndisë”

I pari është më i pazakonti (krh. Kol. 3:16) dhe, prandaj, ndoshta është origjinali (ky është një nga rregullat bazë të kritikës së tekstit). UBS⁴ i jep atij një vlerësim “A” (të sigurt). Ky është i vetmi vend tjetër ku ai del në DHR. I dyti, “fjala e Perëndisë,” del disa herë (krh. Luka 3:2; Gjoni 3:34; Efe. 6:17; Heb. 6:5 dhe 11:3).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 10:18-21

¹⁸Por unë them, sigurisht ata nuk kanë dëgjuar asnjëherë, apo jo? Në të vërtetë kanë dëgjuar; **“ZËRI I TYRE KA SHKUAR NË TË GJITHË TOKËN, DHE FJALËT E TYRE DERI NË FUND TË BOTËS.”**

¹⁹Por unë them, me siguri Izraeli nuk e dinte, apo jo? Së pari Moisiu thotë, **“UNË DO T’JU BËJ XHELOZË ME ATË QË NUK ËSHTË KOMB, ME NJË KOMB PA GJYKIM DO T’JU ZEMËROJ.”**

²⁰Dhe Isaia është shumë i guximshëm dhe thotë, **“UNË U GJETA NGA ATA QË NUK MË KËRKONIN, IU SHFAQA ATYRE QË NUK PYETËN PËR MUA.”** ²¹Por sa për Izraelin Ai thotë, **“GJITHË DITËN I KAM SHTRIRË DUART NDAJ NJË POPULLI TË PABINDUR DHE KOKËFORTË.”**

10:18 Ky varg pohon se pjesa më e madhe e hebrenjve e kishin dëgjuar mesazhin dhe se ishin përgjegjës për hedhjen poshtë të tij (një MOHIM I DYFISHTË i fortë në greqisht; pyetja pret një përgjigje “jo”). Problemi nuk ishte padituria, por mosbesimi i vullnetshëm!

Pali citon Ps. 19:4. Në këtë Psalm vv. 1-6 i referohen zbulesës natyrore, që është Perëndia duke folur përmes krijimit (krh. Romakëve 1-2). Pali ndryshon

1. dëshminë universale (“në të gjithë tokën” dhe “deri në fund të botës”)
2. mjetin e transmetimit të mesazhit nga zëri i heshtur i krijimit në predikuesit e ungjillit (apostujt, profetët, ungjilltarët, pastorët dhe mësuesit, krh. Efe. 4:11), që i referohen zbulesës së veçantë (krh. Ps. 19:8-14)

Mendimi kryesor është që mesazhi i ungjillit kishte shkuar në të gjithë botën e njohur të kohës së Palit (bota greko-romake). Pali po përdor hermeneutikën rabinike; ai e ndryshon kontekstin origjinal të DHV për qëllimet e tij teologjike e polemike. Duhet thënë qartë gjithashtu që përdorimi nga ana e Palit e DHV, ashtu si edhe nga ana e apostujve të tjerë, ishte e udhëhequr në mënyrë unike nga Fryma e Shenjtë (krh. II Pjet. 1:20-21). Besimtarët sot, nën ndriçimin/përndritjen e Frymës, nuk mund të riprodhojnë metodat interpretuese të shkrimtarëve të DHR.

TEMË E VEÇANTË: PËRNDRITJA/NDRIÇIMI

Perëndia ka vepruar në të kaluarën për t’i zbuluar Vetën e Vet qartë njerëzimit. Në teologji, kjo quhet zbulesë. Ai përzgjedhi disa njerëz për ta shkruar dhe shpjeguar këtë vetë-zbulesë. Në teologji, kjo quhet frymëzim. Ai ka dërguar Frymën e vet për t’i ndihmuar lexuesit që të kuptojnë Fjalën e tij. Në teologji, kjo quhet përndritje/ndriçim. Problemi vjen kur ne pohojmë se Fryma përfshihet në të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë— atëherë, pse ka kaq shumë interpretime të ndryshme të saj?

Një pjesë e problemit ka të bëjë me botëkuptimin ose përvojat personale të lexuesit. Shpesh, trajtohet një axhendë personale duke e përdorur Biblën si tekst-provues, ose në mënyrë të shkëputur nga konteksti. Shpesh, Biblës i imponohet një kuadër teologjik i caktuar, që e lejon Biblën të flasë vetëm në zona të caktuara dhe në mënyra të përzgjedhura. Përndritja/ndriçimi nuk duhet barazuar kursesi me frymëzimin, ndonëse Fryma përfshihet në të dyja.

Qasja më e mirë mund të jetë të përpiqemi të shprehim idenë qendrore të një paragrafi, dhe jo të interpretojmë çdo hollësi të pjesës. Ai që përçon të vërtetën qendrore të autorit fillestar është mendimi tematik. Përvijimi i librit, ose njësia letrare, na ndihmon që të ndjekim synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Asnjë interpretues nuk është i frymëzuar. Ne s’mund të riprodhojmë metodën interpretuese të shkrimtarit biblik. Por ne mundemi dhe duhet të përpiqemi të kuptojmë se çfarë po thoshte autori fillestar për kohën e vet dhe, pastaj, këtë të vërtetë ta përçojmë në kohën tonë. Ka pjesë të Biblës që janë të vagullta ose të fshehura (deri në një

kohë ose periudhë të caktuar). Do të ketë gjithmonë mosmarrëveshje për disa tekste ose tema të caktuara, por duhet t'i shprehim qartë të vërtetat qendrore dhe duhet të lejojmë njëfarë lirie për interpretimet individuale brenda caqeve të synimit të autorit fillestar. Interpretuesit duhet të ecin nën dritën që kanë, gjithmonë duke qenë të hapur për të marrë më tepër dritë nga Bibla dhe nga Fryma. Perëndia do të na gjykojë në bazë të nivelit të të kuptuarit tonë dhe në bazë të mënyrës sesi e zbatojmë atë që kuptojmë.

10:19-20 Hebrejtë e kanë dëgjuar mesazhin (edhe v. 18, edhe v.19 janë pyetje që presin një përgjigje “jo”), edhe nga Moisiu. Hebrejtë e dëgjuan dhe ishin në gjendje ta kuptonin mesazhin përfshirës të besimit që thotë se të gjithë mund të pajtohen me Perëndinë.

Në këta vargje, Perëndia i foli popullit të Tij të besëlidhjes në lidhje me përfshirjen e johebrejve. Kjo bëhet me anë të një citimi nga LiP. 32:21 në v. 19 dhe Isa. 65:1-2 në vv. 20-21. Kjo përfshirje shokuese e johebrejve kishte si synim të nxiste (përmes xhelozisë/zilisë) hebrejtë për të ardhur në besim (krh. 11:11,14).

10:21 Kjo thënie është një citim nga Septuaginta of Isa. 65:2 në lidhje me hedhjen poshtë të YHWH nga ana e popullit të besëlidhjes (krh. Isa. 65:1-7). Perëndia ka qenë besnik; Izraeli ka qenë i pabesë/jobesnik. Mosbesnikëria e tyre ka çuar në gjykim të përkohshëm mbi kombin dhe individë të caktuar në të shkuarën, por hedhja poshtë nga ana e tyre e drejtësisë së Perëndisë përmes besimit në Krishtin do të çojë në gjykim të përtjetshëm!

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Nëse zgjedhja e Perëndisë është kaq kyçe, atëherë pse lutet Pali për Izraelin në 10:1? Pse shprehet 10:9-13 kaq fort në lidhje me nevojën për përgjigje nga ana e njerëzve?
2. Çfarë kuptimi ka v. 4? A i ka dhënë Krishti fund ligjit?
3. Listo elementët e përfshirë në besim në 10:9-10.
4. Pse citon Pali kaq shpesh nga DHV? Si lidhet kjo me një kishë kryesisht johebreje në Romë?
5. Si lidhen vargjet 11-13 me kapitullin 9?
6. Si lidhen vargjet 14-15 me misionin botëror?
7. Si tregohet në kapitullin 10 që vullneti i lirë i njeriut është pjesë e shpëtimit të njeriut?

ROMAKËVE 11

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mbetja e Izraelit	Hedhja poshtë e Izraelit nuk është e plotë	Hedhja poshtë e Izraelit nuk është përfundimtare	Mëshira e Perëndisë mbi Izraelin	Mbetja e Izraelit
11:1-10	11:1-10	11:1-10	11:1-6 11:7-10	11:1-6 11:7-10
Shpëtimi johebrejve	i Hedhja poshtë e Izraelit nuk është përfundimtare			Hebrenjtë do të rimëkëmben në të ardhmen
11:11-12	11:11-36	11:11-12	11:11-12 Shpëtimi i johebrejve	11:11-12
11:13-16		11:13-16	11:13-15	11:13-15
		Metafora e pemës së ullirit	11:16-18	Hebrenjtë janë ende populli i zgjedhur 11:16-24
11:17-24		11:17-24	11:19-24	
Rimëkëmbja e Izraelit		I gjithë Izraeli do të shpëtohet	Mëshira e Perëndisë mbi të gjithë	Kthimi në besim i hebrejve
11:25-32		11:25-32	11:25-32 Lavdërim ndaj Perëndisë	11:25-29 11:30-32 Një himn ndaj mëshirës dhe urtësisë së Perëndisë
11:33-36		11:33-36	11:33-36	11:33-36

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

A.Paragrafi i parë

B.Paragrafi i dytë

C.Paragrafi i tretë

D.Etj.

TE DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Kapitulli 11 e vazhdon marrëdhënien paradoksale midis zgjedhjes dhe ungjillit. Zgjedhja e DHV ishte për shërbim, ndërsa zgjedhja e DHR është për shpëtim (shiko renditësin alfabetik në fund të Biblës!). Në një kuptim besimtarët thirren për të qenë edhe familja e Perëndisë (DHR), edhe shërbëtorë të Tij (DHV). Zgjedhja është kolektive dhe individuale, pozitive dhe negative (Jakobi/Izraeli-Esau/Edomi; Moisiu/Faraoni). Në thelb tensioni nuk është vetëm midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por në vetë karakterin e Perëndisë. Kapitujt 9-11 theksojnë në mënyrë të përsëritur mëshirën e Perëndisë dhe rebelimin e njerëzimit. Perëndia është besnik, njerëzit janë të pabesë.
- Zgjedhja nuk është doktrinë për të përjashtuar disa, por një themel shprese dhe sigurie për ata që u janë përgjigjur (1) premtimeve dhe (2) Birit të Perëndisë besëlidhje-bërës.
- B. Në kapitullin 9 Pali pohoi sovranitetin dhe lirinë e Perëndisë. Edhe në një marrëdhënie besëlidhore, Perëndia është i lirë. Në kapitullin 10 Pali pohoi se hebrenjtë ishin të lirë t'i pranonin ose t'i hidhnin poshtë premtimet dhe besëlidhjet e Perëndisë. Meqenëse e treguan veten të pabesë dhe i hodhën poshtë premtimet dhe besëlidhjet e Perëndisë, edhe Perëndia në një kuptim i hodhi poshtë ata. Megjithatë, në kapitullin 11 Pali pohon besnikërinë e Perëndisë, edhe përballë mosbesnikërisë së Izraelit (krh. Ligji i Përtërirë 8).
- C. Në të kaluarën, ashtu si edhe në të tashmen, një mbetje e hebrenjve besoi dhe ushtroi besim në Mesian e Perëndisë. Pali vetë ishte një shembull i kësaj. Hedhja poshtë e disa hebrenjve jobesimtarë lejoi përfshirjen e johebrenjve besimtarë. Përfshirja e johebrenjve do të rezultojë në (1) popullin e plotë të Perëndisë ose (2) numrin e plotë të të zgjedhurve të Perëndisë, hebrenj dhe johebrenj. Kjo përfshirje e johebrenjve do ta motivojë Izraelin të besojë në Mesian e Perëndisë, Jezusin.
- D. Si në kapitujt 9 dhe 10, Pali përdor disa citime të DHV në kapitullin 11.
1. v. 3 – I Mbr. 19:14
 2. v. 4 – I Mbr. 19:18
 3. v. 8 – Isa. 29:10 dhe LiP. 29:4
 4. v. 9 – Ps. 69:22
 5. v. 10 – Ps. 69:23
 6. v. 26 – Isa. 59:20-21
 7. v. 27 – Isa. 27:9
 8. v. 34 – Isa. 40:13-14
 9. v. 35 – Job 35:7; 41:11

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:1-6

¹Unë them atëherë, Perëndia nuk e ka hedhur poshtë popullin e Tij, apo jo? Kurrë mos qoftë! Sepse edhe unë jam izraelit, pasardhës i Abrahamit, nga fisi i Benjaminin. ²Perëndia nuk e ka hedhur poshtë popullin e Tij që e paranjohu. Apo nuk e dini atë që thotë Shkrimi në *pasazhin për Elian*, se si ai i lutet Perëndisë kundër Izraelit? ³“Zot, PROFETËT E TU I KANË VRARË, ALTARËT E TU I KANË SHKATËRRUAR DHE VETËM UNË KAM MBETUR DHE ATA PO KËRKOJNË JETËN TIME.” ⁴Por cila është përgjigjia hyjnore ndaj tij? “KAM RUAJTUR për Vetën Time SHTATË MIJË BURRA QË NUK IA KANË PËRKULUR GJURIN BAALIT.” ⁵Në të njëjtën mënyrë, ka mbetur edhe në kohën e tanishme një mbetje sipas zgjedhjes së hirshme të Perëndisë. ⁶Por nëse është nga hiri, nuk është më në bazë të veprave, përndryshe hiri nuk është më hir.

11:1 “Perëndia nuk e ka hedhur poshtë popullin e Tij, apo jo” Kjo pyetje pret një përgjigje “jo”. Pali i përgjigjet kësaj pyetjeje në vv. 1b-10. Ky seksion duhet të lidhet me argumentin e mëparshëm të Palit. Kapitujt 9-11 formojnë një njësi letrare, një argument të zgjatur.

Fjala e përkthyer “hedh poshtë” (AORISTE JOVEPRORE [deponente] DËFTORE) në thelb do të thotë “të refuzosh” ose “të dëbosh.” Ajo është përdorur në

1. Veprat 7:39 – Izraeli në shkretëtirë që hodhi poshtë udhëheqjen e Moisiut
2. Veprat 13:46 – hebrejntë e sinagogës në Antiokinë e Pisidisë që hodhën poshtë predikimin e ungjillit nga Pali
3. I Tim. 1:19 – disa anëtarë të kishës në Efes që hodhën poshtë dhe besimin dhe e shkatërruan atë (d.m.th., Himeneu dhe Aleksandri)

YHWH nuk e hodhi poshtë Izraelin! Izraeli e hodhi poshtë YHWH me mosbindjen e vazhdueshme, me idhujtarinë dhe tani me legalizmin e tij të vetëdrejtë.

Është interesante të vëmë re që dorëshkrimi i hershëm grek në papirus P⁴⁶ dhe uncialët F dhe G e kanë “trashëgimi” në vend të “popull,” që mund të vijë nga LXX e Ps. 94:14. UBS⁴ i jep “popull” një vlerësim “A” (i sigurt).

▣ **“Kurrë mos qoftë”** Kjo është mënyra karakteristike e Palit për të hedhur poshtë pyetjet e kundërshtarit hipotetik (diatribit, krh. 3:4,6,31; 6:2,15; 7:7,13; 9:14; 11:1,11).

▣ **“edhe unë jam izraelit”** Pali përdor veten e tij për të vërtetuar ekzistencën e një mbetjeje besimtarësh hebrej. Për më shumë në lidhje me prejardhjen hebreje të Palit shih Fil. 3:5.

▣ **11:2 “Perëndia nuk e ka hedhur poshtë popullin e Tij”** Ky mund të jetë një aluzion ndaj Ps. 94:14 (krh. LiP. 31:6; I Sam. 12:22; I Mbr. 6:13; Vaj. 3:31-32). Është një përgjigje specifike për pyetjen e v. 1.

▣ **“që e paranjohu”** Kjo është një referencë e qartë ndaj zgjedhjes së Izraelit nga Perëndia. Shih shënimin te 8:29. Ajo e çon argumentin përsëri te kapitulli 9, ashtu si edhe vv. 4-6. Kyçi nuk ishin veprat e Izraelit, por zgjedhja e Perëndisë. Perëndia është besnik ndaj premtimeve të Tij për shkak të asaj që Ai është, jo për shkak të veprave të Izraelit (krh. Ezek. 36:22-32).

▣ **“Shkrimi thotë”** Kjo është një referencë ndaj tregimit të arratisjes së Elias nga Jezebeli te I Mbretërve 19:10, cituar në v. 3.

11:4 “KAM RUAJTUR për Vetën Time SHTATË MIJË” “Për Vetën Time” nuk është në tekstin Masoretik Hebraik të I Mbr. 19:18 (Pali nuk citon TM ose LXX), por është shtuar nga Pali për të theksuar zgjedhjen e Perëndisë. Mbetja besnike e I Mbr. 19:18 është parë nga këndvështrimi i zgjedhjes së Perëndisë, jo nga hedhja poshtë prej tyre e adhurimit të Ba’alit.

Ajo që Pali po thotë është që ishte një grup i vogël besimtarësh edhe në Izraelin e pabesë dhe idhujtar të kohës së Elias. Edhe në kohën e Palit kishte një mbetje besimtarësh nga populli hebre (shih Temë e Veçantë në 9:27-28). Në çdo epokë disa hebrej janë përgjigjur me besim. Pali thotë që këta hebrej besimtarë marrin fuqi nga mëshira dhe hiri i Perëndisë (vv. 5-6).

▣ **“Baalit”** Kjo është NYJE FEMËRORE me një EMËR MASHKULLOR. Kjo për arsye se hebrejntë rregullisht futnin zanore nga fjala hebraike FEMËRORE “turp” (*bosheth*) në bashkëtingëlloret e emrave të hyjnive pagane për t’u tallur me to.

11:5-6 Këta janë vargje kyçë. Ata lidhin veprimet e kaluara të Perëndisë në DHV me situatat aktuale. Lidhja është zgjedhja e Perëndisë me anë të mëshirës (krh. 9:15,16,18; 11:30,31,32). Hiri i Perëndisë është përparësi, por besimi njerëzor është i nevojshëm (krh. Mark 1:15; Veprat 3:16,19; 20:21), megjithatë nuk bazohet aspak në meritën njerëzore (krh. Efe. 2:8-9; II Tim. 1:9; Titit 3:5). Këto të vërteta janë kyçe në argumentimin e Palit gjatë gjithë kapitujve 9-11.

11:6 “nëse” Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Shpëtimi është me anë të hirit të Perëndisë (shih shënimin te 3:24, krh. 6:23; Efe. 2:8-9).

▣ KJV i shton një frazë përmblylëse vargut 6, “Por nëse është nga veprat, atëherë nuk është më hir: përndryshe vepra nuk është më vepër.” Kjo frazë nuk gjendet në pjesën më të madhe të dorëshkrimeve greke P⁴⁶, κ*, A, C, D, G, ose P, dhe në versionet e vjetra në latinisht, por dy forma të ndryshme të kësaj fraze dalin në dorëshkrimet κ* dhe B. UBS⁴ e vlerëson heqjen e kësaj fraze si “A” (e sigurt).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:7-10

⁷Çfarë atëherë? Atë që Izraeli po kërkon, nuk e ka arritur, por ata që u zgjodhën e arritën, dhe pjesa tjetër u ngurtësua; ⁸ashtu siç është shkruar, “PERËNDIA U DHA ATYRE NJË FRYMË PËRGJUMJEJE, SY PËR TË MOS PARË DHE VESHË PËR TË MOS DËGJUAR, DERI NË DITËN E SOTME.” ⁹Dhe Davidi thotë, “TRYEZA E TYRE U BËFTË NJË LAK DHE NJË KURTH, DHE NJË GUR PENGESE DHE NJË NDËSHKIM PËR TA. ¹⁰“U ERRËSOFSHIN SYTË E TYRE QË TË MOS SHOHIN, DHE PËRKULI SHPINAT E TYRE PËRGJITHMONË.”

11:7 “Atë që Izraeli po kërkon, nuk e ka arritur” Kjo është vendosur e para në fjalinë në greqisht për të theksuar mendimin e Palit. Shumë hebrenj po kërkonin të ishin në pozitë të drejtë me Perëndinë dhe e kërkonin këtë në kryerjen e ritualeve fetare, në privilegjin racial dhe në përpjekjet e veta. Ata nuk e arritën synimin e tyre! Asnjë mish nuk do të përlëvdohet përpara Perëndisë (krh. I Kor. 1:29; Efe. 2:9).



NASB “por ata që u zgjodhën e arritën”
NKJV “por të zgjedhurit e kanë arritur”
NRSV “Të zgjedhurit e arritën”
TEV “E gjeti vetëm grupi i vogël që zgjodhi Perëndia”
NJB “por vetëm ata pak të zgjedhur”

Ky është koncepti i DHV i “mbetjes” (shih Temë e Veçantë në 9:27-28), që këtu i referohet 7,000 burrave të I Mbr. 19:18. Çelësi nuk është përpjekja njerëzore, raca apo fetarizmi (v. 6), por zgjedhja e Perëndisë (krh. Efe. 1:3-14).

■ **“pjesa tjetër u ngurtësua”** Kjo është një AORISTE PËSORE DËFTORE (krh. II Kor. 3:14). Nënkuptimi është që Perëndia i ngurtësoi (krh. vv. 8-10). Agjenti i ngurtësimit është i ligu (krh. II Kor. 4:4). “U ngurtësua” (*pōroō*) është një term mjekësor për fortësimin apo verbërinë (krh. Rom. 11:25; II Kor. 3:14; Efe. 4:18). Po i njëjti term është përdorur për Apostujt te Marku 6:52. Është një term i ndryshëm në greqisht nga 9:18 (*sklērunō*) që është e kundërta e mëshirës (krh. Heb. 3:8,15; 4:7).

Ky varg është shumë i qartë dhe është një përmbledhje e 11:1-6. Disa që u zgjodhën besuan, disa që nuk u zgjodhën, u ngurtësuan. Megjithatë, ky varg nuk u shkrua në izolim, si një slogan teologjik. Ai ishte pjesë e një argumenti teologjik të zgjatur. Ka një tension mes të vërtetës së shpallur kaq qartë në këtë varg dhe ftesave universale të kapitullit 10. Ka një mister këtu. Por zgjidhja nuk është të mohosh apo minimizosh asnjë nga brirët e dilemës, polet paradoksale.

11:8-10 Këta vargje janë citime të marra nga Isa. 29:10 (v. 8a), LiP. 29:4 (v. 8b, por jo nga MT ose LXX) dhe Ps. 69:22-23 (vv. 9-10). Ata vërtet reflektojnë thirrjen dhe misionin e Isaias ndaj një Izraeli rebel në 6:9-13. Isaia do të shpallte Fjalën e Perëndisë, por populli i Perëndisë nuk do të mundej dhe nuk do të donte të përgjigjej. Pali po jep këtu prova të faktit që Perëndia i ngurtësoi disa, siç bëri edhe në 9:13,15,17.

11:8

NASB, NKJV “Perëndia u dha atyre një frymë përgjumjeje”
NRSV, NJB “Perëndia u dha atyre një frymë letargjie”
TEV “Perëndia i mpiu mendjet dhe zemrat e tyre”

Kjo fjalë greke (*katanuxis*), e përdorur vetëm këtu në DHR, përdorej për një pickim insekti që i mpin shqisat me anë të mbindjeshmërisë.

11:10 “U ERRËSOFSHIN SYTË E TYRE QË TË MOS SHOHIN, DHE PËRKULI SHPINAT E TYRE PËRGJITHMONË” Kjo është një AORISTE PËSORE URDHËRORE e ndjekur nga një AORISTE VEPRORE URDHËRORE. Ky është misteri i sovranitetit të Perëndisë dhe i përgjigjes së nevojshme të njeriut. Perëndia është burimi i të gjitha gjërave, iniciatori i të gjitha gjërave, e megjithatë, në vullnetin e Tij sovran Ai ka dekretuar që njerëzit, krijimi i Tij më i lartë, t’i përgjigjet Atij lirisht. Ata që nuk përgjigjen me besim, janë ngurtësuar (d.m.th., zgjedhja e tyre, e finalizuar) në mosbesimin e tyre.

Në këtë kontekst Pali shpall planin e përjetshëm të Perëndisë për shpengimin e të gjithë fëmijëve të Adamit. Mosbesimi i hebrenjve do t’u hapë derën e besimit johebrenjve dhe përmes xhelozisë do të rikthejë

Izraelin si komb! Është një plan përfshirjeje (krh. Efe. 2:11-3:13), jo përjashtimi! Ngurtësimi i shërben një të korre më të madhe (krh. Faraonin)!

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:11-16

¹¹Unë them atëherë, ata nuk u penguan që të bien, apo jo? Kurrë mos qoftë! Por me anë të shkeljes së tyre shpëtimi u ka ardhur johebrenjve, për t'i bërë ata xhelozë. ¹²Tani, nëse shkelja e tyre është pasuri për botën dhe dështimi i tyre është pasuri për johebrenjtë, sa më tepër do të jetë përmbushja e tyre! ¹³Por unë po ju flas juve që jeni johebrenj. Meqenëse jam apostull i johebrenjve, unë e madhëroj shërbesën time, ¹⁴nëse në ndonjë mënyrë mund t'i shtyj në xhelozë bashkëkombasit e mi dhe t'i shpëtoj disa prej tyre. ¹⁵Sepse nëse refuzimi i tyre është pajtimi i botës, çfarë do të jetë pranimi i tyre, përveçse jetë nga vdekja? ¹⁶Nëse pjesa e parë e brumit është e shenjtë, i gjithë brumi është i shenjtë; dhe nëse rrënja është e shenjtë, të tilla janë edhe degët.

11:11 “Unë them atëherë” Kjo është e njëjta frazë retorike si në 11:1. Ajo vazhdon argumentin teologjik të Palit në një mënyrë tjetër. Në vv. 1-10 jo i gjithë Izraeli është hedhur poshtë nga Perëndia; në vv. 11-24 hedhja poshtë e Izraelit nuk është e përhershme; është e qëllimtë. Përmes saj janë përfshirë johebrenjtë.

■ **NASB** “ata nuk u penguan që të bien, apo jo”
NKJV, NRSV “a janë penguar që të bien”
TEV “Kur u penguan hebrenjtë, a u rrëzuan deri në shkatërrimin e tyre”
NJB “A kanë rënë përgjithmonë hebrenjtë, apo thjesht janë penguar”

Kjo pyetje pret një përgjigje “jo”. Mosbesimi i Izraelit nuk është një situatë e përhershme.

■
NASB “me anë të shkeljes së tyre”
NKJV “përmes rënies së tyre”
NRSV “përmes pengimit të tyre”
TEV “Për shkak se mëkatuan”
NJB “rënia e tyre”

Në kontekst, kjo i referohet hedhjes poshtë nga hebrenjtë të Jezusit si Mesia i tyre (krh. v. 12).

■ **“shpëtimi u ka ardhur johebrenjve”** Çfarë deklarate tronditëse ishte kjo për hebrenjtë e shekullit të parë (krh. v. 12; Veprat 13:46; 18:6; 22:21; 28:28).

■ **“për t'i bërë ata xhelozë”** Termi “xhelozë” del në 10:19 dhe 11:14. Plani i Perëndisë i përfshirjes së johebrenjve u shërben dy qëllimeve.

1. Shpengimit nga Perëndia të të gjithë njerëzimit
2. Rikthimit nga Perëndia të mbetjes së penduar të Izraelit në besim personal

Unë personalisht pyes veten nëse #2 ka të bëjë me

1. një rizgjim të hebrenjve në fundin e kohës (krh. Zak. 12:10)
2. besimtarët hebrenj të shekullit të parë dhe të çdo shekulli
3. sinagogat e sotme mesianike mund të jenë përmbushja e premtuar

11:12-14 Në këta vargje ka një seri prej dhjetë FJALISH KUSHTORE që lidhen me mosbesimin e hebrenjve në raport me besimin e johebrenjve. Vargjet 12,14,15,16,17,18,21,24 janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË PARË që supozohen të vërteta nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare, kurse vv. 22 dhe 23 janë FJALI KUSHTORE TË KLASIT TË TRETË që tregojnë veprim të mundshëm të ardhshëm.

11:12
NASB “sa më tepër do të jetë përmbushja e tyre”
NKJV “sa më tepër plotësia e tyre”
NRSV “Sa shumë më tepër do të ketë kuptim përfshirja e tyre e plotë”
TEV “Atëherë, sa më i madh do të jetë bekimi, kur të përfshihet numri i plotë i hebrenjve”
NJB “atëherë mendoni sa më tepër do të përfitojë nga kthimi në besim i të gjithë atyre”

Kyçi i interpretimit është kuptimi i termit “plotësia e tyre.” Ai lidhet me (1) shpëtimin e hebrenjve, vv. 14b, 26a, ose (2) me numrin përfundimtar të besimtarëve të zgjedhur hebrenj dhe johebrenj?

11:13 “Unë po ju flas juve që jeni johebrenj” Kapitujt 9-11 formojnë një njësi letrare që i përgjigjej pyetjes, “Pse është hedhur poshtë nga hebrenjtë Mesia hebre?” Megjithatë, pyetja mbetet, pse e ndjeu nevojën Pali në këtë letër, në këtë pikë në prezantimin e tij, për t’u marrë me këtë pyetje.

Vargjet 13-24, 25c duket se reflektojnë një problem në kishën e Romës midis hebrenjve etnikë dhe johebrenjve. Nuk është e qartë nëse ishte midis hebrenjve besimtarë dhe johebrenjve besimtarë, apo midis johebrenjve besimtarë dhe hebrenjve jobesimtarë (sinagogës).

▣ **“jam apostull i johebrenjve”** Pali u ndje i thirrur në mënyrë unike për t’i shërbyer botës johebreje (krh. Veprat 9:15; 22:21; 26:17; Rom. 1:5; 15:16; Gal. 1:16; 2:7,9; I Tim. 2:7; II Tim. 4:17).

▣
NASB, NKJV “unë e madhëroj shërbesën time”
NRSV “unë e përlëvdoj shërbesën time”
TEV “unë do të krenohem në punën time”
NJB “dhe jam krenar që jam dërguar”

Termi “madhëroj” mund të kishte kuptimin (1) mirënjohje; (2) krenim, ose ndoshta (3) bërja çmos për ta përmbushur. Kjo mund të reflektojë një problem në kishën në Romë! Pali (1) është i kënaqur t’iu shërbejë johebrenjve ose (2) e pa shërbesën e tij si bërjen e hebrenjve jobesimtarë xhelozë, gjë që do të rezultonte në shpëtimin e tyre (krh. vv. 11,14 dhe 9:1-3).

11:14 “shpëtoj disa prej tyre” Kjo është thirrja ungjilltare e Palit. Ai e dinte që disa do t’i përgjigjeshin predikimit të ungjillit (krh. I Kor. 1:21), kurse të tjerë jo (krh. I Kor. 9:22). Ky është misteri i zgjedhjes (DHV dhe DHR)!

11:15 Hedhja poshtë (fjalë e ndryshme nga ajo në v. 1) e Izraelit të zgjedhur të DHV ishte pjesë e planit të Perëndisë për shpengimin e gjithë njerëzimit (*kosmos*). Vetëdrejtësia e hebrenjve, arroganca e tyre racore dhe legalizmi i tyre e vinin qartë në dukje nevojën për besim (krh. 9:30-33). Besimi në YHWH dhe në Mesian e Tij është kyçi për pozitën të drejtë, jo veprat fetare të njerëzve. Por kujtoni që hedhja poshtë e Izraelit ishte për qëllimin e shpengimit të gjithë njerëzimit. Këtu nuk ka vend për krenari njerëzore, as hebreje, as johebreje. Ky me sa duket është një mesazh që kisha e Romës kishte nevojë ta dëgjonte!

▣ **“pajtimi i botës”** Kjo është teologjikisht paralel me “drejtësinë e Perëndisë.” Termi i përbërë vjen nga *kata* plus *alassō* (të këmbesh, të ndryshosh, apo të shndërrosh). Ai i referohet këmbimit të armiqësisë me paqen dhe me anë të saj, rikthimin e pëlqimit (krh. Rom. 5:11; 11:15; II Kor. 5:18,19). Perëndia kërkon rikthimin e bashkësisë në Eden. Mëkati e prishi atë bashkësi, por Krishti e ka restauruar imazhin e Perëndisë në njerëzimin e rënë për të gjithë që ushtrojnë besim. Ata janë pajtuar dhe pranuar (paralelizëm i v. 15). Njerëzimi nuk mund ta rikthente këtë intimitet, por Perëndia mundet dhe e riktheu!

▣ **“përveçse jetë nga vdekja”** Konteksti i adresohet Izraelit si komb, atëherë

1. a i referohet kjo frazë një Izraeli etnik të restauruar
2. a i referohet kjo frazë “numrit të plotë/plotësisë” të hebrenjve dhe johebrenjve (d.m.th., Izraelit shpirtëror, krh. 9:6; 11:25-26)
3. a i referohet kjo frazë (krh. 6:13) jetës në epokën e re, jetës së ringjalljes?

Mua më pëlqen #3. Për arsyet e mia, shih “Artikullin Kyç Hyrës,” në komentarin tim mbi Zbulesën online falas në www.freebiblecommentary.org.

11:16 “Nëse pjesa e parë e brumit është e shenjtë” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Ajo është një aluzion ndaj Num. 15:17-21. Ajo është një metaforë që është e ngjashme me konceptin e DHV të Fryteve të Para (ose të dhjetës) që i jepeshin Perëndisë për të treguar se e gjithë e korra i përkiste Atij.

Mbetja e lashtë e hebrenjve besimtarë ende kishte një efekt mbi të gjithë kombin (krh. Zan. 18:27-33; II Kron. 7:14). Metafora e “pjesa e parë” është paralele me “rrënja” (krh. Jer. 11:16-17), dhe të dyja u referohen besnikëve të Izraelit e veçanërisht Patriarkëve (d.m.th., “rrënja” e vv. 16-17) të DHV (krh. v. 28).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:17-24

¹⁷Por nëse disa nga degët u këputën, dhe ti, duke qenë ulli i egër, u shartove në mes tyre dhe u bërë pjesëmarrës me ta i rrënjës së pasur të pemës së ullirit, ¹⁸mos u bëj arrogant ndaj degëve; por nëse je arrogant, kujto që nuk je ti që e mban rrënjën, por rrënja të mban ty. ¹⁹Ti do të thuash atëherë, “Degët u këputën që të shartohesha unë.” ²⁰Ashtu është, ato u këputën për shkak të mosbesimit të tyre, por ti qëndron me anë të besimit tënd. Mos u bëj mendjemadh, por ki frikë; ²¹sepse, nëse Perëndia nuk i kurseu degët natyrore, Ai nuk do të të kursejë as ty. ²²Shiko, atëherë, mirësinë dhe ashpërsinë e Perëndisë; ndaj atyre që ranë, ashpërsi, por ndaj teje, mirësinë e Perëndisë, nëse vazhdon në mirësinë e Tij; përndryshe edhe ti do të pritësh. ²³Edhe ata, nëse nuk vazhdojnë në mosbesim, do të shartohen, sepse Perëndia është në gjendje t’i shartojë përsëri. ²⁴Sepse nëse ti u këpute nga ai që është nga natyra ulli i egër, dhe u shartove kundër natyrës në ulli të butë, sa më tepër ata që janë *degët* natyrore do të shartohen në pemën e tyre të ullirit?

11:17-24 Për habi “ti” në këtë paragraf është në NUMRIN NJËJËS (SHUMËSI rishfaqet në v. 25). Çfarë do të thotë kjo?

1. Një johebre si simbol i të gjithë johebrenjve
2. problemi në kishën e Romës midis udhëheqësisë hebreje dhe johebreje, dhe këtu u referohet udhëheqësve të tanishëm johebrenj (krh. vv. 18-20)

11:17 “nëse” Shih shënimin në 11:12-24.

▣ **“degët u këputën”** Kjo u referohet izraelitëve jobesimtarë (krh. vv. 18,19, “degët natyrore,” v. 21).

▣ **“ulli i egër”** Kjo u referohet johebrenjve besimtarë që i përgjigjen predikimit të ungjillit.

▣ **“u shartove”** Pali e vazhdon metaforën bujqësore që e filloi në v. 16. Shartimi i degëve të ullirit të egër në një pemë të kultivuar ndihmonte në shtimin e frytshmërisë (krh. v. 24).

▣ **“i rrënjës së pasur”** Faza origjinale fjalë për fjalë, “rrënja e majmërisë” (UBS⁴ i jep një vlerësim “B” [pothuaj i sigurt]), gjendet në MSS \aleph^* , B, C. Ka disa lexime të tjera në traditat e dorëshkrimeve në greqisht që përpiqen ta zbusin këtë asindeton (Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, fq. 526).

▣ **“pemës së ullirit”** Kjo është simbol i Izraelit etnik (krh. v. 24; Ps. 52:8; 128:3; Jer. 11:16; Os. 14:6). Kjo është metafora e dytë e Palit nga DHV për të përshkruar marrëdhënien midis hebrenjve dhe johebrenjve.

11:18 “mos u bëj arrogant ndaj degëve” Kjo është URDHËRORE E TASHME me PJESËZ MOHORE që zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Ky varg, plus vv. 13, 20, 25, nënkupton që kishte një problem në kishën e Romës midis hebrenjve besimtarë dhe johebrenjve besimtarë.

11:19-20 Vargu 19 është një tjetër diatrib (një kundërshtar i supozuar). Pali shpjegon pse u hodhën poshtë hebrenjtë. Ishte për shkak të mosbesimit të tyre, jo sepse johebrenjtë u deshën më shumë! Johebrenjtë u përfshinë vetëm për shkak të dashurisë së Perëndisë (krh. Zan. 3:15) dhe besimit të tyre! Ata gjithashtu mund t’i bënin hebrenjtë të ktheheshin te Perëndia për shkak të xhelozisë (krh. vv. 11,14).

11:20

NASB “por ti qëndron me anë të besimit tënd”

NKJV “dhe ti qëndron me anë të besimit”

NRSV “por ti qëndron vetëm përmes besimit”

TEV “ndërsa ti qëndron në vend sepse beson”

NJB “nëse ti ende mbahesh fort, kjo është vetëm falë besimit tënd”

Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORË. Megjithatë, ajo është në kontekstin e dhjetë FJALIVE KUSHTORE. Qëndrimi ynë përpara Perëndisë është dhe vazhdon të jetë me anë të besimit. Nëse besimi pushon, qëndrimi ynë pushon. Shpëtimi është (1) përgjigje fillestare besimi; (2) një gjendje e të qenit në besim; (3) një proces i vazhdueshëm besimi; dhe (4) një kulminim final besimi. Kini kujdes nga ndonjë sistem teologjik që fokusohet vetëm në njërin nga këto të vërteta biblike. Shih Temën e Veçantë: Kohët e foljeve në greqisht që përdoren për shpëtimin në 10:4.

Perëndia është autori, iniciatori, mbajtësi, dhe kulminuesi i shpëtimit, por në një model besëlidhor. Ai ka zgjedhur që njerëzimi mëkatar duhet të përgjigjet dhe të vazhdojë të përgjigjet me anë të pendimit dhe besimit në çdo hap të procesit. Ai kërkon bindje, ngjashmëri me Krishtin dhe këmbëngulje!



NASB	“Mos u bëj mendjemadh, por ki frikë”
NKJV	“Mos u bëj fodull, por ki frikë”
NRSV	“Prandaj mos u bëj krenar, por mbushu me frikë”
TEV	“Por mos ji krenar për këtë, përkundrazi, frikësohu”
NJB	“Në vend që të të bëjë krenar, kjo duhet të të frikësojë”

Të dyja këto thënie janë URDHËRORE TË TASHME. E para ka PJESËZËN MOHORE, që zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Ko zbuloi një problem në kishën e Romës. Arsyeja për frikë jepet në v. 21.

11:21 “nuk do të të kursejë as ty” Ashtu si Izraeli e la besimin dhe u largua nga YHWH me mosbesim krenar dhe u këput, kështu do të këputet edhe kisha nëse ajo e braktis besimin në Krishtin nëpërmjet vetëdrejtësisë krenare. Besimi fillestar duhet ndjekur nga një besim si mënyrë jetese (krh. Mat. 13:1-23; Marku 4:1-12; Luka 8:4-10). Krenaria duhet të rezistohet vazhdimisht. Ne jemi ata që jemi me anë të hirit të Perëndisë dhe jemi vëllezër me të gjithë ata që i besojnë Krishtit!

TEMË E VEÇANTË: FEMOHIMI (APHISTËMI)

Ky term greqisht, *afistēmi*, ka fushë të gjerë semantike. Gjithsesi, termi anglisht “apostasy” [shqip, “femohim”] rrjedh nga ky term dhe e paragjykon përdorimin e tij në mendjen e lexuesve anglishtfolës. Si gjithmonë, konteksti është ka vlerë kyçe, dhe jo ndonjë përcaktim paraprak.

Kjo është një fjalë e përbërë nga parafjala *apo*, që do të thotë “prej” ose “larg nga” dhe *histēmi*, “ulem”, “qëndroj”, ose “ngulis”. Vini re përdorimet e mëposhtme (joteologjike):

1. heq fizikisht
 - a. nga tempulli, Luka 2:37
 - b. nga një shtëpi, Marku 13:34
 - c. nga një njeri, Marku 12:12; 14:50; Veprat 5:38
 - d. nga të gjitha gjërat, Mat. 19:27, 29
2. heq politikisht, Veprat 5:37
3. heq nga ana e marrëdhënieve, Veprat 5:38; 15:38; 19:9; 22:29
4. heq ligjërisht (divorcoj), LiP. 24:1, 3 (LXX) dhe DhR, Mat. 5:31; 19:7; Marku 10:4; 1 Kor. 7:11
5. largoj një borxh, Mat. 18:27
6. tregoj moskokëçarje duke u larguar, Mat. 4:20; Gjoni 4:28; 16:32
7. tregoj preokupim duke mos u larguar, Gjoni 8:29; 14:18
8. lejoj ose jap leje, Mat. 13:30; 19:14; Marku 14:6; Luka 13:8

Në kuptimin teologjik, edhe FOLJA ka përdorim të gjerë:

1. anuloj, fal, largoj fajin e mëkatit, Eks. 32:32 (LXX); Num. 14:19; Jobi 42:10 dhe DhR, Mat. 6:12, 14-15; Marku 11:25-26
2. i qëndroj larg mëkatit, 2 Tim. 2:19
3. neglizhoj duke u larguar prej
 - a. Ligjit, Mat. 23:23; Veprat 21:21
 - b. Besimit, Ezek. 20:8 (LXX); Luka 8:13; 2 Thes. 2:3; 1 Tim. 4:1; Heb. 3:12

Besimtarët e sotëm bëjnë shumë pyetje teologjike që shkrimtarëve të DhR as nuk u kanë shkuar kurrë në mendje. Një prej këtyre lidhet me prirjen moderne për ta ndarë besimin nga besnikëria.

Ka persona në Bibël që përfshihen në popullin e Perëndisë dhe ndodh diçka.

- I. Dhiata e Vjetër
 - A. Ata që dëgjuan lajmin e dymbëdhjetë (dhjetë) spiunëve, Numrat 14 (shih Heb. 3:16-19)
 - B. Korahu, Numrat 16
 - C. Bijtë e Elit, 1 Samuelit 2, 4
 - D. Sauli, 1 Samueli 11-31
 - E. Profetët e rremë (shembuj)
 1. LiP. 13:1-5; 18:19-22 (mënyrat si të njihet profeti i rremë)
 2. Jeremia 28
 3. Ezekieli 13:1-7
 - F. Profeteshat e rreme
 1. Ezekieli 13:17
 2. Nehemia 6:14
 - G. Drejtuesit e ligj të Izraelit (shembuj)
 1. Jeremia 5:30-31; 8:1-2; 23:1-4
 2. Ezekieli 22:23-31
 3. Mikea 3:5-12

II. Dhiata e Re

- A. Fjalë për fjalë, ky term greqisht do të thotë “femohim”. Dhiata e Vjetër dhe ajo e Re konfirmojnë shtimin e ligësisë dhe mësimin të rremë përpara Ardhjes së Dytë (shih Mat. 24:24; Marku 13:22; Veprat 20:29,30; 2 Thes. 2:9-12; 2 Tim. 4:4). Qartazi, këta mësues të rremë nuk ishin të krishterë, por vinin nga brenda (shih Veprat 20:29-30; 1 Gjonit 2:19); megjithatë, ata janë në gjendje të joshin dhe të bëjnë për vete besimtarët e papjekur (shih Heb. 3:12).

Pyetja teologjike është kjo: a kishin qenë ndonjëherë besimtarë këta mësues të rremë? Është e vështirë t'i përgjigjemi, pasi në kishat lokale kishte mësues të rremë (shih 1 Gjonit 2:18-19). Shpesh, traditat tona teologjike ose denominacionale i përgjigjen kësaj pyetjeje pa iu referuar pasazheve të veçanta biblike (përveç metodës së “pasazhit-provë”, pra, e citimit të një vargu jashtë konteksti gjoja për të provuar anshmërinë tënde).

- B. Besim në dukje
 1. Juda, Gjoni 17:12
 2. Simon Magjistari, Veprat 8
 3. Ata që përmenden te Mat. 7:13-23
 4. Ata që përmenden te Mateu 13; Marku 4; Luka 8
 5. Judenjët e Gjonit 8:31-59
 6. Aleksandri dhe Himeneu, 1 Tim. 1:19-20
 7. Ata të 1 Tim. 6:21
 8. Himeneu dhe Fileti, 2 Tim. 2:16-18
 9. Dema, 2 Tim. 4:10
 10. Mësuesit e rremë, 2 Pjetri 2:19-22; Juda v. 12-19
 11. Antikrishtët, 1 Gjonit 2:18-19
- C. Besim pa fryt
 1. 1 Korintasve 3:10-15
 2. 2 Pjetrit 1:8-11

Ne rrallëherë mendojmë për këto pasazhe për shkak se teologjia jonë sistematike (kalvinizëm, arminianizëm, etj.) na dikton përgjigjen e detyruar. Ju lutem, mos më paragjykoni pse po e shtroj këtë temë. Preokupimi im është procedura e saktë hermeneutike. Duhet t'i lejojmë Biblës të na flasë dhe s'duhet të përpiqemi ta fusim Biblën brenda një teologjie të paracaktuar. Shpesh, kjo është e dhimbshme dhe tronditëse për shkak se një pjesë e mirë e teologjisë sonë është denominacionale, kulturore, ose sociale (prindi, miku, pastori), jo biblike. Disa që janë Popull i Perëndisë dalin se nuk janë pjesë e Popullit të Perëndisë (p.sh., Rom. 9:6).

11:22 “mirësinë dhe ashpërsinë e Perëndisë” Rrugët e Perëndisë gjithmonë i duken paradoksale njerëzimit të rënë (krh. Isa. 55:8-11). Zgjedhjet tona kanë pasoja. Zgjedhja e Perëndisë nuk e heq përgjegjësinë e njerëzimit. Zgjedhja e Izraelit etnik nuk garantonte shpëtimin e çdo individi.

■ **“nëse vazhdon në mirësinë e Tij”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË me një TË TASHME LIDHORE. Ky konstruksion do të thoshte që vazhdimësia e johebrenjve besimtarë është me kusht (kjo është ana tjetër e medaljes së sovranitetit të Perëndisë të Romakëve 9); ne duhet të jemi të zellshëm ta ruajmë besimin tonë (krh. Fil. 2:12-13). Kjo i referohet si këmbënguljes kolektive, ashtu edhe të individit (krh. Gal. 6:9; Zbu. 2:7,17; 3:6,13,22). Ky është misteri dhe tensioni i kolektivitetit dhe individualitetit në Bibël. Ka edhe premtime (bazuar në karakterin e Perëndisë) dhe besëlidhje me kusht (bazuar në përgjigjen njerëzore). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për të këmbëngulur në 8:25.

11:23 Ky varg ndjek modelin gramatikor dhe teologjik të v. 22. Nëse hebrenjtë pendohen dhe besojnë, ata do të përfshihen. Nëse johebrenjtë ndalojnë së besuari, ata do të hidhen poshtë (krh. v. 20). Besimi fillestar në Krishtin dhe besimi i vazhdueshëm në Të janë kyç për të dy grupet.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:25-32

²⁵Sepse nuk dua, vëllezër, që ju të jeni të painformuar në lidhje me këtë mister— që të mos jeni të urtë sipas vlerësimit tuaj—që një ngurtësim i pjesshëm i ka ndodhur Izraelit derisa të hyjë plotësia e johebrenjve; ²⁶dhe kështu i gjithë Izraeli do të shpëtohet; ashtu siç është shkruar, “ÇLIRIMTARI DO TË VIJË NGA SIONI, AI DO TA HEQË PAPERËNDISHMËRINË NGA JAKOBI.” ²⁷“KJO ËSHTË BESËLIDHJA IME ME TA, KUR UNË TË HEQ MËKATET E TYRE.” ²⁸Nga këndvështrimi i ungjillit ata janë armiq për hirin tuaj, por nga këndvështrimi i zgjedhjes së Perëndisë ata janë të dashur për hir të etërve; ²⁹sepse dhuntitë dhe thirrja e Perëndisë janë të parikthyeshme. ³⁰Sepse ashtu si dikur ju ishit të pabindur ndaj Perëndisë, por tani ju është treguar mëshirë për shkak të mosbindjes së tyre, ³¹po ashtu ata kanë qenë tani të pabindur, që për shkak të mëshirës që u është treguar juve, edhe atyre tani t’iu tregohet mëshirë. ³²Sepse Perëndia i ka mbyllur të gjithë në mosbindje në mënyrë që t’iu tregojë mëshirë të gjithëve.

11:25 “nuk dua, vëllezër, që ju të jeni të painformuar” Kjo është një idiomë karakteristike e Palit (krh. 1:13; I Kor. 10:1; 12:1; II Kor. 1:8; I Thes. 4:13). Ajo zakonisht ndiqet nga një argument i rëndësishëm. Funkcionon si shprehja e Jezusit, “Amen, Amen” në fillim të fjalisë. Pali shpesh e përdor për të treguar një temë të re.



NASB, NKJV,

NRSV

TEV

NJB

“mister”

“një të vërtetë të fshehtë”

“një arsye të fshehtë për gjithë këtë”

TEMË E VEÇANTË: MISTER

Perëndia ka një qëllim të unifikuar për shpengimin e njerëzimit që ishte qysh përpara rënies (krh. Zanafilla 3). Disa shenja të këtij plani janë zbuluar në DHV (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; dhe pasazhet universale në profetët). Megjithatë axhenda e plotë nuk ishte e qartë (krh. I Kor. 2:6-8). Me ardhjen e Jezusit dhe të Frymës ajo filloi të bëhej më e qartë. Pali e përdor termin “mister” për të përshkruar këtë plan total shpengimi (krh. I Kor. 4:1; Efe. 6:19; Kol. 4:3; I Tim. 1:9). Megjithatë, ai e përdor atë në disa kuptime të ndryshme:

1. Një ngurtësim i pjesshëm i Izraelit për të lejuar përfshirjen e johebrenjve. Ky fluks i johebrenjve do të funksionojë si mekanizëm që hebrenjtë ta pranojnë Jezusin si Krishtin e profecisë (krh. Rom. 11:25-32).
2. Ungjilli iu bë i njohur kombeve, që janë të gjithë të përfshirë në Krishtin dhe përmes Krishtit (krh. Rom. 16:25-27; Kol. 2:2).
3. Trupat e rinj të besimtarëve në Ardhjen e Dytë (krh. I Kor. 15:5-57; I Thes. 4:13-18).
4. Sjellja e të gjitha gjërave në Krishtin (krh. Efe. 1:8-11).
5. Johebrenjtë dhe hebrenjtë janë bashkëtrashëgimtarë (krh. Efe. 2:11-3:13).

6. Intimiteti i marrëdhënies midis Krishtit dhe Kishës i përshkruar në terma martesorë (krh. Efe. 5:22-33).
7. Johebrenjtë të përfshirë në popullin e besëlidhjes dhe të brendabanuar nga Fryma e Krishtit që prodhon pjekuri dhe ngjashmëri me Krishtin, domethënë, rikthen/restauron imazhin e dëmtuar të Perëndisë në njerëzimin e rënë (krh. Zan. 1:26-27; 5:1; 6:5,11-13; 8:21; 9:6; Kol. 1:26-28).
8. Anti-Krishtin e fundit të kohës (krh. II Thes. 2:1-11).
9. Një përmbledhje e misterit në kishën e hershme gjendet te I Tim. 3:16.

▣ **“që të mos jeni të urtë sipas vlerësimit tuaj”** Këtu është një tjetër shenjë e tensionit në kishën(at) e Romës (krh. v. 18).

▣

NASB “që një ngurtësim i pjesshëm i ka ndodhur Izraelit”
NKJV “që një ngurtësim pjesërisht i ka ndodhur Izraelit”
NRSV “një ngurtësim ka ardhur mbi një pjesë të Izraelit”
TEV “që kokëfortësia e popullit të Izraelit nuk është e përhershme”
NJB “Një seksion i Izraelit është verbuar”

Kjo deklaratë duhet lidhur me të gjithë kapitullin 11. Ka patur dhe do të vazhdojë të ketë disa hebrenj besimtarë. Kjo verbëri e pjesshme, e shkaktuar nga Perëndia (vv. 8-10) për shkak se hebrenjtë e hodhën poshtë Jezusin, ka një vend në planin e Perëndisë për të shpenguar të gjithë njerëzimin. Perëndia u premtoi shpëtimin të gjithëve (krh. Zan. 3:15). Ai zgjodhi Abrahamin për të arritur të gjithë (krh. Zan. 12:3). Ai zgjodhi Izraelin për të arritur të gjithë (krh. Eks. 19:5-6, shih Temën e Veçantë në 8:28). Izraeli dështoi në misionin e tij për shkak të krenarisë, mosbesnikërisë dhe mosbesimit. Perëndia donte ta arrinte botën johebreje duke bekuar Izraelin (krh. Ligji i Përtërirë 27-29). Izraeli nuk mundi ta mbante Besëlidhjen, prandaj mbi të ra gjykimi i përkohshëm i Perëndisë. Tani Perëndia ka marrë pikërisht këtë gjykim dhe e ka përdorur për të përmbushur qëllimin e Tij fillestar të shpengimit të njerëzimit përmes besimit (krh. vv. 30-31; Ezek. 36:22-38).

▣ **“derisa të hyjë plotësia e johebrenjve”** I njëjti term (*pleroma*) është përdorur në v. 12 për hebrenjtë. Të dy vargjet flasin për paranjohjen dhe zgjedhjen e Perëndisë. “Derisa” flet për një limit kohe për këtë periudhë të johebrenjve (krh. Luka 21:24).

11:26 “i gjithë Izraeli do të shpëtohet” Ka dy interpretime të mundshme.

1. Kjo i referohet Izraelit etnik—jo çdo hebre individual, por shumica në një pikë të caktuar në histori.
2. Kjo i referohet në një kuptim Izraelit frymëror, Kishës.

Pali e përdori këtë koncept në Rom. 2:28-29; Gal. 6:16; I Pjet. 2:5,9; Zbu. 1:6. “Kuota e plotë e hebrenjve” në v. 12 dhe “kuota e plotë e johebrenjve” në v. 25 janë në një marrëdhënie paralele. Është “të gjithë” në kuptimin e zgjedhjes së Perëndisë, jo të gjithë në kuptimin e çdo individi. Pema e ullirit e premtimit do të plotësohet një ditë. Disa komentatorë thonë që kjo duhet t’i referohet Izraelit etnik vetëm për shkak të

1. kontekstit të kapitujve 9-11
2. citimeve të DHV në vv. 26-27
3. deklaratës së qartë në v. 28

Perëndia ende ka një dashuri për farën natyrore të Abrahamit dhe një dëshirë që ata të shpëtohen! Ata duhet të vijnë përmes besimit në Krishtin (Zak. 12:10).

Pyetja nëse ata hebrenj që “u ngurtësuan” do të kenë një mundësi të përgjigjen në fundin e kohërave nuk mund të marrë përgjigje nga ky tekst apo nga ndonjë tekst tjetër. Si amerikanë ne jemi të prirur nga kultura që të bëjmë pyetje që kanë të bëjnë me individin, por Bibla fokusohet në tërësinë kolektive. Të gjitha pyetjet si kjo i duhen lënë Perëndisë. Ai do të jetë i drejtë me krijimin e Tij të cilin e do!

▣ **“ashtu siç është shkruar”** Kjo i referohet dy citimeve nga Septuaginta e Isa. 59:20-21(v. 26) dhe 27:9 (v. 27). Mekanizmi i shpëtimin do të jetë besimi në Jezusin, Mesian. Nuk ka plan B, vetëm plan A. Ka vetëm një mënyrë për t’u shpëtuar (krh. Gjonit 10:7-18; 11:25-29;14:6).

11:27 Isaia 27:9, që citohet në v. 27, bashkon rikthimin e Izraelit në Tokën e Premtuar (vv. 1-11) me ftesën ndaj armiqve tradicionalë (kombeve johebreje) që të përfshihen (krh. vv. 12-13). Nëse ky rikthim është literal atëherë mijëvjeçari mund ta përmbushë këtë profeci. Nëse është figurativ, atëherë synimi do të jetë besëlidhja e re, misteri

i ungjillit, në të cilin edhe hebrenjtë, edhe johebrenjtë bashkohen me anë të besimit në Mesian e Perëndisë (krh. Efe. 2:11-3:13). Është e vështirë ta përcaktosh. Disa profeci të DHV i aplikohen Kishës së Besëlidhjes së Re. Megjithatë, Perëndia është besnik ndaj premtimeve të Tij, edhe kur njerëzit nuk janë (krh. Ezek. 36:22-36).

11:28 Ky varg reflekton aspektet binjake të zgjedhjes.

1. në DHV zgjedhja ishte për shërbim; Perëndia zgjodhi instrumente njerëzore për qëllimin e shpengimit të njerëzimit
2. në DHR zgjedhja është e lidhur me ungjillin dhe shpëtimin e përjetshëm; ky shpëtim i të gjithë njerëzve të krijuar në imazhin e Perëndisë ka qenë gjithmonë synimi (krh. Zan. 3:15)

Perëndia është besnik ndaj premtimeve të Tij. Kjo është e vërtetë për besimtarët e DHV dhe për shenjtoret e DHR. Kyçi është besnikëria e Perëndisë, jo e njeriut, mëshira e Perëndisë, jo performanca njerëzore. Zgjedhja është për qëllimin e bekimit, jo të përjashtimit!

■ **“ata janë të dashur për hir të etërve”** Ky është premtimi i Eks. 20:5-6 dhe LiP. 5:9-10 dhe 7:9. Familjet bekohen për shkak të besimit të brezave të mëparshëm. Izraeli u bekuar për shkak të Patriarkëve besnikë (krh. LiP. 4:37; 7:8; 10:15). Që Mesia do të vinte nga Juda ishte gjithashtu një premtim që iu bë edhe Davidit (krh. II Samuelit 7). Megjithatë, duhet thënë se edhe “besnikët” nuk e mbajtën dot plotësisht Ligjin (krh. Ezek. 36:22-36). Besimi—besimi personal, besimi familjar, por jo besimi i përsosur—është i pranueshëm për Perëndinë dhe potencialisht transferohet nga brezi në brez përmes familjeve (krh. I Kor. 7:8-16).

11:29

NASB, NKJV,

NRSV **“sepse dhuntitë dhe thirrja e Perëndisë janë të parikthyeshme”**

TEV

“Sepse Perëndia nuk e ndryshon mendjen në lidhje me ata që zgjedh dhe bekon”

NJB

“Perëndia nuk i merr mbrapsht dhuntitë dhe as e revokon zgjedhjen e Tij”

Këtu nuk është fjala për dhuntitë frymërore të individëve (krh. I Korintasve 12), por për premtimet e shpëtimit të Perëndisë, DHV dhe DHR. Zgjedhja është efektive. Besnikëria e Perëndisë është shpresa e Izraelit etnik (krh. Mal. 3:6) dhe Izraelit frymëror!

11:30-32 Këta vargje janë një përmbledhje e planeve dhe qëllimeve të Perëndisë.

1. Ata bazohen gjithmonë në mëshirën e Tij (shih shënimin te 9:15-16), jo në përcaktimin arbitrar. Termi “mëshirë” është përdorur katër herë në këtë kontekst më të madh (krh. 9:15,16,18,23).
2. Perëndia i ka gjykuar të gjithë njerëzit. Hebrenjtë dhe johebrenjtë janë të gjithë mëkatarë (krh. 3:9,19,23; 5:11).
3. Perëndia e ka përdorur nevojën dhe pamundësinë e njerëzimit si një mundësi për të treguar mëshirë ndaj gjithë njerëzimit (krh. v. 22). Përsëri në kontekst “të gjithë” duhet parë nën dritën e vv. 12 dhe 25-26. Jo të gjithë individët do t’i përgjigjen ofertës së Perëndisë, por të gjithë janë përfshirë në shtrirjen e shpengimit (krh. 5:12-21; Gjonit 3:16). O Perëndi, kështu qoftë!!!

11:30 dhe 31 “por tani” Kjo nënkupton fort kthimin e Izraelit etnik me anë të besimit në Jezusin (krh. Zak. 12:10). Ashtu siç është mposhtur “mosbesimi” i johebrenjve nga mëshira e Perëndisë, ashtu do të mposhtet edhe “mosbesimi” i hebrenjve.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 11:33-36

³³Oh, thellësia e pasurisë së urtësisë dhe diturisë së Perëndisë! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe sa të pamatshme rrugët e Tij! ³⁴SEPSE KUSH E KA NJOHUR MENDJEN E ZOTIT, OSE KUSH U BË KËSHILLTARI I TIJ? ³⁵Ose KUSH I KA DHËNË I PARI ATIJ QË T’I KTHEHET BORXHI? ³⁶Sepse nga Ai dhe përmes Atij dhe për Të janë të gjitha gjërat. Atij i qoftë lavdia përjetë. Amen.

11:33-36 Kjo është një nga doksologjitë e mrekullueshme spontane të Palit. Pali është i tejmbushur për shkak të rrugëve të Perëndisë: besnikëria e besëlidhjes, përfshirja e besëlidhjes, kulminimi i besëlidhjes.

11:33 “pasuritë” Kjo është një idiomë e preferuar për Palin (krh. 2:4; 9:23; 10:12; 11:12,33; Efe. 1:7,8; 2:7; 3:8,16; Fil. 4:19; Kol. 1:27). Thelbi i ungjillit dhe shpresa e njerëzimit është mëshira bujare e karakterit dhe planit të Perëndisë (krh. Isa. 55:1-7).

▣ **“Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e Tij dhe sa të pamatshme rrugët e Tij”** Kjo është një doksologji me vend për të vërtetat paradoksale të kapitujve 9-11 (krh. Isa. 55:8-11).

11:34 Ky është një citim nga Septuaginta e Isa. 40:13-14, ku Perëndia e çliron popullin e Tij duke i kthyer nga mërgimi. Në I Kor. 2:16 Pali citon të njëjtin pasazh, por ia atribuon titullin “Zot” Jezusit.

11:35 Ky është një citim i lirshëm nga Jobi 35:7 ose 41:11.

11:36 “Sepse nga Ai dhe përmes Atij dhe për Të janë të gjitha gjërat” Këto fraza i referohen Perëndisë Atë në këtë kontekst (krh. I Kor. 11:12), por janë shumë të ngjashme me pasazhe të tjera të DHR që i referohen Perëndisë Bir (krh. I Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 2:10). Pali pohon se të gjitha gjërat dalin/rrjedhin nga Perëndia dhe kthehen te Perëndia.

▣ **“Atij i qoftë lavdia përjetë”** Ky është një bekim karakteristik i DHR mbi hyjninë. Ai i referohet

1. disa herë Atit (krh. 16:27; Efe. 3:21; Fil. 4:20; I Pjet. 4:11; 5:11; Juda 25; Zbu. 5:13; 7:12)
2. disa herë Birit (krh. I Tim. 1:17; II Tim. 4:18; II Pjet. 3:18; Zbu. 1:16)

Shih shënimin e plotë 3:23.

▣ **“Amen”** Shih Temën e Veçantë në 1:25.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si ndodhi që Izraeli nuk e kuptoi rrugën e Perëndisë për shpëtimin?
2. Cilat janë ato dy arsye që jep Pali për të provuar që Perëndia nuk e ka hedhur poshtë Izraelin?
3. Pse i ngurtësoi Perëndia zemrat e hebrenjve? Si?
4. Çfarë kuptimi ka koncepti i një “mbetjeje” hebreje (vv. 2-5)?
5. Përkufizo termin “mister” në DHR.
6. Çfarë kuptimi ka 11:26? Pse? Si lidhet me 9:6?
7. Çfarë paralajmërim u jep Pali besimtarëve johebrenj (vv. 17-24)?

ROMAKËVE 12

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Jeta e re në Krishtin	Fli të gjalla për Perëndinë	Jeta e shenjtëruar	Jeta në shërbimin e Perëndisë	Adhurimi frymëror
12:1-2	12:1-8	12:1-2	12:1-2	12:1-2 Përlësi dhe mirësi
12:3-8		12:3-8	12:3-8	12:3-13
Rregulla të jetës së krishterë	Sillu si i krishterë	Nxitje		
12:9-21	12:9-21	12:9-13 12:14-21	12:9-13 12:14-16 12:17-21	Mirësi ndaj të gjithëve, edhe ndaj armiqve 12:14-21

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

A.Paragrafi i parë

B.Paragrafi i dytë

C.Paragrafi i tretë

D.Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 1-8

- A. Kjo fillon seksionin praktik të Romakëve (12:1-15:13). Letrat e Palit ishin dokumente që i adresoheshin një rasti specifik, prandaj ato kanë edhe seksione doktrinare, edhe seksione zbatimi. Pali shkruante për t'iu adresuar një problemi apo krize lokale. Meqenëse Romakëve 1-8 është një përmbledhje kaq e mrekullueshme doktrinare, seksionet e saj etike dhe praktike janë njësoj të fuqishme.
- B. Teologjia pa zbatim si mënyrë jetese nuk është nga Perëndia (krh. Mat. 7:24-27; Gjoni 13:17; Rom. 2:13; Jakobi 1:22, 25; 2:14-26). Pali mëson qartë një shpëtim falas me anë të hirit të Perëndisë përmes besimit në Jezusin, por kjo dhuratë ka si synim të na i ndryshojë jetët në mënyrë rrënjësore! Shpëtimi është falas, por ai duhet ndjekur nga një ngjashmëri rrënjësore me Krishtin! Ne nuk duhet të guxojmë ta ndajmë shfajësimin nga shenjtërimi!

- C. Vargjet 1-2 formojnë një hyrje për të gjithë seksionin praktik. Kjo është baza për jetën e drejtuar nga Fryma (krh. kapitulli 8).
- D. Vargjet 3-8 diskutojnë dhuntitë frymërore. Nënshtrimi ynë i plotë ndaj Krishtit duhet të rezultojë në shërbim ndaj Perëndisë (krh. LiP. 6:4-5; Mat. 22:37) dhe ndaj të tjerëve (krh. Lev. 19:18; Mat. 19:19). Këto dhunti theksojnë unitetin tonë në Krishtin dhe dhuntitë tona të ndryshme (krh. Efe. 4:1-10). Besimtarët duhet të përpiqen për unitet, jo uniformitet. Ne jemi të pajisur nga Perëndia për t'i shërbyer njëri-tjetrit (krh. I Kor. 12:7,11; Efe. 4:11-13)!

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:1-2

¹Prandaj ju nxis vëllezër, me anë të mëshirave të Perëndisë, t'i paraqitni trupat tuaj një flijim të gjallë e të shenjtë, të pranueshëm për Perëndinë, që është shërbimi juaj frymëror i adhurimit. ²Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, në mënyrë që të provoni cili është vullneti i Perëndisë, ai që është i mirë dhe i pranueshëm dhe i përsosur.

▣ **“Prandaj”** Pali e përdor këtë term në pika të rëndësishme tranzitore në paraqitjen që u bën të vërtetave të ungjillit në librin e Romakëve.

1. Në 5:1 e tutje ajo përmbledh “shfajësimin me anë të besimit”
2. në 8:1 e tutje ajo përmbledh marrëdhënien e besimtarëve me mëkatën, që quhej shenjtërim
3. 12:1 e tutje ajo lidhet me funksionimin praktik të shfajësimit dhe shenjtërimit në jetën e përditshme të besimtarëve

12:1

NASB	“ju nxis”
NKJV	“ju përgjërohëm”
NRSV, TEV	“ju bëj thirrje”
NJB	“ju lutem”

Kjo frazë është edhe e butë, edhe e fortë. Ajo është një thirrje për jetën e duhur. Pali e përdor shpesh këtë term (krh. 12:1;15:30; 16:17; I Kor. 1:10; 4:16; 16:15; II Kor. 2:8; 5:20; 6:1; 10:1; 12:8; Efe. 4:1; Fil. 4:2; I Thes. 4:10; I Tim. 1:3; Filemonit vv. 9-10).

▣ **“vëllezër”** Pali shpesh e përdor këtë term për të prezantuar një temë të re.

▣ **“me anë të mëshirave të Perëndisë”** Në LXX kjo përshkruan natyrën e dhembshur të YHWH (krh. Eks. 34:6). Këtu ajo i referohet progresionit doktrinar të kapitujve 1-11. Te Romakëve ka një theks të dukshëm mbi “mëshirën” (edhe *oikēirō*, dhe *eleeō*) e Perëndisë në marrëdhënie me njerëzimin e rënë (krh. 9:15,16,18,23; 11:30,31,32; 12:8; 15:9). Për shkak se hiri dhe mëshira e Perëndisë ofrohen falas, besimtarët duhet të jetojnë jetë të perëndishme (krh. Efe. 1:4; 2:10) nga mirënjohja, jo nga merita (krh. Efe. 2:8-9). Jetët e reja (shih Kol. 3:9,10,12) kanë si qëllim të kthejnë të tjerë në besim në Krishtin!

▣ **“t'i paraqitni”** Kjo është një AORISTE PASKAJORE. Ky është njëri nga disa prej termave të lidhur me flijimet që përdoren në këtë kontekst: flijim, v. 1; i shenjtë, v. 1; i pranueshëm, v. 1. Po i njëjti koncept është shprehur në 6:13,16,19. Njerëzit ose do t'ia japin veten Perëndisë, ose Satanit. Meqenëse Krishti e dha Vetën e vet në mënyrë unike për të përmbushur vullnetin e Atit, madje deri në vdekjen në kryq, ndjekësit e Tij duhet ta imitojnë jetën e Tij joegoiste (krh. II Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; I Gjoni 3:16).

▣ **“trupat tuaj”** Krishtërimi është ndryshe nga një pjesë e madhe e filozofisë greke, që mendonte se trupi fizik ishte i keq. Ai është arena e tundimit, por është moralisht neutral. Termi “trup” duket se është paralel me “mendje” në v. 2. Besimtarët kanë nevojë t'ia përkushtojnë Perëndisë gjithë qenien e tyre (krh. LiP. 6:5; I Kor. 6:20) ashtu si më parë ia kishin përkushtuar mëkatit (krh. Romakëve 6).

▣ **“flijim të gjallë”** Ky ishte rrënjësisht i ndryshëm nga ofrimet e vdekura të tempujve hebrej dhe paganë (krh. 6:13; Gal. 2:20).

Kjo gjithashtu duhet të dallohet nga asketizmi (trajtimi i ashpër i trupit fizik për qëllime fetare). Këtu nuk propagandohet izolimi dhe ndëshkimi i trupit apo beqaria, por një jetë aktive shërbimi dhe dashuri si e Krishtit.

▣ **“e të shenjtë”** Termi “i shenjtë” do të thotë “i ndarë mënjanë për shërbimin e Perëndisë.” Fokusi i këtij termi në këtë kontekst është mbi shenjtërimin e besimtarit dhe disponueshmërinë për t’u përdorur nga Perëndia për qëllimet e Tij.

TEMË E VEÇANTË: I SHENJTË

- I. Dhiata e Vjetër
 - A. Etimologjia e fjalës *kadosh* (BDB 872) është e paqartë; ka gjasa të jetë kanaanite. Ka mundësi që një pjesë e rrënjës së saj (pra, *kd*) të ketë kuptimin “ndaj”. Ky është burimi i përcaktimit popullor “i ndarë (nga kultura kanaanite, shih LiP. 7:6; 14:2, 21; 26:19) për përdorim nga Perëndia”.
 - B. Ajo lidhet me praninë e Perëndisë në objekte, vende, kohë dhe persona të ndryshëm. Nuk përdoret te Zanafilla, por bëhet e zakonshme te Eksodi, Levitiku dhe Numrat.
 - C. Në literaturën profetike (sidomos te Isaia dhe Osea), elementi personal, që më parë ishte i pranishëm por jo i theksuar, tani del në pamje të parë. Bëhet mënyrë për të përcaktuar thelbin e Perëndisë (shih Isa. 6:3). Perëndia është i shenjtë. Emri i tij, që përfaqëson karakterin e tij, është i shenjtë. Populli i tij, që duhet t’ia zbulojë kësaj bote nevojtare karakterin e tij, është i shenjtë (nëse i bindet besëlidhjes me besim).
 - D. Mëshira dhe dashuria e Perëndisë janë të pandashme nga konceptet teologjike të besëlidhjeve, drejtësisë dhe karakterit thelbësor. Këtu qëndron tensioni brenda Perëndisë kundrejt njerëzimit të pashenjtë, të rënë dhe rebel. Është një artikull shumë interesant për marrëdhënien e Perëndisë si “i mëshirshëm” me Perëndinë si “i shenjtë”, te Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament (Sinonime të Dhiatës së Vjetër)*, f. 112-113.
- II. Dhiata e Re
 - A. Shkrimtarët e DhR (përveç Lukës) janë mendimtarë hebrej, por janë të ndikuar nga greqishtja *koine* (pra, Septuaginta). Ajo që kontrollonte fjalorin e tyre nuk ishte feja, mendimi, apo literatura klasike greke, por përkthimi grek i DhV.
 - B. Jezusi është i shenjtë ngaqë është nga Perëndia dhe si Perëndia (shih Luka 1:35; 4:34; Veprat 3:14; 4:27, 30). Ai është i Shenjti dhe i Drejti (shih Veprat 3:14; 22:14). Jezusi është i shenjtë ngaqë është i pamëkat (shih Gjoni 8:46; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 1:19; 2:22; 1 Gjonit 3:5).
 - C. Për shkak se Perëndia është i shenjtë, fëmijët e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Lev. 11:44-45; 19:2; 20:7, 26; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:16). Për shkak se Jezusi është i shenjtë, edhe ndjekësit e tij duhet të jenë të shenjtë (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pje. 1:15). Të krishterët shpëtohen për të shërbyer në ngjashmëri me Krishtin (shenjtëria).

▣ **“të pranueshme për Perëndinë”** Kjo i referohet një oferte të pranueshme në DHV (krh. v. 2). Kjo është e ngjashme me konceptin e “i patëmetë,” kur përdoret për t’iu referuar njerëzve (krh. Zan. 6:9; 17:1; LiP. 18:13; Jobi 1:1).

▣

NASB	“që është shërbimi juaj frymëror i adhurimit”
NKJV	“që është shërbimi juaj i arsyeshëm”
NRSV	“që është adhurimi juaj shpirtëror”
TEV	“Ky është adhurimi i vërtetë që duhet të ofroni.”
NJB	“në një mënyrë kjo është e denjë për qenie që mendojnë”

Ky term [*logikos*] rrjedh nga *logizomai*, që do të thotë “të arsyetosh” (krh. Marku 11:31; I Kor. 13:11; Fil. 4:8). Në këtë kontekst duhet të ketë kuptimin “i arsyeshëm. Por termi përdorej edhe në kuptimin “frymëror,” si në I Pjet. 2:2. Thelbi duket se është një ofertë e vetëdijshme e vetes përkundër ofrimeve të vdekura ose rituale të kafshëve të flijuara. Perëndia dëshiron jetët tona me dashuri dhe shërbim ndaj Tij, jo procedura formaliste që nuk e ndikojnë jetën e përditshme.

12:2 “mos u konformoni” Kjo është URDHËRORE E TASHME PËSORE (ose E KRYER JOVEPRORE) me PJESËZËN MOHORE qëzakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Ka një kontrast me v. 2 të ngjashëm me atë të Fil. 2:6-8, midis formës së jashtme të ndryshueshme (*schema*, 2:8) dhe thelbit të brendshëm të pandryshueshëm (*morphe*, 2:6-7). Besimtarët nxiten fort të mos vazhdojnë të jenë si sistemi i ndryshueshëm e i rënë i botës (epoka e vjetër e rebelimit) pjesë e të cilit janë ende fizikisht, por të ndryshohen në mënyrë rrenjësores në ngjashmëri me Krishtin (epoka e re e Frymës).

■ **“me këtë botë”** Ky është fjalë për fjalë termi “epokë.” Hebrejtë shikonin dy epoka (krh. Mat. 12:32; Marku 10:30; Luka 20:34-35), epokën e tanishme të ligë (krh. Gal. 1:4; II Kor. 4:4; Efe. 2:2) dhe epokën e ardhshme (krh. Mat. 28:20; Heb. 1:3; I Gjoni 2:15-17). Besimtarët jetojnë në kohën e tanishme të tensionit në të cilën këto epoka për çudi mbivendosen. Për shkak të dy ardhjeve të Krishtit, besimtarët jetojnë në tensionin “po vjen, madje ka ardhur” të Mbretërisë së Perëndisë si edhe e tashme, edhe megjithatë e ardhme.

TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA E ARDHSHME

Profetët e DhV e shihnin të ardhmen si zgjatim të së tashmes. Për ta, e ardhmja do të shënojë rimëkëmbjen e Izraelit gjeografik. Sidoqoftë, edhe ata e shihnin si ditë të re (shih Isa. 65:17; 66:22). Me refuzimin e vazhdueshëm kokëfortë të JHVH-së nga pasardhësit e Abrahamit (edhe pas robërisë), në letërsinë apokaliptike ndërhytore të judenjve u zhvillua një paradigmë e re (p.sh., 1 Enoku, 4 Esdra, 2 Baruku). Këto shkrime filluan të bënin dallimin mes dy epokave: epoka e ligë e tanishme, e dominuar nga Satani, dhe epoka e ardhshme e drejtësisë, e dominuar nga Fryma dhe e inauguruar nga Mesia (shpesh, si luftëtar dinamik).

Në këtë zonë të teologjisë (eskatologjia) ekziston një zhvillim i dukshëm. Teologët e quajnë këtë “zbulesë e shkallëzuar”. DhR e pohon këtë realitet të ri kozmik të dy epokave (pra, një dualizëm kohor).

<u>Jezusi</u>	<u>Pali</u>	<u>Hebrejtë</u>
Mateu 12:32	Romakëve 12:2	1:2
Mateu 13:22, 39	1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:18	6:5
Marku 10:30	2 Kor. 4:4	11:3
Luka 16:8	Galatasve 1:4	
Luka 18:30	Efe. 1:21; 2:1, 7; 6:12	
Luka 20:34-35	1 Timoteut 6:17	
	2 Timoteu 4:10	
	Titit 2:12	

Në teologjinë e Dhiatës së Re, këto dy epoka judaike janë mbivendosur për shkak të parashikimeve të papritura dhe të anashkaluara për dy ardhjet e Mesisë. Mishërimi i Jezusit përmbushi profecitë e DhV për inaugurimin e epokës së re (Dan. 2:44-45). Mirëpo DhV parapa edhe ardhjen e tij si Gjykatës dhe Fitimtar, por herën e parë ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53; Zak. 12:10), i përlurur dhe i butë (shih Zak. 9:9). Ai do të kthehet me fuqi, pikërisht siç e paratha dhe DhV (shih Zbulesa 19). Kjo përmbushje me dy faza bëri që Mbretëria të jetë e tashme (e inauguruar), por edhe e ardhshme (e papërmbushur plotësisht). Ky është tensioni i DhR: tashmë, por ende jo!

■ **“transformohuni”** Besimtarët duhet të transformohen (krh. 6:4; 7:6; II Kor. 5:17; Gal. 6:15; Efe. 4:22-24; Kol. 3:10), jo thjesht të informohen! Forma gramatikore e këtij termi mund të jetë E TASHME JOVEPRORE URDHËRORE, “vazhdoni të transformoni veten” ose E TASHME PËSORE URDHËRORE, “vazhdoni të transformoheni.” Kjo është gjithashtu e vërtetë për “konformoni” në v. 2a. Për një kontrast të ngjashëm krahasoni Ezek. 18:31 (përkushtimi dhe veprimi njerëzor) me Ezek 36:26-27 (dhurata hyjnore). Të dyja nevojiten!

Një formë e të njëjtës fjalë për “formuar” është përdorur për Jezusin në Transfigurim (krh. Mat. 17:2), ku u zbulua thelbi i Tij i vërtetë. Ky thelb i vërtetë hyjnor (krh. II Pjet. 1:3-4) duhet të formohet në çdo besimtar (krh. II Kor. 3:18; Efe. 4:13).

■ **“me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj”** Kjo është nga rrënja greke për “e re në cilësi” (*kainos*) jo “e re në kohë” (*chronos*). Për hebrejtë shqisat e shikimit dhe dëgjimit ishin dritaret e shpirtit. Njeriu bëhet si ajo për të cilën mendon. Pas shpëtimit, për shkak të Frymës brendabanues, besimtarët kanë një këndvështrim të ri (krh. Efe. 4:13,23; Titit 3:5). Kjo pikëpamje e re biblike, bashkë me Frymën brendabanues, është ajo që e transformon mendjen dhe mënyrën e jetesës së besimtarëve të rinj. Besimtarët e shikojnë realitetin në një mënyrë krejt tjetër, sepse mendjet e tyre janë fuqizuar nga Fryma. Një mendje e re, e shpenguar, e udhëhequr nga Fryma rezulton në një mënyrë të re jetese! Kjo është ajo që premtoi besëlidhja e re (krh. Jer. 31:31-34).

TEMË E VEÇANTË: PËRTËRIJ (ANAKAINŌSIS)

Ky term grek në format e tij të larmishme (*anakainōō*, *anakainizō*) ka dy kuptime bazë.

1. “të shkaktosh diçka që të bëhet e re dhe e ndryshme (d.m.th., më e mirë)” – Rom. 12:2; Kol. 3:10
2. “të shkaktosh një ndryshim ndaj një gjendjeje të preferueshme të mëparshme” – II Kor. 4:16; Heb. 6:4-6

(marrë nga *Greek-English Lexicon*, Louw dhe Nida vol. 1, fq. 157, 594)

Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek Testament*, thotë që ky term (d.m.th., *anakainōsis*) nuk mund të gjendet në literaturën greke përpara Palit. Pali mund ta ketë krijuar këtë term vetë (fq. 34).

Frank Stagg, *New Testament Theology*, ka një koment interesant.

“Rigjenerimi dhe ripërtëritja i përkasin vetëm Perëndisë. *Anakainōsis*, fjala për “ripërtëritje,” është një emër veprimi, dhe përdoret në Dhiatën e Re, bashkë me forma foljore, për të përshkruar një ripërtëritje të vazhdueshme, si te Romakëve 12:2, ‘transformohuni sipas ripërtëritjes së mendjes suaj’ dhe 2 Korintasve 4:16, ‘Njeriu ynë i brendshëm ripërtërihet nga dita në ditë.’ Kolosianëve 3:10 e përshkruan ‘njeriun e ri’ si ‘atij që përtërihet në njohurinë e plotë sipas imazhit të atij që e krijoi.’ Kështu ‘njeriu i ri,’ ‘risia e jetës,’ ‘rigjenerimi,’ apo ‘ripërtëritja,’ sido që të thuhet, e ka zanafillën te një akt fillestar dhe një akt i vazhdueshëm i Perëndisë si dhënësi dhe mbajtësi i jetës së përvetshme” (fq. 118).

■ **“në mënyrë që të provoni cili është vullneti i Perëndisë”** Kjo është E TASHME PASKAJORE. Fjala (*dokimazō*) është përdorur me kuptimin “të vësh në provë me prirjen për ta miratuar.” Shih Temën e Veçantë te 2:18.

Vullneti i Perëndisë është që të gjithë të shpëtohen përmes Krishtit (krh. Gjoni 6:39-40), dhe pastaj të jetojnë si Krishti (krh. Rom. 8:28-29; Gal. 4:19, Efe. 1:4; 4:13,15; 5:17-18). Siguria e krishterë (shih Temën e Veçantë në 5:2) bazohet në

1. premtimet e një Perëndie të denjë për t’u besuar
2. Frymën e Shenjtë brendabanues (krh. Rom. 8:14-16)
3. jetën e ndryshuar dhe në ndryshim të besimtarit (krh. Jakobi & I Gjoni) “s’ka fryt, d.m.th. s’ka rrënjë” (krh. Mat. 13:1-9, 19-23)

■ **“cili është vullneti i Perëndisë”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: VULLNETI (*thelēma*) I PERËNDISË

UNGJILLI I GJONIT

- Jezusi erdhi për të bërë vullnetin e Atit (4:34; 5:30; 6:38)
- për të ngritur ditën e fundit të gjithë ata që Ati i dha Birit (shih 6:39)
- që të gjithë të besojnë në Birin (shih 6:29, 40)
- përgjigje ndaj lutjeve që lidhen me kryerjen e vullnetit të Perëndisë (shih 9:31 dhe 1 Gjoni 5:14)

UNGIJTË SINOPTIKË

- kryerja e vullnetit të Perëndisë ka rëndësi jetike (shih Mat. 7:21)
- kryerja e vullnetit të Perëndisë e bën besimtarin vëlla ose motër me Jezusin (shih Mat. 12:50; Marku 3:35)
- nuk është vullneti i Perëndisë që njerëzit të humbasin (shih Mat. 18:14; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9)
- Kalvari ishte vullneti i Atit për Jezusin (shih Mat. 26:42; Luka 22:42)

LETRAT E PALIT

- pjekuria dhe shërbesa e gjithë besimtarëve (shih Rom. 12:1-2)
- besimtarët çlirohen nga kjo epokë e ligë (shih Gal. 1:4)
- vullneti i Perëndisë ishte plani i tij shpengues (shih Efe. 1:5, 9, 11)
- besimtarët përjetojnë dhe jetojnë jetën e mbushur me Frymën (shih Efe. 5:17-18)
- besimtarët mbushen me njohurinë e Perëndisë (shih Kol. 1:9)
- besimtarët përsosen dhe përmbushen (shih Kol. 4:12)
- besimtarët shenjtërohen (shih 1 Thes. 4:3)
- besimtarët japin falënderim për të gjitha gjërat (shih 1 Thes. 5:18)

LETRAT E PJETRIT

- besimtarët bëjnë gjënë e duhur (pra, u nënshtrohen autoriteteve qeverisëse) dhe, në këtë mënyrë, u mbyllin gojën njerëzve të marrë, duke siguruar një mundësi për ungjillizim (shih 1 Pjet. 2:15)
- besimtarët vuajnë (shih 1 Pjet. 3:17; 4:19)
- besimtarët nuk bëjnë jetë egoiste (shih 1 Pjet. 4:2)
-

LETRAT E GJONIT

- besimtarët mbeten përjetë (shih 1 Gjonit 2:17)
- besimtarët kanë rol kyç në përgjigjen e lutjeve (shih 1 Gjonit 5:14)

■ **“ai që është i mirë dhe i pranueshëm dhe i përsosur”** Këto përfaqësojnë vullnetin e Perëndisë për besimtarët pas shpëtimit (krh. Fil. 4:4-9). Synimi i Perëndisë për çdo besimtar është pjekuri në karakterin e Krishtit tani (krh. Mat. 5:48).

■ **“i përsosur”** Ky term do të thotë “i pjekur, plotësisht i pajisur për të përmbushur një detyrë të caktuar,” “i arrirë” ose “i plotë.” Nuk do të thotë “pa mëkat.” Përdorej për

1. krahë dhe këmbë që ishin thyer, por shëruar dhe rikthyer në funksionin normal
2. rrjeta peshkimi që ishin grisur, por ishin ndrequr dhe ishin të dobishme për të kapur peshk përsëri
3. zogj pule që ishin rritur mjaft për t’i nxjerrë në treg
4. anije të pajisura për lundrim

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:3-8

³Sepse përmes hirit që më është dhënë i them cilitdo midis jush të mos mendojë për veten më lart sesa duhet të mendojë; por të mendojë në mënyrë që të ketë gjykim të shëndoshë, ashtu siç Perëndia i ka caktuar secilit një masë besimi. ⁴Sepse ashtu siç kemi shumë gjymtyrë në një trup dhe të gjitha gjymtyrët nuk kanë të njëjtin funksion, ⁵ashtu edhe ne, që jemi shumë, jemi një trup në Krishtin, dhe individualisht gjymtyrë të njëri-tjetrit. ⁶Meqenëse kemi dhunti që ndryshojnë sipas hirit që na është dhënë, *secili prej*

nesh duhet t'i ushtrojë ato në përputhje me këtë: nëse profecinë, sipas përpjestimit të besimit të tij; ⁷nëse shërbimin, në shërbim; ose ai që mëson, në mësim; ⁸ose ai që nxit, në nxitje; ai që jep, me bujari; ai që udhëheq, me zell; ai që tregon mëshirë, me gëzim.

12:3 Vargjet 1-2 theksojnë nevojën për një “mendje të re.” Në v. 3 ka një lojë të katërfishtë mbi fjalën “mendoj.” Në *Zondervan Study Guide Commentary, Romans*, Bruce Corley dhe Curtis Vaughan bëjnë këtë vëzhgim:

“Të menduarit e ekzagjeruar. . . të menduarit e duhur. . . të menduarit e qëllimshëm. . . të menduarit e kthjellët” (fq. 138).

Ky karakterizim është ndihmues.

Ky varg, ashtu si 11:13-24, mund të reflektojë

1. tensionin në kishën e Romës midis besimtarëve hebrenj dhe johebrenj
2. faktin që Pali e shkroi Romakëve nga Korinti (në fundin e udhëtimit të tij të tretë misionar), ku ai ndeshi besimtarë arrogantë dhe shitmendës

▣ **“Sepse përmes hirit që më është dhënë”** Kjo është një Pjesore Aoriste Pësore. Hiri erdhi nga Perëndia në një ngjarje të plotë, të shkuar (d.m.th., takimi në rrugën për në Damask). Në këtë kontekst “hiri” lidhet me dhuntitë frymërore (krh. 15:15; I Kor. 3:10; 15:10; Gal. 2:9; Efe. 3:7-8), jo me dhuntinë e drejtësisë (krh. Romakëve 4). Kjo i referohet kthimit të Palit në besim dhe thirrjes për të qenë apostull i johebrenjve (krh. Veprat 9:15; Rom. 1:1,5; Gal. 1:15-16; 2:7-8; Efe. 3:1-2,8; I Tim. 2:7; II Tim. 4:17).

▣ **“i them cilitdo midis jush”** Paralajmërimi i v. 3 është për të gjithë të krishterët, jo vetëm për udhëheqësit.

▣ **“të mos mendojë për veten më lart”** Shih Temën e Veçantë: Përdorimi nga Pali i fjalëve të përbëra me *Huper* në 1:30.

▣ **“ashtu siç Perëndia i ka caktuar secilit”** Kjo është Aoriste Dëftore Veprore. Besimtarët nuk i zgjedhin dhuntitë e tyre frymërore (krh. I Kor. 7:17; 12:11; Efe. 4:7). Ato janë dhënë nga Fryma në momentin e shpëtimit për të mirën e përbashkët (krh. I Kor. 12:7). Dhuntitë e Frymës nuk janë medalje meritash që lartësojnë individin, por peshqirë shërbëtorësh, në mënyrë që çdo besimtar të mund t'i shërbejë trupit të Krishtit, kishës.

▣ **“një masë besimi”** Kjo i referohet aftësisë së dikujt për të funksionuar efektivisht në dhuntitë e veta frymërore (krh. v. 6). Për të qenë diçka e shëndetshme, dhuntitë frymërore duhen ushtruar me anë të frytit të Frymës (krh. vv. 9-12; Gal. 5:22-23). Dhuntitë janë shërbesat e Jezusit të ndara midis ndjekësve të Tij, ndërsa fryti është mendja e Krishtit. Të dyja janë të nevojshme për shërbesë efektive.

12:4 Kjo është një metaforë e zakonshme në shkrimet e Palit. Ndërvarësia e trupit përshkruan dhuntitë që i janë dhënë kishës (krh. I Kor. 12:12-27; Efe. 1:23; 4:4,12,16; 5:30; Kol. 1:18,24; 2:19). Krishtërimi është kolektiv dhe individual!

12:5 “ne, që jemi shumë, jemi një trup në Krishtin” Ky varg thekson unitetin dhe larmishmërinë e besimtarëve. Ky është tensioni i dhuntive frymërore brenda kishës. Kapitulli i dashurisë i I Korintasve 13 diskuton tensionin e larmishmërisë së dhuntive (krh. I Kor. 12 dhe 14). Të krishterët nuk janë në konkurim, por në bashkëpunim për Porosinë e Madhe!

12:6-8 Këto vargje formojnë një fjali në greqisht me dy Pjesore por pa një Folje kryesore. Ai zakonisht është përkthyer si një URDHËRORE E VETËS SË TRETË, “le t'i përdorim.”

12:6 “dhunti. . . hirit” Termat “dhunti” (*charismata*) dhe “hir” (*charis*) kanë të njëjtën rrënjë në greqisht, që do të thotë “dhënë falas.” Shih shënimin në 3:24. Dhuntitë e Frymës listohen në I Korintasve 12; Romakëve 12; Efesianëve 4 dhe I Pjetrit 4. Listat dhe renditja e tyre nuk janë identike, prandaj ato duhet të jenë përfaqësuese, jo shteruese. Bibla nuk i informon asnjëherë besimtarët se si t'i identifikojnë dhuntitë apo dhuntinë e tyre frymërore. Urtësia më e mirë e krishterë, jashtëbiblike mbi këtë çështje gjendet në parimet që janë në librin e botuar nga InterVarsity Press shkruar nga Paul Little me titull *Affirming the Will of God (Të kuptuarit e vullnetit të Perëndisë)*. Të njëjtat udhëzime për njohjen e vullnetit të Perëndisë shërbejnë edhe për të njohur fushën e

shërbimit tonë efektiv. Me sa duket njohuria që besimtarëve u janë dhënë dhunti është më e rëndësishme sesa identifikimi i vetë dhuntive specifike që u janë dhënë.

■ **“nëse”** Kjo është *eite* (krh. vv. 6,7 [dy herë], 8), që përkthehet “në qoftë se. . .në qoftë se” ose “nëse. . .nëse” në kuptim. Ajo nuk ndiqet nga ndonjë FOLJE në këtë varg (krh. I Kor. 3:22; 8:5; II Kor. 5:10), por shpesh ndiqet nga një DËFTORE E TASHME (krh. I Kor. 12:26; II Kor. 1:6) dhe është, për këtë arsye, një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË, që supozon ekzistencën e këtyre dhuntive frymërore.

■ **“profecinë”** Kjo nuk lidhet me profecinë e DHV si mesazhe zbuluese (të frymëzuara) nga Perëndia. Në DHV profetët shkruan Shkrimin (frymëzimi). Në DHR profecia është akti i shpalljes së të vërtetës së Perëndisë. Ajo mund të përfshijë edhe parashikim (krh. Veprat 11:27-28; 21:10-11). Fokusi nuk është në përmbajtje të re, por në shpjegimin e mesazhit të ungjillit dhe si zbatohet ai sot. Ka një elasticitet në këtë term. Ai mund t’i referohet një funksioni të ushtruar nga besimtarët, (krh. I Kor. 14:1,39) dhe një dhuntie specifike frymërore (krh. I Kor. 12:28; 14:29; Efe. 4:11). I njëjti elasticitet mund të shihet në letrat e Palit drejtuar Korintasve që u shkruan rreth të njëjtës kohë (krh. I Kor. 12:10,12; 13:8; 14:1, 5,29,39).

TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHIATËN E RE

- I. Nuk është e njëjta gjë si profecia e DhV (BDB 611), e cila ka ngjyrimin rabinik të zbulesave të frymëzuara nga JHVH (shih Veprat 3:18, 21; Rom. 16:26). Vetëm profetët mund të shkruanin Shkrimin.
 - A. Moisiu quhej profet (shih LiP. 18:15-21).
 - B. Librat historikë (Jozue-Mbretërve [përveç Ruthit]) quheshin “profetët e hershëm” (shih Veprat 3:24).
 - C. Profetët zënë vendin e Kryepiftit si burim informacioni nga Perëndia (shih Isaia-Malakia)
 - D. Ndarja e dytë e kanonit hebraik është “Profetët” (shih Mat. 5:17; 22:40; Luka 16:16; 24:25, 27; Rom. 3:21).

- II. Në DhR, ky koncept përdoret në një sërë mënyrash të ndryshme.
 - A. për t’iu referuar profetëve të DhV dhe mesazhit të tyre të frymëzuar (shih Mat. 2:23; 5:12; 11:13; 13:14; Rom. 1:2)
 - B. për t’iu referuar një mesazhi për një individ të caktuar, jo për një grup kolektiv (p.sh., profetët e DhV i flisnin kryesisht Izraelit)
 - C. për t’iu referuar, si Gjon Pagëzorit (shih Mat. 11:9; 14:5; 21:26; Luka 1:76), ashtu dhe Jezusit, si shpallës të Mbretërisë së Perëndisë (shih Mat. 13:57; 21:11, 46; Luka 4:24; 7:16; 13:33; 24:19). Po kështu, Jezusi pohoi se ishte më i lartë edhe se profetët (Mat. 11:9; 12:41; Luka 7:26).
 - D. profetë të tjerë në DhR
 1. Elizabeta (shih Luka 1:41-42)
 2. Zakaria (shih Luka 1:67-79)
 3. Simeoni (shih Luka 2:25-35)
 4. Ana (shih Luka 2:36)
 5. parashikime ironike (shih Kajafa, Gjoni 11:51)
 - E. për t’iu referuar dikujt që shpall ungjillin (lista e dhuntive shpallëse te 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
 - F. për t’iu referuar një dhuntie të vazhdueshme në kishë (shih Mat. 23:34; Veprat 13:1; 15:32; Rom. 12:6; 1 Kor. 12:10,28-29; 13:2; Efe. 4:11). Nganjëherë, mund t’u referohet grave (shih Luka 2:36; Veprat 2:17; 21:9; 1 Kor. 11:4-5).
 - G. për t’iu referuar librit apokaliptik të Zbulesës (shih Zbu. 1:3; 22:7, 10, 18, 19)

- III. Profetët e DhR
 - A. Ata nuk japin zbulësë të frymëzuar në të njëjtin kuptim si profetët e DhV (pra, Shkrimi). Ky pohim është i mundshëm për shkak të përdorimit të frazës “besim” (pra, kuptimi i një ungjilli

të plotësuar) në Veprat 6:7; 13:8; 14:22; Gal. 1:23; 3:23; 6:10; Fil. 1:27; Juda 3, 20).

Ky koncept është i qartë nga fraza e plotë e përdorur në Juda 3, “besimi që iu dorëzua një herë e përgjithmonë shenjtorëve”. Besimi “një herë e përgjithmonë” u referohet të vërtetave, doktrinave, koncepteve, mësimëve të botëkuptimit të krishterë. Ky theksim i dhënë një herë e përgjithmonë është baza biblike pse frymëzimin e kufizojmë teologjikisht vetëm për shkrimet e DhR, pa lejuar që shkrimet e mëvonshme ose të tjera të konsiderohen zbulesë. Ka shumë zona të paqarta, të pasigurta dhe gri në DhR, por besimtarët pohojnë me besim se gjithçka që “nevojitet” për besimin dhe praktikën është përfshirë me qartësi të mjaftueshme në DhR. Ky koncept është përvijuar në atë që quhet “trekëndëshi i zbulesës”

1. Perëndia e ka zbuluar veten në historinë kohë-hapësirë (ZBULESA)
 2. Ai ka zgjedhur disa shkrimtarë njerëzorë për të dokumentuar dhe shpjeguar veprat e tij (FRYMËZIMI)
 3. Ai ka dhënë Frymën e vet për të hapur mendjen dhe zemrën e njerëzve që të kuptojnë këto shkrime, jo në mënyrë absolute, por aq sa mjafton për shpëtim dhe për një jetë të krishterë të efektshme (PËRNDRITJE). Ideja e kësaj është se frymëzimi vlen vetëm për shkruesit e Shkrimit. Nuk ka shkrime, vegime apo zbulesa të mëtejshme të autoritetshme. Kanoni është mbyllur. Ne kemi gjithë të vërtetën që na nevojitet për t’iu përgjigjur si duhet Perëndisë. Kjo e vërtetë mund të shihet më së miri në përkimin e shkrimtarëve biblike, në dallim nga mosmarrëveshjet e besimtarëve të sinqertë e të perëndishëm. Asnjë shkrimtar ose folës i sotëm nuk ka nivelin e udhëheqjes hyjnore që kishin shkrimtarët e Shkrimit.
- B. Në disa mënyra, profetët e DhR janë të ngjashëm me profetët e DhV.
1. parashikimi i ngjarjeve të ardhshme (p.sh., Pali, Veprat 27:22; Agabi, Veprat 11:27-28; 21:10-11; profetë të tjerë pa emër, Veprat 20:23)
 2. shpallin gjykimin (shih Pali, Veprat 13:11; 28:25-28)
 3. akte simbolike që portretizojnë në mënyrë të gjallë një ngjarje të caktuar (shih Agabin, Veprat 21:11)
- C. Nganjëherë, i shpallin të vërtetat e ungjillit në mënyra parashikuese (shih Veprat 11:27-28; 20:23; 21:10-1), por ky nuk është fokusi parësor. Profetizimi te 1 Korintasve, në thelb, është komunikimi i ungjillit (shih 14:24, 39).
- D. Ata janë mjeti bashkëkohor i Frymës për zbulesën e zbatimeve bashkëkohore dhe praktike të së vërtetës së Perëndisë në çdo situatë të re, kulturë, apo periudhë kohore (shih 1 Kor. 14:3).
- E. Ata ishin aktivë në kishat e hershme paliane (shih 1 Kor. 11:4-5; 12:28,29; 13:2,8,9; 14:1,3,4,5,6,22,24,29,31,32,37,39; Efe. 2:20; 3:5; 4:11; 1 Thes. 5:20) dhe përmenden në *Didake* (shkruar në fund të shekullit të parë ose në shekullin e dytë, data është e paqartë) dhe në montanizmin e shekujve të dytë e të tretë në Afrikën perëndimore.

IV. A kanë reshtur dhuntitë e DhR?

- A. Është e vështirë t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Në qartësimin e kësaj çështjeje na ndihmon përcaktimi i synimit të dhuntive. A synohen dhuntitë që të mbështesin predikimin fillestar të ungjillit, apo përbëjnë mënyra të vazhdueshme sesi kisha ‘i shërben vetes dhe botës së humbur?
- B. A duhet të shqyrtojmë historinë e kishës për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, apo vetëm DhR? Në DhR nuk na tregohet se dhuntitë shpirtërore ishin të përkohshme. Ata që përpiqen të përdorin 1 Kor. 13:8-13 për të trajtuar këtë çështje abuzojnë me synimin autorial të pasazhit, i cili pohon se gjithçka, përveç dashurisë, do të kalojë.
- C. Tundohem të them se, meqë autoriteti ynë është DhR, jo historia e kishës, besimtarët duhet të pohojnë se dhuntitë vazhdojnë. Megjithatë, besoj se kultura ndikon në interpretim. Disa tekste shumë të qarta nuk janë më të zbatueshme (p.sh., puthja e shenjtë, veshja e mbulesës së kokës nga gratë, takimi i kishave nëpër shtëpi, etj). Nëse kultura ndikon në pasazhet, atëherë pse të mos bëjë të njëjtën gjë dhe historia e kishës?
- D. Kjo është thjesht një pyetje që nuk mund të marrë përgjigje përfundimtare. Disa besimtarë përkrahin “pushimin”, ndërsa disa të tjerë “mospushimin”. Në këtë fushë, si dhe në shumë çështje interpretuese, çelësi është zemra e besimtarit. DhR është e vagullt dhe kulturore.

Vështirësia është se duhet të jemi në gjendje të përcaktojmë se cilat pasazhe preken nga kultura/historia dhe cilat janë për gjithë kohën dhe për gjithë kulturat (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 14-19 dhe 69-77). Pikërisht këtu janë kyçe diskutimet për lirinë dhe përgjegjësinë, që gjenden në Rom. 14:1-15:13 dhe 1 Kor. 8-10. Mënyra sesi i përgjigjemi kësaj pyetjeje është e rëndësishme në dy mënyra.

1. Secili besimtar duhet të ecë me besim në dritën e asaj që ka. Perëndia na shqyrton zemrën dhe motivet.
 2. Secili besimtar duhet të lejojë besimtarët e tjerë që të ecin sipas kuptimit të besimit të tyre. Duhet të ekzistojë tolerancë brenda caqeve biblike. Perëndia dëshiron që ta duam njëri-tjetrin njësoj si ai.
- E. Për të përmbledhur çështjen, krishterimi është jetë besimi dhe dashurie, jo teologji e përsosur. Marrëdhënia me të, e cila ndikon në marrëdhënien tonë me të tjerët, është më e rëndësishme se informacioni absolut, apo përsosuria e kredove tona.

■ **“sipas përpjestimit të besimit të tij”** Kjo lidhet drejtpërdrejt me v. 3, “ashtu siç Perëndia i ka caktuar secilit një masë besimi” (krh. Efe. 4:7). Gjithashtu duhet të lidhet edhe me kontekstin më të gjerë që ka të bëjë me mënyrën se si besimtarët i përdorin dhuntitë e tyre. Kjo lidhet me qëndrimin, motivet dhe energjinë e besimtarëve ndërsa funksionojnë në shërbesat e tyre personale të caktuara nga Perëndia, që janë pak a shumë fryti i Frymës që jepet te Gal. 5:22-23.

12:7

NASB

“nëse shërbimin”

NKJV, NRSV

“ose shërbesën, le ta përdorim atë në shërbesën tonë”

TEV

“nëse është për të shërbyer, duhet të shërbejmë.”

NJB

“nëse administrim, atëherë përdoreni për administrim”

Përkthimet e sotme variojnë sepse nuk ka një barazvlerës të saktë të termit grek (*diakonia*). Ai mund të ketë kuptimin (1) shërbim praktik ose (2) administrim (krh. Veprat 6:1; I Kor. 12:5,28). *The Analytical Greek Lexicon Revised* nga Harold K Moulton, e përkufizon si “një funksion, shërbesë ose pozitë” në Rom. 12:7; I Kor. 12:5; Kol. 4:17; II Tim. 4:5” (fq. 92). Fokusi i kontekstit është të ndihmohen besimtarët e tjerë.

■ **“mëson. . mësim”** Kjo dhunti (*didaskō*) është listuar në I Kor. 12:28 dhe 14:26. Ajo lidhet me profetët në Veprat 13:1 dhe me barinjët në Efe. 4:11. Kisha e hershme i pa këta si njerëz me dhunti, funksionet e të cilëve mbivendoseshin në mënyra të ndryshme. Predikimi, profetizimi, ungjillizimi, dhe mësimi e shpallin ungjillin, por me thekse dhe metoda të ndryshme.

12:8 **“nxit. . nxitje”** Ky term (*parakaleō*) është i lidhur me mësimin (krh. I Timoteut 4:13). Ka mundësi që kjo është aftësia me anë të së cilës e vërteta aplikohet në jetë. Atëherë ajo duhet të ketë lidhje me Efe. 4:15,16 “duke thënë të vërtetën me dashuri. . trupi ndërton veten e vet në dashuri.”

■ **“ai që jep, me bujari”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: BUJARI/ SINGERTË (*HAPLOTES*)

Ky term (*haplotes*) kishte ky kuptime, “bujar” ose “i singertë.” Ai ishte një metaforë e lidhur me shikimin. Në DHV syri përdorej si metaforë për motivin në dy mënyra.

1. sy i keq (kurnnac, krh. LiP. 15:9 dhe Fja. 23:6; 28:22)
2. sy i mirë (bujar, krh. Fja. 22:9)

Jezusi ndoqi këtë përdorim (krh. Mat. 6:22-23; 20:15). Pali e përdor këtë term në dy kuptime.

1. “thjeshtësi, singëritet, pastërti” (krh. II Kor. 1:12; 11:3; Efe. 6:5; Kol. 3:22)
2. “bujari” (krh. Rom. 12:8; II Kor. 8:2; 9:11,13)

■ **“ai që udhëheq, me zell”** Kjo i referohet udhëheqësisë së krishterë, ose shëtitëse, ose lokale.

■ **“ai që tregon mëshirë, me gëzim”** Kjo i referohet ndihmës ndaj të sëmurëve dhe nevojtarëve. Nuk duhet të ketë dallim mes predikimit doktrinar dhe çështjeve sociale të komunitetit të besimtarëve. Ato janë dy anë të së njëjtës monedhë. Nuk ka “ungjill social,” ka vetëm ungjill!

PYETJE DISKUTIMI PËR VARGJET 1-8

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Çfarë përfshihet në paraqitjen e trupit tonë si flajm i gjallë (v. 1)?
2. A ka çdo besimtar dhunti frymërore (vv. 3-8; I Kor. 12:7)? Nëse po, a zgjedh besimtari vetë atë/ato që do?
3. Cili është qëllimi i dhuntive frymërore?
4. A ka një listë të plotë të dhuntive frymërore në Bibël?
5. Si e/i identifikon dikush dhuntinë/të e tij?

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 9-21

- A. Ky seksion mund të titullohej më mirë “Udhëzime të krishtera për marrëdhëniet me të tjerët.” Ky është një diskutim praktik i dashurisë (krh. Mat. 5-7; I Kor. 13 dhe I Gjoni 3:18; 4:7-21).
- B. Kapitulli 12 i Romakëve është shumë i ngjashëm nga përmbajtja dhe struktura me I Korintasve 12-13. Menjëherë pas diskutimit të dhuntive frymërore vjen një paralajmërim në lidhje me krenarinë dhe një theks mbi dashurinë praktike si një mënyrë jetese.
- C. Konteksti ka të bëjë me
 1. marrëdhëniet tona me të krishterë të tjerë (krh. 12:9-13). Kjo gjithashtu diskutohet me detaje në 14:1-15:13 dhe në I Kor. 8:11 e më tej; 10:23-33
 2. marrëdhëniet tona me jobesimtarët, ose ka më shumë të ngjarë, me të krishterë të tjerë me të cilët ka konflikt (krh.12:14-21). Ky seksion duket se reflekton Predikimin në Mal të Jezusit (krh. Mat. 5-7).
 3. kjo ndarje e pasazhit është disi artificiale, sepse këto fusha (marrëdhëniet) mbivendosen
- D. Ky pasazh dominohet nga urdhërime të vazhdueshme, që kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës (URDHËRORE TË TASHME VEPRORE, krh. v. 4 [tri herë], 16, 20 [dy herë], 21 [dy herë] dhe nga PJESORE TË TASHME VEPRORE të përdorura në kuptimin e URDHËROREVE shtatëmbëdhjetë herë). Shpëtimi është një dhuratë falas e hirit të Perëndisë përmes veprës së përfunduar të Krishtit dhe tërheqjes së Frymës, por pasi merret, ai është një përkushtim dhe mënyrë jetese që të kushton gjithçka! Të quajturit e Jezusit “Zot” nuk është metaforë (krh. Luke 6:46)!
- E. Edhe ky pasazh ka disa PJESORE TË TASHME të përdorura në kuptimin e URDHËROREVE me PJESËZËN MOHORE që zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është tashmë në proces, vv. 14, 16 (dy herë), 17, 19 dhe 21. Të krishterët po jetonin përtej asaj që ishte e lejuar! Në një kuptim mëkati mund të përkufizohet si përdorimi i dhuratave të dhëna nga Perëndia përtej kufijve të vendosur prej Tij.
- F. Krishtërimi duhet të jetë “i hapur”— mendje-hapur, dorë-hapur, zemër-hapur dhe derë-hapur (krh. Jakobi 2).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:9-13

⁹Dashuria të jetë pa hipokrizi. Urreni atë që është e keqe; ngjituni pas asaj që është e mirë. ¹⁰Jini të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit në dashuri vëllazërore; i jepni preferencë njëri-tjetrit në nderim; ¹¹duke mos mbetur prapa në zell, të flaktë në frymë, duke i shërbyer Zotit; ¹²duke u gëzuar në shpresë, duke këmbëngulur në mundim, të dhënë pas lutjes, ¹³duke kontribuar për nevojat e shenjtoreve, duke praktikuar mikpritjen.

12:9 “Dashuria të jetë pa hipokrizi” Në tekstin grek nuk ka fjalë lidhëse (*asyndeton*) në këtë kontekst gjë që ishte shumë e zakonshme në Greqishte Koine. Kjo mund të reflektojë formën gramatikore prapa Lumturive të Mateut 5. Kjo formë gramatikore do të theksonte secilën nga frazat si një të vërtetë që qëndron më vete.

“Hipokrizia” ishte një term teatror për “të folurit prapa një maske.” Dashuria nuk duhet të jetë aktrim ose e shtirur (krh. II Kor. 6:6). Dashuria është karakteristika e besimtarëve (krh. Gjoni 13:34-35; 15:12,17; I Gjoni 3:11,18; 4:7-21) sepse është karakteri i Perëndisë.

▣ **“Urreni atë që është e keqe”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e URDHËRORES. Besimtarët duhet të surprizohen dhe të revoltohen nga e keqja (krh. I Thes. 5:21-22). Shpesh ne surprizohemi vetëm nga pasojat që e ndikojnë jetën tonë drejtpërdrejt.



NASB, NKJV “ngjituni pas asaj që është e mirë”
NRSV “mbahuni fort pas asaj që është e mirë”
TEV “mbahuni pas asaj që është e mirë”
NJB “ngjituni pas asaj që është e mirë”

Kjo është PJESORE E TASHME PËSORE (por e përdorur në një kuptim si JOVEPRORE) e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE—“të jesh i ngjitur pas” (krh. LXX e Zan. 2:24; Veprat 8:29 dhe gjithashtu Fil. 4:8; I Thes. 5:21-22). Vini re nevojën e zellit dhe këmbënguljes!

12:10

NASB “Jini të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit në dashuri vëllazërore”
NKJV “Jini të dashur me njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore”
NRSV “Duajeni njëri-tjetrin me dashuri të ndërsjellë”
TEV “Duajeni njëri-tjetrin ngrohtësisht si të krishterë”
NJB “Duajeni njëri-tjetrin ashtu si do ta donin vëllezërit”

Ky është një term grek i përbërë (*phileo + storge*) që bashkon “dashurinë vëllazërore” me “dashurinë familjare” dhe është përdorur vetëm këtu në DHR. Të krishterët janë një familje. Ne urdhërohemi ta duam njëri-tjetrin (krh. I Thes. 4:9). Kjo është e para në një seri DHANORESH që janë vendosur të parat në fjalinë në greqisht për theksim.



NASB “i jepni preferencë njëri-tjetrit në nderim”
NKJV “në nderim duke i dhënë preferencë njëri-tjetrit”
NRSV “kalojani njëri-tjetrit në të treguarit e nderimit”
TEV “dhe jini të paduruar për të treguar respekt për njëri-tjetrin”
NJB “kini një respekt të thellë për njëri-tjetrin”

Kjo është një PJESORE E TASHME JOVEPRORE (deponente) e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Besimtarët duhet t’i trajtojnë pjesëmarrësit e tjerë të besëlidhjes si më të rëndësishëm se vetja (krh. Efe. 4:2; Fil. 2:3).

12:11

NASB “duke mos mbetur prapa në zell”
NKJV “duke mos mbetur prapa në zell”
NRSV “mos mbetni prapa në zell”
TEV “punoni fort dhe mos jini dembelë”

NJB “punoni për Zotin me përpjekje të palodhura”

Dashuria e vërtetë prodhon shumë energji (krh. Gal. 6:9).



NASB, NKJV “të flaktë në frymë”
NRSV “të zjarrtë në frymë”
TEV “me një zemër plot përkushtim”
NJB “me sinqeritet të madh të frymës”

Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Është fjalë për fjalë “të ziesh.” Kjo mund t’i referohet frymës së rilindur njerëzore, ose Frymës së Shenjtë brendabanues (RSV, krh. Veprat 18:25; Zbu. 3:15-16).

☐ **“duke i shërbyer Zotit”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Këtu ka një variant në dorëshkrime. Disa nga familja perëndimore e dorëshkrimeve në greqisht (MSS D*,3, F, dhe G) lexojnë “në kohë” (*kairos*) në vend të “në Zotin” (*kurios*). Ky variant thekson t’i shërbesht Zotit dhe kishës së Tij siç të vijë rasti (krh. Gjoni 9:4; Efe. 5:16).

Ka shumë mundësi që ngatërimi ndodhi ngaqë *kurios* u keqkuptua ose u lexua gabim. Dorëshkrimet më të mira dhe më të vjetra greke P⁴⁶, א, A, dhe B e kanë “duke i shërbyer Zotit.” UBS⁴ e vlerëson “Zot” si “të sigurt” (A).

12:12 “duke u gëzuar në shpresë” Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE (krh. 5:2).

Termi “shpresë” është përdorur shpesh në lidhje me Ardhjen e Dytë (krh. 5:2; 8:24; 15:13; I Thes. 5:8). Nuk është shpresë në kuptimin që e përdorim sot si një dëshirë, por në kuptimin e DHR të një ngjarjeje të sigurt, por me një element kohor të dykuptimtë. Shih shënimet e plota te 4:18 dhe 5:2.

☐ **“duke këmbëngulur”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Termi do të thotë “qëndrueshmëri aktive, vullnetare, e palëkundur.”

☐ **“në mundim”** Ashtu si në 5:3,5 “shpresë” është e lidhur me mundimin (*thlipsis*). Kjo është norma për ndjekësit e Krishtit në një botë të rënë (krh. Mat. 5:10-12; Gjoni 16:1-3; 17:14; Veprat 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; II Kor. 4:16-18; 6:3-10; 11:23-30; Fil. 1:29; I Thes. 3:3; II Tim. 3:12; Jakobi 1:2-4; I Pjet. 4:12-16). Ne as duhet ta kërkojmë, as duhet ta shmangim atë! Shih Temën e Veçantë: Mundimet në 5:3.

☐ **“të dhënë pas lutjes”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Lutja është një disiplinë frymërore dhe një dhuratë që e dallon dorën vepruese të Perëndisë në histori. Besimtarët mund ta ndikojnë një Atë Qiellor të dashur. Perëndia ka zgjedhur ta kufizojë Vetën nga lutjet e fëmijëve të Tij (krh. Veprat 1:14; 2:42; 6:4; Efe. 6:18-19; Kol. 4:2). Kjo e bën lutjen një përgjegjësi shumë të madhe. Shih *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare (Tri pyetje themelore në lidhje me luftën shpirtërore)* nga Clinton Arnold, fq. 43-44, 187-188.

12:13

NASB, NRSV “duke kontribuar për nevojat e shenjtorëve”
NKJV “duke shpërndarë për nevojat e shenjtorëve”
TEV “ndajini gjërat tuaja me vëllezërit tuaj të krishterë që janë në nevojë”
NJB “ndani gjëra me këdo nga populli i shenjtë i Perëndisë që është në nevojë”

FOLJA greke *koinōneō* ka kuptimin “të kesh bashkësi me.” Ky term ka një gamë të gjerë kuptimore për Palin. Ai përfshin edhe bashkësinë në ungjill, edhe nevojat fizike (krh. Gal. 6:6). Ai është përdorur madje edhe për pjesëmarrjen në vuajtjet e Krishtit (krh. Fil. 3:8-10; I Pjet. 4:13) dhe të Palit (krh. Fil. 4:14). Të jesh i bashkuar me Krishtin do të thotë të jesh i bashkuar me popullin e Tij në çdo nivel! Shih Temën e Veçantë: Shenjtorët në 1:7.

Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE (krh. Fja. 3:27; Gal. 6:10). Besimtarët duhet të punojnë fort në mënyrë që të kenë më shumë për të tjerët, në emrin e Jezusit (krh. II Kor. 8:11-12; Efe. 4:28).

TEMË E VEÇANTË: KOINŌNIA

Termi “bashkësi” (*koinōnia*) do të thotë

1. shoqërim i ngushtë me një person
 - a. me Birin (shih 1 Gjonit 1:6; 1 Kor. 1:9)
 - b. me Frymën (shih 2 Kor. 13:14; Fil. 2:1)
 - c. me Atin dhe me Birin (shih 1 Gjonit 1:3)
 - d. me vëllezërit/motrat e tjerë të besëlidhjes (shih 1 Gjonit 1:7; Veprat 2:42; Gal. 2:9; Filemoni 17)
2. shoqërim i ngushtë me gjëra ose grupe
 - a. me ungjillin (shih Fil. 1:5; Filemoni 6)
 - b. me gjakun e Krishtit (shih 1 Kor. 10:16)
 - c. jo me errësirën (shih 2 Kor. 6:14)
 - d. me vuajtjet (shih Fil. 3:10; 4:14; 1 Pje. 4:13)
3. dhuratë ose kontribut, që jepet në mënyrë bujare (shih Rom. 12:13; 15:26; 2 Kor. 8:4; 9:13; Fil. 4:15; Heb. 13:16)
4. dhurata e hirit të Perëndisë përmes Krishtit, e cila rimëkëmb bashkësinë e njerëzimit me të dhe me vëllezërit e motrat e tij

Kjo thekson marrëdhënien horizontale (njeri me njeri) që shkaktohet nga marrëdhënia vertikale (njeriu me Krijuesin). Ajo thekson dhe nevojën për komunitetin e krishterë, si dhe gëzimin e këtij komuniteti. Koha e foljes thekson fillimin dhe vazhdimësinë e kësaj përvoje të komunitetit (shih 1:3 [dy herë], 6, 7). Krishterimi është kolektiv!

▣ **“duke praktikuar mikpritjen”** Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Fjalë për fjalë do të thotë “duke ndjekur mikpritjen” (shih shënimin në 14:19, krh. I Tim. 3:2; Titit 1:8; Heb. 13:2; I Pjet. 4:9). Kjo shërbesë ishte shumë e rëndësishme në kishën e hershme, për shkak të reputacionit të keq të “haneve.” Kjo kryesisht i referohej strehimit dhe ushqyerjes së shërbyesve të krishterë shëtitës.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 12:14-21

¹⁴Bekoni ata që ju përndjekin; bekoni dhe mos mallkoni. ¹⁵Gëzohuni me ata që gëzohen dhe qani me ata që qajnë. ¹⁶Jini të një mendjeje me njëri-tjetrin; mos jini fodullë në mendje, por shoqërohuni me të ulët. Mos e mbani veten për të urtë. ¹⁷Kurrë mos ia ktheni ndokujt të keqen me të keqe. Respektoni atë që është e drejtë në sytë e të gjithë njerëzve. ¹⁸Nëse është e mundur, për aq sa varet prej jush, jini të paqe me të gjithë njerëzit. ¹⁹Kurrë mos u hakmerrni për veten, të dashur, por lini vend për zemërimin e Perëndisë, sepse është shkruar, “HAKMARRJA MË TAKON MUA, UNË DO TË SHPAGUAJ,” thotë Zoti. ²⁰“por NËSE ARMIKU YT KA URI, USHQEJE, DHE NËSE KA ETJE JEPI TË PIJË; SEPSE DUKE BËRË KËTË TI DO TË GRUMBULLOSH THËNGJIJ TË NDEZUR MBI KOKËN E TIJ.” ²¹Mos u mundni nga e keqja, por mundeni të keqen me të mirën.

12:14 “Bekoni ata që ju përndjekin” Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE e përdorur dy herë në këtë varg. Ne marrim termin “eulogji” nga ky term “bekoj” (krh. Mat. 5:44; Luka 6:28; I Kor. 4:12; Jakobi 3:9-12; I Pjet. 3:9). Në P⁴⁶ (Papuruset Chester Beatty) dhe dorëshkrimin B (Vaticanus), “ju” është lënë jashtë duke e bërë deklaratën shumë më përfshirëse, ose e thënë ndryshe, një deklaratë shumë më të përgjithshme. Për “përndjek” shih shënimin te 14:9.

▣ **“mos mallkoni”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE (deponente) me PJESËZËN MOHORE, që zakonisht ka kuptimin të ndërpresësh një veprim tashmë në proces. Kjo i referohet thirrjes së emrit të Perëndisë në

lutje për hakmarrje (e ngjashme me mallkimet e I Kor. 12:3). Nuk i referohet fjalëve të pista (krh. Efe. 4:29; I Pjet. 3:9).

12:15 “Gëzohuni me ata që gëzohen dhe qani me ata që qajnë” Këto dy PASKAJORE TË TASHME janë përdorur në kuptimin e URDHËROREVE. Të krishterët janë një familje. Besimtarët nuk janë në konkurim, por duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin me dashuri si pjesëtarë të një familjeje. Për shkak të kontekstit të vv. 14-21 është madje e mundur që kjo të reflektojë reagimin e besimtarit ndaj komunitetit jobesimtar duke përdorur mundësi ose rrethana kulturore për ungjillizim.

12:16

NASB, NKJV “Jini të një mendjeje me njëri-tjetrin”

NRSV “Jetoni në harmoni me njëri-tjetrin”

TEV “Interesohuni njëllonj për çdo njeri”

NJB “Trajtoni çdo njeri me mirësi të njëllonjtë”

Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE (krh. 15:5; II Kor. 13:11; Fil. 2:2). Vargu 16 mund të shikohet në lidhje me

1. konfliktin midis besimtarëve hebrej dhe atyre johebrej në kishën e Romës (krh. 11:13-24)
2. konfliktin e vjetër midis klasave shoqërore
3. dhuntitë e ndryshme frymërore
4. traditat breznore dhe preferencat personale

▣ **“mos jini fodullë në mendje, por shoqërohuni me të ulët”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE, që zakonisht ka kuptimin të ndërpresësh një veprim tashmë në proces.

Termi “të ulët” mund të jetë MASHKULLORE ose ASNJANËSE. Nëse është ASNJANËSE, atëherë përkthimi duhet të jetë “pranoni detyra të përlulura”; nëse është MASHKULLORE, “shoqërohuni me njerëz të varfër ose të përlulur.”

▣ **“Mos e mbani veten për të urtë”** Kjo është një URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE (deponente) me PJESËZËN MOHORE, që zakonisht ka kuptimin të ndërpresësh një veprim tashmë në proces (krh. Pro. 3:7; Isa. 5:21; I Kor. 10:12; Gal. 6:3). Besimtarët nuk duhet të sillen si superiorë ndaj njëri-tjetrit, ose me arrogancë ndaj komunitetit jobesimtar.

12:17 “Kurrë mos ia ktheni ndokujt të keqen me të keqe” Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE me PJESËZËN MOHORE, që zakonisht ka kuptimin të ndërpresësh një veprim tashmë në proces. Është kompetencë e Perëndisë t’i ndreqë gjërat, jo e besimtarëve (krh. Fja. 20:22; 24:29; Mat. 5:38-48; Luka 6:27; I Thes. 5:15; I Pjet. 3:9).

▣ **“Respektoni atë që është e drejtë në sytë e të gjithë njerëzve”** Kjo është një PJESORE E TASHME JOVEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE (krh. II Kor. 8:21; I Thes. 5:22; dhe I Tim. 3:7). Kjo mund të jetë një aluzion ndaj Fja. 3:4 në Septuagintë (LXX). Besimtarët jetojnë me një sy nga ungjillizimi i besimtarëve. Ne nuk duhet të bëjmë asgjë që do të ofendonte apo largonte një jobesimtar (krh. I Kor. 9:19-23). Edhe bindjet tona më të thella duhen shprehur me dashuri.

12:18 “Nëse është e mundur, për aq sa varet prej jush, jini të paqe me të gjithë njerëzit” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Ajo ndiqet në pjesën e varur nga një PJESORE E TASHME VEPRORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. Kjo nuk është gjithmonë në dorën e besimtarit, por gramatika nënkupton që shpesh është e mundur (krh. Marku 9:50; II Kor. 13:11; I Thes. 5:13).

12:19 “Kurrë mos u hakmerrni për veten” Kjo është një PJESORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE, që zakonisht ka kuptimin të ndërpresësh një veprim tashmë në proces. Perëndia do t’i rregullojë punët një ditë (krh. Lev. 19:18; LiP. 32:35; Heb. 10:30).

▣ **“sepse është shkruar”** Kjo është një DËFTORE E KRYER PËSORE, që është një mënyrë idiomatike semitike e referimit ndaj Shkrimeve të frymëzuara. Kjo idiomë frymëzimi është paralele me “siç thotë Zoti” (krh. I Kor. 14:21 dhe II Kor. 6:17). Ky është një citim nga LiP. 32:35.

12:20 “por nëse armiku yt” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË që nënkupton veprim të mundshëm të ardhshëm. Armiqtë do të vijnë!

▣ **“grumbullosh thëngjij të ndezur mbi kokën e tij”** Ky është një aluzion ndaj Fja. 25:21-22. Teoritë e interpretimit janë:

1. Kjo ishte një idiomë kulturore ndoshta nga Egjipti, që kishte kuptimin që mirësia është mënyra më e mirë për ta kthyer një armik në mik. Ajo është ende përgjigjia e krishterë ndaj së keqes së ngulitur (krh. Mat. 5:44).
 2. “Thëngjij të ndezur” duket se përfaqëson turp për veprimet jo të mira të dikujt që zbulohen shumë qartë nën dritën e dashurisë dhe faljes së dikujt tjetër (krh. Ambrosiasterin, Augustinin dhe Jero[ni]min).
 3. Origeni dhe Krisostomi thanë që kjo i referohet mirësisë së krishterë që bën që Perëndia ta gjykojë edhe më ashpër të papënduarin (krh. the *Jerome Biblical Commentary*, vol. 2, fq. 326).
- Të gjitha teoritë e mësipërme janë thjesht teori. Kyçi është në deklaratën përmbljedhëse të Palit në v. 21.

12:21 “Mos u mundni nga e keqja, por mundeni të keqen me të mirën” Kjo është një URDHËRORE E TASHME PËSORE dhe URDHËRORE E TASHME VEPRORE. Reagimi ynë ndaj trajtimit të padrejtë do të përcaktojë dhe reflektojë nivelin e paqes dhe gëzimit tonë të brendshëm. Hidhësia është një kancer shpirtëror. Besimtarët duhet t’ia dorëzojnë atë Perëndisë.

▣ **“e keqja”** Kjo është ose MASHKULLORE dhe, si e tillë, një referencë ndaj të ligut (shih Temën e Veçantë në 16:20), ose mund të jetë ASNJANËSE dhe t’i referohet së keqes në përgjithësi (krh. 12:9; I Thes. 5:21-22). Kjo është një dykuptimësi e zakonshme e DHR (krh. Mat. 5:37; 6:13; 13:19,28; Gjoni 17:15; II Thes. 3:3; I Gjoni 2:13-14; 3:12; 5:18-19).

Duhet mbajtur mend që qëllimi i këtyre qëndrimeve dhe veprimeve të reja është ungjillizimi!

PYETJE DISKUTIMI PËR VARGJET 9-21

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Pse ka kaq shumë URDHËRORE TË TASHME me PJESËZËN MOHORE në vv. 9-21?
2. Listoni të gjithë urdhërimet në këto vargje veçmas në një kolonë. Ato janë një listë e shkëlqyer për atë se çfarë përfshin ngjashmëria praktike e përditshme me Krishtin!
3. Pse është kaq e vështirë të përcaktojmë se cilat vargje u referohen sjelljes së besimtarëve me besimtarët e tjerë dhe cilat sjelljes së besimtarëve me jobesimtarët?

ROMAKËVE 13

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Bindje ndaj rregullave	Nënshtroruni qeverisë	I krishteri dhe shteti	Detyrat ndaj shtetit dhe autoriteteve	Nënshtrim ndaj autoriteteve civile
13:1-7	13:1-7	13:1-7	13:1-5 13:6-7	13:1-7
Dashuria vëllazërore	Duaje fqinjin tënd	Dashuria e përmbush Ligjin	Detyra ndaj njëri-tjetrit	Dashuri dhe luftë
13:8-10	13:8-10	13:8-10	13:8-10	13:8-10
Afrimi i ditës së Krishtit	Vishni Krishtin	Afërsia e Ardhjes së Dytë të Krishtit		Fëmijë të dritës
13:11-14	13:11-14	13:11-14	13:11-13 13:14	13:11-14

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

A.Paragrafi i parë

B.Paragrafi i dytë

C.Paragrafi i tretë

D.Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 1-7

- A. Ashtu si kapitulli 12 trajtonte çështje që kishin të bënin kryesisht me të krishterin dhe bashkëbesimtarët e tij (vv. 9-13) dhe të tjerët në shoqëri (vv. 14-21), kapitulli 13:1-7 trajton kryesisht çështje të të krishterit dhe qeverisë civile. Megjithatë, nuk ka ndarje kontekstuale midis këtyre subjekteve. Pali i pa ato si një. Nuk ka ndarje midis të shenjtës dhe laikes. E gjithë jeta i përket Perëndisë. Besimtarët janë administratorë në çdo fushë! Lidhja midis këtyre dy kapitujve mund të shihet në 12:18.
- B. Të kuptuarit e besimtarëve për vendin e qeverisë civile ka qenë i ndryshëm. Në DHV qeveria zhvillohet brenda linjës së Kainit (krh. Zan. 4:16-22). Kulla e Babelit (krh. Zan. 11) është e lidhur me përpjekjet e njerëzimit për të sunduar pa Perëndinë. Mbretëria brenda Izraelit duhej të ishte mbretërimi i Perëndisë përmes ligjit hyjnor dhe përmes një nën-bariu të caktuar (Mbretit), por nuk ishte e suksesshme për shkak të mëkatit të njerëzimit. Fjalët që tha Jezusi për vendin e duhur të qeverisë te Mat. 22:21 dhe

Marku 12:17 janë kyçe. Është për t'u habitur që Pali nuk i përmend fjalët e Jezusit në këtë kontekst (megjithëse vv. 1-7 dhe 11 duken paralele me Mat. 22:15-22 dhe 39). Në këtë botë të rënë ka një vend të duhur të caktuar nga Perëndia për qeverinë. Shpesh Apostujt gjendeshin para një dileme se si të sillleshin me autoritetet, si civile ashtu edhe fetare. Ajo ishte një detyrë herë pozitive, herë negative, në varësi të veprimeve të autoriteteve njerëzore. Pali edhe u mbrojt, edhe u përdoq nga qeveria. Megjithatë, Gjoni, te Zbulesa, flet për qeverinë si Kurva e Madhe (krh. Zbu.17)!

Ne duhet ta mbështesim qeverinë për sa kohë ajo nuk shkel ndërgjegjen tonë të udhëhequr nga Fryma, dhe nuk kërkon besnikëri absolute. Rendi civil është i preferueshëm mbi kaosin (krh. II Thes. 2:6-7).

C. E njëjta temë trajtohet te Titi 3:1 dhe I Pjetrit 2:13-17.

D. Judaizmi ishte fe e ligjshme nën qeverinë romake të shekullit të parë. Krishtërimi konsiderohej një sekt brenda tij për shumë vite (krh. Veprat 18:12-16). Kjo gjë i siguroi mbrojtje ligjore lëvizjes misionare në vitet e para. Një qëllim i librit të Veprave ishte të demonstronte që krishtërimi nuk përbënte kërcënim politik për Romën. Roma siguroi një paqe të brendshme dhe stabilitet (*pax Romana*) në të cilën u përhap ungjilli (krh. I Tim. 2:1-2).

E. Ky pasazh intensifikohet nën dritën e përvojave personale të Palit me autoritetet. Është gjithashtu e mundur që ky seksion u përfshi për shkak të

1. tensioneve brenda kishës së Romës në lidhje me dekretet qeveritare (p.sh., që kufizonin ritualet hebreje). Kjo gjë mund të ketë bërë që disa hebrenj besimtarë të largoheshin nga kryeqyteti (p.sh., Akuila dhe Priskila, krh. Veprat 18:2). Në mungesën e tyre u zhvillua udhëheqësia johebreje.
2. tensioneve në Romë të shkaktuara nga predikimi i ungjillit në komunitetin e madh hebre në Romë. Historiani Suetonius, *Jeta e Klaudit* 25.2, shënon që Perandori i dëboi hebrenjtë nga kryeqyteti në vitin 49 pas Krishtit për shkak të trazirave të vazhdueshme të shkaktuara nga në "Chrestus." Ky mund të jetë një variant latin i fjalës Krisht (Christos).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:1-7

¹Çdo person duhet t'iu nënshtrohet autoriteteve qeverisëse. Sepse nuk ka autoritet përveçse nga Perëndia, dhe ata që ekzistojnë janë vendosur nga Perëndia. ²Prandaj, kushdo që i kundërvihet autoritetit i është kundërvënë urdhrin të Perëndisë; dhe ata që i janë kundërvënë do të marrin mbi vete dënim. ³Sepse sundimtarët nuk janë shkak për frikë për sjelljen e mirë, por për të keqen. Do që të mos e kesh frikë autoritetin? Bëj atë që është e mirë dhe do të kesh lëvdim nga ai; ⁴sepse ai është shërbëtor i Perëndisë për ty për të mirë. Por nëse ti bën atë që është e keqe, ki frikë; sepse ai nuk e mban kot shpatën; sepse ai është shërbëtor i Perëndisë, hakmarrës që sjell zemërim mbi atë që praktikon të keqen. ⁵Prandaj është e nevojshme t'i nënshtrohesh, jo vetëm për shkak të zemërimit, por edhe për hir të ndërgjegjes. ⁶Sepse për këtë ju edhe paguani taksat, sepse *sundimtarët* janë shërbëtorë të Perëndisë, që ia përkushtojnë veten kësaj gjëje. ⁷U jepni të gjithëve atë që u takon: taksën atij që i takon taksat; doganën atij që i takon dogana; frikë atij që i takon frika; nderim atij që i takon nderimi.

13:1 "Çdo person duhet t'iu nënshtrohet" Kjo është (1) E TASHME PËSORE URDHËRORE që ka kuptimin, "vazhdon të nënshtrohesh" ose (2) E TASHME JOVEPRORE URDHËRORE, "nënshtrohet veten" (krh. Titit 3:1; I Pjet. 2:13). "Nënshtrohet" ishte një term ushtarak që përdorej për të përshkruar një zinxhir komandimi. Pali po u drejtohet të gjithë besimtarëve. Pali thotë që besimtarët duhet t'i nënshtrohen njëri-tjetrit (krh. Efe. 5:21).

Në kohën tonë nënshtrimi duket si një term negativ. Ajo është një fjalë që përshkruan edhe përulësi, edhe një kuptim të thellë të botës së Perëndisë dhe të vendit tonë në të. Jezusi iu nënshtroi (1) prindërve të Tij tokësorë (krh. Luka 2:51) dhe (2) Atit të Tij qiellor (krh. I Kor. 15:28). Ai është udhërrëfytyesi ynë në këtë fushë!

Shih Temën e Veçantë: Nënshtrimi në 10:3.

■ **“autoriteteve qeverisëse”** Megjithëse Pali e përdori këtë fjalë (*exousia*) në kontekste të tjera për t’iu referuar fuqive engjëjlore, kryesisht demonike (krh. 8:38; Kol. 1:16; 2:10,15; Efe. 1:21; 3:10; 6:12), këtu konteksti kërkon “autoritetet civile” (krh. I Kor. 2:6,8; Titit 3:1; I Pjet. 2:13). Bibla duket se nënkupton që ka autoritete engjëjlore prapa qeverive njerëzore (Danieli 10 dhe the LXX e LiP. 32:8, “Kur Shumë i Larti ndau kombet, kur Ai ndau bijtë e Adamit, Ai i caktoi kufijtë e kombeve sipas numrit të engjëjve të Perëndisë.” Shih Oscar Cullman, *Christ and Time* dhe Hendrikus Berkhof, *Christ and the Powers*). Por ende autoritetet qeverisëse funksionojnë nën Perëndinë (krh. vv. 1b,4a, dhe 6). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: AUTORITETI (*EXOUSIA*)

Është interesante të vëzhgosh përdorimin nga Luka të *exousia* (autoritet, fuqi/pushtet, ose e drejtë ligjore).

1. Në 4:6 Satani thotë se mund t’i japë Jezusit autoritet/pushtet.
2. Në 4:32,36 hebrejtë u habitën se si Jezusi mësonte duke përdorur autoritetin e Tij personal.
3. Në 9:1 Ai u dha pushtetin dhe autoritetin e Tij Apostujve të Tij.
4. Në 10:19 Ai u dha autoritetin e Tij shtatëdhjetë misionarëve.
5. Në 20:2,8 bëhet pyetja qendrore e autoritetit të Jezusit.
6. Në 22:53 të keqes i është lejuar autoriteti për ta dënuar dhe vrarë Jezusin.

Megjithëse jo te Luka, hyrja e Mateut e Porosisë së Madhe, “Mua më është dhënë i gjithë autoriteti në qiell dhe në tokë,” është një deklaratë e mrekulleshme (Mat. 28:18).

Përgjigjia e Jezusit ndaj pyetjes së tyre do të kishte qenë

1. fjalët që foli Perëndia në
 - a. pagëzimin e Tij (Luka 3:21-22)
 - b. transfigurimin e Tij (Luka 9:35)
2. profecia e përmbushur e DHV
 - a. fisi i Judës (krh. Zan. 49:10)
 - b. familja e Jeseut (krh. II Samuel7)
 - c. lindur në Betlehem (krh. Mikea 5:2)
 - d. lindur gjatë perandorisë së katërt (Romës) të Danielit 2
 - e. ndihmoi të varfrit, të verbrit, nevojtarët (Isaia)
3. Dëbimi i demonëve nga Ai zbuloi fuqinë dhe autoritetin e Tij mbi Satanin dhe mbretërinë e Tij.
4. Fakti që Ai ringjalli shumë nga vdekja tregoi fuqinë e Tij mbi jetën fizike dhe vdekjen.
5. Të gjitha mrekullitë e Tij zbulojnë fuqinë dhe autoritetin e Tij mbi të përkohshmen, hapësinoren dhe fiziken.
 - a. natyra
 - b. ushqyerjet
 - c. shërimet
 - d. të kuptuarit e mendimeve
 - e. kapja e peshqve

TEMË E VEÇANTË: QEVERIA NJERËZORE

HYRJE

- A. Përcaktim – Qeveria është organizimi i njerëzimit për të përmbushur dhe siguruar nevojat e perceptuara (fq.sh., Zanafilla 4 dhe 11). Njerëzit janë qenie shoqërore (edhe përpara Rënies [shih Zan. 2:18]). Familjet, fiset dhe kombet na japin komunitet.
- B. Qëllimi – Vullneti i Perëndisë është që rendi është i preferueshëm ndaj anarkisë.
 1. Legjislacioni i Moisiut, veçanërisht Dekalogu, është vullneti i Perëndisë për njerëzimin në shoqëri. Ai ekuilibron adhurimin dhe jetën.
 2. Në Shkrim nuk përkrahet asnjë formë ose strukturë qeverisjeje, ndonëse teokracia e Izraelit të lashtë është forma paraprirëse e qiellit. As demokracia, as kapitalizmi, nuk janë e vërteta biblike. Të krishterët duhet të veprojnë siç duhet në çfarëdo sistemi qeverisës që të gjenden. Qëllimi i të krishterit është ungjillizimi dhe shërbesa, jo revolucioni. Të gjitha qeveritë janë kalimtare!

C. Origjina e qeverisjes njerëzore

1. Katolicizmi është shprehur se qeveria njerëzore është nevojë e qenësishme, madje dhe përpara Rënies. Aristoteli duket se ishte i pari që e siguroi këtë premisë. Ai thotë: “njeriu është kafshë politike”; me këtë nënkupton se qeveria “ekziston për përkrahjen e jetës së duhur”.
2. Protestantizmi, veçanërisht Martin Luteri, ka pohuar se qeveria njerëzore është e qenësishme pas Rënies. Ai e quan “dora e majtë e mbretërisë së Perëndisë”. Luteri thotë se “Mënyra e Perëndisë për të kontrolluar njerëzit e ligj është të vërë njerëz të ligj në kontroll”.
3. Karl Marksi ka thënë se qeveria është mjet me anë të së cilit një elitë pakicë mban nën kontroll masat. Për të, qeveria dhe feja luajnë rol të ngjashëm.

I. MATERIALI BIBLIK

A. Dhiata e Vjetër

1. Izraeli është modeli që do të përdoret në qiell. Në Izraelin e lashtë, Mbret ishte YHWH. Teokracia është termi që përdoret për të përshkruar sundimin e drejtpërdrejtë të Perëndisë (shih 1 Sam. 8:4-9).
2. Sovraniteti i Perëndisë në qeverisjen njerëzore mund të shihet qartë në faktin se ai cakton.
 - a. të gjithë mbretërit (Dan. 2:21; 4:17, 24-25)
 - b. mbretërimin mesianik (Dan. 2:44-45)
 - c. Nebukadnetsarin (neo-Babilonia) (Jer. 27:6; Dan. 5:28)
 - d. Kirin II (Persi) (2 Kro. 36:22; Esdra 1:1; Isa. 44:28; 45:1)
3. Populli i Perëndisë duhet të jetë i nënshtuar dhe respektues edhe ndaj qeverive pushtuese dhe zaptuese:
 - a. Danieli 1-4, Nebukadnetsari (neo-Babilonia)
 - b. Danieli 5, Belshatsari (neo-Babilonia)
 - c. Danieli 6, Dari (Persia)
 - d. Esdra dhe Nehemia (Persia)
4. Judea e mëkëmbur duhet të lutej për Kirin dhe për mbretërimin e pasardhësve të tij
 - a. Esdra 6:10; 7:23
 - b. Judenjtë duhet të luteshin për autoritetet civile, Mishnah, Avot. 3:2

B. Dhiata e Re

1. Jezusi tregonte respekt për qeveritë njerëzore
 - a. Mateu 17:24-27; ai pagoi taksën e tempullit (autoritetet fetare dhe civile duhet të ishin një; shih 1 Pje. 2:17)
 - b. Mateu 22:15-22; Marku 12:13-17; Luka 20:20-26; ai përkrahu dhënien e taksës romake dhe, në këtë mënyrë, edhe autoritetin civil romak
 - c. Gjoni 19:11; Perëndia lejon autoritetin civil
2. Fjalët e Palit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Romakëve 13:1-5; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile, pasi janë caktuar nga Perëndia
 - b. Romakëve 13:6-7; besimtarët duhet të paguajnë taksat dhe të nderojnë autoritetet civile
 - c. 1 Timoteut 2:1-3; besimtarët duhet të luten për autoritetet civile
 - d. Titi 3:1; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile
3. Fjalët e Pjetrit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Veprat 4:1-31; 5:29; Pjetri dhe Gjoni përpara Sinedrit (kjo tregon precedentin biblik për mosbindjen civile).
 - b. 1 Pjetrit 2:13-17; besimtarët duhet t’u nënshtrohen autoriteteve civile për të mirën e shoqërisë dhe ungjillizimit
4. Fjalët e Gjonit në lidhje me qeveritë njerëzore
 - a. Zbulesa 17; kurva e Babilonisë simbolizon qeverisjen njerëzore, e cila organizohet dhe funksionon veçmas Perëndisë
 - b. Zbulesa 18; kurva e Babilonisë shkatërrohet

II. PËRMBYLLJE

- A. Qeverisja njerëzore (në këtë botë të rënë) caktohet nga Perëndia. Kjo nuk është “e drejta hyjnore mbretërve”, por detyra hyjnore e qeverisjes. Asnjë formë nuk përkrahet mbi të tjerat.
- B. Detyra fetare e besimtarëve është t’i binden autoritetit civil dhe të lutet për të.

- C. Detyra e besimtarëve është ta mbështesin qeverinë njerëzore me anë të taksave, duke shfaqur qëndrimin e duhur plot respekt.
- D. Qeveria njerëzore ekziston me qëllim që të ruajë rendin. Ata janë shërbëtorë të Perëndisë për këtë detyrë.
- E. Qeveria njerëzore nuk është absolute. Ajo është e kufizuar në autoritetin e vet. Besimtarët duhet të veprojnë për hir të ndërgjegjes duke refuzuar autoritetin civil kur ai i tejkalon caqet që i ka caktuar Perëndia. Siç pohoi Augustini në *Qytetin e Perëndisë*, ne jemi qytetarë të dy mbretërive, asaj të përkohshme dhe asaj hyjnore (shih Fil. 3:20). Ne kemi përgjegjësi ndaj të dyjave, por absolutja është mbretëria e Perëndisë! Jepet një fokus individual dhe kolektiv në lidhje me përgjegjësinë tonë ndaj Perëndisë.
- F. Ne duhet t'i inkurajojmë besimtarët e sistemeve demokratike që të marrin pjesë aktive në procesin e qeverisjes dhe që të zbatojnë, aty ku është e mundur, mësimet e Shkrimit.
- G. Ndryshimi shoqëror duhet paraprirë nga kthimi individual në besim. Nuk ekziston asnjë shpresë e qëndrueshme dhe e vërtetë eskatologjike në qeverinë njerëzore. Të gjitha qeveritë e njerëzve, ndonëse të caktuara dhe të përdorura nga Perëndia, janë shprehje të mëkatshme të organizimit njerëzor që funksionon veçmas Perëndisë. Ky koncept shprehet në përdorimin që i bën Gjoni fjalës “botë” (shih 1 Gjonit 2:15-17).



NASB “ata që ekzistojnë janë vendosur nga Perëndia”
NKJV “që ekzistojnë janë caktuar prej Perëndisë”
NRSV “që janë themeluar nga Perëndia”
TEV “janë vendosur atje nga Perëndia”
NJB “janë caktuar nga Perëndia”

Kjo është një PJESORE PERIFRASTIKE E KRYER PËSORE. Kjo formë gramatikore pohon se Perëndia është mbrapa të gjitha autoriteteve njerëzore (krh. Gjoni 19:11; Dan. 2:21; 4:17). Kjo nuk i referohet “të drejtës hyjnore të Mbretërve,” por vullnetit hyjnor për rregull. Kjo nuk po pohon një lloj specifik qeverie, por qeverinë vetë. Rregulli civil është më i mirë se kaosi (krh. v. 6).

13:2 “kushdo që i kundërvihet autoritetit” Kjo është një PJESORE E TASHME JOVEPRORE. Ajo i referohet rebelimit personal të vazhdueshëm/të bërë zakon kundër një rregulli të caktuar, fjalë për fjalë, “të vendosësh veten në opozitë/kundërshtim” (krh. Veprat 18:6; Jakobi 5:6). Te Marku 12:17, Jezusi shprehu qartë fushat e veprimit si për qeverinë, ashtu edhe për kishën. Në Veprat 5:25-32 shohim se çfarë ndodh kur autoritetet i kapërcejnë kufijtë e tyre.

■ **“i është kundërvënë. . . i janë kundërvënë”** Kjo është DËFTORE E KRYER VEPRORE dhe PJESORE E KRYER VEPRORE. Këto flasin për një rebelim të mirëorganizuar. Perëndia ka siguruar për rregull në këtë botë të rënë (krh. vv. 4,6). T’i kundërvihesh rregullit është t’i kundërvihesh Perëndisë, përveç rastit kur autoritetet civile i kalojnë kufijtë e dhënë nga Perëndia. Çështja e vërtetë shpirtërore është nënshtrimi ndaj autoriteteve. Njerëzimi i rënë dëshiron autonomi!

■ **“do të marrin mbi vete dënim”** KJV e përkthen “dënimin” si “damnation.” Kjo fjalë (që, në atë kohë kishte kuptimin *dënim*, shën. përkth.) e ka intensifikuar kuptimin në anglisht qysh nga viti 1611 (dhe ka marrë kuptimin *mallkim*, shën. përkth.). NKJV e përkthen si “gjykim.” Në kontekst kjo mund t’i referohej (1) gjykimit të Perëndisë ose (2) ndëshkimit civil (krh. v. 4). Këta njerëz sjellin gjykim mbi veten e tyre me anë të qëndrimeve dhe veprimeve të tyre kundër autoritetit (krh. Gjoni 3:17-21).

13:3 Shih komentin paralel në I Pjet. 2:14.

■ **“sundimtarët”** Shih Temën e Veçantë: *Archë* at 8:38.

■ **“autoritetin”** Shih Temën e Veçantë at 13:1.

13:4 “sepse ai është shërbëtor i Perëndisë për ty për të mirë” Autoritetet qeverisëse veprojnë kundër keqbërësve civilë ndërsa besimtari kufizohet në hakmarrjen e tij personale (krh. 12:17-19). Martin Luteri tha “Mënyra e Perëndisë për të kontrolluar njerëzit e ligj është të vërë njerëz të ligj në kontroll.”

▣ **“nëse”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË që ka kuptimin e veprimit të mundshëm të ardhshëm.

▣

NASB “sepse ai nuk e mban kot shpatën”
NKJV “sepse ai nuk e mban shpatën më kot”
NRSV “sepse autoriteti nuk e mban shpatën më kot”
TEV “pushteti i tyre për të ndëshkuar është real”
NJB “nuk është më kot që simboli i tyre i autoritetit është shpata”

Fjala “shpatë” (*machaira*) i referohet shpatës së vogël romake që përdorej në ndëshkimin kapital (krh. Veprat 12:2; Rom. 8:35). Ky pasazh dhe Veprat 25:11 japin bazën e Dhiatës së Re për ndëshkimin kapital, kurse Zan. 9:6 shpreh qartë këndvështrimin e Dhiatës së Vjetër. Frika është frenues efektiv i kaosit!

▣ **“sepse ai është shërbëtor i Perëndisë, hakmarrës”** Termi për hakmarrës (*ekdikos*) është përdorur disa herë në DHV. Ai është përdorur madje edhe në pjesën e parë të Lev. 19:18. Në DHV nëse një person vriste një person tjetër, edhe aksidentalisht, familja e atij personi kishte të drejtën të ushtronte hakmarrjen “sy për sy” (hakmarrësi i gjakut). Pali me sa duket po e lidh zakonin e DHV me autoritetin e qeverisë civile.

Në I Thes. 4:6 Perëndia thuhet se është hakmarrësi, që ndjek Rom. 12:19. Të dy këta pasazhe i referohen LiP 32:35 (krh. Heb. 10:30).

13:5 “është e nevojshme t’i nënshtrohesh” Jepen dy arsye (1) t’i shpëtosh ndëshkimit, ose të Perëndisë, ose të autoriteteve qeverisëse dhe (2) për ndërgjegjen e besimtarëve.

▣ **“për hir të ndërgjegjes”** Nuk ka ekuivalent të DHV për termin grek “ndërgjegje” veç nëse termi hebraik “krahavor” nënkupton një njohje të vetes dhe të motiveve të saj. Fillimisht termi grek i referohej vetëdijes të lidhur me pesë shqisat. Më vonë u përdor për shqisat e brendshme (krh. Rom. 2:15). Pali e përdori këtë term dy herë në gjyqet e tij në Veprat (d.m.th., 23:1 dhe 24:16). Ajo i referohet vetëdijes së tij që nuk kishte shkelur me sa dinte asnjë detyrë fetare ndaj Perëndisë (krh. I Kor. 4:4).

Ndërgjegjia është të kuptuarit gjithnjë e më i madh i motiveve dhe veprimeve nga ana e besimtarit bazuar në

- A. një pikëpamje biblike
- B. Frymën brendabanues
- C. një njohuri si mënyrë jetese bazuar në Fjalën e Perëndisë

Ajo bëhet e mundur nga pranimi personal i ungjillit.

13:6 “për këtë ju edhe paguani taksat” Kjo është një DËFTORE E TASHME VEPRORRE, megjithëse në formë mund të jetë URDHËRORE E TASHME VEPRORRE (krh. JB). Ky është një shembull i përgjegjshmërisë së krishterë ndaj autoriteteve civile pikërisht sepse autoritetet qeverisëse janë shërbëtorë të Perëndisë (krh. vv. 1-2).

13:7

NASB “U jepni të gjithëve atë që u takon: taksën ...doganën ...frikë...nderim”
NKJV “U jepni për këtë arsye të gjithëve atë që u takon; taksat. . .; doganën. . .; frikë. . .; nderim”
NRSV “jepuni të gjithëve atë që u takon—taksat. . .; të ardhurat. . .; respekt. . .; nderim”
TEV “Paguajuni, atëherë, atë që u detyroheni; paguajuni taksat personale dhe të pronës, dhe tregoni respekt dhe nderim për të gjithë ata”
NJB “Paguajini çdo zyrtari të qeverisë atë që ai ka të drejtë të kërkojë—qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë taksa, ose jo të drejtpërdrejtë, frikë ose nderim”

Kjo mund t’iu referohet dy grupeve të veçanta të autoriteteve civile (krh. RSV), por ndoshta kuptimi këtu është që të krishterët duhet t’iu japin edhe taksat, edhe respektin autoriteteve civile, sepse ata funksionojnë si shërbëtorë të Perëndisë (krh. vv. 1,4 [dy herë],6; Mat. 22:15-22).

Të dy termat, “taksë” dhe “doganë” janë përdorur si sinonime këtu (megjithëse TEV bën një dallim). Nëse analizohen etimologjikisht (kuptimi origjinal), i pari u referohej taksave të paguara nga një komb i mundur (krh. Luka 20:22) dhe i dyti taksave personale (krh. Mat.17:25; 22:17,19).

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR ROMAKËVE 13:8-14

- A. Është e mundur t'i kuptojmë vv. 1-7 si një kontekst letrar më vete. Megjithatë, tema e “detyrimit” në v. 7 duket se vazhdon në një kuptim tjetër në v. 8. Besimtarët kanë detyrime ndaj shtetit; besimtarët gjithashtu kanë detyrime ndaj qenieve të tjera njerëzore.
- B. Vargjet 8-10 janë një mendim i unifikuar, ashtu si edhe vv. 11-14. Ata vazhdojnë diskutimin nga kapitulli 12 të përgjegjësisë së krishterë për të dashur të tjerët.
- C. Përdorimi nga Pali i Dekalogut (Dhjetë Urdhërimeve) të DHV si udhërrëfyes moral për besimtarët e Besëlidhjes së Re tregon se DHV vazhdon të jetë aktuale në fushën e jetesës së përendishme (shenjtërimit), jo të shpëtimit (shfajësimi, krh. Galatasve 3). Duket se Pali ka kombinuar disa burime për të ndërtuar udhëzimet e tij etike:
1. fjalët e Jezusit
 2. drejtimin e Frymës
 3. Dhiatën e Vjetër
 4. trainimin e tij rabinik
 5. njohurinë e tij për mendimtarët grekë (veçanërisht Stoikët)
- Kjo karakterizonte “ligjin e dashurisë”— dashuri për Perëndinë, dashuri për njerëzimin, shërbim ndaj Perëndisë, shërbim ndaj njerëzimit!
- D. Vargjet 11-14 kanë një orientim eskatologjik (të fundit të kohërave). Kontrasti i dritës dhe errësirës ishte karakteristikë e literaturës hebraike, duke përfshirë edhe Rrotullat e Detit të Vdekur. Ai është gjithashtu i zankonshëm në shkrimet e Gjonit dhe Palit. Tensioni “tashmë” por “ende jo” i jetës së krishterë është nxitja për jetesë të përendishme. “Epoka e re” (Mbretëria e Perëndisë) është përruar dhe shpejt do të realizohet plotësisht. Ky pasazh është shumë i ngjashëm me I Thes. 5:1-11.
- E. Vargjet 13-14 patën një efekt jetë-ndryshues mbi Augustinin në verën e vitit 386 pas Krishtit. Ai thotë, në *Rrëfimet* 8:29, “Nuk doja të lexoja më, nuk kisha nevojë; menjëherë në fund të kësaj fjalie një dritë e qartë ma pushtoi zemrën dhe e gjithë errësira dhe dyshimi u zhdukën.”

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:8-10

⁸Mos i kini asnjë detyrim askujt përveçse të doni njëri-tjetrin; sepse ai që e do fqinjin e tij e ka përmbushur ligjin. ⁹Sepse ky, “NUK DO TË SHKELËSH BESNIKËRINË BASHKËSHORTORE, NUK DO TË VRASËSH, NUK DO TË VJEDHËSH, NUK DO TË LAKMOSH,” dhe nëse ka ndonjë tjetër urdhërim, ai përmbledhet në këtë thënie, “DO TA DUASH FQINJIN TËND SI VETEN TËNDE.”
¹⁰Dashuria nuk i bën të keqe fqinjit; prandaj dashuria është përmbushja e ligjit.

13:8 “Mos i kini asnjë detyrim askujt” Kjo është e TASHME VEPRORE URDHËRORE me një PJESËZ MOHORE që zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim tashmë në proces. Kjo frazë emfatike ka dy MOHORE. Ajo ka mundësi që të ketë patur lidhje me çështje taksash (vv. 6-7). Borxhi financiar është gjithmonë një lodhje emocionale dhe potencialisht edhe shpirtërore. Ruhuni nga dashuria për botën. Ajo ua vjedh besimtarëve aftësinë për të mbështetur kauzat e krishtera dhe bamirësitë personale. Megjithatë, ky varg nuk mund të përdoret si tekst për të provuar se nuk duhet marrë kredi konsumatore. Bibla duhet interpretuar nën dritën e kohës së vet. Ajo nuk

është gazetë amerikane mëngjesi! Vargjet 8-10 theksojnë përparësinë e të dashurit të njëri-tjetrit (1) si vëllezër të besëlidhjes (Mat. 22:39-40; Gjoni 13:34-35) dhe (2) si qenie njerëzore (krh. Mat. 5:42; Gal. 6:10).

NIDNTT, vol. 1, fq. 668, bën vëzhgimin që FOLJA “i detyrohem dikujt” ka dy kuptime.

1. në Ungjijtë është përdorur për borxhin
2. në Letrat e Palit është përdorur për një përgjegjësi

Në këtë tekst Pali duket se i kombinon këto nuanca kuptimore.

■ **“përveçse të doni njëri-tjetrin”** Ky është mendimi kyç i vv. 8-10 (krh. Gjoni 13:34; 15:12; Rom. 12:10; I Kor. 13; Fil. 2:3-4; I Thes. 4:9; Heb. 13:1; II Pjet. 1:7; I Gjoni 3:11; 4:7, 11-12).

■ **“ai që e do fqinjin e tij”** Kjo FOLJE është PJESORE E TASHME VEPRORE. Ajo nuk u referohet veprave të izoluara apo sezonale të dashurisë, por një mënyre jetese me dashuri si të Krishtit.

Termi “fqinj” është fjalë për fjalë, “një tjetër i një lloji tjetër” (*heteros*), megjithëse dallimi midis *heteros* dhe *allos* (një tjetër i të njëjtit lloj) po humbiste në Greqishten Koine. Në kontekst kjo mund t’i referohet fqinjit të dikujt, në termat më të gjera të mundshme, besimtar ose jo (krh. Luka 12:14-21; 10:25-37). Megjithatë, citimi nga Lev. 19:18 në kontekst i referohet një partneri të besëlidhjes (një izraeliti tjetër).

Të krishterët duhet t’i duan të krishterët e tjerë si vëllezër dhe njerëzit e humbur si vëllezër të mundshëm (krh. Gal. 6:10). Krishtërimi është një familje. Secili anëtar jeton dhe shërben për shëndetin dhe rritjen e së tërës (krh. I Kor. 12:7).

■

NASB, NKJV,

NRSV **“e ka përmbushur Ligjin”**

TEV **“i është bindur Ligjit”**

NJB **“i keni zbatuar detyrimet tuaja”**

Kjo FOLJE e zakonshme në greqisht (*pleroō*) mund të përkthehet në disa mënyra. Ajo është E KRYER VEPRORE DËFTORE, që mund të përkthehet si “ka qenë dhe vazhdon të përmbushet.” Robert Hanna, *A Grammatical Aid to The Greek New Testament*, citon A. T. Robertson dhe e quan atë “E KRYER gnomike (që i referohet një të vërtete të zakonshme, të mirënjohur nga marrësit)” (fq. 28). Ajo përsëritet në v. 10 (krh. Gal. 5:14; 6:2).

13:9 Nuk është e pazakontë për Palin të përdorë Ligjin e Moisiut (Eks. 20:13-17 ose LiP 5:17-21 dhe Lev. 19:18) për të motivuar besimtarët e Besëlidhjes së Re. Në Efe. 6:2-3, Pali përdori një nga Dhjetë Urdhërimet si motivim për të krishterët (krh. I Tim. 1:9-10). Ky tekst i DHV nuk ishte mjet shpëtimi, por ishte megjithatë vullneti i zbuluar i Perëndisë për mënyrën se si njerëzit duhet ta trajtonin Perëndinë dhe njëri-tjetrin (krh. Rom. 15:4; I Kor. 10:6,11). Ndoshta citimi nga DHV ishte mënyra e Palit për t’u marrë me besimtarët hebrenj dhe johebrej në kishën e Romës. Ky përdorim i termit “përmbushur” lidhej edhe me ato që tha Jezusi për Ligjin te Mat. 5:17.

Është e mundur që kjo t’i referohet ligjit në përgjithësi, ligjit si normat shoqërore dhe jo Ligjit të Moisiut në veçanti (krh. JB). Megjithatë, fakti që Pali citon nga DHV në v. 9 nënkupton një referencë ndaj Ligjit të Moisiut. Vini re që vetëm dashuria, jo mbajtja e rregullave nga ana e njeriut mund ta përmbushë me të vërtetë Ligjin! Shih Temat e Veçanta më poshtë.

Levitiku 19:18 është përdorur në dy mënyra domethënëse.

1. Jezusi e përdor atë në lidhje me *shema-n* (shih LiP 6:4-6) si një përmbledhje të të gjithë Ligjit (krh. Mat. 22:37-40; Marku 12:29-31; Luka 10:27).
2. Për Palin ai funksionon si një përmbledhje e gjysmës së dytë të dekalogut (d.m.th., marrëdhënia e njeriut me partnerët e besëlidhjes, krh. Gal. 5:14), dhe ndjek komentin e Jezusit te Mat. 7:12 dhe Luka 6:31.

TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT

Ai është i mirë dhe nga Perëndia (krh. Rom. 7:12,16).

- A. Ai nuk është rruga për në drejtësi dhe në pranim nga Perëndia (ai madje mund të jetë një mallkim, krh. Galatasve. 3).
- B. Ai është ende vullneti i Perëndisë për besimtarët sepse është vetë-zbulesa e Perëndisë (Pali shpesh e

- citon DHV për të bindur për mëkat dhe/ose inkurajuar besimtarët).
- C. Besimtarët informohen nga DHV (krh. Rom. 4:23-24; 15:4; I Kor. 10:6,11), por nuk shpëtohen nga DHV (krh. Veprat 15; Romakëve 4; Galatasve 3; Hebrenjve).
- D. Ai funksionon në besëlidhjen e re për të:
1. treguar mëkatshmëri (krh. Gal. 3:15-29)
 2. udhëhequr njerëzimin e shpenguar në shoqëri
 3. informuar vendimet etike të krishtera

Është ky spektër teologjik nga mallkimi dhe aspekti kalimtar në bekim dhe përhershëmëri që shkakton problemin kur përpiqemi të kuptojmë pikëpamjen e Palit për Ligjin e Moisiut. Në *A Man in Christ*, James Stewart tregon të menduarit dhe të shkruarit paradoksal të Palit:

“Natyrshtëm do të prisnim që një njeri i cili i ishte futur punës për të ndërtuar një sistem mendimi dhe doktrine do t’i fiksonte në mënyrë sa më të ngurtë kuptimet e termave që do të përdorte. Do të prisnim që ai të synonte precizion në frazeologjinë e ideve të tij kryesore. Do të kërkonim që një fjalë, pasi të ishte përdorur njëherë nga shkrimtari ynë në një kuptim të caktuar, duhej ta ruante atë kuptim gjithandej. Por nëse do ta kërkojmë këtë te Pali, do të zhgënjehemi. Pjesa më e madhe e frazeologjisë së tij është fluide, jo e ngurtë. . . ‘Ligji është i shenjtë,’ shkruan ai, ‘Unë gjej kënaqësi të madhe në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm’ (krh. Rom. 7:12-13) por është qartësisht një aspekt tjetër i *nomos* që e bën të thotë në një vend tjetër, ‘Krishti na ka shpenguar nga mallkimi i ligjit (krh. Gal. 3:13)’” (fq. 26).

TEMË E VEÇANTË: SHËNIME MBI EKSODIN 20

EKSODI 20:13, VRASJA

I. KONTEKSTI

- A. Duhet mbajtur mend që edhe urdhërimet që duken sikur janë të një natyre shoqërore janë në të vërtetë fetare. Sovraniteti i Perëndisë mbi krijimin dhe shpengimi janë hijezuar në këto urdhërime. Urdhërimi për të mos vvarë është, në fokusin e duhur, një fjalë për imazhin e Perëndisë në çdo qenie njerëzore dhe për kujdesin dhe preokupimin e Perëndisë për jetën njerëzore.
- B. Duhet mbajtur mend që çdo urdhërim reflekton komunitetin e besimit. Ndalimi për të marrë një jetë në mënyrë të paligjshme fokusohet kryesisht dhe fillimisht në kontekstin e komunitetit të besimit.
- Rrjedhojat dhe nënkuptimet e tij pastaj janë po aq të shtrira sa edhe njerëzimi!

II. STUDIM FJALE PËR TERMAT E RËNDËSISHËM

A. “Vrasje”

1. Ky është një term i rrallë (*rasah*) për marrjen e një jete, përdorur vetëm 46 herë në DHV. Ka dy terma të tjerë më të zakonshëm.
 - a. *Harag*, përdorur 165 herë
 - b. *Hemit*, përdorur 201 herë
2. Termi (*Rasah*) duket se ka një kuptim origjinal të kufizuar dhe një kuptim më të zgjeruar.
 - a. Fillimisht ai lidhej me marrjen e jetës së një partneri të besëlidhjes në një mënyrë ligjore të paramenduar, shpesh të lidhur me “shpenguesin nga fisi” ose “*go’el*.” Ky përdorim nënkuptonte paramendim, por në një kuptim hakmarrjeje ligjore (krh. Num. 35:30-34; Lev. 24:13-23). Në realitet *Lex Talionis*, “sy për sy,” (krh. Zan. 9:5-6) ishte një mënyrë për ta kufizuar hakmarrjen. Më vonë u caktuan qytetet e strehimit (LiP 4:41; Joz. 20:3) në mënyrë që, një anëtar i besëlidhjes që vriste aksidentalisht ose në zemërim e sipër një anëtar të komunitetit, të mund t’i shpëtonte zemërimit të familjes së viktimës.
 - b. Më vonë termi filloi t’i referohej motivit ose qëndrimit që gjendej pas aktit të marrjes së jetës së dikujt. Koncepti i “qëllimshmërisë” bëhet shumë i rëndësishëm! (krh. Eks. 21:12-14; Num. 35:11,22; LiP 28:24).
 - c. Ky dallim bëhet shumë i rëndësishëm në këtë urdhërim. Në kontekst duket se i

referohet vetëm të tjerëve brenda komunitetit të besëlidhjes. Ai është i lidhur me shpenguesin nga fisi, ose me hakmarrësin e gjakut. Megjithatë, termi është përdorur në pasazhe të mëvonshme që reflektojnë Dekalogun, Osea 4:2 dhe Jeremia 7:9, për t'iu referuar një vrasësi. Kjo fjalë lidhet jo vetëm me ligjin, por edhe me motivin. Ajo zgjerohet nga i afërmi/fqinji në një qenie tjetër njerëzore.

3. Ky term sigurisht nuk lidhet me çështjen e sotme etike të dënimit kapital apo të luftës. Hebrejtë nuk kishin problem me ekzekutimet në komunitet apo me luftën e shenjtë (ose, edhe me luftën e pashenjtë!).
4. Përkthimi më i mirë për kulturën e sotme do të ishte “vrasje me paramendim.”

III. TË DHËNA KONTEKSTUALE

- A. Urdhërimi i gjashtë, i shtatë dhe i tetë përbëhen vetëm nga dy fjalë në hebraisht. Ata janë shumë të shkurtër dhe koncizë.
- B. Jeta, si e gjithë jeta, është e lidhur me Perëndinë. Mënyra si i trajtojmë të tjerët reflekton mendimet tona për Perëndinë.

IV. PARALELE NË DHIATËN E RE

- A. Jezusi
 1. Zgjerimi që Ai i bëri këtij urdhërimi (krh. Mat. 5:21-26) na jep orientimin e duhur për diskutimin tonë të sotëm në lidhje me zbatimin e këtij teksti në kohën tonë.
 2. Jezusi dukshëm e zhvendosi Dekalogun nga fusha e veprimeve në fushën e motiveve. Ne jemi ashtu siç mendojmë! “Ashtu si mendon në zemër të vet, ashtu është ai.” Jeta e mendimeve është shumë më e rëndësishme dhe e lidhur me gjithçka tjetër sesa e pohojmë normalisht.
- B. Gjoni
 1. I Gjoni. 3:15, këtu pohohet i njëjti koncept që urrejtja konsiderohet si vrasje.
 2. Termat grekë të përdorur te Mateu 5:21 e më tej dhe I Gjoni 3:15 janë të ndryshëm, por kuptimi është në thelb i njëjtë.
 3. Vini re aspektin pozitiv të I Gjoni 4:19-21.

V. TË VËRTETA PËR ZBATIM

- A. Megjithëse dikush që ka vararë dikë pa paramendim mund t'i shpëtojë hakmarrësit të gjakut duke u arratisur në një qytet strehimi (krh. Num. 35; Joz. 20), ai duhet të vuajë ndëshkimin e mbylljes në atë qytet deri në vdekjen e Kryepriftit. Pasojat e veprimit të tij mbeten!
- B. Megjithëse ky varg nuk lidhet drejtpërdrejt me vetëvrasjen, sepse të lashtët ndoshta nuk mendonin kurrë për këtë ngjarje, teksti ende jep një parim shpirtëror në lidhje me shenjtërinë e jetës njerëzore dhe sovranitetin dhe qëllimin e Perëndisë për jetën njerëzore të krijuar në imazhin e Tij. Ky tekst flet fort për kohën tonë në këtë fushë!
- C. Ky tekst, megjithatë, nuk flet në mënyrë decizive për çështjet e sotme të: (1) dënimit kapital ose (2) luftës. Për Izraelin këto nuk ishin gjëra të këqija në vetvete. Izraelitët ishin të përfshirë në të dyja. Ende, parimi i rëndësishëm së jetës së krijuar në imazhin e Perëndisë dhe nën kontrollin e Tij është një e vërtetë e rëndësishme në këtë fushë.
- D. Ky tekst flet një fjalë të nevojshme për dinjitetin dhe shenjtërinë e jetës njerëzore! Ne në komunitetin e besimit jemi administratorë, jo vetëm të veprimeve tona, por edhe të shoqërisë sonë. Dhurata e jetës është edhe individuale, edhe kolektive.

Ne jemi përgjegjës për abuzimin fizik, shoqëror dhe psikologjik të trupave tanë po aq sa edhe për abuzimet fizike, shoqërore dhe psikologjike të të tjerëve në komunitetin tonë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një kulturë si jona ku na lejohet të flasim dhe ta ndryshojmë sistemin. Ne jemi rojtarët e vëllait tonë!

EKSODI 20:14, KURORËSHKELJA

I. KONTEKSTI

- A. Është e dukshme që urdhërimi është i lidhur me respektin e dikujt për Perëndinë që duket në respektin për jetën, gruan dhe pronën e fqinjit (krh. Jer. 5:8). Kjo vërtetohet nga rendi i ndryshëm i këtyre urdhërimeve në Septuagintë.
- B. Paraleli i Ligjit të Përtërirë tregon përshtatshmërinë e adoptimit të kësaj të vërtete të lashtë në kulturën tonë.
- C. Ashtu si respekti për prindërit shihej si kyç për një shoqëri të qëndrueshme, ashtu shihet edhe ky urdhërim.
- D. Ky urdhërim gjithashtu nënkupton që Perëndia është pronari dhe ka nën kontroll si jetën familjare, edhe atë seksuale.
- E. Ky urdhërim duket se bazohet te Zanafilla 2:24 ashtu si urdhërimi numër 4 bazohet te Zanafilla 2:1-3.

II. STUDIM FJALE

- A. Termi kryesor në këtë tekst është “kurorëshkelja.” Është kyçe që ta kuptojmë këtë term nën dritën e kulturës hebraike.
 - 1. Ky term është i dallueshëm në kontekstin e DHV nga “kurvëria.” Kurorëshkelja nënkupton që të paktën njëra nga palët në marrëdhënien seksuale është e martuar. Termi “kurvëri” nënkupton që asnjëra nga palët nuk është e martuar (krh. Fja. 29:3; 31:3). Dallimi ka humbur në termat grekë të DHR.
 - 2. Kjo mundësi shpjegon arsyen për theksin në statusin martesor sepse lidhet me rëndësinë e të drejtave të trashëgimisë që përfshiheshin në premtimin e “tokës” nga Perëndia. Çdo 50 vjet (Jubileu) e gjithë toka i duhej kthyer pronarëve fillestarë sipas fiseve.
 - 3. Kurorëshkelja dënohej nga ana kulturore përpara ligjit të Moisiut (krh. Zan. 12:10ff; 26:7ff; 39:9).
 - 4. Kurorëshkelja shihej si mëkat ndaj:
 - a. Fqinjët – Eksodi 20:14; Ligji i Përtërirë 5:18
 - b. Martesës – Levitiku 18:20
 - c. Perëndisë – Zanafilla 20:1-13; 26:7-11
 - 5. Ishte e ndëshkueshme me vdekje për të dyja palët:
 - a. Levitiku 20:10
 - b. Ligji i Përtërirë 22:22-24
 - c. Ezekieli 16:40 (metaforë)
 - d. Paralajmërimi të rrepta gjenden në Fjalët e Urta 1-9

III. LIDHJA ME DHR

- A. Jezusi përdorur Levitikun 19:18 si një përmbledhje të Zbulesës së Vjetër (krh. Luka 10:27). Kjo konfirmon që të Dhjetë Urdhërimet lidhen me mënyrën si ne trajtojmë të tjerët.
- B. Jezusi i intensifikon urdhërimet te Mateu 5:28. Ai e vendos theksin mbi motivin më shumë sesa mbi veprimin. Hebrenjtë e konsideronin mendjen si djepi i shpirtit. Për ta njeriu ishte ashtu si mendonte (Fja. 23:7). Kjo i bën Dhjetë Urdhërimet pothuaj të pamundura për t’u mbajtur—dhe ky është qëllimi! (krh. Gal. 2:15-3:29).

IV. ZBATIMI PËR KOHËN E SOTME

- A. Martesa është ndoshta analogjia më e mirë e kohës së sotme për një përkushtim besnik e për gjithë jetën në emrin e Perëndisë. Ajo është mundësia jonë më e mirë për të kuptuar realitetet e koncepteve të besëlidhjeve të DHV (Mal. 2:14). Respekti që tregojmë për bashkëshortin apo bashkëshorten në të gjitha aspektet, duke përfshirë edhe seksualitetin njerëzor, na ndihmon ta rrokim kuptimin kryesor të këtij vargu.
- B. Stabiliteti dhe besnikëria martesore, ashtu si edhe respekti për prindërit, është një shtyllë kryesore e forcës dhe jetëgjatësisë shoqërore.
- C. Duhet theksuar se seksualiteti njerëzor është dhuratë nga Perëndia. Ishte ideja dhe vullneti i Tij për njeriun. Udhëzimet nuk kanë synim të pengojnë gëzimin apo lirinë e njeriut, por të japin udhëzime të perëndishme për njeriun e rënë. Kufijtë na janë zbuluar për të mirën dhe lumturinë tonë afatgjatë. Megjithatë njeriu e ka keqpërdorur seksualitetin, ashtu siç ka bërë me të gjitha

dhuratat e Perëndisë, ai është ende një shtysë e fuqishme brenda racës njerëzore që duhet të jetë nën kontrollin dhe drejtimin e Perëndisë.

- D. Seksi duhet mbrojtur në mënyrë që të respektohet shenjtëria e personit njerëzor (femër ose mashkull), sepse ai apo ajo janë krijuar në imazhin e Perëndisë. Fokusi ynë mëkatar mbi “mua” është shumë i dukshëm në këtë fushë.

EKSODI 20:15, VJEDHJA

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

- A. Ashtu si me të gjitha rregullat në Dekalog, besimi ynë, dashuria dhe respekti për Perëndinë duhet të shihen në aspektet e shenjta dhe laike të jetës sonë të përditshme. Është një neveri për Perëndinë të themi se e njohim Atë dhe pastaj të shfrytëzojmë partnerin tonë të besëlidhjes (krh. I Gjoni 4:20-21; 2:7-11).
- B. Ky urdhërim ka si synim të ndihmojë në ruajtjen e bashkësisë të komunitetit besëlidhor. Ciësia e kësaj bashkësie frymërore do të tërheqë botën e cila është konfuze dhe në kërkim tek Perëndia ynë, gjë që është qëllimi i Shkrimeve.
- C. Ashtu si urdhërimet e tjera janë fokusuar në faktin që Perëndia zotëron të gjithë jetën, edhe ky urdhërim bën të njëjtën gjë! Ne jemi administratorë, jo pronarë. Shtysa jonë (për shkak të rënies) drejt pasjes së zotërimeve, pa na kushtuar gjë, gjendet prapa këtij ndalimi (krh. Ps. 50:10-12).

II. STUDIM FJALE DHE FRAZE

- A. Ky është urdhërimi i tretë në gjysmën e dytë të Dekalogut që përbëhet vetëm nga dy fjalë në hebraisht.
- B. Objekti i këtij urdhërimi mungon. Ai mbështetet zakonisht nga:
1. Konteksti i dy urdhërimeve të mëparshme që lidhen me shkelje madhore.
 2. Prania e pasazheve paralele të zbatueshëm edhe të menjëhershëm (Eks. 21:16), edhe të largët (LiP 24:7). Gjithashtu shih Zanafilla 37.
- C. Megjithatë, edhe forma e shkurtër argumentohet
1. Ajo është regjistruar për ne me anë të frymëzimit
 2. Ajo e zgjeron gamën e urdhërimit
 3. Gjithashtu ka një pasazh paralel në kontekstin e menjëhershëm që lidhet me vjedhjen—Eksodi 22:1 e më tej.
 4. Jezusi me sa duket citon këtë pasazh në lidhje me vjedhjen (krh. Mat. 19:18).
- D. Vjedhja gjithashtu trajtohet edhe në Kode Ligjore të tjera të lashta, por zakonisht ndëshkimi është vdekja, gjymtimi ose kthimi 30 herë më shumë.
- E. Ka disa pasazhe paralele të rëndësishme që e përkufizojnë dhe e shpjegojnë këtë të vërtetë:
1. Levitiku 19:1-18—“Jini të shenjtë, sepse unë, Zoti, Perëndia juaj jam i shenjtë”
 - a. Mënyra jonë e jetesës duhet të reflektojë karakteristikat familjare të Atit tonë dhe Perëndisë tonë (krh. v. 18).
 - b. Besimi ynë duhet ta ndikojë përditë jetën tonë, edhe në veprime pozitive, edhe në ndalime negative, të dyja të informuara nga motive të dhura (krh. v. 17).
 - c. Dhembshuria për të mënjanoarit dhe nevojtarët, vv. 9-10, 13, është po aq e rëndësishme sa edhe refuzimi për t’i zhvatur të afërmit tanë, v. 11.
 2. Amosi 8:4-7—Perëndia e urren shfrytëzimin!
 3. Mikea 6:6-8—Perëndia dëshiron motive të dhura në të gjitha veprimet tona. Puna është te arsyeja pse nuk vjedhim!
 4. Eksodi 22:1 e më tej—Shpesh e vërteta që na mungon në diskutimet tona të sotme të vjedhjes është rikthimi! Mëkati gjithmonë kushton!

III. TË VËRTETA PËR ZBATIM

- A. Xhoi Davidman (Joy Davidman), bashkëshortja e Si Es Luisit (C. S. Lewis), ka shkruar një libër të mrekullueshëm mbi Dekalogun. Ajo e përkthen këtë urdhërim “Ti nuk do të përpiqesh

të marrësh diçka pa paguar.” Kjo patjetër që e zgjeron gamën përtej zotërimeve. Ajo gjithashtu thotë që “prona nuk është as mëkat, as e drejtë e patjetërsueshme, por një hua, një gjë që na është besuar nga Perëndia.”

- B. Vjedhja, ashtu si të gjithë mëkatet e tjerë të zemrës së rënë, zgjidhet/rregullohet me anë të një zemre të re, Efe. 4:28. Është mahnitëse se si natyra e vjetër e “marrjes” kthehet në natyrën e re të “ndarjes me të tjerët!”
- C. Respekti ynë për Perëndinë shihet qartë në respektin tonë për partnerët e tjerë të besëlidhjes! Kjo e vërtetë e mbizotëron Dekalogun.
- D. Njeriu i sotëm vjedh në shumë mënyra!

PYETJE DISKUTIMI

1. Si e praktikon vjedhjen njeriu i sotëm?
2. Si lidhet rikthimi i gjësë së vjedhur me pendimin?
3. So lidhet ky varg me pikëpamjen kapitaliste të pronës?

EKSODI 20:17, LAKMIA

I. HYRJE

- A. Është possible ta shohim marëdhënien midis pesë urdhërimeve të fundit si më poshtë:
 1. Numri 6, 7, dhe 8 ndalojnë lëndimin/cënimin e një partneri të besëlidhjes në një veprim të hapur.
 2. Numri 9 ndalon lëndimin/cënimin e një partneri të besëlidhjes në të folur.
 3. Numri 10 ndalon lëndimin/cënimin e një partneri të besëlidhjes në mendime.
- B. Është e vërtetë që akti i lakimit shqetëson personin që lakmon, jo objektin, fqinjin/të afërmin. Megjithatë, është e mundur që ky urdhërim pret që mendimet do të pasohen nga veprime.
- C. Shumë e shonin këtë urdhërim si një koncept unik që gjendet vetëm në kodin Ligjor të lashtë të Izraelit dhe që mungon në kodet e tjera ligjore të lashta të Lindjes së Afërme. Ky koncept i ri do të ishte ndalimi i mendimeve. Është e vërtetë që Izraeli e kishte të qartë që mendimet ishin zanafilla e veprave të këqija (krh. Fja. 23:7; Jakobi 1:14-15). Megjithatë, ky varg duket se bën fjalë për mendime që rezultojnë në veprime. Disa pasazhe e përdorin termin “lakmoj” në lidhje me një veprim që rezulton prej lakmisë (krh. LiP 7:25; Joz 7:21; Mikea 2:2).
- D. Nëse është e vërtetë që theksi bie mbi atë që është listuar në fillim dhe në fund, domethënia e vërtetë e këtij urdhërimi shihet qartë. Adhurimi ekskluziv i Perëndisë është i pari, por qëndrimet dhe motivet tona kundrejt gjërave të kësaj bote e ndikojnë devocionin tonë të vërtetë ndaj Perëndisë. Ky theks i dyfishtë shihet edhe te Predikimi në Mal i Jezusit, Mat. 6:33—“por kërkonte më së pari Mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij dhe të gjitha këto gjëra (krh. vv. 19-32) do t’ju shtohen.”

II. STUDIM FJALE DHE FRAZE

- A. Eksodi 20:17 dhe Ligji i Përtërirë 5:21, megjithëse në thelb janë të njëjta, kanë disa dallime të rëndësishme:
 1. Bashkëshortja është përfshirë në konceptin më të madh të “shtëpisë” ose të pronës së një burri tek Eksodi 20 kurse te Ligji i Përtërirë 5 ajo është vendosur në një kategori më vete, që duket prioritare.
 2. Pasazhi tek Eksodi 20 ka termin hebraik “lakmoj” që ka kuptimin “dëshiroj të marr,” por Ligji i Përtërirë 5 ka një term tjetër, “dëshiroj” si edhe “lakmoj.” “Lakmoj” flet për dëshirë që është e lidhur me një veprim për të marrë objektin e dëshirës, por “dëshirë” duket se fokusohet vetëm në qëndrimin.
 3. Gjithashtu, Eksodi 20, i shkruar për bijtë e Izraelit gjatë periudhës së endjeve në shkretëtirë nuk e përmend “arën” në listën e zotërimeve kurse Ligji i Përtërirë 5 po përsërit të njëjtat urdhërime për një shoqëri që është vendosur në Tokën e Premtuar.
- B. Termi “lakmoj” është një term neutral. Ai mund t’i referohet dëshirimit të gjërave të mira (krh. Ps. 19:10; I Kor. 12:31).
- C. Dëshira e pavend është shkaku rrënjësor i rënies së Satanit, Adamit dhe Evës dhe i të gjithëve

ne. Pali e theksoi betejën e tij personale me lakminë te Romakëve 7:7-8. Lakmia është në thelb një pakënaqësi dhe mungesë besimi në kujdesin dhe sigurimin e Perëndisë.

D. Disa pasazhe të DHR lidhen me lakminë:

1. Problemi i njeriut është pakënaqësia dhe lakmia (krh. Luka 12:15; I Tim. 6:8-10).
2. Lakmia është përfshirë në listën e Jezusit të mëkateve që e ndotin njeriun (krh. Mark 7:17-23; I Kor. 5:10; Efe. 5:5; Kol. 3:5).

III. TË VËRTETA PËR ZBATIM

A. Përgjigjia ndaj lakmisë mëkatore dhe pakënaqësisë është:

1. Dashuria – Rom. 13:8-10

2. Të qenit i kënaqur – Heb. 13:5; Fil. 4:11-13 (dhe ndarja me të tjerët e gjërave, Fil. 4:14)

B. Urdhërimi thotë “ndalo” por vetëm Krishti na e dha fuqinë për të ndaluar! Në Të ne mund t’i kontrollojmë mendimet deri në njëfarë shkalle.

C. Perëndia i njeh mendjet dhe zemrat tona

1. I Kronikave 28:9
2. Fjalët e Urta 20:27
3. Psalmi 139:1,23
4. Jeremia 17:10
5. Romakëve 8:27
6. Zbulesa 2:23

D. Gjërat nuk janë të këqija, por kur ato bëhen përparësia bëhen mëkat. Gjërat nuk janë gjëja më e lartë dhe as të përjetshme; njerëzit që janë krijuar në imazhin e Perëndisë janë të tillë! Lakmia e ndikon Komunitetin Besëlidhor në mënyra të fshehta dhe shkatërruese!

PYETJE DISKUTIMI

1. Çfarë është lakmia?
2. Si lakmon njeriu i sotëm?
3. A janë mëkat mendimet tona?
4. Pse janë mendimet kaq të rëndësishme në jetën e krishterë?
5. Pse është urdhërimi tek Eksodi 20:17 disi i ndryshëm nga ai te Ligji i Përtërirë 5:21?

▣ **“Sepse ky”** Kjo është një referencë ndaj Dhjetë Urdhërimeve ose Dekalogut. Rradha e renditjes së gjysmës së dytë të Dhjetë Urdhërimeve ndjek dorëshkrimin grek B, të quajtur Vaticanus. Ai është paksa ndryshe nga Teksti Masoretik hebraik i Eksodit 20 dhe Ligjit të Përtërirë 5. Gjysma e dytë e Dekalogut trajton marrëdhënien e izraelitëve me njëri-tjetrin bazuar në marrëdhënien e tyre me YHWH.

▣ **“dhe nëse ka ndonjë tjetër urdhërim”** Kjo është FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet e vërtetë nga këndvështrimi i autorit, ose për qëllimet e tij letrare. Ka edhe urdhërime të tjera. Fraza ka kuptimin “nëse ka ndonjë urdhërim tjetër jashtë Dekalogut.” Me fjalë të tjera, kjo e përmbledh të gjithë Ligjin e Moisiut, ose ndoshta “ligjin” në përgjithësi.

Ekziston një variant në traditën e dorëshkrimeve greke në lidhje me sa dhe në ç’radhë janë rreshtuar këto Dhjetë Urdhërime. Judaizmi ka një numër; Katolikët dhe Protestantët kanë numra të ndryshëm. Kuptimi i pasazhit nuk ndikohet nga ky variacion, gjë që është e vërtetë në lidhje me pjesën dërrmuese të variacioneve të dorëshkrimeve.

▣ **“ai përmbledhet në këtë thënie”** Ky është një citim nga Lev. 19:18. Ai citohet disa herë në Ungjijtë (krh. Mat. 5:43; 19:19; 22:39; Marku 12:31 dhe Luka 10:27). Jezusi e quan atë urdhërimi i dytë më i madh. Ai citohet edhe te Gal. 5:14 dhe Jakobi 2:8. Kur dikush e do Perëndinë, atëherë do edhe atë që Perëndia e do (d.m.th., qeniet njerëzore të krijuara në imazhin e Tij, krh. Zan. 1:26-27).

▣ **“DO TA DUASH FQINJIN TËND SI VETEN TËNDE”** Besimtarët duhet të duan veten ashtu siç Perëndia i do ata përpara se ata të duan dhe të pranojnë të tjerët. Dashuria e duhur për veten nuk është e keqe. E vërteta kryesore e këtij seksioni thuhet qartë—duaji të tjerët (krh. v. 10). Ata që janë prekur nga dashuria e Perëndisë që është dhënëse e vetes dhe sakrifikuere do t’i duan të tjerët në të njëjtën mënyrë (krh. I Gjoni 3:16). Ky është thelbi

i ngjashmërisë me Krishtin (i imazhit të rikthyer të Perëndisë.) Në praninë e kësaj lloj dashurie nuk ka nevojë për “ligj.”

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 13:11-14

¹¹**Bëjeni këtë, duke e ditur kohën, që është tashmë ora që ju të zgjoheni nga gjumi; sepse tani shpëtimi është më afër nesh sesa kur besuam.** ¹²**Nata pothuaj ka shkuar dhe dita është afër. Prandaj, le të lëmë mënjanë veprat e errësirës dhe të veshim armët e dritës.** ¹³**Le të sillemi siç duhet si ditën, jo në teprime dhe në dehje, jo në imoralitete dhe shturje, jo në grindje dhe xhelozë.** ¹⁴**Por vishni Zotin Jezus Krisht dhe mos u kujdesni për mishin në lidhje me dëshirat e tij.**

13:11

NASB “*bëjeni këtë*”
NKJV “*dhe bëjeni këtë*”
NRSV “*Veç kësaj*”
TEV “*Duhet ta bëni këtë*”
NJB “*Veçse*”

Kjo është një mënyrë për të lidhur atë që vjen më pas (vv. 11-14) me atë që vjen më përpara (vv. 9-10). Jini bërës të fjalës, jo vetëm dëgjues (krh. Jakobi 1:22,23,25)! Dashuria duhet të vihet në veprim.

▣ **“duke e ditur kohën”** Kjo është PJESORE E KRYER VEPRORE. Ky term për kohën (*kairos*) përdoret në kuptimin e një periudhe të veçantë kohe, jo për kohën kronologjike (*chronos*). Besimtarët duhet të jetojnë në (1) dritën e kthimit nga çasti në çast të Krishtit dhe (2) të epokës së re që ka aguar.

▣ **“që është tashmë ora”** Kjo metaforë, “ora” (përdorur shpesh në Ungjillin e Gjonit), i referohet një momenti të veçantë (i ngjashëm me *kairos*) në planin shpengues të Perëndisë (krh. 3:26; I Kor. 7:29; 10:11; Jakobi 5:8; I Pjet. 4:7; II Pjet. 3:9-13; I Gjoni 2:18; Zbu. 1:3; 22:10). Ajo është përdorur edhe për kohën e kryqëzimit të Jezusit, edhe për kthimin e Tij.

▣ **“gjumi”** Ky term është përdorur këtu metaforikisht për lëshim moral dhe frymëror (krh. Efe. 5:8-14; I Thes. 5:6). Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst specifik. Kini kujdes nga një përkufizim i ngurtë. Të gjitha fjalët kanë disa kuptime të mundshme (fusha semantike).

▣ **“sepse tani shpëtimi është më afër”** Shpëtimi është një vendim fillestar dhe një proces (Shih Temën e Veçantë at 10:14). Shpëtimi nuk do të jetë i plotë derisa besimtarët të kenë trupa të rinj (krh. I Gjoni 3:2; I Thes. 4:13-18; Heb. 9:28; I Pjet. 1:5). Teologjikisht ky quhet “përlëvdim” (Rom. 8:30). Është shpresa e çdo brezi të krishterësh të presin që Zoti të kthehet gjatë jetës së tyre (krh. Luka 21:28). Edhe Pali nuk bënte përjashtim (krh. I Thes. 4:15).

▣ **“sesa kur besuam”** Krishtërimi fillon me një vendim (shfajësim dhe shenjtërim i menjëhershëm), por duhet të rezultojë në një mënyrë jetese të perëndishme (shenjtërimi progresiv, Shih Temën e Veçantë at 6:4) dhe përfundon në ngjashmëri me Krishtin (përlëvdim). Personi duhet ta pranojë ofertën e Perëndisë në Krishtin (krh. Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13). Ky vendim fillestar nuk është fundi, por fillimi!

13:12 “Nata pothuaj ka shkuar” Kjo i referohet epokës së tashme të ligë që tashmë po shkatërrohet dhe po zëvendësohet (krh. I Kor. 7:29-31; 10:11; Jakobi 5:8; Efe. 5:8,14; I Gjoni 4:7; II Gjoni 2:17-18; Zbu. 1:3; 22:10). Shih Temën e Veçantë at 12:2. Pali, dhe veçanërisht Gjoni, përdor kontrastin midis errësirës dhe dritës, dhe po ashtu bëjnë edhe Rrotullat e Detit të Vdekur.

▣ **“dita është afër”** Kjo është E KRYER VEPRORE DËFTORE. Këto janë ditët e fundit (krh. Fil. 4:5; Jakobi 5:9). Kohët e fundit kanë filluar që nga mishërimi i Jezusit. Ato do të zgjasin deri në kthimin e Tij të lavdishëm. Të gjithë besimtarët qysh nga shekulli i parë janë habitur nga një vonesë kaq e madhe e kthimit të Krishtit. Megjithatë, epoka e re ka aguar në Krishtin.

Ky shënim mbi afërsinë e kthimit të Krishtit është marrë nga “Crucial Introduction” (Hyrje shumë e rëndësishme) e komentarit tim mbi Zbulesën. Shikojeni atë online në www.freebiblecommentary.org.

“TENSIONI I GJASHTË (kthimi i shpejtë i Krishtit përkundër *Paorusia*-s së vonuar)

Shumica e besimtarëve janë mësuar që Jezusi do të vijë shpejt dhe papritur (krh. Mat. 10:23; 24:27,34,44; Mark 9:1; 13:30). Por çdo brez besimtarësh që ka pritur këtë deri tani e ka pasur gabim! Shpejtësia (menjëhershmeria) e kthimit të Jezusit është një shpresë e madhe e çdo brezi, por do të jetë realitet vetëm për një të tillë (dhe ai i persekutuar). Besimtarët duhet të jetojnë sikur Ai të vinte nesër, por të planifikojnë dhe ta çojnë përpara Porosinë e Madhe (krh. Mat. 28:19-20) nëse Ai vonon.

Disa pasazhe në Ungjijtë (krh. Mark 13:10; Luka 17:2; 18:8) dhe I dhe II Thesalonikasve bazohen në një Ardhje të Dytë (*Parousia*) të vonuar. Janë disa ngjarje historike që duhet të ndodhin së pari:

1. ungjillizimi mbarë-botëror (krh. Mat. 24:15; Mark 13:10)
2. zbulimi i “njeriut të Mëkatit” (krh. Mat. 24:15; II Thes. 2; Zbu. 13)
3. përndjekja e madhe (krh. Mat. 24:21,24; Zbu. 13)

Ka një dykuptimshmëri të qëllimtë (krh. Mat. 24:42-51; Mark 13:32-36)! Jeto çdo ditë sikur të ishte e fundit, por planifiko dhe trainohu për shërbesë të ardhme!”

☐ **“të lëmë mënjanë . . . të veshim”** Këto janë AORISTE LIDHORE JOVEPRORE, që japin një notë urgjence. Nënkuptimi është “ju lini mënjanë. . . vishni një herë e mirë ose me vendosmëri.” Edhe Perëndia, edhe njeriu janë aktivë si në shfajësim (pendim dhe besim), edhe shenjtërim (jetesë të perëndishme). Kjo metaforë veshjeje është shumë e zakonshme në shkrimet e Palit. Besimtarët duhet të heqin rrobat e gjumit dhe të veshin armët e luftës (krh. Efe. 4:22-25; Kol. 3:10,12,14). Ne jemi ushtarë të krishterë që përgatiten për betejën e përditshme frymërore (krh. Efe. 6:10-18). Shih shënimin në NIDNTT, vëll. 1, fq. 315-316.

☐ **“armët e dritës”** Ky është ndoshta një aluzion ndaj Isa. 59:17. Besimtarët duhet të veshin me vendosmëri armët e drejtësisë (krh. II Kor. 6:7; 10:4; Efe. 6: 11,13; I Thes. 5:8). Armatimi i Perëndisë është i disponueshëm për besimtarët, por ata duhet

1. të kuptojnë nevojën e tyre
2. të kuptojnë sigurimin e Perëndisë
3. që personalisht dhe me qëllim ta bëjnë atë pjesë të jetës dhe mendimeve të tyre

Ka një betejë të përditshme frymërore! Shih Clinton F. Arnold, *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare*.

13:13 “Le të sillemi siç duhet” Kjo është AORISTE VEPRORE LIDHORE, fjalë për fjalë, “ecim.” Kjo ishte një idiomë hebraike për mënyrën e jetesës (krh. Efe. 4:1,17; 5:2,15). Pali e përdor atë mbi 33 herë.

Lista e mëkateve në këtë varg përbëhet nga tre çifte termash. Termat kanë njëfarë mbivendosje semantike. Është e mundur që ato të jenë shkruar si sinonime. Shih Temën e Veçantë: Veset dhe Virtytet në 1:28-32.

Këta terma mund të lidhen me tensionin midis besimtarëve hebrenj dhe johebrenj në kishën e Romës. Besimtarët e rinj johebrenj mund të kenë qenë duke vazhduar (1) disa nga praktikat imorale të adhurimit të tyre pagan ose (2) të sillen me arrogancë ndaj udhëheqësve hebrenj të rikthyer që ishin larguar për një kohë të shkurtër për shkak se Neroni kishte ndaluar të gjitha ritet hebreje në Romë.

☐ **“jo në teprime dhe në dehje”** Kjo i referohet imoralitetit seksual që lidhej me ritualet fetare pagane për dehjen. Në listën e mëkateve të mishit te Gal. 5:21, këta terma vendosen pranë e pranë.

☐ **“jo në imoralitete dhe shturje”** Ky çift duket se mbivendoset me çiftin e parë. Termi i dytë është përdorur gjerësisht në DHR (krh. Mark 7:22; II Kor. 12:21; Gal. 5:19; Efe. 4:19; I Pjet. 4:3; II Pjet. 2:7). Nëse çifti i parë fokusohet në dehjen, ky çift fokusohet në imoralitetin seksual, madje në një lëshim të pakontrolluar në shturje.

☐ **“jo në grindje dhe xhelozë”** Këta terma flasin për grindje midis njerëzve (krh. Gal. 5:20). Ky mund të ketë qenë rezultati i sjelljes së papërshtatshme të dy çifteve të para. Nëse këta i adresohen të krishterëve (krh. I Kor. 3:3; Kol 3:8), ata reflektojnë disa nga praktikat pagane që duhet të ndalojnë në jetët e besimtarëve. Megjithatë, në kontekst ky varg është në kontrast me besimtarët, prandaj, në atë kuptim, do të ishte një paralajmërim.

13:14 “vishni Zotin Jezus Krisht” Kjo metaforë lidhet me robën mbretërore të Mbretit Jezus që është vendosur tani mbi supet e besimtarëve (shenjtërimi pozicional). Disa studiues e shohin atë si një aluzion ndaj veshjes së pagëzimit. Kjo metaforë veshjeje është përmendur fillimisht në v. 12. Ajo është një mënyrë për të treguar pozicionin e ri të besimtarëve në Krishtin. Ajo gjithashtu thekson faktin që besimtarët duhet t’i vënë në jetë zgjedhjet e tyre të mënyrës së jetesës (shenjtërim progresiv) për shkak të pozicionit të tyre të ri në Krishtin (krh.

Efe. 4:22,24; Kol. 3:8). Në Gal. 3:27 kjo e vërtetë është shprehur si një fakt, DËFTORE; këtu ajo është shprehur si URDHËRORE (AORISTE JOVEPRORE), si urdhër.

Ky tension midis deklaratës DËFTORE dhe URDHËRORES është tensioni midis pozicionit tonë në Krishtin dhe përpjekjes sonë për ta zotëruar atë pozicion (Shih Temën e Veçantë në 6:4). Ne jemi “shenjtorë” (të shenjtë) në momentin e shpëtimit, por gjithashtu nxitimi të jemi “të shenjtë.” Ky është paradoksi biblik i shpëtimit të plotë dhe falas në Krishtin dhe thirrjes për ngjashmëri me Të !

■ **“mos u kujdesni”** Kjo është URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE me një PJESËZ MOHORE. Kjo formë gramatikore zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Kjo duket se nënkupton që disa të krishterë në Romë po jetonin jetë moralisht jo të përshtatshme. Kjo mund të jetë mbartur nga praktikat e tyre pagane të adhurimit.

Është e vështirë të shpjegosh mësimet e DHR në lidhje me krishtërimin e mishtë. Autorët e DHR e paraqesin gjendjen e njeriut në terma bardh e zi. Një i krishterë i mishtë është një kontradiktë në terma. Megjithatë është një realitet i jetëve tona në “tashmë, por jo ende.” Pali e kategorizoi njerëzimin në tre grupe (I Kor. 2:14-3:1):

1. njeriu natyror (njerëzimi i humbur), 2:14
2. njeriu frymëror (njerëzimi i shpëtuar), 3:1
3. njeriu i mishtë (të krishterët e mishtë ose foshnja në Krishtin), 3:1

■ **“mishin në lidhje me dëshirat e tij”** Pali i njëjtte mirë rreziqet e vazhdueshme të natyrës sonë të rënë Adamike (krh. Rom. 7; Efe. 2:3), por Jezusi na jep fuqinë dhe dëshirën për të jetuar për Perëndinë (krh. Romakëve 6). Kjo është një betejë e vazhdueshme (krh. 8:5-7; I Gjoni 3:6-9). Shih Temën e Veçantë: Mishi (*sarx*) në 1:3.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Pse ishte deklarata e Palit për qeverinë aq radikale për të krishterët e hershëm?
2. A duhet t’i nënshtrohen të krishterët çdo lloj forme qeverisjeje?
3. A duhet t’i nënshtrohen të krishterët çdo kërkesë ligjore të qeverisë?
4. A mëson vargu 1 të drejtën hyjnore të mbretërve?
5. A po hap Pali një terren të ri teologjik, apo ka një precedent në fjalët e Jezusit te Mat. 22:21?
6. A është ndonjëherë e justifikuar mosbindja civile për të krishterët (krh. Veprat 5:25-32)?
7. Si lidhet vargu 4 me çështjen e ndëshkimit kapital?
8. A ka gjithmonë të drejtë ndërgjegjia e të krishterit (krh. v. 5)?
9. Bazuar te vargu 8, a duhet që besimtarët të mos kenë karta krediti?
10. A flet vargu 8 për dashurinë tonë për të krishterët e tjerë, apo për të gjithë njerëzit?
11. Pse e përdor Pali Dekalogun si një nxitje për besimtarët e Dhiatës së Re?
12. Pse i liston Pali mëkate kaq të tmerrshme në lidhje me besimtarët?
13. Si mund të “veshim Zotin Jezus krisht?”

ROMAKËVE 14

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Mos e gjyko vëllanë tënd	Ligji i lirisë	Dashuria respekton skrupujt e të tjerëve	Mos i gjyko të tjerët	Mirësi kundrejt skrupulozëve
14:1-12	14:1-13	14:1-4 14:5-6 14:7-9 14:10-12	14:1-4 14:5-12	14:1-12
Mos e bëj të pengohet vëllanë tënd	Ligji i dashurisë		Mos i bëj të tjerët të bien	
14:13-23	14:14-23	14:13-23	14:13-18 14:19-23	14:13-21 (14:22-15:6) 14:22-23

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë kenë përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

- A. Paragrafi i parë
- B. Paragrafi i dytë
- C. Paragrafi i tretë
- D. Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 1-12

- A. Ky kapitull përpiqet të balancojë paradoksin e lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së krishterë. Njësia letrare vazhdon deri në 15:13.
- B. Problemi që e precipitoi këtë kapitull ishte ndoshta tensioni midis besimtarëve hebrej dhe atyre johebrej në kishën e Romës (ose ndoshta përjetimi aktual i Palit në Korint). Përpara kthimit në besim hebrej prireshin nga legalizmi, kurse paganët prireshin nga imoraliteti. Mbani mend, ky kapitull u drejtohet ndjekësve të sinqertë të Jezusit. Ky kapitull nuk u drejtohet besimtarëve të mishtë (krh. I Kor. 3:1). Motivi më i lartë u atribuohet të dy grupeve. Ekstremet gjithmonë janë të rrezikshme në të dy krahët. Ky diskutim nuk u jep përkrahje as legalistëve që kritikojnë për çdo gjë edhe më të

voglën, as liberalëve që mburren me mëkatën. Mbani mend që Pali u shkroi romakëve nga Korinti. Problemi atje ishin ndasitë, por këtu kishte lloje të ndryshme besimtarësh.

- C. Besimtarët duhet të kenë kujdes që të mos e bëjnë teologjinë ose etikën e tyre standard për të gjithë besimtarët e tjerë (krh. II Kor. 10:12). Të gjithë besimtarët duhet të ecin nën dritën që kanë, por të kuptojnë që teologjia e tyre nuk është automatikisht teologjia e Perëndisë. Të gjithë besimtarët janë ende të ndikuar nga mëkati. Ne duhet të inkurajojmë, nxisim dhe mësojmë njëri-tjetrin nga Shkrimi, arsyeja dhe përvoja, por gjithmonë me dashuri. Sa më shumë të dijë dikush, aq më shumë di që nuk di (krh. I Kor. 13:12)!
- D. Qëndrimet dhe motivet përpara Perëndisë janë çelësat e vërtetë në vlerësimin e veprimeve të besimtarëve të tjerë. Të krishterët do të dalin përpara Krishtit që të gjykohen se si e trajtuan njëri-tjetrin (krh. vv. 10,12 dhe II Kor. 5:10).
- E. Martin Luteri tha, “Një i krishterë është zot i lirë i të gjithave, i panështruar ndaj ndonjërit; i krishteri është shërbëtori më i përlurur i të gjithëve, i nënshtruar ndaj të gjithëve.” E vërteta biblike shpesh paraqitet në një paradoks të mbushur me tension.
- F. Kjo temë e vështirë, por kyçe trajtohet në gjithë njësinë letrare të Romakëve 14:1-15:13 dhe gjithashtu në I Korintasve 8-10 dhe Kolosianëve 2:8-23. Një libër ndihmues për mua në këtë fushë është libri nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How To Read the Bible For All Its Worth*, (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka) fq. 75-86.
- G. Megjithatë, duhet thënë se pluralizmi midis besimtarëve të sinqertë nuk është gjë e keqe. Çdo besimtar ka pika të forta dhe të dobëta. Secili duhet të ecë në dritën që ka, gjithmonë i hapur ndaj Frymës dhe Biblës për më shumë dritë. Në këtë periudhë kur shohim si në një pasqyrë të errët (I Kor. 13:8-13) ne duhet të ecim në dashuri (v. 15) dhe paqe (vv. 17,19) për ndërtimin e ndërsjellë.
- H. Titujt “më i fortë” dhe “më i dobët” që Pali u jep këtyre grupeve na shkakton paragjykim neve. Ky patjetër nuk ishte qëllimi i Palit. Të dy grupet ishin besimtarë të sinqertë. Ne nuk duhet të përpiqemi t’i bëjmë të krishterët e tjerë si vetja jonë! Ne e pranojmë njëri-tjetrin në Krishtin!
- I. I gjithë argumenti mund të përvijohet në këtë mënyrë
1. pranoni njëri-tjetrin sepse Perëndia na pranon në Krishtin (krh. 14:1,3; 15:7);
 2. mos e gjykoni njëri-tjetrin sepse Krishti është i vetmi Zot dhe Gjykatës i yni (krh. 14:3-12);
 3. dashuria është më e rëndësishme sesa liria personale (krh. 14:13-23);
 4. ndiqni shembullin e Krishtit dhe dorëzoni të drejtat tuaja për ndërtimin dhe të mirën e të tjerëve (krh. 15:1-13).

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:1-4

¹Tani pranojeni atë që është i dobët në besim, por jo me qëllim që të gjykoni mendimet e tij. ²Një person ka besim që ai mund të hajë nga të gjitha gjërat, por ai që është i dobët ha vetëm perime. ³Ai që ha nuk duhet të shohë me përbuzje atë që nuk ha, dhe ai që nuk ha nuk duhet të gjykojë atë që ha, sepse Perëndia e ka pranuar. ⁴Kush je ti që të gjykos shërbëtorin e një tjetri? Për zotërinë e tij ai qëndron ose bie; dhe ai do të qëndrojë, sepse Zoti është në gjendje ta bëjë të qëndrojë.

14:1

NASB

“Tani pranojeni”

NKJV

“Priteni”

NRSV, TEV

“Mirëpritni”

NJB

“Jepini mirëseardhje”

Kjo është URDHËRORE E TASHME JOVEPRORE (krh. 15:1). Ky është një urdhër i vazhdueshëm me theksin mbi kryefjalën. PËREMRI “ju” është në greqisht FOLJE, por në anglisht nënkuptohet dhe i referohet të krishterëve “të fortë” (krh. 15:1). Kjo nënkupton dy grupe në kishën në Romë. Kjo mund të ketë patur lidhje me (1) tensionin midis besimtarëve hebrenj dhe johebrej (krh. 15:7-21) ose (2) me llojet e ndryshme të personalitetit. I gjithë konteksti ka të bëjë me besimtarë të vërtetë e të sinqertë; disa të fortë, disa të dobët në besim. Besimi është përdorur këtu në sensin e të kuptuarit të ungjillit dhe të rrjedhëve të tij rrënjësisht të reja dhe çliruese.



NASB, NKJV “atë që është i dobët në besim”

NRSV, TEV “ata që janë të dobët në besim”

NJB “Nëse besimi i një personi nuk është i fortë sa duhet”

Kjo frazë theksohet duke u nxjerrë përpara (d.m.th., duke u vendosur e para në tekstin në greqisht). Fjalë për fjalë është “i dobët në besim.” KOHA E TASHME fokusohet në faktin që kjo është një karakteristikë e jetës. Kjo i referohet një mentaliteti legalist. Besimtari i krishterë tepër skrupuloz përshkruhet në këtë kapitull në tri mënyra:

1. ndalim të ushqimeve të caktuara (krh. 14:2,6,21)
2. theksim mbi ditë të veçanta (krh. 14:5-6)
3. ndalim të verës (krh. 14:17,21)

I njëjti lloj personi përmendet edhe te Rom. 15:1 dhe I Kor. 8:9-13; 9:22. Kini kujdes që të mos e kategorizoni veten tepër shpejt si i krishterë i fortë ose i dobët. Shpesh besimtarët janë të dobët në një fushë dhe të fortë në një tjetër.

Qëndrimi i Palit kundrejt këtyre çështjeve është shumë i ndryshëm te Gal. 4:9-10 dhe Kol. 2:16-23. Këta tekste reflektojnë qëndrimet dhe mësimet e mësuesve të rremë. Te Romakëve këta janë besimtarët e sinqertë që kanë ndërgjegje tepër skrupuloze.

Shumë komentues mendojnë se “i dobët në besim” i referohet besimtarëve hebrenj (d.m.th., judaistëve) dhe theksit të tyre të vazhdueshëm mbi bindjen ndaj Ligjit të Moisiut ashtu siç kuptohej në traditat rabinike (d.m.th., Talmudi). Kjo patjetër përputhet me #1 dhe #2 në paragrafin një, por nuk përputhet me #3. Për këtë arsye unë mendoj se një lloj i caktuar personaliteti përputhet më mirë me kontekstin. Mund të jetë fjala për besimtarë hebrenj ose johebrej mbi të cilët traditat e shkuara kanë ende shumë ndikim!

TEMË E VEÇANTË: DOBËSIA

Këtu është kontrasti. Mësuesit e rremë mburren me kredencialet dhe stilin e tyre retorik, por Pali e njeh vlerën e “dobësisë” (*astheneō*). Vini re sa shpesh këta terma (ose format e tyre) janë përdorur në I dhe II Korintasve.

Mburrem	I dobët
I Korintasve 1:29,31	I Korintasve 1:25,27
3:21	2:3
4:7	4:10
5:6	8:7,9,10,11,12
9:15,16	9:22
II Korintasve 1:12,14	11:30
5:12 (dy herë)	12:22
7:4,14 (dy herë)	15:43
8:24	II Korintasve 10:10
9:2,3	11:21,29,30
10:8,13,15,16,17	12:5,9,10 (dy herë)
11:12,16,17,18,30	13:3,4 (dy herë), 9
12:1,5,6,9	

Pali e përdor konceptin e dobësisë në disa mënyra të ndryshme.

1. Dobësia e Perëndisë, I Kor. 1:25
2. I dobët në botë, I Kor. 1:27
3. Dobësia dhe frika e Palit, I Kor. 2:3; 9:22; II Kor. 11:29,30; 12:5

4. Pali dhe skuadra e tij e misionit, I Kor. 4:10; II Kor. 11:21
5. Besimtari i dobët (krh. Rom. 14:1-15:13), I Kor. 8:7,9,10,11,12; 9:22
6. Sëmundja fizike, I Kor. 11:30
7. Pjesët e trupit njerëzor, I Kor. 12:22
8. Trupi njerëzor, I Kor. 15:43
9. Prezenca fizike e Palit ose aftësia e tij në të folur, II Kor. 10:10
10. Dobësia e Palit e shumëzoi forcën e Perëndisë, II Kor. 12:9,10; 13:4,9
11. Mesazhi i Krishtit përmes Palit, II Kor.13:3
12. Trupi fizik i Krishtit, II Kor. 13:4



NASB “por jo me qëllim që të gjykoni mendimet e tij”
NKJV “por jo të ziheni për gjëra të paqarta”
NRSV “por jo për qëllimin që të grindeni për opinione”
TEV “por mos u zini me ta në lidhje me opinionet e tyre personale”
NJB “pa filluar një grindje”

Besimtarët duhet t’i pranojnë plotësisht besimtarët e tjerë me të cilët nuk bien dakord pa u përpjekur t’i ndryshojnë! Kjo kërkon lirinë e ndërgjegjes si bazë të bashkësisë, jo një uniformitet të imponuar. Të gjithë besimtarët janë në proces. Ata duhet t’i japin Frymës kohë të punojë dhe të pjekë secilin, por edhe në pjekuri ne nuk do të biem të gjithë dakord.

14:2 Dieta që përmendet në këtë varg është për qëllime fetare, jo për shëndet. Ky problem i ushqimit mund të ketë dalë nga dy burime të mundshme (1) ligjet ushqimore hebreje (krh. Levitiku 11) ose (2) mishi i flijuar idhujve paganë (krh. I Korintasve 8-10). Jezusi mësoi qartë që ushqimi nuk e ndot njeriun (krh. Mat. 15:10-20; Marku 7:14-23). Kjo e vërtetë është ilustruar nga vizioni i Pjetrit në lidhje me Kornelin te Veprat 10.

14:3 “Ai që ha nuk duhet të shohë me përbuzje” “Të mos shohë me përbuzje” është E TASHME VEPRORE URDHËRORE e *ezouthenō* me PJESËZËN MOHORE që zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që është tashmë në proces.

“Përbuzje” është fjalë për fjalë “t’i ulësh rëndësinë,” “ta zerosh,” ose “ta quash të pavlerë” (krh. 14:10; Luka 18:9; I Kor. 6:4; 16:11; II Kor. 10:10; Gal. 4:14; I Thes. 5:20). Besimtarët duhet të ruhen nga vetë-drejtesia që i shikon të tjerët me përçmim. Të fortët në besim nuk duhet t’i dënojnë të dobët në besim.

■ **“gjykojë”** Kjo është E TASHME VEPRORE URDHËRORE me PJESËZËN MOHORE që zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Të dobët në besim duhet të ndalojnë së gjykuari veprimet e vëllezërve/motrave të tyre që nuk bien dakord me ta.

■ **“sepse Perëndia e ka pranuar”** Kjo është AORISTE JOVEPRORE DËFTORE. I njëjti term është përkthyer “pritur” në v. 1. Baza për pranimin e njëri-tjetrit për besimtarët është se Perëndia përmes Krishtit (15:7) i ka pranuar ata. Në kontekst v. 3 po u flet drejtpërdrejt atyre që janë tepër skrupulozë, të krishterëve të dobët në besim.

14:4 **“Kush je ti”** Kjo është emfatike në greqisht, dhe i referohet vëllait ose motrës së dobët.

■ **“shërbëtorin”** Ky është termi *oiketēs*, që formohet nga termi *oikos*, që do të thotë “shtëpi,” prandaj, ai është një skllav shtëpie, apo shërbëtor (krh. Luka 16:13; Veprat 10:7; Rom. 14:4; I Pjet. 2:18). Ai është përdorur në këtë kuptim në Septuagintë (krh. Zan. 9:25; 27:37; 44:16,33; 50:18). Ai nuk është përdorur si termi mbizotërues për skllav ose shërbëtor në DHR, i cili është *doulos*; ai mund të përshkruajë gjithashtu edhe shërbëtorët e shtëpisë ose skllavërit.

Argumenti i Palit këtu është që çdo besimtar është një skllav/shërbëtor i Krishtit. Ai është “zoti” i tyre dhe Ai dhe vetëm Ai do t’i drejtojë dhe do t’i mbajë përgjegjës për veprimet dhe motivet e tyre (krh. II Kor. 5:10).

■ **“Për zotërinë e tij ai qëndron ose bie”** Në kontekst Pali po u drejtohet atyre që janë tepër skrupulozë, por deklarata është e qartë që u referohet të dy grupeve. Besimtarët do të bënin mirë të hiqnin lëmishtet nga sytë e tyre (krh. Mat. 7:1-15).

■ **“dhe ai do të qëndrojë, sepse Zoti është në gjendje ta bëjë të qëndrojë”** Ky ishte një premtim i mrekullueshëm (krh. 5:1-2; Juda 24-25). Ai gjithashtu përfshin bashkëpunimin e çdo besimtari (krh. I Kor. 15:1-2). Shih Temën e Veçantë: Qëndroj te 5:2.

Këtu ka një variacion në dorëshkrimet greke. NKJV, duke ndjekur dorëshkrimet uncialle D, F, G, 048 dhe 0150, si edhe Vulgatën, ka “Perëndi” (*Theos*), megjithatë, MSS P⁴⁶, Ⲙ, A, B, C, P kanë “Zot” (*kurios*). UBS⁴ e vlerëson “Zot” si të sigurt (A).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:5-9

⁵Një person e vlerëson një ditë mbi një tjetër, një tjetër e vlerëson çdo ditë *njësoj*. Çdo person duhet të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij. ⁶Ai që e respekton ditën, e respekton për Zotin, dhe ai që ha, ha për Zotin, sepse falenderon Perëndinë; dhe ai që nuk ha, për Zotin nuk ha, dhe falenderon Perëndinë. ⁷Sepse asnjë prej nesh nuk jeton për veten, dhe asnjë nuk vdes për veten; ⁸sepse nëse jetojmë, jetojmë për Zotin, ose nëse vdesim, vdesim për Zotin; prandaj qoftë nëse jetojmë, apo vdesim jemi të Zotit. ⁹Sepse për këtë qëllim Krishti vdiq dhe u ngjall përsëri, që Ai të mund të jetë Zot edhe i të vdekurve, edhe i të gjallëve.

14:5 “Një person e vlerëson një ditë mbi një tjetër” Disa njerëz janë ende shumë të ndjeshëm ndaj ditëve të kalendarit fetar (d.m.th., ditë të caktuara apo ngjarje vjetore, krh. Gal. 4:10; Kol. 2:16-17). Të gjitha ditët i përkasin barabar Perëndisë. Nuk ka ditë të veçanta. Nuk ka ditë “laike” dhe ditë “të shenjta.” Të gjitha janë të shenjta!

■ **“Çdo person duhet të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij”** Kjo është E TASHME PËSORE URDHËRORE. Ky është çelësi për paqe në këtë fushë. Bindjet personale të besimtarëve janë përcaktuese për veprimet e tyre (krh. v. 23), por jo për ato të të gjithë besimtarëve të tjerë. Perëndia nuk jeton brenda kutisë sime teologjike. Teologjia ime nuk është patjetër ajo e Perëndisë!

14:6 “për Zotin” Kjo frazë DHANORE është përdorur tre herë në v. 6 dhe dy herë in v. 8. Të gjitha zgjedhjet e mënyrës së jetesës nga ana e besimtarëve të sinqertë duhen bërë si “për Zotin” (krh. Efe. 6:7 dhe Kol. 3:23), jo thjesht nga preferencat personale, denominacionale, apo traditat familjare, apo opinionet!

14:7 “Sepse asnjë prej nesh nuk jeton për veten” Asnjë i krishterë nuk është një ishull. Të krishterët jetojnë së pari dhe mbi të gjitha për Krishtin (krh. v. 8). Veprimet e besimtarëve ndikojnë të tjerët. Ata janë pjesë e një familjeje të madhe shpirtërore. Prandaj, ata duhet ta kufizojnë lirinë e tyre personale nga dashuria (krh. I Kor. 10:24,27-33). Ata duhet t’i lejojnë të tjerët të rriten në lirinë personale. Legalizmi çon në një uniformitet vetë-drejtësie që nuk është nga Perëndia. Fjalët dhe gjykimet më të ashpra të Jezusit iu drejtuan Farisenjve të vetë-drejtë.

14:8 “nëse. . .nëse” Këto janë dy fjali kushtore të klasit të tretë që kanë kuptimin e veprimit të ardhshëm të mundshëm. Besimtarët i shërbejnë Zotit në çdo situatë të mundshme (krh. Efe. 6:7; Kol. 3:23)!

14:9 “Zot edhe i të vdekurve, edhe i të gjallëve” Kjo është një renditje e pazakontë e këtyre termave. Renditja e tyre mund të reflektojë vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Ai është tani Sovran i të dy mbretërive.

Kjo e vërtetë formon arsyen teologjike pse të krishterët nuk duhet të jetojnë për veten, por edhe për besimtarët e tjerë. Ata nuk i përkasin vetes; ata janë blerë me një çmim. Ata janë shërbëtorë të Jezusit, që vdiq për mëkatit e tyre në mënyrë që ata të mos jenë më skllëvër të mëkatit, por të Perëndisë (krh. Romakëve 6). Besimtarët duhet të imitojnë jetën e Jezusit që karakterizohej nga shërbimi me dashuri duke vdekur ndaj dëshirave të tyre që rrotullohen rreth vetes (krh. II Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; I Gjoni 3:16).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:10-12

¹⁰Por ti, pse e gjykon vëllanë tënd? Ose ti përsëri, pse e shikon vëllanë tënd me përbuzje? Sepse ne të gjithë do të qëndrojmë përpara fronit të gjykimit të Perëndisë. ¹¹Sepse është shkruar, “ASHTU SIÇ UNË JETOJ, THOTË ZOTI, ÇDO GJU DO TË MË PËRULET DHE ÇDO GJUHË DO T’I JAPË LAVDËRIM PERËNDISË.” ¹²Kështu pra, secili nga ne do t’i japë llogari për vete Perëndisë.

14:10 “Por ti” Kjo është nxjerrë përpara për theksim.

■ Të dy pyetjet e v. 10 janë fokusi i vv. 1-12. Të dy grupet që u referohet në v. 3 kontrastohen përsëri. Një grup “grykon,” grupi tjetër shikon “me përbuzje.” Të dy qëndrimet janë të papërshtatshëm për “skllëvërit!” Zoti i tyre, Jezu Krishti, është i Vetmi që ka të drejtën të “kritikojë” ose “të përbuzë.” Nëse besimtarët veprojnë si gjykatës (1) uzurpojnë vendin e Perëndisë dhe (2) gjykojnë në mënyrë të parakohshme dhe të paplotë.

■ **“ne të gjithë do të qëndrojmë përpara fronit të gjykimit të Perëndisë”** Kjo e vërtetë është shprehur edhe në II Kor. 5:10. Besimtarët do t’i japin llogari Zotit për mënyrën si e kanë trajtuar njëri-tjetrin. Jezusi do të veprojë si Gjykatës hyjnor (krh. Mat. 25:31-46).

NKJV e ka “fronit të gjykimit të Krishtit.” Dorëshkrimet greke që mbështesin KJV janë korrektorët e parë të dorëshkrimeve të lashta uncialle greke 2 \times , dhe C2. *Theos* është në MSS κ , B, C, D, F dhe G. Kopistët ndoshta e ndryshuan tekstin në greqisht për t’u konformuar me II Kor. 5:10. Është gjithashtu e mundur që kopistët e ndryshuan këtë varg për të kundërshtuar një pikëpamje të hershme mbi Krishtin të quajtur “adoptivizëm.” Ka disa variante tekstuale që duket se janë bërë për ta bërë tekstin më ortodoks (krh. Bart D. Ehrman’s *The Orthodox Corruption of Scripture, (Korruptimi ortodoks i Shkrimeve)* botuar nga Oxford University Press, 1993), fq. 90-91. UBS⁴ i jep *Theos* një vlerësim “B” (pothuaj i sigurt).

14:11 “Sepse është shkruar” Kjo është E KRYER PËSORE DËFTORE. Kjo ishte një idiomë e specializuar hebraike që përdorej për të përshkruar citime të frymëzuara nga DHV. Ky është një aluzion ndaj Isa. 45:23, që është cituar edhe në Fil. 2:10-11.

■ **“Ashtu siç unë jetoj”** Kjo është një formulë betimi që është lojë fjalësh mbi emrin besëlidhor të Perëndisë, YHWH, e cila është një formë e FOLJES hebraike “jam” (krh. Eks. 3:14). Ai është i vetmi Perëndi i gjallë dhe që jeton përgjithmonë. Prandaj Ai po betohet për vetë ekzistencën e Tij. Shih Temën e Veçantë: Emrat për Hyjninë të 9:29.

14:12 “Kështu pra, secili nga ne do t’i japë llogari për vete Perëndisë” Të krishterët do të gjykoohen (krh. II Kor. 5:10), dhe ata që kritikojnë vëllezërit do të jenë pjesë e kësaj eksperience. Disa dorëshkrime greke nuk e kanë “Perëndisë.” Ajo nënkuptohet nga konteksti. Ky variant mund të jetë ndikuar nga varianti në v. 10. UBS⁴ e vlerëson përfshirjen e “Perëndisë” (d.m.th., MSS κ , A, C, D) me “C” (e vështirë për ta përcaktuar).

TË DHËNA KONTEKSTUALE MBI ROMAKËVE 14:13-23

- A. Tema se si duhet ta trajtojnë të krishterët njëri-tjetrin filloi në vv. 1-12. Ajo bazohet në të vërtetën që ata duhet t’i pranojnë plotësisht të gjithë llojet e të krishterëve sepse Krishti, që është Zoti dhe Gjykatësi i tyre i pranon plotësisht të dy grupet. Shpesh gjërat shpirtërore që janë të rëndësishme për njërin grup për shkak të së kaluarës, personalitetit, prindërve, preferencave personale, përjetimeve të tyre, etj., nuk janë të rëndësishme për Perëndinë.
- B. Ky seksion i dytë i diskutimit të lirisë dhe përgjegjësisë së krishterë e zhvillon temën nga një këndvështrim tjetër. Në këta vargje është dashuria e besimtarit për Perëndinë, në Krishtin, që e motivon atë të dojë të krishterët e tjerë. Ashtu siç Jezusi e dha jetën e Tij për besimtarët, edhe ata duhet ta dorëzojnë lirinë e tyre për ata (d.m.th., besimtarët e tjerë) për të cilët Ai vdiq (krh. II Kor. 5:13-14; I Gjoni 3:16). Ky theks mbi dashurinë si motivi themelor për jetën e krishterë shihet edhe në 13:8-10 në marrëdhëniet e besimtarit me jobesimtarët.
- C. Disa të krishterë e kanë shumë të vështirë ta pranojnë të vërtetën që të gjitha gjërat në botën fizike janë të pastra. Shpesh madje edhe besimtarët ia hedhin fajin për mëkatin “gjërave” në vend të vetes së tyre (p.sh., alkoolin e quajnë “pija e demonëve”). Pali e thotë në mënyrë të përsëritur se të gjitha gjërat janë të pastra (krh. 14:14,20; I Kor. 6:12; 10:25-26; I Tim. 4:4; Titit 1:15). Thëniet e tij ndjekin mësimin e Jezusit në lidhje me ushqimin te Marku 7:18-23. Ushqimi i pastër dhe i papastër u përdor si ilustrim për Pjetrin në lidhje me pranimin nga Perëndia të Kornelit te Veprat 10:15.

- D. Ky seksion i drejtohet së pari “vëllait më të fortë.” Pali e pranon gjysmë të vërtetën e thënies se “të gjitha gjërat janë të pastra,” por shton se të gjitha gjërat nuk e ndërtojnë familjen e Perëndisë (krh. I Kor. 6:12; 10:23). Liria e vëllait të fortë mund të shkatërrojë të krishterë të tjerë. Besimtarët janë rojtarët e bashkëbesimtarëve të tyre, përmes Krishtit dhe për Krishtin.
- E. Është shumë interesante që Pali nuk e thotë dhe as e nënkupton që “vëllai më i dobët” është në një proces shpirtëror që çon në bërjen “vëlla i fortë.” I gjithë ky diskutim nuk i adresohet rritjes në hir, por përparësisë së dashurisë kur ka dallime në të kuptuarit e gjërave midis të krishterëve. Përfshirja e besimtarëve në një nga të dy grupet bazohet më shumë në llojin e personalitetit, në edukimin fetar dhe përvojat personale sesa në “të drejtën” ose “të gabuarën.” Detyra e besimtarit nuk është të ndryshojë të tjerët, por të dojë dhe të respektojë grupin tjetër. Ajo është një çështje e zemrës, jo e mendjes. Perëndia do, pranon dhe e dha Birin e Tij për gjithë njerëzimin, dhe për të dy grupet.

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 14:13-23

¹³Prandaj, le të mos e gjykojmë më njëri-tjetrin, por më tepër të vendosim këtë—të mos i vëmë përpara pengesë ose gur pengimi vëllait. ¹⁴Unë e di dhe jam i bindur në Zotin Jezus që asgjë nuk është e papastër në vetvete; por për atë që mendon se diçka është e papastër, për të është e papastër. ¹⁵Sepse nëse për shkak të ushqimit tënd vëllai yt lëndohet, ti nuk po ecën më sipas dashurisë. Mos e shkatërro me ushqimin tënd atë për të cilin Krishti vdiq. ¹⁶Prandaj, mos lejo që ajo që për ty është një gjë e mirë të përflitet si e keqe; ¹⁷sepse mbretëria e Perëndisë nuk është të ngrënët dhe të pirët, por drejtësia dhe paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë. ¹⁸Sepse ai që i shërben Krishtit në këtë mënyrë është i pranueshëm për Perëndinë dhe i miratuar nga njerëzit. ¹⁹Prandaj le të ndjekim gjërat që ndihmojnë për paqe dhe për ndërtimin e njëri-tjetrit. ²⁰Mos e shkatërro punën e Perëndisë për hir të ushqimit. Të gjitha gjërat në të vërtetë janë të pastra, por ato janë të këqija për njeriun që ha dhe pengon dikë. ²¹Është mirë të mos hash mish apo të pish verë, apo të bësh ndonjë gjë me anë të së cilës vëllai yt pengohet. ²²Besimin që ke, kije si bindjen tënde përpara Perëndisë. I lumtur është ai që nuk e dënon veten në atë që miraton. ²³Por ai që dyshon është i dënuar nëse ha, sepse e ngrëna e tij nuk është nga besimi; dhe çfarëdo gjëje që nuk është nga besimi është mëkat.

14:13 “le të mos e gjykojmë më njëri-tjetrin” Kjo është E TASHME VEPRORE LIDHORE me PJESËZËN MOHORE që nënkupton ndalimin e një veprimi që është tashmë në proces. Ky nuk është paralajmërim, por ndalim. Kjo është shumë e ngjashme me v. 16. Termi “gjykoj” është përdorur 5 herë nga Pali në vv. 1-12 dhe tani edhe katër herë të tjera në vv. 13-23.

TEMË E VEÇANTË: A DUHET TA GJYKOJNË TË KRISHTERËT NJËRI-TJETRIN?

Kjo çështje duhet trajtuar në dy mënyra.

1. Besimtarët paralajmërohen që të mos gjykojnë njëri-tjetrin (shih Mat. 7:1-5; Luka 6:37, 42; Rom. 2:1-11; 1 Tim. 3:1-13; dhe 1 Gjonit 4:1-6)
2. Besimtarët nxiten që të vlerësojnë drejtuesit (shih Mat. 7:6, 15-16; 1 Kor. 14:29; 1 Thes. 5:21; 1 Tim. 3:1-13; dhe 1 Gjonit 4:1-6)

Na nevojiten disa kriterë për vlerësimin e drejtë.

1. vlerësimi duhet kryer me qëllim afirmimin (shih 1 Gjonit 4:1 – “sprova” që synon aprovimin)
2. vlerësimi duhet kryer me përlësi dhe butësi (shih Gal. 6:1)
3. vlerësimi nuk duhet të përqendrohet në çështje preferencash personale (shih Rom. 14:1-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33)
4. vlerësimi duhet të identifikojë ata drejtues që nuk “preken nga kritikata” brenda kishës, apo nga komuniteti (shih 1 Timoteut 3).

☐ **“të mos i vëmë përpara pengesë ose gur pengimi vëllait”** Kjo është E TASHME VEPRORE PASKAJORE me PJESËZËN MOHORE që nënkupton ndalimin e një veprimi që është tashmë në proces. E njëjta e vërtetë është thënë edhe në v. 21 dhe I Kor. 8:9.

Termi “pengesë” i referohej diçkaje në rrugë që e bën dikë të pengohet. Termi “gur pengimi” ishte fjalë për fjalë një mekanizëm që shkruhe çarkun për të kapur një kafshë.

Krishtërimi ka një aspekt kolektiv. Ne jemi miqtë, inkurajuesit dhe rojtarët e bashkëbesimtarëve tanë. Besimi është familje!

14:14

NASB	“E di dhe jam i bindur në Zotin Jezus”
NKJV	“E di dhe jam i bindur nga Zoti Jezus”
NRSV	“E di dhe më është mbushur mendja në Zotin Jezus”
TEV	“Bashkimi im me Zotin Jezus më bën të jem i sigurt”
NJB	“Tani jam krejtësisht në dijëni, patjetër, dhe flas për Zotin Jezus,”

Kjo është një formë E KRYER VEPRORE e *oida*, që përdorej në kuptimin e KOHËS SË TASHME bashkë me një të KRYER PËSORE DËFTORE. Fjalë për fjalë ka kuptimin, “Unë vazhdoj ta di dhe kam qenë dhe vazhdoj të jem i bindur.” Ky është një ripohim i të vërtetës në vv. 5b dhe 22-23. Besimtarët i kuptojnë gjërat shpirtërore për shkak të marrëdhënies së tyre me Jezusin përmes Frymës së Shenjtë. Ata duhet të jetojnë nën dritën që kanë.

☐ **“që asgjë nuk është e papastër në vetvete”** Po kjo e vërtetë është ilustruar në Veprat 10:9-16. Nuk janë sendet të këqij, janë njerëzit të këqij. Asgjë në krijim nuk është e keqe në vetvete (krh. v. 20; Mark 7:18-23; I Kor. 10:25-26; I Tim. 4:4 dhe Titit 1:15)!

☐ **“por për atë që mendon se diçka është e papastër, për të është e papastër”** Kjo do të thotë e papastër në kuptimin fetar. Besimtarët duhet t’i vlerësojnë veprimet e tyre me anë të ndërgjegjes (krh. vv. 5,22-23). Edhe nëse janë të keqinformuar në lidhje me një çështje apo veprim, ata duhet të ecin në dritën që kanë përpara Perëndisë. Ata, gjithashtu, nuk duhet t’i gjykojnë besimtarët e tjerë në bazë të dritës së tyre, veçanërisht në fushat jo të qarta (krh. 14:1,3,4,10,13).

14:15 “Sepse nëse për shkak të ushqimit tënd vëllai yt lëndohet” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohet si e vërtetë nga këndvështrimi i autorit apo për qëllimet e tij letrare. Mënyra jonë e jetesës duhet të diktohet nga dashuria, jo të drejtat; nga përgjegjshmëria, jo liria.

Kjo lidhet ose me (1) ligjet hebraike të ushqimit (krh. Lev. 11) ose (2) me mishin e flijuar idhujve (krh. I Kor. 8-10). Vargu 20 e shpreh këtë të vërtetë shumë qartë.

☐ **“ti nuk po ecën më sipas dashurisë”** Ky shpesh është quajtur “ligji i lirisë” (krh. Jakobi 1:25; 3:12), “ligji mbretëror” (krh. Jakobi 2:8), ose “ligji i Krishtit” (krh. Gal. 6:2). Edhe në Besëlidhjen e Re ka përgjegjësi dhe udhëzime!

☐

NASB, NKJV	“Mos e shkatërro me ushqimin tënd atë për të cilin Krishti vdiq”
NRSV	“Mos lejo që ajo që ha të shkaktojë shkatërrimin e dikujt për të cilin Krishti vdiq”
TEV	“Mos lër që ushqimi që ha të shkatërrojë personin për të cilin Krishti vdiq”
NJB	“Ti patjetër që nuk je i lirë të hash çfarë të duash, nëse kjo do të thotë rrëzim për dikë për të cilin Krishti vdiq”

Kjo është URDHËRORE E TASHME me PJESËZËN MOHORE që nënkupton ndalimin e një veprimi që është tashmë në proces. Kjo është një frazë shumë e fortë. Liria e disa të krishterëve nuk duhet të shkaktojë shkatërrimin e disa të krishterëve të tjerë! Këtu nuk është fjala për humbjen e shpëtimit, por për humbjen e paqes, sigurisë dhe shërbesës efektive. Shih F. F. Bruce, *Answers To Questions, (Përgjigje ndaj pyetjeve)* fq. 88-89.

Termi “shkatërroj” është fjala greke *lupeō*, që do të thotë “të shkaktosh hidhërim, trishtim, ose dhimbje” (e njëjta gjë në LXX). Pali e përdor këtë fjalë më së shumti në II Korintasve (krh. 2:2,4,5; 6:10; 7:8,9,11). Shkatërroj është një përkthim shumë i fortë. Kjo fjalë nuk i referohet humbjes së shpëtimit, por bindjes që vjen nga Fryma e

Shenjtë kur dikush shkel bindjet e veta personale. Nëse veprimet e besimtarit nuk rrjedhin nga besimi, ata janë mëkat (krh. v. 23).

14:16

NASB

“mos lejo që ajo që për ty është një gjë e mirë të përflitet si e keqe”

NKJV, NRSV

“mos lejo që e mira jote të përflitet si e keqe”

TEV

“mos lejo që ajo që ti e konsideron si të mirë të marrë një emër të keq”

NJB

“nuk duhet ta komprometoni privilegjin tuaj”

Kjo është URDHËRORE E TASHME PËSORE me PJESËZËN MOHORE që nënkupton ndalimin e një veprimi që është tashmë në proces. Liria mund të kthehet lehtë në liri për të mëkatuar!

Kjo “gjë e mirë” në këtë varg i referohet veprimeve të besimtarit të fortë. Nëse një i krishterë i fortë vepron mbi bazën e lirisë së tij/saj në mënyrë të tillë që besimtarët e dobët ndikohen negativisht dhe dëmtohen shpirtërisht, “gjëja e mirë” bëhet një mundësi për të ligun!

Ky varg duket se e ndryshon fokusin nga mënyra si e trajtojnë të krishterët njëri-tjetrin në një shqetësim të mundshëm në lidhje me jobesimtarët (krh. v. 18b). FOLJA është nga fjala “blasfemi” (e folur) që përdoret zakonisht për jobesimtarët.

14:17 “mbretëria e Perëndisë” Ky është përdorimi i vetëm i kësaj fraze te Romakëve. Ajo ishte një temë e shpeshtë për Jezusin. Ajo është një realitet aktual, po aq sa edhe diçka që do të përmbushet në të ardhmen (Mat. 6:10).

Jeta kolektive e trupit të Krishtit është më e çmuar sesa ushtrimi i lirive personale! Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: MBRETËRIA E PERËNDISË

Në DhV, YHWH mendohej si Mbreti i Izraelit (shih 1 Sam. 8:7; Psa. 10:16; 24:7-9; 29:10; 44:4; 89:18; 95:3; Isa. 43:15; 44:6), ndërsa Mesia si mbreti ideal (shih Psa. 2:6; Isa. 9:6-7; 11:1-5). Me lindjen e Jezusit në Betlehem (6-4 para K.), mbretëria e Perëndisë hyri furishëm në historinë njerëzore me fuqi të re dhe me shpengim (besëlidhja e re, shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:27-36). Gjon Pagëzori shpalli afërsinë e mbretërisë (shih Mat. 3:2; Marku 1:15). Jezusi mësoi qartë se mbretëria ishte e pranishme në atë vetë dhe në mësimet e tij (shih Mat. 4:17, 23; 9:35; 10:7; 11:11-12; 12:28; 16:19; Marku 12:34; Luka 10:9, 11; 11:20; 12:31-32; 16:16; 17:21). Mirëpo mbretëria është edhe e ardhshme (shih Mat. 16:28; 24:14; 26:29; Marku 9:1; Luka 21:31; 22:16, 18).

Në paralelet sinoptike te Marku dhe Luka gjejmë frazën “mbretëria e Perëndisë”. Kjo temë e zakonshme e mësimet të Jezusit kishte të bënte me mbretërimin e tanishëm të Perëndisë në zemrat e njerëzve, që, një ditë, do të përmbushet mbi gjithë tokën. Kjo pasqyrohet në lutjen e Jezusit te Mat. 6:10. I shkruar për judenjtë, ungjilli i Mateut preferonte frazën që nuk përdorte emrin e Perëndisë (Mbretëria e qiejve), ndërsa Marku dhe Luka, që iu shkruan johebrenjve, përdorën termin e zakonshëm, duke përdorur emrin e hyjnisë.

Kjo është një frazë shumë kyçe në ungjijtë sinoptikë. Predikimi i parë dhe i fundit i Jezusit, si dhe shumica e shëmbëlltyrave të tij, trajtuan këtë temë. Ajo flet për mbretërimin e Perëndisë në zemrat e njerëzve tani! Është e habitshme që Gjoni e përdor këtë frazë vetëm dy herë (dhe asnjëherë në shëmbëlltyrat e Jezusit). Në ungjillin e Gjonit, metaforë kyçe është “jeta e përjetshme”.

Tensioni në këtë frazë shkaktohet nga dy ardhjet e Krishtit. DhV përqendrohej vetëm te një ardhje e Mesisë së Perëndisë – një ardhje ushtarake, gjykuese dhe e lavdishme – por DhR tregon se, herën e parë, ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaisë 53 dhe si mbreti i përulur i Zak. 9:9. Dy epokat judaike, epoka e ligësisë dhe epoka e re e drejtësisë, mbivendosen. Tani, Jezusi mbretëron në zemrat e besimtarëve, por, një ditë, do të mbretërojë mbi gjithë krijimin. Ai do të vijë siç paratha DhV! Besimtarët jetojnë në periudhën “tashmë, por ende jo” të mbretërisë së Perëndisë (shih Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 131-134).

■ **“por drejtësia dhe paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë”** Është Fryma që ua jep këto cilësi besimtarëve individualë dhe komunitetit të besimit. Këto janë karakteristikat e familjes së Perëndisë, të jashtme dhe të brendshme.

Termi “drejtësi” është përdorur këtu nga Pali në një kuptim të specializuar. Shih Temën e Veçantë në 1:17. Zakonisht për Palin kjo fjalë përshkruan drejtësinë e veshur/të atribuuar, një deklaratë ligjore nga Perëndia për faljen e besimtarit dhe për pozicionin e tij në Krishtin (krh. 3:21-31; 4). Por njerëzit mëkatarë nuk mjafton vetëm të llogariten të drejtë; ata duhet të bëhen të drejtë. Drejtësia është edhe dhuratë, edhe synim, DËFTORE dhe URDHËRORE, një akt besimi dhe një jetë besimi! Shih Temën e Veçantë në 6:4.

14:18 Besimtarët që i vetë-kufizojnë liritë e tyre për hir të besimtarëve më të dobët i bëjnë shërbim Vetë Krishtit. Nuk ka mënyrë më të fortë për të pohuar dashurinë tonë për Jezusin sesa të duam, të kujdesemi dhe të mbrojmë ata për të cilët Ai vdiq.

▣ **“i miratuar nga njerëzit”** Kjo mund të jetë një mënyrë për të pohuar që dashuria e të krishterëve për njëri-tjetrin mund të hapë dyert e shërbesës dhe dëshmisë në komunitetin e jobesimtarëve (krh. v. 16; II Kor. 8:21; I Pjet. 2:12). Mënyra si e trajtojmë njëri-tjetrin brenda komunitetit të besimit është një dëshmi e fuqishme, ose pozitive, ose negative.

14:19 “le të ndjekim” Ky term, *diōkō*, një idiomë e DHV e zakonshme në Septuagintë dhe gjithashtu e zakonshme në shkrimet e Palit, do të thotë “të ndjekësh me zell” ose “të përpiqesh me zell për të fituar diçka.” Pali e përdor këtë fjalë te Rom. 9:30,31; 12:13; dhe këtu në kuptimin “i bie pas,” por në 12:14 për ata që i përndjekin besimtarët (krh. I Kor. 4:12; madje edhe atë, 15:9; II Kor. 4:9; Gal. 1:13,23; Fil. 3:6).

Kjo është ose E TASHME VEPRORE DËFTORE (MSS X, A, B, F, G, L & P) ose E TASHME VEPRORE LIDHORE (MSS C, D) e përdorur në kuptimin e një URDHËROREJE. UBS⁴ vendos LIDHOREN në tekstin e vet, por i jep një vlerësim “D” (me shumë vështirësi).

Vini re gjërat që duhet të ndjekë i krishteri.

1. mikpritjen, 12:13
2. gjërat që shërbejnë për paqe dhe për ndërtimin e njëri-tjetrit, 14:19
3. dashurinë, I Kor. 14:1
4. ngjashmërinë me Krishtin, Fil. 3:12,14
5. atë që është e mirë për njëri-tjetrin dhe për të gjithë njerëzit, I Thes. 5:15
6. drejtësinë, perëndishmërinë, besimin, dashurinë, këmbënguljen, dhe butësinë, I Tim. 6:11
7. drejtësinë, besimin, dashurinë dhe paqen, me ata që e thërrasin Zotin nga një zemër e pastër, II Tim. 2:22

▣ **“për paqe dhe për ndërtimin e njëri-tjetrit”** Ky duhet të jetë synimi i besimtarit në të gjitha gjërat (krh. Ps. 34:14; Heb. 12:14). Liria personale dhe të kuptuarit tonë teologjik duhet të çojnë në stabilitetin dhe rritjen e trupit të Krishtit (krh. 15:2; I Kor. 6:12; 14:26; Efe. 4:12). Shih Temën e Veçantë: Ndërtoj në 15:2.

14:20 “Mos e shkatërro punën e Perëndisë” Kjo është E TASHME VEPRORE URDHËRORE me PJESËZËN MOHORE që zakonisht ka kuptimin të ndalosh një veprim që është duke ndodhur. Kjo është një FOLJE E PËRBËRË e fortë (*kata + luō*). Është përdorur vetëm tre herë në shkrimet e Palit (krh. II Kor. 5:1 për vdekjen dhe Gal. 2:18 në kuptimin këtu, shkatërroj). Ka një lojë fjalësh midis “ndërtoj” në v. 19 dhe kësaj fjale, që fjalë për fjalë do të thotë “rrezoj/prish.” Të dyja janë metafora ndërtimi.

Cila është “puna e Perëndisë” në këtë kontekst? Nuk mund të jetë fjala për pjekurinë, por për veprimtarinë e Frymës në jetën e besimtarëve “të dobët.” Askund në këtë kontekst ose I Korintasve 8-10 Pali nuk thotë që njëri grup duhet ta ndihmojë grupin tjetër të bjerë dakord ose të ndryshojë!

▣ **“të gjitha gjërat janë të pastra”** Shih shënimin në v. 14.

▣

NASB	“por ato janë të këqija për njeriun që ha dhe pengon dikë”
NKJV	“por është e keqe për njeriun që ha duke penguar”
NRSV	“por është e gabuar që ti t’i bësh të tjerët të rrëzohen me atë që ha”
TEV	“por është e gabuar të hash ndonjë gjë që do të bëjë që dikush tjetër të bjerë në mëkat”
NJB	“por bëhet e keqe nëse duke e ngrënë atë ti bën që dikush tjetër të largohet nga besimi”

Ky varg është e vërteta qendrore e këtij kapitulli (krh. I Kor. 10:25-26; Titit 1:15).

Kjo i referohet mishit të ofruar një idhulli (krh. I Korintasve 8-10). Mishi nuk është as i mirë, as i keq, por nëse besimtar i dobët, i cili mendon se kjo gjë nuk është e mirë, sheh një tjetër të krishterë që ha prej tij, dhe ha edhe ai, ajo gjë që është moralisht asnjëse bëhet e keqe, sepse ai apo ajo po bën diçka që mendon se është e gabuar në sytë e Perëndisë (krh. v. 23).

Pjesa më e madhe e përkthimeve në anglisht e lidhin këtë fjali të varur me “vëllanë më të fortë” dmth që për shkak se ai ha, besimtari më i dobët ndikohet. Përkthimi katolik i Biblës së Re Amerikane (New American Bible) jep opsionin tjetër dhe e lidh fjalinë e varur me “vëllanë më të dobët,” “por është e gabuar që një njeri të hajë kur ushqimi dhunon ndërgjegjen e tij.” Në kontekst opsioni i parë duket më i mirë, por dykuptimësia mund të jetë e qëllimshme dhe t’i referohet të dyve ashtu si te vv. 22-23.

14:21 Kjo është një fjalë për “vëllezërit më të fortë.” Kjo është e vetmja bazë në Bibël për konceptin teologjik të “heqjes dorë totalisht” nga disa ushqime apo pije. Të krishterët e fortë duhet ta kufizojnë lirinë e tyre për hir të vëllezërve apo motrave të tyre të krishterë, dhe për hir të atyre jobesimtarëve që e kërkojnë Zotin me sinqeritet. Një pjesë e madhe e këtij vetë-kufizimi është kulturor, rajonal dhe/ose denominacional.

Këto janë dy AORISTE VEPRORE PASKAJORE me PJESËZËN MOHORE që nënkupton “mos e fillo një veprim.” Disa i kanë interpretuar këto AORISTE sikur aplikohen vetëm për disa raste (krh. I Korintasve 8-0). Patjetër që ngrënia dhe pirja nuk mund të ndalohen.

14:22

NASB “Besimin që ke, kije si bindjen tënde përpara Perëndisë. I lumtur është ai që nuk e dënon veten në atë që miraton.”

NKJV “A ke besim? Kije për vete përpara Perëndisë. I lumtur është ai që nuk e dënon veten në atë që miraton.”

NRSV “Besimin që ke, kije si bindjen tënde përpara Perëndisë. Të bekuar janë ata që nuk kanë arsye të dënojnë veten për shkak të asaj që miratojnë.”

TEV “Mbaj atë që beson në lidhje me këtë çështje, atëherë, midis vetes tënde dhe Perëndisë. Të lumtur janë ata që nuk ndihen fajtorë kur bëjnë diçka që gjykojnë se është e drejtë!”

NJB “Mbaje besimin tënd si midis teje dhe Perëndisë—dhe konsideroje me fat atë njeri që mund ta marrë vendimin pa shkuar kundër ndërgjegjes së tij.”

Ky është ripohimi i asaj që besimtarët duhet të jetojnë nën dritën e ndërgjegjes së tyre të udhëhequr nga Fryma dhe të informuar nga Bibla (krh. v. 5). Ata duhet të ecin nën dritën që kanë; por, jo në një mënyrë që keqpërdor besimin e bashkëbesimtarëve të tjerë. Vargu 22 lidhet me “vëllanë më të fortë,” kurse vargu 23 lidhet me “vëllanë më të dobët.” Vargu 22 fillon me një variant në dorëshkrime. Mund të jetë pyetje (NKJV) ose FJALI DËFTORE (NASB, NRSV, TEV, dhe JB).

■ **“miraton”** Shih Temën e Veçantë në 2:18.

14:23 “Por ai që dyshon” Kjo është PJESORE E TASHME JOVEPRORE. Kjo i referohet të krishterit tepër skrupuloz të v. 3.

■ **“është i dënuar”** Kjo është E KRYER PËSORE DËFTORE nga *kata + krinō*, që ka kuptimin

1. “duket fajtor për shkak të kontrastit” (krh. Harold K. Moulton, *The analytical Greek Lexicon Revised*, fq. 216)
2. “jo dënimi, por ndëshkimi që ndjek një vendim gjyqësor” (krh. Rom. 5:16,18; 8:1 [krh. Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek Testament*, fq. 328])

Këtu i referohet dhunimit të ndërgjegjes dhe dhimbjes që vjen nga bindja prej Frymës së Shenjtë.

■ **“nëse ha”** Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË TRETË.

■ **“dhe çfarëdo gjëje që nuk është nga besimi është mëkat”** Në fushat që në Bibël janë të paqarta, mëkati është dhunim i ndërgjegjes sonë, jo shkelje e ligjit. Ne duhet të ecim nën dritën që kemi—duke qenë gjithmonë të hapur për më shumë dritë nga Bibla dhe Fryma.

Besimtarët duhet t'i bazojnë veprimet e tyre mbi të kuptuarit e tyre të vullnetit të Perëndisë (kuptimi i fjalës "besim" në këtë kontekst). Është e mundur për besimtarët e pjekur të kenë pikëpamje të ndryshme mbi çështje biblike të diskutueshme dhe të dyja palët të jenë në vullnetin e Perëndisë.

■ Disa dorëshkrime në greqisht e kanë doksologjinë e 16:25-27 në fund të kapitullit 14. Disa e kanë në të dy vendet. Një dorëshkrim në papirus, P⁴⁶, e ka në fund të kapitullit 15. Ka gjashtë vende të ndryshme të kësaj doksologjie në traditën e dorëshkrimeve greke të Romakëve. Për një diskutim të plotë konsultoni, *A Textual Commentary of the Greek New Testament* nga Bruce M. Metzger, botuar nga United Bible Societies, fq. 533-536. Këtu kemi një përmbledhje të shkurtër të teorive.

1. Origeni tha që një heretik i hershëm në Romë, Marcioni, i hoqi dy kapitujt e fundit të Romakëve. Kjo do të shpjegonte doksologjinë në kapitullin 14.
2. Studiues të tjerë hamendësojnë që Pali shkroi një formë të Romakëve për ta dërguar në Romë, kapitujt 1-14, dhe më vonë pa nevojën për ta dërguar të njëjtën letër në Efes; kapitujt 1-16. Lista e gjatë e përshëndetjeve personale (kapitulli 16) reflekton Efesin, jo Romën.
3. Përshëndetjet e kapitullit 16 ishin për besimtarët rrugës për në Romë, sepse Akuila dhe Priskila janë në Efes dhe nuk na thuhet asnjëherë që u kthyen në Romë.
4. Doksologjia nuk ishte në origjinal, por u shtua më vonë nga kopistët për qëllime liturgjike në adhurimin publik.

M. R. Vincent, *Word Studies*, vol. 2, është interesant.

"Kundër këtyre teorive është fakti kokëfortë që nga dorëshkrimet e njohura ekzistuese të Palit (rreth treqind) të gjithë dorëshkrimet e mbledhura deri tani, duke përfshirë të gjithë më të rëndësishmit, japin këta kapituj në këtë renditje, me përjashtim të doksologjisë" (fq. 750).

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Përshkruaj vëllanë "më të dobët." A nënkupton Pali që ata janë të papjekur?
2. Si lidhet liria e krishterë me përgjegjësinë e krishterë?
3. A është gjithçka në natyrë "e pastër" ose moralisht asnjëherë (vv. 14, 20)?
4. Pse ishte çështja e ushqimit kaq e rëndësishme në Korint (krh. I Kor. 8, 10)? Kujtoni që Pali e shkroi Romakëve nga Korinti.
5. Shpjegoni marrëdhënien midis njohurisë, lirisë dhe dashurisë në këtë kapitull.
6. Mbi çfarë duhet ta bazojmë miqësinë në kishë?
7. Mbi çfarë i bazojmë zgjedhjet dhe veprimet individuale?
8. Si i ndikojnë të tjerët veprimet tona? Çfarë kërkon kjo prej nesh?
9. Si e përcaktojmë etikën e duhur të krishterë?
10. A është e mundur që të krishterët e pjekur të mos bien dakord mbi një çështje dhe prapë të jenë të dy palët të pranuar nga Perëndia?

ROMAKËVE 15

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Kënaq të tjerët jo veten 15:1-6	Të mbajmë barrët e njëri-tjetrit 15:1-6	I forti duhet të mbajë të dobëtin 15:1-6	Kënaqni të tjerët, jo veten 15:1-6	(14:22-15:6)
Ungjilli si për hebrenjtë, edhe për johebrenjtë 15:7-13	Përlëvdoni Perëndinë së bashku 15:7-13		Ungjilli për johebrenjtë 15:7-12 15:13	15:7-12 15:13
Caktimi i Palit si misionar 15:14-21	Nga Jerusalemi e deri në Iliri 15:14-21	Shënime personale 15:14-21	Arsyeja pse Pali shkroi me kaq guxim 15:14-21	Shërbesa e Palit 15:14-16 15:17-21
Plani i Palit për të vizituar Romën 15:22-29	Plani për të vizituar Romën 15:22-33	15:22-29	Plani i Palit për të vizituar Romën 15:22-29	Planet e Palit 15:22-26 15:27-29
15:30-33		15:30-33	15:30-33	15:30-33

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

A.Paragrafi i parë

B.Paragrafi i dytë

C.Paragrafi i tretë

D.Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 1-13

A. Diskutimi në lidhje me lirinë dhe përgjegjësinë e krishterë vazhdon në 15:1-13 nga kapitulli 14.

B. I gjithë argumenti i 14:1-15:13 mund të përvijohet në këtë mënyrë

1. pranoi njëri-tjetrit sepse Perëndia na pranon në Krishtin (krh. 14:1,3; 15:7)
2. mos e gjykoni njëri-tjetrit sepse Krishti është i vetmi Zot dhe Gjykatës i yni (krh. 14:3-12)
3. dashuria është më e rëndësishme sesa liria personale (krh. 14:13-23)

4. ndiqni shembullin e Krishtit dhe dorëzohini të drejtat tuaja për ndërtimin dhe të mirën e të tjerëve (krh. 15:1-13)

C. 15:5-6 reflekton qëllimin e trefishtë të gjithë kontekstit të 14:1-15:13

1. jetoni në harmoni me njëri-tjetrin
2. jetoni në përputhje me shembullin e Krishtit
3. me zemra dhe buzë në unitet ofrojini lavdërime të bashkuara Perëndisë

D. I njëjti tension midis lirisë personale dhe përgjegjësisë kolektive trajtohet në I Kor. 8-10.

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:1-6

¹Tani ne që jemi të fortë duhet të mbartim dobësitë e atyre pa forcë dhe jo *thjesht t'i pëlqejmë vetes*.
²Secili nga ne duhet t'i pëlqejë fqinjët të tij për të mirën e tij, për ndërtimin e tij. ³Sepse as Krishti nuk i pëlqeu Vetes së Tij; por siç është shkruar, "SHARJET E ATYRE QË TË SHANË RANË MBI MUA."
⁴Sepse çfarëdo që u shkrua në kohët më të hershme u shkrua për udhëzimin tonë, në mënyrë që përmes këmbënguljes dhe inkurajimit të Shkrimeve të kemi shpresë. ⁵Tani Perëndia që jep këmbëngulje dhe inkurajim ju dhëntë të jeni në një mendje me njëri-tjetrin sipas Krishtit Jezus, ⁶që me një mendje dhe një zë të përlëvdoni Perëndinë dhe Atin e Zotit tonë Jezus Krisht.

15:1

NASB	"Tani ne që jemi të fortë duhet të mbartim dobësitë e atyre pa forcë"
NKJV	"Ne atëherë që jemi të fortë duhet të durojmë skrupujt e të dobtëve,"
NRSV	"Ne që jemi të fortë duhet të durojmë dobësitë e të dobtëve"
TEV	"Ne që jemi të fortë në besim duhet të ndihmojmë të dobët të mbartin barrët e tyre"
NJB	"Ne që jemi të fortë kemi detyrë të tolerojmë dyshimet dhe shqetësimet e të dobtëve"

Këto janë dy PASKAJORE TË TASHME të përdorura në kuptimin e URDHËROREVE. Përmendja e të fortëve dhe të dobtëve tregon se kapitulli 15 e vazhdon diskutimin e filluar në 14:1. Kjo duket se reflekton tensionin brenda kishës së Romës, dhe të gjitha kishave, mbi mënyrën se si të krishterët i jetojnë jetët e tyre në

1. fusha që janë të paqarta në Bibël
2. kërkesat e DHV
3. reagimet ndaj çështjeve kuturore, që nuk janë morale

Një libër i mirë që ka qenë shumë ndihmues për mua në këtë fushë është Gordon Fee, *Gospel and Spirit*.

Për lexuesit e kohëve të sotme, etiketimi i dy këndvështrimeve si "të fortë" dhe "të dobët" është të paragjykoshet grupet. Ky nuk ishte qëllimi i Palit. Grupi i fortë ishte ai që ishte çliruar nga një jetë fetare e orientuar nga rregullat dhe ritualet. Marrëdhënia e tyre me Perëndinë nuk është e varur në fije të perit mbi kryerjen e disa detyrave apo shmangien e disa tabuve fetare. Edhe grupi tjetër ishte një grup besimtarësh plotësisht të krishterë, plotësisht të pranuar dhe plotësisht të përkushtuar. Megjithatë, ata e shikonin besimin e tyre përmes ideve fetare të përvojave të kaluara. Besimtarët hebrej prireshin të mbaheshin pas praktikave të Besëlidhjes së Vjetër të judaizmit. Paganët e kthyer në besim prireshin të ruanin disa nga idetë dhe praktikat e tyre të vjetra fetare (pagane). Por vini re që Pali nuk e quajti këtë mendësi midis besimtarëve "mëkat." Vetëm kur ata dhunonin ndërgjegjet e tyre kjo bëhej mëkat (krh. v. 23).

Termi *adunatos*, "pa forcë" (krh. Veprat 14:8) është i lidhur me termin *astheneō* (krh. 14:1,21; I Kor. 8:7,10,11,12; 9:22), që gjithashtu do të thotë "pa forcë."

Ky tekst nënkupton që të krishterët duhet të mos i tolerojnë të krishterët e tjerë me dhëmbë të shtrënguar, por me dashuri "të kujdesen për" dhe të "bashkëpunojnë me" njëri-tjetrin. Termi, "mbart" u përdor edhe për "mbartjen e kryqit" nga Jezusi te Gjoni 19:17 dhe Luka 14:27. Pali i dinte tensionet që mund të ndodhin midis njerëzve fetarë. Ai ishte trainuar nën Gamalielin, i cili ishte një rabin i shkollës liberale të Hilelit.

■ **"dhe jo thjesht t'i pëlqejmë vetes"** Kjo është një URDHËRORE E TASHME VEPRORE me PJESËZËN MOHORE që zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që është duke u kryer. Përqendrimi te vetja është një shenjë e sigurt e papjekurisë; ndjekja e shembullit të Krishtit (krh. v. 3; Fil. 2:1-11) është shenja e pjekurisë. Përsëri, kjo u

adresohet të fortëve (krh. 14:1,14,16,21,27). Kjo nuk do të thotë që ata kishin gjithë përgjegjësinë në mbajtjen e marrëdhënies. Pali u drejtohet edhe të dobtëve në 14:3, 20, 23; 15:5-6,7.

15:2 “Secili nga ne duhet t’i pëlqejë fqinjit të tij” Kjo është “fqinj” në kuptimin e vëllait të krishterë. Kjo nuk do të thotë kompromis me bindjet personale, por të mos u imponojmë të tjerëve preferencat apo opinionet tona në fushat e paqarta. Uniteti dhe rritja e trupit të Krishtit është kryesorja, jo liria personale (krh. I Kor. 9:19-23; 10:24-33; Efe. 4:1-16).



NASB	“për ndërtimin e tij”
NKJV	“që çon në ndërtim”
NRSV	“për qëllimin e mirë të ndërtimit të fqinjit”
TEV	“me qëllim që t’i ndërtojmë ata në besim”
NJB	“t’i ndihmojmë ata të bëhen të krishterë më të fortë”

Kjo është ideja madhore e kapitullit 14 (krh. 14:16,19). Ajo është gjithashtu një nga provat për dhuntitë frymërore që gjenden në I Kor. 10:23; 12:7; 14:26; Efe. 4:29.

Në këtë kontekst kuptimi është që besimtari më i fortë ta kufizojë lirinë e tij/saj me dashuri për qëllimin që të ndihmojë të krishterët e tjerë të rriten në besim. Joseph A. Fitzmyer dhe Raymond E. Brown, ed., *The Jerome Biblical Commentary*, vol. 2, kanë një koment interesant për këtë varg.

“Kjo frazë është menduar shpesh se ka kuptimin ‘të ndërtosh atë’ (fqinjin), duke iu referuar zhvillimit personal të fqinjit të të krishterit. Por duke patur parasysh që Pali shpesh e përdor metaforën e ndërtimit në letrat e tij në një kuptim kolektiv, fraza padyshim ka edhe këtu një kuptim shoqëror, kolektiv (krh. I Kor. 14:12; Efe. 4:12; Rom. 14:19)” (fq. 328).

TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ

Ky term *oikodomeō* dhe format e tij të tjera përdoren shpesh nga Pali. Fjalë për fjalë do të thotë “të ndërtosh një shtëpi” (krh. Mat. 7:24), por më vonë u përdor në mënyrë metaforike për:

1. trupin e Krishtit, kishën, I Kor. 3:9; Efe. 2:21; 4:16
2. ndërtimin e
 - a. vëllezërve të dobët, Rom. 15:1
 - b. fqinjëve, Rom. 15:2
 - c. njëri-tjetrit, Efe. 4:29; I Thes. 5:11
 - d. shenjtorëve për shërbesë, Efe. 4:11
3. ne ndërtojmë me anë të
 - a. dashurisë, I Kor. 8:1; Efe. 4:16
 - b. duke kufizuar liritë personale, I Kor. 10:23-24
 - c. duke shmangur hamendësimet, I Tim. 1:4
 - d. duke kufizuar folësit në shërbesat e adhurimit (këngëtarët, mësuesit, profetët, ata që flasin në gjuhë të tjera dhe interpretuesit), I Kor. 14:3-4,12
4. të gjitha gjërat duhet të ndërtojnë
 - a. autoriteti i Palit, II Kor. 10:8; 12:19; 13:10
 - b. deklaratat përmbljedhëse të Rom. 14:19 dhe I Kor. 14:26

15:3 “Sepse edhe Krishti” Krishti është modeli dhe shembulli ynë. Kjo e vërtetë theksohet edhe në v. 5; Fil. 2:1-11; I Pjet. 2:21; I Gjoni 3:16.

■ **“është shkruar”** Kjo është E TASHME PËSORE DËFTORE, që është një idiomë për Shkrimin e DHV. Ky është një citim nga Psalmi 69:9. Duke iu referuar shembullit të Krishtit (nuk i pëlqeu Vetes, krh. Fil. 2:5-8) dhe një citimi nga DHV, Pali përdor dy burimet më të rëndësishme të autoritetit në kishën e hershme (krh. Newman and Nida, *A Translator’s Handbook on Paul’s Letter to the Romans*, fq. 271). Altruizmi i Krishtit ndërsa mbarti mëkatin e gjithë botës është shembulli ynë (krh. I Gjoni 3:16).

Pali duket se i lidh bashkë

1. faktin që Jezusi mbarti sharjet si Mesia

2. faktin që Pali mbarti sharjet për hir të ungjillit

Ka një çmim për të paguar kur i shërben Perëndisë në një botë të rënë.

1. Jezusi i hedhur poshtë dhe i kryqëzuar
2. Pali tregon për refuzimin dhe për përndjekjen e tij te II Kor. 4:7-12; 6:3-10; 11:23-33. Edhe Palit, në fund iu pre koka.

15:4 “Sepse çfarëdo që u shkrua në kohët më të hershme u shkrua për udhëzimin tonë” DHV u shkrua edhe për besimtarët e DHR (krh. Rom. 4:23-24; 15:4; I Kor. 9:10; 10:6,11). Ajo është aktuale për besimtarët e besëlidhjes së re (krh. II Tim. 2:15; 3:16-17). Ka një vazhdimësi, por edhe një mosvazhdimësi midis Dhiatës së Vjetër dhe Asaj të Re.

▣ **“në mënyrë që përmes këmbënguljes dhe inkurajimit të Shkrimeve”** Vini re se si kombinohen e vërteta e Fjalës së Perëndisë dhe përgjigjia e besimtarëve ndaj saj në mënyrën se si jetojnë. Besimi dhe praktika janë të lidhura së bashku (krh. v. 5). Ato rezultojnë në siguri në jetë, në vdekje dhe në shpresën e premtuar të kthimit të Krishtit.

▣ **“të kemi shpresë”** Kjo është E TASHME VEPRORE LIDHORE, që nënkupton se shpresa jonë është e varur në veprimet e përmendura më parë në v. 4. Në DHR “shpresa” shpesh lidhet me Ardhjen e Dytë kur shpëtimi ynë do të përfundohet (krh. Rom. 8:30; I Gjoni 3:2). Ky term grek nuk e ka nuancën e pasigurisë siç e ka në anglisht (dhe në shqip). Ardhja e Dytë është një ngjarje e sigurt me një element kohor të paqartë.

Pali e përdor këtë term shpesh në disa kuptime të ndryshme, por të lidhur me njëri-tjetrin. Shpesh ai lidhet me përfundimin e besimit të besimtarit. Kjo mund të shprehet si lavdia, jeta e përjetshme, shpëtimi përfundimtar, Ardhja e Dytë, etj. Përbushja është e sigurt, por elementi kohë është i ardhshëm dhe i panjohur. Ai shpesh shoqërohet me “besim” dhe “dashuri” (krh. I Kor. 13:13; I Thes. 1:3; II Thes. 2:16). Më poshtë është një listë e pjesshme e disa prej përdorimeve nga ana e Palit:

1. Ardhja e Dytë, Gal. 5:5; Efe. 1:18; 4:4; Titit 2:13
2. Jezusi është shpresa jonë, I Tim. 1:1
3. Besimi në ungjillin, Kol. 1:23
4. Shpëtimi përfundimtar, Kol. 1:5; I Thes. 4:13; 5:8
5. Lavdia e Perëndisë, Rom. 5:2, II Kor. 3:12; Kol. 1:27
6. Siguria e shpëtimit, I Thes. 5:8
7. Jeta e përjetshme, Titit 1:2; 3:7
8. Shpengimi i gjithë krijimit, Rom. 8:20
9. Besimi, Rom. 8:23-25, 15:4
10. Titulli i Perëndisë, Rom. 15:13
11. Dëshira e Palit për besimtarët, II Kor. 1:7

15:5 “Perëndia. . . ju dhëntë” Kjo është një AORISTE e rrallë OPTATIVE, që shpreh një dëshirë ose lutje. Lutja e Palit, vv. 5-6, kishte dy kërkesa.

1. Të jeni në një mendje (krh. 12:16; II Kor. 13:11; Fil. 2:2)
2. Të jeni në një zë në lavdërim (krh. vv. 6, 7,9)

▣ **“Perëndia që jep këmbëngulje dhe inkurajim”** Ky është pothuaj një titull përshkrues për Perëndinë (krh. 15:13; I Kor. 1:3). Këto karakteristika të Perëndisë vijnë tek besimtarët përmes Shkrimeve (krh. v. 4). Shih Temën e Veçantë: Nevoja për të këmbëngulur në 8:25.

15:6 “Perëndinë dhe Atin e Zotit tonë Jezus Krisht” Ky është titulli i plotë i Hyjnisë i DHR (krh. II Kor. 1:3; Efe. 1:3; Kol. 1:3; I Pjet. 1:3; vini re një titull të ngjashëm në 1:7). Ky nuk është Perëndia i domosdoshmërisë filozofike, por i zbulësës. Vini re të dy titujt e Perëndisë në lutjen e Palit te vv. 5-6.

1. Perëndia i këmbënguljes dhe inkurajimit
2. Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht

Shih Temat e Veçanta: Këmbëngulja në 8:25 dhe Atë në 1:7.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:7-13

⁷Prandaj, pranoni njëri-tjetrin, ashtu si edhe Krishti na pranoi për lavdinë e Perëndisë. ⁸Sepse unë them që Krishti është bërë shërbëtor i rrethprerjes për shkak të së vërtetës së Perëndisë për të konfirmuar premtimet e dhëna etërve, ⁹dhe që johebrenjtë të përlëvdojnë Perëndinë për meshirën e Tij; siç është shkruar, “PRANDAJ DO TË TË PËRLËVDOJ MIDIS JOHEBRENJVE, DHE DO T’I KËNDOJ EMRIT TËND.” ¹⁰Përsëri ai thotë, “GËZOHUNI O JOHEBRENJ ME POPULLIN E TIJ.” ¹¹Dhe përsëri, “LAVDËRONI ZOTIN TË GJITHË JU JOHEBRENJ, DHE LE TA LËVDOJNË TË GJITHË POPUJT.” ¹²Përsëri Isaia thotë, “DO TË VIJË RRËNJA E JESEUT DHE AI QË ÇOHET PËR TË SUNDUAR MBI JOHEBRENJTË, NË TË DO TË SHPRESOJNË JOHEBRENJTË.” ¹³Tani Perëndia i shpresës ju mbushtë me çdo gëzim e paqe në besim, që të teproni në shpresë me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë.

15:7

NASB, TEV “pranoni njëri-tjetrin”
 NKJV “prisni njëri-tjetrin”
 NRSV “mirëprisni njëri-tjetrin”
 NJB “trajtojeni njëri-tjetrin në të njëjtën mënyrë miqësore”

Kjo është E TASHME JOVEPRORE URDHËRORE. Besimtarët duhet të vazhdojnë ta pranojnë njëri-tjetrin sepse Krishti i pranoi! E njëjta e vërtetë gjendet në 14:1. Megjithatë, këtu ajo prezanton një seri pasazhesh të DHV në lidhje me pranimin nga Perëndia të johebrenjve (krh. vv. 9-12). Kjo mund të ketë reflektuar tensionin brenda kishës së Romës. Krishtërimi karakterizohet nga dhënia e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit (krh. 1:12; 12:5,10,16; 13:8; 14:13,19; 15:5,7,14; 16:16).

▣ **“ashtu si edhe Krishti na pranoi”** Kjo është një AORISTE JOVEPRORE DËFTORE. Këtu është motivi dhe shtysa e veprimeve të besimtarit ndaj të tjerëve (krh. 14:3). Në kapitullin 14 fokusi ishte mbi

1. Krishtin si Zot dhe Gjykatës, vv. 1-12
2. Krishtin si shembulli ynë i dashurisë vetë-dhënëse, vv. 13-23

Krishti na pranoi, ne duhet të pranojmë të tjerët!

▣ **“për lavdinë e Perëndisë”** Shih shënimin në 3:23.

15:8 **“Krishti është bërë shërbëtor i rrethprerjes”** Jezusi është përmbushja nga Perëndia e profecive të DHV (krh. Mat. 10:6; 15:24). Kjo ka mundësi t’i drejtohet tensionit në kishën e Romës midis hebrenjve besimtarë dhe johebrenjve besimtarë.

▣ NASB “për shkak të së vërtetës së Perëndisë për të konfirmuar premtimet e dhëna etërve”
 NKJV “për të vërtetën e Perëndisë, për të konfirmuar premtimet e bëra etërve”
 NRSV “për shkak të së vërtetës së Perëndisë me qëllim që ai të mund të konfirmojë premtimet e dhëna patriarkëve”
 TEV “për shkak të hebrenjve, për të treguar që Perëndia është besnik, për t’i realizuar premtimet ndaj paraardhësve të tyre”
 NJB “në mënyrë që Perëndia të mund t’i plotësonte me besnikëri premtimet e bëra ndaj patriarkëve”

Kjo ndoshta lidhet me premtimet besëlidhore të DHV të Perëndisë ndaj Izraelit (krh. 4:16). Megjithatë, kjo mund t’i referohet edhe premtimeve të Perëndisë për të shpenguar gjithë njerëzimin (krh. Zan. 3:15, 12:3, Eks. 19:5-6; Isa. 2:2-4; 56:7; 66:18-24). Misteri i ungjillit është që plani i Perëndisë ka qenë gjithmonë bashkimi i hebrenjve dhe johebrenjve përmes Krishtit (krh. Efe. 2:11-3:13).

Mesazhi i DHR është përmbushja e shpresave të DHV, jo diçka krejt e re. Misioni i madh i Krishtit ishte të (1) përmbushte ndaj Izraelit shpresën që i ishte premtuar dhe (2) të hapte derën ndaj johebrenjve (krh. Rom. 3:29-30; 9:30; 10:11-12,16-20; 11:25,32; 16:25; Efe. 2:11-3:21). Meqenëse Izraeli kishte dështuar në misionin e tij ungjillizues për ta bërë Perëndinë të njohur dhe për të tërhequr johebrenjtë në besim, Jezusi autorizon një Izrael të ri frymëror (krh. 9:6; Gal. 6:16) për të përmbushur këtë detyrë universale (krh. Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Gjoni 3:16; Veprat 1:8).

▣ **“konfirmuar”** Shih Temën e Veçantë në 4:16.

15:9-12 Kjo është një seri citimesh të DHV për të treguar që johebrenjtë kanë qenë gjithmonë pjesë e planit të Perëndisë (shih Temën e Veçantë: Anësitë ungjillore të Bobit në 1:5, krh. 10:16-20). Kjo është një seri citimesh të DHV nga

1. v. 9 – Ps. 18:49 or II Sam. 22:50
2. v. 10 – LiP 32:43
3. v. 11 – Ps. 117:1
4. v. 12 – Isa. 11:1,10

Vini re që ka një citim nga secila pjesë e kanonit hebraik: Ligji, Profetët dhe Shkrimet.

15:9 “të përlëvdojnë Perëndinë për mëshirën e Tij” Mëshira e Perëndisë është çelësi teologjik i paracaktimit të Romakëve (krh. 9:15,16,18,23) dhe i përfshirjes së johebrenjve (krh. 11:30,31,32; 15:9). Është mëshira e Perëndisë ajo që e shpëtoi Izraelin. Është mëshira e Perëndisë ajo që shpëton johebrenjtë që besojnë. Mekanizmi nuk është performanca njerëzore/veprat (krh. Romakëve 9), por karakteri i hirshëm, i pandryshueshëm i Perëndisë (krh. Eks. 34:6; Neh. 9:17; Ps. 103:8,4; Joeli 2:13) dhe premtimi i Mesias (krh. Isa. 11:1,10).

Është interesante që johebrenjtë “e përlëvdojnë” Perëndinë me anë të

1. rrëfimit/lavdërimit
2. të kënduarit

Kur një besimtar i këndon Perëndisë, ai po rrëfen besimin! Himnet, ashtu si kredot, janë në mënyrë e mirëqenë e rrëfimit të besimit (krh. 10:9-13).

15:13 “Perëndia i shpresës” Kjo ishte një doksologji përmbyllëse për njësinë letrare të filluar 14:1. Ky ishte një tjetër titull i mrekullueshëm për Hyjninë—Perëndia i shpresës.

15:13 “u mbushtë me çdo gëzim e paqe” Kjo është një AORISTE VEPRORE OPTATIVE, që tregon lutjen e Palit për besimtarët në Romë. Vini re praninë e “çdo/të gjithë” (krh. 5:1-2; 14:17).

▣

NASB, NKJV,

NRSV “në besim,”

TEV “me anë të besimit tuaj në Të”

NJB “në besimin tuaj”

Kjo është një PASKAJORE E TASHME VEPRORE. Ajo shpreh sigurinë e këmbënguljes me anë të besimit të vazhdueshëm në Krishtin, në fuqinë e Frymës së Shenjtë, duke pushuar në gëzim dhe paqe personale. Besimi në Krishtin nuk është vetëm një përgjigje fillestare, por një përgjigje për gjithë jetën/si mënyrë jetese.

▣ **“që të teproni në shpresë”** Kjo është një PASKAJORE E TASHME VEPRORE e *perisseuō*, që pak a shumë ka kuptimin “më tepër.” Për “shpresë” shih shënimin në 15:4.

TEMË E VEÇANTË: TEPROJ (*perisseuō*)

Pali e përdor këtë term shpesh.

1. E vërteta e Perëndisë teproi për lavdinë e Tij, Rom. 3:7
2. Dhurata falas e hirit e atij një njeriu, Jezus Krishtit, teproi, Rom. 5:15
3. Besimtarët teprojnë në shpresë, Rom. 15:13
4. Besimtarët nuk e fitojnë miratimin e Perëndisë duke ngrënë ose mos ngrënë disa ushqime, I Kor. 8:8
5. Besimtarët teprojnë në ndërtimin e kishës, I Kor. 14:12
6. Besimtarët teprojnë në punën e Zotit, I Kor. 15:58
7. Besimtarët marrin pjesë me bollëk në vuajtjen e Krishtit dhe me bollëk në ngushëllimin e Krishtit, II Kor. 1:5
8. Shërbesa e drejtësisë tepron në lavdi, II Kor. 3:9
9. Falenderimi i besimtarëve duhet të teprojë për lavdinë e Perëndisë, II Kor. 4:15

10. Bollëku i gëzimit të besimtarëve, II Kor. 8:2
11. Besimtarët tepron në çdo gjë (besim, fjalë, njohuri, zell dhe dashuri), gjithashtu në dhuratën për kishën e Jerusalemit, II Kor. 8:7
12. I gjithë hiri tepron për besimtarët, II Kor. 9:8
13. Falenderimi me tepri i besimtarëve ndaj Perëndisë, II Kor. 9:12
14. Pasuritë e hirit të Perëndisë janë derdhur me tepri mbi besimtarët, Efe. 1:8
15. Dashuria e besimtarëve të mund të teprojë gjithnjë edhe më shumë, Fil. 1:9
16. Siguria e besimtarëve në Palin tepron në Krishtin, Fil. 1:26
17. Pasja me tepri, Fil. 4:12,18
18. Besimtarët teprojnë me mirënjohje, Kol. 2:7
19. Besimtarët të rriten dhe të teprojnë në dashuri për njëri-tjetrin, I Thes. 3:12
20. Teproni në jetesë të perëndishme, I Thes. 4:1
21. Teproni në dashuri për besimtarët e tjerë, I Thes. 4:10

Të kuptuarit e Palit të hirit të Perëndisë në Krishtin ishte “me tepri,” dhe po ashtu është edhe nevoja që besimtarët të ecin në këtë hir dhe dashuri “me tepri” në jetën e tyre të përditshme!

■ **“me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë”** Fryma e Shenjtë është Personi i Trinisë aktiv në këtë Epokë të Re. Pa Atë nuk ndodh asgjë me vlerë apo efekt të qëndrueshëm (krh. 15:19; I Kor. 2:4; I Thes. 1:5). Shih Temat e veçanta te 8:9 dhe 8:11.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Cila është e vërteta qendrore e Romakëve 14:1-15:13?
2. Pse citon Pali pasazhe të DHV në vargjet 9-12? Cila është e vërteta e madhe që mësojnë ata?

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 14-33

- A. Në shumë mënyra mbyllja e kësaj letrë është e ngjashme me hapjen e saj, 1:8-15
 1. ajo lavdëron besimin e tyre (krh. 1:8)
 2. mbron apostullimin e Palit për çuarjen e ungjillit te johebrenjtë (krh. 1:13,14)
 3. pohon dëshirën e Palit për t’i vizituar (krh. 1:10,13)
 4. shpreh dëshirën e Palit që ata ta ndihmojnë që të shkojë në rajone të tjera ende të paungjillizuara (Spanjë, krh. 1:13)
- B. Përsëri, ka një shenjë të ekzistencës së tensionit në kishën e Romës midis besimtarëve hebrenj dhe johebrenj që është aluduar gjatë gjithë letrës, por veçanërisht në kapitujt 9-11, 14:1-15:13.
- C. Gjithashtu ka një shenjë të tensionit në kishën e hershme në lidhje me pozicionin apostolik të Palit. Ai duket se mbron veten në vv. 15-19; 1:2,5.
- D. Kjo njësi letrare përmban dy tema.
 1. Shërbesa apostolike, ungjillizuese, e orientuar nga johebrenjtë e Palit (krh. vv. 14-21)
 2. Planet e udhëtimit të Palit për të përmbushur këtë qëllim mund ta detyrojnë të kalojë nga Roma (krh. vv. 22-33)

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:14-21

¹⁴Dhe në lidhje me ju, vëllezër të mi, edhe unë vetë jam i bindur se ju vetë jeni plot me mirësi, të mbushur me çdo njohuri dhe të aftë gjithashtu të këshilloni njëri-tjetrin. ¹⁵Por ju kam shkruar me shumë guxim në disa pika që t’ju kujtoja përsëri, për shkak të hirit që m’u dha nga Perëndia, ¹⁶për të qenë shërbëtor i Krishtit Jezus ndaj johebrenjve, duke i shërbyer si prift ungjillit të Perëndisë, në mënyrë që oferta ime e johebrenjve të bëhet e pranueshme, e shenjtëruar nga Fryma e Shenjtë. ¹⁷Prandaj në Krishtin Jezus kam gjetur arsye për t’u mburrur në gjërat që i takojnë Perëndisë. ¹⁸Sepse unë nuk do të guxoj të flas për ndonjë gjë përveç atyre që Krishti ka përmbushur përmes meje, duke rezultuar në bindjen e johebrenjve në fjalë dhe vepra, ¹⁹me fuqinë e shenjave dhe mrekullive, në fuqinë e Fymës; kaq sa nga Jerusalemi e përqark deri në Iliri kam predikuar plotësisht ungjillin e Krishtit. ²⁰Dhe kështu desha ta predikojta ungjillin jo atje ku Krishti ishte *tashmë* i njohur, që të mos ndërtoja mbi themelin e një tjetri; ²¹por siç është shkruar, “ATA QË NUK KISHIN ASNJË LAJM PËR TË DO TË SHOHIN, DHE ATA QË NUK KANË DËGJUAR DO TË KUPTOJNË.”

15:14

NASB “Dhe në lidhje me ju, vëllezër të mi, edhe unë vetë jam i bindur”

NKJV “Tani unë vetë jam i sigurt në lidhje me ju, vëllezër të mi”

NRSV “Unë vetë ndihem i sigurt në lidhje me ju, vëllezër dhe motra të mi”

TEV “Miqhtë e mi: Unë vetë ndihem i sigurt se ju”

NJB “Nuk është sepse kam ndonjë dyshim në lidhje me ju, vëllezër, përkundrazi, jam shumë i sigurt që ju”

“Unë” (*auto egō*) është shumë emfatike/theksuese në greqisht. Pali me të vërtetë po e komplimenton këtë kishë (“i bindur,” E KRYER PËSORE DËFTORE).

Pali pohon tri gjëra në lidhje me këta të krishterë në Romë në v. 14.

1. ata janë plot me mirësi (E TASHME VEPRORE DËFTORE)
2. ata janë plot me njohuri (PJESORE E KRYER PËSORE)
3. ata janë të aftë të këshillojnë njëri-tjetrin (PJESORE E TASHME PËSORE)

Ky varg nënkupton që Pali nuk po iu sjell atyre një mesazh të ri, por po iu shpjegon dhe qartëson lajmin e mirë që e kanë dëgjuar dhe pranuar tashmë (krh. v. 15).

▣ **“ju vetë jeni plot me mirësi, të mbushur me çdo”** Ashtu si “unë vetë” është theksuese në frazën e parë, “ju vetë” është theksuese këtu. Termi “plot” (*mestos*) do të thotë “plot me” ose “i ngopur.” Pali e përdor këtë term vetëm dy herë, dhe të dyja herë te Romakëve (1:29; 15:14).

Termi “të mbushur” (*plēroō*) është PJESORE E KRYER PËSORE. Pali e përdor shpesh këtë term te Romakëve (krh. 1:29; 8:4; 13:8; 15:13,14,19). Ai gjithashtu përdor EMRIN *plērōma* shpesh te Romakëve (krh. 11:12,25; 13:10; 15:29), por asnjëherë MBIEMRIN në ndonjë nga shkrimet e tij.

Ishte dëshira e Palit që ungjilli i plotë t’i mbushte tërësisht besimtarët dhe të derdhej në dashuri e shërbim. Besimtarët kanë gjithçka që u duhet në Krishtin. Ata duhet ta pranojnë dhe ta marrin plotësisht këtë siguri.

▣ **“plot me mirësi, të mbushur me çdo njohuri”** Ka dy mënyra për t’i kuptuar këta terma: (1) që ata lidhen nga ana kontekstuale me njësinë letrare pararendëse të 14:1-15:13—dashuria e besimtarëve për njëri-tjetrin në mes të ndryshimeve midis të krishterëve në fushat biblike të paqarta. Kjo mund të konfirmohet nga përdorimi i përgjithshëm i termit “i mirë” në 14:16; 15:2 dhe këtu, ose (2) që ata lidhen me të gjithë ungjillin e besimit dhe praktikës, ortodoksi (lavdërimi i drejtë), dhe ortopraksi (vepra të drejta).

▣ **“të aftë gjithashtu të këshilloni njëri-tjetrin”** Kisha është projektuar nga Perëndia për të inkurajuar dhe këshilluar njëri-tjetrin (krh. I Kor. 12:7; Kol. 3:16; I Thes. 5:14; II Thes. 3:15). Ne jemi shpëtuar për të shërbyer, për t’i shërbyer Perëndisë duke i shërbyer njëri-tjetrit! Ne duhet të jetojmë për shëndetin dhe rritjen e trupit (të Krishtit)!

15:15 **“ju kam shkruar me shumë guxim”** Pali e shkroi këtë letër ndaj Romakëve nga Korinti. Ai u sulmua nga njëri prej grupeve në atë kishë që ishte i guximshëm në letrat e tij, por i dobët personalisht. Kjo formë FOLJORE e

fjalës “me guxim” gjendet te II Kor. 10:2,12; 11:21. Guximi i Palit vinte nga kthimi i tij në besim, nga thirrja e tij dhe nga njohja e ungjillit.

▣ **“për shkak të hirit që m’u dha nga Perëndia”** Pali i referohet hirit të Perëndisë (krh. 1:5; 12:3; I Kor. 3:10; 15:10; Gal. 2:9; dhe Efe. 3:7-8) që e thirri, e shpëtoi, e pajisi me dhunti dhe e dërgoi te johebrenjtë (krh. 11:13; 15:16). Kjo është një mënyrë për të pohuar/vënë në dukje autoritetin e tij dhe të qenit apostull (krh. 1:1,5).

15:16 “shërbëtor. . .duke shërbyer. . .oferta. . .e pranueshme” Vargjet 16 dhe 17 përmbajnë disa terma dhe fraza priftërore. “Shërbëtor” është përdorur për shërbimin priftëror në v. 27. Ai është përdorur për shërbimin e Krishtit te Heb. 8:2. Pali e shikonte veten si prift (krh. Fil. 2:17) duke ia ofruar johebrenjtë Perëndisë, që ishte detyra e Izraelit (krh. Eks. 19:5-6; Isa. 66:20). Kjo detyrë ungjillizuese i është dhënë kishës (krh. Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8). Kisha është quajtur me terma priftërorë të DHV te I Pjet. 2:5,9 dhe Zbu. 1:6.

▣ **“ungjillit të Perëndisë”** Ai nuk është vetëm ungjilli i Jezusit (krh. Mark 1:1; Rom. 1:16; 15:19; I Kor. 9:12,18; II Kor. 2:12; 4:4; 9:13; 10:14; Gal. 1:7, etj.), por gjithashtu mund të quhet me të drejtë “ungjilli i Perëndisë” (krh. Marku 1:14; Rom. 15:16; II Kor. 11:7; I Thes. 2:2,8,9; I Pjet. 4:17). Ai është kulminimi i zemrës së Perëndisë që është premtuar qysh nga Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6 dhe është profetizuar kaq shpesh te Isaia (krh. Isa. 2:2-4; 51:4,5).

▣ **“e shenjtëruar nga Fryma e Shenjtë”** Kjo është një PJESORE E KRYER PËSORE që ka kuptimin, “ka qenë dhe vazhdon të shenjtërohet nga Fryma e Shenjtë.” Kjo përsëri mund të reflektojë tensionin midis besimtarëve hebrenj dhe johebrenj në kishën e Romës. Pali e pohoi qartë që kombet (johebrenjtë) kishin qenë dhe vazhdonin të ishin plotësisht të pranuar dhe të shenjtëruar nga Fryma e Shenjtë (krh. I Kor. 6:11).

15:17-19 Vini re veprimin e përbashkët të Perëndisë Triun: për Perëndinë (krh. v.17); në Krishtin (krh. v. 17); dhe në fuqinë e Frymës (krh. v. 19). Vini re gjithashtu të tre personat e Hyjnisë në v. 30. Megjithëse termi “Trini” nuk është biblik, koncepti është (krh. Mat. 3:16-17; 28:19; Veprat 2:33-34; Rom. 8:9-10; I Kor. 12:4-6; II Kor. 1:21; 13:14; Efe. 1:3-14; 4:4-6; Titit 3:4-6; I Pjet. 1:2). Shih Temën e Veçantë: Trinia në 8:11.

15:18-19 Pali listoi mënyrat e ndryshme si kishte qenë efektive shërbesa e tij me johebrenjtë (1) me fjalë; (2) me vepra; (3) me shenja; (4) me mrekulli; dhe (5) gjithçka përmes fuqisë së Frymës.

Një shënim të vogël në lidhje me një variacion në dorëshkrime të lidhur me #5, “Frymës” (d.m.th., MS B); disa tekste në greqisht shtojnë “Fryma e Shenjtë” (d.m.th., MSS A, D*), disa e kanë “Fryma e Perëndisë” (d.m.th., MSS P⁴⁶, X, D1). Ashtu si me shumë prej këtyre varianteve, kjo shtesë, ose qartësim i pafrymëzuar, nuk e ndikon të vërtetën e pasazhit. Ishte zakonisht një përpjekje për të standardizuar frazat e DHR nga kopistët e mëvonshëm që e kopjuan tekstin. UBS⁴ i jep “Fryma e Perëndisë” një vlerësim “C” (vështirësi për ta përcaktuar).

15:18 “duke rezultuar në bindjen e johebrenjve” Synimi i Perëndisë ka qenë gjithmonë një popull që reflekton kaakterin e Tij. Ungjilli i Jezusit e rikthen imazhin e Perëndisë që humbi me Rënien e Zanafillës 3. Bashkësia intime me Perëndinë bëhet e dukshme nga një karakter i perëndishëm. Synimi i krishtërimin është bashkësia me Perëndinë dhe ngjashmëria me Krishtin, tani!

▣ **“në fjalë dhe vepra”** Kjo i referohej shërbesës së Palit, jo bindjes së të krishterëve romanë. Ajo është me sa duket e lidhur me fuqinë e Frymës në v. 19.

15:19 “me fuqinë e shenjave dhe mrekullive,” Këta dy terma dalin së bashku shumë herë te Veprat (krh. 14:8-10; 16:16-18, 25-26; 20:9-12; 28:8-9), duke përshkruar fuqinë e Perëndisë që punon përmes ungjillit (krh. II Kor. 12:12). Ata duket se janë sinonime. Saktësisht se për se është fjala—mrekullitë apo kthimin në besim—është e paqartë. Këtu përsëri, kjo mund të jetë një shenjë e tensionit në lidhje me apostullimin e Palit. Ashtu siç Perëndia konfirmoi punën e Të Dymbëdhjetëve në Jerusalem, Ai gjithashtu konfirmoi punën e Palit midis johebrenjve me anë të shenjave të vëzhgueshme.

▣ **“kam predikuar plotësisht ungjillin e Krishtit”** Kjo është PASKAJORE E KRYER VEPRORE e *plēroō* (krh. v. 14). Kjo nënkupton që Pali besonte se e kishte përfunduar detyrën e tij të predikimit në Mesdheun lindor (krh. v. 23).

■ **“deri në Iliri”** Kjo provincë romake, gjithashtu e njohur me emrin Dalmaci, ndodhej në anën lindore të Detit Adriatik në veri-perëndim të gadishullit grek (Maqedonisë). Veprat kurrë nuk thotë që Pali predikoi atje, por e përmend që është në atë zonë (krh. 20:1-2). “Deri” mund të ketë kuptimin “në kufijtë e” ose “në rajonin e.”

15:20 “Dhe kështu desha ta predikojta unë, jo atje ku Krishti ishte *tashmë* i njohur” Kjo ishte strategjia e vazhdueshme misionare e Palit (krh. I Kor. 3:10; II Kor. 10:15-16). Ai donte të arrinte paganët që nuk e kishin patur kurrë mundësinë të dëgjonin dhe merrnin ungjillin. Ai zakonisht zgjidhte qytete të mëdha dhe të vendosur strategjikisht të Perandorisë Romake në mënyrë që kisha që do të mbillej të mund të ungjillizonte dhe dishepullizonte zonat përreth.

15:21 Ky është citim nga Septuaginta (LXX) e Isa. 52:15 që flet për johebrenjtë që dëgjojnë për Perëndinë. Pali e zgjodhi këtë profeci si strategjinë e tij misionare.

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:22-29

²²Për këtë arsye jam penguar shpesh që të vija tek ju; ²³por tani, duke mos patur më vend për mua në këto vise, dhe meqenëse kam patur për shumë vjet një dëshirë të madhe për të ardhur tek ju ²⁴kurdo që të shkoj në Spanjë— sepse shpresoj t’ju takoj rrugës për atje, dhe të më ndihmoni për të shkuar atje, pasi të jem kënaqur me shoqërinë tuaj për pak—²⁵por tani, po shkoj në Jerusalem duke iu shërbyer shenjtorëve. ²⁶Sepse Maqedonisë dhe Akaisë i ka pëlqyer të japë një kontribut për të varfrit ndër shenjtorët në Jerusalem. ²⁷Po, atyre u pëlqeu ta bënin këtë, dhe ata u janë borxhli atyre. Sepse nëse johebrenjtë kanë pjesë në gjërat e tyre frymërore, ata e kanë për borxh t’iu shërbejnë atyre edhe në gjërat materiale. ²⁸Prandaj, kur ta kem dorëzuar këtë, dhe të kem vënë vulën time mbi këtë fryt të tyre, do të shkoj, duke kaluar nga ju, për në Spanjë. ²⁹Unë e di se kur të vij tek ju, do të vij në plotësinë e bekimit të Krishtit.

15:22 “Për këtë arsye” Kjo arsye shpjegohet në v. 20.

■ **“jam penguar shpesh”** Kjo është një DËFTORE E PAKRYER PËSORE. Ai ishte penguar në mënyrë të përsëritur (krh. 1:13). Agjenti pengues nuk përmendet. Mund të ketë qenë Perëndia, Satani, njerëzit e këqij, ose mundësi të tjera të ungjillit.

Mbani mend që Pali e shkroi Romakëve ndërkohë që ai ishte në Korint. Në Korint kundërshtarët e Palit e sulmuan mbi faktin që ai nuk kishte mundur t’i përmushte planet e tij të udhëtimit. Pali ishte patjetër i ndikuar nga sulmet brenda kishës së Korintit. Ai mund të ketë përmendur faktin që plani i tij i udhëtimit i ishte prishur në mënyrë të përsëritur.

15:23 “por tani, duke mos patur më vend për mua në këto vise” Ky varg mund të merret në kuptimin e kufizuar gjeografik të Azisë së Vogël ose rajonit të Mesdheut Lindor. Pali nuk i kishte predikuar çdo njeriu, në çdo vend në këto vise, por vetëm disave.

■ **“dhe meqenëse kam patur për shumë vjet një dëshirë të madhe për të ardhur tek ju”** Pali e kishte shprehur shpesh dëshirën e tij për të vizituar Romën (krh. 1:10-15; Veprat 19:21; 23:11).

Në këtë pikë ka një variant në dorëshkrimet greke që nuk listohet në shënimet kritike të UBS⁴. Dorëshkrimet e lashta greke MSS P⁴⁶, X, A, D, F, G & L e kanë “shumë” (*polus*) që është përdorur në v. 22, por MSS B, C & P e kanë “disa” (*ikanos*). Ndoshta kopistë të mëvonshëm u bezdisën nga ekzagjerimi i Palit.

15:24 “kurdo që të shkoj në Spanjë” Pali donte të shkonte në zonën perëndimore të Perandorisë Romake (krh. II Kor. 10:16). Ai u lirua nga burgu romak pas mbylljes së Veprave dhe shkoi në një udhëtim të katërt misionar. Letrat pastorale (I Timoteut, II Timoteut, dhe Titit) u shkruan në këtë udhëtim të katërt. Ka ndoshta një referencë për këtë te II Tim. 4:10 ku disa dorëshkrime greke unciale, X, C dhe Vulgata Latine dhe përkthimet kopte, e kanë “Gali.” Klementi i Romës (shih Ad. Kor. 5:7), që shkroi përpara fundit të shekullit të parë, në “Letrën [e tij] drejtuar Korintasve,” 5:7, gjithashtu pohon që Pali udhëtoi deri në “kufijtë e Perëndimit.”

■ **“dhe të më ndihmoni për të shkuar atje,”** Kjo frazë u bë një idiomë teknike në kishë për ndihmën ndaj misionarëve shëtitës për të shkuar në destinacionin e tyre të rradhës të predikimit (krh. Veprat 15:3; I Kor. 16:6, 11; II Kor. 1:16; Titit 3:13; III Gjoni 6). Roma nuk kishte mundësi të kontribuonte për fondin e ndihmës për kishën në Jerusalem, por ata mund të ishin ndihmë nga ana financiare për udhëtimet misionare të Palit për në perëndim.

15:25 “duke iu shërbyer shenjtorëve” Ky term është përdorur shpesh në lidhje me ngritjen e fondeve financiare (krh. v. 31; I Kor. 16:15; II Kor. 8:4; 9:1). Shih Temën e Veçantë: Shenjtorët në 1:7.

15:26 “një kontribut për të varfrit ndër shenjtorët në Jerusalem” Pali e kishte mbredhur këtë ofertë (shih Temë e Veçantë: *Koinōnia* në 12:13) për disa vjet nga (1) Galatia dhe Azia e Vogël (krh. I Kor. 16:1-4), dhe (2) Maqedonia dhe Akaia (krh. II Korintasve 8-9). Ai e mori idenë nga kisha e Antiokisë (krh. Veprat 11:30; 12:25). Ajo kishte synim të bashkonte të dy krahët e kishës së hershme—hebrenjtë dhe johebrenjtë. Për kishat e johebrenjve thuhet që “u pëlqeu” ta bënin këtë (krh. vv. 26 dhe 27). Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: URIA

I. Hyrje

- A. Uria është kujtuesi i gjithmonë-pranishëm i gjendjes së rënë të njerëzimit dhe krijimit.
- B. Uria është njëri aspekt i problemit të së keqes dhe të vuajtjes. Ajo i atribuohet drejtpërdrejt njerëzimit, jo Perëndisë. Megjithëse Perëndia i ka përdorur bekimet apo mallkimet bujqësore si një mënyrë për të shpërblyer dhe ndëshkuar popullin e Tij të Besëlidhjes (Ligji i Përtërirë 27-28), kjo nuk ka qenë e vërtetë për jobesimtarët në përgjithësi (Mat. 5:45). Uria është një shembull më shumë i njerëzimit lakmitar, egoist dhe materialist. Problemi i urisë nuk është në realitet problem ushqimi, por problem i motivimit dhe përparësive njerëzore.
- C. Uria është një mundësi për njerëzimin e shpenguar të reflektojë dashurinë e Perëndisë. Reagimi i besimtarëve ndaj nevojave fizike në Kishë dhe në botë tregon se cilët jemi në të vërtetë.

II. Materiali biblik

A. Dhiata e Vjetër

1. Moisiu

- a. një nga tre të dhjetat e mundshme në Izraelin e lashtë ishte për të varfrit (LiP 14:28-29)
- b. Ligji kishte parashikime të veçanta për ushqimin e të varfërve (Eks. 23:11; Lev. 19:10; 23:22; LiP 24:19-22)
- c. Ligji kishte parashikime për flijime të veçanta, jo të kushtueshme për të varfrit (Lev. 14:21)
- d. Izraeli duhej të kishte një qëndrim të dhembshur dhe dorëhapur ndaj të varfërve dhe nevojtarëve (LiP 15:7-11, krh. Jobi 29:16; 30:25; 31:16-23)

2. Letërsia e urtësisë

- a. Për ata që ndihmonin të varfrit rezervoheshin bekime të veçanta (Ps. 41:4)
- b. Të ndihmoje të varfrit ishte të ndihmoje Perëndinë (Fja. 14:31; 17:5; 19:17)

3. Profetët

- a. Perëndia kërkonte adhurim ndaj Tij në formën e drejtësisë shoqërore dhe dhembshurisë për të varfrit (Isa. 58:6-7; Mik. 6:8)
- b. Një shenjë e mesazhit të Perëndisë ishte që ai u ishte shpallur të varfërve dhe nevojtarëve (Isa. 61:1-2)
- c. Profetët e Perëndisë e denoncuan me forcë shfrytëzimin shoqëror (Amos 2:6-8; 5:10-13; Mikea)

B. Dhiata e Re

1. Ungjijtë

- a. Ndhimja për të varfrit këshillohet fort (Mark 10:21; Luka 3:11)
- b. Gjykimi bazohet mbi dashurinë tonë shoqërore ndaj të tjerëve në emrin e Jezusit. Në fakt, të ndihmohet të tjerët është të ndihmohet Jezusin (Mat. 25:31-46)
- c. Marku 14:7 është keqkuptuar shumë kur është interpretuar sikur kjo reflekton mungesën e shqetësimit për të varfrit nga ana e Jezusit. Ky varg ka si qëllim të theksojë unikalitetin e Tij, dhe jo të ulë të varfrit.
- d. Isaia 61:1-2 reflekton që marrësit e mesazhit të Perëndisë do të jenë të mënjanuarit shoqërorë (Luka 4:18; 7:22; 14:21).

2. Pali

- a. Pali mësoi nga Antiokia e Sirisë konceptin e një oferte të veçantë dashurie për të varfrit e kishës së Jerusalemit (Rom. 15:26; I Kor. 16:1; II Kor. 8:4,6,19; Gal. 2).
- b. Pali thekson hirin, besimin dhe veprat (Efe. 2:8-10).

3. Jakobi (letërsia e urtësisë e DHR)

- a. Besimi në Perëndinë përmes Krishtit pa shqetësim shoqëror është diçka që nuk shkon (Jakobi 2:14-17).
- b. Ai madje thotë që besimi pa vepra është i vdekur!

4. Gjoni

- a. Libri i I Gjonit thekson se siguria e krishterë bazohet në një jetë të ndryshuar besimi dhe shërbimi (I Gjoni 3:17-18).

III. Përfundim

A. Mjerimi dhe nevoja njerëzore lidhen me mëkatën e njerëzimit. Ka disa aspekte të urisë:

1. sjellja e pamend (Fja. 19:15)
2. ndëshkimi i Perëndisë (LiP 27-28)
3. e lidhur me shërbesën frymërore (II Kor. 11:27)
4. rrethanat kulturore (lakmia, konceptimi, etj).
5. rrethana materiale (zia e bukës, përmbytjet, breshëri, etj).

B. Perëndia vërtet merakoset për njerëzit. Ai i do ata që janë në nevojë në një mënyrë unike!

C. Kisha në veprim është përgjigjia e Perëndisë për nevojat njerëzore (fizike dhe shpirtërore)

1. veprim personal i drejtpërdrejtë
2. veprim kolektiv si kishë
3. organizatë politike për ndryshim

D. Ne duhet t'i vlerësojmë në mënyrë kritike kulturën dhe përparësitë tona personale nën dritën e Shkrimeve (II Korintasve 8-9).

E. Ne kemi nevojë që t'i kemi sytë, zemrat dhe duart të hapura ndaj nevojave njerëzore në vendin tonë dhe jashtë tij; në kishë dhe në botë.

F. Ndhimja duhet të lidhet me atë që jemi në Krishtin nën dritën e Porosisë së Madhe (Mat. 28:18-20). Ndhimja duhet të jetë fizike dhe shpirtërore.

15:27 “nëse” Kjo është një FJALI KUSHTORE E KLASIT TË PARË që supozohej e vërtetë nga këndvështrimi i autorit ose për qëllimet e tij letrare. Nëse johebrenjtë marrin pjesë në bekimet frymërore të hebrenjve (krh. Rom. 10-11) ata duhet të ndihmojnë në nevojat fizike të kishës mëmë në Jerusalem.

15:28

NASB

“kur ta kem dorëzuar këtë, dhe të kem vënë vulën time mbi këtë fryt të tyre”

NKJV

“kur ta kem kryer këtë dhe t’ua kem vulosur këtë fryt”

NRSV

“kur ta kem përfunduar këtë, dhe t’u kem dhënë atyre atë që është mbledhur”

TEV “kur ta kem mbaruar këtë detyrë dhe t’u kem kaluar atyre gjithë paratë që janë ngritur për ta”

NJB “Kështu kur ta kem bërë këtë dhe të kem dorëzuar zyrtarisht atë që është mbledhur”

Kjo është një PJESORE AORISTE VEPRORE dhe një PJESORE AORISTE JOVEPRORE. Kjo fjalë për fjalë të kujton mënyrën e zakonshme të vulosjes së një pakete për të siguruar përmbajtjen e saj. Kjo mund të jetë një mënyrë se si Pali pohon që të gjitha paratë që janë dhënë do të dërgohen dhe do të merren. Për ta siguruar këtë ai mori me vete edhe disa përfaqësues nga kishat kontribuuese (krh. Veprat 20:4).

Për “vulë” shih Temën e Veçantë në 4:11.

15:29 Vini re që fjala *plēroō* / *plērōma* është përdorur përsëri. Shih shënimin në v. 14.

■ **“e bekimit të Krishtit”** Kjo frazë i referohet bekimit që sjell predikimi/mësimi i ungjillit. Në këtë kontekst nuk i referohet një lutjeje.

Disa tekste të lashta greke u përpoqën ta qartësonin këtë kuptim duke shtuar një frazë, “e bekimit të ungjillit të Krishtit” (MS A², NKJV). Teksti më i shkurtër gjendet në MSS κ*, A, B, C, D, F, G, P. UBS⁴ i jep leximit më të shkurtër vlerësimin “A” (i sigurt).

TEKSTI I NASB (I PËRDITËSUAR): 15:30-33

³⁰Tani ju nxis, vëllezër, me anë të Zotit tonë Jezus Krisht dhe me anë të dashurisë së Frymës, të përpiqeni së bashku me mua në lutjet tuaja te Perëndia për mua, ³¹që të mund të shpëtoj nga ata që janë të pabindur në Jude, dhe që shërbimi im për Jerusalem të dalë i pranueshëm për shenjtorët; ³²në mënyrë që të vij te ju me gëzim me anë të vullnetit të Perëndisë dhe të gjej pushim *përtëritës* në shoqërinë tuaj. ³³Tani Perëndia i paqes qoftë me ju të gjithë. Amen.

15:30 “ju nxis. . . të përpiqeni së bashku me mua” Këta janë terma grekë të fortë. I pari është përdorur edhe në 12:1. I dyti është përdorur për betejën e Jezusit në Gjetsemani. Pali ndjeu një nevojë të thellë për lutje për veten e tij dhe për shërbesën e tij të ungjillit (krh. II Kor. 1:11; Efe. 6:18-20; Kol. 4:3; I Thes. 5:25; II Thes. 3:1). Ajo që përjetoi në Jerusalem doli e vështirë (krh. v. 31). Ai mbërriti në Romë, por jo në mënyrën që kishte përfytyruar. Shih Temën e Veçantë: Lutja ndërmjetësuese në 9:3.

15:30-33 Lutja e Palit shpreh tre dëshira.

1. që ai të çlirohej nga armiqtë e tij në Judë (krh. Veprat 20:22-23)
2. që dhurata nga kishat e johebrenjve të pritej mirë nga kisha në Jerusalem (krh. Veprat 15:1ff; 21:17ff)
3. që ai pastaj të mund të vizitonte Romën rrugës për në Spanjë

15:30 “të përpiqeni së bashku me mua” Ky term është përdorur vetëm këtu në DHR. Ai është një term i përbërë nga *sun* (së bashku me) dhe *agōnizomai* (të zihesh, të luftosh, të përpiqesh fort, krh. I Kor. 9:25; Kol. 1:29; 4:12; I Tim. 4:10; 6:12). Kjo PASKAJORE e fortë i bën thirrje kishës së Romës që të luftojë agresivisht në lutje me Palin në lidhje me pritjen e ofertës së johebrenjve nga kisha mëmë në Jerusalem.

15:31 “që janë të pabindur” Kjo u referohet kundërshtarëve hebrej ose ka mundësi judaistëve, por jo kishës në përgjithësi (krh. 11:30,31).

15:32 Lutja e Palit përfundon me dy kërkesa të tjera: (1) që ai të vinte tek ata me gëzim dhe (2) që ai të kishte një kohë pushimi me ata (AORISTE JOVEPRORE [deponente] LIDHORE e *sunanapauomai*, vetëm këtu në DHR, por është përdorur tek Isa. 11:6. Pali e citoi Isa. 11:1,10 në v. 12). Pali kishte nevojë për një kohë pushimi të qetë dhe rikuperimi midis besimtarëve të pjekur (krh. II Kor. 4:7-12; 6:3-10; 11:23-33)! Ai nuk e arriti atë që dëshoi, megjithatë. Në Palestinë e priste arrestimi, gjyqi dhe vite burgu.

Ky varg ka shumë variante dorëshkrimesh.

15:33 “Perëndia i paqes” Ky është një titull i mrekullueshëm për Perëndinë (krh. 16:20; II Kor. 13:11; Fil. 4:9; I Thes. 5:23; II Thes. 3:16; Heb. 13:20).

■ **“Amen”** Shih Temën e Veçantë në 1:25.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Si është DHV e dobishme për besimtarët e DHR (vv. 4-5; I Kor. 10:6,11)?
2. Pse e citon Pali DHV në vv. 9-12? Çfarë të vërtete të madhe mësojnë ata?
3. Ku del në këtë seksion të Romakëve tensioni midis hebrenjve dhe johebrenjve?
4. Ku del në këtë seksion të Romakëve tensioni në lidhje me apostullimin e Palit?
5. Cila ishte arsyeja e Palit për ofertën e kishave johebreje për kishën në Jerusalem (vv. 15-28)?
6. Cila ishte strategjia misionare e Palit? Pse donte ai të shkonte në Spanjë?
7. Si dhe pse e përshkruan Pali punën e tij si ajo e një prifti (v.16)? Në lidhje me Izraelin si Mbretëri Priftërinjsh (Eks. 19:5-6) apo me kishën (I. Pjet. 2: 5,9; Zbu. 1:6)?
8. A iu përgjigj Perëndia lutjes së Palit në vargjet 30-33?

ROMAKËVE 16

NDARJET NË PARAGRAFË TË PËRKTHIMEVE TË SOTME				
UBS ⁴	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje personale	Rekomandimi i motër Febës	Përshëndetje	Përshëndetje personale	Përshëndetje dhe urime të mira
16:1-2	16:1-2	16:1-2	16:1-2	16:1-2
16:3-16	Përshëndetje shenjtorëve në Romë	16:3-16	16:3-5a 16:5b-7 16:8-11 16:12-15 16:16	16:3-5a 16:5b-16
16:17-20	Shmangni personat përçarës	16:17-20	Udhëzime përfundimtare 16:17-20a 16:20b-21	Një paralajmërim dhe postskripti i parë 16:17-20
16:21-23	Përshëndetje nga miqtë e Palit	16:21 16:22 16:23	16:22 16:23	Përshëndetjet e fundit dhe postskripti i dytë 16:21-23
Doksologji	Bekim		Lutje përmbyllëse lavdërimi	Doksologji
16:25-27	16:25-27	16:25-27	16:25-26 16:27	16:25-27

CIKLI TRE I LEXIMIT (shih fq. viii)

NDJEKJA E SYNIMIT TË AUTORIT ORIGJINAL NË NIVELIN E PARAGRAFIT

Ky është një komentuar studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Lexoje kapitullin njëherësh. Identifiko temat. Krahaso ndarjen tënde të temave me pesë përkthimet e sotme. Ndarja në paragrafë nuk është e frymëzuar, por është kyç për të ndjekur synimin e autorit origjinal, gjë që është zemra e interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një temë.

A.Paragrafi i parë

B.Paragrafi i dytë

C.Paragrafi i tretë

D.Etj.

TË DHËNA KONTEKSTUALE PËR VARGJET 1-27

- A. Vini re që të gjitha gratë në këtë seksion përmbyllës ishin bashkëpunëtore me Palin në ungjillin (krh. Fil. 4:3): Feba në v. 1; Priska në v. 3; Maria në v. 6; Junia (ose Junias—nëse ishte burrë) në v. 7; Trifena dhe Trifoza në v. 12; Persida në v. 12; “nëna e tij” në v. 13; Julia në v. 15; dhe “motra e tij” në v. 15. Kini kujdes nga dogmatizmi në fushën e grave në shërbesë. Të gjithë besimtarët janë shërbëtorë me dhunti (krh. I Kor. 12:7,11), dhe me kohë të plotë (krh. Efe. 4:12). Në këtë listë ne kemi një dhjake, Feba, dhe një që ka mundësi të ishte një grua apostulle, Junia (krh. Joel 2:28; Veprat 2:16-21). Është e vështirë të dish si ta trajtosh këtë çështje biblikisht, për shkak të thënieve në dukje paradoksale të Palit si te I Kor. 11:4-5 krahasuar me 14:34.
- B. Vini re sfondet e mundshme racore të këtyre emrave
1. hebrej besimtarë: Aquila, Priska, Androniku, Junias, Maria [disa MSS e kanë Mariam];
 2. emra të familjeve fisnike romake: Priska, Ampliatusi, Apeli, Narcis, Julia, Filologu;
 3. emra të familjeve fisnike hebreje: Aristobuli, Herodioni.
- C. Vargjet 1-16 janë përshëndetjet personale të Palit, kurse vargjet 17-20 janë paralajmërimet e tij përmbyllëse kundër mësuesve të rremë. Në vargjet 21-23 skuadra e misionit dërgon përshëndetje nga Korinti.
- D. Diskutimi i kapitullit 16 në *Tyndale New Testament Commentary* nga F. F. Bruce është shumë ndihmues. Nëse interesoheni në një studim të detajuar të emrave që gjenden në këtë kapitull, lexoni faqet 266-284.
- E. Ka njëfarë dyshimi se ku mbyllet letra. Një mbyllje del disa herë në fund të kapitujve 14, 15 (MS P⁴⁶) dhe 16, në dorëshkrimet e lashta greke. Megjithatë, mbyllja tradicionale e 16:25-27 del në MSS P⁶¹, Ɑ, B, C dhe D si edhe në tekstin grek të përdorur nga Klementi i Romës (A.D. 95). Vargu 24 nuk del në dorëshkrimet më të vjetra greke, P⁴⁶, P⁶¹, Ɑ, A, B, C, dhe as në Vulgatën Latine apo në tekstin grek të përdorur nga Origeni i Aleksandrisë. Për një diskutim të plotë të varianteve shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, fq. 533-536.

STUDIM FJALE DHE FRAZE

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:1-2

¹Ju rekomandoj motrën tonë Feba, që është shërbëtore e kishës që është në Kenkrea; ²që ta prisni në Zotin në një mënyrë që është e denjë për shenjtorët, dhe që ta ndihmoni në çfarëdo gjëje që mund të ketë nevojë për ju; sepse edhe ajo vetë ka qenë ndihmëse për shumë, edhe për mua vetë.

16:1 “Ju rekomandoj” Vargjet 1-2 funksionojnë si një letër rekomandimi për dhjakën Feba. Ajo ndoshta ishte që e çoi letrën e Palit në Romë. Ka disa shembuj të tjerë të këtyre letrave të prezantimit apo rekomandimit në DHR (krh. Veprat 18:27; I Kor. 16:3; II Kor. 3:1; 8:18-24; dhe Fil. 2:19-30).

▣ **“Feba”** Emri i saj do të thotë “e ndritshme” ose “rrezatuese.”

▣	
NASB, NKJV	“që është shërbëtore e kishës”
NRSV	“dhjake e kishës”
TEV	“që i shërben kishës”
NJB	“dhjake e kishës”

Ky është termi *diakonos*. Është në formën KALLËZORE NJËJËS FEMËRORE. Është termi grek për shërbëtor. Ai është përdorur (1) për Krishtin te 15:8; Marku 10:45; (2) për Palin te Efe. 3:7; Kol. 1:23,25; dhe (3) për dhjakët te Fil. 1:1; I Tim. 3:11.

Ka prova edhe në DHR, edhe në shkrimet e hershme pas-biblike të kishës për ofiqin e dhjakes. Një tjetër shembull i grave në shërbesën e kishës lokale në DHR është “lista e vejushave” e letrave pastorale (krh. I Tim. 3:11; 5:3-16). Përkthimet RSV, Amplified, dhe Phillips e kanë “deaconess/dhjake” në 16:1. NASB dhe NIV e

kanë në shënimet në fund të faqes. NEB e ka “që mban postin.” Të gjithë besimtarët janë thirrur dhe pajisur për të qenë shërbëtorë me kohë të plotë (krh. Efe. 4:12). Disa janë thirrur për role të shërbesës së udhëheqësisë. Traditat tona duhet t’u lëshojnë vendin Shkrimeve! Ata dhjakë dhe dhjake të kishës së lashtë ishin shërbëtorë, jo borde ekzekutive.

M. R. Vincent, *Word Studies*, vol. 2, fq. 752 dhe 1196, thotë që *Kushtetutat Apostolike* që datojnë nga fundi i shekullit të dytë ose fillimi i shekullit të tretë, bëjnë një dallim midis detyrave dhe emërimit të ndihmëseve të kishës.

1. dhjakeve
2. të vejave (krh. I Tim. 3:11; 5:9-10)
3. virgjëreshave (krh. Veprat 21:9 dhe ka mundësi edhe I Kor. 7:34)

Këto detyra përfshinin

1. kujdesjen për të sëmuret
2. kujdesjen për ata që përndiqeshin fizikisht
3. vizitat tek të burgosurit për besimin
4. mësonin besimtarët e reja
5. asistonin në pagëzimin e grave
6. mbikqyrnin deri në një shkalle anëtarët femra të kishës

TEMË E VEÇANTË: GRATË NË BIBËL

- I. Dhiata e Vjetër
 - A. Nga ana kulturore, gratë konsideroheshin prona
 1. përfshiheshin në listën e pronave (Eks. 20:17)
 2. trajtimi i skllaveve (Eks. 21:7-11)
 3. betimet e grave ishin të anulueshme nga meshkuj të përgjegjshëm nga ana sociale (Numrat 30)
 4. gratë si plaçka lufte (Ligji i Përtërirë 20:10-14; 21:10-14)
 - B. Praktikisht, ekzistonte një reciprocitet
 1. meshkujt dhe femrat të krijuara në shëmbëllimin e Perëndisë (Zan. 1:26-27)
 2. nderoni babanë dhe nënën (Levitiku 19:3; 20:9)
 3. burrat dhe gratë mund të ishin naziritë (Num. 6:1-2)
 4. bijat kishin të drejtë trashëgimie (Num. 27:1-11)
 5. pjesë e popullit të besëlidhjes (Ligji i Përtërirë 29:10-12)
 6. zbato mësimin e babait dhe nënës (Fja. 1:8; 6:20)
 7. bijtë dhe bijat e Hemanit (familje levite) drejtonin muzikën në tempull (1 Kron. 25:5-6)
 8. bijtë dhe bijat do të profetizojnë në epokën e re (Joeli 2:28-29)
 - C. Gratë ishin në role udhëheqjeje
 1. motra e Moisiut, Miriami, quhej profeteshë (Eks. 15:20-21, shih dhe Mikea 6:4)
 2. gratë që kishin dhunti nga Perëndia për të endur materiale për tabernakullin (Eks. 35:25-26)
 3. një grua, Debora, që ishte edhe profeteshë (shih Gjyq. 4:4), u priu gjithë fiseve (Gjyq. 4:4-5; 5:7)
 4. Hulda ishte profeteshë, të cilës mbreti Josia i bëri thirrje të lexonte dhe të interpretonte “Librin” e sapogjetur “të Ligjit” (2 Mbret. 22:14; 2 Kro. 34:22-27)
 5. mbretëresha Ester, një grua e perëndishme, shpëtoi judenjtë në Persi
- II. Dhiata e Re
 - A. Nga ana kulturore, si në judaizëm ashtu dhe në botën romake, gratë ishin qytetare të dorës së dytë, me pak të drejta apo privilegje (me përjashtim të Maqedonisë).
 - B. Gratë në role udhëheqjeje
 1. Elizabeta dhe Maria, gra të perëndishme në dispozicion të Perëndisë (Luka 1-2)
 2. Ana, gruaja e perëndishme që shërbente në tempull (Luka 2:36)
 3. Lidia, besimtare dhe drejtuese e një kishe shtëpiake (Veprat 16:14, 40)
 4. Katër bijat e virgjra të Filipit ishin profeteshë (Veprat 21:8-9)
 5. Feba, dhjake e kishës në Kenkrea (Rom. 16:1)
 6. Priska (Prishila), bashkëpunëtorja e Palit dhe mësuesja e Apollos (Veprat 18:26; Rom. 16:3)
 7. Maria, Trifena, Trifoza, Persida, Julia, motra e Nereut, një sërë grash bashkëpunëtoreshë të Palit

(Rom. 16:6-16)

8. Junia (KJV), ndoshta një grua apostull (Rom. 16:7)
9. Evodia dhe Sintika, bashkëpunëtore të Palit (Fil. 4:2-3)

III. Si t'i drejtpeshojë shembujt e ndryshëm biblikë besimtari i kohës së sotme?

- A. Si të përcaktojmë të vërtetat historike ose kulturore, që vlejné vetëm për kontekstin fillestar, dhe të vërtetat e përjetshme që vlejné për të gjitha kishat, për të gjithë besimtarët e të gjitha kohëve?
1. Duhet të marrim shumë seriozisht synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Bibla është Fjala e Perëndisë dhe i vetmi burim për besimin dhe praktikën.
 2. Duhet të ballafaqohemi me pasazhet e frymëzuara që, dukshëm, janë të kushtëzuara nga ana historike.
 - a. Kulti (pra, rituali dhe liturgjia) e Izraelit (shih Veprat 15; Gal. 3)
 - b. Judaizmi i shekullit të parë
 - c. Thëniet e kushtëzuara historikisht të Palit në 1 Korintasve
 - (1) sistemi ligjor i Romës pagane (1 Kor. 6)
 - (2) qëndrimi në skllavëri (1 Kor. 7:20-24)
 - (3) beqaria (1 Kor. 7:1-35)
 - (4) virgjëreshat (1 Kor. 7:36-38)
 - (5) ushqimi që u flijohet idhujve (1 Kor. 8; 10:23-33)
 - (6) veprime të padenja në Darkën e Zotit (1 Kor. 11)
 3. Perëndia e zbuloi plotësisht dhe qartazi veten në një kulturë të veçantë dhe në një kohë të veçantë. Ne duhet të marrim seriozisht zbulesën, por jo çdo aspekt të përshtatjes së saj historike. Fjala e Perëndisë u shkrua me fjalë njerëzore dhe iu drejtua një kulture të caktuar në një kohë të caktuar.

- B. Interpretimi biblik duhet të kërkojë synimin e autorit fillestar. Çfarë po i thoshte ai ditës së vet? Kjo është themelore dhe kyçe për interpretimin e sakte. Por, më tej, këtë duhet ta zbatojmë në kohën tonë. Tani, këtu qëndron problemi me gratë në udhëheqje (problemi i vërtetë interpretues mund të jetë përcaktimi i termit. A kishte shërbesa të tjera përveç pastorëve që konsideroheshin udhëheqje? A shiheshin si drejtuese dhjaket ose profetesat? Është shumë e qartë se Pali, në 1 Kor. 14:34-35 dhe 1 Tim. 2:9-15, po pohon se gratë nuk duhet të marrin drejtimin në adhurimin publik! Por si ta zbatoj këtë në kohën time? Nuk dua që kultura e Palit, apo e imja, t'i mbyllë gojën Fjalës dhe vullnetit të Perëndisë. Ndoshta, koha e Palit ishte tepër kufizuese, por ndoshta koha ime mund të jetë tepër e hapur. S'ndihem fare rehat të them se fjalët dhe mësimet e Palit janë të vërteta të kushtëzuara, situatore, lokale të shekullit të parë. Kush jam unë që t'i lejoj mendjes ose kulturës sime të mohojnë një autor të frymëzuar?!

Nga ana tjetër, si t'ia bëj kur gjej shembuj biblikë për gratë drejtuese (edhe në shkrimet e Palit, shih Romakëve 16)? Një shembull i qartë i kësaj është diskutimi që i bëri Pali adhurimit publik në 1 Korintasve 11-14. Në 11:5, ai duket se lejon predikimin dhe lutjen e grave në adhurimin publik, por me koka të mbuluara, ndërsa në 14:34-35 kërkon që ato të qëndrojnë në heshtje! Kishte dhjake (shih Rom. 16:1) dhe profetesa (shih Veprat 21:9). Është pikërisht kjo larmi që më jep lirinë t'i identifikoj komentet e Palit (në lidhje me kufizimet për femrat) si tipare që vlenin vetëm për Korintin dhe Efesin e shekullit të parë. Në të dyja ato vende kishte probleme me femrat që ushtronin lirinë e tyre të sapogjetur (shih Bruce Winter, *After Paul Left Corinth [Pasi Pali la Korintin]*), gjë që mund të ketë shkaktuar vështirësi për kishën që të ungjillizonte shoqërinë për Krishtin. Liria e tyre duhej kufizuar në mënyrë që ungjilli të ishte më i efektshëm.

Koha ime është plotësisht e kundërt me atë të Palit. Në kohën time, ungjilli mund të kufizohet nëse grave të trajnuara, që dinë të flasin, nuk u lejohej të ndajnë ungjillin ose të drejtojnë! Cili është synimi absolut i adhurimit publik? A nuk është ungjillizimi dhe dishepullizimi? A mund të nderohet dhe kënaqet Perëndia nga gratë drejtuese? Bibla në tërësi duket se thotë "po"!

Unë dua t'i nënshtrohem Palit; teologjia ime është kryesisht paliane. Nuk dua që të ndikohem ose manipulohem nga feminizmi modern! Megjithatë, mendoj se kisha ka qenë e ngadaltë për të reaguar ndaj të vërtetave të qarta biblike, si papranueshmëria e skllavërisë, racizmit, fanatizmit dhe seksizmit. Po kështu, ajo ka reaguar shumë me vonesë ndaj abuzimit të femrave në botën e sotme. Perëndia, në Krishtin, e çliroi skllavin dhe femrën. Unë nuk guxoj që të lejoj një pasazh të kufizuar nga ana kulturore që t'i fusë sërish nën pranga.

Dhe një pikë e fundit: si interpretues, unë e di se Korinti ishte një kishë shumë problematike. Dhuntitë karizmatike vlerësoheshin dhe përdorshin për t'u mburrur. Në këtë gjë mund të jenë përfshirë dhe femrat. Po kështu, besoj se Efesi po ndikohej nga mësuesit e remë, të cilët po përfitonin nga gratë dhe po i përdornin si folëse zëvendësuese në kishat shtëpiake të Efesit.

C. Sugjerime për lexime të mëtejshëm

How to Read the Bible For All Its Worth [Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka], Gordon Fee dhe Doug Stuart (f. 61-77)

Gospel dhe Spirit: Issues in New Testament Hermeneutics [Ungjilli dhe Fryma: Çështje në hermeneutikën e Dhiatës së Re], Gordon Fee

Hard Sayings of the Bible [Thënie të vështira në Bibël], Walter C. Kaiser, Peter H. Davids, F. F. Bruce, dhe Manfred T. Branch (f. 613-616; 665-667)

☐ **“kisha”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: KISHA (EKKLESIA)

Kjo fjalë greke, *ekklesia*, vjen nga dy fjalë: “jashtë prej” dhe “i thirrur”. Pra, si fjalë nënkupton njerëz që janë të thirrur nga jashtë në mënyrë hyjnore. Kisha e hershme e mori këtë fjalë nga përdorimi i përditshëm laik (shih Veprat 19:32, 39, 41), si dhe për shkak se Septuaginta e kishte përdorur në kuptimin e “asamblesë” së Izraelit (*Qahal*, BDB 874, shih Num. 16:3; 20:4). Ata e përdornin për vete si vazhdimësia e popullit të Perëndisë në DhV. Kisha ishte Izraeli i ri (shih Rom. 2:28-29; Gal. 6:16; 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6), përmbushja e misionit mbarëbotëror të Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat 1:8).

Kjo fjalë përdoret në një sërë kuptimesh në ungjijtë dhe në Veprat:

1. takim laik i qytetit (Veprat 19:32, 39, 41)
2. populli mbarëbotëror i Perëndisë në Krishtin (Mat. 16:18 dhe Efesianëve)
3. bashkësi lokale besimtarësh të krishterë (Mat. 18:17; Veprat 5:11; në këto vargje, kisha në Jerusalem)
4. populli i Izraelit në mënyrë kolektive (Veprat 7:38; në predikimin e Stefanit)
5. populli i Perëndisë në një rajon të caktuar (Veprat 8:3; në vendin e Judesë)

☐ **“Kenkrea”** Ishte një nga dy portet detare të Korintit. Ky ishte në anën lindore (krh. Veprat 18:18).

16:2 “që ta prisni në Zotin në një mënyrë që është e denjë” Kjo është AORISTE JOVEPRORE [deponente] LIDHORE e *prosdechomai*, që do të thotë “të presësh me mirësi si mysafir” (krh. Fil. 2:29). Pali i besonte kësaj zonje dhe donte që kisha ta mirëpriste dhe ta ndihmonte atë në emrin e tij. Vetë fakti që ai kishte nevojë ta thoshte këtë tregon klimën kulturore.

☐ **“shenjtorët”** Ky term do të thotë “të shenjtët.” Ai përshkruan jo vetëm pozicionin e një besimtari në Jezusin, por gjithashtu me shpresë edhe jetët e tyre të perëndishme, që e tregojnë gjithnjë e më shumë pozicionin e tyre të ri të shenjtë në Krishtin. Termi “shenjtor” është gjithmonë në SHUMËS përveç një herë në Filipianëve (4:21) dhe edhe atje është në një kuptim kolektiv. Të jesh i krishterë do të thotë të jesh pjesë e një komuniteti besimi, një familjeje, një trupi. Kisha e sotme në perëndim e ka nënvlerësuar këtë aspekt kolektiv të besimit biblik! Shih Temën e Veçantë: Shenjtorët te 1:7.

☐ **“që ta ndihmoni në çfarëdo gjëje që mund të ketë nevojë për ju”** Këtu ka dy LIDHORE. E para, *paristēmi* (AORISTE VEPRORE), do të thotë “t’i qëndrosh pranë për ta ndihmuar.” E dyta, *chrēzō* (E TASHME VEPRORE), do të thotë “të ndihmohesh me çfarëdo që kërkohet” (krh. II Kor. 3:1).

Kjo i referohej furnizimeve materiale për shërbyesit e kishës që shkonin nga një vend në tjetrin. Ky ishte qëllimi i letrave të rekomandimit.

☐
NASB, NKJV **“ka qenë ndihmëse për shumë”**
NRSV **“ka qenë mirëbërëse për shumë”**

TEV “sepse ajo vetë ka qenë mike e mirë për shumë njerëz”
NJB “është kujdesur për mjaft njerëz”

Ky term, *proistatis*, gjendet vetëm këtu në DHR. Kjo mund t’i referohet ndihmës fizike ose materiale. Kjo fjalë fillimisht i referohej një padroneje të pasur. Meqenëse Feba po udhëtonte për në Romë (krh. v. 1) dhe kishte ndihmuar shumë (krh. v. 2), kjo mund të jetë historikisht e vërtetë për të.

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:3-16

³Përshtëndesni Priskën dhe Akuilën, bashkëpunëtorët e mi në Krishtin Jezus, ⁴që për jetën time rrezikuan kokat e tyre, të cilët nuk i falenderoj vetëm unë, por edhe kishat e johebrenjve; ⁵gjithashtu përshtëndesni kishën që është në shtëpinë e tyre. Përshtëndesni Epenetin, të dashurin tim, që është i pari i kthyer në Krishtin nga Azia. ⁶Përshtëndesni Marinë, që ka punuar shumë për ju. ⁷Përshtëndesni Andronikun dhe Junian, të afërmit e mi dhe të burgosur bashkë me mua, që janë të dalluar midis apostujve, edhe që ishin në Krishtin përpara meje. ⁸Përshtëndesni Ampliatin, të dashurin tim në Zotin. ⁹Përshtëndesni Urbanin, bashkëpunëtorin tonë në Krishtin, dhe Stakin tim të dashur. ¹⁰Përshtëndesni Apelin, të miratuarin në Krishtin. Përshtëndesni ata që janë nga shtëpia e Aristobulit. ¹¹Përshtëndesni Herodionin, kushëririn tim. Përshtëndesni ata të shtëpisë së Narcisit, që janë në Zotin. ¹²Përshtëndesni Trifenën dhe Trifozën, punëtore në Zotin. Përshtëndesni Persidën e dashur, që ka punuar shumë në Zotin. ¹³Përshtëndesni Rufin, një burrë i zgjedhur në Zotin, gjithashtu nënën e tij dhe timen. ¹⁴Përshtëndesni Asinkritin, Flegontin, Hermesin, Patrobin, Hermasin dhe vëllezërit me ta. ¹⁵Përshtëndesni Filologun dhe Julian, Nereun dhe motrën e tij Olimpën, dhe të gjithë shenjtorët që janë me ta. ¹⁶Përshtëndesni njëri-tjetrin me një puthje të shenjtë. Të gjitha kishat e Krishtit ju përshtëndesin.

16:3 “Priska dhe Akuila” Luka e quan “Priskila.” Ajo shpesh përmendet përpara të shoqit, gjë që ishte shumë e pazakontë nga ana kulturore (krh. Veprat 18:18, 26; I Kor. 16:19; II Tim. 4:19). Ndoshta ajo ishte nga fisnikëria romake ose ishte personaliteti dominues në këtë çift. Edhe Pali edhe ky çift ishin çadrabërës, ose lëkurë-punues. Pali i quan ata “bashkëpunëtorë në Krishtin Jezus.” Ai ndoshta ka dëgjuar për pikat e forta dhe të dobëta të kishës së Romës nga ky çift.

16:4 “rrezikuan kokat e tyre” Kjo është një idiomë nga termi për “sopatën e xhelatit.” Bibla nuk na tregon se çfarë donte të thoshte Pali me këtë frazë.

▣ **“të cilët nuk i falenderoj vetëm unë, por edhe kishat e johebrenjve”** Pali ishte shumë mirënjohës për miqësinë dhe ndihmën aktive të këtij çifti. Ai madje e zgjeron shërbimin e tyre tek “të gjitha kishat e johebrenjve.” Çfarë përgëzim dhe falenderim! Kjo mund t’i referohet faktit që ata inkurajuan dhe mësuan Apolin në shërbesën e tij (krh. Veprat 18:24-28).

16:5 “kishën” Kjo i referohet njerëzve, jo ndërtesës. Termi kishte kuptimin “ata që janë thirrur jashtë.” Në DHV në greqisht, Septuagintën (LXX), ky term u përdor për të përkthyer termin hebraik *qahal*, të përkthet “bashkësi.” Kisha e hershme e shikonte veten si pasardhësit e natyrshëm dhe plotësimi i “bashkësisë së Izraelit” të DHV dhe jo një grup sektar që kishte dalë prej tyre. Shih Temën e Veçantë te 16:1.

▣ **“që është në shtëpinë e tyre”** Të krishterët e hershëm takoheshin nëpër shtëpi (krh. 16:23; Veprat 12:12; I Kor. 16:19; Kol. 4:15 dhe Filemoni 2). Ndërtesat e kishës nuk dalin deri në shekullin e tretë pas Krishtit (A.D.).

▣ **“Epenetin”** Emri i këtij njeriu do të thotë “i lavdëruar.”

▣ **“që është i pari i kthyer në Krishtin”** Kjo është thënë edhe për shtëpinë e Stefanos në I Kor. 16:15.

▣ **“nga Azia”** Kjo i referohej provincës romake që përbënte një të tretën perëndimore të Turqisë së sotme.

16:6 “Marinë, që ka punuar shumë për ju” Asgjë nuk dihet për këtë person. Ajo mund të ketë qenë misionare nga kisha e Romës. Ka shumë besimtarë të mrekullueshëm, të perëndishëm që janë të panjohur për ne, por të mirënjohur për Perëndinë.

16:7 “të burgosur bashkë me mua” Studiuesit e sotëm nuk janë të sigurt se cilit burgim i referohet këtu. Pali vuajti shumë për besimin e tij (krh. II Kor. 4:8-11; 6:4-10; 11:25-28). Ai u burgos në Filipi, Cezare, Romë dhe ndoshta edhe në vende të tjera (krh. Efes, I Kor. 15:32; II Kor. 1:8).

▣ **“Junias”** Ky emër mund të jetë në GJININË MASHKULLORE ose FEMËRORE, gjë që duhet përcaktuar nga shenjat e theksit. Ka variante të dorëshkrimeve greke, “*Iounian*,” gjendet në MSS X, A, B, C, D, F, G & P, por pa shenja theksimi. Forma e theksuar FEMËRORE gjendet në MSS B², D², dhe 0150. Dorëshkrimi i hershëm në papirus P⁴⁶ dhe disa përkthime Vulgate dhe Koptike, si edhe tekste greke të përdorur nga Jeronimi e kanë “*Ioulian*” që është femërore. Disa studiues mendojnë se ky ishte gabim i kopistit. Kjo formë FEMËRORE del edhe në 16:15. Është e mundur që të dy personat e përmendur në v. 7 ishin

1. dy besimtarë hebrenj që ishin burgosur me Palin
2. vëlla e motër
3. burrë e grua

Nëse është FEMËRORE dhe nëse fraza “apostujt” i referohej një përdorimi më të gjerë të këtij termi sesa “Të Dymbëdhjetët”, atëherë ajo ishte një grua apostulle.

Është gjithashtu interesante që gërmëzimi “Junias” nuk haset gjatë në literaturën apo mbishkrimet romake, por emri “Junia” ishte shumë i përhapur. Ishte emër i zakonshëm familjar romak. Për më tepër informacion mbi gratë në shërbesë shih *Women Leaders and the Church*, nga Linda L. Belleville, fq. 188 shënimi 42.

▣

NASB “që janë të dalluar midis apostujve”

NKJV “që janë të shënuar midis apostujve”

NRSV “ata janë të shquar midis apostujve”

TEV “ata janë të mirënjohur midis apostujve”

NJB “për ata apostuj të shquar”

Kjo mund t’iu referohet Të Dymbëdhjetëve, dhe nëse kështu, këta të dy ishin të mirënjohur prej tyre, ose një grupi më të gjerë shërbyesish të kishës të njohur si “apostuj” (krh. Veprat 14:4, 14; 18:5; I Kor. 4:9; Gal. 1:19; Fil. 2:25; I Thes. 2:6). Konteksti nënkupton këtë përdorim më të gjerë, si tek Efe. 4:11, por NYJA SHQESE nënkupton Të Dymbëdhjetët. Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (*Apostellō*) te 1:1.

▣ **“edhe që ishin në Krishtin përpara meje”** Kjo është e qartë që do të thotë se ata ishin të shpëtuar dhe aktivë në shërbimin e Krishtit përpara kthimit të Palit rrugës për në Damask.

16:8-16 Emrat në këtë seksion janë të panjohur për studiuesit. Ata janë të dashur për Perëndinë dhe Palin, por emrat dhe shërbimi i tyre nuk janë regjistruar në DHR ose në literaturën e hershme të krishterë. Ajo që është domethënëse është që ka një përzierje të (1) emrave të zakonshëm të skllëvërve; (2) të fisnikëve romakë; dhe (3) emrave të familjeve hebreje. Ka burra dhe gra. Ka njerëz të lirë e të pasur dhe predikues shëtitës. Ka të huaj nga Persia. Të gjitha pengesat kanë rënë në kishën e Jezu Krishtit (krh. 3:22; 10:12; Joeli 2:28-32 [Veprat 2:14-21]; I Kor. 12:11; Gal. 3:28; Kol. 3:11)!

16:8 “Ampliatin” Ky emër, ashtu si Priska dhe Junia, ishte një emër i mirënjohur i familjeve romake.

▣ **“të dashurin tim në Zotin”** Termi “i dashur” është përdorur nga Perëndia Atë për Jezusin Birin te Mat. 3:17 dhe 17:5, që mund të jetë një titull nga Këngët e Shërbëtorit të Isaias (krh. Mat. 12:18, që citon Isa. 42:1). Megjithatë, Pali e përdor atë për t’iu drejtuar besimtarëve (krh. 1:7; 16:8,9; I Kor. 4:14,17; 15:58; Efe. 6:21; Fil. 2:12; Kol. 4:7,9,14; I Tim. 6:2; Filemoni v. 16).

16:9 “Urbanin” Ky emër do të thotë “banor qyteti” ose “i rritur në qytet.”

▣ **“në Krishtin”** Kjo është një frazë e përsëritur, bashkë me “në Zotin,” gjatë gjithë këtij kapitulli. Këta punëtorë të krishterë ishin të gjithë pjesë e një familjeje, një Shpëtimtari.

▣ **“Stakin”** Ky është një emër i rrallë që do të thotë “kalli” (gruri). Arkeologjia e ka gjetur këtë emër të lidhur me familjen e Cezarit.

16:10 “të miratuarin në Krishtin” Kjo frazë idiomatike i referohet dikujt që kishte kaluar përmes sprovave dhe kishte mbetur besnik. Shih Temën e Veçantë te 2:18.

▣ **“që janë nga shtëpia”** Disa studiues hamendësojnë që kjo frazë i referohet skllevërve në shërbimin shtëpiak të Aristobulit dhe jo anëtarëve të familjes, dhe e njëjta është e vërtetë edhe për frazën në v. 11, “ata të shtëpisë së Narcisit.”

▣ **“e Aristobulit”** Disa studiues (Lightfoot) hamendësojnë që ky ishte vëllai i Herod Agripës I (i cili në Veprat 12 urdhëroi vrasjen e Apostullit Jakob). Nëse është kështu, kjo tregon se si ungjilli kishte filluar të depëronte këtë familje mbretërore idumease.

16:11 “Herodionin” Ky mund të ketë qenë një skllav i familjes së Herodit.

▣ **“ata të shtëpisë së Narcisit”** Kjo mund t’i referohet shërbëtorit të mirënjohur të Perandorit Klaud. Nëse është kështu, kjo tregon se si ungjilli kishte filluar të depëronte familjen perandorake romake.

16:12 “Trifena” Ky emër do të thotë “fine.”

▣ **“Trifoza”** Ky emër do të thotë “delikate.” Ato ndoshta ishin motra, madje edhe binjake.

▣ **“worked hard”** Termi ka nënkuptimin e mundimit “deri në pikën e rraskapitjes.”

▣ **“Persida”** Kjo do të thotë “Persiane.”

16:13 “Rufi” Ky emër do të thotë “i kuq” ose “flokë-kuq.” Në Romë me sa duket jetonte dikush i njohur me këtë emër (krh. Mark 15:21). Nuk e dimë me siguri nëse është i njëjti, por është e mundur.

▣
NASB “një burrë i zgjedhur në Zotin”
NKJV, NRSV “i zgjedhur në Zotin”
TEV “ai punëtor i dalluar në shërbimin e Zotit”
NJB “një shërbëtor i zgjedhur i Zotit”

Kjo fjalë për fjalë është “i zgjedhuri.” Këtu termi lidhet jo vetëm me thirrjen e Perëndisë, por edhe me shërbimin e tij si mënyrë jetese. Edhe nëna e tij e trajtoi Palin me shumë dashuri.

16:14 “Hermes” Ky është emri i perëndisë së fatit të mirë. Ishte një emër shumë i zakonshëm skllavi në botën greko-romake të shekullit të parë.

16:15 “të gjithë shenjtorët” Shih Temën e Veçantë: Shenjtorët te 1:7.

16:16 “puthje të shenjtë” Nuk ka të dhëna të hershme se kush puthte kë, ose kur, ose ku. Në sinagogë burrat puthnin burrat në faqe dhe gratë puthnin gratë, dhe kjo formë përshëndetjeje u vazhduar edhe në kishë (krh. I Kor. 16:20; II Kor. 13:12; I Thes. 5:26; I Pjet. 5:14). Ky akt përshëndetjeje u bë problem brenda kishës sepse keqkuptohej nga jobesimtarët, dhe prandaj u ndalua në disa kisha, megjithëse Justin Martiri e përmend në shekullin e dytë.

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:17-20

¹⁷Tani, ju nxis vëllezër, shënojinia ata që shkaktajnë përçarje dhe pengesa në kundërshtim me mësimin që keni mësuar dhe largohuni prej tyre. ¹⁸Sepse njerëz të tillë janë skllevër, jo të Zotit tonë Krishtit, por të orekseve të tyre; dhe me anë të fjalëve të tyre të buta dhe lajkatuese ata mashtrojnë zemrat e atyre që nuk dyshojnë. ¹⁹Sepse nami i bindjes suaj ka shkuar tek të gjithë; prandaj, unë gëzohem për ju, por dua që të jeni të urtë për atë që është e mirë dhe naivë për të keqen. ²⁰Perëndia i paqes do ta shtypë së shpejti Satanin nën këmbët tuaja. Hiri i Zotit tonë Jezus qoftë me ju.

16:17 Ky paralajmërim duket sikur hyn në kontekst papritur. Megjithatë, Pali mund ta ketë përfshirë atë si një kontrast me shërbyesit shëtitës të ungjillit që ishin të perëndishëm. Ka një listë në vv. 17-18 të asaj se çfarë po bënin këta mësues të rremë.

1. ata nxisinin përçarje
2. ata vendosnin pengesa në rrugën e besimtarit
3. ata mësonin në kundërshtim me udhëzimet që kishte dhënë kisha
4. ata po u shërbenin orekseve të tyre të ulëta
5. ata po mashtronin zemrat e njerëzve që nuk dyshonin me anë të fjalëve të tyre të buta dhe lajkatuese

Kjo listë nuk lidhet me besimtarët e dobët dhe të fortë të 14:1-15:13.

▣ **“largohuni prej tyre”** Kjo është E TASHME VEPRORE URDHËRORE. Kjo është një temë e përsëritur (krh. Gal. 1:8-9; II Thes. 3:6,14; II Gjonit 10).

16:18

NASB, NRSV

TEV “orekseve të tyre”

NKJV “barkut të tyre”

NJB “lakmisë së tyre”

Kjo është fjalë për fjalë “barqeve” (krh. Fil. 3:19; Titit 1:12). Mësuesit e rremë e kthenin çdo gjë në favor të interesave të tyre të ulëta.

▣ **“me anë të fjalëve të tyre të buta dhe lajkatuese”** Mësuesit e rremë janë shpesh fizikisht tërheqës dhe kanë personalitete dinamike (krh. Kol. 2:4). Ata janë shpesh shumë logjikë në prezantimet e tyre. Kini kujdes! Disa prova të mundshme biblike për të identifikuar mësuesit e rremë gjenden në LiP. 13:1-5; 18:22; Mat. 7; Fil. 3:2-3, 18-19; I Gjonit 4:1-3.

▣ **“ata mashtrojnë zemrat e atyre që nuk dyshojnë”** Kjo është E TASHME VEPRORE DËFTORE që tregon mashtrim të vazhdueshëm. Këta besimtarë me sa duket të rinj ose naivë ishin të rrezikuar (“pa përvojë në të keqen”).

16:19 “nami i bindjes suaj ka shkuar tek të gjithë” Kjo përmendet në 1:8. Është një nga hiperbolat e Palit.

▣ **“të jeni të urtë për atë që është e mirë dhe naivë për të keqen”** Kjo reflekton mësimin e Jezusit (krh. Mat. 10:16; Luka 10:3).

16:20 “Perëndia i paqes” Ky është një titull i mrekullueshëm për Perëndinë (krh. 15:33; II Kor. 13:16; Fil. 4:9; I Thes. 5:23 dhe Heb. 13:20).

▣ **“do ta shtypë së shpejti Satanin nën këmbët tuaja”** Ky është aluzion ndaj Zan. 3:15. Marrëdhënia e besimtarit me Mesianin i jep edhe besimtarit fitore (krh. I Gjonit 5:18-20). Ky është një premtim i mahnitshëm por edhe një përgjegjësi po e tillë. Në këtë kontekst Satani është fjala që përmbledh konfuzionin dhe përçarjet që kanë shkaktuar mësuesit e rremë, gjë që e bën kishën ta humbasë fokusin e saj të Porosisë së Madhe. Prapa mësuesve të rremë është demonikja! Megjithatë, ungjilli e shpërndan errësirën dhe të keqen për ata që e përqafojnë dhe jetojnë sipas tij. Për një libër të mirë mbi këtë temë shihni *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare, (Tri pyetje kritike në lidhje me luftën shpirtërore)* nga Clinton E. Arnold.

TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON

Kjo është një temë shumë e vështirë për një sërë arsyesh.

1. DhV nuk zbulon një kryeamik ndaj së vërtetës, por një shërbëtor të JHVH-së, i cili i ofron njerëzimit një alternativë dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi (A. B. Davidson, *Old Testament Theology*, f. 300-306).
2. Koncepti i një kryeamiku personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërdhjatore (jokanonike)

nga ndikimi i fesë persiane (*zoroasrianizmi*). Nga ana e vet, ajo ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik.

3. DhR i zhvillon temat e DhV nëpërmjet kategorive çuditërisht të prera, por dhe të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, ose autor, ose gjini letrare, studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse ligësinë e studiojmë nga një qasje jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose e feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimit të DhR gjën pararendës në dualizmin persian dhe në spiritizmin greko-romak.

Nëse je i përkushtuar në mënyrë paraprake ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit, atëherë zhvillimi në DhR duhet parë si zbuluesë e përshkallëzuar. Të krishterët duhet të ruhen që të mos lejojnë idetë popullore judaike apo letërsinë evropiane (p.sh., Danten dhe Miltonin) që të qartësojnë më tej këtë koncept. Pa dyshim që ka mister dhe vagulli në këtë zonë të zbulësës. Perëndia ka zgjedhur të mos na zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, origjinën dhe synimin e saj, por na ka zbuluar mposhtjen e saj!

Në DhV, termi Satan (BDB 966), ose akuzues, duket se përdoret për tre grupe të ndryshme.

1. akuzues njerëzorë (1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbret. 11:14,23,25; Ps. 109:6)
2. akuzues engjëj (Num. 22:22-23; Zak. 3:1)
3. akuzues demonë (1 Kro. 21:1; 1 Mbret. 22:21; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën ndërthjatore, identifikohet me Satanin gjarpri i Zanafillës 3 (shih Libri i Urtësisë 2:23-24; 2 Enokut 31:3); madje, kalon edhe më shumë kohë para se ky të bëhet mendim rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 bëhen engjëjt e ligj në 1 Enokut 54:6. Ata bëhen fillesa e ligësisë në teologjinë rabinike. Këtë po e përmend, jo për të pohuar saktësinë e saj teologjike, por për të treguar zhvillimin e saj. Në DhR, këto veprimtari të DhV i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëjlore (pra, Satanit) në 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9.

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (në varësi të pikëvështrimit) të përcaktohet nga DhV. Një arsye për këtë është monoteizmi i fortë i Izraelit (shih 1 Mbret. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi i atribuohet JHVH-së për të demonstruar natyrën unike dhe epërsinë e tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bijtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14; Ezekieli 28, ku mbretërit krenarë të lindjes së afërt (Babilonisë dhe Tirit) përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë s’jam shumë i bindur për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora të kopshtit të Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohjes së të Mirës dhe të Keqes (Ezekieli 31). Nga ana tjetër, Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një rebelim engjëjlor për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, kjo është një mënyrë dhe vend tejet i paqartë për këtë synim. Duhet t’i ruhemi prirjes së teologjisë sistematike që të marrë pjesë të vogla dhe të vagullta nga dhiata, autorë, libra dhe gjini të ndryshme e t’i kombinojë si copëza të një enigme hyjnore.

Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah [Jeta dhe kohët e Jezus Mesisë]*, vëll. 2, shtojcat XIII [f. 748-763] dhe XVI [f. 770-776]) thotë se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi dhe hamendësimi demoniak pers. Rabinët nuk janë burim i mirë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi ndryshon tërësisht nga mësimet e sinagogës. Unë mendoj se koncepti rabinik për ndërmjetësimi dhe kundërshtimi engjëjlor në dhënien e ligjit që iu bë Moisiut në malin Sinai i hapi derën konceptit të armikut kryeengjëjlor të JHVH-së dhe njerëzimit. Në dualizmin persian (zoroastrian) ka dy perëndi të larta, *Akhi-man* dhe *Ormaza*, e mira dhe e liga. Ky dualizëm u zhvillua në një dualizëm të kufizuar judaik të JHVH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, në DhR shohim përparimin e zbulësës në lidhje me zhvillimin e konceptit të ligësisë, por jo aq me hollësi sa ç’shpallin rabinët. Një shembull i mirë i këtij dallimi është “lufta në qiell”. Rënia e Satanit është domosdoshmëri logjike, por detajet nuk jepen. Edhe ajo që jepet mbulohet me gjininë apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbyes i JHVH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t’i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ekziston vetëm një Perëndi dhe njerëzimi është përgjegjës për veprimet e veta. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara ashtu dhe pas shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe përmes tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet!

■ **“Hiri i Zotit tonë Jezus qoftë me ju”** Kjo është një mbyllje e zakonshme për Palin (krh. I Kor. 16:23; II Kor. 13:14; Gal. 6:18; Fil. 4:23; Kol. 4:18; I Thes. 5:28; II Thes. 3:18 dhe gjithashtu te Zbu. 22:21). Ajo ndoshta shkruhej me dorën e tij. Ishte mënyra e tij për të vërtetuar që letrat ishin të tijat (krh. II Thes. 3:17; I Kor. 16:21; Kol. 4:18).

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:21

²¹**Timoteu bashkëpunëtori im ju përshëndet, dhe po kështu edhe Luci dhe Jasoni dhe Sosipatri, të afërmit e mi.**

16:21-23 Këto vargje janë poshtë-shënim. Bashkëpunëtorët e Palit në Korint dërgojnë përshëndetjet e tyre.

16:21 “Luci” Ky mund të ketë qenë

1. Luka mjeku (krh. Kol. 4:14), ose ndoshta një idiomë për “shumë i shkolluari”
2. Luci i Kirenës (krh. Veprat 13:1)
3. një i krishterë i panjohur

■ **“Jasoni”** Ky është ndoshta Jasoni në shtëpinë e të cilit qëndroi Pali kur ishte në Selanik (krh. Veprat 17:5-9).

■ **“Sosipatri”** Ky njeri ka mundësi të jetë Sosipatri i Bereas në Veprat 20:4.

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:22

²²**Unë, Terci, që e shkruaj këtë letër, ju përshëndes në Zotin.**

16:22 “Unë, Terci, që e shkruaj këtë letër” Pali përdorte një shkruar (*amanuensis*) për të shkruar letrat e tij (krh. I Kor. 16:21; Gal. 6:11; Kol. 4:18; II Thes. 3:17). Mendoj se Pali kishte probleme me shikimin dhe nuk mund të shkruante me shkronjat e vogla e të ngjeshura që ishin të nevojshme për të kursyer hapësirën në një papirus ose në një pergamenë (krh. Gal. 6:18)!

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:23-24

²³**Gai, mikpritësi im dhe i të gjithë kishës, ju përshëndet. Erasti, thesarmbajtësi i qytetit ju përshëndet dhe Kuarti, vëllai.** ²⁴**[Hiri i Zotit Jezu Krisht qoftë me ju të gjithë. Amen.]**

16:23 “Gai” Ky mund të ketë qenë

1. Gaius Titius Justus i Veprave 18:7
2. Gai i Derbës (krh. Veprat 19:29; 20:4; I Kor. 1:14)
3. Gai i III Gjonit v. 1

■ **“mikpritësi im dhe i të gjithë kishës”** Kjo ishte mikpritja e nevojshme në kishë. Disa besimtarë që kishin mundësi financiare i lejonin shërbyesit shëtitës të qëndronin tek ata. Disa, si ky njeri, e hapnin shtëpinë edhe si vend takimi për kishën. Kishat shtëpi ishin norma për mbi njëqind vjet. Shih Temën e Veçantë: Kisha (*Ekklesia*) në 16:1.

■ **“Erasti, thesarmbajtësi i qytetit”** Edhe ai përmendet te Veprat 19:22; II Tim. 4:20. Ai kishte një shërbesë shëtitëse të lidhur me Palin.

■ **“Kuarti”** Ky emër në latinisht do të thotë “i katërti.” Ai ndoshta ishte vëllai i Tercit, që në latinisht do të thotë “i tretë” (krh. v. 22).

16:24 Ky varg nuk është në dorëshkrimet më të hershme greke, P⁴⁶, 61, 8, A, B, C, dhe 0150. Ai gjendet në disa dorëshkrime greke pas 16:23 dhe në të tjerë pas 16:27. Patjetër që nuk është origjinal i Palit. Ai është hequr në përkthimet NASB, NRSV, TEV dhe NJB. UBS⁴ e vlerëson heqjen e saj “të sigurt” (A). Ajo është një mbyllje tentative e letrës dhe lidhet me problemin e doksologjisë mbyllëse që gjendet në fund të kapitujve 14, 15, dhe 16 në tekste të ndryshme në greqisht.

TEKSTI NASB (I PËRDITËSUAR): 16:25-27

²⁵Tani Atij që është në gjendje t'ju forcojë sipas ungjillit tim dhe predikimit të Jezu Krishtit, sipas zbulësës së misterit që është mbajtur i fshehtë për epoka të tëra në të shkuarën, ²⁶por tani është bërë i dukshëm, dhe me anë të Shkrimeve të profetëve, sipas urdhërimit të Perëndisë së përjetshëm, u është bërë i njohur të gjithë kombeve, duke çuar në bindjen e besimit; ²⁷të vetmit Perëndi të urtë, përmes Jezu Krishtit, i goftë lavdia përjetë. Amen.

16:25-27 Kjo është një fjali në greqisht. Ky bekim mund të gjendet në dorëshkrimet e lashta greke, edhe në fundin e kapitullit 14 dhe të kapitullit 15. Ky kontekst është një përmbledhje e temave kryesore të librit që ka të ngjarë të jetë shkruar me dorën e Palit vetë.

Disa besojnë se kjo doksologji mund të ketë qenë

1. letra shoqëruese për letrën qarkore të Efesianëve
2. për ata rrugës për në Romë sepse
 - a. Pali nuk e kishte vizituar kurrë Romën, e megjithatë përshëndet njëzet e gjashtë njerëz
 - b. në kapitullin 16 përmenden për herë të parë mësuesit e rremë
 - c. doksologjia e tij del në dorëshkrimet greke në disa vende të ndryshme.

Është gjithashtu e mundur që Pali të ketë bërë dy kopje, kapitujt 1-14 për në Romë, kapitujt 1-16 për në Efes. Zakonisht këto thënie marrin si përgjigje

1. faktin që shumë nga këta të krishterë të hershëm udhëtonin
2. faktin që asnjë dorëshkrim drejtuar Romakëve nuk është pa kapitullin 16
3. mundësinë që mësuesit e rremë nënkuptohen në 14:1-15:13

16:25 “Atij që është i aftë” Ky është një tjetër titull i mrekullueshëm për Perëndinë i përdorur tri herë në DHR (krh. Efe. 3:20; Juda 24).

Vini re se si Perëndia i përforcon besimtarët.

1. predikimi i ungjillit nga Pali
2. predikimi në lidhje me Jezus Krishtin
3. zbulimi i planit të përjetshëm të Perëndisë për shpëtimin që kishte qenë mbajtur i fshehtë (mister)

Besimtarët aftësohen nga njohja e ungjillit. Ky ungjill është bërë tani i disponueshëm për të gjithë!

■ **“misterit”** Perëndia ka një qëllim të unifikuar për shpengimin e njerëzimit që ekzistonte madje përpara Rënies (krh. Zan. 3). Gjurmë të këtij plani janë zbuluar në DHV (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; dhe në pasazhet universale në Profetët). Megjithatë kjo axhendë e plotë nuk ishte e qartë (krh. I Kor. 2:6-8). Me ardhjen e Jezusit dhe të Frymës ajo fillon të bëhet më e dukshme. Pali përdori termin “mister” për të përshkruar këtë plan total të shpengimit (krh. I Kor. 4:1; Efe. 2:11-3:13; 6:19; Kol. 4:3; I Tim. 1:9). Megjithatë, ai e përdor atë në disa kuptime të ndryshme.

1. Një ngurtësim i pjesshëm i Izraelit për t'i lejuar johebrenjtë që të përfshihen. Kjo hyrje e hebrenjve do të funksionojë si një mekanizëm që hebrenjtë ta pranojnë Jezusin si Krishtin e profecisë (krh. Rom. 11:25-32).
2. Ungjilli iu bë i njohur kombeve, të cilët janë përfshirë të gjithë në Krishtin dhe përmes Krishtit (krh. Rom. 16:25-27; Kol. 2:2).
3. Trupat e rinj të besimtarëve në Ardhjen e Dytë (krh. I Kor. 15:5-57; I Thes. 4:13-18).
4. Sjellja e të gjitha gjërave nën një krye të vetëm, në Krishtin (krh. Efe. 1:8-11).
5. Johebrenjtë dhe hebrenjtë janë bashkë-trashëgimtarë (krh. Efe. 2:11-3:13).
6. Intimiteti dhe marrëdhënia mes Krishtit dhe Kishës përshkruar në terma martesore (krh. Efe. 5:22-33).
7. Johebrenjtë të përfshirë në popullin e besëlidhjes dhe të brendabanuar nga Fryma e Krishtit në mënyrë që prodhon pjekuri në ngjashmëri me Krishtin, domethënë, restauron imazhin e dëmtuar të Perëndisë në njerëzimin e rënë (krh. Zan. 6:5, 11-13; 8:21) të Perëndisë në njeriun (krh. Zan. 1:26-27; 5:1; 9:6; Kol. 1:26-28).
8. Anti-Krishtin e fundit të kohërave (krh. II Thes. 2:1-11).
9. Një përmbledhje e misterit e përdorur nga kisha e hershme gjendet në I Tim. 1:16.

16:26 “tani është bërë i dukshëm” Ky mister ose plan i Perëndisë tani është zbuluar qartë për të gjithë njerëzimin. Ai është ungjilli i Jezus Krishtit (krh. Efe. 2:11-3:13).

☐ **“dhe me anë të Shkrimeve”** Perëndia e ka manifestuar këtë mister në personin dhe veprën e Jezusit. Kjo ishte parathënë nga profetët e DHV. Ngritja e kishës së DHR të përbërë nga besimtarë hebrej dhe johebrej ishte gjithmonë plani i Perëndisë (krh. Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Jer. 31:31-34).

☐ **“Perëndisë së përjetshëm”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: I PËRJETSHËM

Robert B. Girdlestone, në librin e tij *Synonyms of the Old Testament, (Sinonime të Dhiatës së Vjetër)* ka një koment interesant mbi fjalën “i përjetshëm”:

“Mbiemri *aiōnios* është përdorur më shumë se dyzet herë në DHR në lidhje me *jetën e përjetshme*, që konsiderohet pjesërisht si një dhuratë e tanishme, dhe pjesërisht si një premtim për të ardhmen. Ajo gjithashtu përdoret për ekzistencën e pafund të Perëndisë në Rom. 16.26; për efikasitetin e pafundëm të shlyerjes së Krishtit në Heb. 9.12, 13.20; dhe për epokat e shkuara në Rom. 16.25, 2 Tim. 1.9, Titit 1.2.

Kjo fjalë është përdorur në lidhje me *zjarrin e përjetshëm*, Mat. 18.8,25. 41, Juda 7; *ndëshkimin e përjetshëm*, Mat. 25.46; *grykimin ose ndëshkimin e përjetshëm*, Mark 3.29, Heb. 6.2; *shkatërrimin e përjetshëm*, 2 Thes. 1.9. Fjala në këto pasazhe nënkupton *përfundimësi*, dhe me sa duket do të thotë që kur këto gjykime të ekzekutohen, koha e provës, e ndryshimit, ose mundësia për të marrë mbrapsht pasurinë do të kenë shkuar përgjithmonë. Në kuptojmë shumë pak në lidhje me të ardhmen, në lidhje me raportin e jetës njerëzore me pjesën tjetër të ekzistencës dhe në lidhje me peshën morale të mosbesimit, siç shihet nën dritën e përjetësisë. Nëse, nga njëra anë, është e gabuar t’i shtosh Fjalës së Perëndisë, nga ana tjetër nuk duhet as t’i heqim; dhe nëse lëkundemi nën doktrinën e ndëshkimit të përjetshëm siç prezantohet në Shkrime, ne duhet të jemi të kënaqur të presim, duke u mbajtur pas Ungjillit të dashurisë së Perëndisë në Krishtin, ndërkohë që e pranojmë se ka një sfond të errët që nuk jemi në gjendje ta kuptojmë” (fq. 318-319).

☐ **“u është bërë i njohur të gjithë kombeve”** Kjo është një PJESORE AORISTE PËSORE. Është e vendosur në fund të fjalisë greke për theksim. Perëndia ia ka paraqitur ofertën e ungjillit të gjithë botës, gjë që ka qenë gjithmonë qëllimi i Tij (krh. Zan. 3:15)!

☐
NASB “*duke çuar në bindjen e besimit*”
NKJV “*për bindje ndaj besimit*”
NRSV “*për të sjellë bindjen e besimit*”
TEV “*që çon në bindje të besimit*”
NJB “*për t’i sjellë ata në bindjen e besimit*”

Ka mënyra të ndryshme për ta kuptuar këtë frazë; ajo mund t’i referohet

1. doktrinës për Krishtin
2. besimit në Krishtin
3. bindjes ndaj ungjillit edhe në fillim, edhe në vazhdim

Bindja (krh. 1:5) duhet kombinuar teologjikisht me konceptin e pendimit dhe besimit (krh. Marku 1:15; Veprat 3:16,19; 20:21).

16:27 “të vetmit Perëndi të urtë” Ky është një aluzion ndaj monoteizmit (shih Temën e Veçantë në 3:30, krh. LiP. 6:4-5). Krishtërimi ka vetëm një Perëndi, ashtu si edhe Judaizmi, por hyjnia e plotë e Jezusit, dhe personaliteti i plotë i Frymës na detyron të pranojmë një “tri-unitet,” Trininë (shih Temën e Veçantë në 8:11).

☐ **“i qoftë lavdia përjetë”** Shih shënimin në 3:23.

☐ **“Amen”** Shih Temën e Veçantë në 1:25.

PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimor udhëzues, që do të thotë se ti je vetë përgjegjës për interpretimin e Biblës. Secili prej nesh duhet të ecë sipas dritës që ka. Ti, Bibla dhe Fryma e Shenjtë keni përparësi në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzosh këtë të drejtë komentuesit.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni për çështjet kryesore të këtij seksioni të librit. Ato kanë si qëllim të jenë nxitëse për mendimet, jo përfundimtare.

1. Nga i njihete Pali gjithë këta njerëz në kishën e Romës, kur ai nuk kishte qenë kurrë atje?
2. A ka ndonjë provë biblike për gra dhjake (krh. 16:1; I Tim. 3:11; 5:3-16)?
3. Çfarë rrjedhoje ka fakti që në këtë kapitull janë listuar kaq shumë gra?
4. Përshkruani metodat dhe mesazhin e mësuesve të remë (vv. 17-18).

SHTOJCA NJË

PËRCAKTIME TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT

Greqishtja *koine*, shpesh e quajtur greqishtja heleniste, ishte gjuha e përbashkët e botës mesdhetare, duke filluar që nga pushtimi i Aleksandrit të Madh (336-323 para K.) dhe duke zgjatur rreth tetëqind vjet (300 para K. – 500 pas K.). Ajo nuk ishte thjesht greqishte klasike e thjeshtëzuar, por, në shumë mënyra, ishte një formë më e re e greqishtes, e cila u bë gjuha e dytë e Lindjes së mesme dhe botës mesdhetare në lashtësi.

Greqishtja e Dhiatës së Re ishte unike në shumë mënyra pasi përdoruesit e saj, përjashtoj Lukën dhe autorin e Hebrejve, ndoshta përdornin aramaishten si gjuhë të parë. Si rrjedhojë, shkrimet e tyre u ndikuan nga idiomat dhe format strukturore të aramaishtes. Po kështu, ata lexonin dhe citonin Septuagintën (përkthimin greqisht të DhV), e cila ishte shkruar gjithashtu në greqishten *koine*. Mirëpo edhe Septuaginta ishte shkruar nga studiues judenj, gjuha amtare e të cilëve nuk ishte greqisht.

Kjo na shërben si kujtesë se nuk mund ta futim forcërisht Dhiatën e Re brenda një strukture të ngushtë gramatikore. Ajo është unike, por, megjithatë, ka shumë të përbashkëta me (1) Septuagintën; (2) shkrimet judaike si ato të Jozefit; dhe (3) papiruset e gjetura në Egjipt. Po atëherë, si duhet t'i qasemi analizës gramatikore të Dhiatës së Re?

Tiparet gramatikore të greqishtes *koine* dhe greqishtes *koine* të Dhiatës së Re janë të paqëndrueshme. Në shumë mënyra, bëhet fjalë për një periudhë thjeshtëzimi të gramatikës. Si udhërrëfyes kryesor do të kemi kontekstin. Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst më të gjerë, prandaj, struktura gramatikore mund të kuptohet vetëm në dritën e (1) stilit individual të autorit; dhe (2) kontekstit të veçantë. Asnjë përcaktim përfundimtar i formave dhe strukturave greke nuk është i mundshëm.

Greqishtja *koine* ishte kryesisht një gjuhë foljore. Shpesh, çelësi drejt interpretimit është lloji dhe forma e trajtave FOLJORE. Në shumicën e rasteve, FOLJA shfaqet e para, duke treguar epërsinë e saj. Në analizën e FOLJES greke, duhen vërejtur tre pjesë informacioni: (1) theksimi bazë i KOHËS, DIATEZËS dhe MËNYRËS (eptimi, ose morfologjia); (2) kuptimi bazë i FOLJES (leksikografia); dhe (3) rrjedha e kontekstit (sintaksa).

I. KOHA

A. Koha ose aspekti ka të bëjë me marrëdhënien e FOLJEVE me veprimin e përfunduar ose të papërfunduar. Shpesh, ai quhet “I KRYER”, ose “I PAKRYER”.

1. KOHËT E KRYERA përqendrohen te kryerja e një veprimi. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk jepet përveç faktit se diçka ka ndodhur! Nuk trajtohet fillimi, vazhdimi, apo kulmimi i veprimit.
2. KOHËT E PAKRYERA përqendrohen te procesi i vazhduar i një veprimi. Mund të përshkruhet në kuadër të veprimit linear, veprimit durativ, veprimit progresiv, etj.

B. Kohët mund të kategorizohen sipas mënyrës sesi autori sheh përparimin e veprimit

1. Ndodhi = AORIST
2. Ndodhi, dhe rezultatet vazhdojnë = E KRYER
3. Po ndodhte në të kaluarën dhe rezultatet po vazhdonin, por jo tani = E KRYER E TEJSHKUAR
4. Po ndodh = E TASHME
5. Po ndodhte = E PAKRYER
6. Do të ndodhë = E ARDHME

Një shembull konkret sesi ndihmojnë këto KOHË në interpretim do të ishte fjala “shpëtoj”. Ajo përdoret në disa kontekste të ndryshme për të treguar, si procesin, ashtu dhe kulmimin e tij:

1. AORISTI = “shpëtoi” (shih Rom. 8:24)
2. E KRYER = “jemi shpëtuar dhe rezultati vazhdon” (shih Efe. 2:5, 8)
3. E TASHME = “po shpëtohem” (shih 1 Kor. 1:18; 15:2)
4. E ARDHME = “do të shpëtohem” (shih Rom. 5:9; 10: 9)

- C. Kur përqendrohet te KOHËT E FOLJES, interpretuesi kërkon arsyen pse autori fillestar zgjodhi të shprehej në një KOHË të caktuar. Koha standarde, “pa lajlelule”, ishte AORISTI. Kjo ishte forma e rregullt FOLJORE “e paspecifikuar”, “e paklasifikuar”, ose “e pashënuar”. Ajo mund të përdoret në një larmi të madhe mënyrash, të cilat duhet t’i qartësojë konteksti. Kjo kohë thjesht pohon se diçka ka ndodhur. Aspekti i kohës së shkuar përdoret vetëm në MËNYRËN DËFTORE. Nëse përdoret një KOHË tjetër, po theksohej diçka më e veçantë. Por çfarë?
1. KOHA E KRYER. Bën fjalë për një veprim të përfunduar, por me rezultate që vazhdojnë. Në disa mënyra, ky ishte një kombinim i KOHËS AORISTE me atë TË TASHME. Zakonisht, fokusi është te rezultatet e vazhdueshme, ose te plotësimi i një veprimi (shembull: Efe. 2:5 dhe 8: “ju jeni shpëtuar dhe po vazhdoni të shpëtoheni”).
 2. KOHA E KRYER E TEJSHKUAR. Kjo ishte si E KRYERA, përveçse këtu rezultatet e vazhduara kanë përfunduar. Për shembull: Gjoni 18:16, “Pjetri kishte qëndruar përjashta te porta”.
 3. KOHA E TASHME. Flet për një veprim të papërfunduar ose të pakryer. Zakonisht, fokusi është te vazhdimi i ngjarjes. Shembull: 1 Gjonit 3:6 dhe 9, “Kushdo që banon në të nuk vazhdon të mëkatojë”. “Kushdo që është lindur nga Perëndia nuk vazhdon të kryejë mëkat”.
 4. KOHA E PAKRYER. Në këtë kohë, marrëdhënia me KOHËN E TASHME është e ngjashme me marrëdhënien mes TË KRYERËS dhe TË KRYERËS SË TEJSHKUAR. E PAKRYERA flet për një veprim të paplotë që po ndodhte por që, tani, ka përfunduar, ose për fillimin e një veprimi në të shkuarën. Shembull: Mateu 3:5, “atëherë gjithë Jerusalemi po vazhdonte të shkonte tek ai”, ose, “atëherë, gjithë Jerusalemi filloi të shkonte tek ai”.
 5. KOHA E ARDHME. Bën fjalë për një veprim që, zakonisht, vendoset në një kornizë kohore në të ardhmen. Fokusohej te mundësia e një ndodhie, sesa te një ndodhi aktuale. Shpesh, flet për sigurinë e ngjarjes. Shembull: Mat. 5:4-9, “Të bekuar janë... Ata do të...”.

II. DIATEZA

- A. DIATEZA përshkruan marrëdhënien mes veprimit të FOLJES dhe KRYEFJALËS së saj.
- B. DIATEZA VEPRORE ishte mënyra normale, e pritshme dhe e patheksuar për të pohuar se kryefjala po kryente veprimin e FOLJES.
- C. DIATEZA PËSORE do të thotë se kryefjala po merrte veprimin e FOLJES të kryer nga një veprues i jashtëm. Vepruesi i jashtëm që kryente veprimin tregohet në DhR greqisht me anë të këtyre PARAFJALËVE dhe rasave:
1. Një veprues personal i drejtpërdrejtë, nga *hupo* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22; Veprat 22:30).
 2. Një veprues personal i ndërmjetëm, nga *dia* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22).
 3. Një veprues jopersonal, zakonisht nga *en* me RASËN MJETORE.
 4. Nganjëherë, një veprues personal ose jopersonal, vetëm me anë të RASËS MJETORE.
- D. DIATEZA MESORE/JOVEPRORE tregon se kryefjala prodhon veprimin e FOLJES dhe, gjithashtu, është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e FOLJES. Shpesh, ajo quhet diateza e interesit të shtuar vetjak. Ky konstrukt theksonte në njëfarë mënyre kryefjalën e fjalisë ose periudhës. Ky konstrukt nuk gjendet në anglisht. Ka një mundësi të gjerë kuptimesh dhe përkthimesh në greqisht. Disa shembuj të kësaj forme janë:
1. VETVETORE – veprimi i drejtpërdrejtë i kryefjalës mbi veten. Shembull: Mat. 27:5: “vari veten”.
 2. INTENSIVE – kryefjala e kryen veprimin për vete. Shembull: 2 Kor. 11:14: “vetë Satani e maskon veten si engjëll drite”.
 3. E NDËRSJELLË – veprim i ndërsjellë i dy vepruese. Shembull: Mat. 26:4: “ata këshillonin njëri-tjetrin”.

III. MËNYRA (ose “MODALITETI”)

- A. Greqishtja *koine* ka katër MËNYRA. Ato tregojnë marrëdhënien e FOLJES me realitetin, të paktën në mendjen e autorit. MËNYRAT ndahen në dy kategori të përgjithshme: ajo që tregonte realitetin (DËFTORE) dhe ajo që tregonte mundësinë (LIDHORE, URDHËRORE dhe DËSHIRORE).
- B. MËNYRA DËFTORE ishte forma normale për të shprehur një veprim që kishte ndodhur ose që po ndodhte, të paktën në mendjen e autorit. Ishte e vetmja mënyrë greqisht që shprehte një kohë të përcaktuar, ndonëse edhe këtu ky aspekt ishte dytësor.
- C. MËNYRA LIDHORE shprehte veprim të ardhshëm të mundshëm. Diçka nuk kishte ndodhur ende, por kishte mundësi që të ndodhte. Kishte shumë të përbashkëta me DËFTOREN E ARDHME. Dallimi ishte se LIDHORJA shpreh njëfarë mase dyshimi. Shpesh, në anglisht, shprehet me termat “mund të”, “do të”, “mund”.
- D. MËNYRA DËSHIRORE shprehte një dëshirë që ishte teorikisht e mundshme. Konsiderohej si një hap më larg realitetit nga LIDHORJA. DËSHIRORJA shprehte mundësi në disa kushte të caktuara. DËSHIRORJA është e rrallë në Dhiatën e Re. Përdorimi i saj më i shpeshtë është në frazën e famshme të Palit, “Kurrë mos qoftë!” (KJV, “Mos e dhëntë Zoti”), e përdorur pesëmbëdhjetë herë (shih Rom. 3:4, 6, 31; 6:2, 15; 7:7, 13; 9:14; 11:1, 11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Shembuj të tjerë gjenden te Luka 1:38; 20:16; Veprat 8:20; dhe 1 Thes. 3:11.
- E. MËNYRA URDHËRORE theksonte një urdhër që ishte i mundshëm, por theksin e vinte te synimi i folësit. Ajo theksonte vetëm një mundësi dëshirore dhe kushtëzohej nga zgjedhjet e tjetrit. URDHËROREJA përdorej në mënyrë të veçantë në lutjet dhe në kërkesat e vetës së tretë. Këto urdhra gjenden vetëm në KOHËN E TASHME dhe atë AORISTE në DhR.
- F. Disa gramatika kategorizojnë edhe PJESORET si një tjetër lloj MËNYRE. Ato janë shumë të zakonshme në DhR greqisht, dhe zakonisht përcaktohen si MBIEMRA FOLJORË. Ato përkthehen në lidhje me FOLJEN kryesoren me të cilën kanë të bëjnë. Ekzistonte një larmi e madhe mundësish për përkthimin e PJESOREVE. Gjëja më e mirë është të konsultosh disa përkthime të Biblës në anglisht. *The Bible in Twenty Six Translations (Bibla në 26 përkthime)*, e botuar nga Baker, është shumë e dobishme në këtë pikë.
- G. DËFTORJA AORISTE VEPRORRE ishte mënyra normale, ose “e paklasifikuar”, për të shënuar një veprim. Çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte një domethënie të veçantë interpretuese që dëshironte të komunikonte autori fillestar.
- IV. Për ata që nuk e njohin greqishtes, ndihmat e mëposhtme studimore do t’u sigurojnë informacionet e nevojshme:
- A. Friberg, Barbara dhe Timothy. *Analytical Greek New Testament (Dhiata e Re analitike në greqisht)*. Grand Rapids: Baker, 1988.
- B. Marshall, Alfred. *Interlinear Greek-English New Testament (Dhiata e Re ndërlineare greqisht-anglisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1976.
- C. Mounce, William D. *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament (Leksiku analitik i Dhiatës së Re greqisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1993.
- D. Summers, Ray. *Essentials of New Testament Greek (Elementet bazë të greqishtes së Dhiatës së Re)*. Nashville: Broadman, 1950.
- E. Kurse greqishteje *koine* me korrespondence, të akredituar nga ana akademike, janë të disponueshme përmes Institutit Biblik Moody në Çikago, Illinois

V. EMRAT

- A. Nga ana sintaksore, EMRAT klasifikohen sipas RASËS. RASA ishte forma e eptuar e EMRIT, që tregonte marrëdhënien e tij me FOLJEN dhe me pjesë të tjera të fjalisë. Në greqishten *koine*, shumë prej funksioneve të RASËS tregoheshin nga PARAFJALËT. Meqë forma e RASËS ishte në gjendje të identifikonte një sërë marrëdhëniesh të ndryshme, u zhvilluan PARAFJALËT për t'u dhënë një ndarje më të qartë këtyre funksioneve të mundshme.
- B. RASAT greke kategorizoheshin në tetë mënyrat e mëposhtme:
1. RASA EMËRORE përdorej për të emërtuar dhe, zakonisht, ishte KRYEFJALA e fjalisë ose periudhës. Po kështu, përdorej edhe për EMRAT KALLZUESORË dhe MBIEMRAT me FOLJET lidhëse “jam” ose “bëhem”.
 2. RASA GJINORE përdorej për përshkrim dhe, zakonisht, i caktonte një cilësi ose sasi fjalës me të cilën lidhej. I përgjigjej pyetjes, “Çfarë lloji?” Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “i/e [dikujt]”.
 3. RASA RRJEDHORE përdoret të njëjtën formë të eptuar si GJINORJA, por përdoret për të përshkruar ndarje. Zakonisht, shënonte ndarje nga një pikë në kohë, hapësirë, burim, origjinë ose shkallë. Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “nga/prej”.
 4. RASA DHANORE përdorej për të përshkruar interes vetjak. Mund të shënonte një aspekt pozitiv, ose negativ. Shpesh, ajo ishte KUNDRINORI I ZHDREJTË. Shpesh, në anglisht shprehet me PARAFJALËN “to”.
 5. RASA VENDORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA, por përshkruante pozicionin ose vendndodhjen në hapësirë, kohë, ose kufij logjikë. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “në, mbi, mes, gjatë, me anë të, përbri”.
 6. RASA MJETORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA dhe VENDORJA. Shprehte mjete ose shoqërime. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “nga” ose “me”.
 7. RASA KALLËZORE përdorej për të përshkruar përfundimin e një veprimi. Shprehte kufizim. Kryesisht, përdorej për KUNDRINORIN E DREJTË. I përgjigjej pyetjes, “Sa larg?”, ose “Deri në çfarë mase?”
 8. RASA THIRRORE përdorej për thirrjen e drejtpërdrejtë.

VI. LIDHËZAT DHE LIDHËSET

- A. Greqishtja është gjuhë shumë precize, për shkak se ka një numër shumë të madh fjalësh lidhëse. Ato lidhin mendimet (PERIUDHAT, FJALITË dhe PARAGRAFËT). Janë kaq të zakonshme saqë, shpesh, mungesa (asindetit) e tyre ka rëndësi nga ana ekzegjetike. Në fakt, këto LIDHËZA dhe LIDHËSE tregojnë drejtimin e mendimit të autorit. Shpesh, kanë rol kyç në përcaktimin e saktë të asaj që po përpiqet të përçojë ai.
- B. Ja një listë me disa prej LIDHËZAVE dhe LIDHËSEVE, si dhe kuptimet e tyre (ky informacion është qëmtuar kryesisht nga libri i H. E. Dana dhe Julius K. Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament [Gramatikë praktike e Dhiatës së Re greqisht]*).
1. Fjalët lidhëse kohore
 - a. *epei, epeidē, hopote, hōs, hote, hotan* (LIDH.) – “kur”
 - b. *heōs* – “ndërsa”
 - c. *hotan, epan* (LIDH.) – “kurdo”
 - d. *heōs, achri, mechri* (LIDH.) – “derisa”
 - e. *prin* (PASK.) – “përpara”
 - f. *hōs* – “që kur”, “kur”, “ndërsa”
 2. LIDHËZA logjike
 - a. Qëllim
 - (1) *hina* (LIDH.), *hopōs* (LIDH.), *hōs* – “me qëllim që”, “që”

- (2) *hōste* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
 (3) *pros* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) ose *eis* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
- b. Rezultat
 (1) *hōste* (PASKAJORE, kjo është më e përhapura) – “me qëllim që”, “kështu”
 (2) *hina* (LIDH.) – “në mënyrë që”
 (3) *ara* – “kështu”
- c. Shkakore, ose arsye
 (1) *gar* (shkak/efekt, ose arsye/përfundim) – “sepse,” “pasi”
 (2) *dioti, hoti* – “sepse”
 (3) *epei, epeidē, hōs* – “meqë”
 (4) *dia* (me kallëzore) dhe (me pask. nyjore) – “për shkak”
- d. Rrjedhimore
 (1) *ara, poinun, hōste* – “prandaj”
 (2) *dio* (LIDHËZA më e fortë rrjedhimore) – “për shkak të kësaj”, “si rrjedhojë”, “prandaj”
 (3) *oun* – “prandaj”, “kështu”, “atëherë”, “rrjedhimisht”
 (4) *toinoun* – “në këtë mënyrë”
- e. Kundërshtore, ose kontrast
 (1) *alla* (KUNDËRSHTORE e fortë) – “por”, “përveç”
 (2) *de* – “por”, “megjithatë”, “gjithsesi”, “nga ana tjetër”
 (3) *kai* – “por”
 (4) *mentoi, oun* – “sidoqoftë”
 (5) *plēn* – “gjithsesi” (kryesisht te Luka)
 (6) *oun* – “megjithatë”
- f. Krahasim
 (1) *hōs, kathōs* (prezanton FJALITË KRAHASUESE)
 (2) *kata* (në fjalë të përbëra, *katho, kathoti, kathōsper, kathaper*)
 (3) *hosos* (te Hebrenjve)
 (4) *ē* – “sesa”
- g. Vazhduese, ose seri
 (1) *de* - “dhe”, “tani”
 (2) *kai* – “dhe”
 (3) *te* – “dhe”
 (4) *hina, oun* – “që”
 (5) *oun* – “atëherë” (te Gjoni)
3. Përdorimet theksuese
 a. *alla* – “sigurisht”, “po”, “madje”
 b. *ara* – “me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 c. *gar* – “por me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 d. *de* – “me të vërtetë”
 e. *ean* – “madje”
 f. *kai* – “madje”, “me të vërtetë”, “vërtet”
 g. *mentoi* – “me të vërtetë”
 h. *oun* – “vërtetë”, “patjetër”

VII. PERIUDHA KUSHTORE

- A. PERIUDHA KUSHTORE është ajo që përmban një ose më tepër fjali të varura kushtore. Kjo strukturë gramatikore i vjen në ndihmë interpretimit për shkak se jep kushtet, arsyet, ose shkaqet pse ndodh ose pse nuk ndodh veprimi i FOLJES kryesore. Ka katër lloje PERIUDHASH KUSHTORE. Ato variojnë nga ajo që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit (ose për synimet e tij) tek ajo që është vetëm dëshirë.
- B. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË PARË shprehte veprim ose qenie që supozohej si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrimtarit (ose për synimet e tij), ndonëse shprehej me “nëse”. Në një sërë kontekstesh,

mund të përkthehet “meqë” (shih Mat. 4:3; Rom. 8:31). Sidoqoftë, me këtë nuk nënkuptojmë se të gjitha KLASËT E PARË përrputhen me realitetin. Shpesh, ato përdoren për të vërtetuar një argument ose për të theksuar një ide të gabuar (shih Mat. 12:27).

- C. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË DYTË shpesh quhet “kundër fakteve”. Ajo shpreh diçka që ishte e pavërtetë ndaj realitetit, në mënyrë që të argumentonte diçka. Shembuj:
1. “Po të ishte vërtet profet, dhe nuk është i tillë, do të dinte se kush dhe ç’karakter është kjo gruaja që po varet tek ai, por ja që nuk e di” (Luka 7:39)
 2. “Po t’i kishit besuar vërtet Moisiut, por ju nuk i besoni, do të besonit edhe në mua, por ja që nuk po e bëni” (Gjoni 5:46)
 3. “Po të përpiqesha ende që të kënaqja njerëzit, gjë që nuk po e bëj, nuk do të isha aspak skllav i Krishtit, por ja që jam i tillë” (Gal. 1:10).
- D. KLASI I TRETË bën fjalë për një veprim të mundshëm në të ardhmen. Shpesh, supozon probabilitetin e veprimit. Zakonisht, nënkupton kushtëzim nga rrethanat. Veprimi i FOLJES kryesore varet nga veprimi në fjalinë e varur që fillon me “nëse”. Shembuj nga 1 Gjoni: 1:6-10; 2:4, 6, 9, 15, 20, 21, 24, 29; 3:21; 4:20; 5:14, 16.
- E. KLASI I KATËRT është më i largëti për sa i përket mundësisë. Është i rrallë në DhR. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë PERIUDHË e plotë KUSHTORE E KLASIT TË KATËRT, ku të dyja pjesët e kushtit të përrputhen me këtë përcaktim. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë hapëse është 1 Pje. 3:14. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë përmbyllëse është Veprat 8:31.

VIII. NDALIMET

- A. URDHËRORJA E TASHME me PJESËZËN MË shpesh (por jo ekskluzivisht) thekson ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër. Disa shembuj: “mos mblidhni më pasuri në tokë...” (Mat. 6:19); “mos u shqetësoni më për jetën tuaj...” (Mat. 6:25); “mos i ofroni më mëkatit gjymtyrët e trupit tuaj si mjete keqbërjeje...” (Rom. 6:13); “duhet të ndalni së fyeri Frymën e Shenjtë të Perëndisë...” (Efe. 4:30); dhe “ndalni së u dehuri me verë...” (5:18).
- B. LIDHORJA AORISTE me PJESËZËN MË ka këtë theks: “as mos fillo apo nis të bësh një veprim”. Disa shembuj: “As mos fillo të mendosh se...” (Mat. 5:17); “kurrë mos fillo të shqetësohesh...” (Mat. 6:31); “kurrë s’duhet të kesh turp...” (2 Tim. 1:8).
- C. MOHORJA E DYFISHTË me MËNYRËN LIDHORE përbën një mohim shumë të theksuar. “Kurrën e kurrës”, ose “në asnjë lloj rrethane”. Disa shembuj: “Ai nuk do të përjetojë kurrën e kurrës vdekje” (Gjoni 8:51); “Unë, kurrën e kurrës, nuk...” (1 Kor. 8:13).

IX. NYJA SHQUESE

- A. Në greqishten *koine*, NYJA SHQUESE kishte një përdorim të ngjashëm me një shquese “*the*” në anglisht. Funkzioni bazë i saj ishte të shërbente si “dëftues”, si mënyrë për të tërhequr vëmendjen ndaj një fjale, emri, ose fraze. Përdorimi i saj ndryshon nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. NYJA SHQUESE mund të funksionojë edhe si
1. mjet ballafaques, si PËREMËR dëftor;
 2. shenjë për t’iu referuar një teme ose personi të prezantuar më herët;
 3. mënyrë për të identifikuar KRYEFJALËN në fjali me një FOLJE lidhëse. Shembuj: “Perëndia është Frymë” (Gjoni 4:24); “Perëndia është dritë” (1 Gjoni 1:5); “Perëndia është dashuri” (4:8, 16).
- B. Greqishtja *koine* nuk kishte NYJË JOSHQUESE si në anglisht, “a” ose “an”. Mungesa e NYJËS SHQUESE mund të nënkuptonte
1. Një përqendrim te karakteristikat ose cilësitë e diçkaje

2. Një fokus në kategorinë e diçkaje

C. Autorët e DhR ndryshonin së tepërmi nga njëri-tjetri për mënyrën si e përdornin NYJËN.

X. MËNYRA PËR TË TREGUAR THEKSIMIN NË DHIATËN E RE GREQISHT

A. Teknikat për të treguar theksimin ndryshojnë nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. Shkrimtarët më të njëtrajtshëm dhe më formalë ishin Luka dhe autori i Hebrenjve.

B. Më herët, pohuam se DËFTORJA AORISTE VEPRORE ishte standarde dhe e paklasifikuar për theksim, por çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte domethënie nga ana interpretuese. Me këtë nuk po themi se DËFTORJA AORISTE VEPRORE nuk përdorej shpesh në një kuptim gramatikor domethënës. (Shembull: Rom. 6:10 [dy herë]).

C. Rendi i fjalëve në greqishten *koine*

1. Greqishtja *koinē* ishte një gjuhë e eptuar që, në dallim nga anglishtja, nuk varej nga rendi i fjalëve. Si rrjedhojë, autori mund ta ndryshojë rendin e pritishtëm dhe normal të fjalëve për të treguar

- a. atë që autori donte t'i theksonte lexuesit
- b. atë që autori mendonte se do të ishte e papritur për lexuesin
- c. atë që autori e kishte shumë për zemër

2. Rendi normal i fjalëve në greqisht është ende një çështje e pazgjidhur. Megjithatë, rendi i supozuar normal është ky:

- a. për FOLJET lidhëse
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) PLOTËS
- b. për FOLJET KALIMTARE
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) KUNDRINOR
 - (4) KUNDRINOR I ZHDREJTË
 - (5) FRAZË PARAFJALORE
- c. për FRAZAT EMËRORE
 - (1) EMËR
 - (2) PËRCAKTOR
 - (3) FRAZË PARAFJALORE

3. Rendi i fjalëve mund të jetë një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme ekzegjetike. Shembuj:

- a. “dorën e djathtë na dhanë mua dhe Barnabës për miqësi”. Fraza “dora e djathtë e miqësisë” ndahet dhe është vendosur në krye për të treguar domethënien e vet (Gal. 2:9).
- b. “me Krishtin” vendoset në fillim. Vdekja e tij ishte qendrore (Gal. 2:20).
- c. “ishte pjesë-pjesë dhe në shumë mënyra të ndryshme” (Heb. 1:1) vendoset në fillim. Kontrasti që po jepet është mënyra sesi Perëndia e zbuloi veten, jo fakti i zbulësës.

D. Zakonisht, njëfarë shkalle theksimi tregohet nga

1. Përsëritja e PËREMËRIT që ishte tashmë i pranishëm në formën e eptuar të FOLJES. Shembull: “unë, vetë, do të jem patjetër me ju...” (Mat. 28:20).
2. Mungesa e një LIDHËZE të pritishtë, ose ndonjë tjetër mjeti lidhës mes fjalëve, frazave, fjalive, ose periudhave. Kjo gjë quhet asindet (“jo e lidhur”). Mjeti lidhës pritej, prandaj mungesa e tij tërhiqte vëmendje. Shembuj:
 - a. “Lum”-et në Mal, Mat. 5:3 e më tej (e theksoi listën)
 - b. Gjoni 14:1 (temë e re)

- c. Romakëve 9:1 (pjesë e re)
- d. 2 Kor. 12:20 (thekson listën)
- 3. Përsëritja e fjalëve ose frazave të pranishme në një kontekst të dhënë. Shembuj: “për lëvdimin e lavdisë së tij” (Efe. 1:6, 12 & 14). Kjo frazë përdoret për të treguar veprën e secilit person të Trinisë.
- 4. Përdorimi i një idiome ose loje fjalësh (tingujsh) mes termave
 - a. eufemizmat – zëvendësim fjalësh për disa tema tabu, si “gjumi” për vdekjen (Gjoni 11:11-14), ose “këmbët” për gjenitalet mashkullore (Ruthi 3:7-8; 1 Sam. 24:3).
 - b. perifrazimet – zëvendësim fjalësh për emrin e Perëndisë, si “Mbretëria e qiejve” (Mat. 3:21), ose “një zë nga qielli” (Mat. 3:17).
 - c. FIGURAT LETRARE
 - (1) ekzagjerime të pamundura (Mat. 3:9; 5:29-30; 19:24)
 - (2) pohime disi të tepruara (Mat. 3:5; Veprat 2:36)
 - (3) personifikime (1 Kor. 15:55)
 - (4) ironi (Gal. 5:12)
 - (5) pasazhe poetike (Fil. 2:6-11)
 - (6) lojë tingujsh mes fjalëve
 - (a) “kisha”
 - i. “kisha” (Efe. 3:21)
 - ii. “thirrja” (Efe. 4:1, 4)
 - iii. “i thirrur” (Efe. 4:1, 4)
 - (b) “i lirë”
 - i. “grua e lirë” (Gal. 4:31)
 - ii. “liri” (Gal. 5:1)
 - iii. “i lirë” (Gal. 5:1)
 - d. gjuha idiomatike – terminologji që, zakonisht, është e veçantë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme:
 - (1) përdorimi figurativ i fjalës “ushqim” (Gjoni 4:31-34)
 - (2) përdorimi figurativ i fjalës “tempull” (Gjoni 2:19; Mat. 26:61)
 - (3) idioma hebraike për termin dhembshuri, “urrej” (Zan. 29:31; LiP. 21:15; Luka 14:36; Gjoni 12:25; Rom. 9:13)
 - (4) “Të gjithë” përkundër “shumë”-ve. Krahaso Isa. 53:6 (“të gjithë”) me 53:11 & 12 (“shumë”). Këta terma janë sinonimikë, siç e tregojnë dhe Rom. 5:18 dhe 19.
- 5. Përdorimi i një fraze të plotë gjuhësore, në vend të një fjale të vetme. Shembull: “Zoti Jezu Krisht”.
- 6. Përdorimi i veçantë i *autos*
 - a. kur ka NYJË (pozicioni atributiv), përkthehej “i njëjti”.
 - b. kur s’ka NYJË (pozicioni kallëzuesor), përkthehej si PËREMËR VETVETOR INTENSIV – “veten e tij”, “veten e saj”.

- E. Studiuesi i Biblës që nuk di greqisht mund ta identifikojë theksimin në mënyra të ndryshme:
- 1. Përdorimi i një leksiku analitik dhe i një teksti ndërlinear greqisht/anglisht.
 - 2. Krahasimi i përkthimeve në gjuhën angleze, sidomos ato përkthime që kanë teori të ndryshme përkthimi. Shembull: krahasimi i një përkthimi “fjalë për fjalë” (KJV, NKJV, ASV, NASB, RSV, NRSV) me një përkthim të “ekuivalencës dinamike” (Williams, NIV, NEB, REB, JB, NJB, TEV). Ndihmë e dobishme këtu do të ishte *The Bible in Twenty-Six Translations*, përkthyer nga Baker.
 - 3. Përdorimi i *The Emphasized Bible (Bibla e theksuar)*, nga Joseph Bryant Rotherham (Kregel, 1994).
 - 4. Përdorimi i një përkthimi shumë të fjalëpërfjalshëm
 - a. *The American Standard Version* i vitit 1901
 - b. *Young’s Literal Translation of the Bible*, nga Robert Young (Guardian Press, 1976).

Studimi i gramatikës është i mërzitshëm, por i domosdoshëm për interpretimin e saktë. Këto përcaktime të shkurtra, komente dhe shembuj synojnë të inkurajojnë dhe të pajisin personat që nuk dinë greqisht që të përdorin shënimet gramatikore të dhëna në këtë vëllim. Pa dyshim, këto përcaktime janë të mbithjeshëtuara. Ato nuk duhen përdorur në mënyrë dogmatike dhe të pandryshueshme, por si trampolina drejt të kuptuarit më të mirë të

sintaksës së Dhiatës së Re. Shpresoj se këto përcaktime do t'u mundësojnë lexuesve edhe që të kuptojnë komentet e ndihmave të tjera studimore, si komentarët teknikë për Dhiatën e Re.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimin tonë ta verifikojmë në bazë të informacionit që gjendet në tekstin e Biblës. Gramatika është një nga pjesët më të dobishme të këtij informacioni; elementet e tjera përfshijnë sfondin historik, kontekstin letrar, përdorimin bashkëkohor të fjalëve, dhe pasazhet paralele.

SHTOJCA DY

KRITIKA E TEKSTIT

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojmë shënimet tekstuale që gjenden në këtë komentari. Do të përdorim përvijimin e mëposhtëm:

6. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

D. Dhiata e Vjetër

E. Dhiata e Re

7. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kritikës së ulët”, e quajtur edhe ‘kritika e tekstit’.

8. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

E. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

c. Dhiata e Vjetër

d. Teksti Masoretik (MT) – teksti bashkëtingëllor hebraisht u përcaktua nga rabini Akiva më 100 pas K. Pikat e zanoreve, thekset, shënimet anësore, pikësimi dhe pikat e aparatusit filluan të shtoheshin në shekullin në shekullin e gjashtë pas K. dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas K. Kjo u bë nga një familje studiuesish judenj të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që përdoren ata ishte e njëjta që përdoret në Mishnah, Talmud, Targumet, Peshita dhe Vulgatë.

e. Septuaginta (LXX) – Tradita thotë se Septuaginta u prodhua nga 70 studiues judenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë, me sponsorizimin e mbretit Ptoleme II (285-246 pas K.). Me gjasë, përkthimi u kërkua nga një udhëheqës jude që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristeas”. Shpesh, LXX bazohet në një traditë tekstuale hebraisht që ndryshon nga teksti i rabinut Akiva (MT).

f. Pergamenat e Detit të Vdekur (DSS) – Pergamenat e Detit të Vdekur u shkruan në periudhën romake para Krishtit (200 para K. deri më 70 pas K.) nga një sekt separatistësh judenj të quajtur “esenë”. Dorëshkrimet hebraisht, të gjetura në vendndodhje të ndryshme përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraisht disi të ndryshme nga ajo e MT dhe LXX.

g. Disa shembuj të veçantë për mënyrën sesi krahasimi i këtyre teksteve ka ndihmuar interpretuesit që të kuptojnë Dhiatën e Vjetër

XI. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në

i. LXX, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë do të mahniten me të”.

ii. MTT, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë u habitën me ty”.

iii. Në Isa. 52:15 konfirmohet dallimi përemëror i LXX

(6) LXX, “kështu dhe shumë kombe do të mrekullohen prej tij”

(7) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”

XII. DSS kanë ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në

D. DSS, në Isa. 21:8: “atëherë vrojtuesi bërtiti, ‘Mbi një kullë roje po qëndroj’ ...”

E. MT, në Isa. 21:8: “dhe unë bërtita, një luan! Zoti im, unë do të qëndroj gjithmonë në kullën e rojës ditën...”

XIII. Si LXX, ashtu dhe DSS, kanë ndihmuar për qartësimin e Isa. 53:11

5. LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij, ai do të shohë dritë dhe do të kënaqet”

6. MT, “ai do të shohë... e mundimit të shpirtit të tij, do të kënaqet”

d. Dhiata e Re

4. Kanë mbijetuar mbi 5,300 dorëshkrime të gjithë Dhiatës së Re, ose të pjesëve të saj. Rreth 85 janë shkruar në papirus ndërsa 268 prej tyre janë shkruar vetëm me shkronja të mëdha (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas K., u zhvillua një shkrim i lidhur (minuskul). Dorëshkrimet greqisht, në formë të shkruar, numërojnë rreth 2,700. Po kështu, kemi dhe rreth 2,100 kopje me lista pasazhesh biblike që përdoren në adhurim, të cilat i quajmë leksionarë.

5. Rreth 85 dorëshkrime greqisht, që përmbajnë pjesë të Dhiatës së Re të shkruara në papirus, gjenden në muze. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas K., por shumica janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas K. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban gjithë Dhiatën e Re. Thjesht fakti se ato janë kopjet më të lashta të Dhiatës së Re nuk do të thotë automatikisht se kanë më pak variante. Shumë prej tyre u kopjuan me shpejtësi për përdorim lokal. Nuk u ushtrua kujdes në këtë proces. Si rrjedhojë, ato përmbajnë shumë variante.
 6. Kodiku Sinaitikus, i njohur me shkronjën hebraisht א (*alef*), ose (01), i gjetur në manastirin e shën Katerinës në malin Sinai nga Tischendorf. Daton nga shekulli i katërt pas K. dhe përmban, si LXX-në e DhV, ashtu dhe Dh.R. greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
 7. Kodiku Aleksandrinus, i njohur si “A”, ose (02), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili u gjet në Aleksandri të Egjiptit.
 8. Kodiku Vatikanus, i njohur si “B”, ose (03), i gjetur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas K. Përmban si LXX-në e Dhiatës së Vjetër, ashtu dhe Dhiatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
 9. Kodiku Ephraemi, i njohur si “C”, ose (04), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili është shkatërruar pjesërisht.
 10. Kodiku Bezae, i njohur si “D”, ose (05), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë ose të gjashtë. Është përfaqësuesi kryesor i atij që quhet “tekst perëndimor”. Përmban shumë shtesa dhe është dëshmitari kryesor në greqisht për përkthimin e King James Version.
 11. Dorëshkrimet e DhR mund të grupohen në tre, ndoshta dhe katër, familje që ndajnë disa karakteristika.
 3. Teksti aleksandrian nga Egjipti
 - (4) P⁷⁵, P⁶⁶ (rreth 200 pas K.), që përmbajnë ungjijtë
 - (5) P⁴⁶ (rreth 225 pas K.), që përmban letrat e Palit
 - (6) P⁷² (rreth 225-250 pas K.), që përmban Pjetrin dhe Judën
 - (7) Kodiku B, i quajtur Vatikanus (rreth 325 pas K.), që përfshin gjithë DhV dhe DhR
 - (8) Origeni citon nga ky lloj teksti
 - (9) Dorëshkrime të tjera që shfaqin këtë lloj teksti janë א, C, L, W, 33
 4. Teksti perëndimor nga Afrika veriore
 - (1) Citime nga etërit e kishës në Afrikën veriore, Tertuliani, Qipriani dhe përkthimi i “Vjetër Latin”
 - (2) Citime nga Ireneu
 - (3) Citime nga Tatiani dhe përkthimi “i Vjetër Siriak”
 - (4) Kodiku D, “Beza”, ndjek këtë lloj teksti
 5. Teksti bizantin i lindjes, nga Kostandinopoja
 - F. Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 dorëshkrimeve
 - G. Citohet nga etërit e kishës në Antioki të Sirisë, Kapadokianët, Gojarti dhe Theodreti
 - H. Kodiku A, vetëm në ungjijtë
 - I. Kodiku E (shekulli i tetë) për gjithë DhR
 6. Lloji i katërt i mundshëm është ai “cezareas”, nga Palestina
 5. Kryesisht, shihet vetëm te Marku
 6. Disa dëshmitarë të tij janë P⁴⁵ dhe W
- F. Problemet dhe teoritë e “kritikës së ulët”, ose “kritikës së tekstit”.
5. Si u shfaqën variantet
 - F. të paqëllimshëm ose aksidentalë (shumica dërrmuese e tyre)
 - d. shkarje syri në kopjimin me dorë, ky syri lexon rastin e dytë të dy fjalëve të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, lë pa shkruar të gjitha fjalët e ndërmjetme (homoioteleuton)
 - F. shkarje syri, duke lënë pa shkruar një shkronjë, fjalë, ose frazë, që duhej shkruar dy herë (haplografi)
 - G. shkarje mendjeje, duke përsëritur një frazë ose rresht të tekstit greqisht (ditografi)
 - e. shkarje veshi, që ndodhte në kopjimin me diktim gojor, ku ndodh një keqshqiptim (itacizëm). Shpesh, keqshqiptimi nënkupton ose shqipton një fjalë tjetër greqisht, që tingëllon në mënyrë të ngjashme.

- f. teksti më i hershëm greqisht nuk kishte ndarje në kapituj apo vargje, pak ose aspak pikëzim dhe asnjë ndarje mes fjalëve. Është e mundur që t'i ndash shkronjat në vende të ndryshme, duke formuar fjalë të ndryshme.
- G. të qëllimshëm
- C. bëheshin ndryshime për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar
- D. bëheshin ndryshime duke kombinuar dy ose më tepër variante të ndryshme në një tekst të gjatë e të kombinuar (bashkëshkrirje)
- E. bëheshin ndryshime për të korrigjuar ndonjë problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
- F. disa informacione shtesë në lidhje me sfondin historik ose interpretimin e duhur të tekstit vendoseshin në anë të faqes nga njëri kopjues, ndërsa një kopjues i dytë i fuste në tekst (shih Gjoni 5:4)
6. Parimet bazë të kritikës së tekstit (udhërrëfyes logjikë për përcaktimin e leximit origjinal të një teksti kur ekzistojnë forma variante)
 4. Teksti më i vështirë, ose më i pazakontë nga ana gramatikore, ka gjasa të jetë origjinali
 5. Teksti më i shkurtër ka gjasa të jetë origjinali
 6. Tekstit më të vjetër i jepet më tepër peshë për shkak të afërsisë së tij historike me origjinalin, në rast se gjithçka tjetër është në ekuilibër
 7. MSS që janë të larmishme nga ana gjeografike zakonisht kanë leximin origjinal
 8. Duhet preferuar tekstet më të dobët nga ana doktrimore, sidomos ato që lidhen me diskutimet kryesore teologjike të periudhës së ndryshimeve në dorëshkrime, si Trinia në 1 Gjonit 5:7-8.
 9. Teksti që arrin të shpjegojë më mirë origjinën e varianteve të tjerë
 10. Dy citime që ndihmojnë për të treguar ekuilibrin për këto variante shqetësuese
 4. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism*, f. 68:

“Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet nga një tekst i debatueshëm; dhe studiuesi i DhR duhet të ketë kujdes që të mos dëshirojë që teksti i tij të jetë më ortodoks, ose më i fortë nga ana doktrinator, sesa vetë origjinali i frymëzuar”.
 5. W. A. Criswell i tha Greg Garrisonit të *The Birmingham News* se ai (Criswell) nuk besonte se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut të sotëm nga shekuj përkthyesish”. Criswell tha: “unë jam besimtar i fortë në kritikë e tekstit. Si i tillë, unë mendoj se gjysma e fundit e kapitullit 16 të Markut është herezi: nuk është e frymëzuar, por thjesht e shpikur.... Kur e krahason me dorëshkrimet më të lashta, nuk ekziston diçka e tillë si përmbyllja e librit të Markut. Dikush e shtoi...”

Patriarku i atyre të SBC-së që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës pohoi gjithashtu se “ndërhyrja” është e dukshme edhe në Gjoni 5, në rrëfimin e Jezusit te pellgu i Betezdës. Po kështu, ai diskuton për dy rrëfimet e ndryshme të vetëvrastjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat 1): “Këtu kemi thjesht një pikëpamje të ndryshme të vetëvrastjes”, tha Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një shpjegim për këtë. Dhe dy rrëfimet e vetëvrastjes së Judës janë në Bibël”. Criswell shtoi: “Kritika e tekstit është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Nuk është kalimtare, nuk është e pacipë. Ajo është dinamike dhe qendrore...”
- G. Problemet në dorëshkrime (kritika e tekstit)
- i. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm
 - A. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual (Kritika e Biblës: historike, letrare dhe tekstuale)*, nga R. H. Harrison
 - B. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption, and Restoration (Teksti i Dhiatës së Re: transmetimi, shprishja dhe ndreqja e tij)*, nga Bruce M. Metzger
 - C. *Introduction to New Testament Textual Criticism (Hyrje në kritikën e tekstit të Dhiatës së Re)*, nga J. H. Greenlee

SHTOJCA TRE

FJALORTH

A priori. Në thelb, ky është sinonim i termit “presupozim”. Nënkupton arsyetim mbi bazën e përcaktimeve, parimeve, ose pozicioneve të pranuar më parë, të cilat merren si të vërteta. Pra, nënkupton atë që pranohet pa shqyrtim ose analizë.

Adoptimizmi. Ishte një nga pikëpamjet e hershme për marrëdhënien e Jezusit me hyjninë. Në thelb, pohonte se Jezusi ishte njeri normal në të gjitha mënyrat dhe se u birësua në mënyrë të veçantë nga Perëndia në çastin e pagëzimit (shih Mat. 3:17; Marku 1:11), ose në ringjalljen e tij (Rom. 1:4). Jezusi bëri një jetë kaq shembullore saqë Perëndia, në një pikë të caktuar, (në pagëzim, ose në ringjallje) e adoptoi si “birin” e vet (shih Rom. 1:4; Fil. 2:9). Kjo ishte një pikëpamje pakice në kishën e hershme në shekullin e tetë. Në vend që Perëndia të bëhet njeri (Mishërimi), kjo pikëpamje e përmbys radhën dhe, tani, njeriu bëhet Perëndi!

Ajo është tejet simbolike dhe imagjinare, me shumë terma kriptikë. Shpesh, të vërtetën e shpreh me ngjyra, numra, vegime, ëndrra, ndërmjetësime engjëjsh, fjalë të fshehta e të koduara dhe, shpesh, me një dualizëm të fortë mes mirësisë dhe ligësisë.

Alegori. Ky është një lloj interpretimi biblik që, së pari, u zhvillua brenda judaizmit aleksandrian. U popullarizua nga Filoja i Aleksandrisë. Thelbi bazë i alegorisë është dëshira për t'i dhënë Shkrimin peshë aktuale në sistemin filozofik ose kulturor të kohës duke anashkaluar sfondin historik dhe/ose kontekstin letrar të Biblës. Ajo kërkon një kuptim të fshehur ose shpirtëror pas çdo teksti të Shkrimit. Duhet pranuar se Jezusi, në Mateu 13, dhe Pali, në Galatasve 4, përdorën alegori për të përçuar të vërtetën. Sidoqoftë, këtë e bënë në formë tipologjie, jo ngushtësisht alegorie.

Aleksandrinus. Ky dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë nga Aleksandria, në Egjipt, përfshin Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe shumicën e Dhiatës së Re. Ai është një nga dëshmitarët tanë kryesorë për gjithë Dhiatën e Re në greqisht (me përjashtim të disa pjesëve të Mateut, Gjonit dhe 2 Korintasve). Kur ky dorëshkrim, që emërtohet me shkronjën “A”, përkon me dorëshkrimin e emërtuar “B” (Vatikanus) për ndonjë variant të caktuar teksti, konsiderohet si teksti origjinal nga shumica e studiuesve në shumicën e rasteve.

Analogjia e Shkrimit. Kjo frazë përdoret për të përshkruar pikëpamjen se gjithë Bibla është frymëzuar nga Perëndia dhe se, si rrjedhojë, nuk është kontradiktore, por plotësuese, në vetvete. Ky pohim parasupozues është baza për përdorimin e pasazheve paralele për të interpretuar pjesët biblike.

Anësi. Ky është një term që përdoret për të përshkruar një predispozitë të fortë kundrejt një objekti ose pikëpamjeje. Është një mendësi ku paanësia është e pamundur në lidhje me një objekt ose pikëpamje të caktuar. Anësia është një pozicion i paragjykuar.

Antitetik. Ky është një nga tre termat përshkruar që përdoren për të përcaktuar marrëdhënien mes rreshtave të poezisë hebraike. Ajo përshkruan ato rreshta poezie që janë të kundërt në kuptim me njëra-tjetrën (shih Prov. 10:1; 15:1).

Antropomorfik. Ky term do të thotë “të kesh karakteristika që shfaqen në qeniet njerëzore” dhe përdoret për të përshkruar terminologjinë tonë fetare në lidhje me Perëndinë. Ai vjen nga fjala greke “njerëzim”. Do të thotë se ne flasim për Perëndinë si të ishte njeri. Perëndia përshkruhet me fjalë fizike, sociologjike dhe psikologjike që lidhen me qeniet njerëzore (shih Zan. 3:8; 1 Mbret. 22:19-23). Sigurisht, kjo është thjesht analogji. Sidoqoftë, s’kemi ç’kategori ose fjalë të tjera të përdorim përveç atyre njerëzore. Si rrjedhojë, ndonëse e vërtetë, njohuria jonë për Perëndinë është e kufizuar.

Apolog (Apologjetikë). Kjo vjen nga rrënja e fjalës greke “mbrojtje ligjore”. Përbën një disiplinë të veçantë brenda teologjisë, e cila përpiqet të japë fakte dhe argumente racionale për besimin e krishterë.

Arianizëm. Ari ishte presbiter në kishën e Aleksandrisë, në Egjipt, në shekullin e tretë dhe në fillim të shekullit të katërt. Ai thoshte se Jezusi ishte paraekzistues, por jo hyjnor (jo i së njëjtës substance si Ati), ndoshta duke ndjekur Fjalët e Urta 8:22-31. Ai u sfidua nga peshkopi i Aleksandrisë, i cili (më 318 pas K.) nisi një polemikë që zgjati shumë vjet. Arianizmi u bë kredoja zyrtare e kishës lindore. Këshilli i Nikesë, më 325 pas K., e dënoi Arin dhe pohoi barazinë e plotë të Birit me Atin si dhe natyrën e tij të plotë hyjnore.

- Aristoteli.** Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë, nxënës i Platonit dhe mësues i Aleksandrit të Madh. Edhe sot, ndikimi i tij depërton në shumë fusha të studimeve moderne. Kjo ndodh për shkak se ai theksonte njohurinë përmes vëzhgimit dhe klasifikimit. Ky është një nga parimet bazë të metodës shkencore.
- Autografet.** Ky është një emër që u jepet shkrimeve origjinale të Biblës. Të gjitha këto dorëshkrime origjinale, të shkruara me dorë, kanë humbur. Kanë mbetur vetëm kopjet e kopjeve. Ky është burimi i shumë varianteve tekstuale në dorëshkrimet hebraisht dhe greqisht dhe në versionet e lashta.
- Autori fillestar.** Me këtë, kuptojmë autorët/shkruesit realë të Shkrimit.
- Autoriteti biblik.** Ky term përdoret në një kuptim shumë të specializuar. Përcaktohet si përpjekja për të kuptuar atë që tha autori fillestar në kohën e vet dhe për ta zbatuar këtë të vërtetë në kohën tonë. Zakonisht, autoriteti Biblik përcaktohet si “konsiderimi i Biblës vetë si udhërrëfyesi ynë i vetëm me autoritet”. Sidoqoftë, në dritën e disa interpretimeve të papërshtatshme të kohës sonë, këtë koncept e kam kufizuar për të nënkuptuar interpretimin e Biblës sipas parimeve të metodës historiko-gramatikore.
- Beza.** Ky është një dorëshkrim greqisht dhe latinisht i shekullit të gjashtë pas K. Emërtohet “D”. Përmban ungjijtë, Veprat dhe disa nga letrat e përgjithshme. Karakterizohet nga shumë shtesa shkruesh. Përbën bazën e “Textus Receptus”, tradita kryesore e dorëshkrimeve greqisht që qëndron pas King James Version.
- Deduktive.** Kjo metodë logjike ose arsyetimi kalon nga parimet e përgjithshme në zbatime të veçantë me anë të arsyes. Është e kundërta e arsyetimit induktiv, i cili reflekton metodën shkencore duke kaluar nga elementet e veçanta të vëzhguara në përfundime të përgjithshme (teori).
- Dialektike.** Kjo është metoda arsyetuese me anë të së cilës ajo që duket kontradiktore ose paradoksale mbahet e bashkuar brenda një tensioni, duke kërkuar një përgjigje të unifikuar që përfshin të dyja anët e paradoksit. Shumë doktrina biblike kanë çifte dialektike, paracaktimi-vullneti i lirë; siguria-qëndresa; besimi-veprat; vendimi-dishepullizimi; liria e krishterë-përgjegjësia e krishterë.
- Diaspora.** Ky është termi teknik që përdoret nga judenjtë e Palestinës për të përshkruar judenjtë e tjerë që jetonin jashtë kufijve gjeografikë të Tokës së Premtuar.
- Disa parime të shprehura të gnosticizmit valentinian dhe kerintian në shekullin e dytë janë: (1) materia dhe shpirti janë të bashkëpërjetshme (dualizmi ontologjik). Materia është e keqe, shpirti është i mirë. Perëndia, i cili është shpirti, nuk mund të merret drejtpërdrejt me modelimin e materies së ligë; (2) midis Perëndisë dhe materies ekzistojnë “rrezatime” (*eon*-et, ose nivelet engjëllore). I fundmi dhe më i ulëti i tyre ishte Jahve i DhV, i cili formoi universin (*kozmos*); (3) Jezusi ishte një rrezatim si Jahve, por i një shkalle më të lartë, më pranë Perëndisë së vërtetë. Disa e vendosnin në shkallën më të lartë, por gjithsesi, si më të ulët se Perëndia dhe sigurisht jo si Hyjni të mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të kishte trup njerëzor dhe të mbetej prapëseprapë hyjnor. Ai ishte një fantazmë shpirtërore (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6); dhe (4) shpëtimi sigurohej me anë të besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cilat njihet vetëm nga persona të veçantë. Nevojitej njohuri (fjalëkalimet) për të kaluar përmes sferave qiellore. Për të arritur te Perëndia nevojitej dhe legalizmi judaik.
- Disa shembuj të kësaj gjinie janë (1) në Dhiatën e Vjetër, Ezekieli (kapitujt 36-48), Danieli (7-12), Zakaria, dhe (2) në Dhiatën e Re, Mateu 24, Marku 13; 2 Thesalonikasve 2; dhe Zbulesa.
- Dorëshkrim.** Ky term ka të bëjë me kopjet e ndryshme të Dhiatës së Re në greqisht. Zakonisht, ato ndahen në lloje të ndryshme sipas (1) materialit ku janë shkruar (papirus, lëkurë), ose (2) formës së vetë shkrimit (shkrim me shkronja të mëdha, ose me shkronja të lidhura kursive). Shkurtimi i saj është “MS” (njëjës), ose “MSS” (shumës).
- Dykuptimësia.** Kjo ka të bëjë me pasigurinë që rezulton në një dokument të shkruar kur ka dy ose më tepër kuptime të mundshme, ose kur përmenden dy ose më tepër gjëra në të njëjtën kohë. Ka gjasa që Gjoni të ketë përdorur dykuptimësinë e qëllimshme (fjalë më kuptim të dyfishtë).
- Eisegjezë.** Kjo është e kundërta e eksegjezës. Nëse eksegjeza është “nxjerrja jashtë” e synimit të autorit fillestar, ky term nënkupton “futjen” e një ideje ose mendimi të huaj në tekst.
- Eklektik.** Ky term përdoret në lidhje me kritikën e tekstit. Nënkupton praktikën e përzgjedhjes së varianteve nga dorëshkrime të ndryshme greqisht me qëllim që të arrijmë te një tekst që supozohet se është pranë autografeve origjinale. Ai refuzon pikëpamjen se një familje e caktuar dorëshkrimesh greqisht përmban tekstin origjinal.
- Eksegjezë.** Ky është një term teknik për praktikën e interpretimit të një pasazhi të caktuar. Do të thotë “të nxjerrësh jashtë” (nga teksti), që nënkupton se synimi ynë është të kuptojmë synimin e autorit fillestar në dritën e sfondit historik, kontekstit letrar, sintaksës dhe kuptimit të fjalëve në kohën që u shkruan.

Ekuivalenca dinamike. Kjo është një teori e përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35, dhe në Hyrjen e Robert Bratcher për versionin TEV.

Etimologji. Ky është një aspekt i studimit të fjalëve që përpiket të sigurojë kuptimin fillestar të fjalëve. Nga ky kuptim rrënjë, identifikohen më lehtë përdorimet e specializuara të fjalëve. Në interpretim, fokusin kryesor nuk e përbën etimologjia, por kuptimi dhe përdorimi i fjalëve në kohën e autorit.

Është e vështirë të shpjegojmë me fjalë sesi Jezusi, Perëndia Bir, një hyjni paraekzistues, u shpërblye ose u lartësua për jetën shembullore që kreu. Nëse ai ishte tashmë Perëndi, si mund të shpërblehej? Nëse kishte lavdinë hyjnore paraekzistuese, si mund të nderohej më tepër? Ndonëse e kemi të vështirë që ta kuptojmë, Ati në njëfarë mënyre e nderoi Jezusin në një kuptim të veçantë për përmbushjen e përsosur që ai i bëri vullnetit të Atit.

Fragmenti Muratorian. Kjo është një listë e librave kanonikë të Dhiatë së Re. U shkrua në Romë përpara vitit 200 pas K. Jep po ata njëzet e shtatë libra që kemi në DhR protestante. Kjo tregon qartazi se, praktikisht, kishat lokale në pjesë të ndryshme të perandorisë romake e kishin përcaktuar kanonin përpara këshillave të mëdhenj të kishës në shekullin e katërt.

Frymëzim. Ky është koncepti se Perëndia i ka folur njerëzimit duke udhëhequr autorët biblikë që të shënojnë saktë dhe qartë zbulesën e tij. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

Fushë semantike. Ka të bëjë me gamën e plotë të kuptimeve që shoqërohen me një fjalë të caktuar. Në thelb, nënkupton ngjyrimet e ndryshme që ka një fjalë në kontekste të ndryshme.

Gnosticizëm. Shumica e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Sidoqoftë, idetë fillestare të tij ishin të pranishme në shekullin e parë (dhe më herët).

Gjini letrare. Kjo ka të bëjë me format e veçanta që mund të marrë komunikimi njerëzor, si poezia ose narrativa historike. Secili lloj letërsie ka procedurat e veta të veçanta nga ana hermeneutike, përpos parimeve të përgjithshme që vlejné për çdo letërsi të shkruar.

Gjini. Vjen nga një term francez (“zhanër”) që nënkupton llojet e ndryshme të letërsisë. Thelbi i këtij termi është ndarja e formave letrare në kategori që kanë karakteristika të përbashkëta: narrativa historike, poezia, fjalët e urta, apokaliptikja dhe legjislacioni.

Gjuhë përshkrimi. Kjo përdoret në lidhje me idiomat ku është shkruar Dhiata e Vjetër. I flet botës sonë në kuadër të mënyrës sesi na shfaqen gjërat ndaj pesë shqisave. Nuk është përshkrim shkencor, dhe as nuk synon të jetë i tillë.

Hermeneutikë. Ky është term teknik për parimet që i prijné eksegjzës. Ajo është edhe një grup parimesh të veçanta, edhe art. Hermeneutika biblike, ose e shenjtë, zakonisht ndahet në dy kategori: parimet e përgjithshme dhe parimet e veçanta. Ato lidhen me llojet e ndryshme të literaturës që gjendet në Bibël. Secili lloj (gjini) i veçantë ka parimet e veta unike, por ndan edhe disa supozime dhe procedura të përbashkëta interpretimi.

I fjalëpërfjalshëm. Ky është një emër tjetër i metodës historike dhe me fokus tekstin, që erdhi nga Antiokia. Do të thotë se interpretimi përfshin kuptimin normal dhe të dukshëm të gjuhës njerëzore, ndonëse pranon gjithsesi dhe praninë e gjuhës së figurshme.

Idiomë. Kjo fjalë përdoret për frazat që gjenden në kultura të ndryshme, të cilat kanë kuptim të specializuar që nuk lidhet me kuptimin e zakonshëm të termave në vetvete. Disa shembuj të sotëm janë: “ishte tmerrësisht e shkëlqyer”, ose “ti më heq trurin”. Edhe Bibla përmban këto lloj frazash.

Induktive. Kjo është një metodë logjike ose arsyetuese që kalon nga elementet e veçanta te tërësia. Është metoda empirike e shkencës moderne. Në thelb, është qasja e Aristotelit.

JHVH. Ky është emri i Besëlidhjes i Perëndisë në Dhiatën e Vjetër. Përcaktohet në Eksodi 3:14. Është forma KAUZATIVE e termit hebraisht “jam”. Judenjtë druheshin të shqiptonin emrin, që të mos e merrnin më kot; prandaj, e zëvendësonin me termin hebraisht *Adonai*, “zot”. Kështu u përkthye në anglisht ky emër besëlidhjeje.

Judaizmi rabinik. Kjo fazë e jetës së popullit jude filloi me robërinë babilonase (586-538 para K.). Me humbjen e ndikimit të priftërinjve dhe Tempullit, sinagogat lokale u bënë fokusi i jetës judaike. Këto qendra lokale të kulturës, bashkësisë, adhurimit dhe studimit biblik jude u bënë fokusi i jetës fetare të kombit. Në kohën e Jezusit, kjo “fe e skribëve” ishte paralele me atë të priftërinjve. Pas rënies së Jerusalemit më 70 pas Krishtit, forma skribale, e mbizotëruar nga farisenjtë, vuri nën kontroll drejtimin e jetës fetare judaike. Karakterizohet nga interpretimi praktik dhe legalist i Torahut, i cili shpjegohet nga tradita gojore (Talmudi).

Kanon. Ky është një term i përdorur për të përshkruar ato shkrime që besohet se janë frymëzuar në mënyrë unike. Përdoret për Shkrimet e Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re.

Këta njerëz të urtë guxuan të bënin pyetjet e vështira të jetës. Shpesh, ata i sfidonin pikëpamjet fetare tradicionale (Jobi dhe Predikuesi). Ata formojnë një ekuilibër dhe tension ndaj përgjigjeve të lehta për tragjedite e jetës.

Kjo kategori teologjike po rritet nga lëvizja e “tokës së vjetër” ndër shkencëtarët e krishterë (p.sh., shkrimet e Hugh Ross). Ata e përdorin këtë kategori për të pohuar se gjithë e vërteta është e vërteta e Perëndisë. Natyra është derë e hapur për njohurinë rreth Perëndisë; është e ndryshme nga zbuluesia e veçantë (Bibla). Ajo i jep shkencës moderne lirinë që të hulumtojë rendin natyror. Për mendimin tim, ajo përbën një mundësi të re të shkëlqyer për t’i dëshmuar botës së sotme shkencore në përditë.

Komentar. Ky është një lloj i specializuar libri kërkimor. Ai jep një sfond të përgjithshëm për librin biblik. Pastaj, përpiket të shpjegojë kuptimin e çdo pjese të librit. Disa komentare fokusohen te zbatimi, ndërsa të tjerë e trajtojnë tekstin në mënyrë më teknike. Këta libra janë të dobishëm, por duhen përdorur pasi të kesh përfunduar studimin paraprak personal. Interpretimet e komentuesit nuk duhen pranuar kurrë me symbyllur. Zakonisht, krahasimi i disa komentareve që japin pikëvështrime të ndryshme teologjike është diçka e dobishme.

Kristocentrik. Ky është një term që përdoret për të përshkruar natyrën dhe rolin qendror të Jezusit. Unë e përdor në lidhje me konceptin se Jezusi është Zoti i gjithë Biblës. Dhiata e Vjetër dëfton drejt tij dhe ai është përbushja dhe synimi i saj (shih Mat. 5:17-48).

Kritika e lartë. Kjo është ajo procedurë e interpretimit biblik që fokusohet te sfondi historik dhe te struktura letrare e një libri të veçantë biblik.

Kritika e ulët. Shih “kritika e tekstit”.

Kritikë e tekstit. Ky është studimi i dorëshkrimeve të Biblës. Kritika e tekstit është e domosdoshme pasi nuk ekziston asnjë dorëshkrim origjinal dhe kopjet ndryshojnë nga njëra-tjetra. Ajo përpiket të shpjegojë variantet dhe të arrijë (sa më tepër të mundet) te fjalët origjinale të autografeve të Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re. Shpesh, quhet “kritika e ulët”.

Legalizëm. Ky qëndrim karakterizohet nga mbitheksimi i rregullave ose ritualeve. Priret të bazohet në zbatimet njerëzore të rregullave si mjet pranimi nga Perëndia. Priret të nënvlerësojë marrëdhënien dhe lartëson veprat, ndonëse këto janë të dyja aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së besëlidhjes mes Perëndisë së shenjtë dhe njerëzimit të mëkatshëm.

Leksik analitik. Ky është një lloj mjeti kërkimor që të lejon të identifikosh çdo formë greqisht në Dhiatën e Re. Leksiku është një përmbledhje, në rendin alfabeti greqisht, e formave dhe përcaktimeve bazë. Në kombinim me një përkthim ndërlinear, u mundëson besimtarëve që s’lexojnë dot greqisht që të analizojnë format gramatikore dhe sintaksore greqisht të Dhiatës së Re.

Letërsia apokaliptike. Kjo ishte në masën mbizotëruese (ndoshta, edhe në mënyrë unike) një gjini judaike. Ishte një lloj kriptik shkrimi që përdorej në kohë pushtimi dhe okupimi të judenjve nga fuqitë e huaja botërore. Supozimi i saj është se ngjarjet botërore janë krijuar dhe kontrollohen nga një Perëndi personal dhe shpengues, dhe se Izraeli ka rëndësi të veçantë për të dhe për përkujdesjen e tij. Kjo literaturë premton fitoren përfundimtare përmes përpjekjes së veçantë të Perëndisë.

Letërsia e urtësisë. Kjo ishte një gjini letërsie e përhapur në lindjen e afërt në lashtësi (si dhe në botën moderne). Në thelb, ishte përpjekje për të udhëzuar brezin e ri me udhëzime për jetë të suksesshme përmes poezisë, fjalëve të urta, ose eseve. I drejtohej më tepër individit sesa shoqërisë si kolektiv. Nuk përdorte aludime për historinë, por bazohej në përvojën dhe vëzhgimet nga jeta. Në Bibël, Jobi e deri te kënga e Këngëve merrnin si të sigurt praninë dhe adhurimin e JHVH, por ky botëkuptim fetar nuk është i shkoqur çdo herë, apo në çdo përjetim njerëzor.

Metonimia. Kjo është një figurë letrare, ku emri i diçkaje përdoret për të paraqitur diçka tjetër që shoqërohet me të. Për shembull, “po zien çajniku” do të thotë “po zien uji në çajnik”.

Mësuesit e rremë gnostikë përkrahnin dy sisteme të kundërta etike: (1) për disa, stili i jetesës s'kishte fare lidhje me shpëtimin. Sipas tyre, shpëtimi dhe spiritualiteti përmbliidhen në një njohuri të fshehtë (fjalëkalime) për të kaluar përmes sferave engjëllore (*eon-eve*); ose (2) për disa të tjera, mënyra e jetesës ishte kyçe për shpëtim. Ata theksonin një stil asket jetese si provë spiritualiteti të vërtetë.

Ndërlineare. Ky është një lloj mjeti kërkimor, i cili u lejon atyre që nuk njohin gjuhën biblike që të arrijnë të analizojnë kuptimin dhe strukturën e saj. Kjo metodë e vendos përkthimin në gjuhën tonë në nivelin “fjalë për fjalë”, poshtë gjuhës origjinale biblike. Ky mjet, i kombinuar me “leksikon analitik”, jep format dhe përcaktimet bazë të hebraishtes dhe greqishtes.

Nestorianizëm. Nestori ishte patriarku i Kostandinopojës në shekullin e petë. Ishte edukuar në Antioki të Sirisë dhe pohonte se Jezusi kishte dy natyra, një plotësisht njerëzore dhe një plotësisht hyjnore. Kjo pikëpamje shmangej nga pikëpamja ortodokse e Aleksandrisë se Krishti ka një natyrë. Preokupimi kryesor i Nestorit ishte titulli “nëna e Perëndisë”, që i ishte dhënë Marisë. Nestori (dhe, rrjedhimisht, edukimi i tij antiokas) u kundërshtua nga Kirili i Aleksandrisë. Antiokia ishte qendra e qasjes historiko-gramatikore dhe tekstuale ndaj interpretimit biblik, ndërsa Aleksandria ishte qendra e shkollës së katërfishtë (alegorike) të interpretimit. Në fund, Nestorin e hoqën nga posti dhe e çuan në syrgjyn.

Njësi letrare. Ka të bëjë me ndarjet kryesore të mendimit në librat biblikë. Mund të përbëhet nga disa vargje, paragrafë ose kapituj. Ajo përbën një njësi të vetëpërmbajtur me temë qendrore.

Papirus. Ky është një lloj materiali nga Egjipti mbi të cilin mund të shkruhej. Bëhej nga kallamet e lumit.

Papirusi është materiali në të cilin janë shkruar kopjet më të hershme të Dhiatës së Re në greqisht.

Paradoks. Ka të bëjë me ato të vërteta që duket sikur janë kontradiktore, por janë të dyja të vërteta, ndonëse në tension me njëra-tjetrën. Ato e inkuadrojnë të vërtetën duke e paraqitur nga anë të kundërta. Një pjesë e mirë e së vërtetës biblike paraqitet në formë dyshesh paradoksale (ose dialektike). Të vërtetat biblike nuk janë yje të izoluar, por janë njësi që përbëhen nga formacione yjesh.

Parafrazë. Ky është emri i një teorie të përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35.

Paragraf. Kjo është njësi interpretuese bazë në prozë. Përmban një mendim qendror dhe zhvillimin e tij. Nëse qëndrojmë te mesazhi i tij kryesor, nuk do të përqendrohemi te pikat anësore, as nuk do të humbasim synimin e autorit fillestar.

Pasazhet paralele. Ato janë pjesë e konceptit se gjithë Bibla është e dhënë nga Perëndia dhe, si rrjedhojë, është interpretuesja më e mirë e vetes si dhe drejtpeshuesja e të vërtetave paradoksale. Kjo është e dobishme edhe kur përpiqemi të interpretojmë një pasazh të paqartë ose të dykuptimtë. Pasazhet paralele na ndihmojnë edhe që të gjejmë pasazhin më të qartë për një temë të dhënë, si dhe gjithë aspektet e tjera biblike të një teme të dhënë.

Pergamenat e Detit të Vdekur. I referohet një serie me tekste të lashta, të shkruara në hebraisht dhe aramaisht, që u gjetën pranë Detit të Vdekur më 1947. Ato ishin bibliotekat fetare të judaizmit sektar të shekullit të parë. Trysnia e pushtimit romak dhe luftërat zelote të viteve '60 i shtynë që t'i fshihnin pergamenat në qypa qeramike të mbyllur hermetikisht, duke i vendosur në shpella ose vrima. Ato na kanë ndihmuar të kuptojmë sfondin historik të Palestinës së shekullit të parë dhe kanë vërtetuar se Teksti Masoretik është shumë i saktë, të paktën që nga fundi i periudhës para Krishtit. Ato emërtohen me shkurtimin “DSS”.

Përkues. Ky është një lloj mjeti kërkimor për studimin e Biblës. Ai rendit çdo përdorim të çdo fjale në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Na ndihmon në një sërë mënyrash: (1) përcakton fjalën hebraisht ose greqisht që qëndron pas çdo fjale të caktuar në gjuhën tonë; (2) krahason pasazhet ku është përdorur e njëjta fjalë në greqisht ose hebraisht; (3) tregon se ku dy terma të ndryshëm hebraisht ose greqisht janë përkthyer me të njëjtën fjalë në gjuhën tonë; (4) tregon shpeshësinë e përdorimit të disa fjalëve në libra ose autorë të caktuar; (5) na ndihmon të gjejmë një pasazh të caktuar në Bibël (shih Walter Clark, *How to Use New Testament Greek Study Aids*, f. 54-55).

Përndritja. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia i ka folur njerëzimit. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulues – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta

shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbuluesën e tij.

Përshkrimi simbolik i botës dhe botëkuptimi. Këta terma janë shoqërues të njëri-tjetrit. Të dy janë koncepte filozofike të lidhur me krijimin. Termi “përshkrim simbolik i botës” lidhet me “si-në” e krijimit, ndërsa “botëkuptimi” lidhet me “Kush-in”. Këta terma gjejnë përdorim në interpretimin se Zanafilla 1-2 trajton kryesisht “Kush-in”, jo “si-në”, e krijimit.

Platoni. Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë. Filozofia e tij pati ndikim të jashtëzakonshëm në kishën e hershme përmes studiuesve nga Aleksandria e Egjiptit dhe, më vonë, nga Augustini. Platoni besonte se gjithçka në tokë ishte iluzion dhe thjesht kopje e një arketipi shpirtëror. Më vonë, teologët i barazuan “format/idetë” e Platonit me sferën shpirtërore.

Presupozim. Ka të bëjë me mënyrën e parakonceptuar si kuptojmë diçka. Shpesh, mendimet ose gjykimet tona për çështje të ndryshme i formojmë përpara se të shkojmë te vetë Bibla. Kjo predispozitë njihet edhe si anësi, si pozicion *a priori*, si supozim, ose si botëkuptim paraprak.

Provincializëm. Ka të bëjë me anësitë e rrënjosura në një sfond lokal teologjik/kulturor. Ai nuk e njeh natyrën ndërkulturore të së vërtetës biblike, apo zbatimin e saj.

Septuagintë. Ky është emri që iu dha përkthimit greqisht të Dhiatës së Vjetër hebraike. Tradita thotë se u shkrua në shtatëdhjetë ditë nga shtatëdhjetë studiues judenj për bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Data tradicionale është rreth 250 para K. (në të vërtetë, u deshën mbi njëqind vjet që të përfundonte). Ky përkthim është i rëndësishëm pasi (1) na jep një tekst të lashtë për ta krahasuar me tekstin hebraisht Masoretik; (2) na tregon gjendjen e interpretimit judaik në shekullin e tretë dhe të dytë para K.; (3) na jep botëkuptimin mesianik të judenjve përpara se të refuzonin Jezusin. Shkurtimi i tij është “LXX”.

Si gjini, ajo shprehte të vërteta të përgjithshme. Sidoqoftë, kjo gjini nuk mund të përdoret në çdo situatë të veçantë. Këto janë pohime të përgjithshme që nuk zbatohen gjithmonë në çdo situatë individuale.

Sinaitikus. Ky është një dorëshkrim greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjet nga studiuesi gjerman, Tischendorf, në manastirin e shën Katerinës në Xhebel Musa, vendi tradicional i malit Sinai. Ky dorëshkrim u emërtua me shkronjën e parë të alfabetit hebraik “alef” [א]. Përmban Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Është një nga dorëshkrimet tona më të lashta uncialë.

Sinonimik. Ka të bëjë me terma që kanë kuptime të njëjta ose shumë të ngjashme (ndonëse, në realitet, dy fjalë nuk kanë kurrë mbivendosje të plotë semantike). Ato janë të lidhura kaq ngushtë sa që mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në fjali pa i humbur kuptimin. Ky term përdoret edhe për të përcaktuar një nga tri format e paralelizmit poetik hebre. Në këtë kuptim, u referohet dy rreshtave poetikë që shprehin të njëjtën të vërtetë (shih Psa. 103:3).

Sintaksë. Ky është një term greqisht që i referohet strukturës së fjalisë. Lidhet me mënyrat sesi bashkohen pjesë e fjalisë për të dhënë një mendim të plotë.

Sintetik. Ky është një nga tri termat që lidhet me llojet poezisë hebraike. Ky term bën fjalë për ata rreshta poetikë që ndërtohen mbi njëri-tjetrin në mënyrë shtuese, nganjëherë, e quajtur “kulmore” (shih Psa. 19:7-9).

Shkolla aleksandriane. Kjo metodë e interpretimit biblik u zhvillua në Aleksandri të Egjiptit në shekullin e dytë pas Krishtit. Ajo përdor parimet interpretuese bazë të Filos, i cili ishte ndjekës i Platonit. Shpesh, ajo quhet metoda alegorike. Ajo mbizotëroi në kishë deri në kohën e Reformacionit. Përkrahësit më të aftë të saj ishin Origeni dhe Augustini. Shih Moises Silva, *Has The Church Misread The Bible?* (Academic, 1987).

Shkolla antiokase. Kjo metodë interpretimi biblik u zhvillua në Antioki të Sirisë në shekullin e tretë pas Krishtit si reagim ndaj metodës alegorike të Aleksandrisë në Egjipt. Thelbi bazë i saj ishte përqendrimi te kuptimi historik i Biblës. Ajo e interpretonte Biblën si letërsi normale dhe njerëzore. Kjo shkollë u përfshi në polemikën nëse Krishti kishte dy natyra (nestorianizmi) apo një natyrë (plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri). U shpall heretike nga kisha katolike e Romës dhe u zhvendos në Persi, por shkolla pati pak peshë. Më vonë, parimet e saj hermeneutike bazë u bënë parime interpretuese të reformatoreve klasikë të protestantizmit (Luteri dhe Kalvini).

Shpirtërizim. Ky term është sinonimik me alegorizimin, në kuptimin se përjashton kontekstin historik e letrar të pasazhit dhe interpreton në bazë të kriterëve të tjera.

Talmudi. Ky është titulli i kodifikimit të traditës gojore judaike. Judenjtë besojnë se Perëndia ia dha Moisiut në malin Sinai. Në të vërtetë, Talmudi duket se është urtësia kolektive e mësuesve judenj ndër vite.

Ekzistojnë dy versione të ndryshme të shkruara të Talmudit: versioni babilonas dhe versioni më i shkurtër dhe i papërfunduar palestinas.

Teksti Masoretik. Kjo u referohet dorëshkrimeve hebraisht të Dhiatës së Vjetër në shekullin e nëntë, të prodhuara nga breza studiuesish judenj, të cilat përmbajnë pikësime zanoresh dhe të tjera shënime tekstuale. Ai përbën tekstin bazë për Dhiatën e Vjetër në gjuhën tonë. Teksti i tij është vërtetuar historikisht nga dorëshkrimet në hebraisht, sidomos Isaia, të njohura si Pergamenat e Detit të Vdekur. Shkurtohet si “MT”.

“Teksti provë”. Kjo është praktika e interpretimit të Shkrimit duke cituar një varg pa patur parasysh kontekstin e tij të atypëratyshëm apo kontekstin më të gjerë të njësisë së tij letrare. Kjo i largon vargjet nga synimi i autorit fillestar dhe, zakonisht, përfshin përpjekjen për të provuar një mendim personal duke pretenduar autoritet bibliik.

Tekstus Receptus. Ky përcaktim u zhvillua në botimin e DhR greqisht prej Elzevirit më 1633 pas K. Në thelb, kjo është një formë e DhR greqisht që u prodhua nga disa dorëshkrime të vona greqisht dhe versione latinisht të Erazmit (1510-1535), Stefanusit (1546-1599) dhe Elzevirit (1624-1678). Në *An Introduction to the Textual Criticism of the New Testament*, f. 27, A. T. Robertson thotë: “praktikisht, teksti bizantin është Textus Receptus”. Teksti bizantin është më pak i vlefshmi nga tre familjet e dorëshkrimeve të hershme greqisht (perëndimore, aleksandriane dhe bizantine). Ai përmban gabimet e akumuluar prej shekujsh të teksteve të kopjuara me dorë. Megjithatë, edhe A. T. Robertson thotë: “Textus Receptus ka ruajtur për ne një tekst, në thelb, të saktë” (f. 21). Kjo traditë e dorëshkrimeve greqisht (sidomos botimi i tretë i Erazmit i 1522) përbën bazën e përkthimit të King James Version më 1611.

Teologji sistematike. Kjo është një fazë interpretimi që përpiket t’i lidhë të vërtetat e Biblës në mënyrë të unifikuar dhe logjike. Ajo përbën një paraqitje logjike, jo thjesht historike, të teologjisë së krishterë nëpërmjet kategorive (Perëndia, njeriu, mëkati, shpëtimi, etj.).

Tipologjik. Ky është një lloj i specializuar interpretimi. Zakonisht, nënkupton të vërtetën e Dhiatës së Re që gjendet në pasazhet e Dhiatës së Vjetër me anë të një simboli analogjik. Kjo kategori e hermeneutikës është element kryesor i metodës aleksandriane. Për shkak të abuzimit me këtë lloj interpretimi, duhet që përdorimin e tij t’ia rezervojmë vetëm shembujve të veçantë të regjistruar në Dhiatën e Re.

Torah. Ky është term hebraisht, që do të thotë “mësim”. U bë titulli zyrtar për shkrimet e Moisiut (Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë). Për judenjtë, është pjesa më e autoritetshme e kanonit hebre.

Vatikanus. Ky është dorëshkrimi greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjend në bibliotekën e Vatikanit. Në fillim, përmbante gjithë Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe Dhiatën e Re. Sidoqoftë, disa pjesë humbën (Zanafilla, Psalmet, Hebrenjve, letrat pastorale, Filemoni dhe Zbulesa). Është dorëshkrim shumë i dobishëm për përcaktimin e fjalëve origjinale të autografeve. Është emërtuar me shkronjën e madhe “B”.

Vulgata. Ky është emri i përkthimit të Biblës në latinisht nga Jeronimi. Ai u bë përkthimi bazë, ose “i përbashkët”, i kishës katolike të Romës. U bë në vitet 380 pas K.

Zbulesa e natyrshme. Kjo është një kategori e vetëzbulesës së Perëndisë ndaj njeriut. Ajo përfshin rendin e natyrshëm (Rom. 1:19-20) dhe ndërgjegjen morale (Rom. 2:14-15). Përmendet në Psa. 19:1-6 dhe Rom. 1-2. Duhet dalluar nga zbulesa e veçantë, e cila është vetëzbulesa e veçantë e Perëndisë në Biblën dhe, epërsisht, në Jesusin e Nazaretit.

Zbulesë. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia ka folur me njerëzimin. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

SHTOJCA KATËR

DEKLARATË DOKTRINARE

S'është se dua t'ia di për deklaratat doktrinare apo kredot. Parapëlqej të pohoj vetë Biblën. Gjithsesi, e kuptoj se një deklaratë besimi do t'u sigurojë atyre që s'më njohin një mënyrë për të vlerësuar këndvështrimin tim doktrinor. Në kohën tonë, të mbushur me kaq shumë gabime dhe mashtrime teologjike, ofroj shkurtimisht më poshtë përmbledhjen e teologjisë sime.

1. Bibla, si Dhiata e Vjetër ashtu dhe e Reja, është Fjala e frymëzuar, e pagabueshme, e autoritetshme dhe e përjetshme e Perëndisë. Ajo është vetëzbuluesja e Perëndisë, e shkruar nga njerëzit nën drejtimin e mbinatyrshëm hyjnor. Ajo është burimi ynë i vetëm i së vërtetës së qartë për Perëndinë dhe për synimet e tij. Po kështu, ajo është burimi i vetëm i besimit dhe praktikës për kishën e tij.

2. Ekziston vetëm një Perëndi i përjetshëm, krijues dhe shpengues. Ai është krijuesi i të gjitha gjërave, të dukshme dhe të padukshme. Ai e ka zbuluar veten si Perëndi i dashur dhe i dhembshur, ndonëse është edhe i paanshëm e i drejtë. Ai e ka zbuluar veten në tre persona të veçantë: Ati, Biri dhe Fryma; vërtet të veçantë por, megjithatë, të njëjtë për nga substanca.

3. Perëndia është aktivisht në kontroll të botës së vet. Ekziston një plan i përjetshëm për krijimin e tij, që është i pandryshueshëm, por edhe një plan i fokusuar tek individ, që lejon vullnetin e lirë njerëzor. Asgjë nuk ndodh pa njohurinë dhe lejen e Perëndisë, por, megjithatë, ai lejon zgjedhje individuale ndër engjëjt dhe njerëzit. Jezusi është Njeriu i Zgjedhur i Atit dhe të gjithë janë potencialisht të zgjedhur në të. Paranjohja e ngjarjeve nga ana e Perëndisë nuk i ul njerëzit në nivelin e një skenari të parashkruar dhe të paracaktuar. Të gjithë jemi përgjegjës për mendimet dhe veprat tona.

4. Njerëzimi, ndonëse i krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë dhe i lirë nga mëkati, zgjodhi të ngrinte krye kundër Perëndisë. Ndonëse u tunduan nga një veprues i mbinatyrshëm, Adami dhe Eva ishin përgjegjës për egoizmin e tyre rebel. Kryengritja e tyre ka prekur njerëzimin dhe krijimin. Të gjithë kemi nevojë për mëshirën dhe hirin e Perëndisë, si për gjendjen tonë kolektive në Adamin, ashtu dhe për kryengritjen tonë të vullnetshme si individë.

5. Perëndia i ka siguruar njerëzimit të rënë një mënyrë faljeje dhe rimëkëmbjeje. Jezu Krishti, biri i pashoq i Perëndisë, u bë njeri, bëri një jetë të pamëkatë dhe, me anë të vdekjes së vet zëvendësuese, pagoi dënimin për mëkatin e njerëzimit. Ai është e vetmja rrugë për rimëkëmbjen dhe bashkësinë me Perëndinë. Nuk ka mënyrë tjetër shpëtimi përveçse përmes besimit në veprën e përfunduar të tij.

6. Secili prej nesh duhet të pranohet personalisht ofertën e faljes së Perëndisë dhe rimëkëmbjes në Jezusin. Kjo arrihet me anë të besimit të vullnetshëm në premtimet e Perëndisë përmes Jezusit, duke i kthyer vullnetshëm shpinën mëkateve të njohura.

7. Të gjithë ne falemi dhe rimëkëmbemi plotësisht në bazë të besimit në Krishtin dhe pendimit nga mëkati. Sidoqoftë, provat për këtë marrëdhënie të re shihen në jetën e ndryshuar dhe në ndryshim e sipër të besimtarit. Synimi i Perëndisë për njerëzimin nuk është vetëm qielli dikur në të ardhmen, por ngjashmëria me Krishtin tani. Ata që janë vërtet të shpenguar, ndonëse mëkatojnë ndonjëherë, do të vazhdojnë me besim dhe pendim gjatë gjithë jetës.

8. Fryma e Shenjtë është "Jezusi tjetër". Ai është i pranishëm në botë për të drejtuar të humburit të Krishti dhe për të zhvilluar ngjashmërinë me Krishtin të shpëtuarit. Dhuntitë e Frymës jepen kur shpëtohem. Ato janë jeta dhe shërbesa e Jezusit, të ndara brenda trupit të tij, kishës. Dhuntitë, të cilat në thelb janë qëndrimet dhe motivet e Jezusit, duhen motivuar me anë të frytit të Frymës. Fryma është po aq veprues në kohën tonë sa dhe në kohët biblike.

9. Ati e ka bërë Jezu Krishtin e ringjallur Gjykatës të të gjitha gjërave. Ai do të kthehet në tokë për të gjykuar gjithë njerëzimin. Ata që kanë besuar në Jezusin, emrat e të cilëve janë në librin e jetës së Qengjit, do të marrin trupa të përlëvduar dhe të përjetshëm kur të kthehet ai. Ata do të jenë përjetësisht me të. Ndërsa ata që s'kanë pranuar t'i përgjigjen së vërtetës së Perëndisë do të ndahen përjetësisht nga gëzimet e bashkësisë me Perëndinë Triun. Ata do të dënohen së bashku me Djallin dhe engjëjt e tij.

Sigurisht, kjo nuk është as e plotë, as tërësore, por shpresoj se do t'ju japë sadopak ngjyrimin teologjik të zemrës sime. Mua më pëlqen shprehja:

“Në thelbësoret – unitet; në jothelbësoret – liri; në gjithçka – dashuri”.